

ENVER HOXHA

Kur lindi Partia

Kujtime

«Kur lindi Partia» është libri i parë në serinë e kujtimeve të shokut Enver Hoxha për periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Materialet e këtij libri, të shkruara gjatë viteve 1975-1976, u kushtohen luftës dhe përpjekjeve të komunistëve shqiptarë për krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, kurorëzimit të këtyre përpjekjeve më 8 Nëntor 1941 dhe ngjarjeve kryesore të jetës dhe të veprimtarisë së Partisë Komuniste të Shqipërisë gjatë viteve të Luftës Nacionalçlirimtare.

Ky libër, i hotuar me rastin e 40-vjetorit të Themelimit të Partisë, e bën akoma më të plotë dhe konkrete njohjen e asaj periudhe të lavdishme të historisë së popullit e të Partisë sonë.

NE ATO DITË E NET KUR LINDI PARTIA

Përballë pushtimit

Pushtimi i atdheut nga Italia fashiste, më 7 prill 1939, ishte për popullin tonë një nga ngjarjet më të hidhura të historisë. Sidomos për ne, komunistët shqiptarë të asaj kohe, kjo ngjarje e rëndë ishte jo vetëm burim i dhimbje, s më të thellë, por edhe rënie e alarmit më të madh. Misioni ynë, si komunistë, ishte që në ato ditë të ngrinim popullin në këmbë, të viheshim në ballë të tij, ta mobilizonim në luftën supreme për lirinë dhe pavarësinë e atdheut në rrezik. Dëshira, vullneti dhe gatishmëria nuk na mungonin për kryerjen e kësaj vepre sublime, patriotizmin dhe shpirtin e sakrificës së popullit i njihnim, bile edhe përpjekjet e para i bëmë. Por të tjera shkaqe, të tjerë faktorë e kushte bënë të mundur realizimin në prill 1939 të njëres prej tragjedi më të rënda në historinë shumëshekullore të popullit tonë.

Kurrë nuk do vi harroj ato ditë të zeza, kur filloi të errësohej qielli i atdheut tonë, kur Italia fashiste e Musolinit na kërcënonte me invadim. Ndodhesha në Korçë, ku që prej vitit 1937 punoja si mësues në Liceun e mirënjohur të atij qyteti. Sapo kisha dalë nga mësimi, kur një i njohuri im më ndali i tronditur:

- E more vesh? - më tha, - Musolini i drejtoi Shqipërisë ultimatim !

Më beta për një moment si i ngrirë. Prej ditësh qarkullonin zëra nga më të ndryshmit e më kontradiktorët për mundësinë e një agresioni fashist mbi Shqipërinë; çdo mbrëmje, gjer natën vonë,

ndiqnim me ankth emisionet e, radiove të huaja për të marrë vesh diçka më të saktë, por dhe ato, ashtu si Radio Tirana Ilomotitnin gjithçka, por vetëm të vërtetën e tmerrshme që po përgatitej e mbanin krejtësisht të fshehur.

E ja, tani, një populi i tërë, i tradhtuar poshtërsisht, ndodhej ballë për ballë agresionit.

U nisa me shpejtësi për në farkëtarinë e mikut tim proletar, veteranit komunist, Pilo Peristeri. Dhe çfarë ironie! Ndërsa rendja rrugës, në veshë më vinin tingujt e një muzike banale që transmetonte Radio Tirana, radioja mbretërore! Ishin çastet kur duhej të binin me të gjithë forcën kambanat e alarmit; ishin çastet kur duhej të shpërthente kushtrimi i madh i historisë, ndërsa mbreti tradhtar, regjimi i tij i kalbur guxonin akoma të mashtronin e të çoroditnin opinionin, përpiqeshin të mbytnin të vërtetën e ta paraqitnin gjendjen sikur s'kishte ndodhur e s'do të ndodhte asgjë me rëndësi.

Piloja, sapo më dëgjoi, e mbylli menjëherë farkën.

- Po shkoj te Miha, - tha. - Të mblidhemi.

- Të ngrihemi menjëherë në demonstrata, - i thashë. - Unë po shkoj në Lice,

Siç dihet në Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë, Shkodër e në gjithë Shqipërinë, shpërthyen menjëherë demonstratat e popullit. Në ballë të tyre ishin komunistët, të cilët, të ndërgjegjshëm se mbreti, qeveria dhe ushtria mbretërore e kishin tradhtuar përfundimisht atdheun, po merrnin përsipër misionin e udhëheqjes së popullit për rezistencë. Me iniciativën e komunistëve e të nacionalistëve patriotë në shumë qytete u krijuan qendrat e regjistrimit të vullnetarëve për luftë kundër agresorëve. Por, me gjithë përpjekje, dhe veprimet revolucionare që u ndërmoren, ato ditë akoma më në pah doli e meta e madhe e lëvizjes sonë komuniste grupet komuniste ishin të përçara, ato nuk ishin në gjendje për t'u paraqitur në momentet e rënda të atdheut si një udhëheqje, e vetme dhe e aftë të mobilizonte popullin në luftë.

Sidoqoftë, komunistët e grupeve të ndryshme u vunë në krye të aksioneve patriotike antifashiste.

Në Korçë Grupi Komunist «Puna», siç quhej në atë kohë, doli në ballë si kurdoherë. Studentë e profesorë të Liceut, së bashku, u vërsulën nëpër rrugë e buleva rde.

- Poshtë Italia! Poshtë Musolini! - shpërthyen thirrjet që në portat e Liceut. Ndërkaq në rrugë vërshuan punëtorë, zanatçinj, mësues, nxënës, gra shtëpiake, të rinj e pleq.

- Poshtë Zogu! Duam armë! Duam të luftojmë! - buçitën si kurrë ndonjëherë zërat e fuqishëm të punëtorisë e të rinisë korçare.

Prefekti dhe kryetari i Bashkisë, të frikësuar e si minjtë në dhokan, ishin mbyllur në zyra, të mbrojtur nga xhandarë. Vala e popullit, duke kënduar këngët patriotike të vjetra e të reja, po vazhdonte demonstratat me zemërim të papërmbajtur. Demonstratat vazhduan gjithë ato ditë me furi dhe e elektrizuan mbarë opinionin. Populli nuk nënshtrohej, ai s'trembej nga invazori i tmerrshëm, ai ishte i gatshëm të derdhte gjakun për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Por tradhtia e madhe. nuk ishte përgatitur vetëm në sarajet e Zogut e në kulisat e agjentëve e të misionarëve italiano. Gjithë aparati shtetëror i mbretit satrap iu kundërvu hapur kërkesave nga poshtë por mobilizimin e armatimitin e përgjithshëm të popullsisë. Në këtë situato Grupi i Korçës, duke i çmuar seriozisht gjendjen e rëndë të atdheut dhe. dëshirën e zjarrtë të popullit por ta pritur agresorin me plumba, mori iniciativë të bëhej një mbledhje në Bashkinë e qytetit dhe të merrej fuqia nga ana e përfaqësuesve të popullit.

Për këtë qëllim u caktuan disa shokë, në mes të të cilëve edhe uno.

Gjithë rrugët ishin mbushur me, popull, veçanërisht Bulevardi i Shëngjergjit, ku ndodhej godina e Bashkisë dhe ku ishte vendosur të zhvillohej mbledhja. Shokët punëtorë, në formacione lufte, me shkopinjë në duar, kishin zënë pikat kyçe të rrugëve nga ku mund të sulmonte forca e xhandarmërisë, e demoralizuar dhe kjo, por kurdoherë non urdhrin e prefektit Veli Vasjari, i cili qe mbyllur në prefekturë, në shtëpinë e Rakos. Ne, si grup komunist. kishim vendosur paraprakisht që në këtë mbledhje të arrihej sidomos në dy konkluzione të rëndësishme: Sé pari, të regjistroheshin menjëherë vullnetarë popullorë dhe, me komunistë në krye, të niseshin por në Durrës; së diti, të organizohej rezistenca e përgjithshme me armë kundër pushtuesit. kur kv të marshonte drejt Korçës.

Mbledhja kishte karakter kombëtar, patriotik, prandaj merrnin pjesë jo vetëm komunistë, por kishim thirrur edhe patriotë, edhe «nacionalistë». Në mbledhje erdhën dhe Fazlli Frashëri e Loni Kristo, sollën dhe Zai Fundon tok me këlyshin e Fazllit, Stavri Skëndin.

Filluam diskutimet. Natyrisht, tonat ishin të zjarrta, radikale, kundër pushtuesit dhe kundër Zogut e regjimit të tij të urryer që po na sillte katastrofën më të rëndë.

- Kohë por ligjërata të gjata nuk ka, - këmbëngulëm ne. - Armiku po troket në portat tona. Nëse jemi patriotë të vërtetë, nëse jemi kundër pushtuesit, të marrim masa të menjëhershme, - dhe paraqitëm hapur propozimet që kishim vendosur në Grupin Komunist. Diskutimet në mes nesh dhe oportunistëve u acaruan.

- Të mos ngutemi, të presim ç'do të bëjnë patriotët në Tiranë! - propozonin oportunistët me Fazlli Frashërin në krye.

- «Të presësh» do të thotë të pranosh pushtimin fashist, - kundërshtonim ne me forcë. - Çdo çast është në favor të armikut.

Gjendja u elektrizua.

Në mendje, ato caste, më vinin ngjarjet e mëdha të historisë luftarake të popullit tonë, përpjekjet dhe betejat e tij të pareshtura por liri e pavarësi kombëtare; para sysh më dilte Selam Musa Salaria me shokë, që, njëzet vjet më parë, i hodhën në det ushtritë zaptuese të atij mbreti e të asaj mbretërie që tani na kanosnin me një robëri tjetër të rëndë. Na buçiste në veshë kënga luftarake «Vlora-Vlora», e cila na thërriste të ngriheshim përsëri në këmbë. Përpara më dilnin ngjarjet e mëdha të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës, që i kisha mësuar në shkollë, përpara më dilte Revolucion i Madh i Tetorit dhe mësimet e Leninit, që i mësonim në pasticerinë e Koci Bakos. Prandaj, i mbështetur nga shokët, u ngrita e propozova:

- Të krijojmë menjëherë një komitet për shpëtimin e atdheut, të mobilizojmë e të organizojmë të rinj e të moshuar, t'i armatosim, t'u presim rrugën fashistëve italianë që po na kërcënojnë me pushtim. Po ashtu, flitet se Ahmet Zogu po përgatitet të ikë vjedhurazi për në Greqi. Është detyra jonë, e do nderi i këtij populli që po demonstroi kudo nëpër rrugë e sheshe që t'i presim udhën edhe mbretit kapitullant e frikacak e t'i japim atë që meriton.

- Dale, more djalë, qysh thënke kështu për naltmadhërinë! - u hodh një nga «patriotët» afendikonj. Ai ka deklaruar se, po ta dojë nevoja, do të veshë opingat.

- Ve.ç jo për të luftuar, por për t'ia mbathur, thirri njëri nga shokët tanë.

Më kujtohet se plasi një rrëmujë e madhe. Ne të rinjtë ishim për veprime, të tjerët skuqeshin, zverdheshin, bërtitnin: «Të mos shpejtohemi», «Të mos hyjmë në konflikt me qeverinë».

Sigurisht brenda kishte dhe agjentë të prefektit, të cilët, në mes të rrëmujës, e vunë në korent për gjithçka ndodhte me anë të telefonit ose dërguan ndonjërin, si Petraq Katron, një tregtar prozogist.

Kur po diskutonim, hynë në sallë një kapedan i xhandarmërisë dhe disa të dërguar, të njohur si njerëz të prefektit, të cilët urdhëruan, në emër të këtij të fundit, të shpërndahej mbledhja, se, përndryshe, do t'i je pej urdhër xhandarmërisë «të vendoste rregullin». Nuk më kujtohet mirë, por më duket se Piloja u doli për para dhe u tha:

- S'kemi frikë as nga kërcënimet e prefektit, as nga tuajat, as nga sulmi i xhandarëve, jemi ndeshur edhe herë të tjera me xhandarët e Zogut dhe dimë të luftojmë. I thoni prefektit ta lëshojë xhandarmërinë dhe

do të shohë se ç'do të ngjasë. Pa hidhni një sy në bulevard, zotërinj të xhandarmërisë, dhe do të bindeni!

Turma jashtë, e egërsuar, bërtiste dhe hidhte parulla kundër Italisë, kundër regjimit.

Rrugët që ishin plot me popull dhe shokët që ki

shin zënë vende gati për t'u përleshur me xhandarmërinë, e trembën prefektin të mente masat me të cilat na kërcënoi.

Në mbledhje kërkua me këmbëngulje të na dorëzoheshin armë, përndryshe do të sulmoheshin depot.

Ndërkaq na erdhi «ultimatumi» i komandantit të xhandarmërisë së qarkut:

- Populli do të marrë armë vetëm kur të më vijë urdhri nga lart, prandaj shpërndahuni!

Por jashtë sheshi e rrugët gjëmonin:

- Armë ! Armë ! Duam armë !

Fazlli Frashëri, Zai Fundo dhe të tjerë nga paria,

gjoja patriotë dhe nacionalistë e ndien rrezikun dhe, pas një konsultimi me Zain, u ngrit Fazlli Frashëri:

- Dëgjoni, bre vëllezër, - nisi të thoshte. - T'i pjekim mirë këto punë. Për të evituar vëllavrasjen, se çdo gjë mund të ngjasë, më lejoni të vele vetë te prefekti të bisedoj me të dhe t'i transmetoj dëshirën e mbledhjes.

- Vendimin e mbledhjes, - bërtiti një punëtor nga mesi i sallës.

Fazlliu doli dhe u kthye me vonesë, duke na thënë:

- Prefekti më dëgjoi me indulgjencë, por duhet t'i lëmë kohë deri nesër, sa të japë urdhrat e nevojshëm, pse tash është vonë.

Asnjëri nuk i besoi kësaj gënjeshtre. Megjithatë, vendosëm që mbledhjen ta linim për të nesërmen në mëngjes. Por të nesërmen xhandarët dhe ushtria e krimbur që kishte mbetur, kishin zënë rrugët dhe sheshet. Oñicerët e Zogut, të mbrojtur dhe të armatosur, kishin marrë parullën: «Po përgatitemi për të luftuar, kemi urdhër nga mbreti». Po luhej akti i fundit, më i turpshmi i tradhtisë. Të gjitha këto ishin llafe për ta qetësuar popullin që ziente. Në këtë situatë ne, komunistët e Grupit të Korçës, filluam të përpilonim listat e vullnetare've, që ishin të gatshëm të niseshin drejt Durrësit.

Njerëzit e thjeshtë të popullit, punëtorë, zanatçinj, liceistë, vinin dhe shënonin emrin e tyre me natyrshmërinë e birit, që është gati të japë jetën për tokën mëmë. Me mijëra burra dhe gra qëndronin para ndërtesës së Bashkisë dhe Monumentit të Luftëtarit Kombëtar, që ishte kthyer në një simbol të shenjtë të luftërave të popullit tonë për liri e pavarësi dhe vazhdonin të thërritnin: «Duam armë!», «Rroftë liria Shqipërisë!», «Rroftë Flamuri!», ndërsa këngët patriotike, si ajo «Për mëmëdhenë» e, të tjera, këndoheshin me zjarr nga mëngjesi deri në orët e vona të natës.

Autoritetet e vendit vërtiteshin të shqetësuar, xhandarmëria ishte gati të qëllonte jo mbi armikun që kërcënonte atdheun, por mbi popullin që donte ta inbronte atdheun. Dhe, ndërsa Fazlli Frashëri me kompani lexonin plot pompozitet e bujë telegramet e «protestës» për «gjëmën e mëmëdheut», njëfarë Eqrem Telhai, toger zogist në atë kohë e më vonë, oficer fashist, ballist, agjent i anglezëve, e çfarë të duash, bërtiste në kafene:

- Më në fund na erdhi dita t'ia tregojmë qejfin Italisë.

Kjo qe një farsë e, poshtër. Ndërsa i gjithë populli, anembanë vendit ishte ngritur në këmbë, ishte derdhur në rrugë dhe kërkonte armë, ndërsa populli dhe rinia e Tiranës sulleshin në muret e, pallatit të xhelatit Ahmet Zog, të ruajtura nga mijëra xhandarë dhe thërritnin: «Armë! Armë!», zëdhënësi i katilit dilte në ballkon dhe deklaronte : «Mbani qetësinë se lartmadhëria ka vendosur të veshë opingat dhe të dalë me ju në mal!». Por, kur rinia e Tiranës, që nuk gënjehej, iu vërsul kazermave për të rrëmbyer armët, ato i kishin sabotuar tradhtarët dhe agjentët e Italisë: pushkët ishin pa shule. Mirëpo demonstratat vazhdonin. Në Tiranë njerëzit e Zogut lëshuan alarmin: «Sot pasdite do të vijnë avionët italianë të bombardojnë, rrini nëpër shtëpia e mbrohuni ku të mundni!». Qytetarët e Tiranës, për të mbrojtur familjet dhe, fëmijët, u mbyllën në bodrume e disa ikën në periferi ose në fshatrat e afërta. E gjithë kjo zhurmë e «kapedanëve» të Zogut kishte për qëllim t'i siguronte rrugën mbretit

satrap dhe familjes së tij, që të arratisesh si bandit e si kusar që ishte, duke marrë me vete edhe arin e shtetit.

Në këto kushte, kur ushtria dhe xhandarmëria u lanë në fatin e vet dhe të tradhtuar ngritën duart, në Tiranë, në Durrës, në Elbasan e gjetkë u krijuan patr ulla nga komunistët e grupeve dhe të rinj. Në Elbasan këta i zunë pritë kolonës së makinave të mbretit, por satrapin nuk mundën ta kapnin. Zogu, si cub, çau ferrën.

Në Korçë ato ditë kishte ardhur një njeri i mbretit, Qazim Bodinaku, ndofta me, mision që të përgatiste kalimin e Zogut, të familjes e të suitës nga Kapshtica për në Greqi. Por, një mëngjes, prefekti zogist, element i urryer e kriminel, u gjend i vrarë në hotel nga një dorë e paditur. U fol se e

vrau djali i Maliq Frashërit. Si dhe pse, as situata, por as ndonjë arsye tjetër s'na shtynte të interesoheshim. Të dyja palët qenë të përziera në krime.

Ndërkaq lajmi i zi u përhap kudo: trupat fashiste italiane shpërthyen agresionin. Një popull i tërë, i ngritur në këmbë, i gatshëm të luftonte për lirinë e pavarësinë e vet, u ndodh pa udhëheqje, pa armë, pa organizim, i tradhtuar nga klasat sunduese, nga mbreti e nga qeveria, pa ndihmë e pa përkrahje nga jashtë. E megjithëkëtë grupe patriotësh shqiptarë, si Mujo Ulqinaku me shokë, i pritën agresorët me plumba dhe fakt është se fashistët italianë, para se të organizonin «ceremonialin» e hyrjes në Durrës, u detyruan të tërhiqnin në fshehtësi trupat e ushtarëve të vrarë e të lanin sheshet nga gjaku i derdhur.

Numri i fashistëve të vrarë në brigjet tona u mbajt në fshehtësinë më të madhe dhe kufomat e tyre u çuan natën në Itali, ose u zhdukën në fund të detit. Këto qenë «buqetat» e vërteta, me të cilat populli shqiptar i priti agresorët më 7 prill 1939.

Por rezistenca e patriotëve tanë në Durrës, Sarandë, Vlorë, Shkodër, Shëngjin etj., ndonëse e përgjakshme dhe heroike, ishte spontane dhe e paorganizuar. Ajo u shtyp përballë hordhive fashiste të armatosura gjer në dhëmbë me mjetet më moderne të agresionit e të shfarosjes.

Shqipëria u pushtua. Nuk kam për t'i harruar kurrë urrejtjen dhe dhimbjen e thellë, me të cilat shoqëruan ibanorët e qytetit të Korçës aeroplanët e parë të fashizmit dhe të pushtimit. Njerëzit lëshonin lot dhe kërcënonin me grusht aeroplanët. Në sytë e, popullit shqiptar fashistët panë vetëm urrejtje.

*

* *

Gjendja e rëndë, që iu imponua atdheut nga pushtimi fashist, na ngarkoi ne, komunistët, me përgjegjësi të mëdha. Nëse në ditët vendimtare para 7 prillit grupet komuniste, të përçara e në luftë me njëri-tjetrin, nuk mundën të krijonin një udhëheqje të vetme e të mobilizonin popullin për veprime të armatosura kundër agresorëve, tani, gjendja e paspushtimit e nxirrte më në pah domosdoshmërinë e një pune komuniste të organizuar e të pandërprerë. Duhej të vepronim, të organizoheshim për rezistencë, t'u tregonim njerëzve ç'ishte fashizmi italian e, ç'qëllime kishte; të demaskonim demagogjinë e tij, karakterin e masave që merrte dhe metodat dinake që përdorte ai, sikur erdhi gjoja të shpëtonte vendin nga Zogu, se gjoja Shqipëria do të ketë qeverinë e saj e,tj. Duhej të organizonim rezistencën d'he propagandën kundër qeverisë kuislinge të Vërlacit, që realizoi maskaradën e «Bashkiunit të Shqipërisë» në «suazën e perandorisë italiane» me Viktor Emanuelin III në krye, i cili, ca kohë më parë, kishte marrë titullin e «perandorit të Etiopisë» dhe tash merrte edhe titullin «mbret i Shqipërisë».

Kryerja e këtyre detyrave ishte, pa dyshim, e vështirë, por jo e pamundur. Demonstratat e, mëdha që shpërthyen në ditët e para të prillit në të gjithë vendin kundër kërcënimit italian, kërkesat për armë që masat e gjëra të popullit i bënë qeverisë tradhtarë dhe feudale të Zogut, shprehja e përgjithshme e gatishmërisë për të luftuar, goditja e trupave italiane të zbarkimit në Durrës, Vlorë, Sarandë e Shëngjin ishin për ne, komunistët, sinjali se vetëm duke u organizuar, dune u armatosur dhe dulce luftuar do të shporrej armiku, që tashmë kërcënonte vetë të ardhmen e vendit e të popullit tonë, ishin vërtetimi më i madh i faktit se populli ynë s'do ta duronte pushtimin, se me një udhëheqje të sigurt ai do të ngrihej në këmbë e do t'i hidhte agresorët në det.

Mirëpo ne, anëtarët e grupeve të ndryshme komuniste, megjithëse e ndienim nevojën e luftës kundër okupatorit dhe praktikonim në jetë forma të ndryshme të saj, nuk po arrinim ta gjenim fjalën me njëri-tjetrin, të sheshonim divergjencat ideopolitike dhe të bashkonim forcat e përpjekjet tona. Kjo ishte një gjë shumë e dëmshme për luftën e përbashkët kundër të njëjtit armik. Edhe, si grupe, pushtimi na gjeti jo të organizuar si duhej. Puna e grupeve nuk kishte shtrirje të gjerë në masat e popullit dhe në mbarë vendin, me gjithë udhëzimet e drejta të Kominternit, që i kishte sjellë shoku Ali Kelmendi që më 1932, dhe më pas me direktivat e reja të Kongresit të 7-të të Kominternit, që

erdhën në Shqipëri qysh në vitin 1937, e na rekomandonin të futeshim në masa, të punonim midis tyre dhe aty të rritnim e të forconim celulat e reja.

Këto udhëzime, në frymën dhe në dritën e direktivave të Kongresit të 7-të të Kominternit, u përcaktuan në Moskë, në një mbledhje të organizuar nga Seksioni Balikanik i Kominternit, ku u analizua gjendja e lëvizjes komuniste në Shqipëri dhe detyrat që qëndronin para saj. Perspektivat e gjera që hapnin këto direktiva për zhvillimin e lëvizjes komuniste në Shqipëri, u sabotuan nga elementët trockistë.

Grupi Komunist i Korçës i pranoi e i bëri të tijat udhëzimet e Kominternit. Ky grup arriti mjaft suksese në punën që bënte me punëtorë, me të rinj dhe me zanatçinj e tregtarë të vegjël. Megjithatë karakteristikë e shokëve, të Grupit të Korçës ishte sektarizmi, që shprehej në një punë të mbyllur brenda në qytetin e Korçës, kurse jashtë tij dhe në qytete të tjera grupi zhvillonte një punë shumë të zbehtë, për të mos thënë inekzistuese. Nga ky sektarizëm e dobësi të tjera, që pengonin zhvillimin dhe zgjerimin e, lëvizjes komuniste, përfituan disa elementë antimarksistë të këtij grupi, të cilët shkëputën disa prej anëtarëve të grupit tonë në Tiranë. Një pjesë nga këta kishin formuar që më 1936 një grup trockist me Aristidh Qendron në krye, kurse të tjerë me Anastas Lulën e Sadik Premten po shfaqnin shenjat e një fraksioni të ri, që më vonë, pas pushtimit të veridit, dolën si grup më vete, i cili Rjohet me emrin Grupi i «Të Rinjve».

Më kujtohet që, pak kohë pas pushtimit të vendit, Grupi i Korçës dërgoi në Tiranë dy përfaqësues të vet, për të marrë kontakt me Anastas Lulën dhe me disa shokë të tij, që t'i orientonin këta për detyrat e reja të situatës së pushtimit e për t'i bindur që të ruanin lidhjet me grupin. Mirëpo të dërguarit e Grupit të Korçës jo vetëm nuk i bindën dot Anastas Lulën me shokë, por vunë re në idetë dhe në jetën e tyre akte të poshtira, trockiste, antikomuniste, amorale në kulm. Ata u ndanë nga grupi i Anastasit të tmerruar dhe, kur na raportuan, me të drejtë Grupi i Korçës vendosi e filloi luftën ideologjike kundër këtyre trockistëve.

Ky grup kishte përqaftuar të gjitha teoritë dhe praktikën e gangsterëve trockistë e, anarkistë: vjedhjen, gënjeshtër, korrupsionin e komunitetin mbi gratë. Ata nxorën «teori» të reja, të cilat po i sillnin një dëm të madh luftës sonë. Sipas Anastas Lulës, Andrea Zisit e trockistëve të tjerë «pughtimi i vendit kishte anën e keqe, por edhe anën e mirë: ai ishte, i favorshëm se do të mëkëmbej borgjezia, do të ndërtohej industria, do të krijohej klasa punëtore dhe, atëherë mund të flitej për krijimin e një partie komuniste të vërtetë, atëherë mund të flitej për luftë kundër okupatorëve». «Duhet të presim krijimin e proletariatit», «puna me fshatarësinë nuk ka rezultat» propagandonin ata. Natyrisht, «teoritë» e këtyre krerëve ishin jo vetëm antikomuniste, por i shërbenin pushtuesit dhe sabotonin organizimin e rezistencës e, të luftës popullore kundër tij. Grupi i Korçës i luftoi pa mëshirë këta tradhtarë dhe këto «teori» e veprime që ishin jo vetëm trockiste, por që puqeshin me ato të Partisë Fashiste Shqiptare, krijesë e pushtuesit.

Grupi i Korçës kishte një vijë të drejtë për këto probleme kapitale, por duhet thënë se Koço Tashkoja ndikonte për keq në zhvillimin e gjerë të kësaj vije. Jashtë Korçës, sidomos në Tiranë, ku puna e grupit ishte lënë në duart e Koço Tashkos, procesi thuhet se kishte ngecur në vend. Koço Tashkoja, duke përfituar nga fakti që kishte, sjellë prej Moske udhëzimet e Kominternit, hiqej si i parë, si përfaqësues i Internacionales në Shqipëri, por e vërteta ishte se ai nuk dinte të punonte me njerëzit, ishte sa sektar aq dhe oportunist.

Grupin e Korçës e kishte goditur edhe, reaksioni zogist, por sidomos ai mbetej grupi më i madh e më i rëndësishëm, jo vetëm për numrin, por, sidomos, për faktin se idetë e këtij grupi ishin më të drejta se të grupeve të tjera. Grupi ynë i Korçës e shikonte drejt rrezikun e, madh të pushtimit fashist dhe luftonte me mënyrat e tij, por ai me një punë organizative më të shëndoshë, më të zgjuar, po të vepronte energjikisht dhe me pjekurinë e duhur për të likuiduar gjithë atë mal «mërish», kontradiktash, zënkash e ambiciesh personale ose shpifjesh, që nuk mungonin në mes grupeve, komuniste, do të kishte ndikuar më shumë në afrimin e komunistëve e do të kishte shpejtuar formimin e Partisë. Përpara rrezikut të madh të fashizmit që na kishte pushtuar, u neglizhua rëndë rru-ga e unitetit marksist-leninist. Për pasojë edhe, pas pushtimit grupet jo vetëm qëndruan në

pozitat e vjetra, por zënkat dhe kontradiktat u shtuan e u acaruan. Kogo Tashkoja dhe Anastas Lula ishin një pengesë e madhe për përmirësimin e gjendjes në këtë drejtim.

Sidoqoftë, fakt është se, në Korçë, ku grupin e drejtonte shoku Miha Lako, puna shkonte në përgjithësi mirë. Vecanërisht në prag të pushtimit dhe menjëherë pas tij veprimtaria e grupit u gjallërua si kurrë më parë. Ne mbledheshim rregullisht, diskutonim, përcaktonim qëndrimet që duhej të mbanim për problemet e mëdha e të vështira që kishim përpara.

Në radhë të parë, na duhej të ruanim e të forconim më tej unitetin e shëndoshë brendapërbrenda Grupit Komunist, të mos lejonim asnjë çarje në radhët e tij, asnjë shenjë frike ose paniku përpara terrorit e raprezaljeve të regjimit fashist. Mbjaj mend se në ditët e para të prillit, kur ende pushtuesit s'kishin hyrë në qytet, dikush hodhi mendimin që disa nga shokët tanë, të njohur nga autoritetet e nga agjentët fashistë për veptlimtarinë e tyre antifashiste, të largoheshin nga Korça për t'i shpëtuar internimit ose burgut. Shpërthyen kundërshtime të ashpra:

- Gjithë populli i Korgës, gjithë populli i Shqipërisë është antifashist, - theksuam në mbledhje. Në rrugë me mijëra veta po demonstrojnë e, thërresin hapur: «Poshtë fashizmi!». Atëherë, si të largohen komunistët nga populli?! E kundërta duhet të ndodhë. Ne duhet të jemi të parët në veprime e demonstrata, ne duhet t'i tregojmë popullit rrugën e vërtetë të luftës e të gëritit, ne, duhet ta bindim atë me shembullin tonë !

Dhe kështu ndodhi vërtet. Komunistët e Grupit të Korgës, bërthamën kryesore të të cilit e përbënin punëtorët e qytetit, nuk u tutën e nuk u ndalën përpara asnjë rreziku. Ndikimi i punëtorëve të nxënësit, që në atë kohë i quanin studexltë, ishte i madh. Liceu i Korçës ishte një mbështetje me rëndësi për rezistencën kundër fashizmit. Nxënësit e këtij Liceu dhe mësuesit e tyre revolucionarë, frymën e demonstratave antifashiste të prillit 1939 e thelluan çdo ditë e më tepër, dhe më pas, veçanërisht pas themelimit të Partisë sonë Komuniste, ata e kthyen Liceun në një gerdhe të vërtetë revolucionare, në një burim kuadrosh e partizanësh të Partisë e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Edhe profesorët francezë, pa asnjë përjashtim, ishin kundër pushtimit italian, ata u treguan solidarë me ne, mësuesit antifashistë, me nxënësit dhe me popullin. Ata hapur nuk flisnin, kurse, me ne po, nuk na pengonin në asnjë veprim tonin me nxënësit, përkundrazi, na përkrahnin e na jepnin zemën. Ata prisnin me muaj dhe me ditë që të nxirreshin jashtë nga Shqipëria, si të padëshirueshëm për regjimin fashist.

Në luftën që u bënë pushtuesve fashistë, kur bojkotonim çdo veprim politik ose arsimor të tyre, ne nuk harronim të demaskonim jo vetëm agjentët e tyre, si Alarupin, Tefik Vlborjen e të tjerë, vegla të bindura të fashizmit, por edhe Qazim Frashërin e mikun e tyre, trockistin Zai Fundo, i cili qe kthyer në Shqipëri si «komunist» për të bërë punën e fashizmit e të agjenturave të huaja imperialiste.

Historinë e këtij tradhtari të Internacionales së Tretë Komuniste, të këtij armiku të lëvizjes sonë komuniste e të Partisë Komuniste të Shqipërisë ne e njihim mirë dhe qysh më parë ishim ndeshur me të.

Zai Fundoja në kohën e qeverisë së Fan Nolit ishte një nga të rinjtë demokratë korgarë, që morën pjesë në lëvizjen kundër feudalëve, duke qenë anëtar i shoqërisë «Bashkimi» që e kishte themeluar dhe e drejtonte patrioti i shquar, Avni Rustemi. Zai ishte, bir i borgjezisë së mesme qytetare të Korçës, bir i një tregtari, nga ata që shëtitnin me dolloma dhe venin çdo të diel në kishë.

Familja e Zait, natyrisht, hiqej si familje «arkondësh» dhe kishte një përbuzje të dukshme ndaj elermentëve myslimanë, që rrinin në një mëhallë të veçantë të Korçës, e cila konsiderohej si një geco nga «arkondët» e mësuar të mëhallave të tjera. Këta tregtarë arkondë bënë krushqi me njerëz të s'htresave, të tyre, shkonin e vinin nga jashtë, bënë tregti me Greqinë dhe me Rumaninë, sillnin që andej zakonet dhe mënyrën e jetesës gjoja të qytetërimit. Nganjëherë dërgonin në këto vende dhe djemtë e tyre për t'u bërë doktorë dhe avokatë, që ishin dy profesione «më të preferuara» për ta, sepse sillnin Ɛhumë të ardhura e që, sipas tyre, krijonin pasuri dhe autoritet. Nga një familje e tillë rridhte dhe Zai Fundoja. U duk sikur ai mori një rrugë tjetër, u fut në valën e veprimtarisë politike dhe «mbronte krahun e demokracisë kundër feudalëve».

Kur Zogu hyri në Tiranë, i ndihmuar nga fuqitë e huaja, veçanërisht nga reaksioni serb, i cili i vuri në dispozicion edhe mercenarë vrangelistë të emigruar nga Rusia, pas fitores së Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, qeveria e Nolit kishte mbaruar dhe mbështetësit kryesorë të saj dolën jashtë kufijve të atdheut, në mërgim. Edhe Zai Fundoja u mërgua dhe u gjend më në fund në Bashkimin Sovjetik, me një grup shqiptarësh, midis të cilëve ishin: Ali Kelme, ndi, Naum Prifti, Sali Hidri, Koço Tashkoja, Selim Shpuza, Demir Godelli e të tjerë.

Nën regjimin e egër të Zogut, mezi informoheshim mbi veprimtarinë e emigrantëve antizogistë, të cilët, natyrisht, ishin të ndarë e të përçarë. Për Zai Fundon shumë rrallë na bizin në vesh se «është komunist», ss «punon në Kominiern», por si e qysh, asgjë konkrete nuk dinim. Herë xas here merrnim në mënyrë ilegale gazetën e Omer Nvhanit, «Çlirimi komibëtar», dhe atje disa herë, tok me artikujt e zjarrtë të Halim Xhelos, lexonim edhe ndonjë të Zai Fundos.

Më vonë çdo gjë u bë e qartë mbi Zai Fundon. Siç dihet, ai e tradhtoi komunizmin, u bë një renegat, një trockist i rrezikshëm. Them i rrezikshëm, sepse ishte shumë dinak, i zgjjar e me kulturë, njeri i penës dhe i gojës. Ai dërgohej nga Kominterni me misione, ashtu siç dërgoheshin edhe të tjerë, por në Shqipëri nuk kishte ardhur asnjfherë, qoftë ilegalisht qoftë legalisht, siç kishin ardhur shokë të tjerë, si Ali Kelmendi e Halim Xhe~o. Zai Fundoja, intelektual i trockist i fshehtë, e ndiente frikën deri në palcë.

Kur u zbuluan aaktiviteti dhe pikëpamjet e tij trockiste, Zai Fundoja ndodhej jashtë Bashkimit Sovjetik dhe kështu shpëtoi nga spastrimet kundër trockistëve, buharinistëve e tridhtarëve të tjerë.

Pas kësaj ai rronte herë në Zvicër, herë në Francë e gjetkë, ku zhvillonte një luftë të tërbuar dhe të hapur kundër komanizmit, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Stalinit. Tani ai luftonte si eksponent në radhët e Internacionales së Katërt trockiste dhe ishte, vënë në shërbim të kushedi se të ç'shteteve imperialiste që organizonin sabotirnet dhe luftën kundër Bashkimit Sovjetik. Në të njëjiën kohë ai vazhdonte të bënte një punë të poshtër, ir.trigante, sabotuese, e shkatërrimtare kundër revolucionarëve të vërtetë, si Ali Kelmendi, dhe kundër çdo lëvizjeje përparimtare jashtë ose brenda Shqipërisë. Fundo;a u bashkua me elementët më të fëlliqur të emigracionit politik shqiptar jashtë dhe, ndër të tjera, bënte g'është e mundur për të sabotuar vajtjen e vullnetarëve shqiptarë në Spanjë.

Para se Italia të na pushtonte atdheun, morëm vesh se kishte ardhur në Shqipëri Zai Fundoja. Ai u kthye nga mërgimi duke marrë lejen e qeverisë së Zogut, të cilën e kishte siguruar se nuk do të merrej me politikë. Tashmë ne, komunistët e Grupit të Korçës, e njihnim mirë veprimtarinë e tij, sepse Ali Kelmendi na kishte vënë në korent për çdo gjë lidhur me të dhe ishim të bindur se Zai Fundoja nuk vinte, pa qëllime të caktuara pas kaq kohësh emigrimi. Ai nuk ishte, një emigrant ekonomik dhe as një emigrant politik i thjeshtë, por «i njohur» si antizogist dhe antifeudal e, sidomos, si «komunist».

E tillë ishte figura e tij nga ana e jashtme, të cilën Zogu, si dhe ish-ministri i tij i Brendshëm, Musa Juka e të tjerë mendonin ta ruanin si të tillë, sepse kishin ne,vojë për këtë person që kishte ndërruar shpirt e lëkurë dhe, në fakt, nuk ishte më as antizogist, as komunist.

Duke i ditur të gjitha këto, ne, pra, qemë të ibindur se Zai Fundoja erdhi në Shqipëri në këto kohë të turbullta, ashtu si ujku që kërkon mjegull, me siguri, i dërguar nga agjenturat e huaja për t'i përgatitur terrenin pushtuesit, për të sabotuar krijimin e PKSH, për të sabotuar rezistencën e armatosur të popullit shqiptar.

Dhe një mëngjes ai u duk në Korçë. Në shtëpinë e Andresë së Thullës, ku rrija, më erdhi shoku Raqi Themeli, teneqexhi, dhe më lajmëroi se renegati Zai Fundo kishte ardhur në Korçë. U nisa dhe shkova te dyqani i Mihas [Lako], për të biseduar me të dhe për të vendosur se ç'mënyrë dhe ç'taktikë do të përdornim për të luftuar kundër këtij renegati. Unë mora përsipër ta deznaskoja në radhët e mësuesve, profesorëve e nxë

nësve, njëkohësisht të zbuloja manovrat dhe metodat e punës së tij, ku do ti krijonte bazat dhe si do të shtrinte rrjetat. Shokët e, tjerë morën përsipër detyrën t'u bënin të qartë punëtorëve dhe elementit fshatar se kush ishte ky tradhtar. Ne e pamë që në fillim rrezikshmërinë e këtij elementi të njohur në borgjezinë tregtare të Korçës, në inteligjencien liberale dhe, «demokratike» të këtij qyteti. Kurse te punëtorët e Korçës do të ishte vështirë të depërtonte se për ta ai ishte me kohë i djegur, ndërsa

lidhjet me fshatin, né qoftë se ai do të tentonte né këtë drejtim, do t'i bënte nëpërmjet bejlerëve «liberalë» dhe agallarëve. Kështu ia filluam punës kundër tij, me gardën e vjetër të Grupit Komunist të Korçës né krye, Miha Lakon, Pilo Peristerin, Gaqo Peristerin, Sotir Vullkanin, Koci Bakon, Sotir Gurrën, Petro Papin, Nesti Titanin, Petraq Titanin, Raqi Themelin, Foni Thanon, Llambi Dishnicén, Stefo Grabockën e të tjerë.

Zai Fundoja filloi nga puna me sistem. Ai ra né kontakt me të gjithë ata për të cilët prefekti dhe agjuntura e tij nuk kishin asnjë fije dyshimi, pra, ai po e legalizonte veprimtarinë e, tij sipas «premtimeve» të dhëna që para se të kthehej né Shqipëri.

Ne shihnim me kujdes lidhjet që vendoste dhe takimet që bënte jashtë, né vende publike, né kafe ose né shëtitjet e dendura mbrëmjeve né bulevard, gjithashtu dhe vizitat e shpeshta që bënte nëpër familje, deri te ndalesat né dyqanet e tregtarëve të ndryshëm.

Ai filloi të lidhej me krerët e borgje, zisë tregtare korçare, me, Fundot, me Vangjo Turtullin, me Manot, me Katrot e shumë të tjerë të këtij kalibri si edhe me ata të kalibrit më të ulët. Këta ishin përfaqësuesit e borgjezisë së krishtere që qenë lidhur me bejlerët dhe agallarët myslimanë dhe ishin më né kontakt me fshatin dhe ndër më të besuari-t e Zogut, të Musa Jukës e të Krosëve, që sillnin ose hiqnin nga pushteti, kur të donin, Koço Kotët, Pandeli Vangjelët e të tjerë si këta, Zai Fundoja i dinte këto situata dhe këto nuanca politike i shfrytëzonte. Fazlli Frashëri, i vëllai Qazka, Selim Mborja, Tefik Mborja, Rexhep Merdani e mjaft, të tjerë si këta e më të ulët se, këta, por që formonin opiononin e «elitës myslimane» korçare, u bënë miqtë e tij më të ngushtë.

Po ashtu mbështetje e Zai Fundos u bënë disa irtektualë korçarë, si Stavri Skëndi, Andon Frashëri, Vili Jatru e irtektualë fashistë, si Alarupi e të tjerë.

Natyrisht bisedat e tij me këta njerëz e kishim të vështirë t'i mësonim, por disa herë merrnim vesh ndonjë gjë nëpërmjet vesit të tyre për t'u mburrur për «politikën» që bënin kafeneve. Kapardisej Zai si «politikan i zoti», «si njeri me kulturë të madhe». U fuste atyre se «ishte për reforma, por né mënyrë të moderuar, sepse nuk ishte akoma koha për reforma të thella», se «vendi ishte prapa nga ana arsimore» etj., etj., por nuk hynte thellë né arsytet se ç'duhej bërë. Fliste, «fjalë të mira» për rininë, evitonte bisedat direkte për Bashkimin Sovjetik dhe për Stalinin dhe thos'hte: «Jam komunist dhe këtë e di gjithë bota, bile edhe prefekti e këtë s'kam si e fsheh» (!). Për Grupin tonë Komunist të Korçës nuk fliste dhe kur e pyesnin se ç'mendonte për komunistët né Shqipëri, ai përgjigjej:

«Nuk di gjë, s'kam lidhje dhe nuk përzihem me ta» eti.

Për të diskutuar rreth të gjitha këtyre taktikave të Zai Fundos, ne mblidheshim herë pas bere në dyqanin e vogël të Mihas ose në sobalkën e Pilos, ku, pas diskutimeve, merrnim vendime, për ta demaskuar Zain si renegat, si armik të punëtorëve, si armik të reformës së vërtetë agrare që do të shpëtonte fshatarësinë etj. Natyrisht Zait dhe miqve të tij nuk u vinte mirë nga kjo luftë që u bënin bolshevikët, siç na quanin ata. Nuk i vinte mirë as «kryetarit» të grupit tonë, Koço Tashkos. Edhe ky mundohej të na imponohej për të mos e luftuar Zai Fundon, sepse ai na paskej «ndjenja pozitive»! Por ne vazhduam punën tonë kundër tradhtarst Fundo pa ndërprerje, si para ashtu edhe pas pushtiznit fashist të atdheut.

Por edhe Zai, si njeri i përgatitur për misionin e tij agjenturor, nuk tërhiqej. Në prag të 7 prillit, pasi bffl ç'ishte, e mundur që të sabotonte punën tonë për rezistencë kundër pushtuesit, papritur ndërroi rol. Në kulmin e demonstratës popullore u ngjit në shkallët e Bashkisë dhe mbajti një fjalim «antifashist» gjithë figura, gjeste e ekstazë. Ne, që e njihnim mirë fytyrën e vërtetë të renegatit, nuk i hëngrëm fjalët e tij, por, sidoqoftë, ato efektin e bënë. Pak kohë pas vendosjes së regjimit fashist, një mëngjes mbërriti në Korçë «kryetari» i grupit tonë, Koço Tashkoja. Ai na mblodhi, natyrisht në ilegalitet, na foli mbi situatën dhe përveç të tjerave na tha:

- Duhet ta pushoni luftën kundër Zai Fundos!

- Të pushojmë luftën kundër armikut? - e pyetëm ne me habi.

- Po, po, - foli Koçoja, - pse tash kemi një armik tjetër përpara për të luftuar, pushtuesin italian.

Pati debate të ashpra. Ne ngulnim këmbë se, sipas mësimëve të Leninit e të Stalinit, trockistët janë agjenturë e borgjezisë dhe e fashizmit dhe Zai, si i tillë, duhej luftuar, kurse Koçoja, thoshte se Zai torni «paraqitet kundër pushtuesit italian, prandaj ne duhet ta kemi në provë» etj. Sidoqoftë, ne nuk iu nënshtruam dëshirës së «kryetarit» të grupit tonë dhe, krahas rezistencës së pandërprerë që i bënim pushtuesit, vazhduam punën njëkohësisht edhe për demaskimin e renegatit Zai Fundo.

Një ditë, kur po dilja nga «Kafeneja e bilbilav&», siç e quanim ne kafe-lulishten afër Spitalit, u ndesha ballë për ballë me Zain. U përshëndetëm e i dhamë dorën njëri-tjetrit.

- Bëjmë një shëtitje të vogël bashkë, - më tha Zai.

- Si të duash, - i thashë, - por cleri në Lice se kam për të dhënë mësim.

Rrugës filloi të më fuste për «ndjenjat e tij antifashiste», se ai «kishte ardhur në Shqipëri të luftonte kundër pushtuesit» etj., etj. Pastaj doli te kryesorja:

- Pse më sulmon, ti dhe shokët e tjerë, në masat e punëtorëve e të arsimitarëve? Unë s'jam armik, kam biseduar gjerë e gjatë edhe, me Koçon etj.

I zemëruar, e ndë rpreva e i thashë afërsisht:

- Dëgjo, Zai Fundo! Ti je antifashist vetëm me fjalë, por me qëndrime e me vepra je trockist, armik i komunizmit, i Stalinit, pra je dhe, armik i popullit tonë. Ti je armik i Bashkimit Sovjetik, sabotator i luftës revolucionare, prandaj je një antirevolucionar.

Kështu u ndava me Zai Fundon për të mos e parë kurrë më nga afër. Disa vjet më vonë, në kulmin e luftës sonë heroike për çlirimin e plotë të Shqipërisë, në emër të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare do të jepja urdhrin për dënimin e merituar të Zai Fundos. Forcat tona të armatosura e kishin kapur skilen e vjetër e dinake, tek vepronte me fytyrën e vërtetë të tij, si agjent i anglezëve e udhëheqës në një bandë reaksionare të Kryezinjve, që luftonte kundër formacioneve tona ushtarake në Veri. Por kjo është histori që i takon periudhës së kurorëzimit të luftës sonë, tari jemi akoma në fillimet e saj.

Në Korçë, si kudo gjetkë, pushtuesi, që në ditët e para të ardhjes së tij, gjeti urrejtjen e pafund të ponu~-'t. Kjo urrejtje, që fillimisht shprehej në sabotim= n e pian eve për fashistizimin e popullit shqiptar, në kundërshtimin për t~u rregjistruar në parti dhe në r,,rëanizatata e tjera fashiste, gradualisht mori proporcionë më të gjera e më të hapura. Shpërthyen demon-tratat e protestatë popullit kundër regjimit fashist ,i he lig *eve të tij të pushtimit. Të rinjtë, e sidomos ai,,a 'ë shkollave, ishin ndër të parët që shfaqnin hapur c nje forcë urrejtjen kundër pushtuesve,. Unë, që nga orna e Grupit Komunist të Korçës isha ngarkuar të punoja veçanërisht me rininë dhe me mësuesit patriotë e revolucionarë të Liceut, kurrë nuk do ta harroj atë atmosferë të zjarrtë e shpërthyesë që sundonte në Lice e jashtë tij. Jo ve,tëm në bisedat me grupe të kufizua:a shokësh e simpatizantësh, por shpes.h edhe në orët e mësimi flisnim hapur kundër regjimit fashist e pasojave të tij, ndizesl:in diskutime të gjalla, përgatiteshin mendjet dhe zemrat për betejat që na prisnin. Nxënësit e Liceut ishin një mbështetje e shëndoshë për lëvizjen komuniste e antifashiste në përgjithësi. Ata ishin kurdoherë përkrah punëtorëve në protesta e demonstrata, me «padurimin» e tyre, me shpirtin e tyre të papëruilur e luftarak, ata të frymëzonin e të Shtonin forcat për t'u ngritur në aksione kundër fashizmit.

Gjithë kjo valë urrejtjeje që ndihej në të katër anët e vendit, sidomos te punëtorët e te rinia shkollorë si dhe hutimi e çorientimi që po dukeshin në disa shtresa, si në disa rrethe intelektualësh e të tjerë, e bënë gjithnjë e më evidente para nesh domosdoshmërinë e bashkimit të grupeve në një parti të vetme.

Kuptohet, puna jonë do të binte dhe ra në sy të armikut. Pas një sërë «vërejtjesh» e survejimesh të vazhdueshme nga ana e agjentëve, të fashizmit, për shembull, mua, në ditët e para të dhjetorit 1939, më komunikuan pushimin nga puna. Ndodhi kjo pas demonstratës së madhe që organizuam në Korçë më 28 Nëntor të atij viti, në përkujtim të përvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë. Qysh në - mëngjes herët kolonat e liceistëve dolën rrugëve, duke kënduar këngë patriotike e duke, hedhur parulla. Menjëherë u bashkuan me ne punëtorë, zanatçinj, gra shtëpiake, të moshuar e të rinj. Grumbulli i madh i demonstruesve ndali para Monumentit të Luftëtarit Kombëtar dhe vendosëm

atje një kurorë me lule. Kjo i tërboi armiqtë, sepse e ndienin që kurora ishte thurur me idealin e lirisë që nuk mund të vdiste kurrë nga zemra e shqiptarit. E gjithë demonstrata ishte një përkujtim për pavarësinë e humbur, ishte një thirrje për të fituar përsëri atë që na kishin rrëmbyer.

Pas kësaj, u shpalla si «i padëshirueshëm» për qytetin e Korçës dhe fillimisht më thanë se do të më transferonin në Gjinnazin e Gjirokastrës. Por fashistët ndërruan përsëri mendim: Urdhri nga Tirana ishte që të mos punoja në asnjë shkollë, sepse «turbulloja» rininë me ide të rrezikshme.

Kjo, në një rën ose në tjetrën mënyrë, do të ndodhte patjetër një ditë. Fashistët do të bënin punën e tyre, ne do të vazhdonim punën tonë.

Ishte koha kur kundër regjimit nuk po «turbullohej» vetëm rinia, por gjithë populli shqiptar. Momentet nuk prisnin, duhej intensifikuar puna në të gjitha drejtimet. Mbi të gjitha duhej dalë nga «kuadri» i Korçës, pra, duhej zgjeruar e shtrirë më tej puna komuniste e grupit, duheshin krijuar lidhje të shëndosha me grupet e tjera, duhej ecur me shpejtësi drejt sheshimit të mosmarrëveshjeve, drejt përgatitjes së terrenit për krijimin e Partisë.

Prandaj nuk kundërshtova vendimin e autoriteteve fashiste dhe, në fillimin e, vitit 1940, u largova nga Korça. Nga ky qytet, me tradita të shquara në çështjen e lirisë, të punës e të përparimit, nga njerëzit e tij punëtorë e patriotë, veçanërisht nga punëtorët e mrekullueshëm korçarë, ruaja, siç kam ruajtur e do të ruaj përjetë, kujtimet më të mira. Kisha ardhur në Korçë djalë fare i ri, me etjen e madhe për dije, kulturë e përparim, që t'i shërbeja edhe unë sadopak zhvillimit të atdheut të dashur, por Korça më dha shumë më tepër se sa kaq. Aty mora mësimet e para të revolucionit e, të revolucionarit, aty u lidha për herë të parë me lëvizjen komuniste shqiptare, e cila, ndonëse vetë atëherë ishte në hapat e parë të saj, prapëseprapë më dha atë orientim, i cili do të bëhej qëllimi më i madh dhe, i vetëm i jetës sime.

Qysh atëherë, kur isha nxënës në Lice, një gjë më binte në sy e këtë ua thosha edhe shokëve të mi të Gjirokastrës, si Aqifit e Selamiutl:

- More këta punëtorët e Korçës, megjithëse nuk kanë shkollë, duken të zgjuar, të hedhur, të qeshur në mjerim, s'përzihen kurrë me djemtë e efendilerëve dhe të arkondëve, të cilëve u futin lloj-lloj të sharash. Punëtorët korçarë shkonin në disa kafene të veçanta të dielave, atje ku veja edhe unë ngandonjëherë. Çudi, ata shkonin atje jo për të ngrënë e për të pirë,

por për t'u takuar me njëri-tjetrin e lëvonte muhabeti

që ç'ke me të. Tek ëmbëltoja e Koci Bakos u njoha

me Sotir Gurrën, Gaqo Naston, te Çaloja² i pasticerisë «Kristal» u njoha me Llambi Dishnicën, Petro

Papin, Pilo Peristerin, Koçi Xoxen e të tjerë. Me këtë të fundit u njoha në banjat pranë internatit, isha me «Këmbkën», nofka e Llambi Dishnicës.

- E mo student, - më thoshin, - ç'kemi ndonjë të re nga shkolla?

Unë u flisja.

Koci Bakoja një ditë më pyeti:

- E mbarove atë që të dhashë? - Më kishte dhënë «Manifestin» e mirënjohur Komunist të Marksit e të Engelsit.

- E lexova, - iu përgjigja, - kam lexuar edhe për Komunën e Parisit dhe për përleshjet e punëtorëve të Parisit me borgjezinë.

- Atëherë na trego dhe ne, - thoshte Koci dhe më shikonte, me ata sy të zez dhe të thellë. Dhe unë filloja.

Nj-ëherë, kur po vazhdoja, Koci më solli një pastë dhe, duke ma ndërur, më tha:

- Haje!

- Të falemnderit, - ia ktheva, - por s'kam ta paguaj.

- Çfarë lekë, more, - ma ktheu Koci, - ne do të luftojmë së toku në barrikada dhe ti më flet për lekë.

Të tillë ishin punëtorët e Korçës. Ata, edhe, unë në shembullin e tyre, në rrjedhën e viteve e të ngjarjeve, do të zhvilloheshim. Çka unë lexoja në mënyrë të fshehtë apo hapur në Lice, merrnin një

kuptim tjetër, një kuptim të thellë. Unë e kuptova përse u ndritnin sytë si shkëndija punëtorëve të Korçës, pse ishin serbes, pse rrinin të bashkuar dhe shëtitnin së toku grupe-grupe. E kisha për nder kur shëtitja me ndonjë prej tyre të dielave o në ditë pushimi. Më dukej vetja më i fortë. Më vonë, kur u ktheva në Korçë, në Lice, si mësues ose profesor, siç quheshin atëherë mësuesit e shkollave të mesme, isha i përgatitur «për barrikada», siç më pat thënë shumë vjet më parë Koci Bakoja. Ishin përgatitur më mirë për barrikada edhe ve.të mësuesit e mi të parë të lëvizjes komuniste në Shqipëri, punëtorët revolucionarë korçarë. Këtë e vura re menjëherë, pasi u lidha me ta, tashmë në mënyrë të organizuar, nëpërmjet shokëve të mi: Stefo Grabockës e Llambi Dishnicës, anëtarë të Grupit Komunist të Korçës.

Me, përpjekje e këmbëngulje, në ndeshje me regjimin terrorist e ariadollak të Zogut, ata kishin ecur më përpara në formimin e tyre politik e ideologjik, e kishin forcuar më tej Grupin Komunist dhe kishin arritur një sërë suksesesh veçanërisht në punën me masat, për organizimin e t'yre në shoqëri, për hedhjen në greva e në demonstrata me karakter ekonomik e politik etj.

Në atë kohë, militanti i shquar komunist Ali Kelmendi ishte larguar nga Shqipëria, por mendimi i tij konsekuent, vula e punës së tij revolucionare në punëtorët e Korçës, ndihej kudo e gjallë.

Pak para se të largohej nga Shqipëria, unë pata fatin e madh të takohesha me të paharruarin Ali Kelmendi në Gjirokastrë.

Ndodhi kjo në verën e 1936-s, aty nga mesi i kofrikut. Sapo isha kthyer në Gjirokastrë, kur më vjen shoku im i vjetër Skënder Topulli dhe më thotë se në Gjirokastrë do të vinte i internuar një komunist nga më të mirët, që ndiqej e persekutohej vazhdimisht prej regjimit të Zogut si element i rrezikshëm. Skënderit këtë njoftim ia kishin dhënë shokët e Korçës me anë të një letre ku e porositnin ta gjente «Malokun» (pseudonimi i Ali Kelmendit) e të kujdesohej për të.

- Ta gjejmë patjetër, - i thashë Skënderit dhe vazhduam të qëndronim në kërkim.

Të dy sapo ishim kthyer nga jashtë dhe ishim të papunë. Skënderi kishte mbaruar studimet në Francë, kurse unë, pasi u pushova nga puna në konsullatën shqiptare në Belgjikë, tani rrija në Gjirokastrë, pranë prindërve, në pritje të ndonjë pune.

Një mëngjes qemë ulur në një kafene afër Qafës së Pazarit e po bisedonim. Papritur hyri një burrë, me shtat e moshë mesatare, kokë jashtë. I ra mes për mes kafenesë, pa parë as majtas as djathtas, diçka bleu te banaku e u kthye të dilte.

- Maloku! - më tha Skënderi ngadalë e u ngrit menjëherë. E arriti te dera dhe u përqaftuan. Unë, pa lëvizur nga vendi, po e shihja me vëmendje e me një ndjenjë të thellë admirimi të porsaardhurin. Dukej i lodhur, ishte i vranë në fytyrë, i mërzhitur. Menjëherë e kuptoja se kishte kaluar një jetë plot vuajtje e mundime.

Pasi i ranë së bashku rrugës gjer te sheshi, që më pas do të merrte emrin «Sheshi i Çerçizit», u kthyen përsëri te kafeneja, ku unë po prisja.

- Kush është ai? - e kishte pyetur Aliu Skënderin.

- Një shoku im, mos u bëj merak, - i qe përgjigjur Skënderi. - Do ta njohësh.

- S'e kam hallin për vete, - i kishte thënë Aliu.

U prezantuam dhe u ulëm të tre. Qëndruam gjatë. Aliu ishte një burrë i qetë, f liste pak, ishte krejt i përqendruar në bisedë dhe shumë i matur.

Pas kësaj takoheshim vazhdimisht, herë në kafene, herë në ndonjë sofat ose, në ndonjë mur guri. E njohëm më mirë njëri-tjetrin dhe shumë shpejt Aliu na f oli hapur për lëvizjen komuniste, për Grupin e Korçës, për të tjerët. Mbi të gjitha, shpresat i vinte te Grupi i Korçës.

Nuk qëndroi gjatë në Gjirokastrë, rreth një muaj, e shumta dy, por në atë pak kohë që qëndroi spikatën vetitë e tij prej komunisti e re,volucionari konsekuent e të palodhur. Ndiqej vazhdimisht nga xhandarmëria e spiunët, por ai s'trembej dhe ne, nga ana jonë, përpiqeshim që Vi vinim sadopak në ndihmë.

Në xhandarmërinë e Gjirokastrës në atë kohë pu lonte një oficer i ri, Javer Xhiku. Ishte, më duke,t, adjutant i prefektit ose i komandantit të xhandarmërisë, s'e mbaj mend mirë. Si unë dhe Skënderi e njihnim Javerin që nga fëmijëria, bile kishim qenë në një kohë së bashku edhe në shkollë, në Gjirokastrë. Tani puna e solli që Javeri ta provonte veten ndaj nesh dhe ndaj mikut tonë. Spiunët e

xhandarët që ndiqnin çdo lëvizje të Ali Kelmendit dërgonin raporte e njoftime të shpeshta për të. Shumë nga këto njoftime binin në duart e Javerit dhe ai jo vetëm i griste ose i fshihte, por dhe ne na sinjalizonte të tregoheshim të kujdesshëm. Kam mendimin se që njeri i mirë dhe, me sa di, nuk përfundoi keq, më duket, vdiq qysh para Çlirimit.

Gjatë kohës që qëndroi në Gjirokastrë Aliu s'di nga rënsoi se në burgun e kalasë ishte i burgosur një shok i tij komunist, Mustafa Kaçaçi, i dënuar si pjesëmarrës në Uvizjen e Fierit.

- S'di ç'do të jepja po të takohesha me të, - na thoshte, ato ditë, dhe vriste mendjen për gjetjen e rrugëzgjdhjes. Dhe e gjeti vërtet. Jeta e gjatë nëpër burgje e, internime e kishte bërë që të njëhej edhe me lloj-lloj xhandarësh, me ndonjë prej të cilëve e kishte zgjatur bisedën, bile kishte krijuar edhe njëfarë miqësie.

Një ditë na tha me gëzim:

- Më duket do t'ia dal mbanë. Takova një të njohurin tim të vjetër që më ka ruajtur në internim. Ka ardhur gardian në kala.

Dhe konspiratori i regjur Ali Kelmendi filloi të vizitonte shpesh e më shpesh Kalanë e Gjirokastrës. Hiqej, ndër ata që takonte, si amator i kështjellave të vjetra dhe shumë shpejt u mor vesh «pasioni» i çuditshëm i të internuarit politile! Kështu një ditë, duke «admiruar» bukurinë e, kubeve të Kalasë, Aliu, si gjoja rastësisht, u ndodh ballë për ballë me xhandarin që njëhte prej kohësh. Ia tha hapur ç'kërkonte dhe xhandari ia plotësoi dëshirën mikut të vjetër.

Por s'kaluan as tri-katër ditë e plasi alarmi. Aliut iu dha kjo alternativë:

- Ose të largohesh nga Shqipëria, ose të vesh të mb'yllesh vetë në «shtatë penxheret»i.

Ishim të tre, Aliu, Skënderi dhe unë te kafeneja në «Sheshin e Çerçizit», kur e njoftuan se e kërkonte, urgjent prefekti. «Prisni», na tha Aliu. Kur u kthye na tregoi për bisedën që kishte bërë me prefektin nga Korça, i njohur si patriot i Rilindjes e që kishte punuar me Asdrenin. Ai i kishte thënë: «Me keqardhje ju njoftoj urdhrin e Ministrisë së Brendshme që ose të largohesh jashtë Shqipërisë, ose të shkosh të mbyllesh vetë në burg. Edhe i internuar je, i rrezikshëm për qeverinë e Zogut».

- Kur u ngrita, - tregoi Aliu, - prefekti më tha: - A mund t'ju jap ndonjë ndihmë nga ana ime për shpenzimet e rrugës?

- Jo, - i kishte thënë Aliu, - më japin shokët.

~Ne u hidhëruam. Ky ishte, takimi im i fundit me Ali Kelmendin. Skënder Topulli njëhte Hamit Baçen e vëllanë e tij, agallarë, që shitnin qymyr dhe që miqësisht mbanin Aliun. Vëllai i Hamitit i kishte dhënë një

sahat Aliut që Skënderi, a nuk di kush, ma kanë dhënë mua dhe e ruaj në shtëpi.

Pak më pas, kur u caktova me punë në Liceun e Korçës, unë i kisha të gjalla e, të pashlyeshme fjalët e mira, respektin e simpatinë që më kishte shprehur Ali Kelmendi për punën e Grupit Komunist të Korçës dhe perspektivat e mëtejshme të veprimtarisë së tij.

Këtë e, ndjeva dhe e pashë me sytë e mi, sapo u lidha me grupin e u njoha më nga afër me gardën e tij të vjetër, Miha Lakon, Pilo Peristerin, Gaqo Peristerin, Nesti Titanin, Raqi Themelin, Llambi Dishnicën e të tjerë.

Miha Lako dhe Pilo Peristeri, dy komunistë syapatrembur, na udhëzonin me vendosmëri të madhe në luftën politiko-ideologjike të rëndësishme që ne duhej të zhvillonim.

Në prag dhe pas pushtimit fashist të vendit, në Korçë ndihej e fortë atmosfera e, rezistencës që po piquej. Në mes punëtorëve, rinisë, intelektualëve përparimtarë flitej për luftë kundër okupatorit; rinia ishte e zjarrtë dhe në shkolla kishte protesta të hapura antifashiste nga studentët. Ne, komunistët, bënim propagandë dhe, në mbledhjet tona të rregullta ilegale, diskutonim për format e luftës. Te Miha, bolshevik i patundur e i guximshëm, dyqani i të cilit qëndronte kurdohere' hapur, shkonim këshilloheshim e shkëmbenim mendime edhe për veprime që duhej të bënim në shkolla me

nxënësit, me mësuesit, me profesorët, me të cilët unë isha caktuar veçanërisht të punoja. Kudo që shkoje, në rrugë, në restorante, në kafene, shihje anembanë shokë e miq, e ndieje veten të fortë, e ndie je forcën e «partisë», siç e quanim ne grupin tonë. Edhe në kovaçhanën e Pilos venim vazhdimisht. Ai, si proletar i vendosur, rrihte mbi kudhër hekurin e skuqur, duke bise.duar ç'do të bënim të nesërmen, ç'do të bënim të pasnesërmen e në ditët e tjera që do tëvinin.

- Mos eja kaq sheshit këtej, - më thoshte nganjëherë ai gjithë merak. - Duhet të ruhesh.

- Pse? - e pyesja.

- Qysh pse? Hafijet janë sheshit. «Ç'do profesori i Liceut në kovaçhanë?!» - do të pyesin e të vihen mbrapa.

Mblidheshim edhe në shtëpinë e Sotir Gurrës, të këtij komunisti të vjetër, shok i Aliut, i Mihas, i Pilos dhe imi, bise.donim për punën që na priste, për organizimin më të mirë të saj. Puna intensive që bënte grupi me komunistët dhe me masat, na kishte krijuar bindjen se okupatori dhe bashkëpunëtorët e tij ishin ata që kishin frikë nga ne e jo ne nga ata. Punëtorët e Korçës u bënë mësuesit e mi më të mirë. Ata më edukuan dhe më kalitën më tej në luftën për triumfin e komunizmit.

Kur isha në Korçë, isha takuar edhe me Selim Shpuzën, i njohur si demokrat-revolucionar dhe me ide komuniste. Kur u shtyp kryengritja e Fan Nolit e 1924-ës, Selim Shpuza emigroi e shkoi në Bashkimin Sovjetik, ku, bashkë me Ali Kelmendin e të tjerë, mori pjesë në një grup komunist që u formua në Moskë nga një numër shokësh shqiptarë e që pushoi së ekzistuari shumë shpejt. Më pas, Selim Shpuza u kthye në Shqipëri dhe për disa kohë banoi edhe në Korçë, ku, veç të tjerash, bashkëpunonte me revistën përparimtare «Bota e re». Ai ishte njeri me kulturë dhe, njohës i mirë i historisë së popullit tonë, dhe mua më pëlqente të njihesha me ngjarje e figura të Rilindjes sonë Kombëtare, me lëvizjen demokratike

dhe të mësoja nga ai shumë gjëra për Bashkimin Sovjetik e komunizmin.

E ja, tanfi më duhej të ndahesha nga shokët e mi të vjetër. Do të largohesha nga Korça për të vazhduar e për të zgjeruar më tej punën e Grupit tonë Komunist, për të punuar bashkë me shokët, për krijimin e asaj shtate, kur s'do të flitej më për komunistë «të Korçës» apo «të Shkodrës», të këtij apo të atij grupi,

por për komunistë të një organizate të vetme - të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Disa «nacionalistë», të lidhur me fashistët, kur

dëgjuan se, unë, pas vendimit për pushim nga puna, po shkoja në Tiranë, më propozuan ndihmën e tyre që «ta, zbutnin» qeverinë e të më emëronin mësues në Gjimnazin e Tiranës! Si duket donin të më «merrnin me të mirë», donin që në Tiranë, pas kësaj që

«pësova» në Korçë, të qëndroja «urtë» e të mos tra:zohesha në politikë!

Kundërshtova kategorikisht:

- Jo, - u thashë, - nuk do të merrem më me mësuesi. Kam vendosur të ushtroj... tregtinë në Tiranë!

Kjo edhe i habiti, po edhe sikur i qetësoi një rëzit e fashizmit e të qeverisë kuislinge. «E po, thanë, e pa edhe ky që s'i bihet murit me kokë dhe tanfi po u bëka si ne, tregtar».

Në dyqanin «Flora»

Ideja për të shkuar në Tiranë e «për t'u marrë me tregti» nuk ishte një gjetje e rastit dhe nuk lindi thjesht nga fakti i pushimit tim nga puna. Jo, kjo ishte një punë e menduar dhe e llogaritur mirë nga ana e Grupit tonë Komunist. Siç kam përmendur edhe më lart, veçanërisht pas pushtimit fashist të Shqipërisë, Grupi Komunist i Korçës e ndjeu më tepër se kurrë dobësinë e vjetër të mbylljes brendapërbrenda Korçës. Nga kjo mbyllje jo vetëm ishte penguar zgjerimi i mëtejshëm i radhëve të grupit dhe gjithë puna që duhej bërë për qartësimin e mobilizimin e masave, por ishin kufizuar edhe, mundësitë për lidhje e bashkëpunim me grupet e tjera komuniste.

Koço Tashkoja, që kryesisht rrinte në Tiranë, nuk bënte asnjë punë të organizuar mirë, qoftë edhe propagandë gojore. Puna e Koços konsistonte në disa biseda «akademike» me, intelektualët, por edhe me këta me druajtje e me frikë, se mos diktohej nga policia.

Në përgjithësi, mund të them se ai ishte edhe mega loman, edhe frikaman. Natyrisht, në këtë konkluzion për Koçon ne, nuk arritëm menjëherë dhe që në atë kohë, por më vonë dhe pak nga pak, gradualisht, se vetë puna e tij tregonte ç'ishte, se në fillim ne nuk e njihnim si duhet. Me disa shokë të grupit tonë, që ndodheshin në ato kohë në Tiranë, si me Xhevdet Dodën; Demir Godellin në Peqin e të tjerë, ai nuk bënte veçse muhabetë të përcipta, përpjekje për njohje individuale dhe sharje e luftë kundër grupeve të tjera komuniste, sidomos kundër Grupit të Shkodrës e, fraksionit të Anastas Lulës, fraksion i cili sa vinte e po merrte format e një grupi më vete. Por edhe këto sharje ndaj të tjerëve Koçoja i bënte en bloc, pa asnjë diferencim midis anëtarëve, të tyre, ku kishte komunistë të vendosur, dhe pa marrë iniciativa afrimi e bisedimi me ta. Prandaj kishte lindur nevoja e një pune më të organizuar e më intensive jashtë Korçës,. sidomos në Tiranë, ku jo vetëm ishte qendra e, reaksionit fashist, por në atë periudhë ndodheshin e vepronin edhe përfaqësuesit kryesorë të grupeve të tjera komuniste. Pikërisht në këto momente ndodhi pushimi im nga puna dhe. qendra e Grupit tonë Komunist e shfrytëzoi këtë rast për të më dërguar fillimisht mua e më pas edhe disa shokë të tjerë në Tiranë. Atje, me porosi të qendrës, duhej të ngrinim degën e Tiranës të Grupit Komunist të Korçës, të zgjerohim mbi baza të shëndosha veprimtarinë e grupit dhe të organizonim lëvizjen antifashiste në kr'ye,qytet e në krahina të tjera të vendit.

Pasi diskutuam e ramë dakord me Mihan, Pilon e shokë të tjerë për drejtimet kryesore të punës sonë në Tiranë e në zona të tjera, duhej gjetur edhe, mënyra se si do të vendoseshim atje, ç'do të bënim «legalisht», në sytë e njerëzve, të autoriteteve. Pikërisht në këto diskutime lindi ideja e «tregtisë», ideja e krijimit në Tiranë të dyqanit «Flora», i cili shumë shpejt do të bëhej një ndër bazat më të rëndësishme të lëvizjes komuniste e antifashiste.

Thirra në Korçë simpatizantin e vjetër të Grupit tonë Komunist, Esat Dishnicën. Ai rridhte nga një familje e pasur, por fakt është se ky njeri patriot ishte ndër të parët që gjithë pasurinë e tij e, vuri në shërbim të çështjes së Partisë e të popullit. Ësati njihej prej të gjithëve për ndjenjat e tij të theksuara antizogiste dhe, aq hapur i demonstroi këto ndjenja, sa i kishte dalë nami si njeri «anarkist», si «njeri i opozitave». Kuptohet, «anarkist» e ««opozitar» në atë kohë klasat e pasura, njerëzit e Zogut e të qeverisë kuislinge, cilësonin çdo element përparimtar e revolucionar që ngrihej kundër tyre, këdo që cenonte bazat e tyre, politike e ekonomike. Një ndër këta ishte edhe Esati. Këto tipare unë, ashtu si edhe shokët e tjerë të Grupit Komunist, ia njihnim Esatit me kohë, prandaj dhe kishim krijuar e mbanim lidhje të ngushta me të. Nga kjo konsideratë u nisa edhe kur e thirra të vinte në Korçë, aty nga mesi i dhjetorit të vitit 1939. Erdhi menjëherë.

- A mund të na rregullosh një dyqan në Tiranë, - i thashë. - Unë e disa shokë të grupit duhet të vijmë «për punë» atje.

- Kur të doni! - tha i vendosur. - Po ku? Në periferi? !

- Jo, - i thashë, - mu në mes të Tiranës, mundësisht sa më afër qendrës!

- Ç'thua kështu?! - ma ktheu. - T'ju diktojnë menjëherë?!

Biseduam gjatë dhe rrahëm gjer në hollësi gjithçka. Pasi e, binda se pikërisht në qendër një dyqan legal ngjail më pak dyshime për punën ilegale si dhe për avantazhet e tjera që do të kishte vendosja jonë atje, biseda erdhi te mallrat që do të shitnim. S'qenkej punë e thjeshtë! Ca më tepër për mua që kurrë ndonjëherë më parë s'më kishte shkuar ndër mend se do të vinte dita të futesha edhe në të fshehtat e tregtisë! Por kisha një avantazh: s'më interesonin fare të fshehtat e, nxjerrjes së fitimit, por të fshehtat e një pune ilegale sa më të efektshme.

- Të shesim sende të vogla, - i thashë Esatit, cigare, kafe, pije, sallam... Kështu dyqanin do ta frekuentojnë sa më shumë njerëz të thjeshtë e, në mes tyre, njerëzit tanë do të hyjnë e do të dalin më lirisht, nuk do të bien lehtë në sy të spiunëve. Si thua ti?!

- U tha, mbaroi! - u përgjigj si kurdoherë i. gatshëm e i vendosur Esati.

Ja, kështu, u gjet dyqani i cili u quajt «Flora», duke marrë emrin e fabrikës së cigareve ku ishte drejtor Esati. Pronari i kësaj fabrike ishte daja i tij, Ibrahim Biçaku, që më pas u vu në shërbim të nazistëve dhe u bë kryetar i njëfarë «komiteti ekzekutiv provizor», që u krijua nga gjermanët pas ardhjes së tyre në Shqipëri. Pas Çlirimit të vendit ky u dënua nga gjyqi i popullit si tradhtar e, kriminel luftë.

Pale kohë pasi e siguruam dyqanin «Flora», unë fillova punën atje. Shpejt kuptova se vetëm me Koço Tashkon në Tiranë nuk mund të punohej, prandaj i bëra një raport Mihas, ku i kërkoja të më dërgonin në ndihmë shokë punëtorë korçarë për të filluar një punë më të gjerë jo vetëm në gjirin e punëtorëve, numri i të cilëve ishte, më i madh, por edhe me shtresat e intelektualëve antizogistë e antifashistë. Dhe kështu më erdhi ndihma: Pilo Peristeri, Kristo Mushi, Ilo Dardha, Sotir Sykuçka (Lubonja) dhe Sotir Vullkani, (ky i fundit ishte anëtar i grupit trockist të Aristidh Qendros, të cilin e braktisi dhe u bashkua me Grupin e Korçës. Gjatë luftës ky nuk u lëkund, por, kur Partia zbuloi tradhtinë e, Koçi Xoxes e të Pandi Kristos, u lëkund, u trondit dhe i mbrojti këta tradhtarë, prandaj Partia e përjashtoi nga radhët e saj).

Të gjithë shokët që erdhën nga Korça ishin punëtorë, komunistë të vendosur, të etur për aktivitet. Për të mbuluar lidhjet tona i rregullua-m në punë si mundëm, kush u fut formalisht si çirak në dyqanin Flora», ndër ta edhe Pilo Peristeri, kush hyri si punëtor në fabrikën e cigareve, ku grumbulluam edhe punëtorë të tjerë.

U mblodhëm të gjithë së bashku dhe përpiluam planin e punës sonë, planin e luftës. U shpjegova atyre se rëndësia e dyqanit «Flora» nuk qëndronte në anën materiale, por në faktin se atë mund e duhej ta përdornim shumë mirë për veprimtarinë tonë po- litike. Cigaret që shitnim kërkoheshin shumë dhe për ne kjo kishte një rëndësi të madhe, sepse na jepej mundësia që, me anën e, tyre, ne të fitonim simpatinë e dyqanxhinjve të vegjël e të varfër.

- Këtyre t'u japim pako më shumë, - u thosha shokëve, - të tregohemi shumë dashamirës, të drejtë, t'ua japim edhe me kredi kur nuk kanë.

- Enver, për komunizmin ke dorë të lirë, ndërhynte Esati. - Sa për Biçakun të mos kesh merak, se atij ia bëj mendjen tym fare unë, - thoshte ai për pronarin e fabrikës së cigareve.

Pas kësaj mund të themi se puna e Grupit të Korçës në Tiranë u gjallërua mirë. Valët e luftës na përpinë të gjithëve, veç Koço Tashkos, i cili bridhte me një leone të bardhë të lidhur me, zinxhir, që «të maskohej» si borgjez. Ai pretendonte se ishte «kryetari» i Grupit të Korçës e për më tepër «i dërguar» i Kominternit, por ai rrallë dukej në dyqanin tonë, nga frika se mos komprometohej. Do ta maste shumë herë, pa të vinte në shtëpitë tona ose në një takim natën, «se mos e diktonte policia».

Koçoja, një ditë prej ditësh, na u fejuua me motrën e Stefan Trebickës, ose, siç e thërritnin në Korçë, Stefan Kokëmadhi. Mirëpo nuk mendoj se me çfarë do ta ushqente e do ta mbante familjen. Ndaj, kur e pa veten ngushtë, na u drejtua neve ta ndihmonim, por nuk kishim mundësi ta bënim këtë, se ato të ardhura fare të pakta që nxirrnim nga dyqani «Flora» na duheshin për luftën e nuk mund të mbanim në kurriz edhe një familje të re. I thamë t'u drejtohej vëllezërve të tij, te të cilët jetonte deri atëherë.

- Jo, - tha Koçoja, - kjo gjë s'ka si bëhet. «Kryetari» donte medoemos «ndihmë» që të hapte një dyqan, ku të shiste «këmishka» dhe të tjera vogëlsira të brendshme për gra dhe të vinte atje si shitëse «zonjën Pavlinë», të zinte një shtëpi me qira dhe «të fitonte» koromanen. Bisedova me shokët. U thashë se një rrugë kishte: T'i lutesha motrës sime., Sanos, të më jepte paratë që plaku i kishte kursyer lekë-lekë për pajën e saj dhe t'ia jepnim Koços. Më kujtohet që kërcyen Kristo Mushi me Ilo Dardhën dhe më thanë:

- Dëgjo, Enver, asnjë grosh të mos i japim Koços, ata janë të Sanos. Pse u martua shoku Koço pa u menduar mirë?! Të hollat, edhe në qoftë se na i jep Sanoja, na duhen për luftën e punën që kemi nisur dhe jo për dyqanin e modës të Koço Tashkos e të Pavlinkës.

Ata arsyetonin si proletari, por megjithatë vendosa të a_sedoja me motrën. Ajo, pa ngurruar aspak, m'i dha të hollat, duke më thënë: «Për luftën t'i jap me gjithë zemër». Sanoja nuk e mori vesh se ku shkuan të hollat që dhuroi.

Koçoja zuri një vrimë si dyqankë në Rrugën e Bamit (sot rruga «Qemal Stafa») dhe i bëri asaj një vitrinë e ca rafte. Një ditë të bukur erdhi e më tha:

- Enver, duhet të shkoj në Itali me Pavlinën.

- Përse?! - e pyeta i habitur.

- Të blej ca mallra për dyqanin, - më tha. Atje do t'i marr më lirë dhe këtu do t'i shes më shtrenj të.

- Je në vete? - i thashë, - bleje këtu ç'ke për të blerë. S: do të shkosh në Itali, pale edhe me gjithz gruan ? !

- Do të vete, - u hodh Koçoja, - se kështu edhe maskohem.

Dhe, bëri, ç'bëri, shkoi. Kështu Koçoja na u bz me dvqan të modës për gra. Që atëherë filloi tek unë ftohja dhe njëfarë mosbesimi për Koço Tashkon, kurse shokët e tjerë nuk e honepsnin fare. E merrnim me mend se sa e preokuponte puna e grupit Koço Tashkon. Sidoqoftë, të gjithë ne mbanim gjakfto-itësinë me të dhe vazhdonim me këmbëngulje punën për të realizuar qëllimet që i kishim vënë vetes.

Dy qëllime kryesore, bazë, na preokuponin për idealin e madh që ziente në mendjet dhe në zemrstonat: të shtonim sa më shumë dhe në të gjitha qytetet numrin e anëtarëve të grupit me punëtorë të vendosur, me zanatçinj, me studentë revolucionarë e me intelektualë, të hynim edhe në fshat ku puna jonë ishte, si me thënë, përtokë dhe, qëllimi i dytë, të zhdukim në baza parimore grindjet dhe mosmarrëveshjet me grupet e tjera komuniste që vepronin në Tiranë, në Shkodër e gjetkë, të arrinim me to një bashkim të vërtetë nga vare] çështja jetike e vendit tonë, krijimi i partisë komuniste.

Gjëja kryesore dhe vendimtare ishte zgjerimi i lidhjeve me punëtorët, pse ata do të përbënin bazën e çeliktë të partisë që do të krijonim. Ne e kuptonim se po ta arrinim këtë, s'do të kishte forcë të na thyente.

Në këtë çështje ne i kishim hedhur mirë hapat e parë. Kishim krijuar lidhje e kishim bërë mbledhje me punëtorë revolucionarë, si Mihal Duri e Misto Mame, me shoferë, si Niazi Islami, me çirakë si Dull Keta, me punëtorë që punonin në fabrikën e cigareve «Flora», si Nikolla Tupe e punëtorë të tjerë, si Qiriako e Andon Deçka, një nga vëllezërit e Xibinakëve e të tjerë, që s'po rri t'i numëroj të gjithë. Por kjo veprimtari duhej thelluar më tej. Shokët e rinj punëtorë këshilloheshin të krijonin lidhje e afërsi edhe une të rinj të grupeve të tjera, të futeshin në biseda miqësore me ta, të flisnin kundër armikut fashist, kundër kuislingëve etj., por me kujdes e pa acaruar situatat, duke ruajtur individualitetin e «Partisë» sonë. «Shikoni, shokë, - u theksoja, - kjo ka rëndësi të madhe për të ardhmen».

Dhe kështu u bë. Gjithë këta punuan pa u lodhur e i zgjeruan mjaft rrethet e tyre me punëtorë të rinj, të guximshëm. Këta punëtorë e të rinj të gjallë nuk mbaheshin. Ata donin luftë e aksione kundër armikut. Kurdoherë vinin në dyqanin «Flora», ku më gjenin rrua ose Pilon dhe, pasi na raportonin, bënin pyetjen zakonshme: «Ç'do të bëjmë sot, ç'do të bëjmë nesër?».

Aktiviteti i gjerë e i vrullshëm, që sa vinte e ritej, na detyroi të zinim me qira shtëpi të tjera të vogla në lagje të ndryshme të Tiranës, për të bërë takimet tona, se dyqani «Flora» po komprometohej. Përballë dyqanit ishte një kafene e vogël përdhese. Kafexhiu ishte një tiranas me brekushe, me qeleshe të lartë, me brez të kuq në mes dhe me peshli. Ishte i shëndoshë dhe afër dy metra i gjatë, aq sa, kur hynte e dilte nga dera e kafenesë, me tepsinë me një mbajtëse në mes, duhej të përkulej mirë. E quanin Mali. Ai mbante një çibuk të gjatë nga ata me gdhendje e me ngjyra që bënin artizanët e Tiranës. Çibukun ia shihje Malit ose në gojë, ose në zverk, ose në brez. Mali na donte shumë. Ai nuk e dinte ç'bënim ne, por, kur kafenenë e tij filluan ta vizitonin spiunët, Mali e kuptoi se ata na përgjonin dhe, pa qenë komunist, u bë mbrojtësi ynë i flaktë, derisa policia dyshoi dhe ia mori kafenenë.

Kur shkonin spiunët atje, Mali, gasi u shërbente, dilte te dera, hiqte qeleshen dhe kruante kokën. Kjo ishte parulla për ne që donte të thoshte: «Kujdes, këtu brenda i kam spiunët». Dhe po të dëgjonte ndonjë nga muhabetet e tyre, ai përgjonte rastin kur në dyqanin tonë s'kishte njeri dhe vinte shpejt.

- Envero, du një baqetë «Flora», - më fliste dhe, ndërkohë që unë bëja sikur kërkoja paqetën e sikur i ktheja kusurin, ai më tregonte bisedat e spiunëve. Mali, ai njeri i heshtur, qytetar i këputur i Tiranës, na ka shpëtuar nga shumë rreziqe.

- Punoni çuna, - na thoshte Mali dhe largohet, duke rregulluar qeleshën.

Lidhjet i zgjeruam edhe me punëtorët e qyteteve të tjera. Nga Tirana aktivizuam shokët punëtorë të Kuçovës. Për punëtorët e Kuçovës në tërësi, sidomos për naftëtarët e saj, ndieja prej kohësh një respekt e simpati të thellë. Ata, vite më parë, të organizuar në shoqërinë «Puna» që drejtohej nga shoku Mafuz Laze, në ndikimin e lëvizjes punëtoare në Korçë, ishin ngritur në një grevë të fuqishme, e cila, për nga karakteri, përmbajtja dhe vendosmëria e saj, përbënte një ndërfaqet më të shënuara të lëvizjes punëtoare në Shqipëri. Greva e punëtorëve të Kuçovës vazhdoi disa ditë me radhë dhe aq shumë telashe u nxori sipërmarrësve italianë dhe regjimit zogollian, sa qeveria e atëhershme u detyrua të dërgonte kundër punëtorëve forca të mëdha xhandarësh, të kryesuara nga vetë ministri i Brendshëm i asaj kohe. Greva, më në fund, u mbyl nga forca e kondakëve, e bajonetave dhe e arrestimeve të shumta, por jehona e saj u përhap anembanë vendit. Kisha parasysh këto tradita revolucionare të punëtorëve të Kuçovës, kisha parasysh faktin që ata duhej medoemos të lidheshin sa më ngushtë me lëvizjen komuniste e me partinë komuniste që po luftonim të krijonim, prandaj vendosa dhe shkova vetë atje. U takova me punëtorë, biseduam si të organizoheshin, si të organizonin celulatat dhe si të punonin me shokët e tjerë punëtorë e me popullin. I porosita që të ruheshin sa më mirë nga policia. Më vonë shkova edhe në Fier. Atje u strehova në kasollen e Rafael Petros, në shok i vendosur i grupit, që e kishte në hyrje të Fierit, tek ura, përkundrejt shtëpisë së bejlerëve Resulaj. Kasollen e kishte gati në kënetë, krejt lagështirë. Ai qëndroi i vendosur në rrugën e Partisë, mori pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe, pas Çlirimit, u zgjodh anëtar i Këshillit Popullor dhe për një kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të qytetit të Fierit e ka punuar kurdoherë me nder. Bisedova me të sesi të punonim për zgjerimin e lidhjeve me fshatarët e rrethit të Fierit. Shtypja dhe shfrytëzimi barbar që i ishin bërë dhe vazhdonin t'i bëheshin, sidomos fshatarësisë së zonës së Myzeqesë nga regjimi në fuqi, krijonin mundësi të mëdha që shokët tanë të zgjeronin rrethet e tyre e ta përgatitnin atë për luftë. Këtë bëra edhe me një shok këpucar, kosovar, që banonte nga Bishanaku e që e kisha njohur qëkur isha më i riedhe në Durrës e zhvilluam mirë punën. Atje kishim mjaft shokë, si komunistin e vjetër Abaz Kondon e të tjerë, dhe kjo na ndihmoi të zgjeronim më shumë rrethin tonë. Shtyllë kryesore në atë qytet kishim Telat Nogën, komunist i vendosur, punëtor në fabrikën e cigareve «Stamles». Shumë punëtorë të kësaj fabrike dhe hamej të portit i kishim nën influencën tonë.

Po në këtë periudhë shkova edhe në Gjirokastrë Atje prej vitesh vepronin elementë të grupeve të ndryshme komuniste, si Bedri Spahiu, Haki Toska, Ilo Panduku, Bajram Sinojmeri, Muzafer Asqeriu e të tjerë. U takova me disa nga këta shokë dhe biseduam për problemet që qëndronin para popullit shqiptar e, në radhë të parë, para komunistëve shqiptarë. Ndërmjet të tjerash theksova se, sido që jemi anëtarë të grupeve të ndryshme, ne duhet të afrohem me njëri-tjetrin, sepse si idealet ashtu edhe çështja për të cilën ne duhet të luftojmë janë të njëjta e të përbashkëta. Lufta jonë kundër okupatorit, u thashë shokëve, nuk mund të marrë hov e s'mund të kurorëzohet me sukses pa hedhur poshtë pikëpamjet e frymën e sëmurë të grupeve, prandaj duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për të gjetur gjuhën e përbashkët e për të krijuar kushtet që do të na çojnë drejt themelimit të një partie të vetme, Partisë Komuniste Shqiptare. Kjo është detyrë që qëndron përpara të gjitha forcave të shëndosha revolucionare të vendit, përpara çdo shoku, pavarësisht nëse është në udhëheqje të grupit apo anëtar i thjeshtë, pavarësisht nëse punon e lufton në Tiranë, në Korçë, në Shkodër, në Gjirokastrë apo kudo gjetkë.

Kurse puna jonë me fshatin ishte akoma e dobët, prandaj na dilte detyrë e rëndësishme të krijonim lidhjet me të. Në atë kohë ne luftonim sidomos kundër pikëpamjeve trockiste të Anastas Lulës për problemin e fshatit, pikëpamje këto që ngjallnin konfuzion dhe, po të përhapeshin, do t'i silinin dëme shumë të mëdha jo vetëm punës së partisë që donim të krijonim, por edhe vetë fateve të luftës kundër pushtuesve.

Sipas Anastas Lulës e pasuesve të tij fshatarësia shqiptare ishte «e prapambetur», «konservatore», «reaktionare» dhe me të komunistët nuk mund të punonin, nuk mund të krijonin lidhje e baza të organizuara! Do të flas edhe më poshtë për pikëpamjet reaksionare të Anastas Lulës e të shokëve të tij, por këtu dua të theksoj se Grupi i Korçës, jo vetëm kishte pikëpamje të drejta për këtë problem, por edhe luftonte për mbrojtjen e pikëpamjeve të veta. Veçanërisht pas ardhjes në Tiranë interesi e vëmendja jonë ndaj fshatarësisë u shtuan më tepër. Mua, personalisht, kjo temë më tërhiqte e më interesonte prej kohësh, jo vetëm sepse si komunist e ndieja dhe e kuptoja nevojën e lidhjes midis çështjes së klasës punëtore e të fshatarësisë, por edhe për një arsye tjetër: që në fëmijëri e rini isha njohur e dashuruar pas traditane të mëdha patriotike e revolucionare të fshatarësisë shqiptare, -pas luftërave të saj të pareshtura për lini e pavarësi kombëtare.

Që i vogël kisha dëgjuar nga të afërmit e nga mësuesit e mi për trimëritë e rralla të figurave të shquara të fshatarësisë. Ndodhi të luftërave të Balil Neshës, Gjolekë Labit, Çelo Picarit, Tafil Buzit e Rrapo Hekalit më ishin ngulitur në mendje edhe nga këngët e bukura që këndoheshin brez pas brezi në Gjirokastrë. Këto këngë i mbaj mend mirë edhe sot dhe, të them të drejtën, edhe tani, kur qëllon që mblidhem me miq e me shokë të vjetër, kur vete takohem me popullin në Gjirokastrë a gjebkë, më pëlqen t'i këndoj këto këngë, ku populli me fjalë të rralla ka skalitur si me daltë historinë dhe heronjtë e tij. Qëkur isha nxënës e mësues në Korçë lexoja me pasion ç'gjeja për lëvizjet e kryengritjet fshatare. Tani që ndodhesha në Tiranë i shtova «gërmimet» për të mësuar sa më tepër edhe rreth Kryengritjes së Fshatarëve të Shqipërisë së Mesme e «rebelimit» të Haxhi Qamilit, rreth rrënjëve, arsyeve, qëllimeve të saj. U njoha bile edhe me disa pjesëtarë të asaj lëvizjeje. si Xhaf Zelka. të cilët i prisja me qejf në «Flora» dhe i shpoja për të dëgjuar e për të mësuar sa më shumë. Ky nuk ishte vetëm një pasion i thjeshtë për t'u njohur me historinë e popullit tonë. Jo, nga analizat dhe nga diskutimet që bëja, gjithnjë e më tepër më forcohej bindja për karakterin patriotik e revolucionar të fshatarësisë sonë e të lëvizjeve të saj historike, gjithnjë e më qartë e shihja se me një punë më të dendur, më të kujdesshme, ne duhej dhe do ta bënim patjetër fshatarësinë me vete. Pa fshatarësinë Partia jonë nuk do ta përmbushte dot misionin e saj. Duke ballafaquar pikëpamjet e Anastas Lulës me shokë për karakterin e fshatarësisë sonë me pikëpamjet e shtrembra e denigruese të esadistëve, zogistëve e borgjezisë fajdexheshë, për këtë problem, e pashë qartë, se ato në thelb qenë pothuaj të njëjta. Prandaj ne duhej t'i luftonim me forcë pikëpamjet trockiste e reaksionare mbi fshatarësinë, sepse vetëm kështu do të krijonim një -parti të vërtetë marksiste-leniniste. Megjithatë fillimisht kjo luftë më tepër bëhej nga ana teorike, se konkretisht fshati për ne ishte tokë e paprekur. Në këtë drejtim shquante pikëpamja «uvrieriste», siç shpreheshim ne, kur u shpjegonim shokëve të grupit nga ana teorike problemin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, që ishte jetike për çlirimin e atdheut. Shokët punëtorë e kuptonin këtë nevojë, por, megjithatë, duhet njohur se korçarët ishin ca sektarë në këtë drejtim. Me bindje e me durim ne po mundnim ta thyenim ca nga ca këtë pengesë. Unë, nga ana ime, kisha filluar punën nëpërmjet lidhjeve që kisha vendosur me Myslim Pezën. Me Babën, siç e thërritnin Myslimin fshatarët e Pezës, u njoha nëpërmjet mikut dhe shokut tonë besnik; Esat Dishnicës, që më 1939, para se vendosesha në Tiranë. Myslimi dhe familja e tij kishin miqësi të madhe me Aqif pashë Elbasanin. Të dyja familjet, edhe të Aqif Pashës. edhe të Pezës, ishin armiq për vdekje me Shefqet Vërlacin. Esati ishte armiq i Aqif Pashës, djali i motrës së këtij dhe në shtëpinë e Aqifit kishte dëgjuar dhe qe njohur me Myslim Pezën.

Dy a tri herë, tok me Esatin e me Myslimin, kemi shkuar te kafja e Dem Xhepës, dhe sa herë që shkonim atje, kur uleshim, Myslimi krahët ia mbështeste murit që ta kishte portën karshi.

- Armikun, babë, - thoshte Myslimi, - duhet ta shikosh përpara dhe mbaje ngrehur çarkun, zbraze i pari. se, po u lëkunde, ta kallli.

Kujtimet e mia për patriotin e shquar Myslim Peza janë të shumta e të paharruara, sepse, që nga vera 1939-s e gjer më sot, ne na lidh një histori e tërë, hatoria e revolucionit tonë, që i kemi kushtuar gjithë jetën. Por përshtypjet dhe mbresat nga takimet e para me të janë nga më të shtrenjtat për mua dhe më kanë mbetur të gjalla gjer në detaje. Baba ishte kthyer nga e:nigracioni jo për t'u pajtuar e as për të bërë «luftë kafenesh» kundër pushtuesve, por për të luftuar kundër tyre, ashtu

sikurse edhe elementët me të vërtetë patriotë e revolucionarë, si Haxhi Lleshi, Mustafa Kagaçi, Kajo Karafili e të tjerë. Myslim Peza ishte njeri i pushkës e i barutit, ai u kthye në Shqipëri për të luftuar. Qëllimi i përbashkët - lufta për çlirimin e vendit që ishte vija e komunistëve të vërtetë dhe e Partisë Komuniste që krijuan ata - na afrooi e na lidhi gjithnjë e më ngushtë me Myslimin aslztu siç i lidhi me Partinë ky qëllim të gjitha forcat e shtresat që u dhimbsej me të vërtetë çështja e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut.

Qysh më 1939, sapo mora vesh se Myslim Peza ishte kthyer në Shqipëri nga emigrimi i gjatë politik, u përpoqa dhe arrita të takohesha e të bisedoja me të.

U bëra mik me Myslimin, e doja dhe e çmoja për trimërinë e për mprehtësinë e tij prej fshatari të zgjuar.

Mbaj mend se në një nga takimet tona, ndërsa ishim ulur e po bisedonim kokë më kokë, ia dhanë sirenat e alarmit. Hyri me shpejtësi Esati:

- Alarm ajror! - tha, - ç'do të bëjmë?

Vështrova Myslimin që qëndrorite gjakftohtë e i përqendruar, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

- Si të dojë Baba, - i thashë Esatit. - Për mua në daç rrimë, në daç ikim.

- Është gjithë kjo Tiranë, - tha Myslimi, - e ku drejtin do na gjejë bumja në këtë copë vend!

- Meqë unë s'kam kokë tjetër, po iki, - na e ktheu Esati me shaka dhe na la vetëm që të vazhdonim.

Unë, që e njihja mirë Esatin, e dija se ai s'qe nga ata që u trembeshin fishkëllimave. Gjithë merakun e kishte për ne.

Në bisedë Myslimi ishte i përqendruar e i vëmendshëm. Nuk kishte mundur të arsimohej, por shkolla e vuajtjeve dhe e përpjekjeve të pandërprera e kishte bërë të mprehtë e të aftë të kuptonte çdo problem. Dhe s'kishte gëzim më të madh për mua kur ai me gojën e tij më foli me simpati për komunizmin. Në mërgim ishte njohur me patriotin dhe me revolucionarin e shquar Haxhi Lleshin dhe ky atje i kishte folur e i kishte lexuar Myslirnit për Leninin, për revolucionin e për komunizmin.

- Unë, or babë, - tha Myslimi, - komunist nuk jam, por komunizmin e dua.

- Ne komunistët, shoku Myslim, - i thashë,

jemi për luftë, për luftë me armë kundër fashistëve. A do të jesh edhe ti me ne?

- Oj, si nuk do të jem?! Pse erdha unë? Për

të luftuar erdha, - m'u përgjigj Myslim Peza. - Do të jem në ballë të luftës me ju komunistët dhe me të gjithë ata që duan të luftojnë për vatanin.

I shtrënguam dorën me dashuri e forcë njëri-tjetrit dhe ndjemë se kishte lindur një miqësi luftarake, jo vetëm në mes neve, të dyve, por te Myslimi ne, komunistët (e më vonë Partia), kishim gjetur një luftëtar besnik e të vendosur për Luftën Nacionalçlirimtare dhe bashkimin e popullit në një front të vetëm, në rrugën që këshillonin komunistët e më vonë, kur lindi Partia, në rrugën që tregonte ajo. Folëm gjatë për fashistët e tradhtarët dhe luftën që duhej të organizonim kundër tyre, i folëm njëri-tjetrit për shokë e miq, te të cilët duhej të mbështeteshim e t'i bënim për vete. E kuptuam njëri-tjetrin sikur të kishim 20 vjet që njiheshim.

Lidhjet me Myslimin shkuan duke u forcuar. Një herë i dhurova një «Mauzer» të ri, një njëzetshe.

Më duket se ishte fillimi i vitit 1941. Myslimi ishte njohës i madh i armëve dhe nëpër duar kishte kaluar marka armësh nga më të ndryshmet, por. kur mori dhuratën time, i ndritën sytë:

- S'ka si bëhet peshqesh më i madh, - tha dhe e përkëdheli revolverin me duar. Ai te kjo dhuratë pa edhe respektin tonë për të, por edhe dëshirën e sinjalin e komunistëve. Tashmë aie kishte rritur çetën dhe e vuri atë në dispozicion të luftës për çlirimin e atdheut. Në mars të vitit 1941 Myslimi goditi italianët në rrugën e Pezës dhe doli ilegal me gjithë çetë. Ne, menjëherë pas këtij veprimi, hodhëm një trakt, i cili, megjithëse u shpërnda në pak kopje, se aq kishim mundësi, bëri jehonë. Njëkohësisht filluam të organizonim e t'i dërgonim ndihma Myslimit me anën e Esatit dhe të Dem Xhepës. I nisnim ushqime, veshje dhe të holla, të cilat herë vinte i merrte korrieri i çetës, Rat Mëçalla, herë ia dërgonim me anën e «Qeleshexhiut», një mik tiranas i Myslimit.

I paharruar do të mbetet për mua takimi me babë Myslimin dhe çetën e tij në verën e vitit 1941. Ishte koha kur grupet tona komuniste, e veçanërisht ai i Korçës e i Shkodrës, po gjenin rrugën e drejtë e të sigurt drejt sheshimit të mosmarrëveshjeve, koha kur sapo kishte hyrë në luftën

vendimtare Bashkimi Sovjetik, koha kur po merrte vrull vetë lufta e popullit tonë për Tiri e pavarësi. Me babë Myslimin tash isha mik i vjetër, e njihnim e i kishim dhënë besën njëri-tjetrit se do të luftonim gjer në fund për çështjen e përbashkët. Unë vetë kisha shfaqur dëshirën të takohesha me Çetën e Pezës.

Kur i çova fjalë Myslimit, m'u përgjigj menjëherë: - Hajde kur të duash. Të presim.

Takimi u organizua në një pyll afër Pezës së Vogël. U përqafova me Myslimin, e pastaj me të gjithë pjesëtarët e çetës një për një. Me ta unë nuk isha njohur më parë, por për zemërsia me të cilën më pritën dhe mirëkuptimi që arritëm për të gjitha problemet që diskutuam, më bindën se Myslimi e kishte bërë punën e vet me ta. u kishte folur mirë për mua e për çështjen që përfaqësoja. Atje pashë e përqafova për herë të parë trimin sypatrembur, Kajo Karafi:in. Partia i dha trimërisë së tij mençurinë e mprehtësinë, Partia i dha Kajos përmbajtjen e vërtetë të heroizmit. Kajoja, nga ana e tij, u dha Partisë e popullit gjithçka, gjer edhe jetën.

Atje njoha luftëtarin e pandarë nga Myslimi, Shabë Rexhën dhe xha Kasemin, i cili, ndonëse nuk shihte mirë, e ndiqte Myslimin kudo që shkonte.

U ulëm e biseduam gjatë me çetën. I përgëzoja për përleshjet që kishin zhvilluar. u shpreha dhimbjen e thellë për shokët e parë që kishin rënë në përleshje me armiqtë, bisedova me ta për qëllimet dhe të ardhmen e luftës sonë. U foli për situatën në vend dhe për jehonën e madhe që kishin shkaktuar përpjekjet e para me fashistët e, ndër to, edhe përpjekjet e atyre luftëtarëve trima me të cilët isha ulur e bisedoja.

Ndejtëm gjatë atë ditë të paharruar në pyllin e Pezës, dhe, kur erdhi koha të ndaheshim, iu drejtova Myslimit

- Dua një fjalë prej teje, o Myslim, - i thashë.

- Urdhno, o babë, - m'u përgjigj ai.

- Siç kemi biseduar bashkë edhe më përpara, ne mendojmë të dërgojmë këtu në Pezë shokë të rinj, komunistë. Si thua?!

- Çeta, që se hyre ti këtu. or babë. - m'u për gjigj Myslimi, - ka komunistët brenda. Sill sa të duash, se pa shokë s'kemi ç'bëjmë.

- A mund t'i mbani dot 40-50 veta? - e pyeta.

- Që tani i mbajmë 500, - m'u përgjigj Myslim Peza, - më vonë edhe më shumë!

Qesha me të madhe dhe e përqafova.

I tillë ishte Myslim Peza, komandanti trim i të parës çetë partizane, e .më pas një ndër luftëtarët më legjendarë të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare.

Pas takimit tim me Çetën e Pezës ne filluam menjëherë të dërgonim atje shokët tanë. Po kështu, në bazë të marrëveshjes që arritëm me Grupin e Shkodrës për veprime të përbashkëta, më vonë në çetë dërgoi shokë edhe Grupi i Shkodrës. Kështu, edhe shokët e këtij grupi po luftonin krahas shokëve tanë dhe kjo ishte një gjë e mirë që duhej të na forconte besimin se edhe ky grup ishte për luftë dhe kështu binte një nga akuzat pa vend që ngrinin disa për të.

Vendosëm lidhje edhe me fshatarët e Dajtit e të Krujës, pse andej kishim shokë të mirë, si Met Seserin e të tjerë. Ndërkohë unë vazhdova të zgjeroja lidhjet edhe me ish kolegët e mi, mësues antizogistë e antifashistë. Rrethet tona po zgjeroheshin edhe me intelektualë të tjerë, ca nga të cilët i njihja une, ca Koço Tashkoja. Koço Tashkoja, si më i vjetër dhe ish-nënkonsull në Nju-Jork1, punonte veçanërisht me pleqtë nacionalistë të arratisur në kohën e Zogut, të cilët u kthyen me «vagonat» e italianëve. Koçoja i kishte qejf muhabetet dhe me ta s'kishte rrezik se komprometohej.

Krahas përpjekjeve për zgjerimin e punës së grupit tonë e të propagandës antifashiste në popull, ne kishim punuar e kishim arritur disa suksese edhe në çështjen tjetër kryesore : në atë të kontakteve me grupet e tjera komuniste.

Por më përpara dëshiroj të flas, në përgjithësi, për gjendjen e pikëpamjet kryesore të Grupit të Shkodrës dhe atij të «Të Rinjve», ashtu siç bëra edhe për Grupin e Korçës. E vërteta është se mendimet e plota për gjendjen e këtyre dy grupeve na u krijuan atëherë kur filluam diskutimet e hapura dhe bëmë autokritikën në emër të grupeve në ditët e

në netët historike kur hodhëm themelet e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Para kësaj kohe asnjëri grup nuk kishte një mendim të saktë e të drejtë për grupin tjetër. Mendimet e Grupit të Korçës për grupet e tjera dhe, anasjelltas, mendimet e tyre për grupin tonë ishin në kundërshtim flagrant me njëri-tjetrin. Në mendimet tona personale kishtë disa nuanca që tregonin se diçka po ndryshonte, po çelej ndonjë shteg komunikimi e afrimi midis nesh, por, në përgjithësi, ne duhej t'i bindeshim qëndrimit të njëjtë rigoroz të grupit dhe kjo lloj disipline na mbante akoma të ndarë, të ftohtë e në mëri me njëri-tjetrin. Ishin pikërisht mbledhjet e ditëve të para të nëntorit të vitit 1941 që hodhën dritë të plotë mbi të mirat dhe mbi dábësitë e mbi të metat në punën e grupeve, që vunë në dukje ç'gjëra na lidhnin e si të bashkoheshim dhe ç'gjëra na ndanin e si t'i shkelmonim ato përfundimisht. Por kjo u bë më vonë. Tani le të qëndrojmë te gjendja konkrete e grupeve.

Grupi i Shkodrës, në përgjithësi, përbëhej nga shokë të mirë. Në mes tyre kishte punëtorë, studentë e disa intelektualë, kurse pak ose aspak fshatarë. Natyrisht, si çdo grup, ai kishte simpatizues nga shtresa të ndryshme. Edhe Grupi i Shkodrës kishte karakter të mbyllur; shumica e anëtarëve të tij ishin në Shkodër, por kishte mjaft njerëz të grupit, punëtorë, e sidomos studentë, - edhe në Tiranë.

Grupit të Shkodrës i mungonte ai organizim e disiplinë e brendshme që kishte krijuar Grupi i Korçës. Lidhjet e anëtarëve të tij ishin të çlirëta; veprimet e tyre nuk diktoheshin nga një udhëheqje pak a shumë e afirmuar, por jepeshin udhëzime dhe direktiva të rastit, individuale. Grupi i Shkodrës ishte i pakontrollueshëm, jo se anëtarët e tij nuk mblidheshin dhe nuk instruktoheshin, por sepse mbledhjet që bënin ishin tepër konspirative dhe asgjë nuk pipëtinte jashtë për veprim.

Grupi i Shkodrës nuk i kishte pranuar direktivat e Kominternit për të shpërndarë «celulat» sektare, për t'u futur komunistët në masat e punëtorëve, të fshatarëve dhe të intelektualëve, për të punuar me ta dhe për të krijuar me më të mirët prej tyre celula të reja, të pastra, të fuqishme dhe të gatshme për luftë.

Këto pikëpamje të udhëheqjes së Grupit të Shkodrës kundër direktivave të Kominternit binin në kundërshtim, dhe këtu qëndronte tragjedia, me dashurinë që ushqenin për komunizmin, për Bashkimin Sovjetik, për Stalinin, për Kominternin shumë anëtarë të mirë të Grupit të Shkodrës, si Vasil Shantoja, Qemal Stafa, Kristo Themelko, Tuk Jakova (i cili znë vonë tradhtoi Partinë dhe komplotoi me titistët jugosllavë kundër Partisë dhe atdheut socialist), Nexhmije Xhuglini, Fiqret Sanxhaktari, Ali Demi, Nazmi Rushiti, Qamil Gavoçi e shumë shokë të tjerë.

Shokët e Grupit të Shkodrës ishin antizogistë e antifashistë të vendosur dhe, sidomos pas okupacionit u hodhën dhe ata në aksione revolucionare, në demonstrata, hedhje traktesh etj. Por k'yi grup ka pasur në krye një trockist dinak, Zef Malën, i cili!, kur u burgos, i dha policisë së Zogut gjithë ç'dinte për grupin e vet e shokë të tjerë. Ai hiqej si proletar i intelektualizuar, por s'ishte gjë tjetër veçse një demagog i vogël dhe intrigant, që zhvillonte një punë minuese. Ai nxori edhe nja dy numra të një buletini gjoja teorik të grupit (që më vonë u quajt «Buletini jeshil», nga ngjyra e kapakëve), me të cilin do të

ushqente anëtarët. Por idetë dhe mendimet, që përhapte ai, ishin pjesë të nxjerra e të lexuara në manuale trockiste, që botoheshin në Italinë fashiste. (Edhe Grupi i Korçës nxirrte një buletin të vetin, i cili, po ta shohim me syrin e sotëm nuk kishte ndonjë peshë të rëndë, veçse shkrimet e tij kishin rrallë ndonjë gabim vije,.)

Grupi i Shkodrës qysh në momentet e para, kur u konkretizua si grup më vete, u përpoq të lidhej me Grupin e Korçës, por, për fat të keq, kjo u zëvendësua nga një lidhje me pasoja të dëmshme: Zef Mala, aty nga fundi i vitit 1937, ra në kontakt me një element të poshtër trockist, me Niko Xoxin, tradhtar i Grupit të Korçës e i Ali Kelmendit.

Niko Xoxi, i mbarsur me të gjithë bagazhin arqiomarksist e diversionist të Andrea Zisit, pasi s'mundi të nënshtronte dot Grupin e Korçës, shkoi në Shkodër e në Tiranë dhe atje shumë shpejt gjeti gjuhë të përbashkët me Zef Malën, gjeti, si të thuash, tenxherja kapakun. Të dy këta renegatë, pas një sërë intrigash, shpifjesh e konfuzioni që krijuan, arritën të merrnin në duar frenat e drejtimit të Grupit të Shkodrës.

Pas kësaj lidhjeje antimarksiste do të shohim të mbijnë në këtë grup lloj-lloj teorish të huaja për lëvizjen revolucionare në Shqipëri, teori që pengonin përcaktimin dhe përfaqimin e një vije të

drejtë revolucionare. Aty nga gjysma e dytë e vitit 1940 drejtuesit e Grupit të Shkodrës kishin hyrë në allishverishe me Grupin e «Të Rinjve», që udhëhiqej nga Anastas Lula.

Veçanërisht, pas afrimit me këtë grup, penetrimi i ideve të gabuara u bë akoma më i theksuar. Në dallim me Grupin Komunist të Korçës që mbështetej te punëtorët e përbëhej kryesisht nga punëtorë, Grupi i Shkodrës, si dhe ai i «Të Rinjve», vëmendjen e përqendruan më tepër në shkollat, në inteligjencien. Bagazhi teorik e organizativ me të cilin ushqeheshin këta të rinj, veçanërisht nga krerët e, Grupit të «Të Rinjve», si dhe nga Zef Mala e Niko Xoxi, nuk ishte në baza të shëndosha marksiste, por sidoqoftë, sidomos pas pushtimit fashist, këto grupe i intensifikuan përpjekjet e &e për të bërë për vete sa më shumë nxënës të shkollave të mesme veçanërisht në Tiranë, në Shkodër, në Vlorë, e diçka më pak në qytetet e tjera të vendit. Propaganda komuniste që bëhej me të rinjtë e shkollave, pavarësisht se si e sa, do të luante edhe rolin e vet pozitiv.

Momentet e rënda që kalonte atdheu nën pushti rrin fashist, urrejtja që ushqenin të rinjtë për pushtuesit, hovi dhe entuziazmi që vlonin në zemrat e tyre djalosha, si të thuash, i amortizonin në mënyrë të natyrshme synimet dhe «ëndrrat» e krerëve antimarksistë për përgatitjen «në qetësi» të «plejadave» të revolucioneve të së ardhmes! Jo, të rinjtë revolucionarë, që hynin nën influencën e njërit ose të tjetrit grup, nuk e bënë këtë për «të nesërmen» që s'dihej kur do të vinte, por e bënë për ditën, për çastin, për luftën që po ziente e po shpërthente. Ata hynin në lëvizjen komuniste dhe e quanin veten komunistë me idenë e shenjtë që të hidheshin menjëherë në demonstrata e në aksione, t'i përvisheshin, pra, çështjes së luftës e të revolucionit, që ishin probleme të shtrura në rendin e ditës. Është kjo arsyeja kryesore, se pse baza e këtyre grupeve, pavarësisht nga puna sabotuese e krerëve, ishte për luftën, ishte për Partinë dhe ushtri influencën e, vet të madhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ekzistonin midis grupeve.

Në Grupin e Shkodrës, si edhe në atë të Korçës, një rol jo të paktë ka luajtur edhe solidariteti lokalit i dëmshëm, i cili ka qenë në baza jo të shëndosha. Për Grupin e Shkodrës gabimet ishin më të theksuara sepse këtu influencenin trockistët Zef Mala, Niko Xoxi, Andrea Zisi e të tjerë, kurse në Grupin e Korçës drejtonin Ali Kelmendi, Miha Lako, Pilo Peristeri e të tjerë proletarë, komunistë të qartë dhe të vendosur.

Një ndryshim tjetër në mes këtyre dy grupeve ishte qëndrimi që mbahej ndaj literaturës, teorisë marksiste-leniniste. Anëtarët e Grupit të Shkodrës kishin një zell më të madh se ata të Grupit të Korçës për të lexuar. Grupin e, Korçës e karakterizonte më shumë praktika dhe aksioni. Veçse duhet thënë se anëtarët e Grupit të Shkodrës dhe ata të Grupit të «Të Rinjve» vërtet lexonin më shumë, por literatura që përdornin, e cila vinte nga Greqia ose nga Italia, ishte e, pak kontrolluar dhe interpretimi i asaj që lexohej bëhej gabim; në Grupin e «Të Rinjve», veçanërisht, bëhej një interpretim trockist. Po aq i shtrembër dhe në baza jomarksiste ishte edhe qëllimi nga i cili niseshin krerët e këtyre grupeve në studimin «e thellë» që gjoja i bënë literaturës që u binte në duar. Në influencën e, Zef Malës e të Niko Xoxit, Grupi i Shkodrës, qysh para pushtimit fashist, përqafoi teorinë antimarksiste të «përgatitjes» e të «ruajtjes së kuadrit», teori që e solli në Shqipëri aventurieri dhe blofisti arqiomarksist Andrea Zisi. Sipas kësaj «teorie» në Shqipëri nuk ekzistonin kushtet për një luftë të vërtetë revolucionare me masat, bile nuk ekzistokeshin as klasa punëtore e borgjezia, as lufta e klasave! Për rrjedhim ndjekësit e kësaj pikëpamjeje kishin arritur në konkluzionin që, gjersa të krijoheshin kushtet për revolucion (!), komunistët s'duhet të bënin gjë tjetër veçse «të përgatiteshin teorikisht», të njihnin «literaturën» në majë të gishtave, «të ruheshin», domethënë të fshiheshin nga lufta e vërtetë, me qëllim që, kur të vinte momenti «i ëndërruar», këta farë burrash «të mësuar», të lëshonin dijet nëpër udhë e të merrnin pushtetin!

Por, pavarësisht nga synimi dhe orientimi i krerëve për këtë problem, duhet thënë se puna e bërë për studimin e asaj pjese të literaturës që ishte vërtet marksiste, do të luante dhe luajti rolin e vet pozitiv në armatosjen revolucionare të bazës së shëndoshë grupeve.

Anëtarët e, Grupit të Shkodrës në shumicën e tyre ishin njerëz të guximshëm, trima. Ata, pavarësisht nga udhëheqësit e tyre trockistë Zef Mala e Niko Xoxi. punonin për të organizuar luftën kundër fashizmit. Duhet të mos harrojmë se ata i vëzhgonte jo vetëm policia e Zogut, por edhe «policia» e klerit katolik. Ky ishte një rrezik i madh në Shkodër, që u ngjitej njerëzve si vëmja.

Zef Mala, kryetari i grupit, mbaroi si agjent i policisë zogiste, i kallëzoi të gjithë shokët dhe punën që bënte grupi i tyre. Policia e Zogut i arrestoi shokët kryesorë të Grupit të Shkodrës, i goi në gjyq dhe i dënoi me burgime të ndryshme. Kur u pushtua Shqipëria, Qemali, Vasili e të tjerë u arratisën nga burgu, Qemali edhe u plagos në krah, kur e ndiqnin xhandarët.

Ç'qëndrim rubante Grupi i Shkodrës përpara okupatorit dhe krerëve trockistë? Duhet thënë se të gjithë anëtarët e tij, ashtu sikurse ata të Grupit të Korçës, si edhe, baza e Grupit të «Té Rinjve», ishin në bllok kundër okupatorit dhe kuislingëve. Ata e urrenin fashizmin okupator dhe donin të luftonin, prandaj dolën në bllok në demonstrata e në aksione. Por, nga ana tjetër, në radhët e tyre, siç përmenda edhe më lart, kishte konfuzion për shkak të «teorive» pseudomarksiste që shpërndanin trockistët. Ky konfuzion do të zhdukej nae etapa në rrjedhën e ngjarjeve që zhvilloheshin me shpejtësi.

Të tilla karakteristika të mira dhe të këqija ki shte Grupi i Shkodrës. Kuptohet që në këto kushte zhvillohej një grindje dhe një luftë në mes tij e Grupit të Korçës për «hegjemoni», për çështje të tilla, si «kush është parti», «kush ka lidhje me Kominternin», «kush e ka vijën të drejtë», «ç'ral do të luajë punëtoria dhe ç'rol fshatarësia», «si duhej konsidexuar familja, martesja, prona private» e për shumë gjëra të tjera dhe, s'ka dyshim, pikëpamjet e kundërta që kishim për këto çështje na përganin me njëri-tjetrin e as njëra palë, as tjetra nuk bënte Iëchime. Por, përveç çështjeve parimore që na ndanin, lidhjet tona i dëmtonte edhe prepotenca mikroborgjeze e Koço Tashkos, i cili ushqente idenë «se është e kotë të bëhen ,përpjekje për bisedime ose për afrim me ata». Dhe ishte, ca më tepër për të ardhur keq kur shihnim se ai e kishte fjalën edhe për ata shokë të Grupit të Shkodrës që kishin dhënë prova të burrërisë dhe të vendosmërisë komuniste përpara gjyqeve të Zogut, siç qenë Vasil Shantoja dhe Qemal Stafa.

Ç'ishte Grupi i «Té Rinjve»? Unë këtu nuk do të bëj historikun e tij, sepse atë e ka bërë Partia në analizat e saj, por dëshiroj të theksoj disa të vërteta. Grupi në fjalë e kishte qendrën në Tiranë. Ai kishte degë edhe në qytete të tjera, veçanërisht në Vlorë. Në krye të këtij grupi qëndronin dy «të krisur», anarkistë e trockistë, Anastas Lula (Qorri) dhe Sadik Premtja (Xhepi). Në kohën e Zogut këta dy elementë hiqeshin si antizogistë, ndërsa në kohën e okupacionit si antiitalianë. Ata hiqeshin si komunistë, por «teoritë» e tyre që përhapnin s'kishin të bënin fare me komunizmin.

Këta dy elementë mbillnin mjegullën te të rinjtë.

Pas goditjes në vitin 1937 të punës fraksioniste e tradhtare të Aristidh Qendros në Tiranë, Grupi i Korçës këta dy elementë i konsideronte anëtarë të tij dhe u jepte në lidhje ata shokë të grupit që shkonin në shkollë ose për të punuar në Tiranë. Mirëpo Anastas Lula e Sadik Premtja, duke përvetësuar prej Aristidh Qendros gjithë bagazhin e tij antimarksist, e duke përfutur nga lokalizmi i Grupit të Korçës, i cili nuk e zhvilloi sa duhet punën e, vet në të gjitha ato vende ku kishte të rinj, realizuan fraksionin e vet në Grupin e Korçës.

Me kalimin e kohës ky fraksion, ndërsa ruante disa lidhje formale me Grupin e Korçës, e thelloipunën e vet përçarëse dhe në fillim të vitit 1940 dolisi grup më vete. Ishte koha kur ne po punonim e poluftonim për të zgjidhur mosmarrëveshjet me Grupin e Shkodrës, bile u arrit që të krijohej edhe njëfarë «Komiteti Qendror» i përbashkët midis Grupit të Korçës e atij të Shkodrës.

Unë nuk do të zgjatem për thelbin e kësaj ma rrëveshjeje, të cilën, qysh në Mbledhjen e Themelimit të Partisi', me të drejtë, e cilësuam një marrëveshje nga lart, një shartim socialdemokrat, por dua vetëm të theksoj se, pikërisht kur u krijua i ashtuquajturë Komitet Qendror i përbashkët, u zbulua se ekzistonte edhe një grup tjetër, gjer në atë kohë i kamufluar. Ky ishte Grupi i «Té Rinjve». Dalja hapur e tij, sulmi që shpërtheu kundër Grupit të Korçës dhe gjithë arsenalit të tij antimarksist e vështirësuan akoma me tepër punën e nisur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Në Tiranë Anastas Lula dhe Sadik Premtja mbanin në lidhje mjaft të rinj, që i kishin ushqyer dhe fanatizuar me teori banditeske, amorale e trockiste. Kurajën dhe vendosmërinë antizogiste e më vonë antifashiste e, antiitaliane të këtyre të rinjve dhe të rejave ata e drejtonin në veprime gangsterësh e anarkistësh. Këto ishin karakteristika vetëm të disa të rinjve të këtij grupi dhe vetëm në Tiranë, të cilët ishin bërë e mbetën edhe më vonë leitënantët e Qorrit dhe të Xhepit në mendime e

në veprime. Por nuk ishin kështu të gjithë anëtarët e Grupit të «Të Rinjvenë Tiranë, në Korçë, dhe sidomos në Vlorë. Anastas Lula dhe Sadik Premtja, me parullat e tyre trockiste, mundën vetëm të zhvillonin një luftë grupazhi kundër Grupit të Korçës, duke e akuzuar këtë si një grup jokomunist, por luftën e tij kundër Zogut dhe kundër okupatorëve ata nuk mundën ta shuanin dot, bile as ta dobësonin. Kjo ishte për ta «thembra e Akilit». Baza e Grupit të «Të Rinjve» ishte në përgjithësi e pastër, patriotë në kulm, e guximshme, antizogiste, antiitaliane dhe e donte komunizmin. Veçanërisht në Vlorë, Xhepi, megjithëse ishte nga ajo anë, nuk mundi dhe as që guxonte të frenonte veprimtarinë antifashiste e kundër okupatorëve italianë, sepse kishte përpara komunistin e vendosur, antizogistin dhe antifashistin, Hysni Kapo, shok me influencë të madhe e vendimtare në Vlorë, i cili qëndronte në krye të shumë shokëve të rinj të qytetit, të Shkollës Tregtare dhe të fshatrave.

Hysni Kapoja, menjëherë pas themelimit të Partisë, u bë shtylla e organizatës së re të Partisë Komuniste që po ndërtohej në Vlorë dhe, me shokët e tij, me Partinë në kr~e, luftoi që të shpartallohej definitivisht e pa nishan influenca armiqësore e Xhepit dhe e Qorrit në Vlorë, ku ata u orvatën të kryenin fraksionin armiqësor. Lufta e Hysni Kapos kundër tyre në mbrojtjen e Partisë së re, ishte kushtim për likuidimin përfundimisht të pikëpamjeve dhe praktikave trockiste të kryetarëve të ish-Grupit të «Të Rinjve» e disa pasuesve të tyre që nuk vunë mend as pas themelimit të Partisë.

Për Grupin e «Zjarrit» e ndonjë tjetër as nuk do të flas, sepse ato grupe s'kishin asgjë marksiste dhe krerët e tyre ishin provokatorë të hapur. Themelimi i Partisë i shpartalloi ata plotësisht.

Kjo ishte, pra, në vija të përgjithshme gjendja e grupeve kryesore komuniste në Shqipëri, në kohën kur ne, duke punuar legalisht në «Flora», po shtonim përpjekjet për t'u marrë vesh me «kundërshtarët» tanë, me të cilët, në fakt, duhet të ishim shokë që të luftonim për një ideal.

Siç përmenda edhe më lart, nga ana e Grupit të Korçës ne, po bënim ç'ishte e mundur si për forcimin, zgjerimin dhe shtrirjen e grupit ashtu edhe për ndjekjen prej tij të një vije sa më të drejtë e të efektshme. Pas vendosjes sonë në Tiranë i shkruam Mihas dhe ramë dakord që edhe në Durrës të dërgonim një numër shokësh të grupit nga Korça, të cilët, ashtu si ne, të punonin si për zgjerimin e radhëve ashtu edhe për punën me masat. Miha dhe shokët e gjetën të arsyeshëm propozimin tonë dhe, me ndihmën e, disa shokëve tanë që punonin në Durrës, ngritëm edhe atje një bazë të mirë të grupit ku dërguam disa shokë, si Sotir Vullkanin. Foni Thanon, Vaskë Dushkun, Janaq Karapataqin, Peti Shambllin e të tjerë. Ndërkaq u kthyen nga jashtë një numër shokësh të cilët, në Francë, për shembull, kishin krijuar «grupe» komuniste sne punëtorë emigrantë e studentë shqiptarë. Ndër ta shquheshin sidomos vëllezërit Nushi, shokët e mi të shtrenjtë Kozmai e Gogoja, të cilët shumë shpejt do të bëheshin militantë të zjarrtë, shtylla të partisë që do të krijonim. Erdhën edhe Nako Spiru (ky më duket se studionte në Itali ose në Korfuz), Ymer Dishnica e të tjerë. Qysh kur punonin ose studionin në Francë, të gjithë këta lidhjet i mbanin kryesisht me Grupin e Korçës dhe një meritë të veçantë për krijimin e këtyre lidhjeve kishte pasur Ali Kelmendi. Pasi u kthyen, ne ramë shpejt në kontakt me ta dhe filluam punën.

Takimet, mbledhjet, komunikimet në «Flora» u shtuan si kurrë më parë. Hynin njerëz nga më të ndryshmit, nacionalistë, patriotë, komunistë, korriere' të Pezës, klientë fare, të zakonshëm që s'kishin asnjë lidhje me ne. Por paqetat e «Florës» nisën «t'u pëlqenin» edhe disa elementëve të dyshimtë, në shërbim të fashistëve. Shokët i bënë sytë katër dhe vigjilenca e rreptë ishte një ndër preokupimet tona kryesore. Na u desh të bënim brenda dyqanit disa «modifikime», disa shtesa.

- Po na vete mire «tregtia», - hapëm fjalë, e tash do të çelim në brendësi edhe një pijetore me tri-katër tavolina.

Nganjëherë, kur ishim më se të signrt, në këtë pjesë të brendshme organizonim ndonjë takim a bisedë me shokë. Por kjo, si të thuash, ishte pjesa e dukshme, legale. Aty më tepër mund të zhvillonim ndonjë taklln me ata tipa nacionalistësh që e quanin trimëri të madhe të flisnin për politikë kafeneve.

Sidoqoftë edhe me ta cluhej të bisedonim, t'i sqaronim, të përpiqeshim t'i afronim me çështjen e luftës së madhe. E kur ndonjë nga këta, ose çdo element tjetër patriot e revolucionar, «i

kalonte» provat e para, afrohej me, ne dhe bindeshim per vendosmërinë e tij, atëherë bisedat me të në pjesën e dukshme evitoheshin. «Flora- i hapte dyert e saj të brendshme të «zemrës». I~y ishte vendtakimi sekret i ilegalëve, si të thuash, «zyra» jonë e pare e ilegalitetit më të thellë. Prapa rafteve me likerna e cigare ishte një vend i gjerë me arka, arka me shishe, arka boshe, të vjetra e të reja. Dhe prapa tyre, më në thellësi kishte arka të tjera. si të hedhura atje nga «pakujesia»; ato ishin arka «të rrezikshme», me materiale per të shtypur trakte, me libra e broshura të Marksit, T,enininit, Stalinit, me arme, bomba e fishekë, me ilaçe, oambuk, me dare e gërshzrë hekuri. Kjo ishte «zahireja» jonë e dimrit të pushtimit.

Përmbi arkat boshe ishte njëfarë ballkoni i brena shëm, diçka si liozhë, që e përdornim gjoja per të shtuar sipërfaqen e depozitimit të rnalirave. Në fund të këtij ballkoni, në qoshen më të errët, para një perde arkash të vje.tra e të prishura, hapej dera e një dhomëze me tavan shumë të ulët. Këtu bëhes'nin mbledhjet më sekrete.

Mblidheshim atje kokë më kokë, raportonim ç'ki shim bërë, përcaktonim ç'duhej bërë më tej, q'masa duheshin marre, ç'forma duheshin ndjekur. I porositja vazhdimisht shokët të ishin të kujdesshëm e të pjekur, të duruar në punën me elementët që binin në kontakt, të vendosur në çështjen që mbronin, konspiratore' të fortë e vigjilentë në kulm.

Kur filluam të zhvillonim në Tiranë një punë të vrullshme e intensive, dhe pashë më mirë se sa të rinj,, të reja, punëtorë dhe studentë mbanin lidhje me grupet e tjera komuniste, i thosha vetes: «Nuk mund të ecet më kështu. Medoemos duhet të gjejmë rrugën e bashkimit të grupeve, të afrohem me ta, të krijojmë Partinë Komuniste». E bisedoja këtë punë me Koço Tashkon, por ai as që e kuptonte këtë problem, kaq të rëndësishëm, nga vare] çështja jetike e vendit tonë.

- Jo, - thoshte Koço Tashkoja, - bashkim me ata nuk bëjmë. Ata duhet të na binden dhe të vijnë te ne, se ne jemi partia, ne kemi lidhje me Kominternin.

- More Koço, - i thosha, - është e vërtetë që ne kemi një vijë të drejtë, por unë shoh se, ata kanë në gjirin e tyre njerëz të mirë. Do t'i lëmë këta të vazhdojnë t'i gënjejnë Zef Mala dhe Anastas Lula me Niko Xoxin e Andrea Zisin? Ne duhet t'u afrohem atyre njerëzve të mirë dhe t'i izolojmë nga krerët e tyre pseudokomunistë.

Kur përmendja fjalën «krerë», Koço Tashkoja ngrinte sytë dhe më shikonte ku e kisha hallin me këtë fjalë. Ai mendonte për vete, por mua akoma nuk më shkonte në mend se çfarë e shqetësonte «kryetarin» tonë.

- Tua marrim njerëit, - thoshte Koçoja, dhe kështu t'i izolojmë nga krerët.

- Koço, - mundohesha ta bindja, - nuk është aq e lehtë kjo punë që thua ti, se edhe ata kanë disiplinën e grupit të tyre.

Po pse, bindej Koçoja!! Por ama edhe mua ai kiuk më bindte dot. Unë kisha edhe mbështetjen e fortë të pilos, të Ivlihas e të shokëve të tjerë. Unë mendoja që me forma miqësore të afroheshim me njerëzit e bazës të grupeve si dhe me disa shokë kryesorë, si me Vasil Shanton e me Qemal Stafën, për të cilët, megjithëse ishim në grupe të ndryshme rivale, kisha një ndjenjë respekti e admirimi, për ars'ye të gjyqit që u bëri regjimi i Zogut atyre dhe disa të tjerëve. Qemali qëndroi si burrë, si hero komunist përpara gjyqtarëve të katilit Zog. Ai mbrojti komunizmin, na mbrojti të gjithëve ne. Kështu i njoha për herë të parë Qemalin dhe Vasilin, pa i njohur akoma personalisht. Nga afër me ta do të njihesha më vonë.

Kur Qemali, Vasili dhe, të tjerë u arratisën nga burgu, më 7 prill 1939, për fat të keq zënkat «parimore» midis grupeve vazhduan. Pasi erdha në Tiranë, Qemalin e shihja shpesh në rrugë, por nuk takoheshim, bile disa herë e kishim parë edhe «shtrembër» njëri-tjetrin.

Ne ishim pjesëtarë të grupeve komuniste të ndryshme, në kundërshtim dhe në luftë me njëri-tjetrin, për arsye që dihen e që i ka përcaktuar qartë Partia dhe historia e saj. Qemali dhe Vasili ishin anëtarë të Grupit të Shkodrës, kurse, lanë bëja pjesë në Grupin e Korçës. Të tre ishim komunistë, por secili prej nesh ndiqte vijën e grupit të tij. Unë i njihja mirë ata qoftë nga pamja, qoftë në qëndrimet e tyre. Po kështu ndodhte edhe me ata vetë, si me shumë nga shokët e, grupeve komuniste të asaj kohe. Ende nuk takoheshim e nuk bisedonim me njëri-tjetrin nga afër, por interesoheshim të dinim kush qenë e si qenë këta «shokë kundërshtarë», cili qe ky apo ai, nga

ç'pikëpamje anonte, kë përkrahte, kë kishte mbështetje, ç'influencë kishte njëri apo tjetri në grupin ku bënte pjesë etj. Në këtë mënyrë, nga informacioni i marrë, si të thuash, nga larg, e ndieja se, veçanërisht, me Qemalin dhe me Vasilin, megjithëse i kishim kundërshtarë, mund të bisedohej. Në këtë kohë, kur tradhtia e Zef Malës kishte dalë sheshit, Vasil Shantoja dhe Qemal Stafa, me aktivitetin e tyre revolucionar, po luanin një rol të rëndësishëm në Grupin e Shkodrës. Për Qemalin kisha dëgjuar se jo vetëm ishte i vendosur në mendimet «komuniste» të grupit. por edhe se ishte një njeri me kulturë të gjerë, me kulturë marksiste dhe, i zoti i gojës e i punës. Mendoja se çdo afrim me ta, sado i vogël, qoftë edhe thjesht një përshëndetje, ishte një hap drejt çështjes së madhe, bashkimit të grupeve, krijimit të Partisë, luftës kundër pushtuesit. Ky mendim më shtynte t'i thosha përsëri Koço Tashkos:

- Koço, po le të piqemi njëherë me këta njerëz se njëri-tjetrin nuk do ta hamë. Në bisedë me ta me siguri që do të grindemi, por ç'do të humbasim? Asgjë, veç në fitofshim.

Mirëpo ky ngulte këmbë:

- Ata janë trockistë, janë armiq, s'kemi punë me ta.

Sidomos pas dështimit të marrëveshjes dhe shpërndarjes së të ashtuquajturit Komitet Qendror të për bashkë.t, mëria e lioço Tashkos Li bë si mëria e Akil kordhëtarit.

- Na tradhtuan, - turfuhonte Koçoja. - na vodhën shokët. na bënë diversion.

E kishte fjalën për daljen hapur të fraksionit të Anastas Lulës e të Sadik Premtes dhe për përpjekjen e këtyre që të tërhiqnin e të bënin për vete nga pozita grupazhi elementë të Grupit të Korçës.

- Lëri Anastasin e Sadik Premten, - i thosha, - ata nuk janë të Grupit të Shkodrës. Bile dhe baza e grupit të tyre po i njeh e do t'i skartojë.

- Njëlloj janë! - këmbëngulte Koçoja. - Të dy grupet kanë lidhur marrëveshje të sëmurë kundër nesh. Nuk na lejohet të afrohemi me ta, s'do të bëjmë më prova.

Koço Tashkoja, që atëherë e njihnim dhe e respektonim si «kryetar» e «të dërguar» nga Kominterni, na vinte përpara «disiplinën profetare» të grupit tonë, kështu që ishte e zorshme ta thyeje. Por, këtë të ashtuquajtur disiplinë proletare e theu Grupi i Shkodrës.

Një të diel, tek po shëtija në një rrugë të Tiranës, një djalë me biçikletë u ndal në krahun tim, zbriti, më dha dorën, e duke më përshëndetur me emër, më tha:

- Jam Vasil Shantoja.

- Të njoh, - iu përgjigja.

- Bëjmë një copë rrugë tok dhe shkëmbejmë disa fjalë? - më propozoi Vasili.

- S'kam kundërshtim. - i thashë. - po ç'keni për të më thënë?

Vasil Shantoja, duke më vështruar me ata sytë e ëmbël ëndërrimtarë, më tha:

- Shoku Enver, kështu do të vazhdojmë ne, té zihemi e të grindemi? Ne, as të takohemi me njëri-tjetrin nuk guxojmë!

Të them të drejtën, në ato momente e shikova Vasil Shanton me ndjenja të përziera: e ndieja se kisha përpara një punëtor, një proletar që po më zgjaste dorën dhe kjo më shtynte të afrohesha pa ngurrar, por, nga ana tjetër, nxirrte kokë edhe mendimi se këta ishin të gabuar në idetë e tyre, ndërsa ne ishim «në vijë të drejtë». Hezitova pak, por, pasi u mendova, vendosa: «Në djall të vejë Koço Tashkoja! - thashë me ve,te. Unë do t'ua shpjegoj shokëve të grupit, Pilos, Ilos e të tjerëve, bile edhe Koços vetë, dhe e di se Piloja me shokë do të më mbështetin». Atëherë i thashë Vasilit:

- Pse jo, takohemi, do të jetë mirë të bise,dojmë.

Vasili u gëzua, qeshi dhe më tha:

- Gëzohem që gjeta mirëkuptim te ti, se Koço Tashkoja s'pranon. Kur do të takohemi dhe ku dëshiron ti? - më pyeti.

- Për mua s'ka rëndësi vendi, - iu përgjigja. Takohemi ku të duash, vetëm ta lëmë mbas disa ditësh, se duhet të bisedoj më parë me shokët.

- E kuptoj, - ra dakord Vasili. - Atëherë takohemi në shtëpinë e dy mësuesve, shokë të mirë, simpatizantë të grupit tonë, Spiro dhe Bojka Lazri i quajnë.

Më tregoi rrugën dhe shtëpinë e tyre, e cila ndodhej afër vendit, ku sot është stacioni i trenit i Tiranës. Caktuam ditën e takimit dhe u ndamë, duke

i shtrënguar dorën njëri-tjetrit. S'kishte ardhur akoma ko-ha e përqafileve.

Në brendësi të dyqanit «Flora» mbloodha shokët dhe u tregova ndodhinë me Vasil Shanton. Të gjithë më dëgjonin me vëmendje, ndërsa Koço Tashkoja, «kryetari», kishte ulur kokën dhe po heshte.

- Të piqemi një herë pse jo? - tha Piloja. Vasili është punëtor, shohim një herë ç'kanë në kokë këta njerëz.

Ndërsa Koço Tashkoja, për të penguar takimin me Vasilin, ngriti çështjen e Zef Malës, renegat dhe tradhtar i të gjithëve, edhe i vetë Grupit të Shkodrës, me të cilin Koçoja identifikonte padrejtësisht të gjithë anëtarët e grupit.

- Po buletinin e tyre, - tha Koçoja, - e harruat?

- Buletinin e, Zef Malës ne e kemi dënuar se është trockist, - iu përgjigja, - dhe nuk e harrojmë, por duhet të jemi të logjikshëm; Qemal Stafa e Vasil Shantoja nuk mund ta duan e ta respektojnë, pale ta konsiderojnë si udhëheqës të tyre një njeri që u dorëzua dhe ua tregoi policisë e, gjyqit gjithë punën e grupit dhe vetë Qemalin e Vasilin. Për ne ka rëndësi vendimtare të shohim a janë këta njerëz për bashkim në rrugën e drejtë komuniste, a janë kundër pushtimit dhe për luftë? Mbi këto baza dhe në këtë rrugë duhet të ecim ne për të gjetur unitetin.

Pa ditur ç'të thoshte më tej për këtë çështje, Koço Tashkoja nxori edhe një arsye tjetër:

- Duhet të marrim edhe pëlqimin e Mihas, tha ai.

Në fakt Miha, i cili banonte dhe drejtonte komunistët në Korçë ishte udhëheqësi i Grupit tonë të Korçës dhe io Koçoja, por ky na imponohej si i tillë, se kishte qenë në Bashkimin Sovjetik dhe kishte ardhur që andej gioia për të na drejtuar. Megjithatë, ne, anëtarët e grupit, donim e respektonim Mihan dhe Pilon, të dy punëtorë të vendosur e me zemër komuniste. Koço Tashkoja dredhonte dhe filozofonte si borgjez intelektual, kurse Miha gjykonte dhe vendoste si proletar e komunist.

- Dëgjo Koço, - i thashë, - unë e njoh Mihan si edhe, ti, Piloja e njej akoma më mirë se ne, dhe jemi të sigurt se, po të ishte këtu, ai do ta pranonte këtë propozim. Miha do të na këshillonte të ruanim parimet tona d'he ne do t'i ruajmë ato. Ai është një komunist i vendosur e i pjekur. Ne e kemi ndjekur atë me besnikëri në luftën kundër gjithë trockistëve, Andrea Zisit, Aristidh Qendros e Dhimitër Fallos, me të cilin ti, - iu drejtova Koços, - nuk mungon të takohesh, të pish ndonjë kafe me të në «Kursal» e të bisedosh me të rusisht.

Koçoja u skuq e u inatos, dhe, kur inatosej, binte në kontradiktë me veten e harronte ç'mbronte pesë minuta më parë'. Gjithë nervozizëm e poza për të treguar rëndësinë e veprimeve të tij, më tha:

- Në qoftë se jam takuar ndonjëherë me Fallon, këtë e kam bërë për të marrë vesh ç'mendonin ai dhe nacionalistë të tjerë.

Atëherë unë, për ta çarmatosur, iu përgjigja zjarr për zjarr:

- Psen mos e ke pyetur ti Mihan për këtë veprim? Kur ti takon Fallon, pse të mos takoj edhe unë në emër të shokëve një furrxhi, Vasil Shanton? Le të shohim një here' ç'do të na thotë dhe ç'mendojnë ai me shokë.

Koçoja shqeu sytë e më shikonte si budalla, gjë që i ndodhte gjithmonë kur e kapje në fjalë.

Duke, u drejtuar nga shokët u thashë:

- Unë jam i sigurt që Miha do të jetë dakord, -se ai vetë ka takuar në emër të grupit tonë Andrea Zisin, Aristidh Qendron dhe Anastas Lulën, bisedoi me ta dhe, kur pa që s'luanin nga e tyrja, i dërrmoi si trockistë. Ne të gjithë ishim me Mihan dhe i kem

demaskuar ata. Kështu do të bëjmë edhe me Vasi Shanton, po të jetë i tillë. Pstë ashtu Pilo, ç'thua ti? - iu drejtova këtij, duke i kërkuar mendimin.

- Jam dakord me tue, - u përgjigj Piloja.

- Fdhe unë jam dakord, - u hodh Ilo Dardha, e pas tij u shprehën dakord edhe të tjerët. Koçoja, deshi s'deshi, u bashkua me mendimin tim.

Që në atë kohë e, kisha vënë re, por më vonë e pashë edhe më mirë, se Koço Tashkoja çdo veprim të rëndësishëm donte ta bënte vetë, për të ruajtur pozitat false të «kryetarit», por ishte njeri i frikshëm: Ai kishte frikë nga diskutimet dhe nga debate. t me «shokët» e grupeve të tjera, të cilat nuk mund t'i përballonte dot me gjakftohtësi, sepse rrëmbehej e nxehej. Dhe nervozizmi i tij shkaktohej edhe nga mendjemadhësia, edhe nga frika.

Këtë gjendje shpirtërore të Koço Tashkos dhe prirjet mikroborgjeze të tij i kam parë personalisht të shprehura në mënyrë shumë konkrete io vetëm në kohën e grupeve dhe të «legalitetit», por edhe pas formimit të Partisë.

Më kujtohet një ditë kur shëtitnim të dy bashkë në bulevard. Anastas Lula, të cilin nuk e njihja për fytyrë, po shëtiste përballë nesh, kur atë çast Koçoja më tha:

- Mos e, lëviz kókën, se njëri nga ata të dy që fio vijnë, ai zeshkani i shëmtuar me syze, është Anastas Lula, po mos e shiko.

Unë ia qepa sytë Anastasit, i cili m'u duk me të vërtetë njeri i ndyrë edhe në të parë. Kur kaluan ata, e pyeta Koçon:

- Po pse më the të mos e shikoja, a nuk duhet e, dhe fizikisht t'i njohim armiqtë?

Koço Tashkoja m'u përgjigj, dhe me plot bindje:

- As me sy nuk duhet t'i shohim ata njerëz. E di ti se ata duan të më vrasin? Kjo do të të ngjasë edhe ty me ta, prandaj, - vazhdoi të më thoshte - «kryetari» i grupit, - unë shkoj shpejt në shtëpi që kur tra akoma popull në rrugë, se këta, po të gjetën vetëm, të futin ndonjë plumb dhe, të shtrijnë përdhë.

- Ç'janë këto që thua, Koço, - i thashë, - pse frikë nga këta do të tremi? Fundi në luftë jemi dhe e kemi bërë hesap mirë, kështu që kokën në rrezik e tremi çdo ditë. Ne duhet të luftojmë për komunizmin dhe për popullin. Po të tremi frikë se do të na vrasin, atëherë duhet të ngremë duart. Por jo, ne jemi komunistë dhe s'kemi frikë nga armiqtë, cilëtdo qofshin.

- Po, po, - pohoi nga zori Koçoja, - ashtu është, por këta kanë vendosur të më vrasin.

- Jo, or Koço, - u përpoqa ta inkurajoja, - hiqe këtë frikë se nuk është mirë.

Në konfidencë, këtë ndodhi ia tregova Pilos dhe ky, siç fliste ndonjëherë kur nxehej, tha:

- Koçoja është një dhjeraman. Jo Koçoja, po të tjerë ishin ata që, siç e di, zbuluan fraksionin e «Të Rinjve» të Anastas Lulës dhe gjithë ato qelbësira ideologjike e imorale që bënin. Shokët tanë u grinë me Nastasin dhe, në qoftë se Nastasi është nga ata burra, duhet të qëllojë mbi ta e jo mbi Koçon e «konkën» e tij të bardhë.

Në ditën e caktuar për t'u takuar me Vasilin unë shkova në shtëpinë e Spiro Lazrit dhe të Bojkës, Këta ishin dy mësues, burrë e, grua, të dy nga Shkodra. Që ditën e parë u bëmë miq, ishin sirnpatikë dhe të sinqertë. Ata rrinin në një dhomë përdhese, por të pastër. Bojka dinte mire' edhe gjuhën serbe.

Erdhi dhe Vasili, u përqaftua me Spiron e me Bojkën, ndërsa ne të dy shtrënguam fort duart.

- Për hajër na qoftë! - i thashë Bojkës. - Në strehën tënde bujare po piqemi, Vasili dhe unë, dy komunistë nga dy grupe të ndryshme, por që jemi grindur e po grindemi për çështje parimore.

- Mali me mal nuk piqen, - themi ne andej, por njerëzit s'ka si të mos piqen e të mos merrert vesh, - shtoi Vasil Shantoja, duke buzëqeshur, dhe më pa me dashuri me ata sytë e bukur, të ëmbël, të kaltër e me pika si flori.

Si komunist e si intelektual kisha lexuar mjaft dhe nga ato që kisha mësuar më erdhi ndër mend një shprehje e një psikologu francez: «Sytë janë pasqyrë e ndjenjave të brendshme». Instinktivisht i thashë vetes: «Enver, Vasil Shantoja është njeri i mirë, ai është proletar, është komunist. S'ka si të jetë ndryshe. Ne themi se këta bëjnë gabime, po ne, vallë, nuk bëjmë? Duhet të gjykojmë njëri-tjetrin dhe secili vetveten».

I rashë me pëllëmbë në gju Vasilit gjithë dashar inire'si dhe, i thashë - Duhet medoemos të merremi vesh.

Bojka, që ishte më zemërçelur, u ngrit në këmbë e gëzuar, na përqafoi përsëri të d'ye dhe iu drejtua burrit të saj - Hajde Spiro, t'u përgatitim nga një kafe miqve dhe, t'u blejmë ndonjë mollë.

Kjo ishte mënyra më e lezetshme nga ana e Bojkës për të na lënë vetëm mua me Vasilin. Sa dolën të zotët e shtëpisë nga dhoma, i thashë Vasilit:

- Vasil, atë ditë kur u takuam, ti rrë shtrove çështjen: «A do të vazhdojmë të ,grindemi, kuratdheu ynë është në rrezik të madh?». Jo, ne nuk duhet të grindemi, por të merremi vesh. Këtë, natyrisht, nuk e kemi të lehtë, se ka plot gjëra që na ndajnë. Ka njerëz brenda dhe jashtë radhëve tona që nuk e duan bashkimin e grupeve komuniste dhe shkrirjen e tyre në një parti të vetme komuniste, ka antimarksistë që hiqen si komunistë, ka ambiciozë e intrigantë që shpifin për njërin e për tjetrin grup, ka edhe pikëpamje të gabuara dhe këto janë më të rrezikshmet. Ne e dimë se këto vëshirësi që janë grumbulluar dhe që e pengojnë bashkimin tonë, nuk zhduken në një ditë.

- Jani dakord me çka po thua ti, Enver, - më tha Vasil Sharifolà. - Do të na duhet ca kohë t'i sqarojmë këto, por më vullnet duhet ta bëjmë.

- Shoku Vasil, - i thashë, - jemi të gjithë bij të Shqipërisë, a do të luftojmë për atdheun dhe për popullin tonë të shumëvujturë t'i çlirojmë nga zgjedha?

- Patjetër duhet të luftojmë, Enver, edhe, sikur jetën të japim, - m'u përgjigj me vendosmëri Vasili.

I mora dorën, ia shtrëngova fort dhe i thashë:

- Shoku Vasil, pika jetike, akordi bazë për të vendosur është ky. Çështja tjetër që dua të diskutoj me ty është kjo: Do të luftojmë si komunistë për çlirimin e popullit dhe të atdheut apo si çfarëdo «nacionalist»?

- Sigurisht, si komunistë, - u përgjigj Vasili.

- Atëherë, - shtova unë, - ne duhet të bashkohemi, se komunistët nuk mund të luftojnë të përçarë. Duhet të luftojmë të formojmë edhe ne Partinë tonë Komuniste. Në këto kushte kur ne e quajmë Grupin tonë të Korçës «parti», ju të Shkodrës, thoni «jemi ne partia», nga ana tjetër Andrea Zisi deklaroi se

«vulën e Kominternit» e ka ai etj., nuk mund të arrijmë asgjë. Të gjitha këto pretendime shoqërohen me ide e me pikëpamje të ndryshme. Ka prej tyre që janë të drejta, por ka edhe të gabuara, false e troackiste si ato të Zisit, Anastasit, Aristidhit e, pse të mos e them, edhe të Zef Malës, që ne e, dënojmë. Pikërisht këto

janë poplat që janë grumbulluar Vasil, - i thashë. Këto duhet t'i spastrojmë dhe të hapim rrugën tonë të drejtë. Këtë gjë nuk e bëjmë dot që sot, as vetëm

ne të dy, por të biem dakord që të përgatitemi, edhe ju edhe ne, dhe, të ecim me vendosmëri drejt gjetjes së momentit më të përshtatshëm për t'u ballafaquar e për të bërë një punë konstruktive historike. Je dakord në parim, shoku Vasil? Unë mendoj që edhe për këtë afrim duhet t'i pyesim patjetër edhe shokët që na kanë dërguar.

- Jam plotësisht dakord, - u përgjigj Vasil Shantoja. - Meqë zure, në gojë Zef Malën, po të them s'jam dakord me ty, ai është një renegat që na tradhtoi.

Por dhe një gjë duhet të na kuptosh, shoku Enver, shtoi ai. - Unë e një pjesë e mirë e shokëve e njohim dhe e dënojmë Zef Malën, por ka dhe nga ata që akoma kanë iluzione, për të. Ka bile ndonjë që e quan konfuzin antimarksist Zef Mala si «teoricien të madh». Ne për Zef Malën po i sqarojmë shokët me durim, se s'duam t'i humbasim.

- Shumë drejt e ke, shoku Vasil, - i thashë. Kjo është detyra juaj, por dhe jona, e të gjithë komunistëve të ndershëm. Ne duhet të qartësojmë e të llogarisim çdo mendje, sepse luftën që kemi përpara s'do ta bëjmë vetëm ne komunistët, por gjithë bijtë e ndershëm e revolucionarë të vendit.

- Këtë kërkojmë edhe ne, për këtë do të luftojmë, - tha Vasili.

- Vasil, - iu drejtova, - edhe një gjë dua të shtroj me t'y. Ne do të takohemi prapë, do të bisedojmë dhe do të vendosim, por çështja qëndron këtu: nuk mund të parashikojmë që tani se kur do ta spastrojmë krejt rrugën dhe do t'ia arrijmë asaj dite të lumtur e historike, krijimit të Partisë sonë, por gjatë kësaj kohe propozoj që t'u parashikojmë grupeve tona mendimin për të gjetur rrugë e forma të tilla bashkëpunimi që do të na ndihmojnë për veprime të përbashkëta kundër armikut. Ne jemi për aksione.

- Edhe ne jemi për aksion, - theksoi Vasili, prandaj e pëlqej mendimin tënd. Unë personalisht jam dakord, por duhet t'ua parashikoj shokëve, siç do të bësh edhe ti.

Mirëkuptimi me Vasilin në të gjitha çështjet bazë që shtruan, më mbushi me gëzim dhe me optimizëm të madh.

- Vasil, më duket se bëmë një hap e punë para-prake të mirë, - i thashë, dhe për herë të parë u për-qafuam fort si shokë.

- Të them të drejtën, - më tha Vasili, - kam pasur simpati për Miha Lakon, për Pilo Peristerin dhe për ty. Kurse Koçon, - vazhdoi duke qeshur, - nuk e shihja dot, kur më dilte bulevardit me atë konen që e mbante prej zinxhiri.

Erdhi Bojka me burrin, na sollën kafënë dhe frutat. Ajo hapi perdet e bardha të dy dritareve dhe, tha:

- Shihni, u kthjellua qielli!

U ndava me Vasilin dhe i premtova se do të shkoja. ta takoja në furrën ku punonte, e cila ishte në rrugën. që sot mban emrin «Konferenca e, Pezës», përkrah ish-radiostacionit të vogël të dikurshëm. Natyrisht u mblodhëm me shokët e grupit tonë dhe u raportova për bisedën që pata me Vasil Shanton, duke e treguar haptazi përshtypjen time të mirë në përgjithësi.

- Ohu, - tha Koço Tashkoja, - ç'lakra kanë ata, në kokë, as lumi nuk ua lan; ta dish ti ç'është Anastas Qorri e si vepron ai, atëherë do të bindesh se, ç'njenëz janë ata.

- Nuk fola dhe nuk dhashë gjykim për Anastas Lulën, - iu drejtova Koços, - unë fola për Vasil Shanton dhe nuk jam i mendimit t'i futim të gjithë në një thes.

- Po ata në një thes janë futur veM, - shtoi Koço Tashkoja, - ata Tanë të bashkuar.

- Mund të jenë të bashkuar në mjaft gjëra, i thashë Koços, - por i kemi shtyrë edhe ne në këtë drejtim.

Shokët e, tjerë, né përgjithësi, ishin dakord që të mnerreshim vesh dhe vendosëm ta thellonim më tej këtë problem, të reflektonim, të merrnim masat e të gjenim mënyrat e afrimit, të bisedonim edhe me. Mihan „dhe me shokët e tjerë të Korçës; të përpiqeshim, me një fjalë, të ndanim shapin nga sheqeri, të klasifikonim njerezit që kishim përballë, për të veçuar ata, me të cilët duhej të qëronim hesapet; të klasifikonim edhe të kishim né evidencë të gjitha kritikët që duhej fu bënim ne grupeve të tjera komuniste, të bënim .dhe autokritikë për gabimet tona, të qëndronim né .çështjet parimore dhe të linim mënjane morinë e madhe, të thashethemeve, të denigrimeve, të shpifjeve e të çdo gjëje tjetër të këtij lloji që ishin grumbulluar né atë kohë.

Të gjithë shokët, edhe Koçoja, ishin dakord me këtë përgatitje. Vendosëm gjithashtu që tash e tutje të ishim të rezervuar né sulmet, sidomos kundër Grupit të Shkodrës.

Lidhjet me Vasilin vazhdova t'i mbaj e t'i shtoj. Një ditë, ndërsa po bisedonim, i thashë se dëshiroja të takohesha edhe me Qemal Stafën, për të cilin, siç kam shkruar edhe fë lart, kisha krijuar një mendim ,të mirë, pavarësisht se nuk e kisha njohur nga afër.

- Do të jetë një gjë shumë e mirë, - më tha Vasili. - Edhe Qemali të njeh ty, nga larg, e më ka .shprehur të njëjtën dëshirë.

E lamë të ta'koheshim te furra e Vasilit.

Ditën e caktuar, kur hyra né furrë, pashë se afër derës sé saj, buzë shtratit, né një stol, ishte ulur Qemali. Vasili rrinte né këmbë me llërë përveshur dhe, me të më parë mua, më doli përpara e më çoi te Qemali, i cili u ngrit dhe i dhamë dorën njëri-tjetrit. - Jam i gëzuar që po njihemi nga afër, - i tha shë, - dhe këtë ia di për të mirë Vasilit.

- Edhe unë, - tha Qemali me zë të qetë, jam i gëzuar, sido që po grindemi me vite.

- Më duket se me vullnet të mirë, - iu përgjigja, - kjo gjendje duhet të sqarohet për interesin e popullit dhe të atdheut që po vuan nën zgjedhë.

Qemali dhe unë ishim ulur né dy stola të vegjëi, përballë njëri-tjetrit, ndërsa Vasili që rrinte né këmbë, veshët i kishte né bisedën tonë, kurse sytë i mbante nga dera e nga dritarja për të vëzhguar lëvizjet e armikut.

Qemali më bëri një përshtypje shumë të mirë. Ai ishte i paktë nga trupi, kishte një f'ytirë simpatike, dy sy të thellë, që, duke folur, herë mexrnin pamje serioze dhe here' të gëzueshme. Ai mbante syze. I pari e mora fjalën unë dhe, me ton shoqëror, i shpjegova çka i kisha thënë Vasilit né shtëpinë e

Spiro e. Bojka Lazrit, qka kishim vendosur dhe si do të vepronim këtej e tutje. Qemali, me ata sy të zgjuar e të ëmbël prapa xhamave të syzeve, më dëgjonte me kujdes e me dashamirësi. Ai m'u përgjigj, duke shtjelluar pikë pamjet e grupit të tij për një varg qështjesh që shtrova unë. Në përgjithësi ai ishte dakord me problemet principiale siç qenë ato të domosdoshmërisë së formimit të Partisë, të përpjekjeve të përbashkëta që duhet të bënim për të çelur rrugën drejt bashkimit, të gjallërimit e të forcimit të propagandës antifashiste në popull etj.

Formova mendimin se ishte një shok i zgjuar e me kulturë, ashtu siç më kishin thënë. Më pas u takova edhe herë të tjera me të, por «mali» i mërive e i mosmarrëveshjeve të vjetra e të reja midis grupeve tona ishte akoma i madh. Krahas eliminimit të një sërë pengesash, lindnin edhe pengesa e vështirësi të reja, kështu që s'duhet menduar se që në takimin tonë të parë u gjet përfundimisht fjala e përbashkët Sidoqoftë këto takime ishin hapa të drejtë e të sigurt drejt sheshimit të mosmarrëveshjeve. I rëndë sishëm ishte, gjithashtu, fakti që me Qemalin, ashtu si edhe me Vasilin, që në takimet e para unë persona s'ishte thuajse nuk kisha asnjë mosmarrëveshje të rëndësishme; mendimet e dëshirat tona përputheshin. Por çështja për të cilën luftonim nuk varej vetëm nga ne; ne qemë akoma anëtarë të grupeve dhe akoma jo luftëtarë të një partie të vetme.

Me Vasilin qysh më parë kisha biseduar edhe për çështjen e madhe të luftës çlirimtare, - Puna jonë, - i kisha thënë, - kështu si po e zhvillojmë nuk mund të ketë efekt. Çfarë po bëjmë ne? Ne po zihemi me njëri-tjetrin, në vend që të grrijmë armikun në mënyrë të organizuar.

Vasili në përgjithësi, ishte i po këtij mendimi, por kurdoherë thoshte:

- Kemi pengesa, edhe nga ana juaj, edhe nga ana jonë. Po të takohemi si grupe, këtu do të vijmë me paramendime që më shumë të mos merremi vesh se sa të merremi. Gjithsecili mendon të rmbrojë grupin dhe pikëpamjet e tij.

- Mirë, Vasil, - i thosha, - po ja, kur ne të dy, po takohemi, po bisedojmë si shokë e komunistë, po e kuptojmë kaq mirë njëri-tjetrin, atëherë pse të mos bisedojmë edhe si grup?

- Mirë, mirë, - thoshte Vasili, - ashtu është, por duhet të njohim si ju, edhe ne se në grupet tona tra njerëz që nuk binden, që duan t'u dalë e tyrja, prandaj mendoj se duhet të punojmë akoma në këtë drejtim.

Proletari Vasil Shanto kishte të drejtë në këto çështje. Duhej punuar, duhej përgatitur opinioni, se në një konferencë aq serioze, aq të rëndësishme si ajo që mendonim ne për krijimin e Partisë Komuniste. Nuk mund të vihej me pikëpamjet «unë jam parti, ju s'jeni gjë, jeni trockistë; ne e tremi vijën të drejtë, ju të shtrembër; ne luftojmë, ju nuk luftoni». Kjo mënyrë e shtruarjes së çështjes, për mendimin tim, tra qenë e gabuar dhe nuk mund të na çonte kurrë në unitet.

Vasili ishte një revolucionar jo vetëm me mendje të mprehtë e gjykim të shëndoshë, por dhe njeri i aksionit. Miqësia ime. me të lindi në luftë e u rrit në zjarrin e luftës, në përpjekjet e përbashkëta për krijimin e Partisë e më pas për organizimin e forcimit e saj e të Luftës Nacionalçlirimtare që udhëhoqi me nder Partia Komuniste e Shqipërisë.

Kurrë nuk do t'i harroj ato net të errëta të nën torit 1940 kur, bashkë me Vasil Shanton, ngjitnim nëpër mure parulla me thirrjet: «Poshtë fashizmi italian!», «Rroftë populli vëlla grek që lufton për Tiri!». Ishte koha kur Italia fashiste, në vazhdim të po litikës së vet aneksioniste, shpërtheu agresionin kundër popullit vëlla grek. Ne e dënuam menjëherë këtë agresion të ri, shkruam e ghpërndamë në Tiranë, në Korçë e gjetkë një sërë traktesh ku, përveç demaskimit të politikës fashiste, i bënim thirrje popullit tonë që ta sabotonte me ç'të mundej këtë luftë e, sidomos, të sabotonte përpjekjet e fashistëve për të çuar në front si mish për top ushtarë shqiptarë.

Ndodhi ajo që do të ndodhte patjetër: populli shqiptar jo vetëm e priti me indinjatë e urrejtje të pakufishme agresionin e ri të fashistëve kundër popullit grek, por dhe ata pak ushtarë shqiptarë që u çuan nën forcën e bajonetave në front, nuk zbrazën asnjë pushkë kundër vëllezërve grekë, përkundrazi ose ua kthyen pushkët agresorëve, fashistë, ose dezertuan në masë. Por kjo është tjetër histori, le të kthehemi te lufta jonë.

Nuk duhet menduar se lidhja dhe mire'kuptimi im i plotë me Vasil Shanton, e më pas edhe me militantin tje, tër komunist, Qemal Stafën, zgjidhi gjithçka e menjëherë, siç kam thënë më lart, nga «mali» i mërive, i grindjeve e i mosmarrëveshjeve midis grupeve komuniste të asaj kohe. Jo, sepse

edhe siç e kishim parashikuar në takimet e para me Vasilin, përpjekjet do të qenë të mëdha e të vazhdueshme, por edhe pengesat e vështirësitë të tilla qenë.

Fjalën e duhur e të përbashkët s'po e gjenim ende jo vetëm midis grupeve, por shpesh edhe brendapërbrenda secilit grup. Ndodhte kjo edhe në Grupin Komunist të Korçës. Edhe te ne jo çdo gjë shkonte kurdoherë në harmoni të plotë, jo të gjitha «burgjitë» punonin në akord. Si përherë një pengesë e madhe po na bëhej megalomania e Koço Tashkos. Njëherë shkrova një trakt, brendia e fortë e të cilit, për mendimin tim, i përshtatej më së miri situatës së avancuar që jetonte vendi. Ua lexova shokëve dhe që të gjithë e pëlqyen e thanë ta shtypnim e ta shpërndanim.

- T'ia lexojmë edhe Koços, - u thashë. - Të dëgjojmë edhe mendimin e tij.

Në këtë periudhë Koçoja i kishte rralluar shumë ardhjet në «Flora», për të mos thënë i kishte ndërprerë fare. Çështje «konspiracioni»! Mendonte se koka e tij do të binte, më shpejt në sy po të hynte në «Florën» e rrezikshme, sesa kokat tona që natë e ditë ndodheshin aty.

Lamë takim në një bazë dhe ua lexova. Ishin me mua Piloja, Ilo Dardha e më duket se edhe Kristo Mushi.

- S'ka si qepet më mire', - tha Piloja, sapo e dëgjoji për të dytën herë. - Ta shtypim shpejt e ta shpërndajmë.

Edhe shokët e tjerë për këtë këmbëngulën.

Koço Tashkoja, duke ecur rëndë-rëndë nëpër dhomë, u ndal e tha:

- Kam ca vërejtje.

- Urdhëro, - i thashë.

- Po ja, është ca i gjatë, kurse traktet për vetë natyrën e tyre karakterizohen. . ., - e nisi të na bënte shkollën e shkruarjes së trakteve ai që thujse asnjëherë s'kishte marrë mundimin, pale guximin, të shkruante as pesë radhë.

- Dakord në parim, - i thashë, - por na thuaj konkretisht çfarë duhet shkurtuar?

- Po ja, sikur ta heqim këtë pjesën këtu. Është dhe ca e parakohshme nga ana taktike, nuk i përgjigjet situatës objektive...

- Po ç'na thënke ti, o shoku Koço, - iu hodh Filoja. - Ti dashke t'i heqësh barutin! Si ta heqim atë!

U mundova edhe unë ta sqaroja, po Koçoja vazhonte në të tijën: «Jo kjo pjesë kështu, jo ajo ashtu», «jo kjo e fortë, jo ajo e parakohshme», shkurt, deshi ta katandiste traktin në një fletë mirësjelljeje. Bëra edhe një përpjekje tjetër ta bindja, ndërhyne edhe dloja me Kriston, por Koçoja këmbënguli:

- Nuk jam dakord!

Më hipën dhe mua nervat, më kishte ardhur në majë të hundës dhe i thashë me zë të lartë:

- S'je dakord ti, po jemi ne dakord, Koço Tashko ! - dhe instinktivisht përplasa grushtin mbi tavolinë.

Koçoja mbeti me gojë hapur në mes të dhomës, na pa, mori kapelen dhe iku.

Sidoqoftë ne e vazhduam me këmbëngulje punën e nisur dhe veprimtaria e grupit po zgjerohej e po gjallërohej pa ndërprerje. Tash qendra e Grupit Komunist «Puna» të Korçës ishte transferuar në Tiranë dhe lidhjet i kishim shtrirë e i kishim zgjeruar në qytete e në zona të tjera të vendit. «Flora» ishte kthyer në një qendër kontaktesh e lidhjesh të gjithanshme me bazat ilegale të Tiranës e të rretheve. Hov të madh po merrte veprimtaria antifashiste e të gjitha grupeve komuniste, demonstratat, sabotimet, goditja e ndonjë zyre ose objekti etj. Shqipëria e vogël, që kurrë s'kishte duruar sundimin e askujt, po bëhej një tokë e dridhshme nën këmbët e pushtuesve e të tradhtarëve. E, nëse aksionet e Çetës së Pezës, në pranverën e 1941, shënonin fillimin e veprimeve të organizuara kundër pushtuesve, në maj të po atij viti urretjtja e popullit shqiptar ndaj fashizmit do të shpërthente me një akt tjetër të shënuar: I riu Vasil Laçi qëllon me armë perandorin e Italisë, Viktor Emanuelin, mu në mes të Tiranës. Plumbat e Vasil Laçit mbi perandorin fashist kishin për ne komunistët një domethënie të madhe.

Me to populli shqiptar u thoshte pushtuesve:

- Ne nuk ju durojmë në vatrat tona. Ardhja juaj u prit e do të pritët me plumb. Kjo ka qenë gjuha e të parëve tanë me armiqtë, kjo do të jetë dhe gjuha e brezave tanë, të sotëm e të ardhshëm.

Situata revolucionare ishte pjekur, populli ishte i gatshëm për luftë. Nëpër male ku grupe-grupe, ku veç e veç kishin dalë e po dilnin me armë në dorë luftëtarët e lirisë. G jithcka priste si një domosdoshmëri sine qua non forcën e vet udhëheqëse, Partinë Komuniste të Shqipërisë. Drejt krijimit të saj ne tani po ecnim më me siguri.

Drejt bashkimit historik

Në momentet kur ne kishim intensifikuar më tepër se kurrë përpjekjet e po shkonim drejt gjetjes së fjalës së përbashkët për afrimin përfundimtar midis grupeve, një ngjarje e rëndësishme, ashtu si në krejt gjendjen politike ndërkombëtare, do të ushtronte ndikimin e vet revolucionarizues edhe në lëvizjen komuniste e antifashiste në Shqipëri: më 22 qershor 1941 hordhitë hitleriane shpërthyen sulmin e pabesë kundër Bashkimit Sovjetik.

Sulmi hitlerian kundër Bashkimit Sovjetik ishte një tronditje e madhe për të gjitha grupet dhe për të gjithë komunistët shqiptarë. Që përpara se të ndodhte ky sulm, neve na ishte dashur të zhvillonim një luftë të ashpër kundër propagandës fashiste dhe të pseudodemokratëve që, duke keqinterpretuar Paktin e mosulmimit midis Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë, shpifnin se Bashkimi Sovjetik «lidhi aleancë me Gjermaninë hitleriane», se «komunistët shqiptarë nuk duhet të luftojnë okupatorin fashist, sepse Italia është aleate e Gjermanisë hitleriane, me të cilën lidhi Pakt mosulmimi Bashkimi Sovjetik».

Neve, komunistëve, na binte detyra të luftonim propagandën fashiste dhe njëkohësisht të sqaronim të gjithë njerëzit dhe jo vetëm të afërmit tanë, sepse kishte edhe shokë të grupeve që nuk i kuptonin dot arsyet e lidhjes së Paktit të mosulmimit në mes Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë hitleriane.

Sulmi barbar hitlerian kundër Bashkimit Sovjetik jo vetëm na tronditi, por tregoi qartë se kishim të drejtë ne dhe jo armiqtë, se Stalini nuk e kishte tradhtuar kurrë komunizmin dhe Bashkimin Sovjetik. Me hyrjen e Bashkimit Sovjetik në luftë u forcuan shpresa e madhe dhe besimi në fitoren tonë. Lufta e popullit shqiptar kundër fashizmit tani do të kishte edhe një mbështetje të madhe: luftën e popujve sovjetikë, të udhëhequr nga Stalini, kundër nazizmit gjerman. Tash komunistët shqiptarë dhe populli ynë, që nuk kishin ndenjur me duar lidhur, do ta rritnin më shumë luftën e tyre, që kjo të ziente anembanë vendit. Të gjithë duhej të luftonim okupatorët dhe kuislingët.

Komunistët, grupet duhej të linin përfundimisht mënjatë grindjet dhe mëritë.

Menjëherë, sapo dëgjova lajmin e sulmit të pabesë të hitlerianëve kundër Bashkimit Sovjetik, renda për në shtëpinë e Mihal Durit. Atje veç Mihalit gjeta edhe Miston e nja d'y shokë të tjerë. Më rrethuan menjëherë e nisën të më pyesnin. U fola shkurt për ç'kisha mundur të mësoja mbi agresionin e pastaj u thashë:

- Shokë, nuk është koha për bisedime të gjata. Duhet të shtojmë aksionet, të njoftojmë popullin për të vërtetën mbi agresionin nazist, t'i themi se tanfi në luftën tonë për çlirim s'jemi më vetëm, t'i bëjmë thirrje për t'u ngritur në luftën e madhe.

Ata dëgjonin të përqendruar e të gatshëm për të kryer çdo veprim.

- Gjëja e parë, - u thashë, - duhet të shkruajmë e të shpërndajmë sa më shpejt një trakt. E keni gati «shtypshkronjën»? - iu drejtova mandej Mihalit e Mistos.

- Gati është! - m'u përgjigjën ata.

Kishim vërtet një «shtypshkronjë» në atë kohë, të cilën e ruanim dhe kujdeseshim për të si për një krijesë të rrallë. Në kujtimet e mia edhe ajo, Bado e thjeshtë e primitive që qe, zë një vend të nderuar vendin e armës së luftës.

Nevojën për të na e diktoi vetë puna që bënim. Përditë e më tepër ne duhej të zhvillonim një propagandë më të madhe. Por s'kishim as libra, as broshura. Nga frëngjishtja përktheja disa copa të shkëputura nga veprat e Stalinit që bënin fjalë për Partinë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik dhe për Ushtrinë e Kuqe, por edhe këto mezi i gjeni:n Edhe kur i hidhnim në dorë, nuk

kishim mundësi t'i jepnim për daktilografim. Unë vetë dija të shtypja dhe m'u bë zakon që, edhe shumë vjet pas Çlirimit, çdo fjalim ose artikull timin e shkruaja në një rnakinë «Olivetti».

Një ditë i them Misto Mames:

- Nuk ia dal dot kështu, na duhet të organizojmë një shtypshkronjë, le të jetë primitive tani në fillim. Unë mendoj që ti, si zdrukthëtar, të na rregullosh njëfarë «tryeze», kurse Mihali të na sjellë nga tipografia ku punon germat e çfarë duhet tjetër dhe të shtypim materiale në një numër më të madh, se nevojat janë rritur. Prandaj, - e porosita Miston, - hajde sonte me Mihalin në filan shtëpi që të bisedojmë.

Mistoja, me t'i thënë unë këto fjalë, si ngahera, u hodh përperjetë nga gëzimi dhe u largua si shigjetë. Në mbrëmje ai me Mihalin mbërritën në shtëpinë ku u kisha thënë. Ajo ndodhej jo shumë larg nga shtëpia ku më vonë formuam Partinë. Ishte një shtëpi përdhese me dy dhoma të vogla, me një kopsht të rrethuar me mure. Nga jashtë nuk të shihte kush. Mistoja e Mihali ishin nga ata shokë që s'donin të humbitnin kohë. Mistoja kishte në duar një tryezë, kurse Mihali i kishte mbushur xhepat plot me hekura e me shkronja. I vunë në mes të dhomës dhe Mihali më pyeti:

- ('do të bëjmë tash?

- Ju e dini; unë di vetëm të shkruaj, kurse ju t'i radhitni e të shtypni, - u thashë edhe si me shaka, por edhe për t'u ngacmuar mendimin. Rrinim e pa mendoheshim. Mistoja propozonte t'i vinim parvaze tryezes në një lartësi të caktuar. Ilihal i llogariste shkronjat që duheshin.

- Për ç'madhësi duhen? - pyeti ai.

- Si të jetë, - i thashë, - por të fillojmë nga rakti, afër njëzet radhë.

Ilihal u mendua, pastaj u ngrit:

- Duhet shkronja të tjera. Nesër në këtë orë jemi këtu.

- Përgatit traktin, - tha Mistoja, - se do të marrim dhe «Balilën» (pseudonimi i Qiriako Deçkës), që të na ndihmojë.

- Mirë, - u thashë shokëve, - do të punoj natën, se nesër më duhet të jem në dyqan, mbasi Piloja ka shkuar për punë gjetiu.

Dhe u ndamë. Kur shkruaja traktin, mendoja plot gëzim e me naivitet: «Sa gjëra do të bëjmë me këtë «shtypshkronjë» që po përgatitim!».

Por puna na doli e zorshme. Shkronja duheshin shumë, ato lëviznin kur i vinim, duhej t'i lidhnim, t'i mbushnim boshllëqet ose me hekura, ose me dërrasa, në mënyrë që radhitja të qëndronte si në një nngene. Na u desh të punonim tri net me radhë dhe pastaj mezi filluam ta shtypnim traktin e shkruar. Vinim bojën në furçë, ngjitnim letrën dhe Mihali shkante mbi të rulenë prej dërrase që e kishte «fabrikuar» Mistoja. Dolën traktet e para. I entuziazmuar fillova të këndoja me zë të ulët Internacionalen. Më pasuan edhe shokët, kënduam kështu që të katër me ngadalë, se mos dëgjoheshim jashtë. Bëmë disa qindra rakte të firmosur në fund: Partia Komuniste e Shqipërisë.

Kjo ishte «shkrepja» e parë e armës sonë të dashur të shtypit. Dhe ja, fare pak ditë pas kësaj, ne duhej të shtypnim në të traktin e ri, atë mbi agresionin hitlerian kundër Bashkimit Sovjetik. E shkrova traktin me një frymë dhe po me aq shpejtësi dolën ekzemplarët e parë nga rrëshqitja mbi germa e rulesë prej druri.

Pasi mbaruam së shtypuri, tek po pinim cigaren e «triumfit», Mihali tha:

- S'qenka gjë kjo punë.

Unë hapa sytë dhe e pyeta:

- Si, o Mihal, s'qenka gjë kjo punë?

- Ne, - m'u përgjigj ai, - duhet t'i japim të kuptojë armikut se jemi të fortë.

- Po ç'të bëjmë? - i thashë.

- Ja se si: çdo trakt, dhe jo të shkurtuar, do ta shtyp në shtypshkronjë.

- Po a mundet? - e pyeta.

Mihali m'u përgjigj

- Ka kala që nuk e marrin komunistët?!

Shumë shpejt edhe kjo «kala» u mor. Mihali e shokët e tij tipografë, anëtarë ose simpatizantë të grupeve komuniste, arritën që mu në shtypshkronjat e fashizmit, të shtypnin një sërë traktesh ku ne

bënim thirrje për luftë kundër fashizmit. Veçanërisht pas themelimit të Partisë kjo iniciativë e Mihal Durit u përsërit shpesh nga tipografët tanë revolucionarë.

Por puna nuk mbaroi me kaq. Më vonë Mihali, Mistoja e disa shokë të tjerë sulmuan natën një shtyp shkronjë, i rrëmbyen materialet e saj, pa bujë, pa çak e pa bamb dhe i vendosëm në vendin ilegal që kishim gjetur. Kështu filloi veprimtaria e shtypit ilegal. Ai më vonë u pasurua me ciklostilë e me makina të tjera, që ia rrëmbyem armikut.

Por të kthehemi në qershor 1941. Pas shpërndarjes së traktit tonë për hyrjen e Bashkimit Sovjetik në luftë, ku i bënim thirrje popullit tonë të ngrihej në këmbë kundër pushtuesit fashist, na ra në duar një trakt tjetër. Edhe ky kishte një përmbajtje të përafërt me atë të traktit që kishim shpërndarë ne, por nuk ishte «yni». E lexova me një frymë dhe, pavarësisht se kishin përdorur dhe ndonjë parullë të papërshtatshme për kohën e kushtet e luftës që kishim përpara, u thashë shokëve gj'ithë gëzim

- U shemb edhe një nga barrierat që pengonte bashkimin. Shokët e Shkodrës janë për luftën, janë të një mendimi me ne.

Menjëherë dola dhe, pasi kalova në disa baza që i njihja, e gjeta Vasilin. Tani në takimet me të kishin lindur vështirësi të reja. Por këtë herë këto s'qenë si vështirësitë e mëparshme për çështje grindjesh e mosmarrëveshjesh midis grupeve, por për faktin se Vasili ishte detyruar të hidhej në ilegalitet. Veprimtaria e tij kishte rënë shumë në sy të fashistëve, atë e gjurmonin ngado spiunët. Por këtë vështirësi të re ai do ta përballonte dhe e përballoi me sukses. Vasil Shantoja u bë një ilegal i regjur, ishte mjeshtër i madh i maskimit, ai mund të të dilte përpara e ti të mos e njihje fare, nëse vetë s'donte të të jepte të njohur. Takoheshim me të në baza ilegale të Grupit të Shkodrës ose të Grupit të Korçës, bisedonim e shkëmbenim mendime se ç'duhej bërë për një afrim më të madh e më të shpejtë midis grupeve. Pra, e gjeta Vasilin, u përqaftuam gjithë mall dhe i folëm njëri-tjetrit për ngjarjet e fundit. Kishim rreth një muaj e ca që s'qemë takuar.

- Erdhi koha e shumëpritur, Vasil! - i thashë. Tani s'duhet të na ndajë e të na pengojë më fryma e vjetër. Asgjë nuk i justifikon më pritjet e hezitimet. Populli kërkon të luftojë, ai kërkon udhëheqjen. Historia nuk do të na e fali përsëritjen e gabimeve të vjetra.

- Ke të drejtë, Enver, - m'u drejtua Vasili. Edhe grupi ~në kështu mendon. Më duket se tashmë kushtet janë pjekur sa s'bëhet më e, si hap të parë, të realizojmë ashtu siç duhet atë bashkëpunim e koordinim të veprimeve për të cilin kemi folur bashkë dhe tjetër herë.

- Ne jemi gati menjëherë, - i thashë.

- Edhe ne jemi gati.

- Patjetër do t'ia arrijmë qëllimit, - më tha ai me vendosmëri.

Gjatë gjithë kësaj kohe Grupi ynë i Korçës vazhdonte punën intensive për shtimin e radhëve dhe për edukimin marksist të anëtarëve. Unë vazhdoja të hartoja trakte të shkurtra kundër armikut pushtues, të cilat i shtypja në makinë shkrimi ose në «shtypshkronjën» tonë dhe i firmosnim : «PKSH». Kishim gjetur një monedhë të vogël sovjetike, ku figuronte një drapër e një çekan dhe me të vulosnim traktet në fund, të cilat pastaj natën i shpërndanim: Piloja, Mihali, Mistoja, Ilo Dardha, unë e shokë të tjerë, punëtorë e të rinj.

Një herë vendosëm që natën të shkruanim nëpër mure parulla kundër fashizmit pushtues. Po me se t'i shkruanim? Xhevdet Doda (Fëshja), shoku ynë i mirë, të cilin më vonë e vranë gjermanët në kampet e vdekjes, na propozoi:

- Me bojë këpuce të zezë, bre shokë!

- Ide gjeniale! - thamë, dhe të gjithë qeshëm me këtë zgjidhje praktike.

Të nesërmen filluam të blenim andej-këtej, që të mos binte në sy, kuti me bojë të zezë për këpuce dhe furça nga ato që lyejnë muret. Hartuam parulla të ndryshme, të shkurtra dhe natën, në një orë të caktuar, dolëm nga «istikamet», pse vërtet të tilla u bënë për ne shtëpitë e vogla me qerpiç të Tiranës në ditët më të errëta të reaksionit, dhe me nga dy-tri kuti boje në xhep filluam aksionin. Në mëngjes disa mure të rrugëve të Tiranës u gdhinë «të qendisura». Policia dha alarmin për t'i fshirë e për të kapur ata që i kishin shkruar.

Grupi i Shkodrës u nxit nga kjo veprimtari jona dhe një më ngjes u dukën përsëri parulla nëpër mure. Ne e dinim që nuk ishin tonat e se nuk kishte kush t'i bënte përveç anëtarëve të Grupit të Shkodrës. Unë gëzohesha.

Disa ditë pas kësaj u takova me Qemalin e Vasilin në një bazë ku strehohej ky i fundit. E përqafova Qemalin me mall e dashuri. M'u duk se qe rritur e burrëruar më shumë, sido që nuk ishte më tepër se 20-21 vjeç.

- Filloi bashkëpunimi pa u marrë akoma vesh, u thashë për të çelur bisedën.

- Filloi, - ma kthyen ata, - dhe duhet ta vazh dojmë.

- Ta vazhdojmë, - u thashë, - veç këtë radhë duhet ta kurorëzojme patjetër me atë për të cilën tremi vite që luftojmë e përpiqemi: me marrëveshjen përfundimtare për shkrirjen e grupeve, për krijimin e Partisë. Edhe më përpara kemi bërë disa «marrëveshje», kemi krijuar edhe «komisione» e «komitete», por ç'ka dalë prej tyre?! Thuajse asgjë! - u thashë. Ne s'duhet ta lejojmë më këtë gjendje.

- Ke shumë të drejtë, shoku Enver, - ndërhyri Qemali, - «marrëveshjet» e tipit të vjetër nuk duhet të përsëriten më. Për këtë duhet të luftojmë me tërë forcat që të gjithë, sepse, si te ju edhe te ne, tra akoma njerëz që nuk i kuptojnë si duhet problemet, janë ambiciozë, duan të shkojë fjala e tyre, duke menduar se vetëm ata e kanë drejt. Fshhtë formuar një mentalitet i tillë, - dhe Qemali vazhdoi : - Ju thoni se keni lidhje me Kominternin, por Ali Kelmendi, që ishte komunist i vërtetë, vdiq, kurse Koço Tashkoja, që ju e keni në krye e që hiqet si njeri i Kominternit, nuk është gjë tjetër veçse një mendjemadh.

E dëgjoja Qemalin me vëmendje. Ai nuk fuste me pasion, por mbronte me gjakftohtësi dhe me vendosmëri pikëpamjet e veta.

- Shoku Qemal e shoku Vasil, - iu drejtova të dyve, - me siguri tra shumë nga këto gjëra, por tra ardhur koha të gjejmë me çdo kusht mënyrat për Vi likuiduar të këqijat. Të meta tremi vërtet, por prapë jemi komunistë e si Anastas Lula nuk jemi kurrë.

Këtë emër e përmenda me qëllim, edhe për të parë reagimin e Qemalit, edhe për të kuptuar nëse kishte përçarje në mes tyre e në qoftë se kishte, ta thelloja më tepër. Desha t'u lija ta kuptonin që ne bënim dallim në mes tyre dhe Anastas Lulës. Por Qemali tha:

- Ç'ia varni shumë Anastasi t. Me atë ne nuk jemi dakord për shumë çështje.

Ky pohim indirekt i Qemalit më gëzoi pa masë dhe në atë moment i thashë vetes: «Bashkimi është në rrugë, formimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë po duket në horizont».

- Shoku Enver, - ndërhyri Vasili, - ne duhet ta llogaritim edhe Grupin e «Të ftinjve», por të tremi parasysh që këtë grup e udhëheqin Anastasi dhe Sadiku.

- Me siguri, - ia përkraha mendimin, - në këtë grup tra shumë shokë të mirë, trima e komunistë të vendosur, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhen vënë në një thes me Qorrin dhe me Sadikun.

Në vija të trasha ne ishim afërsisht të një me ndimi.

Në fund Qemal me Vasilin më thanë:

- Kjo që kërkojmë të arrijmë së bashku është një çështje e madhe dhe e vështirë. Ne do të mendoj më nga ana jonë, mendoni edhe ju nga ana juaj, dhe të bisedojmë përsëri se si ta realizojmë.

- E vështirë është, - pohova unë, - por jo e pamundur për ta zgjidhur në rrugë marksiste.

- Me gjithë vullnetin tonë, - më tha Qemali, ka njerëz që do të na nxjerrin pengesa. Nuk do të ishte më mirë sikur të kishim një shok komunist, të paanshëm, që të dëgjonte të gjitha palët? Çështja është sa të vihet në lëvizje makina, pastaj dimë vetë ne si të veprojmë.

Propozimi i tyre m'u duk me interes.

- Kjo nuk na ka shkuar r.c n.cnd. - iu përgjigja. - Do fua them shokëve në tndimin tuaj, për a keni ndonjë gjë konkrete?

- Jo, - tha Qemali. - por, në tndojmë, për shembull, për ndonjë shok nga Kominterni, veç, po ta them hapur, jo Koço Tashkon.

- Të mendohej, - u thashë, dhe, duke u përhëndetur me të dy, u largova me një ndjenjë optimiste. Rruga për themelimin e Partisë po çelej, po shkonim me shpejtësi drejt bashkimit historik.

U raportova me hollësi shokëve për bisedën dhe u thashë përshtypjet e mia. Koço Tashkoja, me fytyrë të skuqur, më dëgjonte, por e shihja se nuk i vinte mirë. Edhe ai farë «respekti» që kisha pasur për Koçon, tani gjithnjë e më tepër po më lëkundej. Kurse Mihaan e doja dhe e respektoja shumë, sepse ishte parimor, sa i ashpër ishte me armiqtë e komunizmit, aq i vëmendshëm e i thjeshtë me shokët, punëtorët, njerëzit e punës. Ai ishte nxënës i Ali Kelmendit. Kurse Koçoja ishte një fodull dhe tek ai dukeshin qartë mjaft vese borgjeze.

- Të shohim ku do të dalë kjo rrugë, - nisi të flasë Koçoja me një nervozizëm të brendshëm që mezi e përmbante. - Çfarë «të dërguari» kërkojnë ata? Pse, ç'jam unë? I Kominternit jam. Në s'duan të më njohin, kjo do të thotë se ata nuk njohin as Kominternin, pale «Punën» tonë!

- Si flet kështu, mo?! - kërceu Piloja.

- Flas, posi, - tha Koçoja, dhe si zakonisht la për në fund «argumentin bindës». - Flas se kam marë rëvesh që ata po përpiqen të lidhen me jugosllavët.

- Po mirë, - iu kthvem ne, - le të merren vesh me jugosllavët. edhe ata komunistë janë dhe iu ftojnë, komunistët mësojnë nga njëri-tjetri.

Vendosëm të mendoheshim, të merrnim kontakt me Mihaan e të bisedonim. Unë kisha besim te Mihaan dhe te Piloja.

Ditët kalonin. Me Bojkën dhe burrin e saj, Spron, në shtëpinë e të cilëve kohë më parë isha takuar me Vasil Shanton, takohesha shpesh dhe u shkoja edhe në shtëpi ose, më mirë të them, në shtëpinë-dhomë që kishin. Ata, siç kam thënë, ishin mësues, dhe kjo ishte një arsye tjetër që më bënte të afrohesha më shumë me ta, mua, ish-mësuesin e dikurshëm.

Bisedat me ta sa i fillonim për çështje arsimore, menjëherë i kalonim në planin politile, në ato çështje ku na dhimbte të gjithëve. Ata që të dy ishin antifashistë dhe flisnin me simpati për Bashkimin Sovjetik. Njëpërmjet tyre unë u njoha edhe me shokë të tjerë nga Shkodra. Një ditë, kur vajta tek ata, gjeta një djalë të ri, me trup të hollë e të gjatë, me fytyrë të imët dhe simpatike. Ata ma prezantuan:

- Është Branko Kadija, - më thanë.

Filluam të bisedonim. Brankoja rrinte si i druajtur, sigurisht nga unë, se më njihnte për herë të parë dhe nuk e dinte kush isha, pavarësisht se Bojka më prezantoi. Por Brankoja e kishte hallin gjetiu, ai mendonte se në cilin grup komunist bëja pjesë.

Nuk hymë në biseda grupesh, se unë i evitoja këto me dy miqtë e mi, mësuesit, dhe me të njohurin e ri shkodran.

Bojka, meqenëse pas dy ditësh vinte e diela, propozoi të shkonim shëtitje lart, nga Brrari.

- Atje ka edhe ujë, hajde edhe ti Branko, - i tha ajo.

- Ide e bukur shumë, shkojmë, - aprovova unë.

- Unë do të rregulloj d:çka për të ngrënë, - tha Spiroja.

- Dëgjo, - i thashë Bojkës, - ti na bëj ndonjë ëmbëlsirë, se birra, proshutë, sallam dhe nga një kuti me sardele i sjell unë nga dyqani ynë.

- Pse, ç'dyqan ke ti? - pyeti Brankoja.

- Shes cigare dhe pije, - i thashë, - jam në dyqanin «Flora».

M'u duk se Brankoja sikur u shtang dhe e kuptova se atë çast e mori vesh kush isha.

- Merr dhe ndonjë shok tjetër, Branko, - i tha Spiroja, - mos na kurse.

Me vendosmëri Brankoja premtoi se do të vinte.

Kjo më pëlqeu. Vasil Shantoja dhe Qemal Stafa, me sa dukej, i kishin folur mirë për mua. Kur u largua Brankoja, Bojka tha:

- Kadija është shok i ri, slumë i mirë. Vasil Shantoja e do shumë.

U binda se ai ishte i Grupit të Shkodrës dhe këta ishin njerëzit e bazës së tij. Ndjeva kënaqësi.

E diela erdhi. Brankoja kishte sjellë edhe dy shokë të tij. Shkuam në Brrar, zhveshëm këpucë e çorape e u futëm në ujë, qeshnim, bisedonim, hëngrëm dhe çdo gjë na shijoi. Ndenjëm deri në mbrëmje, pastaj zbritëm në qytet.

Kur po zbritnim, i hodha dorën në krah Branko Kadisë dhe i thashë:

- Sa gjë e shenjtë është miqësia e sinqertë dhe sidomos në kohë të këqija, se vetëm atëherë njihen miqtë e mirë.

- Ashtu është, - m'u përgjigj Brankoja.

- Ke qenë ndonjëherë në Gjirokastër? - e pyeta.

- Jo, s'kam qenë, - m'u përgjigj.

- Unë kam qenë në Shkodër dy herë, - i thashë. - Një herë vajta me një grup gjirokastritësh dhe morem atje eshtrat e Çerçiz Topullit e të Muço Qullit, që ishin varrosur në fushën e Shtoit. Më ka bërë përshtypje të madhe Shkodra, sidomos populli i dashur i saj. Me mijëra veta na përcollën me kurora për të dy dëshmorët. Unë, - vazhdova t'i thosha Brankos, - njoh edhe Qemal Stafën, edhe Vasil Shanton dhe kam simpati për ta. Mendoj se janë trima dhe komunistë të vendosur. A i njeh ti këta, shoku Branko? - e pyeta.

- I njoh posi, - m'u përgjigj ai, duke buzëqeshur. - Ata i kam shokë.

- Sa mirë, - i thashë, - atëherë të lutem, po t'i takosh, u bëj shumë të fala nga unë.

- S'do të mungoj, - tha Brankoja.

U gëzova shumë se u binda që Branko Kadija kishte marrë leje nga Vasil Shantoja për të ardhur me ne. Kjo tregonte se Vasili me Qemalin kishin besim tek unë, gjersa kishin pranuar që të takohesha e të bisedoja me një anëtar të grupit të tyre. Përshtypja e madhe që më bëri mua atëherë k~ fakt, tani ndokujt, e sidomos brezave të rinj, mund t'u duket e pakuptueshme. Por duhen pasur parasysh rrethanat e asaj kohe.

Midis grupeve komuniste, krahas mosmarrëveshjeve, atëherë ekzistonte edhe një konspiracion i fortë, secili grup i ruante me fanatizëm e xhelozri anëtarët e vet e nuk lejonte kollaj që anëtari i njërit grup të hynte në kontakte me anëtarët e një grupi tjetër. Sidomos në krerët ekzistonte frika se mos «ua rrëmbenin» njëri-tjetrit anëtarët! Kjo «frikë» nuk ishte pa baza. Elementë të tillë trockistë e fraksionistë, si Aristidh Qendro, Niko Xoxi, Zef Mala, Anastas Lula, Sadik Premtja e të tjerë, e kishin bërë vijë të veprimtarisë së tyre punën diversioniste në grupet e tjera, synimin për t'i përçarë të tjerët nga pozita antimarksiste e «për t'u rrëmbyer» anëtarët.

Krejt ndryshe mendonin e vepronin për këtë problem elementët e shëndoshë komunistë të Grupit të Korçës apo shokë të tillë të Grupit të Shkodrës, si Qemali, Vasili e të tjerë. Duke dashur të hynim në lidhje me njëri-tjetrin, ne kurrsesi nuk niseshim nga synimi separatist për ta bërë për «vete» këtë apo atë anëtar të grupit tjetër. Jo, ne niseshim nga parimi i drejtë se të gjithë ishim komunistë, ishim shokë idealesh të përbashkëta, se luftonim për një çështje të përbashkët, e pra, duhej të bisedonim e të lidheshim vetëm në emër të këtyre idealeve të larta e jo të qëllimeve meskine e sektare të grupeve apo të fraksioneve.

Pikërisht nga këto motive niseshin kur këmbëngulja para Koço Tashkos që të takohesha me Vasil Shanton e me Qemal Stafën, nga motive të tilla u nisën edhe këta, kur morën iniciativën e u takuan me mua. Për fat të mirë, veçanërisht pas pushtimit fashist të vendit, komunistët e bazës, anëtarë të grupeve të ndryshme filluan të lidheshin e të bisedonin në qendrat e punës, në shkolla etj. si komunistë të vërtetë me njëri-tjetrin e të hidheshin në aksione të përbashkëta, në demonstrata, në greva, në protesta, pavarësisht se ç'u thoshin ose ç'i porositnin disa nga krerët fraksionistë e trockistë. Me kohë kjo lidhje nga poshtë midis komunistëve erdhi duke u forcuar e duke u zgjeruar, gjë që ishte patjetër një faktor i rëndësishëm për vetë krijimin e Partisë.

Kështu ndodhi dhe me mua e me të dashurin e të paharruarin Branko Kadija, të cilin, përveç këtyre dy rasteve, nuk e pashë më. Lufta vazhdoi, Partia u formua dhe ai ra heroikisht, duke luftuar në ato shtëpi-kala të «Shkodrës loke» siç e quajnë banorët e saj, siç e quante edhe Qemal Stafa. E shoh si tashti, kur zbritnim krah për krah nga Brrari, të dy me një ideai të madh e me një zjarr të pashuar kurrë në zemrat tona. Po ecnim krah për krah, si shokë të një ideali dhe jo si anëtarë të grupeve që grindeshin me njëri-tjetrin. Më vonë do të bëheshim ushtarë të asaj Partie Komuniste për të cilën atëherë ëndërronim dhe luftonim për ta krijuar.

Tashmë takohesha herë pas here me Vasil Shanton e me Qemal Stafën. Në këto takime gjithnjë e më tepër sheshoheshin mosmarrëveshjet kryesore midis grupeve tona, gjersa hap pas hapi ramë dakord në parim që në një të ardhme të afërt grupet tona të shkriheshin e të vendosnim themelimin e

Partisë Komuniste të Shqipërisë. Siç theksova edhe më lart, si hap i parë drejt këtij bashkimi historik, ishin aksionet e veprimet e përbashkëta që, veçanërisht, nga gushti i vitit 1941 e gjer më 8 Nëntor 1941, erdhën vazhdimisht duke u rritur. Ndër to një rëndësi të veçantë pati marrëveshja për të çuar në Çetën e Pezës anëtarë nga të dy grupet. Pas takimit tim me çetën e Myslirnit në korrik 1941, në gusht atje shkuan edhe Vasili e Qemali, kurse më pas, në shtator e në tetor shkuan shokët Stefo Grabocka, Mihal Duri, Ferid Xhajku, Stavri Themeli e të tjerë. Por sidoqoftë mbetej akoma shumë për të bërë si për të afruar me qëllimin tonë edhe grupet e tjera, ashtu edhe për të sheshuar më tej mosmarrëveshjet e mëparshme, apo ato që lindnin. Prandaj në këtë periudhë takimet tona me Vasilin u shpeshtuan. Një ditë e pyeta:

- A tremi nga shokët tanë të njohur në Kosovë? A mund të dëxgojmë njeri, si për të shitur cigare? Ne s'dimë gjë ç'bëhet andej. Dëgjojmë se luftën kundër pushtuesve, jugosllavët e kanë filluar dhe ata janë trima. Partia Komuniste e Jugosllavisë tra kohë që ekziston dhe duhet të jetë e fortë. Si thua?

Këto pyetje ia bëra Vasilit, për t'i lënë atij të kuptonte, pa i thënë gjë, se ne në parim ishim dakord që të merrnim kontakt me Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe, e dyta, të mund të mësoja nëse ata po bënin ndonjë gjë në atë drejtim. Vasili më tha:

- Nga ana jonë kanë shkuar në Kosovë disa shokë që janë nga ato anë.

Kaq ngeli kjo bisedë e nuk e zgjata më tej.

U fola shokëve për bisedën me Vasilin e shfaq mendimin se s'do të ishte keq që edhe ne të bënim përpjekje për të hyrë në kontakt me Partinë Komuniste të Jugosllavisë.

- Pse të hyjmë në kontakt me ta? - ndërhyri Koçoja gjithë nerva. - Apo se kështu duan shokët e Shkodrës ? !

- Jo se kështu duan aia, - i thashë, - por është në interes të punës sonë, të lëvizjes sonë komuniste që të lidhemi me një nga partitë komuniste. Cila do të jetë kjo, s'ka rëndësi, mjaft që të jetë anëtare e Kominternit.

- Ashtu po! - «u zbut» Koçoja papritur dhe menjëherë na doli me propozim: - Unë, - tha, kam një adresë të një shoku italian me rëndësi. Të shkoj në Itali e të hyjmë në lidhje me Partinë Komuniste Italiane.

Pavarësisht se sa seriozisht e të sigurtat i kishte ato që thoshte, ne, më në fund, ramë dakord me propozimin e Koços.

Dhe ai, aty nga fillimi i gushtit, u nis për në Itali, kuptohet, bashkë me Pavlinën. Tha se për maskim do të shkonte gjoja për tregti, por jam i bindur se mendonte të kundërtën: shkoi gjoja për lidhje me komunistët italianë, por u mor me tregti dhe ndenji për qejf. Kur erdhi, s'na solli asgjë:

- Ishte bërë batërdia, - na tha, - s'gjeje komunist gjëkund! Ilegalitet i pashembull!

Si duket mendonte se më 1941 do ta prisnin komunistët italianë me lule!

Në këtë kohë erdhi nga Kosova Dushan Mugosha, i cili, pasi ishte takuar me përfaqësues të Grupit të Shkodrës e të «Të Rinjve», kërkoi takim me «k'yetarin» tonë. Mirëpo, me të drejtë, Koçoja nuk pranoi të takohet me të, sepse rruga që u përdor ishte nga më të gabuarat. Koçon e kërkoi për takim Anastas Lula, prandaj merret me mend që ai e refuzoi takimin.

- Me njerëzit që na paraqet Anastasi, - e mbështetëm ne, - nuk duhet të takohemi. - Dhe kështu vendosëm e kështu bëmë.

I njihnim mire' pikëpamjet dhe veprimet antimarksiste të Anastas Lulës, e urrenim atë, prandaj në këtë çështje ishim të gjithë plotësisht të një mendjeje. Kështu Dushan Mugosha, pali mori pjesë në një mbledhje të përbashkët me përfaqësues nga Grupi i Shkodrës e i «Të Rinjve», iku. Por nëse ne, me të drejtë, nuk pranuan të takoheshim me Dushanin, në të njëjtën kohë shfaqëm mendimin që në një moment të përshtatshëm të dërgonim Koçon në Kosovë për të marrë lidhje direkt me shokët e atjeshëm. Pasi e diskutuam çështjen, vendosëm dhe e dërguam Koçon në Kosovë për të marre' kontakt fillimisht me Xhevdet Dodën, që ishte anëtar i Grupit të Korçës dhe, nëpërinjet tija, me Komitetin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovën. Prisnim që Koçoja të na sillte andej gjëra të reja, por ai pothuajse si vajti, erdhi. Atje u lidh me shokë shqiptarë dhe jugosllavë, por asgjë të rëndësishme nuk na solli.

Kishin kaluar ditë nga largimi i Dushan Mugoshës, kur na erdhi një mëngjes në dyqanin «Flora» Tahir Kadareja. Na gjeti mua me Esatin e nisi të fliste mbarë e mbrapsht, siç e kishte zakon. E dëgjoja me njëfarë nënqeshjeje, sepse e njihja mire' karakterin e lëkundshëm të Tahirit. Ai në atë periudhë bënte pjesë në një grup oficerësh antifashistë, por pa ndonjë orientim të qartë politile. Hiqej si simpatizant, si «anëtar», si «i lid'hur» me Grupin tonë të Korçës, por e dija mirë se aderonte po në të njëjtën mënyrë edhe në grupet e tjera komuniste. Për nga veset ishte më i prirur me Grupin e «Të Rinjve»s

U ulëm në një qoshe të «Florës», nat'yrisht, i vura përpara edhe një gotë birra, se «më kishte ardhur në dyqan», dhe e dëgjoja.

Por këtë herë lajmet e tij ishin vërtet shumë të rëndësishme. Po na tregonte, «në konfidencë» se ne Tiranë ishte organizuar një mbledhje e përbashkët ku mente pjesë, përveç shokëve të Grupit të Shkodrës e të «Të Rinjve», edhe një jugosllav, Dushan Mugosha. Si «i të gjithëve» kishte marrë pjesë edhe Tahiri. Por më e rëndësishmja erdhi më poshtë:

- Dushan Mugosha, - vazhdoi Tahiri, - na tha se në kampin e internimit në Peqin fashistët kishin sjellë kohët e fundit një kuadër të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, një shok shumë të mirë. E quajnë

Miladin Popoviç, është sekretar i Komitetit Qarkor të Partisë i Kosmetit, dhe na u lut që ne, komunistët

shqiptarë, të ndihmojmë për të organizuar lirimin e Miladinit nga kampi i internimit.

Kur dëgjova këto, fillova të mendoj : Dushan Mugosha kishte ardhur në Shqipëri për të bërë këtë pro

pozim, apo për të marrë kontakt me grupet komuniste në bazë të kërkesës së tyre? Sidoqoftë ato që na tha

Tahiri dhe serioziteti me të cilin na i tha më bindën se ato që thoshte, ishin të vërteta dhe e falënderuam atë. Shumë shpejt ne i verifikuam thëniet e tij edhe me rrugë të tjera; por, siç thashë, qysh në takimin e parë e çmuam me seriozitetin e duhur lajmin që na solli. Më pas u paraqit rasti të shoqëroheshin deri në Kosovë dy shokë jugosllavë që i kishim çliruar nga kampi i internimit. Menduam fia ngarkonim këtë detyrë Tahirit, se ai vërtet kishte ca huqe, por guximi nuk i mungonte. Por Tahiri, si Tahiri, s'rrinte dot pa bishtra mbrapa.

- Shikoni, - na tha, - mirë, shokët jugosllavë do t'i shoqëroj, por më jepni dhe ndonja 100 pako cigar,e t'i çoj në Kosovë. Të maskohem si tregtar e t'i shes, dhe të marr edhe vesh se ç'bëhet andej.

Se ç'bëhej në Kosovë neve, qoftë si komunistë, qoftë si vëllezër të një gjaku me popullin kosovar, na interesonte, por, që t'i jepnim Tahirit rreth 100 pako cigare, kjo ishte njëllë sikur të hidhnim në lumë një shumë të konsiderueshme të hollash, sepse unë e njihja mirë Tahirin. Ai ishte edhe kumarxhi, pra, i prirë që t'i luante këto të holla në kumar.

- T'ia japim, - tha Esati.

- Jam dakord, - i thashë, - por dëgjo, Esat, mos llogarit që këto të holla të na kthehen.

- Ah, kështu jo, - tha Esati, - atëherë t'i japim 10 pako.

- Ju betohem, - bënte be Tahiri, - nuk do t'i luaj kumar, të hollat do t'jua kthej, për ideal!

- Le të venë në djall edhe këto para, - thamë me Esatin. - Por shih, Tahir, për shokët që do të shoqërosh t'i bësh sytë katër. Pastaj, kthehu shpejt, dhe, në qoftë se ti do t'i luash në kumar, ne do të zemërohemi.

I mori Tahiri të 100 pakot dhe iku.

- Të jemi të sigurt, - i thashë edhe një herë Esatit, - se paret nuk do të na kthehen. Tahoja i mori në kumar navllon Hulusi Babaçosl, që do të nisej për në Spanjë, e jo më paketat tona!

Dhe kështu ndodhi vërtet. Sidoqoftë lajmi që na kishte dhënë në fillim për Miladinin e vlente «të sakrifikonim» 100 pako cigare.

Pra le të kthehemi te fillimi, te koha kur morëm vesh se në Peqin ndodhej i internuar Miladin Popoviçi. I mblodha shokët, u raportova ç'më tha në «Flora» Tahir Kadareja dhe u propozova se edhe, neve të Grupit të Korçës, na takonte të vepronim për të çliruar Miladin Popoviçin.

- Të lirojmë nga kampi i internimit një komunist e kuadër të një partie komuniste tjetër, - u thashë shokëve, - është një detyrë internazionaliste ndaj sé cilës ne s'mund e s'duhet të rrimë mënjane. Pastaj, kam parasysh se mundësitë tona për këtë veprim janë më të mëdha se ato të grupeve të tjera, sepse influenca e lidhjet tona në zonën e Elbasanit dhe të krejt Shqipërisë sé Mesme, janë më të ndjeshme; në ato zona vepron Myslim Peza me çetën e tij me të cilin ne jemi lidhur prej kohësh. Prandaj, - u thashë shokëve, - ne duhet ta kryejmë këtë detyrë dhe t'u propozojmë edhe shokëve të Grupit të Shkodrës për bashkëpunim. Aksioni i përbashkët do t'i forcojë më tepër lidhjet e nisura midis grupeve tona dhe do ta afrojë më tepër ditën e bashkimit për të cilën po përpiqemi prej kohësh. - U theksova, gjithashtu, se ky ishte një rast shumë i mirë që ne, pasi të lironim Miladinin, të hynim në kontakte me të e të realizonim ato lidhje me një të tretë, të paanshëm, për të cilin si Grupi i Shkodrës, si ne ishim në kërkim. Të gjithë ishim të një mendjeje, veç Koço Tashkoja filloi të filozofonte - Ne nuk morëm lidhje, me Dushan Mugoshën e pse të marrim me këtë që nuk e dimë kush është?

Ne mund ta çlirojmë Miladinin, por ta çojmë në Kosovë.

Tashmë ishim mësuar me manovrat e Koço Tashkos për të ngritur të olla «arsye», prandaj me qetësi ia rrëzova ato një nga një, duke i thënë:

- Ne duhet ta çlirojmë Miladinin, të bisedojmë me të si komunistë dhe ai mund të na ndihmojë në zgjidhjen e, kontradiktave që kemi me grupet e tjera. Neve na vihet detyra, - theksova duke iu drejtuar Koços, - të krijojmë unitetin, të sheshojmë kontradiktat dhe të themelojmë një parti të vetme komuniste të tipit të ri. Çështja e, Miladinit nuk vihet si ajo e Dushanit, të cilin na e paraqiti Qorri. Unë mendoj se gabimi që bënë ata ndaj nesh me Dushanin, nuk duhet përsëritur me Miladinin. Propozoj të më lini mua të piqem me Vasil Shanton dhe të biem dakord për këtë çështje, si edhe të ngarkoj Mustafa Gjinishin, i cili di serbisht dhe ka lldhje me njere'z në Peqin, që të organizojë çlirimin e Miladin Popoviçit nga kampi.

Koçoja heshti. S'kishte më asnjë «arsye». Teza ime u aprovua dhe fillova veprimet.

Kur u takova me Vasilin, i shpjegova hollësisht çfarë na tha Tahir Kadareja për çlirimin nga kampi i internimit të një kuadri udhëheqës të PKJ për Kosovën, që quhet Miladin Popoviç.

- Ne, i morëm me seriozitet thëniet e tij, - i thashë Vasilit dhe vazhdova: - Të shpëtosh nga kampi një ose më shumë shokë komunistë jugosllavë, ne e konsiderojmë një detyrë solidariteti me Partinë Komuniste të Jugosllavisë, që po lufton si edhe ne kundër okupatorëve. Aksione të tilla do të na bëjnë që të futemi më shumë në luftë kundër okupatorit.

- Edhe ne, jemi dakord ta çlirojmë Miladin Popo

viçin, - tha Vasilin. - Kemi qenë dakord që ato ditë kur erdhi Dushan Mugosha nga Kosova, por grupi juaj nuk pranoi të takohej me të. Ne jemi gati të bashkëpunojmë. Për Miladinin dimë se është një komunist i pjekur e me eksperiencë.

I sqarova Vasilit se ne kishim të drejtë që nuk pranuan të bisedonim me Mugoshën, mbasi ishte Qorri ai që na lajmëroi për të dhe vazhdova:

- Lirimi i Miladinit është një detyrë internazionaliste për ne, komunistët shqiptarë, dhe mendojmë se do të na afrojë me njëri-tjetrin. Qëllimi i madh i përbashkët, vuajtjet e rreziqet, më mire' se çdo veprim tjetër, do të zhdukën nga radhët tona mosmarrëveshjet që na ndajnë. Përveç kësaj, - i thashë Vasilit, - nuk e di cili është mendimi juaj, por ai yni është që shoku jugosllav, Miladin Popoviçi, i cili na rekomandohet si një nga udhëheqësit më kryesorë të Kosovës, mund të na japë një ndihmë internazionaliste tash që jemi në prag të bashkimit të grupeve në një parti të vetme komuniste. Ne nuk humbasim gjë, veç në përfitofshim, përderisa ai është komunist. Në rast se duam që ai të na japë një ndihmë, natyrisht në qoftë se do të jetë në gjendje, sepse nuk ia njohim as kapacitetin teorik e, as praktikën e tij të luftës, ne mendojmë se duhet të jemi të sigurtë me të dhe t'i parashtrijmë drejt mendimet tona për çështjet parimore që na ndajnë. Të kuptohemi, kur e bëj këtë vërejtje,, e bëj për grupin tonë, për tuajin, por veçanërisht për atë të «Të Rinjve» me Anastasin në krye, tek i cili, po ta them haptazi, dyshojmë. Por, megjithatë ne mendojmë se ju do të influenconi për të mirë.

Vasil Shantoja më dëgjoji dhe u shpreh i një mendimi me mua. Ndieja një gëzim të madh në zemrën time, një shpresë e madhe më pushtoi.

- Ne siç jemi dakord ta lirojmë po ashtu jemi dakord që edhe të bisedojmë me të, - tha Vasili. Shokët tanë kosovarë, që kanë bërë pjesë në grupin tonë, por, meqë janë nga Kosova, shkuan të punojnë e të luftojnë atje, na kanë folur fjalë shumë të mira për Miladinin.

Meqë s'kishim kundërshtim asnjëra palë, atëherë vendosëm të vepronim sa më parë. Pastaj i bëra të ditur Vasilit se ne do të ngarkonim Mustafa Gjinishin, i cili dinte serbisht dhe njihnte terrenin e Peqinit, ku do të gjente njerëzit e duhur për aksionin.

- Jemi dakord, - tha Vasili. - Me Mustafanë mund të dërgojmë edhe ne një a dy shokë nga grupi ~në.

- Do të jetë shumë mirë, - i thashë unë, do të bisedoj për këtë çështje me Mustafanë dhe do ta dërgoj edhe te ti, prandaj mendo për shokët.

Me Mustafa Gjinishin isha njohur kur ai u kthye nga Jugosllavia së bashku me Mustafa Kaçaçin. Ata u paraqitën si komunistë dhe thanë se bënin pjesë në grupin tonë, por unë nuk i njihja as njërin, as tjetrin. Të dy ishin ilegalë. Gjinishi fliste me pretendime dhe hiqej sikur vetëm ai «do ta ,grinte vendin në këmbë». Kurse Kaçaçin, që në fillim, e simpatizova shumë. Mustafa Kaçaçi kishte qenë pjesëmarre's në Kryengritjen e Fierit dhe kishte qenë dënuar me vdekje nga gjyqi zogist. Ishte njeri i thjeshtë e i dashur, me sy të zez e të qeshur. Si duket, ai e njihje Gjinishin, se, kur më prezantuan me ta dhe ky filloi të fliste, Kaçaçi u'li kokën. Më në fund, meqë Gjinishi nuk po pushonte së foluri, i tha:

- Më lër të them edhe unë ndonjë fjalë.

Këta shokë i njohëm me gjendjen tonë dhe u bëmë të qarta qëllimet që kishim për luftën.

- Po këto grupet e tjera? - pyeti Mustafa Gjinishi.

Koçoja u foli për to, kurse unë nuk ndërhyra, përveç ndonjë rasti për të zbutur ndonjë epitet që ai i vishte Grupit të Shkodrës.

Mustafa Gjinishi na tha se ishte takuar me Haxhi Lleshin, kur qe futur nga kufiri i Jugosllavisë, si edhe me Myslim Pezën dhe shtoi: «Qendrën e kam atje, në Pezë». Myslimi kishte qenë mik i ngushtë i Adem Gjinishit, babait të Mustafës. Edhe ai ishte kundër Vërlacit dhe ky vuri njerëz që e, vranë Ademin. Myslimi qëllloi urbi vrasësin e Adem Gjinishit, i mori hakun dhe u arratis. Prandaj Gjinishi ishte i afërt me Myslimin.

Mustafa Gjinishi shkoi në Pezë, kurse Kaçaçin e mbajtëm në Tiranë. E njohëm me shokët, ndër të cilët fitoi shumë simpati. Të gjithë e donin, se ishte djalë i flaktë, ishte për bashkimin e grupeve, për formimin e Partisë dhe për kryerjen e aksioneve. Kurse Mustafa Gjinishi hiqej se ishte me ne, por nuk na raportonte kurrë se çfare' bënte; për të na vini, në korent të tjerët. Ai shkonte kudo nëpër qytet, jo vetëm tek anëtarët e grupeve, por në lloj-lloj njerë

zish, në «nacionalistë», bile shumë herë shkonte edhe në njerëz të dyshimtë. Natyrisht filluam të dysho nim për «sinqeritetin e tij». Ai kishte të tjera plane, por që do të konkretizoheshin më vonë, pas formimit të Partisë, gjatë kohës së zgjerimit të luftës së armatosur. Meqë Gjinishi rrinte i rezervuar, as ne nuk ia hapnim letrat. Ç'është e vërteta, meqenëse në këto kohë nuk kishim ndonjë gjë serioze kundër tij, ne bënim kujdes që të mos e prishnim me, të.

Të nesërmen e takimit me Vasilin thirra Mustafanë dhe ia komunikova vendimin. Bëmë planin, sipas të cilit ai do të shkonte të bënte një herë rikonjicionin e terrenit: fushën ku ndodhej kampi i internimit, rojat e armikut që patrullonin, t'u vinte, syrin njerëzve nga të tijtë, që do të përdorte, plus një ose dy shokëve të tjerë që do t'i rekomandonte Vasil Shantoja. Mustafai u hodh përpjetë nga gëzimi që po e ngarkonim për një veprim special, të cilin ai e konsideronte të rëndësishëm. E porosita të ruante gjakftohtësinë, të ishte konspirativ dhe të gjente mundësinë për të lajmëruar brenda në kamp Miladinin, kurse planin e veprimit dhe datën për zbatimin e tij të na i parashtronte, pastaj të vendosnim definitivisht. Dhe kështu bëri. Kur u kthye pas tri-katër ditësh Mustafai e kishte

gati planin. Pasi e diskutuam bashkërisht, ai mori aprovimin për veprim. Aksioni u krye, me sukses. Miladin Popoviçi u çlirua dhe u vendos në një bazë të sigurt në Tiranë.

Të nesërmen Koçoja, unë dhe Mustafai shkuam dhe u takuam për herë të parë me Miladinin. U përqaftuam dhe u puthëm me të si të ishim njohur prej kohësh. Miladini fliste serbisht, Mustafai përktente. Koçoja i uroi mirëseardhjen dhe i transmetoi gëzimin tonë që u çlirua nga kampi i fashizmit.

Miladini ishte i gëzuar që gjendej në gjirin e shokëve komunistë shqiptarë dhe për këtë na falënderoi shumë. Ai shprehu dashurinë dhe admirimin e tij për popullin vëlla shqiptar. Këto ndjenja kishin lindur në zemrën e tij nga sa kishte dëgjuar për popullin tonë dhe nga ato që kishte parë e njohur vetë, sepse kishte jetuar dhe punuar me shqiptarë. Ai ishte malazez, por virtytet e popullit tonë i gjykonte dhe i vlerësonte si komunist.

- Unë e dua popullin shqiptar, - tha Miladini, - se është një popull trim, heroik, i besës dhe i papërkulur përpara axmiqve,, të jashtëm e të brendshëm, në mes të të cilëve tra qenë edhe reaksioni serbo-malazez. Por, aktualisht, armiku ynë i përbashkët është fashizmi italian dhe gjerman, të cilët duhet t'i luftojmë të organizuar dhe në unitet me Bashkimin Sovjetik në krye. Ne, - vazhdoi Miladini, - jemi komunistë dhe na duhet unitet mendimi e veprimi, pse në rrugën tonë do të gjejmë pengesa kolosale që duhet t'i kapërcejmë.

Pastaj e mora fjalën unë.

- Shoku Miladin, - i thashë, - ne jemi shumë të gëzuar që tremi te ju një shok, një vëlla, një bir të popujve të Jugosllavisë dhe të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Na prekin shumë fjalët dhe mendimet tuaja prej komunisti internacionalist për ne komunistët dhe popullin shqiptar. Ne, po ashtu, tremi një dasiuri dhe një simpati të sinqertë për popujt e Jugosllavisë dhe për Partinë Komuniste të Jugosllavisë, që po luftojnë me heroizëm kundër okupatorëve.

Dëshira jonë e zjarrtë është: Të organizojmë në të gjithë vendin rezistencën dhe luftën, e cila nuk mund të

ketë suksesin që dëshirojmë ne, komunistët, pa ekzisten-

cën e një partie të re, të tipit të ri leninist-stalinian. Siç e theksuat edhe ju, ne duhet të forcojmë unitetin e luftës sonë kundër armiqve të përbashkët, okupatorëve fashistë dhe reaksionit të zi, si atij shqiptar ashtu edhe serbomad. Kësaj veprë vigane nuk mund t'ia dalë mbanë askush tjetër, veçse populli, i udhëhequr nga Partia Komuniste.

Miladini aprovonte, pasi ia përktente Mustafai. Pastaj Miladini tha:

- Unë do të gëzohem, në qoftë se do të ketë mundësi të vihem në korent për gjendjen në Shqipëri, pastaj, prapë me ndihmën tuaj, të kaloj në Kosmet për të vazhduar luftën.

Pa pritur të mbaronte, fjalën Miladini, kërceu menjëherë Koço Tashkoja, dhe, me atë «tonin special» të tij të një personi «superior» në mendime, që fuste ex cathedra, iu përgjigj:

- Me siguri, shok, ne do të të vëmë në korent mbi veprimet e okupatorit në vendin tonë, mbi zhvillimin e ngjarjeve dhe mbi qëndrimet e Grupit të Korçës, sepse, kur erdhi i dërguari i Komitetit të Kosmetat, ne me plot të drejtë nuk u takuam me të. Ai u takua me «ata» të Grupit të Shkodrës e të «Të Rinjve», por duhet të dini, se grupi ynë, Grupi i Korçës. . .

Ndërsa fuste Koçoja, Miladini me dashamirësi e takt ndërhyri:

- Unë nuk tram dijeni për ato që kanë ndodhur me të dërguarin e Kosmetit, sepse, siç e dini, tram qenë i internuar që nga fillimi i gushtit në Peqin, porrrendoj se nuk ekziston asnjë arsye pse të mos merremi vesh.

Koço Tashko mendjemadhi e vazhdoi bisedën me po atë ton. Unë nuk mund ta lija që kjo bisedë të zhvillohej në këtë platformë, prandaj ndërhyra:

- Shoku Miladin, - i thashë, - çështja nuk qëndron në mosmarrëveshjet me shokët e Komitetit të Kosmetit dhe as thjesht në çështjet e një grupi komunist, por në mosmarrëveshjet midis nesh, komunistëve të grupeve të ndryshme shqiptare, që jemi grindur dhe tremi qenë në luftë me njëri-tjetrin për çështje parimore ideologjike dhe politike. Drejt she

shimit të këtyre mosmarrëveshjeve,, sidomos kohët e fundit, tremi ecur përpara. Me shokët e Grupit të Shkodrës, bile kemi arritur në parim në mendimin e përbashkët për shkrirjen e grupeve, e për

krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, u tremi bërë thirrje edhe grupeve të tjera se kanë ardhur momente, vendimtare, bile pranojmë që tremi humbur kohë dhe duhej të kishim bërë përpjekje më të mëdha, që të arrinim qysh më parë të zhdukeshin përfundimisht mosmarrëveshjet e vjetra, të forcoheshin dhe të unifikoheshin më shpejt mendimet politike e ideologjike midis grupeve, të unifikoheshin veprimet tona kundër okupatorit, gjë që nuk mund të bëhet veçse me, shkrirjen e grupeve dhe formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Tjetër rrugë nuk tra.

- Keni të drejtë, shoku Enver, kjo është e vetrja rrugë, - pohoi Miladini. - Partia jonë tra një eksperiencë të hidhur nga puna fraksioniste dhe për këtë ajo është kritikuar rëndë nga Kominterni.

Pastaj unë vazhdova:

- Pikërisht fryma e sëmurë e grupeve e tra penguar edhe te ne bashkimin e tyre dhe themelimin e Partisë. Me arsye ose pa arsye në mes grupeve, tona komuniste tra qenë krijuar prej kohësh një hendek që tash më tepër se kurrë duhet kapërcyex dhe një armiqësi që duhet zhdukur menjëherë. Ne duam t'i sheshojmë edhe ato mosmarrëveshje që kanë mbetur, të ndajmë shapin nga sheqeri dhe, të çajmë sa më shpejt rrugën për formimin e Partisë. Kjo është dëshira e Grupit të Korçës, dhe baia e grupeve të tjera e dëshiron një gjë të tillë, por tra individë që e pengojnë këtë punë shpëtimtare.

Miladini më aprovonte.

- Shoku Miladin, - i thashë në vazhdim, ju kërkua t'ju informojmë për gjendjen në vendin tonë, që, kur të ktheheni në Kosmet, t'u raportoni për këtë shokëve. Shoku Koço ju tha se do ta bëjmë këtë gjë. Ne do të bisedojmë përsëri, por edhe tani mund t'ju shpjegojmë një çikë këtë çështje.

Dhe, dulce iu drejtuar Koços gjoja për t'i marrë leje, por në fakt për f'orcer ta mainl, që të mos kishte si të më disaprovonte, vazhdova:

- Shoku Miladin, ne duam që t'ju vëmë në korent për pikëpamjet e Grupit tonë të Korçës, si për pikëpamjet politike, ideologjike, organizative, ashtu edhe për luftën kundër okupatorëve, kuislingëve, feudalëve e borgjezisë së vendit tonë; t'ju shfaqim mendimet tona për rolin e klasës punëtore, të fshatarësisë e të intelektualëve në Parti dhe në luftë. Ne ju konsiderojmë si shokun tonë, prandaj ju sigurojmë se do t'ju flasim hapur dhe kërkujmë që, së toku, si komunistë, të diskutojmë për këto çështje e të shkëmbejmë mendime. Kërkujmë nga ju, gjithashtu, që të na flisni hapur dhe sinqerisht ku e kemi mirë dhe ku e tremi gabim. Por kjo nuk është e tëra ajo që kërkujmë prej jush. Ne propozojmë që të njëjtën gjë të bëni edhe me Grupin e, Shkodrës e me Grupin e «Të Rinjve». Ne do t'ju flasim edhe për pikëpamjet e këtyre grupeve dhe ç'mendojmë ne për ta. Kështu dëshirojmë që edhe grupet e tjera të bëjnë po këtë gjë ndaj Grupit tonë të Korçës. Në këtë mënyrë mendojmë se ju do të informoheni si duhet. Gjatë kësaj kohe do të piqemi shumë e shumë herë dhe do të diskutojmë bashkërisht, prandaj çështja për ne nuk shtrohet që ju të ktheheni shpejt në Kosovë. Jemi të mendimit se kjo punë do të na marrë ca kohë, por tremi bindjen se do të bëjmë një punë shumë të mirë për të ardhmen e komunizmit në vendin tonë. Ne, komunistët shqiptarë, e dimë se varet nga ne dhe vetëm nga ne që të formojmë Partinë Komuniste të Shqipërisë, se jemi ne që do ta formojmë atë, që dcl 'ta kalitim o-3e jo në beteja. Jemi të bindur, se në mos sot, nesër, Partia Komuniste e Shqipërisë do të formohet, por ne jemi edhe internacionalistë dhe, kërkujmë që ju, shoku Miladin, të na ndihmoni në këtë drejtim.

Pasi mbarova unë, Miladin Popoviçi dukej i gëzuar dhe tha:

- Shaku Enver, ju falemnderit shumë për besimin që tregoni ndaj meje. Unë po ju them se nuk tram ndonjë eksperiencë të madhe, por, si komunist, si internacionalist, çdo gjë timen do ta vë në shërbim të komunizmit. Né qoftë se pranohem edhe nga grupet e tjera, siç propozoni ju, atëherë do të vë të gjitha forcat e mia në shërbim të komunizmit né Shqipëri, do të luftoj dhe do të vritem tok me, ju, po ta lypë nevoja, për popullin shqiptar, sikur të jetë populli im, jugosllav. Ju siguroj se do t'ju shfaq hapur mendimin tim, i cili mund të jetë edhe i gabuar, prandaj, nëse do të jetë kështu, e hidhni poshtë dhe më kritikoni. Çështja e madhe e komunizmit, e formimit të Partisë suaj dhe e luftës për çlirimin e Shqipërisë, është, siç e theksuat edhe ju, çështje e vetë komunistëve shqiptarë dhe e askujt tjetër. Pa mendimin unanim të komunistëve shqiptarë nuk tra dhe as nuk mund të krijohet e të kalitet Partia Komuniste e Shqipërisë. Jam plotësisht dakord me ju, për të gjitha çështjet që paraqitët.

Gatishmërinë dhe sinqeritetin e tij komunist e ndieja në fjalët që i dilnin nga zemra. I gëzuar i thashë

- Vendimi që morëm, shoku Miladin, tra rëndësi dhe do të fillojmë menjëherë nga pana, por Cani duhet të çlodheni. Ne do t'ju çojmë në baza të sigurta. Ndërkohë do t'ju vëmë në lidhje edhe, me njerëz nga grupet e tjera dhe, pasi të merret edhe aprovimi i tyre, do të caktojmë metodën dhe kohën e punës.

- Jam dakord, - tha Miladini, - por unë do të shkruaj një letër për shokët e Kosmetit, që ata të njoftojnë udhëheqjen e PKJ për propozimin tuaj dhe do t'u kërkoj leje për të qëndruar këtu për aq kohë sa të jetë e nevojshme.

Pastaj shtoi:

- Kisha edhe një kërkesë : në qoftë se ju nuk treni kundërshtim, do të kërkoj të vijë këtu edhe Dushan Mugosha që të më ndihmojë, se ai di dhe shqip.

- Dakord, - i tharnë. - le të vijë, kështu zhdu ket edhe mosmarrëveshja që u shkaktua me rastin e ardhjes së tij të parë në Shqipëri.

Ç'komunist dhe ç'njeri ishte Miladin Popoviçi! Titistët, me Titon në kryen emrin e Miladin Popoviçit e kanë përdorur për interesat e tyre shoviniste e aspak internacionaliste, sikur «Miladin Popoviçi themeloi Partinë Komuniste të Shqipërisë», se «pa Miladin Popoviçin nuk do të ishte formuar Partia jonë». Kjo ishte, një gënjeshtër e madhe demagogjike dhe vërtetonte edhe në këtë çështje, si në të gjitha të tjerat, që ata ishin antimarksistë. Vetë Miladin Popoviçi, në Konferencën e Parë të Vendit të PKSH, në mars 1943, siç do të flas më gjere' në kujtimet e mia për atë ngjarjel e, hodhi poshtë atë pretendim, duke theksuar shprehimisht se «nuk është e vërtetë që Partinë Komuniste të Shqipërisë e tra krijuar PKJ», «ju e krijuat vetë Partinë tuaj Komuniste» etj. **As nuk mund të bëhet fjalë që një parti marksiste-leniniste e një vendi të formohet nga një i huaj, qoftë ky edhe komunist - internacionalist i vërtetë**, siç ishte Miladin Popoviçi.

Tërë kjo zhurmë u bë kur doli sheshit tradhtia e këtyre renegatëve të marksizëm-leninizmit dhe Partia jonë demaskoi të gjitha ndërhyrjet antimarksiste, revizioniste, kolonialiste e aneksioniste të tyre ndaj Shqipërisë.

Historia dhe faktet treguan se Miladin Popoviçi, anëtar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, u rrit e u kalit tok me Partinë tonë. Gjatë tre vjetëve që ai qëndroi e luftoi së bashku me ne, me qëndrimet e tij të drejta e parimore, me devotshmërinë dhe me pjekurinë e tij marksiste-leniniste, vërtetoi se i donte shumë Shqipërinë dhe popullin shqiptar dhe mbajti në çdo rast qëndrim të drejtë internacionalist në mbrojtje të interesave e të qëndrimeve të drejta të Partisë sonë.

Por të vijnë në përshtypjet e para të njohjes sono me të. Miladin Popoviçi kishte një shtat të lartë që binte në sy, prandaj gjatë gjithë kohës na është dashur të bënim shumë kujdes në lëvizje që të mos zbulohet nga armiku. Që nga biseda e parë që bëmë, më la një përshtypje të thellë. Miladini fuste i qetë. Me ne sillej në mënyrë të hapur e të sinqertë, sikur të ishim njohur një jetë të tërë. Këto cilësi i pasqyroheshin në sytë e tij të kaltër, të ndritur e të qeshur.

Mbas bisedës që bëmë, kur u ndamë, Miladini na tha

- Shokë, unë nuk kam kobure, duhet të më gjeni një.

Unë menjëherë nxora nga mesi «Mauzerin» tim njëzetësh e dy karrikatorë dhe ia dhashë. Sa shumë u gëzua, e puthi. Ai i donte shumë armët.

Në rrugë i thashë Koços:

- Kemi rënë në një shok të mirë. Ç'përshtypje të bëri ty?

- Si i vendosur duket, - tha Koçoja, - por duhet ta provojmë. Siç na rrlëson Lenini, ta provojmë; - vazhdoi ai. - Prandaj duhet të ecim me kujdes jo t'i hapim zemrën përnjëherë, se m'lu duk sikur ti i premthve ca më tepër nga ç'kemi vendosur.

- Dëgjo Koço, - ia ktheva menjëherë, - ne po i hyjmë një pune dhe duhet Via dalim mbanë. Ky është një shok që nuk e njohim as ne, as grupet e

tjera dhe, dulce qenë në këto pozita, s'ka kush të thotë se ai mbron këtë apo atë grup, njërin apo tjetrin për

son. Neve atë na e rekomanduan për ta çliruar si komunist të mirë dhe shok të vendosur, udhëheqës në Komitetin Krahinor të Kosmetit. Ky që sjellë në kamp nga Jugosllavia, është komunist dhe s'mund të jetë pravokator. Një eventualitet të tillë unë e ekskludoj qind për qind.

- Mirë, bre, mirë, po e kam fjalën të siguria. Duhet maturi në këto punë, duhet verifikim, - më tha Koçoja.

- Biseda e parë që bëmë, - vazhdova unë, ma forcoi shumë këtë besim. Në detyrën tonë inter nacionaliste e bëmë dhe krijova përshtypjen që edhe ai është i gatshëm të na ndihmojë ne si internacionalist, prandaj, nëse udhëheqja e PKJ do të bjerë dakord me propozimin tonë që ai të qëndrojë në Shqipëri,

ne duhet të kemi besim të Miladini. Pastaj këtij sh-oku ne nuk do t'i flasim për organizimin tonë, por do t'i shfaqim pikëpamjet ideopolitike që kemi, do t'i themi po ashtu, ç'mendojmë ne për grupet e tjera dhe këtë gjë duhet ta bëjmë haptazi e pa hezitim. Duke bërë të njëjtën gjë edhe me grupet e tjera, ndihma e tij do të na shërbejë për t'i sqaruar më shpejt mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis nesh.

Në prag të ngjarjes së madhe

Në të Grupit të Korçës filluam menjëherë të përgatiteshim për bisedat me Miladinin, ndërsa ky, me anë të Mustafa Gjinishit, filloi të merrte kontaktet e para me grupet e tjera, natyrisht, me Vasilin e Qemalin, për Grupin e Shkodrës, dhe me Anastas Lulën e Ramadan Çitakun, për Grupin e «Të Rinjve». Ramadan Çitaku ishte kosovar. Ne nuk e njihnim, por ai e dinte mirë edhe serbishten dhe shërbeu më vonë si përkthyes, pas! Miladini në atë kohë nuk e fliste shqipen dhe me vështirësi kuptonte pak frëngjisht.

Ndërkaq erdM nga Kosova Dushan Mugosha, i cili solli aprovimin e udhëheqjes së PKJ që Miladin Popoviçi dhe ai të qëndronin për një periudhë kohe në Shqipëri, sipas propozimit tonë. Caktuam kohën për takimet me Miladinin dhe filluam bisedat. Koçoja e mori fjalën i pari. Ai tregoi se si ishte formuar Grupi ynë i Korçës, si ishte forcuar baza e tij me elementë të klasës punëtore, si i kishte marrë direktivat e Kominternit dhe si veprroi në ato rrethana; foli edhe për veten e tij se si u kthye nga Bashkimi Sovjetik. Ai shpjegoi politikën e drejtë që kishte ndjekur Grupi i Korçës kundër Zogut dhe, në vazhdim, i paraqiti Miladinin të gjitha akuzat që ky grup formulonte kundër grupeve të tjera, të Shkodrës, të «Të Rinjve», të «Zjarrit» e të personave trockistë. Koçoja s'la gjë pa thënë në këtë drejtim, deri edhe frikën që ai kishte ndier se mos bënin atentat kundër personit të tij.

Unë e mora fjalën pas Koços dhe trajtova çështjet që preku ai në përgjithësi, por që mendova se kishte vlerë Ci zgjeroja edhe pak, sepse mund ta sqaronin më të j Miladinin.

Shpjegova se baza e grupit në qytetin e Korçës ishte e fortë.

- Kjo bazë, - vura në dukje, - përbëhet nga punëtorë me kuptimin e vërtetë të proletariatit, që shitinin e shesin krahu e punës, e që punojnë sidomos në sektorin e ndërtimit, si dhe punëtorë zanatçinj të vegjël, këpucare', hekurxhinj, ballomatarë, çirakë dyqanesh e të tjerë. Po ashtu në këtë grup kanë bërë e bëjnë pjesë shërbyes, çirakë pranë artizanëve të mëdhenj e të vegjël, shoferë dhe ndihmës të tyre. Kjo bazë e grupit, - theksova, - është e shëndoshë, e organizuar, e disiplinuar dhe e vendosur. Rreth saj janë grumbulluar studentët e shkollave të mesme dhe sidomos ata të Liceut, disa mësues dhe profesorë, disa intelektualë, nëpunës të vegjël dhe tregtarë të vegjël, simpatizantë, të cilët grupi ka ushtruar e ushtron një influencë të mirë'.

Theksova, po ashtu, gjendjen e përgjithshme politike në Korçë, pozitën relativisht të fuqishme të borgjezisë tregtare, snobizmin e saj dhe forcën e pronarëve të tokave, të bejlerëve e të agallarëve të fshatit. Këta ishin më të shumtët myslimanë, më injorantët dhe më brutalët në shtypjen e fshatarësisë. Borgjezia tregtare e Korçës ishte më e dalë, më e moderuar dhe liberale në dukje, por shtypëse e fajdexheshë në kulm. Në mes borgjezisë së qytetit e tregtarëve të mëdhenj, që ishin të krishterë, nga njëra anë, dhe bejlerëve e agallarëve, që ishin myslimanë, nga ana tjetër, ekzistonin animozitet dhe luftë. Regjimi i Zogut mbështetej në të dy krahët, por për kryeministra pranonte vetëm korçarë të krishterë dhe rrallë, bile vetëm një herë, mysliman. Borgjezia tregtare e qytetit

edhe e urrente klasën punëtore dhe Grupin e Korçës që e drejtonte atë, por edhe e kishte frikë, prandaj këtë frikë ndaj saj e maskonte herë pas here me njëfarë respekti. Ndërsa agallarët e bejlerët nuk e kishin këtë frikë.

Dhe këtu theksova atë pikë të dobët të Grupit Komunist të Korçës, që nuk e theksoi Koçoja: mungesën, ose më mirë punën inekzistuese të komunistëve të grupit me fshatarësinë.

- Kjo, - thashë unë, - ka konsistuar më tepër në disa lidhje miqësore individuale, por nuk ka përbërë aspak një punë serioze.

Këtu theksova qëndrimin kontradiktor që mbante ndaj fshatit Grupi Komunist i Korçës, i cili, në parim dhe në vijën e tij, e kishte të qartë rolin e fshataresisë në revolucion, si aleate e klasës punëtore, kurse në praktikë nuk e kishte vënë ujin në zjarr.

Koço Tashkos nuk i pëlqeu kjo dhe ndërhyri të më korrigjonte:

- Nuk qëndron tamam kështu ky problem, tha ai. - Të mos i injorojmë punën e sukseset tona. Pse pak lidhje ka pasur grupi ynë me boboshticarë e drenovarë, shoku Enver?! - m'u drejtua mua Koçoja. - Lidhjet me drenovarë ose me boboshticarë, nëpërmjet shokut Sotir Gurra apo të ndonjë shoku tjetër, - vazhdova unë, - nuk mund të mbulojnë mosinteresimin e grupit por fshatarësinë punonjëse të fushës dhe të malësisë së Korçës në veçanti dhe por fshatarësinë e gjithë vendit. Arsyen duhet ta gjejmë në mentalitetin lokalist të punëtorit dhe në përgjithësi të të gjithë korçarëve. Prandaj, shoku Koço, - ia ktheva, - ne vërtet nuk duhet t'i mohojmë anët e mira dhe pozitive të punës së grupit tonë, por ama duhet të njohim edhe dobësitë e mëdha, një prej të cilave është neglizhenca e punës me fshatarësinë. Kjo karakteristikë jo emirë e punës së grupit tonë është shfaqur edhe në qendra të tjera ku ka vepruar e vepron grupi, si në Tiranë, në Kuçovë, në Durrës dhe në Gjirokastrë. Përpara, gati asnjë punëtor nuk dilte nga Korça. Asnjëherë, me përjashtim të këtyre dy vjetëve të fundit, ne nuk kemi sjellë grupe të forta shokësh punëtorë nga Korça në Tiranë. Kurse në fshat akoma nuk kemi mundur të dërgojmë. Të njëjtën gjë, - vazhdova unë, - mund të themi edhe për rininë.

Vura në dukje se në Korçë rinia e qytetit kishte hyrë mirë nën influencën e grupit, por ajo nuk i lyente këpucët me baltën e fshatit.

- Në përgjithësi, - theksova, - Grupi ynë i Korçës, si grup komunist që është, antizogizmin e tij të ashpër dhe konsekuent duhej ta zhvillonte në mënyrë të organizuar edhe në masat e gjera të të moshuarve, pikërisht në atë formë që e organizoi me aq sukses me rininë në qytet.

Po ashtu, - i thashë Miladinit, se edhe me gratë puna e grupit kishte çaluar. E vërteta është se gra e vajza korçare, midis të cilave shumë nga grato, motrat e vajzat e shokëve të Grupit Komunist, ishin afruar e merrnin pjesë aktive në shoqërinë «Puna» e në shoqëritë e tjera punëtore e jashtëshkollore që drejtoheshin nga komunistët, por ne s'mund të mohojmë faktin tjetër që, me përjashtim të disa shoqeve, si Kleopatra Maliqi, Ollga Mitrushit e ndonjë tjetër, pak ishte bërë për të lidhur sa më shumë shoqe edhe organizativisht me Grupin Komunist.

- Me këtë rast, - theksova, - meqenëse po flas për dobësitë e grupit, bëj edhe një autokritikë për veben time dhe një kritikë të përgjithshme për grupin, e veçanërisht për shokun Koço që çështjen e përkthimeve të materialeve ideologjike ose të ndonjë gazete ilegale dhe buletinin që nxirrnim një herë në hënzë, e kishim lënë gati pas dore. Për këtë, - thashë, kemi një përgjegjësi të madhe ne, intelektualët e grupit komunist, sepse jo vetëm dimë gjuhë të huaja, por i kemi pasur edhe mundësitë që t'u krijonim shokëve të grupit mësim të organizuar kolektiv, ku të merrnin njohuri marksiste-leniniste. Veçanërisht në Korçë mund të realizohej edhe përkthimi i materialeve, edhe shtypja e tyre ilegalisht, mund të organizoheshin edhe rrethe studimi, por asnjë përpjekje serioze nuk tremi bërë në këtë drejtim, dhe ky tra qenë një minus për grupin tonë. Ne jemi fajtorë për këtë.

- Shoku Enver, - ndërhyri prapë Koçoja, - po na vë shumë minuse. Pa më thuaj, a s'që grupi ynë që u interesua, përktheu e shtypi në fashikuj «Nënën»? Po «Manifestin», po «Shkenca dhe feja»? A, të lutem, kritikë e autokritikë, por me karar, - tha ai i skuqur.

- Shoku Koço, - i thashë i qetë, - unë nuk dua e s'do të lejoja askënd të mohonte apo të denigronte Grupin tonë të Korçës, tiparet e tij pozitive, hapat e mirë që tra hedhur. Unë jam vetë anëtar i

këtij grupi, ai më bëri komunist. Por pikërisht se jemi konzunistë, prandaj të flasim hapur e pa frikë. Përmende «Nënë» e një a dy broshura të tjera. As unë, askush nuk i mohon ato. Por pse, vetëm me 3-4 apo edhe me 10 përkthime do të justifikohemi ne? Kaq qenë mundësitë tona? Kaq qenë nevojat? Kurrsesi! theksova. - Ka ardhur koha kur duhet të flasim hapur e të mos fshehim asgjë, as të mirat, as të metat.

- Grupet e tjera, - vura në dukje më poshtë, janë më keq se ne. Unë bashkohem me Koçon për vijën e gabuar ideopolitike të grupeve të Shkodrës dhe të «Të Rinjve». Ishin kjo vijë dhe pikëpamjet e tyre të gabuara që i kanë bërë Zef Malën, Niko Xoxin, Anastas Lulën dhe në përgjithësi shumë pjesëtarë kryesorë të grupeve të tyre të pengonin afrimin, të pengonin unitetin dhe të mos pranonin direktivat e Kominternit. Ata përhapën lloj-lloj teorish trockiste për çështjet organizative dhe politike të Partisë, për moralin proletar, për Bashkimin Sovjetik e për Stalinin, deri edhe pikëpamje disfatiste për luftën kundër okupatorëve, dulce pretenduar «pritjen e formimit të proletariatit», pasi «me fshatarësinë e lëkundshme e mikroborgjeze nuk mund të shkojmë në luftë, nuk mund të kemi besim tek ajo». Kështu thoshin Anastas Lula, Zef Mala, Niko Xoxi, Andrea Zisi dhe të tjere Lidhur me këtë, zhvillova më tej mendimin se si duhej ta konsideronim ne fshatarësinë e varfër dhe si, të gjithë, të riparonim gabimin që kishim bërë karslhi sai. Për Grupin tonë të Korçës ky riparim duhej bërë në anën organizative, kurse grupet e tjera duhej të ndërronin konceptet dhe të ndreqnin vijën e gabuar për sa i përket fshatarësisë sonë.

- Veçanërisht kjo ka rëndësi për vendin tonë, ku jo vetëm predominon fshatarësia, por ajo njihet për traditat e saj patriotike, mund të themi, dhe revolucionare. Pa këtë forcë e mbështetje, - theksova unë, - klasa punëtore dhe Partia Komuniste e Shqipërisë që duhet të formojmë, nuk mund të kenë sukses në ndërmarrjen e tre historike, në luftën për çlirimin e atdheut. Pa pjesëmarrjen e fshatarësisë në luftë, e përfundova fjalën, nuk mund të çlirohet Shqipëria.

Shokët e tjerë dhe Miladini që mbante shënime, më dëgjuan me kujdes dhe nuk më ndërprejnë asnjëherë, me përjashtim të dy-tri kërcimeve të Koços.

Pasi bëmë një a dy pushime, Miladini na drejtoi një varg pyetjesh, sepse dote t'i kishte më të qarta e më të bazuara në fakte tezat e grupit tonë. Ne iu përgjigjëm të gjitha pyetjeve dhe i thamë se ishim kurdoherë në dispozicion të diskutonim e të ridiskutonim për pikëpamjet e grupit tonë, derisa ai të niste bisedat edhe me grupet e tjera, ku do të mësonte edhe pikëpamjet e tyre. Pastaj, sigurisht, do të bënim analizat, ballafaqimet dhe konkluzionet.

Miladini s'kishte ndonjë kundërshtim dhe mbeti i kënaqur. Ai tha se e kishte të qartë punën e Grupit të Korçës, por na u lut t'i linim kohë të studionte të dhënat e të reflektonte.

- Bisedime, që do të më shërbejnë edhe mua edhe juve, do të bëjmë shumë, dhe unë, - theksoi ai, jam optimist, si edhe ju, se punës që i jemi futur do t'ia dalim mbanë me sukses.

Pas mbledhjes shkuaam për të ngrënë bukë së toku në shtëpinë time me dy dhoma, që ndodhej në Kodrën e Kuqe. Miladinit e Dushanin i njoha rrae plakun e me anenë, të cilët i përqaftuan dhe u uruan mirëseardhjen.

Miladini, pasi i përqaftoi pleqtë e mi, dukej i malluar, ndoshta ngaqë kishte kohë pa e parë nënën e tij. U shtrua në minder dhe aneja filloi ta pyeste siç pyesin gjirokastritët:

- Si je djalë? Je mirë, ke nënë, si e ke? – Plaku xrinte e shikonte me kuriozitet. Ai edhe donte të dinte, por edhe nuk guxonte të pyeste, se Miladini nuk dinte shqip, vetëm vinte dorën në gjoks, si ne, për të shprehur falënderim dhe mirënjohje për atë që flet, kurse Dushani, që dinte një -shqipe të rëndë, të çalë e të përzzer me sllavizma, përgjigjej për të dhe për vete, pasi edhe atij iu bënë të njëjtat pyetje. Pleqtë nuhabën që të dy shokët. tanë ish in të huaj, por s'p'yetën se nga, pse e dinin që edhe ata i ndiqte policia si djalin e tyre e si Pilon, që ata e njihnin qysh më parë. Sanoja përgatiti darkën që na shijoi aq shumë, sa «u shqepëm së ngrëni», si i thonë fjalës. Vura re me gëzim se Miladini e hante shumë djathin e bardhë, si unë. Piloja na kishte blerë në treg një teneqe me djathë kosove, që ia kalonte dhjetëfish djathit më të mirë të Gjirokastrës.

Babai, mirë që hëngri me anenë nga dhoma tjeiër se, po të kishte parë se si i binim djathit unë dhe Miladini, do të bëhej vrer, mbasi e dinte që të nesërmen unë do t'i çoja përsëri shokë në shtëpi dhe ai do ta ndiente veten ngushtë po të mos kishte me se t'i priste. Miladini ishte më i fortë se unë në

djathë. Ai kishte një zakon që e adoptova edhe unë më vonë, natyrisht, kur kishim djathë, se kur s'kishim na qanin sytë. Ai në çdo gjellë që hante, edhe në fasule, oriz apo në jahni, fuste thela me djathë; përjashtim bënte vetëm tek ëmbëlsira. Kur Sanoja i jepte pjatë të pastër, që ta ndërronte të parën, ai, duke qeshur, ia bënte me kokë në shenjë mohimi. Çdo gjellë Miladini e hante në një pjatë. Zaten, Sanos i bëhej mirë, se në shtëpi nuk kishim dhe aq pjata. Ai nuk kishte mani mikroborgjeze as në të ndenjtur, as në të ngrënë, as në të folur. Miladini nuk e hiqte veten si ouvrier, domethënë nuk donte të tregohet me mënyra të jashtme, në sjellje ose në veshje, sikur gjoja ishte proletar, por i tillë ishte në mendime dhe në punë. Miladini ishte intelektual, por nuk kishte asnjë prirje intelektualiste.

Miladini vazhdonte punën me grupet e tjera dhe ne të dy takoheshim në baza të ndryshme. Gjatë kësaj kohe unë u takova me të nja tri a katër herë dhe nga bisedat kuptoja se punët po ecnin mire' dhe për këtë gëzohesha shumë.

- Shoku Enver, - më tha në një nga këto biseda, - mua më duket se Grupi Komunist i Korgës, në përgjithësi, sipas gjykimit tim të parë, ka pasur një vijë të drejtë. Vërejtjet kritike që bëre ti në ekspozitën për grupin tuaj, janë shumë me vend dhe unë, si edhe ju, i konsideroj se kanë vlerë. Natyrisht, kur të mblidhemi qoftë me ju, qoftë edhe me grupet e tjera dhe të ballafaqohemi, të lutem shumë t'i ritheksosh, se kanë rëndësi të madhe për Partinë Komuniste të Shqipërisë që do të formoni. Unë mund të të them ty, personalisht, hëpër hë, pasi nuk kam konkluduar akoma, se në Grupin e Shkodrës ka mjaft influenca të huaja në botëkuptimet pobtiko-ideologjike, sidomos te disa krerë, si Zef Mala.

- Zef Mala për ne, - i thashë, - nuk është gjë tjetër veçse një provokator.

- Edhe unë atë e cilësoj kështu si ju, - më tha Miladini dhe vazhdoi: - Këtë gjë e pranuan edhe Vasil Shantoja e Qemal Stafa. Për sa u përket Anastas Lulës dhe Sadik Premtes, ju nuk gaboni aspak, ata janë trockistë, intrigantë, mundet edhe provokatorë të futur në lëvizjen komuniste shqiptare. Kam përshtypjen, shoku Enver, dhe e përsëris se ky është një mendim i parë imi, prandaj jua them personalisht juve, se Grupi i Shkodrës përveç Zef Malës e ndonjë tjetri si ai, ka shokë të mire', por ka dhe shokë komunistë me gabime që do të ndreqen.

- Pse ne të Grupit të Korçës mos vallë jemi pa gabime? ! - i ndërhyra unë, pa dashur të merrja përgjigje.

Miladini vazhdoi:

- Pashë vendosmëri tek ata. Mendoj se janë komunistë të mirë dhe se e duan komunizmin. Dua të të them se, ashtu siç bëtë ju kundër tyre, edhe ata lëshuan kritika kundër grupit tuaj. Disa ishin me vend, disa jo. Unë, dulce ditur edhe pikëpamjet tuaja, një varg kritikash ua rrëzova nëpërmjet pyetjeve që u bëra dhe ata filluan të ndryshojnë mendime. E kam fjalën për idetë e gabuara që kanë mundur të futin në këtë grup Zef Mala, Niko Xoxi dhe Anastas Lula.

Pastaj, me të qeshur, Miladini shtoi:

- Edhe te disa shokë të Grupit të Shkodrës, si edhe te disa të grupit tuaj, ka shfaqje të mendjemadhësisë e të prepotencës, që shprehen në deklarata të tilla, si «ne e tremi vijën më të drejtë», «ne nuk tremi bërë gabime, kurse të tjerët po».

- Jam i një mendimi me ju, - i thashë Miladinit. - Pikërisht këto shfaqje kanë ndikuar që të ketë pikëpamje të gabuara në vijë, që të krijohet hendeku në mes nesh.

- Shoku Enver, - m'u drejtua Miladini, - si mendoni ju personalisht për Qemalin dhe për Vasilin?

- Kam besim tek ata, - fola me bindje. - Qemali dhe Vasih janë komunistë të vendosur dhe këtë e provuan në gjë. Me ta ne, siç të thamë edhe më parë, kemi rënë dakord në parim për bashkimin e grupeve dhe mendoj se ata të dy do të jenë një mbështetje e madhe e Partisë Komuniste të Shqipërisë që do të formojmë. Nuk tram pasur rastin që t'i njoh për një kohë të gjatë dhe mirë, sepse, megjithëse e quanim veten komunistë, njëri-tjetrin e shikonim si «armiq». Por unë, personalisht, i tram simpatizuar këta të dy. Veçanërisht qëkur jam njohur drejtpërdrejt me ta, thuajse për çdo problem e kemi kuptuar dhe e kemi mbështetur njëri-tjetrin.

- Edhe Vasili, edhe Qemali, - më tha Miladini, - kanë simpati për ty, për Miha dhe për Pilon, kurse Koçon jo vetëm nuk e duan, por e bëjnë përgjegjës që nuk është arritur në një marrëveshje. Ky është mendimi që më shprehën ata, kurse unë nuk fola, nuk kisha të drejtë të jepja mendim për njerëzit.

- Shoku Miladin, përpara unitetit marksist-leninist të lëvizjes, përpara çështjes së madhe, formimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë nuk kanë vlerë një ose dy persona, - i thashë unë. - Unitetin duhet ta krijojmë, Partinë duhet medoemos ta formojmë dhe në baza të shëndosha. Unë po jua them, dhe ky është mendimi im personal, ia tram thënë edhe Koços në sy, edhe shokëve se Koçoja është komunist, por tra ca mënyra dhe disa shenja të karakterit mikroborgjez, tra ca frikë të ekspozohet, tra mendjemadhësi, është nervoz dhe do që t'i dalë e vetja, edhe kur nuk e tra drejt. Ai hiqet si udhëheqës i grupit, sepse tra qenë në Bashkimin Sovjetik, por as nuk është e as nuk punon si i tillë. Unë dhe shokët e tjerë duam dhe njohim si udhëheqës të grupit punëtorin bolshevik, Miha Lakon.

Të olla biseda të hapura e të sinqerta zhvillonim vazhdimisht me Miladinin dhe shkëmbeu mendime për të gjitha çështjet që na dilnin. U lidhëm ngushtë me të, dhe flisnim hapur me njëri-tjetrin. Një gjë na preokuponte - të përgatitnim terrenin për ditën historike.

Por, edhe kur punën thuajse po e vinim në rrugë. prapë na dilnin pengesa, vështirësi e ngatërresa nga më të ndryshmet. Jo vetëm Anastasi e Sadiku vazhdonin të pengonin bashkëpunimin midis grupeve por edhe Koçoja ynë mezi po ambientehej me këtë rrjedhë të re e revolucionare të gjërave. I mësuar t'i gjykonte punët nga lart e nga larg, frikacak e njëkohësisht megaloman, edhe i interesuar që të themelohej Partia, por edhe i trembur se e ndiente që do t'i shpëtonin frerët nga duart, edhe i ndërgjegjshëm se okupatori nuk shporrej ndryshe veçse me bashkim e me luftë të organizuar, por edhe me lepurin në bark, se mos dekonspirohej, pra, një kompleks i tërë mikroborgjezi, ai shpesh hidhej sa nga njëri qëndrim në tjetrin. Por punët nuk prisnin. Tanfi kur në mes elementëve kryesorë të Grupit të Korçës e të Shkodrës ishte arritur marrëveshja për veprimet e përbashkëta, sidomos ne që ishim vënë në balle të punës, nuk na lejohej asnjë hezitim, asnjë shmangie, nga veprimi. Duhej të shkonim bazë më bazë, të takonim shokë, të bisedonim shtruar me ta, të sheshonim mosmarrëveshjet, të përgatitnim terrenin për aksionin e madh, themelimin e Partisë. Por, tamam në këto momente deoizive, kishte raste kur Koçoja nuk na dilte fare në takim, na fshihej. Shkoja vetëm, me Pilon, me Vasilin (një herë bile më ndodhi që isha edhe me Miladinin) dhe e kërkoja. Dilte Pavlina:

- Nuk është Koçoja, - më thoshte.

- Ku ka shkuar?

- Nuk e di, - thoshte ajo, dulce u skuqur e ngatërruar sa dukej sheshit që gënjente.

- Hajde Pavlinë, - i thosha me të urtë, thuaji Koços se kemi ardhur, - dhe hynim brenda. E gjenim Koçon me pantofla, në divan.

- Mor po na rruat konspiracioni, - thoshte "si për të na tërhequr vërejtjen. - Si hyni kështu, në dasmë vini? S'ka lezet fare!

- Kemi dasmën e madhe, përpara, Koço, - i thosha. - Ngrehu se kemi këtë e atë për të bere'. . .

Ne, si grup, nga ana jonë, bëmë një numër takimesh pune dhe u përgatitëm mirë për Mbledhjen e madhe që do të zhvillohej në mes përfaqësuesve, të të tri grupeve komuniste, ku do të merrnin pjesë edhe shoku Miladin me Dushanin.

Vendosëm të shtronim,, në radhë të pare e mbi të gjitha, çështjen që dita e parë e Mbledhjes duhej të konsiderohej si dita historike e shkrirjes së grupeve dhe e Themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, kurse diskutimet, dulce, u nisur nga kjo bazë, mundet dhe duhej të vazhdonin sa të ishte nevoja, sa të sqaroheshin të gjitha problemet dhe mosmarrëveshjet që ekzistonin. Unë u ndala fort në këtë çështje, sepse isha i bindur se nuk duhej vajtur në një mbledhje të përbashkët pa qenë t-ë vendosur për një qëllim të madh, që ishte shkrirja e grupeve dhe formimi i Partisë Komuniste.

Ne, nuk duhet të lejojmë si për veten tonë, ashtu edhe për të tjerët, u thashë shokëve,, të shkojmë në këtë Mbledhje vetëm për të akuzuar e për t'u grindur, por duhet të shkojmë atje për të konkluduar.

Propozova që t'i kërkonim Miladinin të mente edhe aprovimin e të tjerëve për çështjexi që Mbledhja, qysh në fillim, të merrte në parim vendimin për Themelimin e Partisë Komuniste të

Shqipërisë, pastaj le të vazhdonim diskutimet dhe debatet si anëtarë të një partie të formuar. Ky vendim ishte i nevojshëm, sepse nga grupet e tjera do të kishte elementë që nuk e, donin formimin e Partisë, sidomos njerëz si Anastas Lula dhe Sadik Premtja, por, mundet, edhe të tjerë. Si trockistë, ata ishin kundër këtij organizimi, prandaj atyre u leverdiste që të vazhdonte të thellohej përçarja. Të gjithë shokët u bashkuan me propozimin.

Çështja e dytë që vendosëm në grup ishte mënyra e paraqitjes së problemeve. Diskutuam që ne duhej të

mbronim, në frymë me të vërtetë komuniste dhe jo në frymë grupi, vijën e drejtë politiko-ideologjike dhe organizative të Grupit të Korçës, të njihnim dobësitë në punën tonë dhe të prananim kritikën e drejtë që do të na bënin të tjerët, t'i prananim pa u nxehur, pa u nevrikosur. Për çdo kritikë që do të na bëhej, do të konsultoheshim me njëri-tjetrin dhe do të mbanim qëndrim. Ne duhej të kritikonim fort e pa asnjë lëkundje të gjitha pikëpamjet antimarksiste, trockiste, likuidatore të të gjitha grupeve dhe të kërkojmë që kishin luajtur një rol armiqësor në lëvizjen komuniste shqiptare, siç ishin arqiomarksisti Aristidh Qendro, arqiomarksisti, zjarristi e provokatori Andrea Zisi ashtu edhe shoku e miku i tyre, agjenti i Zogut, trockisti Zef Mala me shokë, si Niko Xoxi dhe elementë të tjerë të këtij kallëpi, si Anastas Lula me Sadik Premtën.

- Këtu, - ndërhyra unë, - nuk duhet lejuar asnjë lëshim, asnjë dorashkë, asnjë fije «diplomacie»•. Uniteti i vërtetë do të arrihet vetëm duke i demaskuar deri në fund parimet e tyre trockiste, likuidatore, antikomuniste.

Shokët në diskutimet e tyre ishin plotësisht dakord edhe me këtë linjë qëndrimi e veprimi.

Tash shtrohej çështja se kush do t'i parashtronte këto pikëpamje. Të them të drejtën, mua nuk më ishte mbushur mendja se Koço Tashkoja do ta bënte si duhej një gjë të tillë, sepse ai ishte nevrik. Kundër elementëve trockistë mendoja se ishte i ashpër, por kisha frikë se Qorri që ia dinte huqet Koços, do, s'do, do ta provokonte, dhe ky, duke mos e mbajtur dot gjakftohtësinë, do t'i fuste të gjithë në një thes e do të na prishte punë. Nga ana tjetër, gjatë bashkëpunimit me Koçon, kisha konstatuar se ai mjaft herë, në biseda e në diskutime e humbiste fillin e mendimeve dhe qëndronte si i hutuar. Gjithashtu, ai nuk kishte vazhdimësi në idetë. Edhe Miladini më kishte bërë të ditur që nuk kishin simpati për Koçon dhe e bënin atë përgjegjës për përçarjet dhe grindjet. Sa për shokët e Grupit të Shkodrës, në një bisedë që patëm me ta, na thanë se Koço Tashkoja mund të mente, pjesë në Mbledhjen c- grupeve, si një nga drejtuesit e Grupit të Korçës, por nuk pranonin që ai të hiqej në mbledhje si i «dërguar i Kominternit», siç pretendonte Koçoja.

Mirëpo në të gjitha këto analiza e biseda që bënim në grup ishte, i pranishëm edhe Koçoja, kështu që s'që e lehtë, po të kihet parasysh kompleksi i tij, që t'i thoshim: «S'do të flasësh ti, se na prish punë, në vend që të ndreqësh». Por kjo duhej arritur patjetër, natyrisht me kujdes. Mendova mirë e në mes të diskutimeve, u thashë shokëve

- Unë propozoj të vijë Miha të udhëheqë paraqitjen e pikëpamjeve dhe të diskutimeve nga ana jonë, ndërsa ne të tjerët ta ndihmojmë atë dhe ta ushqejmë Mbledhjen me diskutimet tona.

-- Dakord, të vijë Miha, shok i mirë është dhe i takon se ka qenë në krye, - tha Koçoja me një zë të rrumbullakosur, - por, si të vijë se?! Është sëmure shumë, i ziu!

- Në qoftë se Miha nuk do të vijë dot, - shpreha menjëherë mendimin, - propozoj të ngarkohet me këtë detyrë shoku Pilo, si një nga shokët tanë komunistë më të vjetër dhe punëtor, kovaç.

Piloja, me thjeshtësinë e tij të zakonshme, u ngrit e tha:

- Jo, unë nuk mund ta bëj dot këtë punë, se më duket e vështirë, por propozoj që ta udhëheqë Enveri, kurse unë dhe shokët e tjerë që do të caktojmë, se duhet caktuar edhe sa veta për çdo grup do të marrin pjesë në Mbledhje, do t'i qëndrojmë pranë Enverit me këshilla e me ndërhyrjet tona në diskutime

Shokët e tjerë e mbështetën propozimin e Pilos. Koço Tashkoja, sigurisht, dëshironte që edhe në Mbledhje të ishte ai në krye, prandaj, kur u diskutua çështja se kush do të fliste, në emër të grupit, shokët mundën ta mposhtin rezistencën dhe pakënaqësinë e tij. Kjo nuk ishte ndonjë çështje parimore, por, siç thashë edhe më lart, një sërë arsyesh na bënë ne që të mos lejonim të fliste ai. Sé pari, grupet e tjera nuk e donin Koçon, pastaj edhe ne, e krejt baza e Grupit të Korçës, ia dinim

huqet. Ai rrëmbehej shpejt, donte t'i shkonte, gjithnjë e vetja dhe çdo vërejtje apo akuzë të të tjerëve e merrte si një ofendim ndaj personit të vet, që, padrejtësisht, e vinte mbi gjithë të tjerët. Prandaj shokët vendosën që në këtë Mbledhje unë të parashtroja pikëpamjet dhe propozimet e Grupit të Korçës.

Menjëherë pas kësaj unë iu vura punës në mënyrë sistematike. Krahas përgatitjeve për Mbledhjen e vura Mihan në korant për të gjitha ato që vendosëm në takimin me, shokët e grupit në Tiranë. Ndonëse kjo degë tani ishte bërë qendra e krejt grupit, prapëseprapë me shokët në Korçë, e veçanërisht me Mihan, mbanim lidhje vazhdimisht. Njoftova edhe Miladinin për vendimin tonë kryesor mbi procedurën e Mbledhjes, që përmenda më lart. Ai u kënaq dhe më tha:

- Është një vendim shumë i drejtë, që do t'i vërë përnjëherë pjesëmarrësit e Mbledhjes përpara një përgjegjësie të madhe e historike,. Duke vendosur më parë krijimin e Partisë, siç propozoni ju, nuk do të bëhen më diskutime si në «çarshi» (pazar) dhe qoshe ve të rrugëve, por si komunistë, si anëtarë të partisë, që kërkon analiza serioze e të drejta, që kërkon autokritikë dhe kritikë bolsheviken që kërkon disiplinë të çeliktë. Unë e përshëndes këtë vendim dhe mendoj, megjithëse është puna juaj, - theksoi Miladini, - që ta marrësh ti fjalën i pari dhe, midis të tjerash, të propozosh kryesoren, marrjen që në fillim, në parim, të vendimit për shkrirjen e grupeve dhe formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

- Kështu e kemi vendosur në këtë çështje, i thashë.

- Kjo më kënaq, - u shpreh ai i gëzuar. - Unë kam bindjen se shokët e Grupit të Shkodrës do ta pranojnë këtë pa diskutim, kurse për Anastas Lulën nuk ju siguroj asgjë, vetëm ju siguroj se ai dhe Xhepi janë dinakë, trockistë.

- Të tillë kanë qenë e, janë, shoku Miladin, i thashë, - dhe jam i bindur se në Mbledhje, ashtu si edhe sot e më parë do të na pengojnë me të gjitha forcat. Por mendoj se po të jemi në baza të shëndosha ne dhe shokët e Shkodrës, Anastasi e Sadiku s'kanë ç'na bëjnë.

- Po ju them, shoku Enver, - më tha Miladini, - se me shokët e Grupit të Shkodrës puna po ecën mirë. Ata kanë pranuar shumë gabime të tyre, politike dhe ideologjike, megjithëse lëkundën disa herë, por përpara interesit të madh, në përgjithësi, ata binden. Kurse, me Anastasin dhe me Xhepin ka vështirësi të mëdha. Këta nuk janë në rrugën komuniste, por edhe në mes elementëve të Grupit të «Të Rinjve» ka njerëz të arsyeshëm. Njëri nga këta, me të cilin më kanë njohur, është Ramadan Çitaku, me pseudonimin «Baca». Ai di edhe serbisht. Ramadani më ka vënë në dijeni se shokët e këtij grupi nuk janë të gjithë si Anastasi dhe si Xhepi, por vetëm fryma e mbyllur sektare i mban të lidhur me ta. Kjo do të jetë inkurajuese, në qoftë se është kështu.

I thashë gjithashtu Miladinit se ne kishim menduar që Mbledhjen ta bënim më 8 nëntor dhe çdo grup të përfaqësohej në mënyrë të barabartë me nga 5 veta secili.

Ideja që Mbledhja të fillonte më 8 nëntor 1941 nuk ishte zgjedhje e rastit e një date çfarëdo. Pasi ne, në grupin tonë vendosëm që në fillim të Mbledhjes së përbashkët të krijohej Partia e pastaj të nisnin diskutimet, menduam se edhe data që do të shënonte Themelimin të qe një datë e shënuar.

Periudha kur i bënim këto diskutime ishte ajo e tetorit 1941 dhe përpara kishim vërtet data të shënuara, kishim 7 Nëntorin dhe 28 Nëntorin. Nuk mbaj mend mirë kush, por Koço Tashkoja ose Pilo Peristeri shfaqën mendimin që Mbledhjen ta fillonim më 7 nëntor dhe po atë ditë të themelohej edhe Partia. Arsyet që u paraqitën qenë vërtet të rëndësishme dhe të kuptueshme. 7 Nëntori ishte për të gjithë ne, si për gjithë komunistët, proletarët dhe popujt e botës një datë e shtrenjtë dhe frymëzuese. Në diskutime shfaqta dhe unë mendimin tim

- 7 Nëntori, - u thashë shokëve, - është data historike e Revolucionit të Madh të Tetorit, data që shënon lindjen e socializmit. Të vendosim Themelimin e Partisë sonë atë ditë, do të thotë që Partia jonë do të jetë një parti e revolucionit të tipit Lenin-Stalin, do jetë pasuese e Partisë Bolshevike të Leninit e të Stalinit dhe ashtu si ajo do të luftojë për të udhëhequr popullin tonë në luftën për liri e pavarësi kombëtare e, pastaj, drejt socializmit. Në këtë kuptim unë jam dakord me propozimin e shokëve. Por, kisha diçka për të shtuar, - u thashë dhe vazhdova:

- Dita e lindjes së Partisë sonë do të jetë e shtrenjtë dhe historike për ne e brezat që do të vijnë, ashtu siç është e do të jetë edhe dita e madhe e 7 Nëntorit. Do t'i kujtojmë e do t'i festojmë këto ditë

si ndër ngjarjet më të shënuara. Padashur, shokë, unë thashë «këto ditë», por më duket se kështu duhet thënë vërtet. Sepse, megjithëse të dyja janë e do të jenë historike, megjithëse të dyja do të jenë të lidhura pazgjydhmërisht me njëra-tjetrën, prapë, secila ka vendin e saj, rëndësinë e saj në histori. Prandaj shokë unë propozoj

Sikur të bëjmë një ndryshim fare të vogël në datat, sikur Themelimin e Partisë sonë ta vendosim një ditë më pas, më 8 nëntor, a nuk do të qe më drejt? Kuptohet, shokë, - u thashë, - vlerën dhe forcën Partisë do t'ia japin anëtarët e saj, ne, komunistët shqiptarë dhe, në këtë aspekt, s'ka asnjë rëndësi parimore nëse data e Themelimit do të jetë në tetor, në nëntor apo kurdo qoftë. Kryesorja është ta themelojmë Partinë sa më shpejt. Por, gjersa jemi në prag të nëntorit dhe e kemi ne në dorë caktimin e ditës së Themelimit, unë propozoj 8 nëntorin.

Shokët e aprovuan njëzëri propozimin tim. Ia thashë të gjitha këto edhe Miladinit e shtova:

- Të lutem, ua propozoj këtë dëshirë të grupit tonë shokëve të grupeve të tjera dhe, në rast se nuk kanë kundërshtim, e vendosim përfundimisht. Ne, nga ana jonë, jemi gati.

Nuk vonoi dhe Miladini më lajmëroi se pranohej propozimi i bërë nga grupi ynë, për datën e fillimit të Mbledhjes së Grupeve Komuniste për të formuar Partinë Komuniste të Shqipërisë. Vasili e Qemali na propozuan që Mbledhja të bëhej në shtëpinë e Xhemal e Zylfije Canit, anëtarë të Grupit Komunist të Shkodrës.

Shkova me dy-tre shokë dhe e pamë shtëpinë, studiuam pozicionet e saj, rrugët e rrugicat rrotull, bazat ilegale afër. Propozimi i shokëve të Shkodrës na u duk me vend dhe ramë dakord që të mblidheshim atje. Ndërkohë filluam përgatitjen e shtëpisë. Ne caktuam, me sa mbaj mend, Pilon, shokët e Grupit të Shkodrës, më duket, Kristo Themelkon, që në profesion ishte marangoz, dhe për disa ditë me radhë ata bënë disa rregullime e sistemime të nevojshme. Me sa më kujtohet ato ditë u hap edhe një deriçkë sekrete mbrapa, të cilën do ta përdornim në rast të ndonjë bastisjeje apo culmi të papritur të fashistëve. U bë dhe një shkallë druri që lidhte dhomën ku do të punonim me dhomat e katit të sipërm ku do të flinim. Kjo duhej, se, përndryshe, për t'u ngjitur lart, do të duhej të ngjiteshim .nga shkallët e jashtme dhe mund të na diktonin. Porositëm të zotët e shtëpisë që edhe në rast kontrolli ose edhe po të pyeste ndonjë mik, mund t'u thuhej se «kështu e kemi gjetur... dhe na bën punë. Pse të dalim dimrit jashtë, në të ftohtë e në shi?». Gjithashtu nën dyshtet me dërrasa të dhomës ku do të flinim u bë një vend për të fshehur dokumentet, në rast kontrolli të papritur. Disa ditë para se të fillonte Mbledhja, dy-tre shokë në konspiracion të rreptë e thujse pa u dukur kontrollonin çdo lëvizje rrotull shtëpisë e në rrugicat përreth. Ishim në luftë, ishim para ngjarjes së madhe, vigjilenca e kujdesi duhej të qenë në kulm. Ndonëse bashkëpunimi midis anëtarëve të grupeve tashmë kishte filluar e po zgjerohej, prapë bënë kujdes që të mos binim në ndonjë provokacion apo punë sabotuese të elementëve me prirje grupazhi. Sidomos Anastas Lulës e Sadik Premtes u ruheshim. Por, me ç'shihej, hëpërhë, ata kishin ulur kokën e dukej se qenë për të ardhur në Mbledhje.

Të gjithë po përgatiteshim për këtë ditë që do të shënonte ngjarjen më të madhe historike për popullin tonë. Shumë nga ne rronin në ilegalitet, sepse kudo vepronte reaksioni i tërbuar, por punën që kishim nisur e vazhdonim me një optimizëm të ri, me një shpresë të madhe që na i shumëfishonte forcat.

Edhe pse terrori bëhej gjithnjë e më i egër, lufta jonë popullore qe zgjeruar. Qenë zgjeruar demonstratat, grevat, hedhja e trakteve, goditjet me armë kundër okupatorëve dhe kundër kuislingëve.

Po afrohej 28 tetori, data e «Marcia su Roma» njëkohësisht dhe dita kur më 1940 populli grek u sulmua nga fashistët italianë, sulm të cilin një vit më parë e demaskuam duke vënë edhe trakte nëpër rrugë. Vendosëm që më 28 tetor të vitit 1941, të organi zonim një demonstratë të madhe kundër pushtuesve dhe qeverisë kuislinge të Vërlacit. Grupi ynë propozoi të bënim një aksion të madh të përbashkët me grupet e tjera, ku të merrte pjesë gjerësisht populli, rinia dhe në ballë të tyre të viheshin anëtarë nga të gjitha grupet komuniste. Shokët e grupit më autorizuan të takohesha me Vasil Shantoaz e me Anasta. Lulën dhe të mblidhnim «komisionin e aksionit» (pë? të cilin në parim kishim vendosur, por që nuk e kishim mblidhur asnjëherë). Kur u fola për demonstratën që duhej të

organizonim, Vasili më dha aprovimin pa hezituat fare, kurse Qorri, duke u përtypur, tha të mblidhnim komisionin dhe aty të diskutonim.

Mbledhëm komisionin. Në mbledhje ishin Vasil Shantoja, Anastas Lula, Mustafa Gjinishi, Mustafa Kaçaçi dhe Hasan Reçi. Bëra propozimin dhe filluan diskutimet. Vasili dhe Mustafa Kaçaçi e aprovuan menjëherë propozimin për kryerjen e aksionit. Edhe Mustafa Gjinishi ishte pro, por u shpreh se «duhet të kemi kujdes, se mos na qëllonjë» etj. Hasan Reçi, si një bullafiq dembel, s'vendoste dot, kurse Anastasi hezitonte. Ai me siguri ishte kundër, por nuk e thoshte dot. Vendosëm të bëhej demonstrata dhe të fillonte nga kinemaja «Rex»¹, ku fashistët do të mbanin fjalimin e rastit. Kinemanë do ta mbushnim plot me njerëzit tanë, të cilët, me t'u hapur mbledhja, do të fillonin të hidhnin parullat: «Poshtë fashizmi!» etj., do të thyenin fronat dhe do të dilnin nëpër rrugë, duke bërë titur me parulla antifashiste e duke kënduar këngë patriotike. Jashtë do të prisnin shokë të tjerë dhe patriotë. U vendos që secili grup të bënte punën e vet për të shkuar në demonstratë si një trup i vetëm, dhe u ndamë. Sa dolëm nga komisioni, Anastas Lula, siç e morëm vesh më vonë, kishte takuar Xhepin, që e priste, dhe i kishte thënë:

- Lajmëro shokët se u vendos që demonstrata të mos bëhet.

Por këta nuk mundën ta pengojnë demonstratën, as të pengojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit të tyre.

Kjo ishte në vazhden e punës përçarëse e sabotuese të këtyre elementëve të kamufluar armiq, të cilët, si në këtë periudhë, ashtu edhe më përpara e pas Themelimit të Partisë, na nxorën pengesa e vështirësi të panumërta e serioze.

Fakt është se në këtë periudhë ata u duk sikur e përkrahën idenë e bashkëpunimit midis grupeve dhe ranë dakord që të merrnin pjesë në Mbledhjen The meluese e në veprimet e përbashkëta që u kryen në prag të kësaj ngjarjeje. Arsyet për këtë janë të shumta e të njohura, por një gjë duhet të theksoj : Anastas Lula e Sadik Premtja «u bashkuan» me ne jo se kishin në ndërgjegjen e tyre ndonjë fije komunizmi, jo se u dhimbsej atdheu, që vuante në robëri, e as se i preokuponte çështja e luftës së popullit tonë. Përkundrazi, ata u bënë bisht këtyre problemeve kardinale. Por rrethanat, situata i detyroi të vepronin ashtu siç vepruan. Në radhë të parë, ishte baza e grupit të tyre, komunistët e shëndoshë dhe gjithë të rinjtë revolucionarë që kishin në vartësi, ata që në mënyrë të vetvetishme, nën ndikimin e ngjarjeve, të komunistëve e të simpatizantëve të grupeve të tjera, u bashkuan me idenë e veprimeve të përbashkëta dhe me idenë e krijimit sa më shpejt të Partisë. Anastas Lula e Sadik Premtja në atë periudhë e ndien se do të flakeshin tej nga vetë baza e grupit, nëse s'do të bashkoheshin me rrymën. Ndaj u bashkuan, por, për fat të keq, u bashkuan si diversionistë. Kjo do të provohej shumë shpejt.

Nga ana tjetër, një punë të madhe për afrimin e tyre me idenë e bashkëpunimit e të krijimit të Partisë luajtën shokët e Grupit të Shkodrës. Siç dihet, këto dy grupe, ai i Shkodrës dhe i «Té Rinjve», kishin arritur në marrëveshje, por, nëse në fillim ky bashkëpunim qe mbi baza të shtrembra e antimarksiste, më pas, sidomos nga gjysma e dytë e vitit 1941, Grupi i Shkodrës, krahas përmirësimit e shëndoshjes së gjendjes së vet, ndikoi që edhe baza e Grupit të «Té Rinjve» ta shihte më qartë perspektivën. Në vjeshtën e vitit 1941, veçanërisht në tetor, nga kjo punë edhe Anastas Lula e Sadik Premtja e panë se s'duhej të rrinin mënjane. Këtu luajti rolin e vet edhe puna e shokut tonë, Miladin Popoviçit, i cili në atë periudhë u takua mjaft herë me shokë të Grupit të «Té Rinjve», e ndër ta, edhe me Anastas Lulën e Sadik Premten.

Kështu këta dy elementë erdhën në idenë e përbashkët të krijimit të Partisë, por erdhën nga zori, ngaqë s'kishin si bënë ndryshe, por edhe me qëllime të errëta e sabotuese.

Pjesë e këtyre qëllimeve ishte edhe përpjekja e tyre për të sabotuar demonstratën e madhe të 28 tetorit 1941. Por as në këtë rast përpjekjet e tyre nuk patën sukses.

Demonstrata u bë e madhe, e fuqishme, e furishme, ashtu siç e kishim parashikuar. U përleshëm e u gjakosëm me karabinierinë dhe me milicinë fashiste. Demonstrata pati një jehonë jashtëzakonisht të madhe, ajo u bë gur prove për bashkimin e komunistëve shqiptarë dhe tregoi forcën e pashtershme të popullit tonë, urrejtjen dhe vendosmërisë e tij për luftë kundër fashizmit e kuislingëve.

Gjithë kjo rezistencë që po ngrihej, e udhëhequr nga komunistët, demaskimi që po u bëhej okupatorit dhe veglave të tij, ia kishin nxjerrë bojën qeverisë kuislinge të Vërlacit. Tashmë Italisë fashiste i duhej një dorë më e fortë, një kriminel i regjur e 'i sprovuar për të shtypur popullin, për të «shfarosur komunistët» dhe patriotët në masë, për të bërë demagogji jo më nga pozita «feudale dhe antifshatare» me figurën e Vërlacit, por nga pozitat «nacionaliste e demokrate». Dhe Italia fashiste e gjeti këtë dorë kriminale në figurën e Mustafa Merlikës (Krujës), të cilin, një muaj më vonë, e emëroi kryeministër, në vend të Vërlacit të rrëzuar.

Ky kuisling barbar, me cilësinë e senatorit fashist ishte shquar për urrejtje dhe qëndrime të tërbuara kundër komunistëve dhe popullit, si dhe për spekulimin me ndjenjat patriotike të shqiptarëve të Kosovës, për të zhvatur pasuritë e popullit kosovar në dobi të borgjezisë tregtare fashiste shqiptare, që po krijohej, për të forcuar shfrytëzimin e shoqërive zvatëse italiane që spekulonin në kurrizin e gjithë popullit shqiptar. Mustafa Kruja, në bisedime të padeklaruar dhe në konferenca nëpër kinematë, kërcënonte komunistët me plumba dhe u bënte thirrje për bashkëpunim «nacionalistëve demokratë» të tipit të Ali Këlcyrës me shokë, që me kohë hanin në grazhdin italian. Si kryeministër, Mustafa Kruja do të mbushte burgjet me shokët tanë e me patriotë, do të varte dhe do të vriste, do të shtonte milicinë fashiste dhe do ta bënte këtë mashë të milicisë fashiste italiane. Por rezistenca e lufta jonë po merrnin flakë. Këtë e vërtetoi edhe demonstrata e fuqishme e 28 tetorit 1941, të cilën e organizuan dhe e udhëhoqën komunistët shqiptarë.

Që të nesërmen u detyrova të hidhesha në ilegalitet. Ka edhe kjo historinë e vet.

Në mëngjesin e 29 tetorit në «Flora» ia behën karabinierët. Dy prej tyre, krekosur me rripa meshini kryq e tërthor krahërorit e me këllëfët e revolverëve të hapur, hynë brenda, të tjerët qëndruan jashtë. Vetëm ato çaste e ndiem se ç'gabim të madh kishim bërë. Kishim menduar se në rrëmujën e madhe të përleshjes së djeshme, në mes atyre qindra e mijëra demonstruesve që tundën Tiranën, fashistët nuk na kishin identifikuar. E ja ku tani, thuajse të gjithë ne «punëtorët» e «Florës» ndodheshim përpara çarkut të tmerrshëm.

- Enver Hoxha! - thirri njëri nga karabinierët. - *Dove è Enver Hoxha?!*

Pilos e Ilo Dardhës, që ndodheshin në banak, u ngrinë pecetat në duar. Pasi një çast heshtjeje, por unë ndërkaq e mblodha veten dhe, që nga arka e «pronarit ortak», zgjata kokën e gjithë «xhentilecë» provova të vetmen mundësi që mund të provohej:

- Ja, këtu brenda është, prisni, ju lutem, ta lajmëroj, - u thashë me zë të qetë e me gjeste të një «gatishmërie» kaq shembullore, sikur mezi prisja rastin t'u bëja pepinove një shërbim të çmuar!

Kisha goditur në shenjë. Më besuan. Hyra në pjesën e brendshme të dyqanit, duke thirrur me zë të lartë, «Enver, të kërkoni», hapa me shpejtësi deriçkën e pasme, të çelur apostafat për raste të tilla, u lëshova në një rrugicë të ngushtë, kapërceva në oborrin e një plake të vetmuar dhe prej andej, duke i rënë mes për mes «lagjes së çobanëve», përshkova «i qetë», por me sytë katër bulevardin e madh. Pas disc çastesh kur hyra në lagjen popullore, matanë bulevardit, u binda se fashistëve vetëm emri u kishte m'betur në duar.

I dhashë lamtumirën «Florës» së shtrenjtë, dyqankës sonë modeste, ku për afro dy vjet me radhë legalisht shitnim cigare e sallame, kurse ilegalisht përgatiteshim për revolucionin. Një dyqan i vogël ishte «Flora», me mure prej tulle e qerpiç, por brenda atyre mureve ne,, një grusht djemsh të popullit, mblidheshim kokë më kokë e diskutonim me zjarr për punët tona komuniste, raportonim ç'kishim arritur e përpunonim planet për një punë më të madhe e më të frytshme; atje sheshuam një sërë mosmarrëveshjesh me shokët e grupeve, të tjera komuniste; që andej niseshim me trakte e me misione në çdo cep të k~yeqytetit e në qendra të tjera të vendit. Atje isha takuar me, shokët e mi të paharruar, me patriotë e revolucionarë, me Vasil Shanton, me Qemalin, me Miston, me Mihalini, me Dullë Ketën e me dhjetëra djem e vajza të tjera të popullit.

E, ja, tani më duhej të ndahesha prej saj, më duhej t'i jepja fund «legalitetit» tim. Por nuk më erdhi keq për këtë ndarje. Ajo, në njërën ose në tjetrën mënyrë, do të vinte shumë ahpejt, sepse po dukej se vaia e kryengritjes popullore po ngrihej dhe ora për vendimin e madh po afrohej. E vetmja gjë që më mbajti në ankth e në shqetësim gjithë atë ditë ishte fati i shokëve. Por, në mbrëmje vonë, në

bazën ilegale ku isha vendosur, brofa në këmbë gjithë gëzim, kur pashë Pilon të hynte. Ishte gjithë qejf.

- Ama të punuar, - tha. - Ua le bajgat pepinove, - dhe më shpjegoi fill e për pe, rrëmujën e zemërimit e karabinierëve kur e kishin kuptuar se ç'u kishte ndodhur. Shokëve tanë për fat nuk u kishin bërë asgjë. Si duket emrat e tyre nuk qenë futur akoma në listat e, kuesturës fashiste. Filluam menjëherë nga puna. Koha nuk priste, përpara ishte 8 nëntori.

Themelimi

Atë natë që do të gdhihej data 8 nëntor ne u drejtua për në shtëpinë e vogël që po na priste. Në këto kujtime nuk do ta përkruaj atë, sepse shtëpia ku u Themelua Partia Komuniste e Shqipërisë tash është bërë një monument i shquar i vendit tonë, të cilin e njohin i madh e i vogël në Shqipëri, si edhe mijëra e mijëra miq, shokë e vizitorë të huaj. Anëmbanë rrugicat qenë siguruar me shokë të armatosur, të vendosur e të qetë. Që më parë ishin bërë hetime të kujdesshme për të gjitha familjet rreth e rrotull shtëpisë. Ato ishin familje të varfra, punëtorësh, çirakësh dhe patriotësh.

Në errësirën e natës u futëm në shtëpinë e vogël një nga një, me rregull e në heshtje. Të gjitha dritaret ishin mbuluar nga brenda me batanije. Nuk dukej asnjë dritë. Nuk ndihej asnjë zhurmë. Ilegalitet i plotë. Hymë në shtëpinë e vogël me shpresa të mëdha, me një gëzim dhe me një besim të papërkruar por, ta themi hapur, ashtu siç e ndienim, të gjitha këto i mbulonte një cipë ankthi. Me siguri secili prej nesh, që po vinte aty me dëshirën e madhe të krijimit të Partisë, thoshte me vete: - «Si do të shkojë puna? A do t'ia arrijmë qëllimit të shenjtë?». Atje gjetëm Miladinin, Dushanin, Vasihn dhe Qemalin. U përqaftuam me shokët jugosllavë dhe me të tjerët. Por, të them të drejtën, me shokët e Grupit të Shkodrës përqaftimi që më shumë se i zakonshëm. Kur exdhën krerët e Grupit të «Të Rinjve», takimi që i ftohtë, por pa shenjë armiqësie.

U mbledhëm të gjithë. Nga grupi ynë, për të marrë pjesë në Mbledhje, qenë caktuar: Koço Tashkoja, Pilo Peristeri, Enver Hoxha, Koçi Xoxe dhe Sotir Vullkani. Kishim ardhur të gjithë me përjashtim të Koçi Xoxes, të cilin disa ditë më parë e, kishim dërguar në Korçë që të vinte në dijeni Mihan dhe shokët e atjeshëm mbi platformën që kishim vendosur të ndiqnim në Mbledhjen Themeluese, si dhe për të dhënë udhëzimet e fundit rreth një demonstratë të madhe që kishim vendosur të organizohej në Korçë më 8 nëntor. Nga Grupi i Shkodrës ishin të pranishëm Qemal Stafa, Vasil Shantoja, Kristo Themelkoja, Tuk Jakova, kurse nga Grupi i «Të Rinjve» ishin të pranishëm Ramadan Citaku, Anastas Lula, Sadik Premtja dhe një shok kosovar. Në shtëpi komandonin Vasil Shantoja e Piloja. Ata na caktuan rregullat që duhej t'i zbatonim me disiplinë të hekurt: Nuk do të flitej me zë të fortë as ditën, as natën; ditën asnjëri nuk mural të nxirrte kokën as në dritare, as te dera, as në oborr. Përgatitja e ushqimit do të bëhej tek oxhaku i dhomës së Mbledhjes nga Vasili me ndihmën e Pilos, Xhemali dhe Zylfija, si njerëz të shtëpisë, mund të hynin e të dilnin sipas nevojës, por pa ndryshuar zakonet, që të mos binin as në sy të fqinjëve. Në hajatin e vogël dhe në dhomën tjetër të katit të poshtëm do të hanim bukën, do të bënim edhe pushim. Në atë dhomë disa edhe mund të flinin, por fjetja do të bëhej kryesisht në dy dhomat e, katit të sipërm dhe në divanin e vogël midis tyre. Të gjithë do të flinin përdhe, njëri në krah të tjetrit. Në dhomat sipër do të ngjiteshim vetëm nga shkalla prej druri që lidhte dhomën e Mbledhjes poshtë me katin e sipërm dhe, jo nga shkallët e jashtme.

Këtë «regjim» e zbatuam gjatë gjithë kohës së Mbledhjes. Kur shkuam të flinim sipër, Vasili na coi në atë dhomë e cila ka edhe një dritare që bie në kopsht nga ana e lindjes. Në rast rreziku dhe rrethimi, ne do të dilnim nga kjo dritare, duke, çarë edhe me luftë, po ta kërkonte rasti, do të kapërcenim nga kopshti dhe prej tij do të kalonim në një kopsht tjetër që të nxirrte në një shesh, ku ndodhej një shtëpi që ishte bazë jona, dera e së cilës do të qëndronte e hapur që të futeshin shokët. Në qoftë se, s'do të kishte rrethim, mund të kalohej në rrugicë, ku porta e parë dhe e katërta qenë bazat tona. Në to mund të hynim brenda derisa të kalonte rreziku.

Natyrisht, atë natë historike ne thuajse s'fjetëm fare. Miladini na fliste për luftën e, partizanëve jugosllavë, na tregonte si e kishin organizuar ata partinë dhe komitetet e saj. Ne e dëgjonim me

kujdes. Më të çelur e më të çlirët qëndronin Piloja me Vasilin, si punëtorë që ishin; ata bënë shaka dhe qeshnin. Këtë atmosferë na e komunikuan edhe neve që rriakoma si të ngrirë. Qemali filloi edhe ai me të qeshur, pse kishte humor dhe me spec. Si kurdoherë, me të qeshur, tha:

- Erdhi dita, Koço, të takohemi e të bisedojmë si komunistë, kurse deri dje mund të të haja të gjallë edhe ty, po edhe Anastasin.

Po me të qeshur ia prita dhe unë, duke i thënë:

- Qemal, do të vuaje nga stomaku, pse shihi ç'lëkurë kanë, si zor të treten.

Qeshëm të gjithë, por Koçoja me Anastasin qeshën «thartë». Pastaj kërcëu Tuk Jakova dhe i tha Qemalit

- E ke me vete mandolinën Via marrim një këngë?

- Pse, për të bërë serenata kemi ardhur këtu? ia preu Qemali.

- S'ka këngë këtu, - ndërhyri Koçoja.

- Me zë fare të ulët edhe mund të ketë, - thashë unë, - po më mirë të pyesim furrxhiun.

- Nuk lejohet as me zë të ulët, - u përgjigj Vasili.

- Po kur të formojmë Partinë, - i thashë, do të na ndalosh të këndojmë Internacionalen?

- Atëherë jo vetëm që do ta këndojmë, - tha Vasil Shantoja, - por edhe, me zë të fortë, që ta dëgjojë gjithë Shqipëria.

Një gëzim i madh shkëlqeu fytyrat e të gjithëve ne, përveç fytyrave të errëta, të rrudhura e të ngrira si natë dimri të Anastas Lulës dhe të Sadik Premtes.

Më 8 nëntor 1941 filloi Mbledhja e parë e përfaqësuesve, të të tri grupeve komuniste.

Si grupit më veteran e më të madh në lëvizjen e gjeratëhershme komuniste në Shqipëri, nderi për të çelur Mbledhjen Themeluese i takoi Grupit të Korçës.

Siç kam shënuar më parë, grupi më kishte ngjarliuar mua të flisja. U ngrita në këmbë:

- Shokë, - fillova, - është një gëzim e një nder i madh për Grupin tonë të Korçës, dhe për mua personalisht, që na u dha fjala të parëve.

Isha krejt i emocionuar, por pak nga pak «makina» u ndez.

- Në fillim, - shqiptova, - ftoj mbledhjen të nderojmë kujtimin e të gjithë shokëve komunistë dhe luftëtarëve të tjerë trima, shqiptarë e të huaj, që kanë rënë e po bien në fushën e nderit duke luftuar kundër fashizmit për lirinë e popujve; të nderojmë kujtimin e Ali Kelmendit, të Mujo Ulqinakut e të bij ve të thjeshtë të popullit tonë që u vunë pushkën pushtuesve fashistë; të nderojmë kujtimin e heronjve të Luftës së Spanjës, të heronjve të Bashkimit të madh Sovjetik që japin jetën në luftën për çlirimin kundër bishës naziste; të nderojmë vëllezërit tanë, heronjtë komunistë jugosllavë të rënë në fushën e betejës.

Të gjithë u ngritëm në këmbë dhe mbajtëm një minutë zi në heshtje. Pastaj falënderova nga zemra Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe Komitetin Qendror të saj për ndihmën që po na jepte nëpërmjet shokëve Miladin e Dushan, të cilët, tok me ne, u përpoqën dhe dhanë kontributin e tyre në arritjen e takimit të kësaj dite. (Emrin e Titos nuk e përmenda, sepse në atë kohë nuk e dinim. Më vonë këtë na e tha Miladini, por e mbanim konspirativ, në një rreth të ngushtë shokësh. Pastaj e mësuan edhe të tjerët, kur shokët tanë kapën në një aksion dokumente zyrtare të armikut, ku komandanti italian, që sundonte në Mal të Zi, gjeneral Pircio Biroli, i shkruante Romës për forcat partizane jugosllave që kornando:zesn:n nga Titoja, pseudonim i Josip Brozit.)

Pas këtyre, siç kishim vendosur në grupin tonë, parashtrova propozimin e Grupit të Korçës për Themelimin e Partisë që ditën e parë, për arsvet që kam shënuar më lart, kur diskutuam në grup dhe për të cilat flitet edhe në dokumentet e Partisë. :\\jë pjesë

kam thënë më parë e janë pasqyruar dhe në dokumente të tjera, por edhe këtu do të them disc gjërâ, ashtu siç më kujtohen:

- Shokë, - thashë, sapo fillova fjalën time. në emër të Grupit të Korçës dësh:roj të përshëndes Mbledhjen e parë të përbashkët të përfaqësuesve të të tri grupeve komuniste dhe shokët që e përbëjnë Ne i urojmë kësaj Mbledhjeje sukses të plotë në punime. Nga ana jonë kemi bindjen se diskutimet që çojnë të zhvillohen në këtë Mbledhje do të jenë të frytshme e. por që ato të jenë të tilla, kjo varet nga ne të gjithë, Ne të Grupit të Korçës kemi gjithashtu bindjen se edhe ju keni ardhur

këtu jo që të zihemi si armiq, por që të diskutojmë bile edhe ashpërsisht po të jetë nevoja, por si komunistë. Për ne kanë dhe duhet të kenë prioritet mbi çdo gjë parimet që do të udhëheqin punën tonë, të cilat duhet të jenë të pastra, kurdoherë sipas mësimave të mësuesve tanë të mëdhenj, Marks-, Engelsit, Leninit e Stalinit. Këto parime duhet të ushqejnë e të udhëheqin, në radhë të parë, mendimet dhe veprimet politike, ideologjike, organizative e ushtarake, tonat e të gjithë komunistëve shqiptarë. A ka ndodhur kështu deri më sot? Në të Grupit të Koçës po e themi që në fillim se kemi mendimin që këto parime janë kuptuar e janë zbatuar në mënyra të ndryshme nga grupet komuniste: Diku janë zbatuar mirë, diku janë zbatuar përgjysmë, por edhe në mjaft raste janë shtrembëruar keq. Pikërisht për të vënë drejt parimet marksiste; leniniste jemi mbledhur këtu, kurse të tjerat, - trockistet, anarkistet e fashistet e maskuara, t'i hedhim poshtë, t'i luftojmë, t'i shkëlmojmë. Ne do të diskutojmë për të gjitha këto dhe jemi të mendimit që asgjë të mos mbajmë në skutat e ndërgjegjes sonë, por çdo gjë që kemi në mendje e në zemër, t'i hedhim ndershmërisht mbi tryezë, se vetëm kështu do të arrijmë të kuptohemi e t'i shërbejmë çështjes sonë të madhe, e cila ka të bëjë me të tashmen dhe me të ardhmen e, popullit e të atdheut. Çështja e çlirimit të popullit dhe të atdheut duhet të vihet mbi çdo gjë, veçanërisht për ne, komunistët. Qëllimi i jetës sonë është dhe do të mbetet lufta për lumturinë e popullit. Prandaj, shokë, së pari le, të merremi me të tashmen, pastaj mund të merremi me të kaluarën dhe së toku të dalim me konkluzione se si ta organizojmë e ta drejtojmë luftën në të ardhmen.

Është e qartë për cilindo prej nesh që atdheu ndodhet në mjerim të madh. Populli ynë ka më tepër se dy vjet që vuan nën thundrën e urreyer të fashizmit italian dhe nga tradhtia e kuislingëve. Këtë robëri të rëndë vendit dhe popullit tonë ia përgatitën satrapi Ahmet Zogu, çifligarët dhe borgjezia e vendit. Populli ynë kurrë nuk e ka përkulur kurrizin përpara të huajve dhe satrapëve vendës. Ai ka rrokur kurdoherë armët, ka luftuar në shekuj për liri dhe, ka fituar, është shtypur përsëri dhe përsëri ka ngritur krye e ka derdhur gjak, duke treguar se shqiptari nuk rron dot pa liri.

Me pushtimin e vendit pësuam një tronditje të fortë të gjithë. Ideja e çlirimit të atdheut pushtoi zemrat dhe, energjitë tona, por pushtuesi na gjeti neve, komunistëve, të përçarë e në grindje, në një kohë që momentet e kërkonin të ishim më të bashkuar se kurrë. Vendi ziente kudo si vullkan. Nga të katër anët plasën demonstratat e fuqishme të popullit.

Është e vërtetë se neve, komunistëve të grupeve të ndryshme, na takoi detyra e madhe dhe nderi që t'i organizonim këto demonstrata e të qëndronim në ballë të tyre, por nuk e bëmë si duhet detyrën tonë. Edhe ne, bërtitnim bashkë me popullin: «Armë, armë, duam armë!», po kujt ia kërkonim të na i jepte këto armë? Ahmet Zogut, kryebandit e tradhtar, që e shiti atdheun dhe që, për të shpëtuar nga mëria e popullit, u arratis me valixhet e mbushura me ar? Apo ua kërkonim nëpunësve zogistë dhe oficerëve të lartë e tradhtarëve të tjerë që bëheshin gati ta prisnin okupatorin me lule?

Këtu ishte një gabim yni, i komunistëve. Ne nuk duhej t'i kërkonim armët, se ata që i mbanin, feudalët dhe borgjezia, ishin armiq të tanë, armiq të popullit. Këta armiq nuk kishin si të na i jepnin neve armët, se u duheshin për vete që të mbytnin me gjak rezistencën e popullit dhe të mbështetnin okupatorin. Ne duhej të sulmonim depot, t'i rrëmbenim ato me forcë, të armatosnim popullin, ta organizonim këtë në njësite guerile e në çeta dhe ta goditnim armikun kudo. Këtë rezistencë nuk e bëmë që në fillim. Pse? Se ne, komunistët, ishim vetë, në radhë të parë, të paorganizuar e të përçarë, se ne nuk e konceptonim të gjithë rjelloj luftën kundër okupatorit.

Kjo gjendje jona u interesonte shumë arqiomark sistëve, trockistëve dhe agjentëve të borgjezisë e të fashizmit, të cilët përfitonin prej saj për të përhapur më me lehtësi teoritë e tyre, armiqësore, antikomuniste, antishqiptare, me të cilat synonin të na mbanin të ndarë e të përçarë, siç na mbajtën gjatë regjimit zogist. Ka më se dy vjet që okupatorët italianë, kuislingët dhe tradhtarët pseudodemokratë kanë vënë të gjitha forcat për të shtypur rezistencën e, popullit që vjen duke u shtuar. Ne, komunistët, hymë në luftë kundër okupatorëve, por kjo ishte më shumë një luftë «pa gjak»: të mos shkruhen njerëzit në Partinë Fashiste Shqiptare, të braktisen «Dopolavorot»¹ dhe «Dante Alighieri»², të mos përshëndetet «ala romana» e të tjera, si këto. Natyrisht, nuk ngeleshim pa bërë propagandë kundër okupatorëve, pa bërë ndonjë sabotazh të vogël ose pa hedhur ndonjë trakt. Por, pa dashur të hyj në hollësi, duhet të shtoj, se edhe këtë lloj lufte nuk e zhvillonin njëlloj e

si duhej të tri grupet. Kishte dhe, grupe që edhe këtë e zhvillonin të influencuar nga pikëpamjet e krerëve të tyre arqiomarksistë e trockistë, si Niko Noxi, Aristidh Qendroja, Andrea Zisi, Dhimitër Falloja, Zef Mala e të tjerë, të cilët ishin e janë provokatorë dhe agjentë fashistë të maskuar.

Për pasojë, grupet tona komuniste nuk mendonin më shumë për të organizuar dhe, për të filluar si duhej luftën, por u përpoqën vetëm të binin me njëri-tjetrin në një ujdi socialdemokrate.

Natyrisht duhej të krijohesh më parë uniteti dhe të shkëlmohej fraksionizmi, por kjo s'mund të arrihej me një kompromis të tillë, i cili nuk solli asgjë kon

struktive, sepse zgjerohesh fushën e përhapjes së ideve disfatiste: «S'mund ta fillojmë luftën», «s'kemi proletariat», «s'mund të formojmë akoma një parti komuniste», «duhet të përgatitim më parë kuadrot» e të tjera parulla trockiste si këto, që binin erë dhe e kishin burimin në ofiçinat e okupatorëve fashistë.

Ndjeva në çast se, si heshtjen e thellë që sundonte gjer tani, e prishi një lëvizje nervoze karrigeje. Mezi po e mbante vendi Anastas Lulën. Heshta për një çast dhe e pushë tek fshinte me këndin e xhakëtës xhamat e syzeve. Pastaj, duke përfutur nga ndërprerja momentale që i bëra fjalës, Anastasi ndërhyri:

- Më falni, - tha, duke folur sa me mllef, aq edhe me, ironi, - por mendoj që të respektojmë ca rregulla. Përfaqësuesit të Korçës i bëjmë nder dhe geli Mbledhjen, i dhamë edhe fjalën që të flasë. Por e dëgjoni?! Ai s'po flet për Grupin e Korçës, ai po flet për të gjithë, në emër të të gjithëve! Ç'është kjo?!

- Jo, - i thashë me, gjakftohtësi, - nuk kam marrë përsipër të flas në emër të të gjithëve. Por në emër të shokëve të Grupit të Korçës dhe me porosi të tyre, fillimisht, dua t'i paraqes Mbledhjes një propozim që neve na duket shumë i rëndësishëm e parimor.

- Ç'janë këto propozime! - i erdhi në ndihmë sakaq Sadik Premtja Anastasit. - Ne s'kemi filluar akoma analizat.

- Kini pak durim, shoku Anastas e Sadik, se ne sa kemi filluar të flasim dhe të gjithë do të flasim.

Dhe vazhdova përsëri fjalën time: - E kaluara e grupeve komuniste duhet të na bëhet mësim. Sot shpresat tona janë të mëdha. Popullit i tra vajtur thika në kockë nga shtypja dhe nga mjerimi. Ai është i gatshëm të luftojë me, armë. Rinia është e zjarrtë. Ne, komunistët, jemi të bindur se fitorja do të jetë e popullit, do të jetë jona. Gjermania hitleriane sulmoi Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, por ajo do të thyhet pa asnjë dyshim nga popujt sovjetikë dhe nga Ushtria e Kuqe, e organizuar, e kalitur në revolucion nga Lenini e nga Stalini. Ne duhet të organizojmë luftën e armatosur sa më parë. Na përket neve, komunistëve, ta përgatitim, ta organizojmë dhe ta udhëheqim kryengritjen e përgjithshme. Po si mund ta organizojmë dhe ta udhëheqim ne, këtë? Të ndarë në grupe, të përçarë me lloj-lloj mendimesh kështu siç jemi, kur njëri i bie gozhdës dhe tjetri potkoit?

A do të vazhdojmë, shokë, që edhe në këtë mbledhje ilegalësh, të cilën e bëjmë nën kërcënimin e një okupatori të egër që na tra zaptuar vendin, të grindemi dhe, të mos gjejmë fjalën si komunistë përpara rrebeshit? Ne, të Grupit të Korçës, mendojmë se nuk duhet vazhduar më kështu. Pse, si na mëson Marksi, kështu? Si na mësojnë Lenini dhe Stalini, kështu? Jo, ata na mësojnë të kundërtën. Ne duhet të jemi grusht kundër armikut, të jemi të organizuar, ta luftojmë atë pa mëshirë deri në fitoren tonë të plotë.

Të luftojmë sikurse tra luftuar populli ynë gjithmonë, që nga Skënderbeu, edhe më parë, gjatë gjithë historisë së tij. Ashtu si populli që kurrë s'ka ndenjur me duar kryq, edhe ne të luftojmë për një Shqipëri të lirë, demokratike, pa pushtues, patradhtarë, pa shtay pje e pa shfrytëzim. Dhe për këtë të bashkohemi si vëllezër komunistë, të lidhur me një qëllim. Nuk mund të ecim më përpara, siç tremi ecur deri tani, nuk mund dhe nuk duhet të vazhdojmë më me kompromis, si ai i pari. Çdo gjë duhet të bëhet e organizuar, për çdo gjë të gjykohej dhe të veprohet në rrugën e ideologjisë sonë marksiste-leniniste, në shembullin e Partisë Bolshevike. Kjo ideologji duhet të udhëheqë Mbledhjen tonë të sotme, e cila, mendoj unë, nuk mund të arrijë rezultatin që synojmë, në qoftë se udhëhiqet nga fryma e sëmurë e, grupeve.

Që të marrë fund kjo frymë e grupeve, në radhë të parë, ne duhet të vendosim të shkrijmë grupet e të formojmë Partinë Komuniste të Shqipërisë. Jemi apo nuk jemi ne komunistë shqiptarë? Duam

apo nuk duam të krijojmë dhe të kemi Partinë tonë Komuniste, që të udhëheqë popullin në luftë, të realizojë programin minimal dhe maksimal që do të caktojmë? T'u përgjigjemi një herë këtyre pyetjeve kryesore dhe, në qoftë se jemi komunistë, të diskutojmë si të tillë, me ndjenjë përgjegjësie, me, mendje të kthjellët e me zemër të hapur. - Heshta për një moment, mora frymë thellë që të kapërceja emocionin dhe me zë disi më të lartë shqiptova

- Shokë, propozimi i Grupit të Korçës është:

Të formojmë Partinë Komuniste të Shqipërisë në bazë të mandateve që na kanë dhënë shokët e grupeve para se të vinim në këtë Mbledhje dhe, gasi të vendosim më parë solemnisht dhe unanimisht Themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, të vazhdojmë debatet e diskutimet.

Qëllimi ynë vendimtar është formimi i Partisë.

Këtë e kërkojnë nevojat objektive, e, kërkon klasa punëtore, e kërkojnë komunistët, e kërkojnë momentet historike nëpër të cilat kalon vendi ynë, e kërkon populli që na thërret të hidhemi në luftë tok me të. Këtij objektivi kryesor, shokë, nuk mund t'i shmangemi më për asnjë çast më tepër. Koha dhe situatat e kërkojnë formimin sa më parë të Partisë sonë Komuniste të tipit të ri Lenin-Stalin, si pararojë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe e luftës për një Shqipëri demokratike e popullore.

Partia që do të themelojmë, do të na japë zgjidhjen e drejtë të të gjitha problemeve dhe çështjeve që do të diskutojmë. Këtë herë ne, komunistët, do të mendojmë, do të diskutojmë, do të vendosim dhe do të veprojmë me një frymë të ren me një stil e me një metodë tjetër, pse këtej e tutje ne dhe të gjithë shokët tanë do të kemi Partinë tonë Komuniste.

Shokë, - u thashë, - kaq kisha për të thënë si fillim, - dhe u ula.

Po ndiqja me kujdes çdo lëvizje në fytyrat e qeta, të heshtura e të menduara të shokëve, të cilët e dëgjuan me vëmendje diskutimin tim. Vetëm Anastasi dhe Xhepi, ndryshe nga të tjerët, ishin ca nervozë, në kohën kur flisja dhe, kur mbarova, fytyrat i kishin të vrenjtura e të nxira.

Bëmë pushim dhe pimë cigare njëhën pas tjetrës. Nga ana ime isha edhe i kënaqur, por edhe i shqetësuar. Më preokuponte sidomos qëndrimi i Grupit të Shkodrës dhe i një pjese të shokëve të Anastasit e të Xhepit, pse, po të bashkoheshim ne, Qorri dhe Xhepi le të hidheshin përjetë. Partia do t'i dërrmonte. Në pushim, vura re se Miladini bisedonte me Qemalin dhe me Vasilin, kurse Dushani me Anastasin dhe me Bacën. Të dyja palët bisedonin qetë. Anastasi qëndronte me kokë ulur, por herë pas here e ngrinte dhe thoshte ndonjë fjalë, ndërsa Xhepi dëgjonte bisedimet e Dushanit dhe të Qorrit. Qemali me Vasilin ishin të çejur, ata bisedonin çlirët me Miladinin. Nuk kisha asnjë dyshim se bisedohej për çka parashtrova unë. U kthyem përsëri në Mbledhje.

E mori fjalën Qemal Stafa. Si unë dhe të tjerët e dëgjua me vëmendje. Në substancë më kujtohen vetëm idetë kryesore të diskutimit të tij. Ai bëri një hyrje të drejtë të luftës që duhej t'i bënim fashizmit ne, komunistët, pastaj argumentoi në mënyrë teorike

e me shembuj nga jeta çështë fashizmi dhe rrezikshmëria e tij. Ai tha se, fashizmi është armiku i betuar i popujve, i komunistëve dhe i revolucionit. Përmendi edhe disa citate nga raporti i famshëm i Dim itrovit.

- Por ne, - vazhdoi Qemali, - kush më shumë e kush më pak, nuk i kuptuam e nuk i zbatuam mirë udhëzimet, këshillat dhe direktivat e, Kominternit e të Dimitrovit. Ky është një gabim i madh nga ana jonë dhe për këtë ne të Grupit të Shkodrës bëjmë autokritikë. Edhe ndaj Grupit të Korçës kemi për të bërë kritika, por nuk po i shtroj tani, sepse jam dakord me Enverin që këtyre çështjeve t'u kthehem më vonë.

Kjo më pëlqeu shumë dhe, më ngrohu zemrën,

pse kuptova se Qemali dhe shokët e tij duhej të ishin të një mendimi me propozimin tonë për formimin e

Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Pastaj Qemali vazhdoi:

- Sigurisht, si komunistë që jemi, gjërat duhet t'i shohim në sy dhe të bëjmë përpjekje, t'i gjykojmë drejt e realisht, se, të themi të drejtën, kush më pak e kush më shumë, nuk i kemi parë çështjet si komunistë të vërtetë. Dhe për këtë ka shumë arsye, të cilat e kemi për detyrë t'i analizojmë e të

zhdukim nga mendja jonë mjegullën dhe errësirën. Ne duhet të zhdukim mendjemadhësinë dhe intrigën, të cilat kanë zënë vend te disa e që, sipas mendimit tonë, kanë krijuar atë gjendje, të rëndë rivaliteti, se çdo grup e quante veten parti, çdo grup pretendonte se ishte i lidhur me Kominternin. Edhe ato grupe që nuk kishin lidhje, kërkonin andej-këndeje të lidheshin.

- Kërkonin vula. Oburra të sigurojmë ndonjë vulë si e Zisi qelbanikut dhe u bë «partia»! - ndërhyri Piloja duke qeshur.

- Tamam kështu ndodhte, - aprovoi Qemali. Por harronim se asnjë vulë nuk e bën partinë, sepse partia komuniste nuk bëhet nga ndonjë vulë që siguron, por nga përpjekjet, lufta revolucionare që zhvillon në krye të masave. E tillë ishte gjendja, - vazhdoi ai, - por asnjëri nuk i bënte analizën e shëndoshë parimore punës së tij. Këto ndjenja të sëmura bënë që të fillojë, siç e dimë, lufta joparimore në mes nesh. Na okupoi armiku dhe ne, në vend që ta goditnim atë, grindeshim me njëri-tjetrin. Ne, të Grupit të Shkodrës, mendojmë se një situatë e tillë duhet të marrë fund. Pse duhet të marrë fund?

Qemali, në vazhdim të fjalës së tij, e lidhi çështjen me luftën botërore dhe me okupacionin e vendit tonë, me nevojën absolute të organizimit të luftës së armatosur. Arriti kështu edhe ai në konkluzionin tonë dhe, dulce përfunduar, u shpreh vendosmërisht:

- Ne aprovojmë propozimin e Grupit të Korçës,

që parashtrroi shoku Enver Hoxha - të themelojmë pa humbur kohë Partinë Komuniste të Shqipërisë. Çdo bisedim dhe çdo konkluzion i mëvonshëm do të bëhet me parti të formuar.

Një gëzim i papërshtetur pushtoi zemrën time. M'u duk Qemali si një shok i tërë jetës, që nga vegjëlja e deri në atë çast që po diskutonim në atë dhomë të vogël për një çështje nga më të mëdhatë e his torisë shekullore të popullit tonë. Doja ta shtrëngoja fort në kraharor atë dhe shokët e tij. M'u duk se u fshinë të gjitha pengesat, partia patjetër do të formohej.

Prisja me padurim pushimin. Sa dolëm, iu afrova Qemalit, i dhashë dorën, e tërhoqa nga vetja dhe e përqafova fort. U puthëm dhe i thamë njëri-tjetrit: «Rroftë në shekuj Partia jonë Komuniste!». Pastaj përqafova Vasilin, Tukun, ndërsa Anastasi rrinte mënjanë, dulce tymosur pa pushim e duke bluar në kokë planet e tij djallëzore. I gjithë grupi ynë i shtrëngoi dorën Qemalit. Kurse Qorri dhe Xhepi që nxinin nga inati, nuk lëvizën drejt Qemalit, siç nuk lëvizën as drejt meje, kur po më uronin shokët, pasi fola. Kurse Ramadan Çitaku iu afrua Qemalit dhe i shtrëngoi dorën, ashtu siç kishte bërë edhe me mua.

Punët po shkonin mire. Xhemali me Zylfijen, që aëndronin vazhdimisht në odën matanë, na kujtuan se duhej të hanim drekë. Në qoftë se nuk gabohem, po nuk gabohem, se tërë kohën gati po ato gjellë hanim: fasule të thata me mish, presh, qepë, djathë dhe orizin që na e bënë pilaf. Ndonjëherë hanim hallvë, kurse si pije, vetëm ujë nga pusi. Edhe uria na kishte grirë, por ishim dhe me «oreks» si i thonë, ishim të gëzuar, prandaj u shtruam mirë dhe i fshimë të gjitha ato që na vunë përpara.

Pas buke caktuam dy orë pushim dhe gjithë kujdes, nga shkalla e brendshme, u ngjitëm në dhomat sipër. Hoqëm këpucët dhe u shtrimë të gjithë në velenxa e në mindere. Unë rashë afër Miladinit. Edhe ai ishte shumë i gëzuar dhe, me atë frëngjishte që dinte, më tha:

- Enver, druzhe, çdo gjë shkon mirë. Partia juaj do të krijohet, do apo nuk do Anastasi. Ne kemi për detyrë të mundohemi që t'i bindim.

Koha e pushimit kaloi shpejt dhe zbritëm përsëri në dhomën e bisedimeve. Tash ajo ishte errësuar, sepse, siç dihet, netët e nëntorit afrohen shpejt, merr nata e zvogëlohet dita.

Ndërkaq na sinjalizuan se te të zotët e shtëpisë ishte paraqitur një shok dhe kërkonte të hynte brenda. Kishte dhënë pseudonimin.

- Të vijë menjëherë, - u thashë. - E presim.

Ishte Koçi Xoxja. Siç thashë edhe më lart, ai qe një ndër pesë përfaqësuesit e Grupit të Korçës në Mbledhje, por, para disa ditësh, e kishim nisur me mision në Korçë. U përshëndet me të gjithë dhe na informoi shkurt për gjendjen në Korçë.

- Kishte lëvizje të dyshimta rrugëve? - e pyeti gjithë merak Koçoja. - Mos re në sy, kur hyre?!

- Gjithçka ishte në qetësi, - tha Koçi Xoxja.

- More, mirë rrugica, po demonstrata, a u bë demonstrata? - e pyeti Piloja gjithë kureshtje.

- Masat u morën të gjitha dhe sot Korça do ta tundë. Unë ika që pa gdhirë, - iu përgjigj Koçi.

- Po rrije një çikë sa të shpërthente, a derëzi, - ia ktheu Piloja, - këtu do të na gjeje.

Pas pak zumë vendet. Mbledhja rifilloi. Llambush k,a e vogël me vajguri mbi tryezë u hidhte një ndriçim të zbehtë fytyrave tona. Ajo ndihmohej pakëz edhe nga flaka e druve që digjeshin në oxhak e që ushqeje herë pas here nga Vasili ose nga shoku që ndodhej aty afër. Mbi perusti në një kusi zienin fasulet për darkë dhe zhurma e tyre shoqëroi diskutimin e Anastas Lulë mavrisë.

Ai, sa më kujtohet, e filloi diskutimin ndryshe nga ne:

- Jemi mbledhur, - tha Anastasi, - të diskutojmë për punën që kanë bërë grupet e ndryshme komuniste dhe të gjykojmë për vijën që ka ndjekur secili prej tyre, vija e cilit grup ka qenë e drejtë dhe e cilit e shtrembër. Natyrisht, grupi ynë ka shumë për të thënë në këtë drejtim, sidomos kundër Grupit të Korçës, dhe veçanërisht atij që e kryeson, Koço Tashkos, i cili është nga shkaktarët më kryesorë të përçarjes. Por ne, të Grupit të «Të Rinjve» konstatojmë se prej një periudhe të gjatë ai nuk është vetëm. Ai me një sërë shokësh të tjerë të grupit të tij kanë dëmtuar çështjen, na janë hequr kurdoherë si ligjvënës të komunizmit, kanë pretenduar se vetëm grupi i tyre ishte partia dhe se vetëm ata kishin lidhje me Kominternin.

Anastasi po e fillonte me sulme, në mënyrë sa botuese. Dukej se në rrugën e tij s'kishte bërë asnjë kthesë, qoftë kjo edhe formale. Ishte me të vërtetë revoltues qëndrimi i tij, por duhej mbajtur gjakftohtësia, pse e njihnim mirë që ai ishte një provokator i fëlliqur. Koçoja skuqej dhe lëvizte në karrige nga inati. Anastasi vazhdoi:

- Sa vinte ndonjë shok nga emigracioni politik, përnjëherë udhëheqja e Grupit të Korçës thoshte se erdhën direktiva të Kominternit (ishte e qartë se e kishte fjalën për direktivat që i erdhën lëvizjes komuniste shqiptare më 1937). Por ne e dinim se vinin edhe shokë të tjerë jo të Grupit të Korçës që kishin lidhje me Kominternin dhe ata sillnin direktiva (e kishte fjalën për Andrea Zisin, arqiomarksist, i ardhur nga Greqia tok me një vulë të bërë në Athinë, ku lexohej diçka e tillë: «PKSH, seksion i Kominternit»). Kujt t'i besonim? Atëherë ne u besuam atyre që vetëdija jonë komuniste na thoshte se ishin të drejta, prandaj nisëm të largohemi hap pas hapi nga Grupi i Korçës, gjersa më 1940 dolëm si grup më vete. Grupi i Korçës na tra akuzuar dhe na akuzon si për~, fraksionistë, trockistë arqiomarksistë e çfarë të duash. Ne nuk jemi të tillë, por jemi marksistë revolucionarë të vërtetë.

Koços nuk iu durua më dhe i tha Qorrit:

- Trockistë jeni që ç'ke me të! Dhe nga më të këqijtë!

Anastasi kaq donte, se gati ishte, dhe ia ktheu:

- Koço Tashko, mos më pre fjalën, se kështu tre bërë vazhdimisht ti, kurdoherë arrogant tre qenë.

- Ti tre qenë «qengj», o Anastas Lula, - ndërhyra unë, - e jo vetëm i tillë, por ideologjikisht mund të të cilësojmë «engjël».

- Do të vij edhe në gështjet ideologjike, - tha Anastasi, - sepse këtu jemi mbledhur pikërisht që të gjykojmë punët tona nga ana ideologjike. T'i shkoqitim këto gjëra një herë, pastaj të dalim në konkluzione se kush është në rrugë të drejtë, ju, Grupi i Korçës, apo ne.

Në çast u hodh Qemali dhe i tha:

- Përcaktoje më mirë atë fjalën «ne»! Ç'kupton ti me atë «ne»?

Ishte e qartë, Qemal Stafa e ndante kështu Grupin e Shkodrës nga ai i «Të Rinjve».

Anastasi, i tronditur se mbeti vetëm, pa aleat, por me gjakftohtësi prej gjarpri, iu përgjigj ndërhyrjes së Qemalit:

- Natyrisht, flas për Grupin tonë, të «Të Rinjve». Por, shoku Qemal, - vazhdoi Qorri, - ju të Grupit të Shkodrës nuk e di për ç'arsye treni ndryshuar mendime tash, se të dy grupet tona kanë qenë në unitet mendimesh e veprimesh. Ne ishim të bindur se qëndrimet tona politiko-ideologjike ishin komuniste dhe të drejta. Ne, të Grupit të «Të Rinjve», vazhdojmë të mendojmë si edhe më parë.

Ky ishte një provokacion i dytë i Qorrit, këtë herë në drejtim të Grupit të Shkodrës, provokacion i bërë me qëllim që edhe t'i ofendonte, por edhe t'i kërcënonte, që të mos shkëputeshin nga grupi i tij.

Qemali iu përgjigj përnjëherë, i vendosur:

- Të dy grupet tona në mjaft gjëra kanë pasur mendime që puqeshin, por kanë pasur edhe që nuk puqeshin. Ajo që na bashkonte ishte fryma e një puni grupazhi, e cila na kishte errësuar sytë e s'na Tinte të shihnim kontradiktat në mes të dy grupeve tona, sesse tashun e luftës e kishim drejtuar kundër Grupit të Korçës. Por komunistët janë të atillë që reflektojnë sepse horizonte të reja, a po na hapen dhe këto na ndihmojnë të gjykojmë thellë për situatat e për ngjarje e mëdha që po zhvillohen. Pikërisht kjo kthesë në mendimet tona nuk është kthesa e një borgjezi, siç mendon ti, Anastas Lula, - përfundoi Qemali, - po kthesë prej komunisti.

- Shumë drejt fole, shoku Qemal, - iu drejtov unë, - ashtu mendojmë edhe ne, komunistët e Grupit të Korçës.

Anastasi po karfosej me shpatulla në mur. Po gjarpri ka shtatë «shpirtra», siç thotë populli, ai nu: ngordh, edhe po i këpute një copë të bishtit. Anasta Lula vazhdoi

- Sidoqoftë ju keni të drejtë edhe të ndërror mendime (prapë provokacion, të tëra ndërhyrjet e ti gjatë gjithë kohës që vazhdoi Mbledhja ishin provo kacione), por edhe ne kemi të drejtë të mbrojmë menditë me tona. Dhe mendimi i grupit tonë është në kundëz shtim me procedurën e veprimit që propozuat ju t'ndjekim, shoku Enver. Ju e vini çështjen shtrembër në vend që më parë të diskutojmë dhe pastaj të shprehim nëse biem dakord apo jo në mendime, nëse k'ardhur ose jo koha të vendosim formimin e Partisë ju të Grupit të Korçës na propozoni të formojmë më parë Partinë, pastaj të diskutojmë.

Kjo ishte një manovër tjetër djallëzore e Anast~ Lulës dhe e Sadik Premtes për të sabotuar formimin e Partisë.

Duhej të merrte një përgjigje të vendosur, por di hej bërë edhe kujdes që acarimi të mos shkonte r kulm para se të themelohej Partia. Kjo duhej pasur parasysh jo për këta dy trockistë të pandreqshëm, por

për anëtarët e bazës së Grupit të «Të Rinjve» që ishin të mashtruar dhe që do të bëheshin, me siguri, anëtarë të mirë të Partisë që do të formonim. Acarimi i menjëhershëm mund të shkaktonte tërheqjen e tyre nga Mbledhja, gjë që do t'i jepte mundësi grupit të V tyre të kishte një argument për të thënë: «Ne nuk morëm asnjë ~ angazhim». Përkundrazi, ne duhej të bënim shumë kujdes ndaj tyre e të arrinim të themelonim Partinë, që ishte vullneti i patundur edhe i gjithë komunistëve të këtij grupi, pavarësisht nga mendimet dhe nga dëshirat e kreut të tyre. Pasi të formohej Partia, atëherë mund të diskutonim deri në acarim të debateve, se atëherë këto do të bëheshin brenda Partisë, brenda normave të saj marksiste-leniniste.

Prandaj pa e lënë Anastasin të shkonte më tej në punën e tij sabotuese, ndërhyra duke i thënë:

- Shoku Anastas, propozimi i Grupit të Korçës nuk ka asgjë të gabuar. Ai është leninist, ai nuk është aspak në kundërshtim me teorinë d'ne me normat që Izdhëheqin veprimtarinë e Partisë Bolshevike që themeloi Lenini. Sikur të ishte gjallë Lenini ose sikur të kishim mundësi të pyesnim Stalinin, ata me siguri do të na këshillonin

«Formojeni sa më parë Partinë Komuniste, se mjaft jeni tororitur, pastaj bëni autokritikë bolshevike, caktoni detyrat të reja dhe, si pararojë e klasës punëtore, ecni përpara në betejat e fitore».

Prandaj ne nuk duhet ta kondicionojmë krijimin e Partisë me mosmarrëveshjet që kemi pasur deri më sot, por me detyrën e lartë që na imponon situata. Mosmarrëveshjet tona duhet të zgjidhen, të sheshohen me diskutime e me debate, por jo për çështjen «ta formojmë apo të mos e formojmë Partinë». Situata është pjekur për ta krijuar Partinë me një unitet të atillë që ajo të jetë në lartësinë e detyrës së çlirimit të atdheut. Kështu mendojmë ne.

- Kush «ne», - ndërhyri në moment Sadik Premtja. - E ke fjalën për vete e katër shokët e tu, apo me atë «ne» na përfshin të gjithëve?!

- Kur them ne, - iu drejtova Xhepit, - patjetër që kam parasysh shumë më tepër sesa veten dhe katër shokët e Grupit të Korçës. Ne s'kemi ardhur këtu nga rruga; këtu na kanë dërguar. Na kanë dërguar grupet tona komuniste dhe kur them «ne» kam parasysh gjithë shokët komunistë të ndërgjegjshëm të bazës që kërkojnë me çdo kusht themelimin e Partisë. Dhe, ji i bindur, Sadik, se te «ne-ja» përfshihen edhe pjesa më e shëndoshë e anëtarëve të grupit tuaj, do apo s'do ti e Anastasi.

- S'është e vërtetë! S'të lejojmë të flasësh né emër të shokëve tanë! - u ngrit gjithë tërsëllëm Anastas Lula.

Për të mos dhënë shkas që të acaroheshin më tepër gjakrat, iu drejtova me urtësi Anastasit e Sadikut dhe u shpjegova edhe një here' ars'yen nga niseshim ne për propozimin që bënim.

Né krah m'u vu Qemal Stafa:

- Shokë, - tha ai, - të mos merret kjo çështje e madhe që shtroi shoku Enver sikur këtu kemi të bëjmë vetëm me dëshirën dhe me vullnetin e shokëve të Grupit të Korçës. Jo, ky është vullneti i ne të gjithëve, i të gjithë komunistëve, i të gjithë demokratëve revolucionarë. Mendimin tim unë e shfaq, por dua të theksoj se populli kërkon prej nesh ta udhëheqim rie luftën që ka nisur, por këtë rol udhëheqës nuk rruad ta luajnë grupet komuniste të përçara dhe me lloj-iloj idesh. Atë mund ta udhëheqë vetëm një parti me unitet marksist-leninist të pathyeshëm. Prandaj, Anastas, ne nuk gabojmë po të themelojmë më parë Partinë e pastaj té diskutojmë.

Kaq tha Qemali e, duke m'u drejtuar mua, shtoi gjithë dashamirësi:

- Më fal, shoku Enver, që të ndërpreva...

Unë, që gjatë kësaj kohe qëndroja né këmbë, vazhdova:

- Shokë, ne, grupet, kemi korrur edhe disa suksese, po kemi bërë edhe gabime. Gabime nuk keni bërë vetëm ju, Anastas, por edhe ne të Grupit të Korçës, edhe ata të Grupit të Shkodrës, kush më shumë e kush më pak. Ne nuk do Vi fshehim ato, përkundrazi, do Vi dënojmë të gjitha, nga cilado anë që të jenë bërë. Né këtë Mbledhje që unë e konsideroj historike, nuk duhet të sundojë vullneti i asnjë grupi, por të sundojë vullneti i shëndoshë i marksistë-leninistëve, vullneti i hekurt i komunistëve shqiptarë që kanë vendosur të formojnë Partinë dhe të luftojnë me trimëri, me ndjenjë të lartë sakrifice deri né fund për popullin e tyre, derisa ky të çlirohet përgjithmonë nga zgjedha e okupatorëve, e çifligare've dhe e borgjezisë së vendit, të sundojë vullneti i atyre komunistëve që kanë vendosur të bëjnë revolucionin dhe të sjellin klasën punëtore né fuqi për të ndërtuar socializmin.

Ne, shokë, e dimë të gjithë, se ç'parti duam, ç'parti duhet té formojmë dhe me ç'tipare duhet ta kalitim atë. E thashë edhe né fillim, por e theksoj përsëri se ne do të krijojmë një parti të tipit Lenin-Stalin, ku ,nuk mund të ekzistojnë fraksione dhe punë grupazhi, siç ka pasur te ne deri tash. Kjo situatë duhet të marrë fund! Né Partinë tonë të re, që do të themelojmë, -duhet të vendosim unitet mendimi e veprimi dhe jo vullnet të njërit ose të tjetrit. Partia jonë do të udhëhiqet nga një teori, nga teoria e Marksit dhe e Leriinit; çdo devijim prej saj dhe bartësit e këtij devijimi do të dënohen pa mëshirë. Né Partinë tonë do të ketë demokraci në shfaqjen e mendimeve, por do të ketë edhe .disiplinë, edhe centralizëm. Ne do të diskutojmë dhe do të vendosim një nga një për këto çështje, do të vendosim edhe si do të jetë ndërtimi i Partisë, ç'forma do të kenë celulat dhe komitetet e saj. Në këto diskutime do të kemi edhe ndihmën e shokut Miladin. Prandaj, - iu drejtova përsëri Anastasit, - mendoj se nuk ka asnjë arsye të shëndoshë që të mos bashkoheni edhe ju, si të dy grupet e tjera, me propozimin që të themelojmë më parë Partinë, pastaj të zhvillojmë diskutimet si anëtarë të saj dhe jo më si anëtarë grupi, të diskutojmë në frymën dhe mbi bazat e një partie komuniste dhe jo në frymën e grupeve komuniste.

Këtu e përfundova ndërhyrjen time dhe u ula. Shokët propozuan të bënim pushim.

Pas pushimit e mori fjalën Ramadan Çitaku. Unë e njoha Bacën për herë të parë në këtë Mbledhje. Më bëri përshtypje të mirë dhe e simpatizova menjëhere'. Ai fliste pak, ishte i qetë në gjeste dhe në biseda, pinte cigare duke e thithur si për ta çuar t`ymin në fund të mushkërive. Ishte i ri, megjithëse dulce j i kaluar, pse kishte mustaqe dhe për këtë e mbiquanim Bacë.

Baca, me atë zërin e tij të trashë, foli pak. Në Substancë ai tha:

-- Ne jemi mbledhur këtu që të zgjidhim hallet

tona, se kështu si kemi ecur, nuk mund të ecet më. Unë dua që ta formojmë Partinë dhe jam dakord me parashtrimin e shokut Enver. Jam në një grup me Anastasin dhe me Sadikun, e megjithatë nuk mund ta kuptoj arsyetimin e Anastasit. Jam i bindur se si inua do t'u ngjasë edhe shumë shokëve të grupit tonë. Q'të keqe ka, përveç të mirës, Themelimi i Partisë sa më parë? Kemi edhe kritika e

autokritika për të bërë, por që sot e tutje unë dua Partinë dhe jo grupin, prandaj jam për Themelimin e Partisë.

Kaq tha Baca dhe u ul. Fjalët e tij ishin një grusht tjetër për Qorrin e për Xhepin, por këtë herë nga ai që nuk e prisnin, nga shoku i grupit të tyre.

Pas Bacës e mori fjalën Miladini. Përkthente Du shani dhe herë-herë, për s.aktësi, Baca. Ai foli afër një orë. Na falënderoi në fillim që e shpëtua nga kampi i -internimit dhe për besimin e madh që treguam të gjithë ndaj tij. Ai tha se ky besim i takon Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

- Unë jam anëtar i saj dhe jam urdhëruar prejsai që, me propozimin e komunistëve shqiptarë, - vazhdoi ai, - të jap ndihmën time modeste dhe eksperiencën që mund të kem, qoftë edhe të vogël, duke e vënë atë, si internacionalist, në shërbim të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që ju do të formoni. Në të gjithë shokët komunistë shqiptarë gjeta një dashuri dhe një sinqeritet prej komunistësh ndaj meje. Ju më hapët zemrën, edhe unë gjithashtu. Kemi pak kohë që jemi njohur, por gjendja paraqitet sikur kemi shumë kohë që njihemi. Kjo gjendje është krijuar, sepse jemi komunistë, internacionalistë.

Pasi foli për dashurinë që kishte për popullin, shqiptar, për respektin që ushqente për të, për trimërinë, burrërinë, besën dhe mençurinë, «që i njoh mirë, - tha, - pse kam jetuar me shqiptarë në Kosovë e në Mal të Zi», Miladini vazhdoi:

- Ju më njohët me lëvizjen komuniste shqiptare, me ekzistencën e grupeve, me pikëpamjet e ndryshme që përplasen, me rezultatet e mira, me të metat e me ge(bimet që janë vërtetuar në punët e tyre. Bashkë kemi diskutuar haptazi. Si shok, si komunist, unë karn shprehur hapur disa mendime të miat, të cilat munti edhe të mos jenë të drejta, sepse nuk munti të kem pretendimin ta njoh si ju gjendjen e vendit tuaj dhe të punës suaj. Ju jeni në gjendje dhe e njihni vetë më mirë situatën e vendit, të popullit, të grupeve tuaja komuniste jo vetëm në përgjithësi, siç munda të marr një ide unë, por në thellësi dhe në mënyrë analitike. Ju përket juve të analizoni dhe të vendosni. Unë jam i bindur se ju do të vendosni drejt. Kur ta gjeni të arsyeshme, do të dëshiroja të më jepni fjalën, të më lejoni të them mendimin tim për një sërë problemesh parimore, që, me siguri, ju do t'i ngrini, të jap eksperiencën e partisë sime, si i ka zgjidhur ajo disa probleme analoge. Ato që do të them, ju i gjykoni vetë nëse janë të arsyeshme apo jo. Vendimet që do të merrni, ju përkasin juve dhe askujt tjetër.

Ne e dëgjonim me vëmendje të madhe këtë shok kaq të mirë, këtë komunist kaq të sinqertë.

Miladini bëri një tablo të shkurtër, por të qartë, të situatës ndërkombëtare. Ai foli për rolin vendimtar të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit të madh, foli edhe për luftën partizane në Jugosllavi, të udhëhequr nga Partia Komuniste e Jugosllavisë. Miladini, gasi foli për jrëndësi në që do të kishte formimi i Partisë në vendin tonë, përfundoi:

- Unë bashkohem plotësisht me propozimin e shokut Enver Hoxha që duhet formuar sa më shpejt, tihe më parë se çdo gjë, Partia Komuniste e Shqipërisë. Një veprim i tillë i madh historik është i drejtë politikisht, ideologjikisht dhe organizativisht. Atë e lypin situatat që janë pjekur.

Një gëzim i madh ndriste në fytyrat tona. Edhe

shoku 'ynë, komunisti internacionalist jugosllav, ishte i një mendjeje me ne. Bëmë pushim. Të gjithë e përqafluam fort Miladinin. Nuk munguan edhe Qorri me Xhepin. Shenjat ishin të mira. Iu shtruam darkës me shumë uri dhe me gëzim të madh në zemër. Nuk e ndieja më, ashtu si edhe shokët, atë peshën e brengës së fillimit. Qielli gati u qartësua.

Pas buke u kthyem menjëherë në Mbledhje. E kërkoi fjalën Koço Tashkoja. Natyrisht, në fillim ai mbështeti propozimin për Themelimin e Partisë, u përpoq të bënte edhe një tablo teorike të luftës së drejtë e të luftës së padrejtë dhe menduam se po e mbyll me kaq, urtë e butë. Por Koço Tashkoja harroi ç'kishim vendosur dhe -në fjalimin e tij nisi insinuatat kundër grupeve të tjera, pikërisht në problemet që ne duhej të diskutonim pas formimit të Partisë. Mirë që nuk e zgjati dhe u ul shpejt, se do të detyrohesh të ndërhyja. Megjithatë toni i tij «doktorial», embrouillé dhe me insinuata, nuk mungoi të lëshonte një ftohtësi, të cilën e likuiduan shpejt Pilo Peristeri dhe Vasil Shantoja, që folën shkurt e qartë, pro Themelimit menjëherë të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Po kështu u shprehën

edhe Koçi Xoxja, Tuk Jakova me shokët e tjerë. Në fund e mori fjalën Anastasi dhe pas tij Sadik Premtja. U bë heshtje. Këtë herë Anastasi foli pak.

- Unë, - tha ai, - e tërheq arsyetimin që bëra më parë dhe bashkohem me propozimin që të themelohet Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Edhe Sadik Premtja u solidarizua me të tjerët.

Ra një moment heshtje. Për shumë nga ne, solidarizimi i Anastasit e i Sadikut ishte gjithnjë i dyshimtë.

- Ta hedhim në votë, - tha nga vendi Koço Tashkoja. - Mendimin e shfaqën të gjithë.

- Ta hedhim, - ia priti, jo pa helm Anastas Lula. - Po kush se? Ne këtu jemi të gjithë të barabartë. . .

Ishte vërtet diçka që nuk na kishte shkuar në mendje më parë. Por ndërkaq u ngrit Miladini.

- Shokë, tha, këtu nuk është as punë drejtuesish as presidiumesh. Problemi është fare i thjeshtë: Propozimin mund ta hedhë në votë ai që e paraqiti.

Atëherë u ngrita në këmbë shumë i emocionuar dhe thashë

- Shokë, në bazë të propozimit të Grupit Komunist të Korgës dhe mendimeve të shfaqura nga gjithë të pranishmit po vë në votë projektvendimin: «Sat, më 8 Nëntor të vitit 1941, përfaqësuesit e të trt Grupeve Komuniste, të Korçës, të Shkodrës dhe të «TëRinive», të mbledhur në seancë plenare dhe pas diskutimeve konstruktive me frymë komuniste, duke ti bazuar në mandatin që u kanë dhënë shokët e grupeve të tyre, Themeluan Partinë Komuniste të Shqipërisë». Kush është pro, të ngrejë dorën.

Të gjithë ngritën dorën. Nuk pati asnjë kundër, asnjë abstenim. Një gëzim i papërshkruar na pushtoi të gjithëve. U kurorëzua me sukses hapi kryesor, detyra vendimtare që i kishim vënë vetes kur u nisëm për në këtë Mbledhje historike!

Atëherë deklarova:

- Me unanimitet të plotë u Themelua Partia Komuniste e Shqipërisë. Rroftë Partia Komuniste e Shqipërisë!

Të gjithë, të gëzuar e të emocionuar, u ngritëm në këmbë dhe, me grushtin përperjetë, në dritën e llambës me vajguri, kënduam me zë të ulët Internacionalen, pastaj brohoritëm e brohoritëm për Partinë Komuniste të Shqipërisë, por kurdoherë në surdinë: «Rroftë Partia Bolshevike!», «Rroftë Stalini!», «Lavdi Marksit-Engelsit-Leninit!», «Rroftë Partia Komuniste e Jugosllavisë!», «Poshtë fashizmi!», «Rroftë populli ynë heroik!» etj. Filluam përqaftimet, puthjet. Për herë të parë dhe të fundit përqaftova atë natë Anastas Lulën dhe Sadik Premten.

Qemali tha:

- Nuk mund të na zëré gjumi sonte, hajde të këndojmë.

Të gjithë gati ishim. Ia filluam lehtë-lehtë. Kënduam këngë patriotike nga tonat, u shkuam pas edhe shokëve jugosllavë në këngët e tyre partizane, të cilave, edhe pse nuk ua dinim fjalët, të shumtave ua dinim melodinë, sepse edhe jugosllavët i kishin marrë nga këngët e Revolucionit të Tetorit e nga Radio Moskës, këngë që u bënë aq të njohura dhe te ne gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Kështu, natën e 8 Nëntorit 1941, lindi Partia jonë, që do ta udhëhiqte popullin shqiptar në betejat më të mëdha të të gjithë historisë së tij. Ajo lindi nga gjiri i popullit, nga zjarri dhe nga dufi i tij revolucionar, i pashuar në shekuj, lindi si një diell i ndritshëm në errësirën e kobshme të skllavërisë dhe të terrorit fashist, që kishte mbuluar popullin dhe atdheun.

Ishtim të gjithë në kulmin e gëziimit e të entuziazmit për fitoren e madhe që kishim arritur, kur, pak para mesnatës, hyn brenda një nga rojat dhe na thotë se ka ardhur filani dhe kërkon të na njoftojë diçka që ka ngjarë në Korçë. (Sido që, për vetë karakterin tepër sekret të ngjarjes, qenien tonë në këtë bazë e dinim shumë pak veta, të zgjedhur e të caktuar me kujdes të madh, prapëseprapë ne kishim marrë të gjitha masat që komunikimet e nevojshme e të domosdoshme me jashtë të vazhdonin rregullisht.)

Dola në korridorin e vogël të shtëpisë d'he takova një shok që sapo kishte mbërritur nga Korça. Më informoi mbi demonstratën e madhe që zhvilluar atë ditë atje dhe unë menjëherë hyra në dhomën ku bënim Mbledhjen.

- Shokë, - u thashë, - punëtorët, nxënësit e shkollave, krejt populli i Korçës, me në krye komunistët, pikërisht në këtë ditë historike, kanë bërë një demonstratë masive dhe janë ndeshur me forca të armatosura të pushtuesve, të kuesturës e të milicisë fashiste. Në ballë të popullit demonstrues ndodhej punëtori Koci Bako, komunist i orëve të para i Grupit të Korçës. Kur turma kishte arritur para Monumentit të Themistokli Gërmenjit, forcat armike qëlluan me armë mbi popullin dhe hodhën bomba. Ra i vrarë shoku ynë i paharruar Koci Bakoja dhe dhjetëra të tjerë u plagosën, midis të cilëve edhe Muharrem Butka, djali i patriotit Sali Butka. Ne, shokët e ish-Grupit të Korçës, që vendosëm së bashku me ju t'i japim fund gjendjes së grupeve e njihnim mirë Koci Bakon, komunistin proletar, dhe ëndrrën e tij për krijimin e kësaj Partie që ne sapo e realizuam. Gjaku i Kocit dhe i gjithë komunistëve e patriotëve të tjerë do t'i çimentojë themelet e Partisë që porsa krijuam.

Jo vetëm ne shokët e ish-Grupit të Korçës që e njihnim nga afër Koci Bakon, por gjithë të pranishmit ndien një hidhërim të thellë, por ne qemë komunistë dhe vdekja heroike e shokut tonë të dashur do të na çonte peshë e do të na jepte forca të reja në ato ditë historike e në ditët që vinin.

E mori fjalën Vasil Shantoja:

- Propozoj, - tha, - të mbajmë një minutë heshtje për shokun Koci Bako, si për dëshmorin e parë komunist të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Kaq tha ai dhe ngriti grushtin përpjetë me nderim. E pasuam të gjithë.

Natën, vonë, shumë vonë, ngjitëm shkallën e vogël të drunjtë për të shkuar në dhoma. Zemrat na gufonin. Themelimi i Partisë na hapte perspektiva të ndritura për popullin e për të ardhmen e tij. Kujtoja në ato çaste të lumtura Aliun [Kelmendin], i cili edhe pse tuberkulozi s'iu nda deri në vdekje, luftoi me gjithë shpirt për komunizmin, luftoi deri në fund për t'ia arritur kësaj dite; kujtoja Koci Bakon me të cilin, kur ishim të rinj, në Korçë, rrinim së bashku në heshtje rreth radios së vogël në pastiçerinë e tij dhe dëgjonim Internacionalen që jepte Radio Moska; kujtoja Asim Vokshin, Teni Konomin dhe heronjtë e tjerë të Spanjës; Thanas Zikon e shokë të tjerë, komunistë a revolucionarë, që dhanë jetën për një jetë të re. Themelimi i Partisë ishte kurorëzimi i dëshirave të heronjve të popullit të rënë në beteja, i patriotëve, i heronjve të panumërt që kishin luftuar për lirinë e Shqipërisë, sepse, paskëta, Partia, që u themelua, do të ngrinte lart flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, së toku me flamurin e Skënderbeut, e do të hidhej në beteja të reja me një besim të qindfishuar në fitoren e madhe të çlirimit.

Të nesërmen e deri më 14 nëntor, vazhduan debatet. Folën të gjithë shokët pjesëmarrës në Mbledhje. Debatet ishin të ngjeshura, shumë herë edhe të ashpra. Shpesh harrohej se që nga 8 Nëntori ne duhej të flisnim nga bazat e Partisë së krijuar, me frymën e kësaj Partie dhe mjaft veta vazhdonin të diskutonin me pasion grupi.

E mori fjalën Koço Tashkoja. Ai përpiquej të shoqëronte thëniet e tij me ndonjë citat pa adresë të klasikëve tanë, që thoshte se i kishte mësuar në Moskë. Koçoja, natyrisht, mbrojti vijën e Grupit të Korçës, gjë që ishte e drejtë. Këtë ne e bëmë të gjithë kur morëm fjalën, por Koço Tashkoja, nga pasioni për ta mbrojtur këtë vijë, anët e mira dhe pozitive të punës më Grupit të Korçës ia vishte «udhëheqjes. së tij. Natyrisht, këtu nuk tregohej objektiv. Ndërkaq «harroi» të theksonte të metat dhe gabimet e punës së këtij

grupi. Autokritika që bëri ai për punën e grupit ishte e zbehtë dhe për veten e tij inekzistuese.

Koçoja trajtoi edhe çështjen e direktivave të Kominternit.

Grupi i Korçës, - tha midis të tjerash, - që i vetmi grup komunist sháiplar që i pranoi dhe i vue në jetë alo, kurse grulet e tjera jo vetëm nuk i prarman, por i luftuan me ashpërsi dhe në formën më të dënueshme të grupazhit.

Në këtë kapitull Koçoja filloi kritikën dhe sulmet kundër Grupit të Shkcdres dhe Grupit të «Të Rinjve», kritika, që, në paLim, ishin të drejta. Ai e filloi që nga armiku i komunizmit, arqiomarksisti Niko Xoxi, i cili, pasi që dënuar nga Grupi i Korçës, u strehua në Grupin e Shkodrës, ku u bë një nga -krerët e tij dhe, tok me Zef Malën, organizuan luftën jo vetëm kundër Grupit të Korçës, por kundër marksizmit, kundër Kominternit dhe, natyrisht, kundër Bashkimit Sovjetik e Stalinit. Ishte logjike që këta elementë ndiqnin rrugën e Trockit, kurse «Buletini jeshil», që nxorën, nuk ishte

veçse paçavure trockiste. Koço Tashkoja nuk harroi Aristidh Qendron, Anastas Lulën e Sadik Premten. Anastas Lulën e akuzoi jo vetëm si shok të ngushtë të të parëve, që krijoi nga gjiri i Grupit të Korçës fraksionin e quajtur më pas Grupi i «Të Rinjve», por ngatërroi e tërhoqi në rrugë të shtrembër edhe Grupin e Shkodrës.

Diskutimet vazhduan në këtë mënyrë të elektrizuara tërë ditën, duke marrë fjalën njëri pas tjetrit duke ndërhyrë njëri te tjetri dhe jo me butësi, por me ashpërsi, sa, ngandonjëherë, kalohej edhe masa në shprehje.

Anastas Lula e mori fjalën pas Koços. Ai bëri 15ërprjekje dhe sulmoi me mëri, pa baza, me shpifje e trillime gjithë punën e Grupit të Korçës. Arnti deri atje sa të sulmonte edhe Ali Kelmendin, duke e quajtur të rrëmbyer dhe të padrejtë për kritikën dhe dënimet që kishte bërë kundër Niko Xoxit dhe Aristidh Qendros.

Ne nuk duruam të akuzohej Ali Kelmendi, dhe harruam që ishim në ilegalitet të rëndë.

- Anastas Lula, - i bërtita, - ki kujdes se pozitat nga po flet janë trockiste dhe ne nuk mund të lejojmë askënd të sulmojë figurën e pastër të militantit më të shquar të lëvizjes komuniste shqiptare dhe të një shoku të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Nuk të lejojmë ty të njollosësh figurën e shokut tonë veteran komunist, që na ka mësuar si duhej të luftoheshin Zogu, feudalët e borgjezia, të njollosësh emrin e atij që na solli neve fjalën e Dimitrovit (Ali Kelmendi solli në Shqipëri në vitin 1932 porosinë që Gjergj Dimitrovi i dha lidhur me krijimin e një lëvizjeje komuniste në Shqipëri mbi një platformë politike dhe organizative më të shëndoshë.) dhe luftoi derisa vdiq, gjithmonë i nderuar nga lëvizja komuniste ndërkombëtare. Kë na vë ti, Anastas Lula, përpara figurës së këtij komunisti të madh shqiptar, fytyrat e ndyra të dy arqiomarksistëve, të dërguar në Shqipëri nga reaksioni më i zi grek për të luftuar komunizmin?

Pilo Peristeri, i zemëruar në kulm, u ngrit dhe drës u futën edhe njerëz të ligj e antikomunistë, si Zef Mala e Niko Xoxi, të cilët mundën të përfitonin nga papjekuria jonë për të përhapur në radhët tona mendime dhe ide të gabuara, të dëmshme, trockiste. (Qemali ndershmërisht si komunist i numëroi ato një nga një.) Po Grupi i Korçës vallë dhe Koço Tashkoja, personalisht, nuk kanë bërë gabime? Ai nuk na foli për ato, por po i them unë, se është e drejta ime.

Qemali që në fillim pohoi:

- Unë e dënoj Anastas Lulën që dha atë gjykim për shokun Ali Kelmendi. Unë mendoj tash, por edhe më përpara tram menduar, se Ali Kelmendi ishte luftëtar komunist dhe, megjithëse nuk e tram njohur, si të ardhur nga Bashkimi Sovjetik, si komunist internacionalist, e respektoja dhe e respektoj. Po atëherë përse Grupi i Shkodrës nuk i pranoi direktivat e Kominternit? Ne kemi gabuar.

- Që treni gabuar, kjo dihet, - e ndërpreu Koço Tashkoja. - Po, pse treni gabuar?! Këtë na thuaj!

- Po, - i tha Qemali, - atë do të bëj, prandaj më dëgjo, shoku Koço - dhe vazhdoi: - Ne kemi gabuar, se edhe ju treni gabuar. Këto direktiva ju treni dashur t'i shfrytëzonit në frymë grupi, për të nxjerrë grupin tuaj mbi të tierët. Nga kjo frymë, kuptohet. ishim të infektuar, bile fort edhe ne të Grupit të Shkodrës dhe ngiaiu aio që ngiaiu, që nuk i pranuan. U përnoaëm të gienim lidhie edhe ne, por ramë në provokatorë. Po ti. Koço Tashko. - vazhdoi Qemali, - a bëre, vecanërisht, ndonië përniekie të na bindie, të vije e të diskutoje me ne? Jo. deri në fund. Ti di vetëm të na hiqesh si një «meri i madh». «me dituri të madhe», «me teori të madhe». Vetëm Enveri na është afruar dhe tra biseduar si shok me ne, kurse

ti kurrë.

- Të lutem, djalë, mos ma moho punën, - u nxeh Koçoja. - Pse në bisedimet e një a dy vjetëve të shkuara, kur ramë dhe në marrëveshje me ju, a nuk isba unë dhe a s'dhashë kontribut?!

- E tre fjalën për kompromisin? - iu drejtua

sakaq Qemali me Troni Koços. - Kemi dy ditë këtu që e tremi dënuar e po e dënojmë atë farë «marrëveshjeje» si një kompromis të fëlliqur, pa baza.

- Si kompromis socialdemokrat. Vetë jeta e rrëzoi atë pa filluar mirë puna, - ndërhyra unë.

- Ashtu është, - vazhdoi Qemali. - Prandaj shoku Koço, s'është e hijshme për ty, që na thua se tre pasur lidhje edhe me Kominternin...

- Kam pasur që ç'ke me të! - bërtiti Koçoja.

- Atëherë mundohu ta mbash lart emrin e tij.

E kisha fjalën se s'është e hijshme për ty të na mburresh me veprime të kaluara që kanë qenë të gabuara. Në ato veprime, si me kompromisin që përmendëm, ishim dhe ne, por tash e dënojmë atë që ndrim të atëhershëm. Prandaj unë të bëj thirrje të reflektosh për qëndrimet e tu.a, t'i njohësh edhe ti gabimet e fajet e tua dhe të Grupit të Korçës. Sa për Grupin e «Të Rinjve», - vazhdoi Qemali, - unë tram mendimin dhe flas në emër të Grupit të Shkodrës, se baza e këtij grupi është e shëndoshë, si jona, si edhe e Grupit të Korçës. Por si te ne, edhe te të tjerët, kanë hyrë ide antikomuniste, trockiste, që tash, në këtë dritë të re, i shohim ato më mirë. Kurse ti, Anastas Lula dhe ti Sadik, që fole po me gjuhën e Anastasit, nuk tregoheni aspak të sinqertë dhe komunistë. Ju u bëni dredha çështjeve. Për ne, ju keni bërë dhe vazhdoni të bëni gabime të rënda, por më e keqja qëndron në atë që nuk bëni as përpjekjen më të vogël për t'i njohur.

Qemali e përfundoi fjalën e tij, duke u bërë atyre thirrje që të bënin kthesë.

Kështu vazhdonin çdo ditë debatet dhe diskutimet. Të gjithë ne po avanconim në analizat. Kritikat po merrnin rrugën e drejtë dhe po bëheshin më shumë të argumentuara, autokritikat po thelloheshin çdo ditë e më tepër, njiheshin progresivisht gabimet e përbashkëta dhe të çdo grupi në veçanti. Po spastrohej kështu çdo ditë e më mirë terreni nga skoriet. Ditët po kalonin të mbushura me debate. Kjo ishte një shkollë e madhe për ne, shkollë që nuk e kishim parë kurrë. Në diskutimet asnjëri nuk mungonte të jepte mendim se si duhej të gjykonim dhe të vepronim për këtë ose për atë problem në të ardhmen. Nuk mbahet mend sa herë diskutuan dhe ndërhyjnë në debate të gjithë shokët. Unë, nga pjesa ime, ndërhyra shumë herë, me replika herë të shkurtra, herë relativisht të gjata. Të tilla ishin edhe ndërhyrjet e shokëve të tjerë.

Më kujtohet që fola pas Qemalit dhe mbështeta pikëpamjet e tij në disa çështje. Substanca e ndërhyrjes sime ishte kjo:

- Bashkohem me kritikën që shoku Qemal i bëri Grupit tonë të Korçës për sektarizëm dhe për mungesë të një fryme më të shëndoshë shoqërore e të një durimi më të madh në diskutimet që tremi bërë më përpara me shokët e grupeve të tjera. Këtë qëndrim të gabuar shoku Koço nuk e vuri në dukje, por una po e theksoj dhe duhet ta njohim, se na tra sjellë shumë dëme në të kaluarën. Shfaqje të tilla ne nuk duhet t'i lëmë të kalojnë në Parti, duhet të zhvishemi prej tyre, por, pa i njohur, nuk mund t'i luftojmë.

Sektarizmi i Grupit të Korçës është shprehur, gjithashtu, në lokalizmin e njohur të tij, që e ka dëmtuar shtrirjen e punës së grupit dhe nuk e ka lejuar atë të marrë kontakt në një shkallë më të gjerë me lëvizjen komuniste dhe demokratike anembanë vendit. Shokët korçarë kanë ndikuar edhe në shokët e Grupit të Korçës, që s'janë nga Korça, për një punë pak a shumë të mbyllur e lokale. Pikëpamjedhe qëndrime të tilla të ngushtojnë horizontin e punës dhe të vështrimit, të krijojnë ndjenjën e vetë-kënaqësisë dhe të unit, ushqejnë mendjemadhësinë, sidomos tek ata që i kanë këto në karakterin e tyre.

Në një gjendje të tillë, shoku Koço (iu drejtova këtij), Grupi ynë i Korçës ua la rrugën hapurt trockistëve Niko Xoxi, Aristidh Qendro e të tjerë, për të dalë nga Korça dhe për të marrë kontakt me të rinj revolucionarë në qytete të ndryshme të vendit tonë, duke shkatërruar kështu atë punë të nevojshme e revolucionare që duhej të bënte me ta vetë grupi në mënyrë të organizuar. Ç'bëmë ne të grupit në Tiranë dhe në Shkodër? Ç'bëre ti, shoku Koço në Tiranë? Si doli fraksion Grupi i «Të Rinjve» nga Grupi ynë i Korçës? A nuk tremi edhe ne përgjegjësi në këto gabime, në këto devijime dhe në këtë luftë shterpë, që u zhvillua në mes grupeve? Unë mendoj, se tremi, po të analizojmë ca më thellë punën tonë. Natyrisht, una nuk pranoj as për grupin tonë, as për ne, si individë, gabimet dhe fajet e grupeve të tjera, dhe të anëtarëve të tyre. Por ato gabime e fajet, aq sa na përkasin neve, duhet t'i njohim dhe jo të lajmë duart.

Në vazhdim zhvillova një çështje tjetër:

- Shoku Vasil dhe ti, Anastas Lula, - iu drejtova atyre, - ju me grupet tuaja keni bërë një gabim të madh që nuk i pranuat direktivat e Kominternit. Kjo ka dëmtuar rëndë shëndoshjen e lëvizjes komuniste në Shqipëri, ka lejuar depërtimin e trockizmit në radhët tona, ka frenuar edhe luftën e organizuar masive kundër Zogut dhe regjimit të tij. Këto gabime ju duhet t'i njihni.

- Ne, nga ana jonë, s'kemi pse t'i njohim, ndërhyri Anastasi. I tillë tip që ai. Hidhte batutën, helmin e s'fliste, s'argumentonte më tej.

- Qysh more s'i njihkeni gabimet! - i tha Sotir Vullkani. - Pa na thua, pse?

- Pa më thoni ju, kur kanë ardhur ato udhëzime në Shqipëri? - tha Anastasi me një ton prej ngadhënjimtari dinak.

E kuptova se ku donte të dilte skilja e vjetër, - ndaj iu përgjigja me gjakftohtësi:

- Më 1937.

- Po ne më 1937 nuk qemë akoma as fraksion, pale grup, - foli rëndë-rëndë Anastasi. - Grupin tomë ne filluam ta krijojmë që më 1938 e dolëm më vete si grup më 1940. Atëherë, qysh të mbajmë përgjegjësi për një gjë që ka ndodhur përpara se «të lindim»?

U hodhi një shikim triumfues shokëve dhe u ul i bindur se na zuri në dhokan. Por s'e lashë ta konsumonte gjatë «ngadhënjimin».

- Anastas Lula, - i thashë, - lëri sofizmat dhe --argumentet» prej llogaritari mediokër dhe gjyko drejt!

Vërtet udhëzimet e Kominternit mbërritën në Shqipëri më 1937, por ato nuk qenë vetëm për atë vit, por për krejt periudhën që kishim përpara, pra edhe për atë kohë kur ti nise fraksionin, dhe për kohën kur dole hapur si grup. Bile thelbi i tyre - domosdoshmëria e lidhjes së komunistëve me masat, puna me masat, krijimi i frontit të gjerë antifashist – vliente për dje, për sot e do të na vlejë edhe në të ardhmen.

Pa bërë masat për vete, pa krijuar lidhjet e fuqishme të të gjithë popullit, të të gjitha forcave rreth Partisë, çështja jonë s'do të ecë përpara. Këtë na mësojnë udhëheqësit e mëdhenj të proletariatit, këtë frymë kishin e kanë edhe direktivat e Kominternit. Prandaj, Anastas Lula, e ritheksoj, ju duhet ta njihni gabimin e rëndë që keni bërë deri tash, e të mos lejoni më të përsëritet.

- Vetëm Grupi i Korçës i pranoi e i bëri të vetat, - tha Koçoja me mburrje.

- Është e vërtetë, - vazhdova, - clë Grupi i Korçës nuk gaboi në këtë drejtim dhe këtë ne ia detyojmë, në radhë të parë, Ali Kelmendit për orientimin e drejtë që i kishte dhënë grupit tonë qysh kur ishte në Shqipëri. Ne i pranuan direktivat e Kominternit dhe u përpoqëm që t'i zbatonim në jetë. Por çështjen duhet ta gjykojmë drejt: Si i zbatuam në këto direktiva? A i likuiduam vallë plotësisht celulat e vjetra të mbyllura, sektare dhe a u futëm në masat e gjera të popullit? A iu vunë punës të krijojmë nga radhët e tyre celula të reja, të shëndosha, luftarake dhe të ndërtonim një detashment të vërtetë të organizuar jo vetëm të punëtorëve të Korçës, por të të gjithë vendit? Shoku Koço, - iu drejtova atij, - ne duhet të njohim haptazi se nuk i plotësuam detyrat që morëm. Celulat vërtet i shpërndamë, por edhe ato që krijuam përsëri ca më vonë ishin po ashtu, të ngjashme, gati si të parat, me një ndryshim të vogël njerëzish dhe parimesh. Është e vërtetë që ndikimi i grupit u ndie në masa më shumë, por vetëm në qytetin e Korçës. Është e vërtetë se rinia korçare u organizua më mirë dhe ishte nën ndikimin e grupit, por jashtë qytetit, në fshat dhe jashtë Korçës, çështja i ishte lënë spontaneitetit. Me disa bërthama të vogla që krijuam atje, nuk mund të pretendonim se idetë e mëdha të Kominternit u morën seriozisht në duart e grupit tonë dhe u vunë në jetë si duhet. Ne nuk mund t'i shmangemi një përgjegjësie të madhe dhe të mos i njohim këto të meta e boshjleqe. Grupet e tjera kanë vepruar fare në kundërshtim me direktivat e Kominternit dhe, natyrisht, përgjegjësia e tyre është më e madhe.

Këtyre çështjeve, - theksova, - unë personalisht u vë një rëndësi të madhe, pse kanë pasur konsekuenca të dëmshme për punën në të kaluarën dhe, në qoftë se nuk i spastrojmë të metat dhe gabimet që kanë pasur grupet, Partia jonë e sapoformuar do të vuajë shumë. Do të ccim ne duke ruajtur frymën e grupit në Partionë Komuniste? Në asnjë mënyrë jo! Këtë frymë duhet ta varrosim në këtu, që sot, njëherë e përgjithmonë. Por do të jemi naivë, në rast se

mendojmë se, me të dalë këtej, çdo gjë do të shkasë si në gjalpë. Jo, ne do të na duhet t'i luftojmë pa mëshirë frymën dhe metodat e sëmurë të punës së grupit, do t'i luftojmë pa hezitim fraksionet dhe fraksionistët. Nga kjo Mbledhje duhet të dalim të çliruar prej ndjenjës së epërsisë e të pagabueshmërisë së gjithsecil: grup dhe të armatosur me ndalnjën e unitetit të çëiiktë marks ist-leninist të Partisë Komuniste të Shqipërisë që formuam.

Kur u shpjeguan qëndrimet politike, ideologjike dhe organizative që tremi mbajtur kundër fashizmit okupator dhe qeverisë kuislinge, bëra një ndërhyrje tjetër në mes të ndërhyrjeve të shokëve të grupeve të ndryshme.

- Në të Grupit të Korçës, - vura në dukje, e tremi ttiënë dhe e themi se nuk tremi gabuar as në vijë, as në qëndrimet që kemi mbajtur dhe që vazhdojmë të mbajmë kundër fashizmit okupator. Për dy grupet e tjerë, dua të them krerët e tyre, me pikëpamjet e gabuara janë përpjekur, e deri diku ia kanë arritur, të pengojnë veprimtarinë aktive antifashiste të njerëzve të balës, komunistë, të rinj e të tjerë.

- Don.ETHËNË, - ndërhyri Sadik Premtja, edhe ti je i mendimtar se Grupi i Shkodrës dhe Grupi ynë i «Të Rinjve» nuk kanë qenë kundër okupacionit fashist italian. Kjo është akuzë...

- Unë s'e thashë r. ;ë gjë të tillë, - iu përgjigja.

- E tha Koço Tac Ikoja hapur fare. Po dhe ndërhyrja juaj atje të çon, - vazhdoi Sadiku.

- Nuk është aspak, siç thotë Sadik Premtja, iu drejtova Mbledhjes. - Ndërhyrja ime qëndron në këto çështje:

Në qoftë se Koço Tashkoja, në ndërhyrjet e tij jo fort të kontrolluara dhe me nervozizëm, tra lënë të kuptohet se dy grupet e tjera nuk kanë mbajtur qëndrim kundër okupatorëve, unë nuk bashkohen me këtë mendim të tij. Të gjithë ne, bashkë me popullin, u ngritëm në këmbë kundër okupatorit dhe tradhtarëve, të gjithë dolëm në demonstrata dhe kërkuam armë të luftonim, por duhet njohur se ne nuk ishim në gjendje të organizonim luftën e të goditnim armikun që në ditët e para. Më vonë e morëm veten, i organizuam më mirë rezistencën dhe propagandën kundër pushtuesit, mendonim rrëzë seriozisht për luftë, po edhe atëherë nuk u arrit që këtë punë ta bënin të gjitha grupet njësoj. Mendimi im është se Grupi i Korçës i shikonte më drejt problemet dhe detyrat që na viheshin përpara. Grupi i Shkodrës tra qenë i vendosur kundër okupatorit, tra qenë antifashist, por, siç e theksova edhe më parë, krerët e tij disa çështje të mëdha parimore nuk i kishin të qarta. Kurse, krerët e Grupit të «Të Rinjve», pikërisht të dy shokët që janë këtu, Anastas Lula dhe Sadik Premtja, jo vetëm nuk i kishin aspak të qarta këto çështje, por pikëpamjet e tyre mbanin erë antikomuniste e trockiste.

- Përsëri protestojmë! - u hodh përpjetë Anastasi. - Mua dhe Sadikun po na akuzoni rëndë. Ku i mbështetni ato që thonin?!

- Në një sërë pikëpamjesh e parullash të përquara e të propaganduara prej jush, - i thashë, dhe shpjegova përmbajtjen disfatiste të parullës së tyre «nuk tra ardhur akoma koha të luftojmë, sepse nuk kemi as organizim, as armë» dhe, në vazhdim, denoncova e dënova edhe pikëpamjet e krerëve të tillë, si Aristidh Qendro, Andrea Zisi e të tjerë «për t'u futur në Partinë Fashiste Shqiptare dhe në kuesturë që të marrim vesh ç'bëhet», «për të mos e konsideruar gabim as kallëzimin në polici» etj. Baza e grupeve në të vërtetë nuk i pranonte këto parulla, por krerët anti marksistë e agjentë të borgjezisë e të okupatorit, që përmenda, arrinin me një mijë mënyra t'u imponoheshin e t'i mbanin shokër e bazës në fre.

- Shokëve të Grupit të Korçës, - vazhdova më tej, - na u desh t'u shpjegonim Paktin e Mossulimit sovjetogjerman. Këtë gjë e bëmë edhe në popull, sepse kjo ishte një çështje shumë delikate, të cilën

ar
nriku po e shfrytëzonte në kulm, prandaj neve na u desh t'u shpjegonim shokëve përmbajtjen dhe qëllimin e atij pakti, t'i sqaronim e t'i bindnim se Bashkimi Sovjetik ishte dhe qëndroi ai që kishte qenë, atdheu i lavdishëm i Leninit e i Stalinit.

Në vazhdim të sqarimit të këtij problemi nënvizova se Grupi i Shkodrës nuk u aktivizua si duhet në këtë drejtim, ndërsa ai i «Të Rinjve» aspak, përkundrazi, e përdorën Paktin e Mossulimit në shërbim të teorive të tyre trockiste. «Ja, - thoshte Anastasi, vërtetohet se kemi ne të drejtë dhe jo ju, kur themi se s'ka ardhur koha të luftojmë», «tremi të drejtë kur gjykojmë se duhet të presim sa të industrializohet vendi, të krijohet proletariati, pastaj të krijojmë partinë», «të formohen më parë kuadrot, pa të hidhemi në luftë», «t'i ruajmë e të mos i sakrifikojmë kuadrot», e shumë dokrra të tjera, që njihen tash nga të gjithë. Mirëpo kjo punë armiçësore nga krerët trockistë të grupeve pengonte grumbullimin e energjive komuniste në rezistencë e në luftë. Këta krerë trockistë

vazhduan veprimtarinë e vet disfatiste edhe kur u sulmua Bashkimi Sovjetik. U përpoqën të sabotonin grevat e demonstratat që arritëm më në fund të organizonim bashkërisht ne, Grupi i Korçës me Grupin e Shkodrës. Në vazhdim të ndërhyrjes sime fola, gjithashtu, edhe për bashkëpunimin e ngushtë që kishim arritur të vendosnim me patriotin e shquar, Myslim Peza, dhe me patriotë të tjerë. Ngrita në mënyrë të veçantë çështjen e fshatarësisë dhe vura mirë në dukje rolin e madh të saj në luftën tonë çlirimtare, duke treguar se Grupi i Korçës këtë çështje jetike në parim e shi:conte drejt, por në praktikë nuk kishte bërë shumë ,gjëra. Të tjerët, si në teori edhe në praktikë, e nënvieftësonin, kurse Anastas Lula nne shokë me teorinë e tyre antileniniste, ua linin fsha<,ai-ësinë borgjezisë dhe fashizmit.

Të gjitha këto çështje të mëdha kërkova t'i vle` rësonim drejt, se kishim humbur kohë dhe këtë kohë ,duhej ta fitonim.

Si për problemet e tjera, edhe për këto, u zhvilluan debate të zjarrta. Grupi i Anastasit u gjuhëzua. ,Me gjysmë goje ai u detyrua të pohonte se kishte menduar gabim, «porse. .. ruk ishte tamam kështu. ...», se, «në praktikë qe ashtu, por...», njëqind -por-e». Të gjitha këto ishin jo vetëm për të na hedhur hi syve, por, siç e tregoi vetë jeta, ato përbënin shkëmbinj mbi ujë dhe nën ujë, ishin mina që u viheshin në rrugë rezistencës dhe luftës kundër okupatorëve. Duhej spastruar kjo rrugë për Partinë e për popullin, .duheshin çmontuar minat e dukshme dhe të padukshme. Prandaj ato ditë, në ato momente të zjarrta kur vendosej fati i popullit dhe i atdheut, komunistët shqiptarë zhvilluan një betejë të madhe, të ashpër dhe fituan.

Komunistët e grupeve që ndodheshin në këtë mbledhje u çliruan nga një grumbull i madh pikëparnjesh të dëmshme në kokën e tyre. I nxorën në shesh atol, diskutuan lirisht dhe i dënuan, i bënë kritika të ashpra njëri-tjetrit dhe përfituan shumë nga kjo shkollë e madhe. Sidomos do të përfitonte shumë gjithë Partia jonë e re që formuam.

Si do të ishte kjo Parti, si do të organizohej, cili do të ishte programi i saj minimal për kohërat që kalonim? Gjithë shokët e grupeve, që morën pjesë në diskutimin e këtyre çështjeve jetike, dhanë mendimet e tyre, që puqeshin në vija të përgjithshme, Edhe unë e trajtova gjerë këtë problem në diskutimin tim;, i cili në esencë konsistonte

- Ne, shokë, vendosëm të madhen, kryesoren, themeluan mbi baza marksiste-leniniste Partinë Komuniste të Shqipërisë. Gjithashtu diskutuam haptazi për anë t e mira dhe të këqija të grupeve komuniste. I goditëm vërtet të këqijat, por luftën duhet ta vazhdojmë edhe paskëtaj që të mos lejojmë më të përsëriten të atilla gabime ose të ngjashme me to, të veshura me forma të tjera dhe në rrethana të reja, që do të na krijojë Lufta Nacionalçlirimtare. Anët e mira të grupeve, sidomos anët pozitive të punës që kanë zhvilluar ato, duhet t'i vëmë në shërbim të Partisë dhe të luftës, por të mos vetëkënaqemi me ato pak rezultate që janë arritur. Këtëj e tutje, për të forcuar unitetin në Parti, të mos lejojmë në asnjë mënyrë diskriminimin në radhët e anëtarëve të Partisë, pavarësisht nga ç'grupe kanë ardhur ata. S'ka dhe s'duhet të ketë paragjykime të grupeve as në skutat e ndërgjegjes së ndokujt.

- Shumë drejt, - ndërhyri Vasil Shanfoja, dhe propozoj që këtej e tutje të mos dëgjohet askush të thotë: -«Jam anëtar i këtij ose i atij grupi». Tash e tutje ka vetëm anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

- Plotësisht dakord, - thashë dhe vazhdova: S'ka më as anëtarë, as krerë të grupeve, ata nuk ekzistojnë më. Tash e tutje do të ketë udhëheqje të Partisë, Komitet Qendror dhe komitete qarkore. Formimi i Partisë sonë i likuidoi grupet përgjithmonë, pra duhet të likujdojë edhe frymën dhe praktikën e punës së tare. Me zgjedhjen e Komitetit Qendror nga kjo Mbledhje, ne likujdojmë «pushtetin dhe ndikimin» e krerëve të grupeve komuniste. E përsëris edhe një herë atë që tha edhe Vasili: S'ka më anëtarë grupi. Tash e tutje do të ketë vetëm anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Cilët do të jenë ushtarët e Partisë, domethënë anëtarët e pare' të saj? Shokët këtu diskutuan, të tjerë do të diskutojnë më pas. Unë bashkohem me mendimin se ushtarë të Partisë sonë do të jenë anëtarët e organizuar të ish-grupeve komuniste të Korçës, të Shkodrës dhe të «Të Rinjve» pasi ata të shoshiten, prandaj ne duhet të marrim vendim që, me të mbaruar Mbledhja, të përgatitim brenda një

afati sa më të shkurtër listat ekzakte të anëtarëve të grupeve. Them ekzakte, duke kuptuar me këtë që listat të mos zgjaten me njerëz që nuk kanë qenë aktivë ose që janë të dyshimtë, për të rritur numrin, me qëllim që njëri ose tjetri grup të dominojë në Parti. Por as të paraqiten lista të shkurtra për të fshehur e për të ruajtur aktivistët për një punë eventuale grupazhi jashtë Partisë. Këto lista duhet t'i dorëzohen sa më parë Komitetit Qendror që do të zgjidhet.

Këtu u diskutua shumë për bazat mbi të cilat do të ndërtohet Partia. Mendimi im është se Partia jonë duhet të ndërtohet në shembullin e Partisë Bolshevike qoftë ideologjikisht, qoftë organizativisht. Sir pas kësaj eksperience, me sa dimë, duhet që baza e saj të jetë celula, në të cilën do të militojnë komunistët. Anëtarët e celulës do të zgjedhin sekretarin e saj dhe komunistët e qarkut ose të deleguarit e tyre do të zgjedhin komitetin qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Tani për tanfi, mendoj që kuar drot kryesorë të qarkorëve, sekretarin pohtik e atë organizativ, t'i caktojë Komiteti Qendror derisa të krijojë situata të përshtatshme, gjithë Partia do të dërgojë delegatët e vet në Konferencën e Vendit, e cila, në këto kushte, do të luajë rolin e një kongresi partie dhe, si e tillë, do të jetë instanca më e lartë udhëheqëse e Partisë, që do të përcaktojë vijën e saj dhe do të zgjedhë Komitetin Qendror Definitiv.

Në lidhje me funksionimin, normat dhe parimet e Partisë së re, në Mbledhje pati diskutime të gjalla e konkrete, pati debate dhe propozime me vlerë. Ngriheshim e flisnim thuajse të gjithë me radhë, ose shokët e shfaqnin mendimin e tyre me ndërhyrje të ndryshme. Me këto diskutime e debate po përpunohej vija programatike e Partisë, bazat e normat mbi të cilat do të ndërtohej ajo. Kështu, ndër të tjera, theksuam

Në Partinë tonë do të ekzistojë centralizmi demokratik, do të sundojë kritika dhe autokritika bolshevike, e hapur dhe e sinqertë. Partia jonë do të ketë në bazë dhe do të udhëhiqet në çdo veprim nga teorig e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit. Partia jonë është kundër fraksioneve dhe grupazheve, të cilat do t'i luftojë pa mëshirë. Partia jonë do të inkurajojë shfaqjen e mendimeve, por mendimi i shumicës do të predominojë mbi pakicën; kjo duhet t'i bindet shumicës. Partia jonë duhet të ketë disiplinë të çeliktë, të ketë unitet mendimi dhe veprimi marksist-leninist. Pa një disiplinë të çeliktë dhe unitetin e Partisë, Partia jonë, e cila do të ndeshet me një numër të madh armiqsh, nuk do të mund ta udhëheqë me sukses luftën.

Partia do të luftojë të gjitha ideologjitë dhe rrynat antimarksiste. Por, për ta kryer këtë sa më mire, duhet të ngulim këmbë energjikisht për lartësimin ideologjik teorikisht e politikisht të kadrove dhe të anëtarëve të saj duke studiuar teorinë marksiste-leniniste.

Partia jonë duhet të jetë pararoja e organizuar e klasës punëtore, kurse fshatarësinë do ta konsiderojë si një klasë mike dhe aleate të klasës punëtore e do të mbështetet fuqimisht në të, sepse fshatarësia jonë do të luajë një rol të madh si në Luftën Nacionalçlirimtare ashtu edhe më vonë.

Ky ishte një problem i rëndësishëm që duhej theksuar dhe duhej ta kishin të qartë të gjithë komunistët. Partia jonë ishte themeluar si parti e klasës punëtore që do të udhëhiqej nga ideologjia marksiste-leniniste, pavarësisht se në vendin tonë kjo klasë ishte shumë e vogël, me një numër punëtorësh me mëditje, çirakësh ose zanatçinjsh dhe jo me eksperiencë të afirmuar në luftëra e në përpjekje grevash klasore e sindikale.

Greva punëtorësh ishin bërë në të kaluarën në disa qytete të ndryshme të vendit tonë, por edhe ato të vogla, jo të koordinuara me njëra-tjetrën, si për arsye të numrit të vogël të punëtorëve, ashtu edhe të mungesës së organizimit në sindikata dhe të një borgjezie industriale të ngritur. Grevat e punëtorëve, si ato në Korçë, në Kuçovë ose në Shkodër, kishin pasur, natyrisht, karakter ekonomik klasor, por ato

kishin marre' edhe karakter antishtetëror, kundër qeverisë dhe masave të saj shtypëse. Karakter më të theksuar klasor kishte pasur greva e punëtorëve të Kuçovës, që ishte drejtuar njëkohësisht kundër shfrytëzuesve kapitalistë, të cilët qenë koncesionarët italianë. Kurse shoqëria «Puna» e Korçës kishte pasur for

mat e para të grumbullimit të punëtorëve dhe të zanatçinjve të qytetit për mbrojtjen e të drejtave të tyre ekonomike kundër punëdhënësve. Kjo shoqëri nuk kishte munguar të luftonte edhe për të drejtat demokratike dhe politike deri në atë shkallë sa anëtarët e

simpatizantët e saj dolën edhe në rrugë, ku u përleshën për «bukë» me xhandarmërinë e Zogut. Natyrisht nuk do të zgjatëm këtu në këtë problem, pse këtë çështje kapitale Partia, në vija të përgjithshme, e ka analizuar dhe me siguri historianët dhe sociologët tanë do ta thellojnë atë me studime të mëtejshme, por dua të theksoj se, kur themeluan Partinë, ne i njihnim edhe të metat e dobësitë politike, ideo

logjike e organizative të klasës punëtoare, por njihnim, gjithashtu, edhe traditat e saj luftarake, shpirtin revolucionar, misionin e saj historik, prandaj që në Mbledhjen Themeluese nënvizuam se Partia jonë do të ishte repart pararojë e i organizuar i klasës punëtoare.

Por, duke pasur parasysh këtë, Partia asnjëherë nuk nënvleftësoi rolin dhe peshën e madhe të fshatarësisë në luftë e në revolucion. Që në ditët e para të Baj, Partia pati parasysh se në luftën kundër okupatorëve ajo dhe klasa që përfaqësonte duhej të mbështeteshin te fshatarësia. Fshatarësia ishte e shtypur lëkund, ajo nuk kishte tokë ose kishte fare pak, rronte në errësirën mesjetare feudale dhe në një mjerim të pashoq. Mjerimit të fshatarësisë gjatë shekujsh, të shkaktuar nga bejlerët, feudalët, borgjezia e madhe tihe e vogël fajdexheshë, nga agallarët dhe pronarët e mëdhenj të tokave, iu shtua edhe shtypja nga okupatori italian, grabitësi i lirisë dhe i pavarësisë së atdheut, ai që po sillte kolonët e vet dhe po e nxirrte fshatarësinë nga toka e saj. Fshatarësia jonë kishte tradita të mëdha revolucionare, ajo kishte luftuar më shumë nga qyteti kundër një varg pushtuesish, kundër ligjeve skllavëruese të tyre, kundër taksave etj. Malet dhe fshatrat, nga të cilat fshatarët tane derdheshin mbi armiqtë, kanë pasë qenë kurdoherë qendrat e rezistencës së luftërave çlirimtare. Elementët përparimtarë të qytetit, qofshin këta luftëtarë të penës ose të pushkës, bazën kryesore të tyre e kishin te fshatarësia. Mund të thuhet që për sa i përket zhvillimit të diturisë së gjuhës e të shkollave kjo fillonte në qytete, por, kur vinte puna për pushkë, elementët përparimtarë dhe revolucionarë të qyteteve aleate kishin fshatarësinë. Natyrisht, në ato kohëra, kur nuk ekzistonte klasa punëtoare, fshatarësia ishte objekt i influencave të ndryshme. Luftohej edhe atëherë kush ta bënte dhe ta kishte fshatarësinë me vete, borgjezia që po lindte, apo bejlerët, feudalët dhe pronarët e mëdhenj të tokave. Bejlerët dhe feudalët, të mbështetur edhe nga okupatorët otomanë e të tjerë, e ruanin me mjetet e forcës këtë dominim mbi fshatarësinë, sido që nuk mundnin ta frenonin shumë herë dufin për luftë që shpërthente fshatarësia jonë kundër okupatorëve dhe feudalëve. Këtë e tregojnë këngët popullore, historia e lavdislune gojore e ido epoke.

Por elementët përparimtarë të borgjezisë së qyteteve, që ngriheshin, dhe elementë përparimtarë e patriotë me influencë, që shkëputeshin nga klasa e tyre e bejlerëve dhe e feudalëve, luftonin për zgjimin e fshatarësisë dhe u bënë konkurrentë të klasës feudale për Via minuar kësaj ndikimin në fshat.

Natyrisht, ka edhe faktorë të tjerë që konkurronin në këtë luftë që përmenda shkurtimisht më lart, siç janë sidomos fetë e ndryshme, krerët e të cilave ndihmonin edhe të huajt, por edhe klasat sht'ypëse të feudalëve dhe të borgjezisë spekulative. Megjithatë në besimtarët. në popull të të gjitha feve, kishte korrente liberale, veçanërisht në ato myslimane dhe ortodokse, korrente që e theksonin më tepër animin e fshatarësisë nga borgjezia priroarimtare. Shpirti patriotik revolucionar. lufta kundër varfërisë dhe shtypjes e shtynte fshatarësinë tonë krenare jo drejt ateizmit, siç e kuptojmë ne komunistët. por në atë rrugë që «fenë e besoj, sepse ashtu është gjendur, pse i atij besimi kam lindur dhe ashtu do të vdes. etj. Në luftën e madhe që na priste. ne do të mbështeteshim pikërisht te këto masa, te këto tradita, prandaj në diskutimin tiro theksova

- Partia duhet të luftojë sektarizmin dhe opor tunizmin qoftë në mendime, qoftë në veprime. Duhet të shtojmë radhët e Partisë, para së gjithash me elementë të shëndoshë punëtorë, por edhe me fshatarë e me luftëtarë të tjerë revolucionarë. Të gjithë ata që do të pranohen në Parti duhet të provohen në luftë për qëllimet e Partisë. Tu mbyllim dyert e Partisë spiunëve dhe provokatorëve të maskuar, t'u mbyllim derën llafazanëve e frikamanëve, t'u mbyllim derën elementëve fraksionistë,

anarkistë e intrigantë, të cilët do të mundohen të depërtojnë në radhët e saj për të shkaktuar aty ngatërresa e për të krijuar shesh për punë trockiste e antiparti.

Vendin kryesor në programin e Partisë sonë duhet ta zërë lufta e organizuar dhe e pamëshirshme kundër okupatorëve dhe tradhtarëve. Ne kemi si pikësynim kryengritjen e përgjithshme me armë, atje duhet të mobilizohet gjithë populli, por, që të arrijmë në kryengritjen e përgjithshme, duhet të zhvillohen format më të thjeshta të luftës, demonstratat, sabotimet, atentatet, aksionet e njëpasnjëshme. Partia në qytete duhet të organizojë njësitet guerile, kurse në fshatra duhet të formojë çetat e partizanëve e të vullnetarëve të lirisë, nga të cilat do të organizojë në luftë e sipër njësitë e mëdha që do të formojnë ushtrinë e popullit. Prandaj Partia duhet të zgjerojë punën ndër masat e të bëjë kudo një politikë të gjerë për të mobilizuar popullin, gjithë njerëzit e ndershëm, të gjitha forcat patriotike e antifashiste në luftën e madhe. Gjithë populli duhet të bindet se lufta me armë në dorë është i vetmi shpëtim nga robëria dhe se në këtë luftë ai do të fitojë. Populli duhet të bindet për forcën dhe për vijën e drejtë të Partisë. Partia jonë e re duhet të jetë në ballë të luftës, atje ku është rreziku më i madh, atje ku janë sakrificat më të mëdha, atje të jenë komunistët.

Partia duhet të thotë popullit se luftohet që ai të marrë vetë fuqinë dhe, kur Via arrijë kësaj, Partia do të bëjë reforma të mëdha ekonomike, kulturore, shoqërore. Partia do të thotë popullit se «liria fitohet, nuk dhurhet». Prandaj Partia Komuniste e Shqipërisë do të formohet, do të jetë Partia që do të udhëheqë, Luftën Nacionalçlirimtare dhe popullin në fitore. Ky duhet të jetë misioni i madh i Partisë në vija të përgjithshme.

Pasi u shfaqën këto mendime dhe u diskutua përkëto probleme të rëndësishme nga të gjithë shokët, në fund vendosëm njëzëri që këto parime si dhe konkluzionet e vendimet e kësaj Mbledhjeje historike, që themeloi Partinë Komuniste të Shqipërisë, të përbënin përmbajtjen e sintetizuar të «Rezolucionit të Mbledhjes së Grupeve Kryesore Komuniste të ShqipërisëA për krijimin e Partisë». Pas gjithë këtyre i erdhi radha çështjes së fundit: zgjedhjes së Komitetit Qendror. Fillimisht shokët ranë dakord me propozimin që u bë, që ky Komitet që do të zgjidhim të ishte i përkohshëm gjer në thirrjen, e një konference të Partisë të vendit. Po kush do të zgjidhet? Ky nuk ishte një problem i thjeshtë po të, kihet parasysh që në Mbledhje merrnin pjesë krerë të ish-grupeve, nga ata që gjithnjë kishin pretenduar për të qëndruar në krye të gjithçkaje. Damosdo, qejfi do t'ua kishte të ishin përsëri në «akryesinë» e Partisë së re. Aq më shumë, cili kryetar i ish-grupeve do të ishte «kryesori» në krye të Komitetit Qendror? - Lindi Partia Komuniste e Shqipërisë, por megjulla e ish-grupeve nuk ishte e mundur të ishte zhduruar kaq shpejt nga mendja e ndërgjegjja e anëtarëve të tyre. Prandaj, shumë shokë, mes tyre dhe unë, kishim mendimin që me pdo kusht ish-krerët e grupeve të mënjanohehin nga udhëheqja. Ky vendim do të kishte një rëndësi të jashtëzakonshme për unitetin e udhëheqjes së Partisë së porsakrijuar, rrjedhimisht edhe për gjithë Partinë.

Pikërisht se gjykuam kështu, prandaj me çdo kusht duhej gjetur mënyra për t'i mënjeluar krerët. Për këtë -edhe mundësitë ekzistonin. Veç periudhës para Mbledhjes, sidomos 6-7 ditët e debateve në Mbledhje, ua kishin nxjerrë kallajin krerëve, ata ishin goditur më rëndë se kushdo, qenë ngarkuar me përgjegjësi për -dobësitë e mëparshme në lëvizjen komuniste në Shqipëri.

Këtu bëri një ndërhyrje të zgjuar Miladini, në rolin që kishte luajtur si arbitër në mes grupeve, dhe tha:

- Shokë, kam parasysh këtu një mendim ose propozim që ka bërë shaku Tashko kohë më parë. Ai ka propozuar që si një ndër krerët e ish-grupeve të mos zgjidhet në Komitetin Qendror. Mendoj se propozimi është me vlerë jo vetëm për të, por edhe për të tjerët. Prandaj unë, dulce e parë propozimin vetjak të Koços në kuadrin e përgjithshëm, i sugjeroj Mbledhjes që në përbërjen e Komitetit Qendror të Përkohshëm të Qnos zgjidhet asnjë nga krerët e ish-grupeve, as kryetarët, as nënkryetarët.

Menjëherë m'u kujtua se në një takim, para fillimit të Mbledhjes, ku veç disa shokëve tanë ishte edhe Miladin Popoviçi, kur ne po bisedonim se krerët grupeve kishin penguar bashkimin në të kaluarën

dhe se si ata po bëheshin akoma pengesë, Koço Tashkoja ishte skuqur nga zemërimi dhe në inat e sipër tha:

- Po të jetë se kam penguar unë, atëherë, hiq rënë. Por s'jam unë që kam penguar, të tillë janë ata të Shkodrës e të «Të Rinjve»...

Isha i bindur se Koçoja këtë e bënte thjesht për demagogji, për t'u dukur «i gjerë», «parimor», që «i dhimbsej çështja» etj. Bile edhe në një nga ndërhyrjet e tij gjatë Mbledhjes, Koçoja, si kalimthi e kishte përsëritur atë gjë.

Koço Tashkos, kur dëgjoi Miladinin, sikur i rapika dhe tha:

- Dale, të kuptohemi... Unë fjalën e kisha...

- Shumë drejt e kishe, - i tha Piloja me serio

zitet, por edhe me qesëndisje. - Jam dakord të mos zgjidhen kryetarët.

Anastas Lula e Sadik Premtja e përmbajtën ze rënë. S'dinin kujt t'i hakmerreshin. Koços apo vetes? Vetëm Vasil Shantoja e priti vendimin e Mbledhjes me qetësi e me një gjerësi prej komunisti të vërtetë e të devotshëm. Nuk mbaj mend kush propozoi dhe «kompromisi» u pranua që kandidaturat për në Komitetin Qendror t'i përgatiste e t'i paraqiste një komision prej 3 vetash, nga shokët që pak a shumë kishin qenë në krye të grupeve e merrnin pjesë në atë Mbledhje. Pra, në komision u zgjodhën Koço Tashkoja, Vasil Shantoja e Anastas Lula. Por ky komision nuk veprroi shkëputur nga konsultimet me shokët pjesëmarrës në Mbledhje, e jo vetëm secili me shokët e grupit të vet, por dhe në konsultime me të tjerë. Kandidaturat u caktuan duke pasur parasysh të kaluarën e tyre, rolin që luajtën në Mbledhje njëri e tjetri, duke pasur parasysh dhe origjinën klasore e duke vendosur një proporcion të drejtë në mes numrit me origjinë ose gjendje punëtore dhe intelektuale. U mbajt parasysh, që të ruhej deri diku, brenda mundësive, njëfarë ekuilibri, duke përfshirë në Komitetin Qendropërfaqësues sa më të shëndoshë nga ish-grupet.

Kështu, pasi u diskutua për këto çështje e për karakteristikat që u paraqitën, Mbledhja zgjodhi një Komitet Qendror të Përkohshëm prej 7 vetash. Ata qenë: Enver Hoxha, Qemal Stafa, Ramadan Çitaku, Koçi Xoxe, Tuk Jakova, Kristo Themelko e Gjirë Marku.

Për të siguruar unitetin, nuk pati zgjedhje për kryetar ose sekretar të Komitetit Qendror. Pariteti i plotë u vu në themel të të gjithë punës, si për përgatitjen, ashtu edhe për zhvillimin e punimeve të Mbledhjes për Themelimin e Partisë. Nuk duhej kryer asnjë akt që mund të krijonte përshtypjen se një grup kishte më shumë të drejta dhe avantazhe se tjetri.

Kështu, pas 7 ditësh pune intensive, Mbledhja mbaroi punimet me një fitore të madhe, Themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, me një vijë të drejtë e program të qartë.

Me gëzim në zemër e plot entuziazëm iu vumë, punës me zell e me optimizëm.

Partia në veprim

Ne dolëm nga Mbledhja Themeluese, ku punuam ,ihe luftuam ditë e natë për Partinë tonë Komuniste, të formuar si parti e tipit të ri që do të na udhëhiqte .dhe na udhëhoqi, që na edukoi, na kaliti si komunistë me ideologjinë e saj të lavdishme marksiste-leniniste, na çoi në betejë, na mësoi si të luftonim drejt, si të mendonim drejt, si të organizonim drejt, si të ڤilleshim drejt në çdo gjë. Kësaj Partie do t'i shërbemim tërë jetën tonë. Mbledhja e armatosi Partinë me një program të qartë luftarak, marksist-leninist, program që u përgjigjej, në vija të përgjithshme, detyrave më imediate që na shtroheshin. Me këtë program ne u hodhëm në veprim. Në procesin e punës e të luftës do të forcoheshim ne, do të forcohej Partia, do të përpunohej e plotësohej më mirë edhe vetë programi luftarak i Partisë sonë.

Ky program, i cili qysh në ditët e para e deri sot, ka ardhur vazhdimisht duke u plotësuar e duke u forcuar, ka qenë e mbetet program lufte e pune, për të mirën e atdheut e të popullit. Ne, komunistët e parë, qemë djem e vajza të këtij populli dhe për ne nuk ishin të panjohura hallet e dëshirat e tij, lufta që ai kishte zhvilluar e zhvillonte me shtypësit e vet. Këto na i kishte mësuar historia e shkruar dhe e pashkruar.

Familjet tona kishin luftuar e luftonin në mes të këtyre ngjarjeve dhe kjo luftë klasash, luftë influencash, goditjesh me armë dhe përpjekjesh me penë e me libër na kishin lëkundur në djepet tona të vegjëlisë.

Ne, komunistët e ardhshëm, u rritëm në mes të këtij zjarri, të këtyre përpjekjeve, të këtyre vuajtjeve fizike e shpirtërore të popullit tonë dhe ne, bijtë dhe bijat e tij, u kalitëm e u mësuan në këtë shkollë të madhe të mjerimeve e të luftërave. Ne na mësuan lufta e ilegalëve të Rilindjes, trimëritë e tyre, shkrimet e tyre, na mësuan mjerimet e popullit gjatë Luftës së Parë Botërore, na mësuan rezistenca dhe lufta kundër fqinjëve agresorë dhe imperialistë, na mësuan tmerrin, vrasjet dhe uria e kohës së Zogut, na mësoi fshatari i mjeruar që rripej rrugëve të qyteteve për të shitur një vandak me dru, na mësoi i varfri i qytetit që vende çante çakëll gjithë ditën në rrugë dhe paguhej vetëm nja 2-3 lekë, aq sa kushtonte afërsisht në atë kohë një kilogram bukë.

Të gjitha këto ne, komunistët e rinj të qytetit dhe të fshatit, punëtorë, zanatçinj, fshatarë, argatë, hamej dhe studentë, i kishim plagë në kurriz, i kishim plumba në zemër dhe mësim të rrënjosura në kokë. Kjo e tëra, si me thënë, përbënte bazën e ideologjisë sonë marksiste-leniniste. Këtë na e mësoi më mirë Partia, e cila na tha ta marrim këtë armë, të luftojmë me të dhe atëherë do të fitojmë me siguri jetën, do të fitojmë botën e re. Dhe në fakt kështu ngjau. Po i vure shtëpisë themele të shëndosha, ajo nuk shembet kurrë.

Kështu ngjau me Partinë tonë Komuniste, historia e së cilës nuk është si një përrallë që gjyshja ia tregon nipçes së vogël natën e dimrit ndanë zjarrit. Ja, ajo është një krijesë e lavdishme, e gjallë, revolucionare, e krijuar, e mbujtur dhe e ndërtuar hap pas hapi me një logjikë të hekurt marksiste. Partia jonë nuk ishte as një ndërmarrje aventureske, që do ta merrte tufani i parë, as një lodër kalamajsh që ndër tojnë kështjella në rërë. Komunistët, që e themeluan dhe e ndërtuan Partinë e tyre me gjak e me sakrificë kolosale, mund të ishin të rinj nga mosha, por populli, nga i cili ata kishin dalë, ishte një popull i vjetër, i zgjuar, i urtë, trim, guximtar. Edhe ideologjia që përqaftuan ata ishte e asaj klase që i përkiste e ardhmja, ishte strumbullari i asaj force kolosale që do të ngrëjë-botën në revolucion dhe do ta çojë drejt socializmit e komunizmit. Prandaj bazat e Partisë sonë Komuniste nuk u ndërtuan në rërë, ato u ndërtuan në çelik e në beton. Një hap i gabuar mund të rrezikonte çdo gjë,

dhe një hap i tillë nuk u bë kurrë, gjë që nu'k i detyrohet fatit, por ideologjisë marksiste-leniniste dhe gjithë atyre që ishin të vendosur ta zbatonin atë deri nëvdekje, që kishin vendosur të çanin përmes zjarrit të plumbave dhe të topave, përmes demagogjisë dhe dredhive politike të okupatorëve e të tradhtarëve, të çanin të uritur e të zbatuar në tufan e në borë për të, fituar lirinë për popullin, pavarësinë dhe sovranitetin për atdheun e tyre dhe të ndërtonin atë jetë që na mësonin Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini.

Gjatë vazhdimit të Mbledhjes, asnjë aksident i jashtëm nuk na ngjau. Armiku nuk diktoi asgjë ç'po bëhej. Kishte edhe familje afër shtëpisë ku u bë Mbledhja që diçka nuhatën, ndienin se aty ishin mbledhur njerëz, që rrinin mbyllur ditën dhe dilnin vetëm natën në oborr për të marrë një çikë ajër ose për ndo-një nevojë, por kurrë nuk e hapën gojën. Të gjithë ata ruanin fshehtësinë. Bile na njoftuan se një plak dilte natën te porta e shtëpisë së tij dhe, ashtu në errësirë, ruante rrugën. Një herë i doli befasi nga errësira një person i veshur me mushama si policët e kuesturës ,dhe e pyeti:

- Ç'bën këtu natën te porta, ipse nuk futesh brenda?

Plaku, pa u tronditur, iu përgjigj:

- Po pres çunin se ka shku në farmaci. . .

Shoku me mushama ishte njeriu ynë, një nga ata që bënin rojë. Të nesërmen në mëngjes plaku priti .Xhemal Canin, kur doli në rrugë, dhe i tha:

- Dreqi ta hajë, o zoti Xhemal, me këta policët -e poshtër, edhe këtu në këto rrugë të qeta bëjnë pa-trullim natën, dhe i tregoi ngjarjen.

Me fjalë të tjera, ai donte t'i thoshte Xhemalit: -«Bëni kujdes!». Ja si na ruante populli fukara.

S'duhet harruar se jeta jashtë vazhdonte, vazhdo-nin veprimet antifashiste, por vazhdonte edhe veprim-taria e grupeve. Mbledhja, pjesëmarrësit e sai në të ,s'mund të qenë të shkëputur nga ato që ndodhnin jashtë. Prandaj mbaheshin lidhje të vazhdueshme e të pandërprera. Më kujtohet se Pilon,

për shembull, e dërguam për të mbledhur informata më të plota për -çka ndodhi në Korçë më 8 nëntor, për jehonën e demonstratës, për reagimin e mëtejshëm të fashistëve etj.

Edhe një gjë tjetër duhet të kihet parasysh. Ba-zat ku bëheshin mbledhjet, qoftë kjo ku u Themelua Partia, qoftë edhe shumë 'baza të tjera ku më pas mblidhej Komiteti Qendror ose Komiteti Qarkor i Tiranës etj., ishin njëkohësisht baza që nga e kaluara i dinin shumë të tjerë, komunistë, ish-anëtarë të grupeve, simpatizantë e të tjerë. Ndodhte që pa ditur gjë se atje zhvillohej njëra ose tjetra mbledhje e rëndësishme, ndonjë nga shokët, për arsye të ndryshme, trokiste atje dhe hynte. Ngandonjëherë pranohej, qëndronte atë natë e pastai largohej. Në mbledhje të tjera ndodhte që thirrej nga jashtë njëri ose tjetri për të sqaruar një problem, për t'u ngarkuar me një detyrë etj. Këto ishin më se normale. Ishte luftë, neve na duhej të drejtonim. Më pas ndonjë nga këta «të pranishëm» të rastit ose ndonjë autor që shkruan kujtime të mbledhura për këtë ose për atë ngjarje apo person, gabimisht u vesh këtyre se paskan qenë pjesëtarë të Mbledhjes. Ka pasur bile edhe ndonjë që më pas ka pretenduar padrejtësisht e pa asnjë bazë se ka marrë pjesë edhe në Mbledhjen e Themelimit të Partisë. Dhe e mbështet këtë në trillime me qëllime egoiste, që të ngrejë veten pa të drejtë, ose, në rastin më të mirë, e mbështet në faktin se mund të ketë ndodhur që ai, krejt pa ditur gjë ose i thirrur për ndonjë ndih më apo për të dhënë ndonjë informacion, mund të jetë ndodhur në atë shtëpi në ndonjë rast.

Duhet pasur mirë parasysh kushtet dhe rrethanat e atëhershme. Kur u bë, për shembull, Konferenca e Parë e Vendit e .PKSH në Labinot të Elbasanit, në mars të vitit 1943, mbledhja u zhvillua në shtëpinë e njeriut të afërt të Partisë, Sami Bahollit. Ai veten, shtëpinë, krejt pasurinë, gjithçka ua kishte kushtuar Partisë, popullit, Luftës Nacionalçlirimtare.

Për lidhjet e .tij të forta me ne, për kontributin e meritat e tij të mëdha, unë kam shkruar edhe gjetkë, por këtu dua të theksoj diçka tjetër. Sami Bahollh.

si i zoti i shtëpisë së Bahollëve, i ngarkuar me punë të organizimit e të sistemimit të delegatëve, ishte i pranishëm në shtëpinë ku u zhvillua Konferenca e Parë e Vendit e PKSH. E megjithatë ai, ndonëse kishte qenë komunist që në kohën e grupeve e shok me Qemalin, dhe, si të thuash, de facto një anëtar i devotshëm i Partisë që nga 8 Nëntori 1941, zyrtarisht nuk ishte organizuar akoma në ndonjë celulë si anëtar partie. Kjo u bë menjëherë, pas Konferencës, në prill 1943. Por Samiu i thjeshtë, parimor, i drejtë, si atëherë ashtu edhe në gjithë jetën e tij, asnjëherë s'ka dalë e s'del me pretendimin absurd se, meqë u ndodh në shtëpinë ku zhvillohej Konferenca, bile, edhe asistoi në ndonjë seancë, ka qenë pjesëtar i Konferencës. Kushdo që ka një jetë të pastër, luftarake prej komunisti të ndershëm, kurrë s'pranontribute që s'i takojnë.

Në ato ditë të rënda të terrorit fashist, siç kam thënë edhe më lart, rrotull bazës ku zhvillonim Mbledhjen kishim caktuar edhe roja që vëzhgonin e informoheshin për gjithçka. Në heshtje, duke vërejtur çdo lëvizje të dyshimtë, duke shtrënguar në xhepa bombat e revolverët, ata bij e bija të mrekullueshëm, ato nëna e baballarë të popullit, kryenin një vepër të lavdishme. Kuptohet ata qenë nga njerëzit më trima e më të besuar, ata qenë njësh me ne, ata ashtu si ne, ashtu si qindra e qindra të tjerë' ishin pjesëmarrës në veprën e madhe, në veprën e pavdekshme të Themelimit të Partisë. Ata. qenë nga bijtë më të mirë patriotë e revolucionarë të popullit, nga komunistët e parë që i shërbyen Partisë që ditën që lindi, me vigjilencë, me trimëri e më në fund deri me jetën e tyre.

Pas Mbledhjes së Themelimit, ne të Komitetit Qendror të Përkohshëm bëmë një varg mbledhjesh njëra pas tjetrës për të vendosur masa të rëndësishme për të vënë në jetë vendimet që u morën. Vendimet du heshin formuluar në . «Rezolucion», duheshin zbërthyer e vënë në jetë.

Bëmë ndarjen e punës në mes shokëve të Komitetit Qendror Provizor. Së pari, të gjithë do të rnerreshim me organizimin e Partisë, por u bë dhe njëfarë ndarje pune në bazë qarqesh ose sektore'sh. Kështu Qemali u caktua me punën e rinisë, Baca me financën e Partisë, unë do të merresha me shtypin e teknikën dhe me organizimin e Partisë në Tiranë, e kështu edhe të tjerët me radhë u shpërndanë në qarqet ku kishin punuar ose njiheshin. Tuku shkoi në Shkodër, Koçi Xoxe në Korçë, Gjin Marku në Berat, Kristo Themelko në Gjirokastrë, më duket edhe në Vlorë etj.

Edhe Ramadan Çitaku shkoi në Elbasan, por në fillim u desh të qëndronte pak kohë në Tiranë, sepse, si i ish-Grupit të «Të Rinjve», do të ndihmonte në plotësimin dhe në verifikimin e listave të ish-anëtarëve të këtij grupi që na kishin dorëzuar A. Lula e S. Premte.

Por detyrat ishin të mëdha, të shumta dhe, mjaft prejtyre, kërkonin zgjidhje të shpejtë. Për këtë ne, përveç anëtarëve të Komitetit Qendror Provizor, qysh në atë periudhë aktivizuam edhe shokë të tjerë si Kozma e Gogo Nushin, Nako Spirun e ndonjë tjetër si për të verifikuar listat që na kishin dorëzuar grupet për anëtarët që do të futeshin në Parti ose në Rininë Komuniste, ashtu edhe për të organizuar celula të Partisë e për të përgatitur konferencat e qarqeve. Më vonë edhe unë e Qemali shkuam në qarqe, si në Durrës, në Fier, në Vlorë etj., por në fillim qëndruam në Tiranë.

Detyrat më urgjente ishin: organizimi i Partisë, formulimi i Rezolucionit e i Thirrjes së Parë të Komitetit Qendror të Partisë dhe organizimi i Rixiisë Komuniste.

Iu vumë këtyre detyrave frontalisht. Megjithëse në ilegalitet të rëndë, si mua, si Qemalin, na u desh të lëviznim vazhdimisht bazë më bazë për të marrë kontakt me shokë të ndryshëm, duke u dhënë lajmin gazmor dhe duke grumbulluar listat me emrat e shokëve komunistë të grupeve. Brenda disa ditëve krere't e ish-grupeve na paraqitën listat emërore të shokëve të tyre. Kjo ishte një çështje themelore. Mua, Qemalit dhe Bacës na duhej t'i verifikonim emrat e t'i kontrollonim jo vetëm nëpërmjet listave, por edhe me anë shokësh, për të provuar nëse listat ishin ekzakte, nëse ishin të tërë, apo kishte mangut ose qenë shtuar. Na u desh ta zhvillojmë këtë punë jo vetëm në Tiranë, por, për të verifikuar listat me bazën, dërguam shokë të besuar edhe në Shkodër, në Korçë, në Vlorë, në Durrës e gjetkë.

Shtëpia ku u Themelua Partia u bë qendra kryesore ku punoja dhe ku merrja kontakt me shokët kryesorë. Takimet e tjera të shumta i bënim në baza të tjera. Shtëpia e vogël, ku u Themelua Partia, duhej të «binte në qetësi» në pamje, për të mos rënë në sy, të mos diktohej nga armiku dhe nga spiunët e tij, të cilët, gjurmonin dhe bastisnin me egërsi. Në këtë shtëpi hynin dhe dilnin shokë të kontrolluar dhe me pikëpjekje, jo vetëm për arsye konspirative, por sepse ne që punonim atje ishim të mbytur deri në grykë edhe me punë. Edhe ditën në dhomën e punës që ishte dhoma ku bëmë Mbledhjen, ishim të detyruar të punonim me gjysmë drite, mbasi jashtë, nën strehë, që nga kolona e nënshkallës dhe deri në cepin e tejmë të shtëpisë, kishim varur nja dy batanije dhe kishim rregulluar një vend të vogël ku dilnim çlodheshim dhe merrnim ca. ajër pa u diktuar nga fqinjët. Kështu ky korridor i vogël për ne ilegalët e shtëpisë ishte, si me thënë, «bulevardi» ynë ku mund të shpinim këmbët e mund të çlodhnim pale kokën në ajër të pastër.

Çdo natë, deri në orët e vona, punonim për të bërë karakteristikat e shokëve, duke shënuar në to anët e mira dhe të metat e tyre. Kjo nevojitej për ngritjen dhe organizimin e celulave. Celulat duhej të ishin të përziera me shokë të grupeve të ndryshme. Megjithëse shoqe kishim jo shumë, vendosëm, lidomos në Tiranë, të krijonim një organizatë ose celulë vetëm me shoqe. Në celulën e parë me shoqe që formuam në Tiranë, bënin pjesë Nexhmije Xhuglini, Fiqret Sanxhaktari, Liri Gega, Naxhije Durre, Meriban Najdeni e ndonjë tjetër. Por shpejt disa nga shoqet e kësaj celule, që paraqiteshin më të vendosura në vijën e re të Partisë, na u desh t'i shpërndanim në disa celula, ku elementi i ardhur nga Grupi i «Të Rinjve», nxirrte ngatërresa e krijonte konfuzion politile e organizativ. Edhe në qarqe të tjera, bile në disa për shumë kohë, kishim celula vetëm ose kryesisht me shoqe. Siç vendosëm në Mbledhjen Themeluese, menjëherë pas saj na u desh të studionim e të caktonim shokët që do të zgjidheshin apo do të kooptoheshin në komitetet e qarqeve ose «qarkorët», siç u thoshim. Sekretare't politikë e organizativë, i caktuam ne të Komitetit Qendror, kurse për anëtarët e tjerë do të vendosej në vend, kur të shkonin të deleguarit.

Përgatitja e të deleguarve që do të shkonin nëpër qarqe për të organizuar Partinë, për të zgjedhur komitetet, për të shtruar rëndësinë e Themelimit të Partisë, për të shpjeguar parimet, vendimet dhe detyrat e Mbledhjes Themeluese ishte një punë shumë e madhe e shumë intensive që na mori shumë ditë dhe net. Çdo gjë duhej ta përsëritnim, ta kishim të qartë dhe ta mbanim mend. Duhej të mbanim shumë pak shënime me shkrim, kurse lista shokësh asnjëherë të mos kishim nëpër xhepa. Udhëzimi i Partisë ishte: «Komunisti nuk duhet të bjerë i gjallë në dorë të armikut» në qoftë se arrestohej në

befasi, «asnjë fjalë armikut»; «të kallëzosh në polici, konsiderohet tradhti dhe do të dënohet nga Partia».

Të gjithë të deleguarit, dica legalë, dica ilegalë, me të gjitha çfarë përmenda më lart, u nisëm në qendra të ndryshme për të organizuar konferencat e Partisë në qarqe nga do të dilnin komitetet e Partisë. Unë me Qemalin, siç thashë, qëndruam në Tiranë, edhe për të ndihmuar organizimin këtu, edhe për të organizuar lidhjet me qarqet, por edhe për të formuluar Rezolucionin e për të shkruar Thirrjen, siç u vendos në Mbledhje. Rezolucioni njihet dhe është dokumenti i parë bazë i Partisë Komuniste të Shqipërisë. E tërë Partia duhej ta studionte dhe në bazë të tij të organizohej dhe të luftonte në të gjitha drejtimet.

Gjatë kësaj kohe Qemali dhe unë u njohëm më mire me njëri-tjetrin. Qemali ishte i dashur, i thekës në mendime, me një karakter të hapur, me kulturë, i qeshur, ishte komunist i vendosur dhe trim. Ai e donte muzikën, këngën. Kishte humor dhe në pushime, pas një pune të lodhshme, Qemalin do ta shihje të merrej edhe me disc. lodra të vogla prej druri ose prej metali, apo edhe me zare qelqi nga ato që luajnë kalamajtë, si e si të çlodhej sadopak. Ky komunist e kishte shpirtin e ri, prandaj, sa jetoi, luftoi me zjarr të madh për Partinë dhe për rininë.

Lufta më hartimit të Rezolucionit e të Thirrjes se duhej t'i mbaronim shpejt. Ata duheshin shtypur dhe duheshin dërguar në të katër anët e vendit. Edhe kjo, ana teknike, ishte një problem kolosal. Duhet t'i kesh jetuar ato momente të rënda për ta marrë me mend sa i vështirë ishte problemi, pse tash duket sikur mund të bëheshin fare lehtë shtypja dhe shpërndarja e materialit ilegal. Armiku përgjonte, kontrollonte, kapte, burgoste, vriste dhe vane shokë.

Kishte ditë dhe net që na bëhej koka daulle.

- Mjaft punuam, Enver, - më thoshte Qemali, kur kalonin orë të tëra pa pushuar, - ia marrim një këngë?

Këngët që ai këndonte i shoqëronte me mandolinë, kurse këngët e mia labçe, jo vetëm me mandolinë nuk shoqëroheshin, por atyre s'kishte as kush t'ua kthente e kush t'ua mbushte; duheshin tre veta për labçen, kurse ne ishim dy, një shkodranl dhe një gjirokastrit. Në idetë e komunizmit ishim të akorduar, kurse në muzikë jo.

- Mësomë dhe mua t'ia kthej, - më thoshte Qemali.

- A, a, - i thosha unë, - labçja nuk di të ketë pasur profesor muzike kurrë, veçse popullin. Rri, dëgjoje dhe mëso vetë. - Qeshnim.

- Ne jemi më të qytetëruar, - më thoshte Qemali.

Rezolucionin e mbaruam si tërësi. Por sa ditë të tjera na u deshën ta shihnim e ta rishihnim, hiqandej, shto këndej, jo këtu duhet theksuar kjo e metë ose ky gabim, jo duhet bërë më e qartë e më e plotë kjo direktivë, e kështu me radhë.

Rezolucioni do të qe një dokument bazë, dokumenti principlial ku do të sintetizohej krejt e kaluara e lëvizjes komuniste shqiptare e do të formulohej saktë e qartë vija e ardhshme e Partisë dhe e popullit, programi i saj luftarak. Ne duhej të sintetizonim gjithçka ishte thënë në diskutimet e shumta për 6-7 ditë e net me radhë, të qëronim çdo bar të huaj, të përcaktonim çdo gjë që duhej përcaktuar.

Për njërën ose për tjetrën çështje ngecnim. Atëherë thërritnim ata shokë të Komitetit Qendror që ndodheshin në Tiranë e konsultoheshim me ta. U lexonim paragrafë të tërë, sqaronim gjithçka duhej sqaruar e vazhdonim më tej. Por, dihet, formulimi i Rezolucionit ishte për Qemalin dhe për mua vetëm një ndër detyrat e mëdha e të shumta të atyre ditëve.

Vetëm 7-8 ditë pas mbarimit të Mbledhjes së Themelimit të Partisë, dihet se u themelua Rinia Komuniste. Si unë dhe Qemali u ngarkuam e u mobilizuam të organizonim krejt punën edhe për këtë ngjarje të rëndësishme. Të dy ne morëm pjesë në këtë mbledhje nga fillimi gjer në fund. Pikërisht në valët e këtyre punëve shkruanim edhe Rezolucionin. Ai u shkruajt në luftë e sipër, në të, vetë pjesëmarrja jonë aktive në ngjarjet që zhvilloheshin, bëri që të hynin edhe lisa ngjarje që i takojnë periudhës fill pas Themelimit. Më pas në një mbledhje të Komitetit Qendror të Përkohshëm, aty nga fundi i nëntorit, pas diskutimesh që u bënë, u aprovua Rezolucioni dhe e mora unë përsipër për të rregulluar shtypjen e tij.

Thirra shoqen Fiqret Sanxhaktari, një nga shoqet tona më të mira, më të vendosura, komuniste aktive dhe e zgjuar, dhe i dorëzova Rezolucionin. I vura detyrë asaj të organizonte shtypjen e tij. Fiqreti e kreu me sukses këtë detyrë të madhe.

Pasi përfunduam Rezolucionin, Qemali u nis për në qarqe, për punën e Partisë e të Rinisë. Unë vazhdova hartimin e Traktit të parë të rëndësishëm programatik të Partisë drejtuar popullit, «Thirrjen e Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë drejtuar popullit shqiptar pas krijimit të Partisë». Thirrja shpejt u bë gati, por ajo u shtyp dhe u shpërnda në dhjetor të vitit 1941.

Nëpërmjet kësaj Thirrjeje dhe të tjerave që lëshoi Partia më vonë, nëpërmjet trakteve e komunikatave ajo iu drejtua gjithë popullit të ngrinte krye kundër okupatorit, dhe populli ynë e ndjeu thellë Thirrjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Por, me Thirrjen e Partisë nuk mund të pritej që populli të ngrihej përnjëherë në këmbë dhe të rrëmbente pushkën. Për këtë Partisë iu desh një luftë këmbëngulëse, dulce përdorur të gjitha format, që nga propaganda gojore, traktet, demonstratat, atentatet, sulmet e armatosura nga më të voglat me njësite dhe deri në më të mëdhatë, me çeta e reparte të tjera më vonë.

E gjithë kjo punë dhe lufta duheshin organizuar.

Për këtë kërkohesh një organizim i fortë dhe njerëz trima, që të ndienin e, njëkohësisht, të kuptonin se kjo luftë do të ishte e përgjakshme, pra, dante sakrifica, zotësi organizuese dhe pjekuri politike. Në luftë njerëzit duhej të mësonin edhe taktikat e ndryshme të luftimit që u diktonte situata, forcat e okupatorit dhe metodat e tij të luftimit. Pra, duhej kuptuar se lufta që do të zhvillonim nuk ishte as një aventurë, as një ndërmarrje romantike: armiku duhej luftuar pa mëshirë, pa kompromis, atë ne nuk do ta falnim kurrë, ashtu sikundër nuk do të na falte as ai kurrë ne. Prandaj parulla e Partisë ishte: «Në duart e armikut nuk duhet rënë i gjallë».

Të gjitha këto u arritën me luftë e sakrifica, me punë politike, organizative e me propagandë luftarake. Por në historinë e Partisë sonë Thirrja e parë zë një vend të veçantë. Ajo ishte një dokument me rëndësi kolosale që bëri përshtypje të thellë në popull.

Njëkohësisht, gjatë kësaj kohe, natën, kur errej, shkoja në calula, të formuara rishtas, e më pas, kur u formua Komiteti Qarkor i Tiranës, që u ngarkova ta drejtoja unë, mbledheshim edhe me shokë të këtij Qarkori. Mbledhje bëheshin gati çdo natë, të mas harrojmë, në ilegalitet të rëndë. Nga celulat na vinin raporte të ndryshme mbi gjendjen në kryeqytet, mbi lëvizjet e armikut, mbi simpatizantët, mbi aksionet që duheshin kryer, mbi traktet që duheshin shkruar e një mijë çështje. Partia Komuniste e Shqipërisë po hidhej me heroizëm në luftë. Rreth saj po grumbullohej rinia, populli. Nga puna e madhe s'dinin ku kishim kokën, si i thonë një fjale.

Gjithë kjo periudhë pune intensive ka mbetur e pashlyer në kujtesën time. Si të thuash, ne tanfi vazhdonim mbledhjen e Partisë në terren, në jetë. Mbledhjet e takimet bëheshin zakonisht natën dhe vazhdonin pa kufi. Diskutimet bëheshin me gojë, e merrte fjalën njëri, thoshte mendimet e tij, dikush tjetër e ndërpriste, i bënte pyetje, zhvilloheshin debate, pastaj vazhdonte prapë më tej ai që qe ngritur. Mbledhja mbaronte kur ishin ezauruar problemet që shtroheshin ose që dilnin gjatë diskutimeve. Kështu ndodhte që mbledhjet të vazhdonin edhe gjer në mëngjes. Nganjëherë, kur qemë të lodhur, i ndërpritnim diskutimet, shtriheshim e flinim aty, dy ose tri orë, pastaj vazhdonim më tej. Jo rrallë, veçanërisht kur debatet kishin të bënin me pikëpamjet e gabuara të njërit ose të tjetrit ndiqnim edhe forma të tjera. Pasi e shihnim se ndonjëri s'bindej në ato që i thoshin shokët, bënim pushim dhe një ose dy shokë të udhëheqjes e merrnin mënjanë «të pabindurin» dhe i flisnim më shtruar, më hapur. Kështu vazhdonin e ecnin përpara punët.

Krahas kësaj pune voluminoze dhe të vrullshme na u desh të merrnim gjithnjë e më shpesh kontakte edhe me Anastas Lulën e Sadik Premten, për shkak se këta vazhdonin të mbanin lidhje personale me ish-shokë të vjetër të grupit dhe i trashnin këto lidhje në dëm të organizimit e të vijës së Partisë. Disa herë u kacafytëm me Qorrin, derisa e kërcënova: «O do të këputësh çdo veprim antiparti dhe grupazhi, o do të marrim masa të rënda ndëshkimore». Anastasi gënjente, mohonte, premtonte, përdridhej. Shumë herë e ballafaqova me ish-shokë të tij të grupit dhe arrita që t'i izoloja këta shokë

nga kthetrat e tij, t'i fitoja për Partinë. Por disa herë edhe dështoja në përpjekjet e aria, pse Qorri ishte një element antiparti i regjur dhe dinak, i zgjuar në ligësitë e tij.

Luftën kundër trockistëve, të hapur dhe të kamufluar, duhej ta mbanim vazhdimisht të ndezur. Si në Komitetin Qendror të Përkohshëm, kur mblidhej, si në Qarkorin e Tiranës, edhe në organizatat-bazë ku shkoja, shtroja dhe shpjegoja vijën, duke theksuar kurdoherë rrezikun e 'ideve trockiste e fraksioniste, me frymën e vjetër të grupeve. Këshilloja, së pari, shokët që të luftonin me mish e me shpirt për unitetin e Partisë kundër fraksioneve, kundër grupazhit dhe shpjegoja praktikisht si veprojnë grupazhet. Pastaj shpjegoja çështjen e madhe të disiplinës komuniste dhe të konspiracionit; shpjegoja çështjen e celulës dhe të centralizmit demokratik. Ngulja këmbë vazhdimisht në këto, pse ndryshe armiqtë do të na përçanin organizativisht Partinë. Dhe Partia bëri një luftë të madhe heroike e me sukses në këtë drejtim.

Megjithatë, nuk munguan të depërtonin përsëri në Parti parulla armiçësore që i mbillnin elementët trockistë, për të krijuar konfuzion politile në radhët e shokëve. Njëra prej këfyre parullave ishte edhe kjo: «Aleanca e Bashkimit Sovjetik, e Anglisë dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk është për t'u besuar, nuk është e drejtë, ashtu siç nuk ishte i drejtë dhe Pakti i mossulmimit midis Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë naziste. Ky pakt i ri është me kapitalistët, me imperialistët». Na është dashur të mbeteshim me ditë të tëra në mbledhjet e celulave, të shpjegonim, të bindnim, por edhe të dënonim shokë, që jo vetëm nuk donin ta kuptonin qëllimin dhe përmbajtjen antifashiste të aleancës, por edhe që viheshin kundër vijës së Partisë. Natyrisht, këtu ishte dora e fshehtë e Anastas Lulës dhe e shokëve të tij, trockistë, antisovjetikë, si Andrea Zisi e të tjerë.

Ndërkohë Qemali nga ana e tij punonte intensivisht për organizimin e rinisë. Po ashtu punonin edhe të gjithë shokët e tjerë anëtarë të Komitetit Qendror, në qarqe, për formimin e Partisë. Korrierët na silinin lajme të mira, inkurajuese, ekzaltuese.

Lufta kundër okupatorëve dhe tradhtarëve po mente një hov të madh e të paparë. Armiku u trondit. Kjo luftë do të rritej e do të zgjerohej hap pas hapi, në të do të merrte pjesë i gjithë populli shqiptar. Dhe ai çdo ditë e më tepër do të shkonte më i mobilizuar e më i ndërgjegjshëm në këtë luftë, sepse për herë të parë në historinë e tij kishte një udhëheqje besnike të popullit, të idealeve dhe të aspiratave të këtij për të ardhmen, kishte Partinë e vet, Partinë Komuniste të Shqipërisë.

THEMELIMI I RINISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

(23 Nëntor 1941)*

* Kujtimet e shokut Enver Hoxha për këtë ngjarje për herë të parë u botuan më 24 nëntor 1976, në gazetën «Zëri i rinisë», me rastin e 35-vjetorit të Themelimit të Rinisë Komuniste të Shqipërisë.

Organizimi i rinisë së vendit për të luftuar okupatorin italian dhe reaksionin e brendshëm ishte një nga detyrat kryesore që Partia Komuniste e Shqipërisë i vuri vetes, që në ditët e para të themelimit të saj. Jo vetëm Partia jonë që po formohej ishte e re nga mosha, por edhe ne, anëtarët e saj të parë, shumica ishim të rinj. Partia e kuptoi drejt situatën e rëndë që u krijua në vend nga okupatorët dhe i vlerësoi drejt anët klasore të forcave që do të përlesheshin me armikun, si edhe anën e shtresave dhe të moshës së njerëzve që do të angazhoheshin në luftë.

Rinia, në të gjithë historinë e popullit tonë, ka qenë ajo shtresë që ka dalë përpara në luftime, që i ka vënë gjoksin rrezikut dhe ka luftuar heroikisht. Populli ynë, i urtë dhe heroik, të rinjtë e tij i frymëzuar kurdoherë me një ndjenjë të lartë patriotizmi, vetëmohimi dhe sakrifice, për çështjen e atdheut, për çështjen e besnikërisë ndaj tij. Populli ynë kurdoherë edukonte rininë e vet me pjekurinë në mendime dhe në veprime. Ishte populli ai që rrezatonte dashurinë për jetën e lirë, pjekurinë në mendime, guximin e heroizmin për qëllime të larta; besnikërinë ndaj atdheut,

drejtësinë për njerëzit dhe urrejtjen kundër çdo armiku të tij, të brendshëm dhe të jashtëm. Populli ishte burim i forcës, kurse rinia ishte pjesa e madhe dhe e gjallë e kësaj force të tij. Populli ishte atdheu me të kaluarën e tij të lavdishme dhe me të ardhmen e ndritur që i përgatiste rinisë.

Okupatori italian d'he veglat e tij u përpoqën me shumë mënyra dhe në shumë drejtime ta shkëputnin rininë e vendit tonë nga rezistenca dhe nga lufta kundër tij, ta ndanin atë nga gjiri i popullit, domethënë nga rruga e patriotizmit, e ndershmërisë dhe e burrërisë tradicionale, nga rruga e drejtësisë dhe e urrejtjes tradicionale kundër shkelësve e robëruesve të atdheut, ta ndanin atë nga gjiri i familjes, duke pretenduar dhe duke propaganduar se rebelizmi i rinisë kundër «rendit fashist» ishte i organizuar nga të huajt «për të shkatërruar familjen shqiptare», «për të minuar dhe shkelmuar autoritetin e prindërve» etj. Çfarë nuk përdorën armiqtë dhe tradhtarët?! Por, të gjitha përpjekjet për ta shkëputur rininë nga lufta, armiqve u shkuan kot. Megjithatë ngritja e tërë rinisë në luftë nuk u bë në një ditë.

Është fakt historik se edhe në kohën e regjimit të Zogut, kur mbretëronte terrori, rima punëtore, nxënësit dhe studentët, kanë qenë kurdoherë elementi më refraktar, kundërshtar i regjimit; ata lëviznin në forma të ndryshme, në mënyrë herë aktiveherë pasive; ata u rezistonin presionit dhe terrorit, organizoheshin dhe vepronin në forma legale e ilegale, krijonin organizata dhe shoqëri të ndryshme për të mbajtur gjallë traditat patriotike që i neveriste dhe i përçrnonte regjimi feudo-borgjez.

Vetë Avni Rustemi ishte i ri dhe organizata «Bashkimi» që ai formoi ishte organizatë e të rinjve; vetë Ali Kelmendi, që është veterani i lëvizjes sonë komuniste, ishte i ri; djemtë trima e kapedanët e luftërave të kaluara ishin të rinj. Kapedanët tanë të midhenj, që neve. bijve dhe nipërve të tyre, na duken të kaluar nga mosha, ishin të rinj në kohën kur filluan luftën. Pjekuria e Partisë sonë qëndroi në atë që. luftën e madhe që po organizonte, ajo e kuptoi drejt si një luftë jo vetëm të rinisë, por të të gjithë popullit si një bllok i vetëm, në unitet, të rinj e të vjetër, prindër dhe fëmijë, burra dhe gra, djem e vajza, laikë dhe besimtarë.

Shembullin e shkëlqyer rinisë sonë ia dhanë mitingjet dhe demonstratat e para në prillin e zi të 1939-s, kur qeveria tradhtare dhe mbreti tradhtar konsumuan tradhtinë e tyre, i hapën rrugën okupacionit të vendit nga Italia fashiste.

Italia fashiste filloi të organizonte të rinjtë tanë në format organizative fashiste, po të tëra ato u sabotuan nga rinia jonë revolucionare. Jo vetëm kaq, por «Dopolavorot» që ndërtuan fashistë, punëtorët tanë i shndërruan në «nevojtores». Asnjë i ri veç

djemve të të shiturve, nuk u shkruan «Xhovani fashisti». «balila». Të tillë bënë dhe dërguan kalamanët e tyre të shiturit. Asnjë i ri nuk përshëndeti «ala romana»; studentet e reja braktisën dhe hodhën poshtë «uniformat» fashiste; asnjëri nuk u shkonte në shoqërinë «Dante Aligieri»; asnjë student patriot nuk u shkrua në «Guf». Nga të katër anët bojkotim total nga rinia masave fashiste. Me forcë u përpoqën fashistët që nxënësit dhe studentët të këndonin himnin e tyre «Xhiovineca». Rinia shqiptare në shkolla këndonte kudo himnin e vet, himnin e popullit, himnin e luftës, «Himnin e Flamurit».

Përpara dështimeve të shumta armiku përdori terrorin, vrasjet, burgosjet, internimet, torturat. Asgjë nuk mund ta shpëtonte atë nga vdekja. Momentet u poqën për krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila u bë trashëgimtarja e ligjshme e dëshirave të zjarra të popullit. Ajo trashëgoi, do të ruante dhe do të zhvillonte çdo gjë që populli kishte më të mirë e më të shtrenjtë.

Që në debatet kur po themelohej Partia, një nga pështjet kryesore ishte që, pasi të organizonim Partinë, duhej të krijohesh menjëherë Organizata e Rinisë Komuniste të Shqipërisë, e cila duhej të bëhej dhe u bë ndihmësja e lavdishme e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Vendimi i Mbledhjes së Themelimit të Partisë, për krijimin e Organizatës së Rinisë Komuniste të Shqipërisë u zbatua pikërisht më 23 nëntor 1941, 15 ditë pas Themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Kjo është një ditë historike për luftën e popullit tonë, ditë

historike e lavdishme për rininë tonë heroike, është një ditë historike për popullin shqiptar dhe njëkohësisht plot emocione dhe kujtime të pasflyeshme nga mendja jonë për ne që morëm pjesë në ato mbledhje të paharruara, kur themeluan këtë organizatë, duke realizuar vullnetin dhe dëshirën e Partisë dhe të rinisë sonë luftarake.

Siç kam shkruar edhe më iart, që nga dita e Themelimit të Partisë dhe deri ditën e hapjes së mbledhjes, që do të bënim në Tiranë për formimin e Organizatës së Rinisë Komuniste. Qemali dhe unë, përveç punëve të tjera të ngutshme që duhej të zhvillojmë, ishte edhe problemi i madh i organizimit të rinisë, si krahu i Partisë dhe forcë e madhe për luftën që kishim përpara.

Në shtëpinë ku u themelua Partia punova me Qemalin për organizimin e mbledhjes themeluese të rinisë komuniste. Morëm, së pari, në studim listat e të rinjve dhe të të rejave që na u dorëzuan. Natyrisht, këto lista ishin më të gjata nga listat e anëtarëve të grupeve komuniste, me të cilët organizonim çdo ditë celulatat e Partisë. Këto lista i kontrollonim një nga një dhe me Qemalin ramë dakord se me siguri nuk ishin të plota. Çdo anëtar i grupit kishte në lidhje plot të rinj dhe të reja. Por të tërë këta nuk na shirë dorëzuar, sepse akoma fryma e tarafëve dhe e grupeve nuk lejonte një gjë të tillë. Kjo frymë do të luftohej dhe do të zhdukej në Parti dhe si konsekuencë edhe në organizatën e rinisë. Por tash na vihej për detyrë që këta të rinj e të reja komunistë t'i organizonim, dhe organizimi vendosëm të bëhej në këtë mënyrë: baza e organizatës së rinisë të ishte dhe të quhej jo celulë, si ajo e Partisë por «bërthamë e rinisë» dhe çdo anëtar i kësaj bërthame të kishte një ose më shumë grupe simpatizantësh. Rinia duhet të kishte Komitetin Qendror të Rinisë Komuniste dhe në çdo qark komitetin qarkor të rinisë. Edhe në këtë organizatë duhej të ekzistonin centralizmi demokratik dhe norma, natyrisht më pak rigorozë se ato të Partisë, por disiplina në veprime dhe konspiracioni i rreptë duhej kurdoherë të ishin edhe këtu në rendin e ditës. Rinia Komuniste e Shqipërisë do të udhëhiqej nga Partia Komuniste e Shqipërisë. Në forumet e saj duhej të vinin shokë të rinj e të vendosur, anëtarë partie të ngarkuar për punën me rininë, por edhe jo anëtarë partie. Rinia Komuniste në asnjë mënyrë nuk duhej konsideruar si një «parti» përkrah Partisë, por ajo do të ishte dhe do të vepronte si organizatë udhëheqëse e masave të rinisë antifashiste, e drejtuar nga Partia Komuniste e Shqipërisë. Këtë e theksuam dhe do ta theksonim vazhdimisht, pse rrezikoheshim nga sektarizmi dhe nga koha e rëndë e luftës, e terrorit dhe e konspiracionit. Në kushte të tilla organizata e rinisë mund të mbyllej në vetvete dhe të braktiste masat e gjera të të rinjve dhe të të rejave, që ishin forca kolosale e Partisë dhe ndërlidhësja më e sigurt e Partisë me moshat e pjekura.

Me Qemalin m'u desh të punonim edhe për organizimin në përgjithësi të bërthamave të rinisë në qendra të ndryshme, por në veçanti studiuam shokët që duhej të propozonim për të ardhur në mbledhjen që do të themelonte Rininë Komuniste si organizatë dhe të zgjidhte Komitetin Qendror Provizor të saj. Na është dashur me Qemalin të diskutonim karakteristikat e kandidatëve, por pa harruar prejardhjen e grupeve, origjinën ahoqërore, ngritjen kulturore, krahinën, seksin, vendin ku punonin ose mësonin deri edhe g'fe ishin, myslimanë, apo të krishterë, pse, pavarësisht se të gjithë ata ishin ateistë, masat me të cilat do të punonin dhe do të ngrinin në këmbë nuk ishin të tilla. Në atë kohë njerëzit i shikonin dhe këto gjëra dhe ne duhet t'i kishim parasysh këto në punën tonë për bashkimin e gjithë popullit në luftë.

Na u desh të përgatitnim edhe kandidaturat për Komitetin Qendror Provizor të Rinisë Komuniste. Përveq asaj duhet të kishim gati edhe kandidaturat kryesore të udhëheqjes së komiteteve të rinisë në qarqe. Kohët ishin shumë të vështira. Në këtë kohë të fillimit, dhe kohë lufte, nuk mund të kërkonim demokraci integrale, propozimet duhej t'i bënim nga lart dhe zgjedhjet e anëtarëve të forumeve të bëhehin në konspiracion të rëndë, siç do ta tregoj më poshtë.

Pasi i mbaruam këto, si Qemali dhe unë u përgatitëm për mbledhjen. Unë do të flisja për formimin e Partisë, për nevojën e krijimit të organizatës së rinisë, për situatën ndërkombëtare dhe për luftën tonë kundër okupatorëve. Qemali do të mbante referatin kryesor për themelimin dhe organizimin e Rinisë Komuniste, për vijën politike dhe ideologjike të kësaj organizate.

Kur ishim duke punuar me Qemalin në dritën e llambushkës, ghoku që ruante jashtë hyri në dhomë dhe na tha:

- Ka ardhur Anastas hula dhe kërkon të takohet me ju, pse ka një gjë urgjente.
- Fute, - i thamë.
- Ç'ka Qorri që po vjen? - tha Qemali.
- Të shohim, - iu përgjigja.
- Hyri Anastasi, gjoja me një frymë, dhe tha:
- Spiuni Ali Reçi po ngjit Rrugën e Spitalit, ai është vetëm, hajdeni ta ekzekutojmë!
- U ngrita në këmbë, mora një nga nagantet që mbanim pranë mbi tryezë, drodha rrotën, u sigurova që ishte plot me fishekë dhe ia ndëra Qorrit, duke i thënë
- Merre nagantin, shko e vraje dhe, me të dëgjuar krismat, ne do të largohemi nga kjo bazë! Anastasi shtangu.
- Ç'pret, - i thashë unë, - nisu!
- Na, - i tha Qemali, - merre dhe këtë bombë, kije në xhep! - Anastasi shtrëngoi kasketën në kokë dhe u zhduk në errësirë. Ne vazhduam punën. Qemali tha:
- Enver, ky Anastasi, i poshtër tra qenë dhe i poshtër do të mbetet.
- Ishte provokacion nga ana e tij, - i thashë Qemalit, - po nuk na e hedh dot. Ai as atentat tra bëre, as do të bëjë, prite kur të kthehet.
- Dhe nuk mungoi të kthehej. Pas ndonjë ore erdhi si i dëshpëruar dhe tha:
- Iku, s'e arrita dot, cihe vuri koburen dhe bombën mbi bankë.
- S'ka gjë, - i thashë, - herë tjetër.
- Natën e mirë, - i tha Qemali i inatosur, ghko task, se kemi punë. - Dhe, pasi doli nga dhoma, Qemali shfreu:
- Gjarpri me syze!

Pas dy ditë E h hap mbledhja për themelimin e Rinisë Komuniste. Shokët që do të bënin pjesë në këtë mbledhje ishin lajmëruar që në ditën e caktuar duhet të i%hin te shtëpia e Sabrije Vokshit, në fund të bulevardit që sot mban emrin «Stalin».

Bije Vokshi është halla e Asim Vokshit, luftëtar i brigadave ndërkombëtare, i rënë në Spanjë. Bija është kosovare, pikërisht nga Gjakova, nga një familje me emër dhe nga më patriotet në Kosovë. Ajome nipërit e saj ishte vendosur në Tiranë. Ishte një grua pale e kaluar në moshë, po burrneshë, patriote, e guximshme, komuniste e vendosur e ish-Grupit të Shkodrës. Kishte një zemër flori. Ajo ishte antifashiste në kulm, siç janë komunistët. Vdekja heroike e Asimit në Spanjë kishte ngjallur në zemrën e saj një urrejtje të pakufishme kundër fashizmit. Ajo ishte shumë e zgjuar, konspirative, e heshtur, punëtore. Shtëpia e saj ishte një nga bazat më të rëndësishme tonat, të ilegalëve. Bija na vinte rrotull të gjithëve, na bënte të hanim, na lante rrobat, fshinte shtëpinë që ta gjenim të pastër. Shtëpia e Bijes ishte «depo armësh», atje vinin dengjet me trakte dhe merreshin nga shokët për t'i shpërndarë.

Një mbrëmje, pasi krijuam Partinë dhe organizatën e rinisë, më qëllloi të ndodhesha kur Bija u ndau shokëve pakot me trakte. Në mes tyre ishte dhe nipi i saj. Bija kishte radhitur si ushtarë shokët, i thërriste ata me radhë njërin pas tjetrit, u jepte pjesën e trakteve që i takonin secilit, një paleo dhe një bombë njërit, tjetrit një paleo dhe një kobure me nja dy fishekë, një të treti një paleo dhe një thikë, e kështu me radhë. I endhi radha nipit të saj, të cilit i dha patron me trakte, po jo armë.

- Po mua, - i tha nipi, - pa armë do të më nisësh ?
 - U mbaruan. merr një urë zjarri po të duash i tha Bija, - dhe nisu e të pakta fjalët!
- Shokët humbën nëpër natë për të shpërndarë traktet. Rrija dhe shikoja Bijen. E tillë ishte kjo grua patriote kosovare nga familja e Vokshëve, që nipin e saj nuk e vinte më parë nga të tjerët. Shtëpia e Bijes, ku u bë mbledhja për formimin e organizatës së rinisë, ishte një shtëpi përdhese tiranase. Ajo ishte rrethuar nga rruga dhe nga të gjitha anët e tjera me mure e shtëpi të vogla prej qerpiçi. Kishte dy hyrje dhe kjo na favorizonte shumë. Nga ana e rrugës kryesore hyje më parë në një kopsht me drurë e pemë, si akacie, lofatë, ndonjë fik, ndonjë ftua, man (sidoqoftë edhe ky kopsht ishte i favorshëm për punën tonë ilegale), pastaj kishte një deriçkë, që unë e quaja

«thoropullë». Qemali qeshte kur thosha thoropullë, kurse Bija nuk e shqiptonte dot dhe më thoshte:

«Çfarë drejt fjalë asht kjo?». Nga fundi i kopshtit, në rast rrethimi dhe kontrolli nga armiku, mund të kapërcenim murin dhe të dilnim tej, shtëpi më shtëpi, në fushë. Kështu shpëtoi në një rast Qemali. Porta tjetër ishte një portë e zakonshme, me dy kanabe prej dërrase të vjetruar dhe me lloz nga pas. Te kjo portë duhej të vije nga një rrugicë e ngushtë dhe me disc kthesa në mes një numri shtëpish të tjera të ulëta tiranase, ku jetonin familje të popullit patriot. Nga kjo anë ishim edhe më të sigurt.

Për të hyrë në shtëpi, kaloje në një oborr që pjesërisht ishte shtruar me kalldrëm, pjesa tjetër ishte me dhe, kishte një pus dhe anës murit ndonjë lule. Shtëpia kishte tri dhoma, dy nga të cilat ishin me d'ysHEME, një e vogël e një tjetër më e madhe. Kurse një e ndërrë tjetër ishte shtruar me baltë, ishte pa tavan e pa oxhak, siç ishin «shtëpitë e zjarrit» të zakonshme tiranase ku Bija ndizte zjarrin, gatuante gjellët, ndante traktet. Atje ne zhvishnim këpucët me llucë dhe hidhnim mbi një tryezë palltot o mushamatë e qullura. Dera e këtij hauri-kuzhinë, siç mund ta quanim, dilte në një hajat të shtruar me baltë të ngjeshur në vend të pllloçave, i hapur nga përpara me dy a tre trarë në vend të kolonadave dhe i mbuluar nga sipër me tjeçuila. Por pa tavan.

Në të dyja dhomat me dysHEME, të cilat komunikonin me një derë, mund të hyje nga një derë nga oborri që të çonte në dhomën e vogël dhe nga një derë nga kuzhina që të çonte te dhoma më e madhe. Në dhomën e vogël me dysHEME u bë mbledhja historike.

Shokët që nuk ishin ilegalë, hynin me kujdesin më të madh në të ngrysur, kush nga dera e kopshtit, kush nga dera tjetër e rrugicës. Ne, ilegalët, vëmë kur u err mirë. Më kujtohet që hyra nga rruga kryesore, dera e madhe, zbrita kopshtin në errësirë, duke më mbajtur shoku që ruante, se ishte ca tatëpjetë dhe nga s'hiu ishte bërë baltë e mund të rrëshqitje. Pasi kapërceva deriçkën, takova Bijen. U përqaftuam. Më thotë:

- Të gjithë shokët kanë ardhur, po hanë.

Lashë pallton në kuzhinë dhe nga dhoma e madhe hyra në atë të voglën dhe i pashë të gjithë shokët të nibledhur tok. pranë njëri-tjetrit, që hanin e bisedonin të gëzuar. Dhoma ishte e vogël, po mua m'u duk e madhe. Disa shokë i njihja, disa i shihja për herë të parë nga fytyra. Qemali m'i prezantoi njërin pas tjetrit. Në mes të shokëve ishte edhe një shoqe e vetme, shoqa Nexhmije Xhuglini. Qemali, duke ma prezantuar, më tha

- Kjo është Nexhmija, shoqja jonë komuniste nga më të mirat, nga më të vendosurat, që të kam folur.

Nexhmija, me fytyrë të skuqur, i tha:

- Qemal, të lutem, lëri këto...

- E po mirë, atëherë, - i tha Qemali, - që të mos të lëvdoj, po i them Enverit që unë i kam vënë Nexhmijes një pseudonim: «Delikatja».

Të gjithë qeshëm.

- Por, - shtoi Qemali, - në fakt ajo është e fortë si malësoret.

Dhoma ishte rrethuar me mindere, më një anë kishte tryezën dhe disc frona, në një qoshe kishte një sobë dhe dhoma ishte mbushur plot me tym, por j® me tym cigareje, se nuk pinin shokët e rinj, por me tym të bukës së pjekur e të thekur në sobë, ku valonte dhe çajniku. Ishim të varfër, ajo ishte darka e festës sonë: çaj dhe bukë të thekur. Çajin nuk e pinim në çafka, se nuk kishim, por në sapllakë prej alumini që na përvëlonin buzët. Qëllonte që me një sapllak pinim edhe dy veta përnjëhere', një gllënjë njëri dhe një gllënjë tjetri. Mora edhe unë racionin tim dhe pastaj shpejt e shpejt spastruam dhomën, rregulluam trye, zat dhe rreth orës 9 të mbrëmjes filloi mbledhja historike.

Mbledhjen e hapu unë në emër të Komitetit Qendror Provizor të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

U shpreha më parë përshëndetjet e përzemërta revolucionare të Komitetit Qendror Provizor të Partisë Komuniste të Shqipërisë delegatëve të rinisë së vendit, të mbledhur për të themeluar Organizatën e Rinisë Komuniste të Shqipërisë dhe u urova sukses të plotë në punën e tyre.

Në substancë shokëve të konferencës u thashë:

Me themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë u hap një periudhë e re, e qartë dhe plot shpresa për popullin dhe për rininë tonë, që luftojnë kundër zgjedhës së okupatorëve italianë dhe tradhtarëve të vendit. Që nga 7 prilli i 1939-s dhe deri sot, në nëntorin e vitit 1941, kanë kaluar më tepër se dy vjet që vendi ynë ndodhet i robëruar, por populli shqiptar nuk e ka përkulur kurrizin kundër armiqve të tij. Populli me rininë e tij nuk e ka pranuar kurrë okupacionin, ata e pritën këtë me pluniba në portet e zlbarkimit si dhe kudo gjetkë, me demonstrata, greva dhe goditje me armë. Kudo dhe në çdo gjë, gjatë gjithë kësaj kohe. armikut dhe veglave të tij po u bëhet një rezistencë e vendosur, e cila gjithnjë e më shumë po rritet dhe po kristalizohet. Ne të gjithë e dimë se në krye të demonstratave dhe të kësaj rezistence qëndronin Komunistët e grupeve të ndryshme. Çdo grup komunist kishte me vete dhe në krah në greva e në demonstrata një shumicë të madhe të rinjsh dhe të rejash, që së toku prinin masat në aksione kundër regjimit. Por populli kërkonte një udhëheqje të vendosur, të guximshme, të drejtë që ta udhëhiqte në luftën e çlirimit kundër këtij armiku të egër. Populli kishte parë njerëz që përlesheshin nëpër rrugët me fashistët, kishte lexuar traktet e para të grupeve komuniste, që bënin thirrje për rezistencë dhe për luftë, por ai akoma nuk e kishte parë si duhej dorën e hekurt të një udhëheqjeje, që të binte si duhej mbi kokat e fashistëve dhe të tradhtarëve. E kërkonte populli një udhëheqje të tillë.

Edhe komunistët e grupeve e kuptuan se ishin në rrugëkryq, që kishte ardhur koha dhe bile ajo kishte kaluar, që të krijonin Partinë Komuniste të Shqipërisë, partinë e tyre të klasës punëtore, në shembullin e Partisë heroike Komuniste Bolshevike të Lenin-Stalinit. Dhe Partia Komuniste e Shqipërisë, partia e klasës punëtore, u krijua më 8 Nëntor.

Pastaj u fola shokëve mbi debatet që u zhvilluan në Mbledhjen e Grupeve Komuniste, mbi demaskimin dhe dënimin e të gjitha atyre veprimeve dhe teorive antimarksiste, trockiste dhe të rrezikshme, që zhvilloheshin në gjirin e komunistëve nga elementë të dyshimtë dhe shumë të dyshimtë, u vura në dukje se «debatet që u zhvilluan të ashpra, por në frymë konstruktive, përcaktuan parimet e drejta politike, ideologjike dhe organizative marksiste-leniniste që duhef këtej e tutje të udhëhiqnin në çdo veprim Partinë tonë. Dhe në bazë të këtyre parimeve u ndërta Partia jonë dhe do të ecë ajo këtej e tutje. Rrugë tjetër nuk ka dhe nuk lejohet».

Duke ditur se ne sapo kishim dalë nga lufta e sëmurë e grupazhit, duke ditur se të gjithë shokët e bazës, dhe ca më pak shokët e rinisë, nuk e kishin kuptuar si duhej dhe plotësisht centralizmin demokratik të Partisë, duke ditur se Anastas Lula e Sadik Premtja akoma nuk po i dorëzonin të plota listat e të rinjve dhe donin të mbanin lidhje të fshehta dhe të dënueshme nga Partia me ish-anëtarët e Grupit të tyre të «Të Rinjve», u theksova shokëve rrezikshmërinë e madhe të një pune të tillë që të çonte në fraksione në Parti. Lidhur me këtë çështje, u theksova shokëve të rinisë se Partia është kundër fraksioneve në Parti dhe do të likuideojë Çdo përpjekje që synon të godasë vijën e Partisë në çdo aspekt të saj. Një veprimtari e tillë ka për qëllim të vetëm ta përçajë Partinë, ta dobësojë dhe ta likuideojë atë, gjë që do të çonte në shuarjen e luftës kundër okupatorëve dhe në zgjatjen e jetës së këtyre dhe të mjerimeve e të robërimit të popullit. - Këtë punë grupazhi të sëmurë në asnjë mënyrë nuk duhet ta lejojmë që të zhvillohet në Organizatën e Rinisë Komuniste të Shqipërisë që do të formojmë. Organizata e rinisë, në shembullin e Partisë Komuniste të Shqipërisë që do ta udhëheqë, duhet të konsiderojë të huaja dhe armiqësore të tilla pikëpamje dhe veprime, pse ekzistojnë akoma individë të sëmurë ideologjikisht që metodat e një pune grupazhi orvaten dhe do të orvaten edhe më vonë në futin në rini.

Organizata e rinisë, theksova më poshtë, duhet të ishte një organizatë masive dhe luftarake në kulm. Ajo duhet të luftonte, e udhëhequr nga direktivat dhe nga veprimet e Partisë, me çdo mjet e me çdo formë në familje, në punë, në shkollë, në arë, në zyrë, të fuqizonte luftën antifashiste në çdo skaj të vendit, në gjirin e popullit.

Duke luftuar, bëhemi luftëtarë, u thashë të rinjve në mbledhje. Lufta aktuale duhet të bëhet e shumëformshme. Të rinjtë të mos neglizhojnë, por të pranojnë, qoftë edhe një ndihmë të vogël në fillim nga një i ri ose e re apo një fjalë të mirë prej tyre për luftën tonë, qoftë e thënë kjo edhe

me druajtje në fillim, pse kjo është, né fakt, një ndihmë, është një premtim për një ndihmë më të madhe nesër, kur të gjithëve Vu dalë frika. Rinia, u thashë né përgjithësi, është trme, e guximshme. por té gjithë dhe përnjë herë nuk janë e nuk mund të jenë të tillë. Trima bëhen njerëzit duke luftuar, kur kanë kuptuar përse luftojnë dhe kur e ndiejnë veten se nuk janë luftëtarë të vetmuar. Prandaj në mbledhjen që u bë, theksova se Partia insiston në karakterin që duhet të ketë organizata e rinisë dhe këtë karakter ta ruani.

Duke iu referuar analizave e konkluzioneve të Mbledhjes ku u themelua Partia dhe zhvillimit të ngjarjeve të luftës që po zhvillohej kundër fashizmit italian, nazizmit gjerman dhe militarizmit japonez, në Evropë e në botë, unë u bëra një tablo të shkurtër të ngjarjeve dhe të luftimeve. Vura në dukje, në radhë të parë, luftën heroike që zhvillonte Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe Ushtria heroike e Kuqe, të udhëhequr nga Stalini i madh. U vura në dukje dhe theksova se populli, Partia dhe rinia jonë duhet ta duan me gjithë shpirt atdheun e Leninit dhe të Stalinit dhe ushtrinë e tyre heroike, që është forca kryesore që lufton nazizmin e egër gjerman. Theksova se ne duhet të propagandojmë për ta dhe ta lidhim ngushtë luftën tonë me luftën e popujve të Bashkimit Sovjetik, që udhëheq me gjenialitet Stalini i madh. Theksova se, me hyrjen e Bashkimit Sovjetik në luftë, lindën shpresat e fitores për popujt që luftojnë.

Vura, po ashtu shkurtimisht, në dukje rëndësinë e aleancës së madhe antifashiste në mes Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe se ne duhet të jemi pro kësaj aleance, pse që të tria janë në luftë kundër të njëjtëve armiq, që janë dhe armiqtë tanë.

Kjo duhet të jetë e qartë, theksova, pse ka akoma paqartësi në këtë problem të luftës antifashiste. Është e qartë që ne e dimë kush janë imperializmi anglez dhe ai amerikan, ç'qëllime kanë dhe ç'objektiva svnojnë pas luftës dhe nuk mund t'i barazojmë ata me Bashkimin Sovjetik që është një shtet socialist. Këto çështje në këtë aleancë nuk duhet t'i konfundojmë, por duhet të jemi shumë vigjilentë. Çështja, pra, e aleancës antifashiste është një aleancë me të gjithë ata që duan të luftojnë fashizmin dhe nazizmin. Kështu duhet të veprojë Partia jonë edhe brenda. Janë momente nacionale, është detyra jonë të grumbullojmë gjithë popullin për luftë, pavarësisht se do të ketë njerëz që ideologjikisht s'pajtohen me ne, po ata pajtohen me ne në luftën kundër fashizmit.

Kjo çështje duhej ngritur pse, ashtu siç na kishte ndodhur edhe në disa mbledhje të celulave të para, pikërisht kur filluam diskutimet, edhe në mbledhjen e rinisë u ngrit një anëtar i ish-Grupit të «Të Rinjve» dhe paraqiti çështjen e aleancës në mes të tre të mëdhenjve si të dëmshme, të dënueshme, prandaj, sipas tij, Partia jonë nuk duhej ta pranonte. Natyrisht, të gjithë ata që diskutuan ia hodhën poshtë pikëpamjet e tij, por elementë si ky ishin njerëz të rastit në Parti, ishin anarkistë, trockistë dhe që disa gjatë luftës, disa pas Clirimit u implikuan në punë antiparti dhe u hodhën jashtë Partisë.

Në fjalimin tim u bëra shokëve një pasqyrë të gjendjes shpirtërore të popullit dhe të rinisë, të urrejtjes së tyre kundër okupatorëve dhe tradhtarëve me një bilanc të gjendjes së rezistencës kundër okupatore"ve. U zhvillova, gjithashtu, në vija të përgjithshme, perspektivat e luftës në të ardhmen.

Pas meje e mori fjalën Qemal Stafa, i cili mbajti raportin për gjendjen ideopolitike të rinisë së vendit tonë, për organizimin e saj të tashmë e të ardhshëm dhe detyrat politike, ideologjike e ushtarake të saj, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Qemali, pasi foli edhe ai mbi rëndësinë e Themelimit të Partisë, theksoi se ç'përfaqëson rinia për Partinë tonë të porsaformuar, e veçanërisht në kushtet e vendit tonë. Regjimi satrap i Zogut jo vetëm e kishte lënë vendin në varfëri e mjerim dhe, më në fund, e shiti në ankand tek imperializmi italian, po ai mbahej në fuqi duke shtypur çdo liri mendimi e veprimi, duke persekutuar e duke vrarë njerëz përparimtarë dhe jo vetëm komunistë, por edhe demokratë revolucionarë. Pushtimi fashist italian dhe ikja tinzare e Zogut me qojlet e tij u dhanë zjarr ndjenjave patriotike e revolucionare të popullit dhe të rinisë sonë. Në esencë Qemali përshkroi përmbledhtas e qartë se si e priti rinia pushtuesin fashist urne urrejtje, me greva dhe me demonstrata, si u përpoq të siguronte armë e të luftonte. Ajo bëri përpjekje për të sabotuar çdo

veprim të fashistëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre. Rinia luftoi kundër orvatjeve të armikut për fashistizimin e vendit, me organizatat që krijoi e me shkollat, për të mashtruar popullin me të ashtuquajture'n mirëqenie e mbrojtje që do t'i sillte gjoja vendit tonë Italia fashiste. Rinia kërkonte të organizohej, të vepronte. Dhe të rinjtë, që ishin në lidhje me grupet komuniste, në shumicë nuk ishin infektuar nga pikëpamjet e sëmura të grupeve dhe të krerëve të tyre, bile as nuk kishin dijeni për zënkat në mes tyre.

Prandaj thirrjet për demonstraia e aksione ishin për të rinjtë një gëzim e rast për të shpërthyer dufin e tyre dhe ata merrnin pjesë në to në masë. Kështu që Partia e re Komuniste do të gjente në rini një rmbështetje e rezervë të shëndoshë. Qemali theksoi se megjithëqë në kohën e parë më aktive duket rinia studenteske (kështu quhej rinia e shkollave të mesme), duhej treguar më vëmendje ndaj rinisë punëtore, shëgertëve dhe atyre të shtresave të varfra, që as punë nuk gjejnë, as mundësitë nuk i kanë që të ndjekin shkollat. Qemali vuri në dukje se në këtë drejtim diçka bëhet në Tiranë, në Shkodër, në Korçë e në Durrës, por kjo punë duhet zgjeruar në të gjitha qytetet. Me pjesën më të ndërgjegjshme të këtyre të rinjve punëtorë shëgertë dhe me të rinjtë më revolucionarë të shkollave duhet të fillojmë organizimin e Rinisë Komuniste, rreth së cilës do të grumbullohej dhe do të organizohej rinia antilashiste.

Qemali tërhoqi veçanërisht vëmendjen në punën që duhej bërë për ngritjen e rinisë fshatare, nga e cila grupet komuniste kishin qëndruar larg, kurse mendimi i Partisë ishte që te kjo rini do të gjendej një burim i madh njerëzor për Luftën Nacionalçlirimtare, duke pasur parasysh se fshatarësia jonë nuk ka qëndruar kurrë indiferente ndaj çështjes së lirisë dhe pavarësisë së atdheut dhe se ajo ka tradita të pasura të luftërave të saj për liri, për tokë dhe për bukë.

Qemali, gjithashtu, nënvizoi se Partia jonë e re, si parti komuniste, është për barazinë në mes burrit dhe gruas dhe Lufta Nacionalçlirimtare do të ishte një bazë e shëndoshë për të sigituruar një kthesë drejt emancipimit të gruas shqiptare.

Qemali pastaj shtjelloi parimet mbi të cilat duhel të ngrihej Organizata e Rinisë Komuniste. Ashtu siç mendonte Partia, ajo duhej të ishte një organizatë as aq e ngushtë sikur të ishte parti, por jo dhe aq e gjerë sa të përfshinte gjithë të rinjtë që ishin kundër fashizmit. Në Rininë Komuniste duhej të pranoheshin të rinjtë më revolucionarë e simpatizantë të komunizmit e jo vetëm nëpërmjet librave e leximeve, por që kishin dhënë prova në aksione, në greva, në demonstrata, në sabotazhe e në aksione të tjera të Partisë e të Rinisë Komuniste.

U fol në përgjithësi për disc forma që u përcaktuan më mirë më vonë pas diskutimeve në Komitetin Qendror të Rinisë Komuniste e sipas rrethanave që paraqiteshin, si, për shembull, për aktivet e Rinisë Komuniste, për bërthamat me të rejtat e të rinjtë komunistë më të zgjedhur, që do të shërbenin dhe si ndërlidhës me forumet e Rinisë Komuniste, që do të ngriheshin në çdo qark, sikundër bëhej edhe në Parti, do të kishte dhe grupe edukative me të rinj e të reja, ku do të diskutoheshin probleme ideopolitike e do të merreshin njohuri teorike mbi shoqërinë komuniste dhe mbi programin e detyrat aktuale të Partisë.

Nga gjithë të rejtat dhe të rinjtë komunistë kërkohet që të punonin, duke filluar nga familjet e tyre, me prindërit, vëllezërit, motrat, si dhe me shokë e të njohur, të cilët t'i sqaronin, t'i aktivizonin në punëra të ndryshme për lexim e ndarje traktesh, për mbledhje ndihmash, dhe, kur të jepnin dica prova venënsmerie, disa nga këta simpatizantë mund të pranoheshin në Rininë Komuniste, kurse të tjerët të mbaheshin në lidhje si të rinj antifashistë. Qemali theksoi se edhe këta mund dhe duhet të aktivizoheshin në forma të ndryshme. Gjithashtu ai theksoi dallimin që duhet pasur parasysh në mes kërkesave për anëtarët e Partisë dhe atyre për të rinjtë komunistë qoftë për sa u përket formave të mbledhjeve, qoftë për detyrat që u rgarkohen. Por, sidoqoftë, disa cilësi, si konspiracioni, vendosmëria për aksion etj., duhejtëkërkoheshin nga të rinjtë komunistë. - Rininë ta hedhim në aksion, - tha Qemali, - por Partia na porositi që edhe ta ruajmë rininë sa më shumë nga goditjet e armikut, prandaj do të na duhet që në hapat e parë të organizimit të forumeve dhe të bërthamave të Rinisë Komuniste të tregohemi të kujdesshëm, se rinia merr zjarr shpejt.

Pastaj ai foli për detyrat që e presin rininë në bazë të programit e të detyrave që caktoi Mbledhja e parë e Themelimit të Partisë dhe Komiteti Qendror i saj Provizor: luftë deri në fund kundër pushtuesve fashistë, demaskim e luftë kundër bashkëpunëtorëve të tyre, tradhtarëve të popullit dhe të atdheut, lidhje sa më të ngushta me masat e popullit dhe sqarimi i tyre mbi fashianin, mbi forcën e Bashkimit Sovjetik si vend socialist dhe urbi luftën e gjithë popujve të robëruar, popullarizimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë si luftëtare e vendosur dhe e radhës së parë për çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë dhe për sigurimin e një jete më të mirë për popullin në të ardhmen, që mund të sigurohej vetëm me luftë dhe të bashkuar në rrugën që tregon Partia jonë.

Qemali foli ndonjë orë e gjysmë; ai fliste rrjedhshëm, qartë, me një të folur gegërishte në mes elbasançes dhe shkodrançes.

Pasi foli Qemali, e mbyllëm seancën aty nga mesnata e datës 22. Natyrisht dyshekë e mbulesa për të gjithë nuk kishte. Si gjithnjë, në këto raste disa shokë shtriheshin pranë njëri-tjetrit, duke vënë kokën në jastëk ose në minder, veshur siç ishin, koburet nën jastëk dhe këmbët të shtrira në dërrasa. Në disa raste, kur ishim shumë, disave u binte të flinin ndenjtur, në dërrasa ose mbi karrige, duke mbështetur kokën mbi tryezë, ose në murin e ftohtë, ose në supin e ngrohtë të ndonjë shoku. Nexhmija që më e fituara në këtë mbledhje, ajo fjeti në krevatin e Bijes.

Të nesërmen, në mëngjesin e 23 Nëntorit, u ngritëm herët. Bija na dha nga një gotë me çaj lule buri dhe një copë bukë. E vazhduam mbledhjen me diskutimet orbi vijën dhe direktivat e Partisë dhe mbi detyrat për Organizatën e Rinisë Komuniste.

Mbi dica probleme të gjendjes ndërkombëtare, si dhe për rininë në Tirane e në Durrës dhe mbi disa masa për ta ruajtur atë nga demagogjia fashiste foli Nako Spiru. Mbi punën me të rinjtë punëtorë në Korçë e në Shkodër folën Tasi Mitrushu dhe Ndoc Mazi.

Nexhmija foli mbi veprimtarinë e të rejave komuniste, veçanërisht në Institutin Femëror të Tiranës, mbi mundësitë e mëdha për të shtrirë lëvizjen antifashiste jo vetëm brenda kësaj shkolle, por edhe nëpërmjet saj në të gjithë vendin, sepse në këtë Institut për mësuese, i vetmi në vend, vinin vajza nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Kishte mjaft vajza edhe nga shtresat e varfra dhe përparimdashëse, që, me shumë sakrifica, kush me ndonjë bursë, kush me shpenzimet e veta, përpiqeshin të përfitonin profesionin e mësueses për të siguruar të ardhmen e tyre dhe për të ndihmuar familjet.

Përpyekjet që bëri Zogu për t'i lidhur pas qerres së tij këto edukatore të brezit të ri, dulce organizuar me anën e motrave të tij pritje e parada karnavaleske, nuk patën sukses. Kur erdhi puna të mbrohej atdheu, vajzat e Institutit, bashkë me shakët e rinisë shkollore e punëtoresh, organizuan shfaqje teatrale patriotike,

dolën në demonstrata, kërkuan para pallatit të mbretit arme për të luftuar, dolën vullnetare për t'u përgatitur si infermiere, duke menduar se armiku do të pritej me arme.

Me ardhjen e pushtuesve fashistë, filloi një lëvizje më e gjallë në shkollë, se shoqet komuniste dolën nga guaska e tyre, nga puna e ngushtë me masat. Nexhmija përshkroi se si sabotoheshin në shkollë ngritja e «flamurit me sëpata», mësimi mbi fashizmin, aktivitetet e pedagogëve fashistë italiane për shfaqje fizkulturore,

parada e të tjera manifestime fashiste. Kur erdhi për vizitë Konti Qianoja, ministër i Jashtëm i Duçes, vajzat e Institutit që i nxorën me detyrim, dolën me grykëset e zeza, duke hequr në mënyrë demonstrative jakat e bardha dhe dica qanin, disa i kthyen shpinën. (Për këtë pritje Qianoja ka shkruar edhe në ditarin e tij.)

Nexhmija theksoi se një veprimtari e tillë zhvillohej jo vetëm në shkollë. Të rejtat e grupeve komuniste dhe aktivistet antifashiste kishin filluar të punonin edhe me vajzat shtëpiake, të cilat, tha ajo, i dëgjojnë me shumë etje bisedat tona dhe janë të gat

shme të hidhen edhe në aksione, megjithëse pengohen shumë nga fanatizmi i rrethit të tyre familjar dhe i opinionit ku luftojnë. Megjithëse shumica e vajzave shtëpiake janë me çarçaf, ndonjëra e ka hedhur atë dhe ka dalë në demonstrata, të tjera ikin pa leje e vijnë në mbledhjet tona, lexojnë libra dhe trakte dhe ato që s'dinë kërkojnë të mësojnë. Nexhmija vuri në dukje se

me të rejat punëtore punohet vetëm nëpërmjet motrave të disa shokëve punëtorë, të cilat punojnë edhe ato në fabrikën e cigareve ose si rrobaqepëse etj.

Diskutimet vazhduan ditën e dytë. Ato khin të zjarrta, plot barut dhe entuziazëm, në unitet të plotë me Partinë Komuniste të Shqipërisë. Diskutimet treguan besnikërinë e madhe të rinisë ndaj Partisë së tyre, që sapo ishte formuar, dhe shokët u betuan se do t'i qëndronin besnikë deri në vdekje mësimëve të saj, se do të luftonin nën urdhrat e saj deri në fitore për lirinë e plotë të popullit. Të gjithë anëtarët e mbledhjes me diskutimet e tyre aprovuan një ëzëri raportin tim që u mbajta në emër të Komitetit Qendror Provizor, si edhe raportin e shokut Qemal Stafa. Në mbarim të diskutimeve u vu në votë dhe me një entuziazëm të papërshtatshëm u themelua Organizata e Rinisë Komuniste të Shqipërisë. U përqaftuam, kënduam. Ishte data 23 Nëntor e vitit 1941.

Pas themelimit të organizatës duhej bërë zgjedhja e Komitetit Qendror Provizor të Rinisë. U vendos që për çështje konspiracioni nuk do të paraqiteshin kandidaturat me emra, por me numra dhe përbri secilit numër karakteristikat. Pra do të votohej për numrin, pa ditur kush ishte, por duke u bazuar në karakteristikat. Unë dhe Qemali kishim shkëmbyer mendime edhe më parë për kandidaturat, por, pasi na ngarkoi mbledhja, i riformulua, i plotësuam karakteristikat dhe i paraqitëm. U zgjodhën pikërisht aq sa duhej dhe të gjitha votat ishin unanime për numrat që u caktuan. Emrat tash dihen. U zgjodhën 5 veta: Qemal Stafa, Nako Spiru, Nexhmije Xhuglini, Tasi Mitrushu dhe një shok që, menjëherë pas mbledhjes, u dërgua me punë në Kosovë e në vend të tij u zgjodh Misto Mame.

Mbledhja historike mbaroi me sukses. Rinia he roike e vendit tonë kishte tash organizatën e saj, udhëheqjen e saj. Kjo organizatë do të zgjerohej, do të forcohej, do të kalitej në luftë, do të bënte heroizma të paparë kurrë në historinë e popullit tonë, ajo do të nxirrte nga gjiri i saj heronj legjendarë, udhëheqës të shquar të Partisë, ajo u b.ë dhe mbeti fidanishtja e pashterur e Partisë. Brezi i të rinjve, që luftuan si luanë, u bë brezi i parë i lavdishëm i Partisë dhe sot kjo organizatë me një histori të madhe, nën udhëheqjen e Partisë, qëndron në ballë të ndërtimit të socializmit.

Pasi mbaroi mbledhja, shokët u shpërndanë në për vendet nga kishin ardhur dhe tash që atyre iu çel perspektiva, të armatosur me udhëzime dhe me direktiva të qarta, me entuziazëm do t'i shpërndanin dhe do t'i rrënjosnin këto në gjithë rininë e vendit tonë. Tash duhej të fillonte anëmbanë vendit organizimi i rinisë. Me shakët e Komitetit Qendror bëmë disa mbledhje. Shoku Qemal Stafa u zgjodh me entuziazëm dhe me unanimitet sekretar politik i Rinisë Komuniste të Shqipërisë. Zgjedhja e Qemalit, anëtarit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, si sekretar politik i Organizatës së Rinisë Komuniste, ishte një garanci e madhe për Partinë dhe për organizatën e rinisë, pse Qemali ishte një shok me cilësi të rralla për moshën e tij të re. Ai ishte shumë i ri, por edhe shumë i pjekur, ai ishte i thellë dhe serioz në mendime e në diskutime. Me të rinjtë ai dinte të fliste për çështje të thella, por me një ton të dashur, të qeshur, shumë herë me humor. Qemali ishte i atillë që e ndiqnin të rinjtë, e rrethonin, ishte njeri me kulturë dhe këtë kulturë dinte ta përdorte, ta adaptonte, nuk ishte nga ata që donte të tregohej se dinte, por te cilido e linte të thellë përshtypjen se dinte. Sa për guxim dhe trimëri, ai ishte i patundur dhe i hedhur. Shumë pak rrojta e punova me Qemal Stafën, pse shumë pak rrojti ky shok i lavdishëm dhe jetën e tij të re, derisa u vra dulce luftuar, ua kushtoi komunizmit dhe Partisë. Kohërat e vështira e të turbullta të luftës ilegale më lidhën ngushtë me Qemalin. Kur ktheheshim në mëngjes ose në errësirën e natës në baza për të shkëmbyer mendime dhe për të marrë vendime, kur mbaronim hallet, Qemali fillonte barcaletat, unë i përgjigjesha me të miat. Hynte kështu pak të qeshur dhe çlodhje në jetën tonë.

Nako Spiru u zgjodh sekretar organizativ. Këtë unë e njihja me kohë, pse ishim të një grupi, por Nexhmijen e njoha për herë të parë në mbledhjen e themelimit të Rinisë Komuniste të Shqipërisë. E dëgjova me vëmendje diskutimin e saj dhe më pëlqeu. E filloi diskutimin pak e emocionuar, si dukej i vinte turp nga ne, si më të rritur dhe të njohur të rinj. Më la përshtypje të thellë qartësia dhe vendosmëria e saj me të cilën foli.

Një simpati e madhe prej shoku lindi tek unë për këtë shoqe të re e të vendosur. Në mbledhjet e mëvonshme të Komitetit Qendror të Rinisë, ku asistova dhe unë, e njoha më mirë Nexhmijen. Ajo tanfi fliste hrisht e me zjarr në këto mbledhje, i doli turpi nga unë. U nda puna në Komitetin e Rinisë. Qemali e propozoi Nexhmijen të drejtonte organizatën e rinisë së Tiranës. Përgjegjesi e madhe. Nexhmija me thjeshtësinë e saj tha:

- Unë jam ushtarë e Partisë, do të vë të gjitha forcat, por a do ta bëj dot?

- Do ta bësh, - i tha Qemali, - se s'do të jesh vetëm.

- Do të të ndihmojmë, - i thashë unë.

Kjo ishte njohja e parë me Nexhmijen, që më vonë çoi në ato lidhje që u kalitën në luftën tonë të përbashkët kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, si dy ushtarë besnikë deri në vdekje në shërbim të Partisë dhe të kauzës së madhe të komunizmit e të socializmit.

Në intervalet e këtyre mbledhjeve nuk mund të harroj nga kujtesa ato çaste të gëzueshme që kalonim me shokët e rinisë, këngët që i këndonim në surdinë, të shoqëruara me mandolinë nga Qemali.

- Bije, - i thoshte Qemali, - bën ç'të duash, vrit pesë fashistë, por ne sonte duam hallvë, se formuam Rininë Komuniste.

- Ju baj, djelt e Bijes, - thoshte ajo dulce qeshur dhe, kur dridhte luharen në tenxheren ku bë hej hallva, ne rrinim rreth e rrotull dhe lëpinim buzët. Ose herë tjetër Qemali i thoshte Bije Vokshit, e cila e donte aq shumë Qemalin

- Mjaft Bije, na ngope me ujë të zier, në vend të çajit ne duam harapash.

Qemali ishte edhe fotograf amator, kishte një aparat të vjetër dhe punonte, si të thuash, në njëfarë biruce që përdorej për Vu larë, e cila kishte një vrimë si penxhere. Qemali e kishte kthyer këtë në «dhomë të zezë», ku lante fotografitë.

- Qemal, - i thashë një ditë, - më bën një fotografi për një letërnjoftim fals?

- Posi, - tha Qemali dhe ma bëri e ma lau shpejt. Ishte aia fotografi që ekziston në një letërnjoftim timin fals, ku kam dalë me syze dhe me mustaqe. Ajo është kujtim nga Qemal Stafa.

Që nga themelimi i Organizatës së Rinisë Komuniste dhe derisa u vra nga fashistët, megjithëse në ilegalitet të rëndë, Qemali shkoi në Shkodër, Durrës, Lushnjë, Berat, Gjirokastrë e gjetkë për të organizuar, për të udhëzuar dhe për të mobilizuar organizatat e Partisë dhe të rinisë. Ai bënte një punë të madhe dhe, kur kthehej, bisedonim së toku dhe me shokë të tjerë, i raportonim shoqi-shoqit, merrnim vendime dhe hidheshim në punë.

Dita e fundit e pjekjes siine me Qemalin ishte më 4 maj. U poqëm në bazën nr. 66, në Rrugën e Shëngjergjit, në shtëpinë e Hysen Dashit. Ishte një familje e ndershme populli. Kryetari i familjes ishte një patriot, një plak me virtyte të larta, që na donte shumë. Ai e dinte ç'ishim ne, po kurrë nuk u tremb nga patrullat. Gruaja dhe fëmijët e tij ishin të gjithë tanët. «Zjarr le të marrë shtëpia, - thoshte plaku, - rroftë Partia Kamuniste» (si tiranas që ishte, nuk e thoshte dot komuniste). Plaku na donte të gjithë, po Gogo Nushin e donte më shumë nga të gjithë.

Me Qemalin ndenjëm tërë ditën brenda në dhomë dhe punuam. Plaku na solli të hanim. Unë po përgatitja një leksion për Ushtrinë e Kuqe, Qemali përgatitej se të nesërmen që në mëngjes, duke gdhirë 5 maj, do të nisej për në Vlorë. Ramë e fjetam afër njëri-tjetrit, në një minder të mbuluar me batanije.

Në mëngjes u përqaftuam dhe u ndamë. Ai u nis për në Vlorë, unë për një mbledhje me shokë. Sido që ne baritnim çdo herë, si thotë popuili, «me qefin në kokë», me kobure në brez dhe me bomba nëpër xhepa, as nuk mendonim për vdekjen që na priste në çdo qoshe rruge. Si mund të mendoja unë se e putha dhe e shtrëngova për herë të fundit në kraharorin tim shokun, nga më të mirët e Partisë, shokun dhe bashkëluftëtarin tim të dashur, Qemal Stafën?!

Në bazën ku isha, erdhi një shok dhe, duke qarë, më tha:

- Armiku na vrau Qemal Stafën!

Vura duart në kokë dhe nuk i mbajta dot lotët.

- Ku e vranë? - i thashë.

- Në Tiranë, - më tha shoku, - në një shtëpi në bregun e lumit të Tiranës.

U ngrita në këmbë dhe me shpresë i thashë:

- S'duhet të jetë e vërtetë, Qemali që në mën

gjes u nis për në Vlorë. Për këtë jam i sigurt, mos e besoni, se armiku hap parulla!

- Mjerisht, - më tha shoku, - kjo është e vërtetë. Qemali u vra duke luftuar, ra heroikisht dhe mbrojti tërheqjen e shokëve që shpëtuan. Ai harxhoi gjithë municionin që kishte. - Dhe më tregoi tërë historinë e ngjarjes që ka përshkruar historia.

Kështu mbaroi Qemal Stafa, heroi i Partisë, Heroi i Popullit. Ai ra, për të mos vdekur kurrë, ai u bë simbol i madh i luftës dhe i vetëmohimit për kauzën e madhe të komunizmit, të socializmit, për kauzën e Partisë dhe të Rinisë Komuniste të Shqipërisë, për këto ditë të bukura që gëzojnë populli dhe atdheu ynë socialist.

Ty rini e mrekullueshme e atdheut tonë, asgjë nuk të ndali në rrugën e çlirimit kombëtar dhe shoqëror, ltu të udhëhiqte Partia e shtrenjtë. Ti shkrepje si vetëtima mbi okupatorët dhe tradhtarët, ty s't'u drodh kurrë dora, ti ishe zjarr, barut e çelik.

Të pashë në demonstrata, në luftë të hapur dhe në ilegalitet, të pashë në aksione dhe në beteja, ku ti qëndroje si heroinë, ti u ndodhe në vendet më të rrezikshme ku të caktonte Partia. Ti rini e vendit tonë ia bëre të padurueshme jetën armikut në qytete, ti mbushe getat, batalionet e brigadat tona të lavdishme partizane dhe e godite për vdekje armikun. Ti me Partinë Komuniste të Shqipërisë, si nënë të lavdishme, si edukatore dhe udhëheqëse të pagabueshme, dole vigane në fitoren e madhe të çlirimit.

Partia dhe populli jo vetëm mburrëshin me ty, pjellën e tyre të kalitur në zjarr e në furtuna, por që në ditët e para të Çlirimit të besuan detyra të rënda dhe të lavdishme. Kishte njerëz që thoshin: «Këta s'do Via dalin dot mbanë, pse janë të rinjH, por për Partinë ju ishit më të pjekurit e më të zotët, se ju pikërisht në Luftën Nacionalçlirimtare fituat një eksperiencë kolosale.

Dhe skeptikët u çarmatosën: Libri i ndritur i Shqipërisë socialiste është i hapur dhe shkëlqen, pse në të pasqyrohen edhe përpjekjet, luftërat, guzimi, heroizmi, sakrificat, gjaku, dituria e zotësia e rinisë sonë heroike, edhe drejtimi i drejtë politik, ideologjik dhe organizativ i asaj Rinie Komuniste që u formua në zjarrin e mitralozave, të asaj rinie që sot quhet Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, që udhëhiqet si kurdoherë nga Partia e Punës e Shqipërisë në betejat e reja për ndërtimin e socializmit.

KONSULTA E PARË E AKTIVIT TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

(12-14 prill 1942)

Nuk kishin kaluar veçse pesë muai nga dita e formimit të Partisë, kur ne u mblodhëm për një ngjarje tjetër të shënuar: në Konsultën e Parë të Aktivit të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ky aktiv kishte një rëndësi shumë të madhe për jetën organizative, ideologjike, politike të Partisë dhe për organizimin e fuqizimin e luftës kundër okupatorit fashist. Për ne kjo ishte një ngjarje e paharruar, edhe sepse aty u takuam me shokët komunistë, me ata që njiheshim dhe me ata që nuk njiheshim më parë, por edhe sepse këtë herë takoheshim si anëtarë të asaj Partie që e kishim ëndërruar prej kohësh dhe tash e kishim realizuar këtë ëndërr. Prandaj vinim të gëzuar dhe krenarë për Partinë tonë të re, pulsi i së cilës, që tani në hapat e parë, ndihej të rrihte në shumë vende të atdheut tonë.

Kjo mbledhje e rëndësishme do të kthehej në një shkollë për ne. Aty do të konsultoheshim me shokë të dërguar nga organizatat e terrenit për punën dhe për situatat, do të shkëmbejm

përvojën e muajve të parë të punës së Partisë dhe do të caktonim detyra të mëtejshme. Eksperienca e punës dhe e luftës së Partisë në Tiranë, si dhe raportet që na dërgonin shokët nga terreni, më dhanë mundësinë që në raportin e Konsultës së Aktivitetit të formuloja sa më besnikërisht gjendjen në Parti. Ky raport që mbajta në atë Konsultë tashmë njihet, por dua të theksoj se ishte me rëndësi që aty të pasqyrohej realiteti, të thuhet_ shin gjërat copë, ashtu siq ishin, që të mos krijoheshin as iluzione, as përshtypje të gabuara che pa baza. Ishin muajt e parë të jetës së Partisë dhe Komiteti Qendror i Përkohshëm i saj nuk duhej as ta fshihte, as ta zbulonte realitetin e gjërave, por as ta nxinte. Ne, shokët e Komitetit Qendror, kishim besim të patundur në të ardhmen e Partisë sonë, por në asnjë rast nuk e gënjenim veten me mendimin se e kaluara e semurë e grupeve do të zhdukej menjëherë. Ne e kishim të qartë se do të duhej një luftë e gjatë dhe këmbëngulëse nga ana e të gjithë komunistëve për t'i spastruar ato mendime dhe mbeturina të dëmshme që bluheshin në koka të sëmura dhe në zemra të frikshme.

Kohët, natyrisht, ishin shumë të vështira. Reaksioni që i madh dhe goditjet e tij kundër nesh ishin të rënda. Armiku okupator e shihte rrezikun, prandaj i shtoi raprezaljet si me armë, ashtu edhe me denigrime e me propagandë politike. Kuislingu i egër dhe gjakatar, Mustafa Kruja, i shtonte çde dito zullumet. Përveç propagandës antikomuniste që bënte me zyrat e fashios, me gjithë organizmat shtetërorë dhe me shtypin fashist, ai kishte vënë në lëvizje edhe pseudonacionalistët, të cilët na trajtonin ne, komunistët, si «kalamanë», si «aventurierë» dhe Partinë tonë «si një parti të huaj për Shqipërinë e për shqiptarët». Kurse Grupin e «Zjarrit» ata e quanin, sig e quante edhe grupi veten, «partia e vërtetë komuniste», parti regale, e cila jo vetëm «ka lidhje me Kominternin», por na përdorëj edhe taktikat «elastike» të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (bolshevike) (!), që «di, si ajo, kur të tërhiqet dhe kur të sulmojë», me një fjalë, edhe «komuniste», edhe fashiste, edhe agjenturë e Mustafa Krujës. Kjo «parti» e kalbur mbante në gjë plehra të njohura, si Andrea Zisin, Niko Xoxin, Aristidh Qendron, Hysni Lepenicën, Fetah Butkën dhe të tjerë, që në realitet ishin agjenturë e fashizmit.

Pikërisht në mes këtij reaksioni të egër e të përgjithshëm që na rrethonte, na përgjonte e përpiquej të na godiste nga të gjitha anët, ne do të mblidheshim në Konsultë. Konsulta do t'i zhvillonte punimet në një atmosferë të rritjes së mëtejshme të terrorit fashist. Që prej 1939-s ishte bërë traditë që, në prag të gdo 7 prilli, populli e rima, me komunistët në krye, ngriheshin në demonstrata të mëdha, ku protestonin me të gjitha forcat kundër pushtimit fashist, dhe përlesheshin me karabinierët e hierarkët fashistë. Edhe në fillimin e prillit 1942 autoritetet fashiste e ndienin se populli dhe rima do të ngrihej përsëri në demonstrata, prandaj aro ditë ata po i forconin më shumë se kurrë masat e shtrëngimit, të gjurmimit e të bastisjes në masë. U shtuan patrullat e repartet e posagme «të vendosjes së rendit», sidomos në sheshet e në rrugët kryesore. Në prag të 7 prillit, ndërtesa e atëhershme e Bashkisë në Tiranë, aty ku tari ndodhet Komiteti Ekzekutiv i Tiranës, u kthye në një arsenal të vërtetë lufte, ku u grumbulluan forcat e armikut zaptues, mercenarët e spiunët e tij të specializuar për shtypjen e demonstratave e për gjurmimin dhe kapjen e «delinkuentëve», siç na quanin ne, komunistët, fashistët dhe tradhtarët vendës. Herë pas here nëpër rrugë e sheshe lëshoheshin skuadra kavalerie të ngjeshura e të pajisura me armë zjarri e shpata që feksnin në diell plot shkëlqim. Kuptohet, armiku nuk i bënte këto për paradë. Përkundrazi, të gjitha këto demonstratoheshin hapur e me përdhunë, me qëllim që në popull të krijohej psikoza e terrorit dhe e frikës, me qëllim që njerëzit tanë ta ndienin se ato shpata e tyta automatikësh fare lehtë do të lëshoheshin mbi ta, nëse do të ngrinin krye. Por ne e dinim se nën këtë kapardisje musoliniane fshiheshin frika e tmëri i pushtuesve nga shpërthimi i urrejtjes së popullit.

Ne i shihnim të gjitha këto dhe me gjakftohtësi mendonim për kundërgoditjen. Demonstratën do ta organizonim patjetër, por edhe shokët duhej t'i ruanim. Për këtë na u desh që gjithë ato ditë, krahas përgatitjeve për Konsultën dhe për përballimin e problemeve të tjera të mëdha, të shkonim në shumë baza e të organizonim një sërë takimesh me shokë e shoqe të qarkorëve të Partisë e të rinisë së Tiranës. Diskutuan me hollësi për mënyrën e organizimit të demonstratës, parullat që do të hidheshin, itinerarin që do të ndiqnim etj.

Dhe më 7 prill demonstrata shpërtheu me gjithë masat e rrepta parandaluese e kërcënuese që kishin marrë pushtuesit e reaksionarët vendës. Ata që në mëngjes kishin zënë sheshin e madh në qendër të Tiranës, ku zakonisht bëheshin demonstratat, e prisnin të lëshoheshin mbi demonstruesit, por mëngjesi i asaj dite në Tiranë ishte fare «i qetë». Bile-bile nëpër rrugë lëviznin më pak njerëz se zakonisht. Afër mesditës fashistët, si duket, menduan se populli «kishte vënë mend» e nisën të shpërndareshin.

Por tamam, kur ata s'e prisnin, në mbasdite, mu në mesin e bulevardit të sotëm «Stalin», diku atje afër ku tash ndodhet ndërtesa e gazetës «Zëri i popullit», një grumbull shokësh e shoqesh, të ngarkuar për fillimin e demonstratës, shpalosën e ngritën lart një flamur të madh të kuq me shqiponjën tonë dykrenare, pa sëpatat që i kishin vënë në krah fashistët.

Ky ishte sinjali ynë i fillimit të demonstratës. Menjëherë shpërtheu kënga patriotike: «Eja mbledhuni këtu, këtu...» dhe vërshuan drejt flamurit dhjetëra e dhjetëra njerëz, shokë, shoqe, simpatizantët e tyre, të lajmëruar për demonstratën, duke kënduar këngë revolucionare e duke hedhur parulla antifashiste. Kolonat e demonstruesve po rriteshin pandërprerë me të rinj e të reja, patriotë e antifashistë, kurse karabinierët e fashistët, duke shtrënguar radhët në sheshin para Bashkisë, prisnin që vala e njerëzve t'u vinte përpara. Por s'ndodhi kështu. Demonstruesit, me flamurin përpara, vazhduan në anën e kundërt, i ranë mes për mes bulevardit drejt zonës ku sot është stacioni hekurudhor, morën atje kthesën drejt shtëpisë ku u themelua Rinia Komuniste, pastaj u futën në rrugën e sotme «Siri Kodra», e kaluan atë dhe dolën në Rrugën e Dibrës, sot «Bajram Curri» ose, siç thonë, dhe Rruga e Spitalit.

Në dallim nga demonstratat e mëparshme, kjo e 7 prillit 1942 po zhvillohej brenda lagjeve popullore, nëpër rrugët e rrugicat e Tiranës, pranë portave e oborreve të shtëpive. Dhjetëra e dhjetëra burra, gra e Mmijë, duke parë demonstratën «t'u kalonte» te dera, linin portat hapur, bashkoheshin me të tjerët e nisnin të thërritnin e të këndonin.

Ndërkaq një grup «milicësh të armatosur u lëshuan mbi demonstruesit, duke qëlluar në ajër, duke goditur me kondakët e pushkëve etj. Por vala e demonstruesve nuk përmbahej.

Pa u trembur nga kërcënimet e milicëve e nga britmat e tyre, demonstruesit, duke kënduar e duke hedhur parulla, arritën në sheshin e ish-Medresesë, pikërisht në krye të rrugicës ku ndodhet Shtëpia e Partisë. Atje, pas një fjalimi të shkurtër që mbajti një shok i caktuar qysh më parë, objektivi i demonstratës u quajt i realizuar dhe njerëzit u shpërndanë.

Ky veprim i guximshëm e i organizuar mirë i tërhoi armiqtë. Qysh atë natë filloi një valë e re kërkimesh e arrestimesh që vazhdoi edhe ato ditë, kur ne u mbledhëm në Konsultën e Parë të Aktivitetit të Partisë. Në botimin e parë të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe në një sërë shkrimesh të botuara pas Qlirimit, është thënë se Konsulta i zhvilloi punimet nga 8 deri më 10 prill 1942. Për këtë autorët janë nisur nga një letër e shkurtër, e shkruar me dorë nga unë, e që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë, me të cilën lajmëroja shokët se punimet e Konsultës do të fillonin më 8 prill. Mirëpo, për shkak të terrorit të egër që shpërtheu më 7 e 8 prill 1942 në Tiranë, si dhe për arsye se ndonjë nga shokët pjesëmarrës në Konsultë nuk kishte mundur të mbërrinte në Tiranë në kohën e duhur, Konsulta, në fakt, i zhvilloi punimet pak më pas se dita e parashikuar dhe pikërisht nga 12 deri më 14 prill 1942.

Mbledhja u bë në ilegalitet të rëndë në shtëpinë e Bije Vokshit, të cilën e kam përshkruar edhe më parë. Këtë herë mbi tryeza, në rripat tanë të mesit ose në mure, ishin vendosur dhe varur shumë kobure, bomba dhe automatikë. Të gjithë ishim të armatosur, gati për luftë, prandaj dhe mbledhja ishte barut. Në Konsultë që vendosur dhe me kohë ishin marrë masat të vinin të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror Provi zor të Partisë, anëtarë të Komitetit Qendror të Rinisë, sekretarët politikë dhe organizativë të komiteteve të

Partisë në qarqet, dhe disc komunistë nga më të vjetrit, që nuk kishin funksione në forume. Të gjithë delegatët, më të shumtët e të cilëve ishin në ilegalitet dhe ndiqeshin këmba-këmbës, erdhën, me përjashtim të dy personave - njëri nga këta ishte drejtuesi i organizatës së Partisë në Gjirokastrë, Bedri Spahiu. Pse nuk erdhi në këtë Konsultë Bedri Spahiu? Jeta dhe puna e tij e mëvonshme e treguan se ç'ishte ai: një «komunist» i frikshëm që, gjoja për t'u raskuar, u bë

deri «myhib. në teqenë e Dervish Rexhepit, këtij reaksionari të poshtër, i cili ndodhet i arratisur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka ngritur edhe një teqe. Më kujtohet si sot, në Konsultë, pasi mbajta raportin dhe pas diskutimeve të zjarra të shokëve, nxora nga xhepi një defter të vogël bakalli me kapak të hollë e të zi, që na e kishte dërguar Bedri Spahiu,

tië të cilin, rrie bojë simpatike, ku lexohej e ku nuk lexohej, ai shkruante në vija të përgjithshme për punën e Partisë në Gjirokastrë. Ky ishte një raport bajat dhe i paqartë. Nuk mungova ta dënoja veprimin e Bedriut, i cili nuk erdhi në mbledhje, siç erdhi të gjithë shokët nëpërmjet rreziqeve të panumërta. Në mbledhje nuk thashë që «Bedriu u tregua frikacak që nuk erdhi», por thashë vetëm se «Bedriu duhet të kishte ardhur në këtë mbledhje të rëndësishme» dhe se «ai është mbyllur në kullë të fildishtë». Bedriu, më vonë, kur u takuam, më tha se nuk i kishte ardhur mirë që e kisha cilësuar ashtu punën e tij, por në realitet unë kisha arsye dhe përshtypjet t mia për atë dhe për punën e tij.

Bedriun e kam njohur që në rini. Në kohën e regjimit zogollian ai kishte qenë anëtar i Grupit të Oficerëve, një shoqëri e vogël e mbyllur antizogiste me karakter karbonaresk, e cila u zbulua dhe anëtarët e saj u dënuan me burgime. Edhe më pas ai mbeti një njeri i mbyllur, me një konspiracion të sëmurë, bile mistiko-fetar, derisa arriti që, edhe duke e quajtur veten «komunist», të shkonte dhe «të shugurohej» myhib. Përveç kësaj, në kohën e grupeve, Bedriu kishte qenë në lidhje me Anastas Lulën dhe me Sadil Premten. Me siguri, edhe më vonë, ai nuk i kishte shkëputur lidhjet shpirtërore me ta dhe duhej të kishte pasur rezerva edhe për formimin e Partisë, por ç'të bënte?, iu nënshtrua «provizorisht» gjendjes. Ish' -oficeri e hiqte veten antizogist e komunist me meriti të mëdha, prandaj, duke e njohur fodullëkun e tij them se ai, me sfiguri, duhej të ishte i pakënaqur që nuk u thirr në Mbledhjen Themeluese të Partisë: Këto i mendoja që atëherë dhe, në momentet e vështira që kalonte Partia, kur armiqtë e sulmonin ashpër atë, nuk i harroja përshtypjet që kisha për Bedri Spahiun. Dhe koha i vërtetoi ato.

Ashtu si Bedri Spahiu, nuk erdhi në Konsultë as Gjin Marku, të cilin e kishim zgjedhur edhe në përbërjen e Komitetit Qendror të Përkohshëm dhe ishte caktuar me punë në qarkun e Beratit. Ai nuk erdhi sepse, siç na tha më vonë, na paska qenë «shumë i zënë me punë». Në fakt, Gjin Marku endej nëpër malet dhe fshatrat e Skraparit, shtrohej në dreka e darka, që j pëlqenin fort, dhe për shumë kohë nuk u bë i gjallë e harronte se tani kishte Parti. Jo vetëm në Konsultë, por as në Konferencën e Jashtëzakonshme që mbajtëm dy muaj më vonë, as në mbledhje të tjera të Komitetit Qendror që bëmë herë pas here, Gjin Marku nuk paraqitej fare dhe kështu, megjithëse i zgjedhur, ai de facto nuk mori pjesë dhe nuk luajti asnjë rol si anëtar i Komitetit Qendror të Përkohshëm. Mjaftohej me ndonjë pallo informacion që na dërgonte një herë në hënë e ku shkruante gjë tjetër veç mburrje e lëvdata për veten e tij e për «trimëritë» që bënte. E vërteta është se në zonën ku e kishim dërguar, veçanërisht në Skrapar, flakët e Luftës Nacionalçlirimtare u ndezën shumë shpejt e me vrull, por këto nuk vinin vetëm nga puna e Gjin Markut. Ishte populli trim e patriot i atyre zonave që e përqafoi menjëherë thirrjen e Partisë, ishte puna e lavdëruar e djemve dhe e vajzave të mrekullueshme të popullit të këtyre krahinave që me gjakun, djersën e fjalën e tyre bënë të buçitnin malet e Skraparit e të Beratit dhe të ngrihej e të valëvitej krenar flamuri i lirisë, Veprën heroike të trimave të tillë të mençur e të palodhur, si Ramiz Aranitasit, Zylyftar Veleshnjës, Kahreman Yllit, Ajet Xhindolit, Margarita e Kristaq Tutulanit, patriotizmin dhe besnikërinë e Pasho Hysit, Ibrahimud e Hysen Zaloshnjës, të dhjetëra e të qindra të tjerëve, përdorte për mburrje Gjin Marku.

Të dy këta elementë, qoftë Bedri Spahiu në Gjirokastrë, qoftë Gjin Marku në Berat e në Skrapar shumë punë e telashe na hapën në ato vite të vështira. Kur erdhi puna që të zbritnim në qytete, që u çliruan me gjakun e sa e sa partizanëve pas kapitullimit të Italisë, kur duhej dalë me guxim e trimëri në krye të komunistëve e të popullit, ashtu siç ua kërkonte detyra që u qe ngarkuar, të d'y këta kapitulluan, bënë kompromis, Bedriu me ballistët në Gjirokastrë, Gjini me gjermanët në

Berat. Partia menjëherë e me vendosmëri i goditi gabimet e tyre të pafalshme, dhe më pas rrjedha e ngjarjeve ua nxori krejtësisht edhe atë çikë kallaj që u kishte mbetur.

Por le të kthehemi te Konsulta, e cila u mblodh, vazhdoi e përfundoi me sukses të plotë, pa e ndier fare mungesën e këtyre dy elementëve, që vala e luftës dhe e revolucionit i bashkoi përkohësisht me ne.

Vendosmëria dhe gjallëria e shokëve të pranishëm, entuziazmi; dhe shpirti i tyre revolucionar ia bënë zemrën n:al. Përqafoheshim e i shtrëngonim duart me dashuri njëri-tjetrit, silleshim me secilin sikur të qemë shokë të njohur prej vitesh. Një gëzim të madh ndjeva kur përqafova Hysni Kapon, shokun tonë trim të Vlorës, që ishte zgjedhur sekretar Politik dhe e kishim shtyllën e çeliktë të organizatës së Partisë në këtë qark. Hysni ishte atëherë një djalë i ri, me një fytyrë të hollë, të pastër, me sy të zez e të ndritshëm. Ishte i lehtë e i shpejtë në gjeste, por i matur, i pjekur në fjalë dhe i zjarrtë për Partinë. Më kujtohet, që në pushime, në një bisedë me Nakon dhe me Qemalin, u thashë:

- Partia Vlorën e ka në dorë të sigurt me Hysni Kapon. Puna atje do të zgjerohet dhe Vlora, megjithë ato tradita që ka nga 1912-a e 1920-a, si dhe para e pas fyre, do të bëhet një nga zonat më luftarake.

- Anastas Lula dhe Sadik Premtja e kanë mbaruar shkollën në Vlorë, - më tha Qemali, - po Hysni i ka ata në grykë të pushkës. Duhet të kemi kujdes andej, nga Gjirokastra, - vazhdoi ai, - se Qorri dhe Xhepi mund që bëjnë dashuri me «oficerin» (e kishte fjalën për Bedri Spahiun).

- Do ta ndihmojmë Hysniun ta forcojë punën e Partisë dhe ta rritë influencën e saj në fshatrat e Labërisë, - u thashë shokëve. - Do të bisedoj veçanërisht me Hysniun.

Ja kështu erdhëm ne në këtë Konsultë që Historia e Partisë e konsideron si një nga datat e shënuara të saj, sepse atje u rrahën një sërë çështjesh jetike për popullin, Partinë dhe për luftën e tyre.

Raporti që mbajta në emër të Komitetit Qendror u dëgjua me shumë vëmendje. Shokët mbajtën shënime, sido që, kur u larguan nga mbledhja, u thamë që ato, pali t'i lexonin mirë, t'i digjin, ose t'i ruanin me kujdes të madh. Pastaj filluan diskutimet. Të gjithë shokët kryesorë diskutuan. Ata raportuan dhe bënë vërejtje e sugjerime të dobishme. Diskutimet ishin luftarake dhe mbi këto, ashtu si edhe mbi raportin që u mbajt, u hartua Rezolucioni që konkludoi mble. dhjen.

Theksi në mbledhje u vu në shumë çështje, por gjo e krijimit të lidhjeve sa më të ngushta të Partisë me masat ishte nga detyrat më kryesore. Zgjidhja drejt e saj kushtëzohej nga forcimi ideologjik, politile e organizativ i Partisë. Këtu qëndronte forca e Partisë dhe vetëm kështu do të zhvillohej drejt e me sukses lufta çlirimtare. Pa një Parti të ngritur politikisht dhe ideologjikisht as organizimi dhe zgjerimi i saj, as vija e saj e drejtë, e, për pasojë, as lidhjet e ngushta me masat nuk mund të realizoheshin. Prandaj këto çështje merrnin rëndësi të dorës së parë. Duhet rrahur hekuri sa ishte i nxehtë, duhej kalitur Partia.

Por cila do të ishte rruga që do të ndiqte Partia për të realizuar lidhjet me masat e gjera të popullit? Konsulta në këtë drejtim u bëri një kritikë të fortë pikëpamjeve sektare, oportuniste e liberale dhe shtroi çështjen se, për t'i tërhequr masat e popullit me vete, duhet të futesh në to, të përqafosh hallet dhe dertet e tyre dhe me vepra të shquhet Partia se udhëheq. Në luftë do të zgjerohej, do të forcohej dhe do të kalitej Partia, me luftë do të fitonte ajo besimin e dashurinë e popullit. Masat duan të shohin njerëz të guximshëm e të hekur, të shohin njerëz që në mënyrë të organizuar të godasin jo vetëm në një vend, por në shumë vende. Kjo është jo vetëm çështje psikologjike, po tregon edhe forcën. Pikërisht këtë forcë duhet ta tregojë Partia dhe kjo tregohet, sidomos, duke u futur në mesa. Lidhur me këtë Konsulta konkretizoi më tej idenë e Frontit Nacionalçlirimtar si një organizatë e gjerë që duhet ta udhëheqë Partia dhe ta mbushë me njerëz të popullit, duke luftuar në të dallimet fetare që janë përdorur kurdoherë nga okupatorët për të përçarë popullin.

- Rilindasit tanë, - theksova midis të tjerash, thoshin: j<Feja e shqiptarit është shqiptaria». Ja, edhe historikisht është luftuar për të siguruar unitetin e° popullit me thirrje patriotike dhe mobilizuese kundër atyre që deshën ta përçanin e ta sundonin, siç po. bëjnë fashistët sot. Këta

shkuan deri atje sa në një xhami në Tiranë futën derra dhe përhapën fjalën se këto gjëra i bëjnë komunistët, enfiasia ata janë kundër' fesë, kundër familjes etj.

Në konkluzione u theksua veçanërisht çështja e aksioneve me njësitet guerile në qytete e në fshatra, pse disa aksione ishin bërë, por jo sa duhej dhe, si duhej.

- Njësitet guerile vetëm kur janë të organizuara, mirë e të udhëhequra si duhet nga qarkorët, - theksova në këtë mbledhje, - kur veprojnë me plane të studiuara e bëjnë goditje të forte, arrijnë ta dëmtojnë armikun dhe të ngrenë peshë moralin e popullit. Është e domosdoshme që këto të organizohen e të udhëhiqen më mirë dhe nga këto pastaj të kalohet në njësite dhe në çeta partizane nacionalçlirimtare, që do të jenë baza e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Duhet pasur paras'ysh se Partia jonë nuk mund të quhet Parti marksiste-leniniste pa organizuar luftën, pa organizuar Ushtrinë Nacionalçlirimtare të popullit. Kjo është detyra numër një e saj. Populli duhet të mbushë radhët e ushtrisë, e cila duhet të armatoset dulce luftuar dhe të përbëhet nga njerëz të fshatit dhe të qytetit.

Organizimi i Partisë kishte rëndësi të madhe, sepse u jepte fund kaosit, fraksionit dhe grupazhit. Për ta arritur këtë, shokët punuan kudo me zell dhe me abnegacion. Ata, si trina që ishin, e morën rrezikun në sy dhe kapërcyen vështirësi të shumta e të çdo lloji që krijoheshin si nga njerëzit tanë, edhe nga arxniku. Kështu, me luftë e me punë të guximshme, në kushte terrori të egër, u organizuan celulatat, u zhvilluan konferencat e qarqeve, u zgjodhën komitetet qarkore të Partisë dhe këto komitete në krahina të ndryshme të vendit u lidhën me Komitetin Qendror. U hodhën themelet e Partisë. Kjo ishte një fitore e madhe. Pas kësaj vazhdoi puna me një aptimizëm të mi për organizimin dhe për zgjerimin e luftës kundër okupatorit me greva, me demonstrata, dina herë edhe me goditje me armë.

Por në të gjitha këto veprime, gjatë gjithë kësaj pune në ata 4-5 muaj pas formimit të Partisë, na u çelën sytë dhe task e shihnim më qartë ku ishin anët e mira të shokëve dhe ku qenë dobësitë e tyre. Te të gjithë ne kishte vendosmëri, por puna e dobët e grupeve në të kaluarën na kishte lënë shumë telashe pas. Përveç shfaqjeve dhe pikëpamjeve të tyre të gabuara, ndihej edhe mungesa e theksuar e ngritjes ideologjike dhe politike të shokëve. Natyrisht, këtu nuk bëhej fjalë për një nivel të lartë teorik, por për një minimum të nevojshëm, që mund të arrihej në ato kushte. Shokët thoshin «jemi komunistë», por shumë prej tyre nuk dinin akoma në vija të trasha ç'ishte komunizmi, eishte partia komuniste, si organizohej dhe cilat ishin normat e saj, ç'ishte klasa punëtore dhe ç'vend e ç'rol kishin klasat e tjera. Në kohën e grupeve bëheshin përpjekje për të mësuar disa gjëra parimore, por shokët nuk arrinin të merrnin një edukatë të shëndoshë teorike, sepse në gjirin e çdo grupi nuk kishte pikëpamje të qarta për çështjet që përmenda më lart, të cilat ishin nga më parimoret e më të rëndësishmet. Në ato kushte ishte e pamundur që të llogarohesh si duhej mjegulla nga kokat e sëmura.

Në radhë të parë, siç theksohej edhe në Rezolucionin e Themelimit të Partisë, duhej forcuar uniteti i Partisë në të gjitha drejtimet - politikisht, ideologjikisht, organizativisht. Ky unitet rrezikohesh edhe nga brenda, edhe nga jashtë, edhe nga elementët grupash të maskuar si komunistë, edhe nga okupatori dhe nga tradhtarët shqiptarë. Ky ishte një rrezik i madh, të cilin e theksova në raport, por që u vu mirë në dukje edhe nëpërmjet diskutimeve të shokëve.

Idetë komuniste në vendin tonë ishin relativisht të reja dhe nuk kishin arritur të futeshin akoma në masa. Fshatarësinë ato nuk e kishin prekur pothuaj fare. Feudo-borgjezia bënte një propagandë shpifëse aq të ndyrë kundër Bashkimit Sovjetik dhe komunizmit, sa që edhe njerëz të ndershëm shpesh me zor arrinin të bënin diferencim midis shpifjeve e të vërtetës. Kjo edhe sepse «politikanët» e saj, që nuk ishin gjë tjetër veç hajdutë, gjakpirës, shtypës të popullit, përpiqeshin të fshiheshin nën maskën e nacionalizmit.

Me këtë gjoja nacionalizëm dhe me ata elementë 'borgjezë të korruptuar që mbuloreshin nën këtë «flamur» Partia jonë e re ishte ndeshur e do të ndeshesh më tepër në të ardhmen, prandaj kishte rëndësi të madhe të sqaronim mendjen e njerëzve, e në radhë të parë të komunistëve se ç'që nacionalizmi i vërtetë e ç'që pseudonacionalizmi, se cilët ishin patriotë e nacionalistë të vërtetë, dhe cilët ishin pseudonacionalistë e pseudopatriotë.

Termi nacionalizëm për popullin shqiptar në të kaluarën kishte marrë kuptimin e patriotizmit kombëtar, nën flamurin e të cilit elementët patriotë kanë luftuar në çdo kohë kundër të huajve okupatorë dhe të shiturve tek ata. Në këtë mënyrë, për popullin, nacionalist do të thoshte patriot, njeri që lufton për çështjen kombëtare, për gjuhën kombëtare, për lirinë dhe për pavarësinë e kombit.

Populli, dhe në radhë të parë fshatarësia, ishte forca e vërtetë që kishte luftuar gjithnjë për të gjitha këto të drejta kombëtare. Natyrisht, në përpjekjet e shumta kombëtare të fundit të shekullit të kaluar e të fillimit të këtij shekulli, elementi revolucionar i borgjezisë shqiptare ishte në pararojë dhe në këto përpjekje fshatarësia ishte rezerva e saj. Por edhe kur vendi fitoi pavarësinë, kjo mbeti kurdoherë e shtypur dhe ishte feudo-borgjezia ajo që, pasi mori fuqinë, vendosi mbretërinë e satrapit Zog, shtypi fshatarë-, sinë, klasën punëtore e lëvizjet përparimtare të disa shtresave intelektuale e të rinisë dhe e nxori vendin në ankand. Dhe tash, feudo-borgjezia për realizimin e qëllimeve të veta, dilte e mbulohej me flamurin e «nacionalizmit».

Në raport, si dhe në diskutimet, u kritikua me forcë praktika e gabuar e braktisjes së fshatit në kohën e grupeve dhe u theksua se akoma nuk po bëhej kthesë në këtë drejtim. «Komunistët, - u tha, - nuk vijnë në fshat, por presin t'u vijë fshatari në pazar që t'i thonë nga një fjalë, t'i bëjnë atij nga një propagandë të vogël». Konsulta hodhi parullën: Të kthehet fytyra nga fshati, që ky Vi njohë komunistët dhe këtë të njohin hallet, plagët, aspiratat e ndjenjat e fshata rëve, t'u hapin sytë atyre dhe të forcohet Partia me elementë të vendosur të fshatit.

Kështu fshatarëve do t'u çelej perspektiva e do të kuptonin se te lufta çlirimtare qëndronte shpëtimi dhe çlirimi i tyre, qëndronte fitorja. Vetëm kështu ata do të shihnin e do të kuptonin ç'forcë e madhe ishin punëtorët dhe Partia Komuniste, kështu ata do ta donin Partinë, do të thoshin se kjo ishte Partia e tyre, Partia e hallevë të tyre e do të linin kokën për të.

Prandaj në Konsultë vumë në dukje rëndësinë e fshatit për Partinë dhe theksuam se Partia jonë e re nuk duhej të ishte sektare, nuk duhej të mendonte se luftën do ta bënin vetëm komunistët dhe punëtorët. Vumë në dukje që Partia duhej të kuptonte mirë se rezerva e madhe e luftës dhe aleatja besnike e klasës punëtore do të ishte fshatarësia e varfër dhe ajo e mesme. Fshatarësinë duhej ta fitonte medoemos Partia dhe këtë do ta arrinte jo me llafë, por me punë e, me luftë kundër armiqve të saj, okupatorëve, kuislingëve, feudalëve dhe fshatarëve të pasur të lidhur me pushtuesit. Fshatarëve duhej t'u spastronim çdo gjë të mykur nga koka, t'u tregonim ç'ishte patriotizmi dhe cilët ishin patriotët e vërtetë, t'u shpjegonim se ç'ishim ne, komunistët, ç'donim dhe ç'synonim të bënim për popullin e për atdheun. Duhej ta bindnim me vepra fshatarësinë se ne, djemtë e popullit të vuajtur, nuk ishim agjentë të «pansllavizmit» e të shitur te të huajt, siç shpifnin armiqtë, por ishin pseudonacionalistët ata që qenë shitur te fashizmi italian.

Por, që të fitohej fshatarësia, që të depërtonte Partia në fshat, duhej kuptuar teorikisht e praktikisht nga të gjithë komunistët roli i fshatarësisë në luftë dhe domosdoshmëria e aleancës së kësaj me klasën punëtore, sepse trockistët, si Anastas Lula e Sadik Premtja, brenda në Parti, dhe Niko Xoxi, Aristidh Qendroja e «Zjarri» jashtë Partisë, vazhdonin të hidhnin helmin se «fshatarësia është e prapambetur, ajo është injorante, ajo nuk e kupton luftën e klasës punëtore». Parullat reaksionare të trockistëve, zjarristëve e anarkistëve të ndryshëm puqeshin me ato të okupatorit dhe të kuislingëve, se «populli shqiptar nuk mund' të vetudhëhiqet, atë duhet ta udhëheqin të huajt» etj.

Por, që të bëhej mirë puna e Partisë me fshatin, që ajo të ngrinte në luftë fshatarësinë tonë patriote, shumë gjëra duheshin kuptuar drejt brenda në Parti. Pikëpamjet e gabuara dhe reaksionare, e sidomos ato sektare, brenda e jashtë Partisë, përbënin një rrezik serioz që i turrej asaj, i cili duhej kuptuar e duhej luftuar. E gjithë kjo punë do ta rriste Partinë, do ta bënte të njohur në masat, do ta forconte ralin e saj udhëheqës.

Me një preokupim të veçantë u diskutua në Konsultë për frymën e grupeve, e cila manifestohej në shumë forma. Lokalizmi ishte një nga sëmundjet mikroborgjeze, që shfaqej te disc shokë, ishte një pamje sektare, e ngushtë e zotësisë personale lidhur me një «patriotizëm» krahinor, që është krejt i huaj për marksizëm-leninizmin. Natyrisht, tash flitej më pak: «Unë jam i atij osa i

këtij grupi», por kjo paraqitet në forma të tjera, si «Unë jam nga Korça», «Unë jam nga Shkodra», «Unë jam andej, unë jam këndej», «Ne e kemi traditë luftën, ju keni qenë «lalë»», «Ne jemi me ka karakteristika malësori, ju jeni më të borgjezuar». Këndej dilej në atë që «Pse ju keni njerëz në Komitetin Qendror dhe ne nuk kemi?». Kalohej pastaj në pakë.naqësi personale, si «Pse ai është në Komitetin Qarkor dhe unë jo? Unë jam më i zoti se ai» e të tjera si këto, që flisnin për mbeturina shumë të theksuara të pikëpamjeve të borgjezëve të vegjël dhe, pra, të një niveli politiko-ideologjik të ulët në përgjithësi.

Gjatë punës sonë lido që kishte kaluar një kohë e shkurtër nga formimi i Partisë, te disa shokë shihnim shfaqje të theksuara ambicieje, shfaqje liberale dhe frike. Disa drejtues të Partisë në krahina tregoheshin të plogësht ose karakterizoheshin nga një frymë e sëmurë intelektualiste, që shfaqej në ngurrimin: e skepticizmin për të ngritur kuadro nga radhët e klasës punëtore. Këto të meta qenë dobësi të fillimit të punës pas shkrirjes së grupeve. Udhëheqjes së Partisë i vihej detyrë që të gjitha këto mbeturina t'ua pastronte shokëve ane shpjegime teorike dhe sidomos duke i hedhur në veprime konkrete. Të dyjave u vinim rëndësi, se njëra varej nga tjetra. Vetëm vija e drejtë,. lufta, aksionet do t'i ndreqnin ata që do t'i vinin vetes detyrë të bëheshin komunistë, luftëtarë të zjarrtë për çështjen e Partisë, ndërsa do të gjenin vendin e tyre ata që nuk do ta meritonin këtë emër.

Në Konsultë nxorëm konkluzionin se akoma galante puna për ngritjen e nivelit teorik e politik të komunistëve; Rezolucioni i Mbledhjes për Themelimin e Partisë, që ishte një dokument historik, nuk ishte punuar thellë në Parti; nëpër celula ai ishte lexuar, ishte diskutuar dhe ishte pranuar, por duheshin zbërthyer dhe trajtuar një nga një problemet, diskutimi i të cilave duhej të shërbente si një shkollë ideologjike, politike dhe organizative. Rezolucioni, në fakt, kishte shërbyer, se kishte hedhur themelet, por në bazë të tij duhej bërë edukimi, duhej zgjeruar organizimi, duhej proceduar në përgatitjen e luftës, pse ideja e kr`yengritjes së përgjithshme ishte hedhur dhe traktet e Partisë, proklamatat e saj i bënin thirrje popullit të ngrihej në luftë, të organizohej e të luftonte. Këto dokumente përfaqësonin programin teoriko-politik dhe organizativo-ushtarak të Partisë, ku shtroheshin probleme të mëdha të vijës së saj, të cilat duheshin sqaruar, kuptuar e zbatuar. Lidhur me këtë në raport theksova:

Që të bëhemi drejtues, udhëheqës të masave, duhet të studiojmë. Gjithë komunistët duhet t'i lexojnë e t'i studiojnë proklamatat e Partisë e literaturën komuniste, se vetëm kështu do të armatosemi me dije. Vështirësitë objektive të mungesës së kësaj literature të kapërcehen dhe materialet të shumëfishohen me makinë ose edhe me dorë. Veçanërisht t'i kushtohet kujdes ngritjes së nivelit të shokëve punëtorë.

Në Konsultë kritikua pikëpamjet e disa shokëve sektarë të bazës, që nuk bënin përpjekje për të pranuar në Parti punëtorë, por kënaqeshin me atë numër punëtorësh komunistë që ishin edhe në kohën e grupeve dhe këta i quanin të mjaftueshëm; kritikua edhe ata shokë me pikëpamje intelektualiste Liberale që donin të futnin në Parti njerëzit e tyre e të na i kthenin kështu celulat e Partisë në vende debatesh akademike për çështje të tilla si «A ka vlerë aleanca anglo-sovjeto-amerikane apo jo», «A duhet ti ketë më shurnë fshatarë apo intelektualë në Parti» dhe harronin unitetin me masat, luftën dhe aksionet që do t'i jepnin jetë kësaj Partie të re.

Prandaj në konkluzion theksova se duhej Vu hapnim dyert e Partisë në radhë të parë punëtorëve, fshatarëve dhe intelektualëve patriotë e revolucionarë, se duhej të hynte medoemos gjak i ri në Parti dhe kjo të bëhej pa hezitim. Njerëzit të zgjidheshin nga lufta e masave, të ishin me të kaluar të pastër, të vendosur për vijën e Partisë dhe për luftën e ashpër, plot sakrifica që kishim përpara. Nuk mund dhe nuk duhej të futnim në Parti njerëz në baza farefisnie ose krushqie. Partia jonë, theksova, është Parti e punëtorëve dhe jo një «republikë e shokëve dhe e miqve», sipas mendimeve sektare e oportuniste që manifes tohen te disa.

Konsulta me seriozitetin më të madh shtroi problemin e zgjimit e të aktivizimit masiv të gruash shqiptare. Gruaja, theksua në Konsultë, është forcë kolosale, patriote në kulm, që ka ndenjur me shekuj në gjumë e shtypur nga paragjykimet, nga fetë, nga kanunet. Gruaja, skllave e burrit dhe e zakoneve feudo-borgjeze, duhet të ngrihet totalisht në këmbë. Do të Jetë Partia

jonë ajo që do Vi thyejë zinxhirët që e mbajnë gruan të nënshtruar. Komunistët të jenë plotësisht të vendosur për këtë çlirim, të jenë shembull i një morali pa njolla dhe sjellje nga më korrektet me gratë, të bëjnë punë të madhe politike me to, brenda e jashtë familjeve të tyre, për Vi çliruar nga bestyt nitë dhe nga psikologjia e skllavit. E gjithë Partia duhet të luftojë për këtë dhe Vu prijë me shembullin e saj rinisë dhe shoqeve tona, të cilat të jenë në ballë të kësaj pune.

Ky qe një orientim i drejtë, i cili jo vetëm hidhte themelet e organizatës së gruas, por që kishte edhe një rëndësi të veçantë për zhvillimin me sukses të luftës. Në qoftë se Partia do të fitonte gruan shqiptare, ajo kishte fituar një nga betejat më të mëdha, kishte çarë me shpatë errësirën e madhe që mbulonte vendin dhe kishte nxjerrë në qiellin e atdheut një dritë të shkëlqyer, gruan shqiptare.

Si në Rezalucionin e Themelimit të Partisë, ashtu edhe në Konsultën e Aktivit të Parë të Partisë, u vu theksi në egërsinë e diktaturës fashiste që duhej shtypur dhe zhdukur në planin ndërkombëtar dhe në planin e brendshëm të vendit tonë. Në Konsultë ne vumë në dukje sa i drejtë dhe shpëtimtar kishte qenë spastrimi i trockistëve, i zinovievistëve, i tradhtarëve të djathtë dhe i oficerëve tradhtarë në Bashkimin Sovjetik. Të tëra këto plehra punonin dhe komplotonin t'i bënin varrin Bashkimit Sovjetik. Këto ishin kolona e pestë e armiqve. Prandaj konkludua se duhet Cu bëjmë një luftë të ashpër trockistëve edhe në Partinë tonë, qofshin këta brenda, qofshin jashtë radhëve të saj.

Lufta jonë, u theksua në diskutimet e Konsultës, është e lidhur me luftën e drejtë të Bashkimit Sovjetik. Ne duhet të bashkojmë luftën tonë me luftën e aleatëve të mëdhenj dhe me atë të të gjithë popujve që janë hedhur kundër fashizmit dhe të mos lejojmë që vendi ynë të shërbejë si një trampolinë për të sulmuar fqinjët tanë, por ta pengojmë me luftë një gjë të tillë.

Kështu, në këto vija të përgjithshme dhe konkrete, kjo Konsultë armatosi Partinë të ishte në pararojë, të kaliste unitetin, të forconte disiplinën e hekurt dhe konspiracionin e shëndoshë. Të gjitha këto duhej të kuptoheshin teorikisht dhe të zbatoheshin hap pas hapi në çdo çast, në çdo veprim, në çdo mendim nga Partia, nga çdo komunist, edhe kur mendonte dhe vepronte kolektivisht, edhe kur secili vepronte i veçuar. Shpirti i iniciativës, brenda vijës së Partisë, ishte një nga rekomandimet e Konsultës.

S'kanë ç'na duhen komunistë të fjetur, inaktivë pa iniciativë, llafazanë e të frikshëm, u tha në Konsultë. Ose komunistë zjarr, ose s'kanë ç'na duhen nëpër këmbë gurë dhe hekura të rëndë që na pengojnë të ecim përpara. Partia është pararoja. Partia është e duhet të jetë në sulm.

Ruaj kujtimet më të mira dhe përsht'ypjet më të thella për këtë Konsultë që la mbresa në të gjithë ne, anëtarët e Partisë së re, që morëm pjesë në të. Ishte e para herë që bëmë një mbledhje të tillë të gjerë, ishte e para herë që ngrihej zëri i komunistëve në unitet, të grumbulluar në Partinë e tyre të dashur. Dhe çfarë zëri u ngrit! Nuk ishte dëgjuar ndonjëherë një zë i tillë. Shokët ishin të rinj nga mosha, por si, kur kishin vite e vite me radhë stazh luftime revolucionare. Diskutimet ishin të zjarra, diskutime reale, luftarake, konkrete, analizohej puna me seriozitet të madh, pa zbulime, u bihej kokës gabimeve dhe njerëzve që nuk ecnin në rrugën e Partisë.

Më kujtohet diskutimi i zjarrtë i Hysni Kapos, goditja e rreptë e pamëshirshme e tij kundër punës antiparti e intrigave të fraksionistëve, A. Lulës e S. Premtes me shokë.

- Ne do Vi dërrmojmë ata që nuk ecin në rrugën e Partisë, - tha Ilysniu me atë vendosmëri shembullore, që do të shquhej në luftërat me armë dhe në ato për mbrojtjen e Partisë e të vijës së saj. - As trockistët dhe asnjë armik tjetër nuk do të lëmë të cenojë radhët tona. Vlorë, - tha Hysni Kapoja, - nuk është vetëm qyteti, por edhe fshati, është edhe fshati trim e heroik i luftërave të paharrueshme. Ne fshatin e kemi me Luftën Nacionalçlirimtare, fshati i Vlorës është dhe do të jetë me Partinë. Qysh në janar të këtij viti, - raportoi më tej Hysni, - në zonën e Mesaplikut ne kemi krijuar njësitin e parë partizan, i cili përbën bërthamën e çetës së ardhshme partizane në zonën e Vlorës.

Diskutimi i pjekur dhe i vendosur i Hysniut, që ishte një konkretizim i frymës luftarake të Konsultës, bëri përshtypje të madhe te të gjithë ne.

Edhe diskutimi i Qemalit, po ashtu, ishte një zbrërthim i gjallë dhe entuziazmues për punën e rinisë. Nakoja me shembuj konkretë e të mprehtë foli kundër atyre shokëve që tundnin derën, që bënin sikur punonin. Ai goditi elementët e sëmurë në radhët e Partisë, të cilët i sillnin dëm punës nëpër celula.

Nexhmija na bëri një pasqyrë të gjerë të entuziazmit të të rejave të qytetit, të nxënë seve dhe të vajzave shtëpiake. Ajo e siguroi Konsultën se gratë dhe vajzat kishin një brumë të mrekullueshëm revolucionar dhe një terren të madh pune, por kërkoi edhe ndihmën e shokëve në këtë drejtim, se «ka nga ata, tha ajo, - që jo vetëm nuk ndihmojnë, por edhe pengojnë».

Në Konsultë diskutuan shokë që punonin në krahina të ndryshme të vendit. Ata vunë gishtin në të metat dhe ngritën probleme të rëndësishme për punën në të ardhmen. Një qëndrim të fortë autokritik, për shembull, mbajtën shokët e Shkodrës, të cilët pranuan se nuk kishin arritur ta gjallëronin shumë organizatën e Partisë në qark, nuk kishin mundur të aktivizonin në shkallën e duhur masat në aksione. «Sigurisht, thanë ata, - në Shkodër reaksioni është i madh dhe kisha zhvillon punë minuese, por edhe puna jonë nuk ka qenë në lartësinë e duhur».

Autokritika e shokëve shkodranë që bolshevikë, sepse, pas kësaj mbledhjeje, puna në Shkodër mori një hov të madh dhe heroizmat e komunistëve atje i dëgjoi gjithë Shqipëria.

Kështu ishin të gjitha diskutimet e shokëve të tjerë. Konsulta ishte një shkollë e madhe për Partinë që do të na ndihmonte të korrnim fitore dhe t'i jepnim një hov të madh punës revolucionare të Partisë.

Kujtimet e atyre tri ditëve të shënuara më kanë mbetur të pashlyera nga mendja. Dhe, të mendosh se rrethidheshin, diskutonin e vendosnin për të ardhmen kuadrot më kryesorë të Partisë, brenda në Tiranë, nën terrorin e egër të forcave të okupacionit dhe të spiurëve e të vrasësve të Mustafa Krujës! Këta përgjonin që me çdo kusht të zbulonin dhe të goditnin për vde kje udhëheqjen e Partisë, t'i këputnin kësaj kokën dhe ta likuidonin. Ne i kishim parasysh të gjitha këto, prandaj tregoj një vigjilencë e lartë nga ana jonë, një konspiracion i madh, një disiplinë e rregull të fortë dhe të çeliktë. Shtëpia ku bëhej mbledhja, natyrisht, ruhej nga shokët, nga afër dhe nga larg. Ne kishim një qendër ku shokët duhej të venin sa më shpejt e të njoftonin «dëgjova kështu e kështu», për çdo informatë që të merrnin, qoftë edhe larg e larg, por sadopak e dyshimtë. Shoku i kësaj qendre na i transmetonte këto dhe ne i analizonim sipas rëndësisë e rrezikshmërisë së tyre.

Hanim e flinim brenda shtëpisë ku punonim. Fliflim përdhe apo mbi frona, dulce mbështetur kokën në supet e shokëve e ku të mundnim, kështu që dilnim jashtë vetëm kur mbaronte mbledhja.

Me këtë rast po shënoj disa vërejtje që tram për disa kujtime, që shkruajnë shokët, por që nuk janë të sakta. Për shembull, nuk është e saktë ajo që tra shkruar një shok lidhur me mbledhjen e kësaj Konsulte, sikur tremi pezulluar mbledhjen dhe tremi dalë në sheshin para Bashkisë, ku një hierark fashist mbante fjalim dhe se këtë e paskemi bërë gjoja për ta kthyer mitingun kundër tij. Një veprim i tillë u bë me porosi të Partisë, por nuk është e vërtetë që dolëm ne. Shumica nga ne ishim ilegalë, prandaj këtë nuk mund ta bënim dhe nuk e bëmë, sepse ishim mbledhur për një punë shumë të rëndësishme që nuk duhej të na dështonte në asnjë mënyrë.

Na del më pas një i dytë e na shkruan për gjëra jo të sakta dhe ky, që ta bëjë «të lezetshme» ngjarjen, trillon e shkruan në kujtimet e tij sikur «Qemal Stafa doli e mori pjesë në këtë miting i veshur si milic fashist që të maskohej». Të tilla shkrime nuk duhet të botohen dhe gabohen ata që mendojnë se me gjëra të paqena gjoja ngrenë prestigjin e udhëheqjes së Partisë. Udhëheqja e Partisë dhe vetë Partia gjithmonë kanë qenë për luftën, aksionet, veprimet konkrete e të pandërprera, por kurrë s'kanë qenë për aventurizma, për veprime të pamenduara e të pallogaritura mirë.

Në vazhdim të këtyre vërejtjeve, pavarësisht se dal ca nga tema, dëshiroj të vë në dukje se tram lexuar mjaft kujtime të shokëve e të njerëzve të luftës, shumica e të cilave janë objektive dhe reale, por tra edhe nga ato subjektive, me fakte të trilluara ose të fryra e plot fraza mburrëse. Në shkrimet e disa autorëve nuk tra veç «vetëtima, heroizma, bomba, krisma». Disa nga këta e bëjnë këtë pa vetëdije, për të mirë, por shumë e bëjnë dhe për të treguar veten si «trima të paepur». Në këto shkrime nuk tra realitet historik, pse lufta tra pasur edhe heroizma, tra pasur edhe fitore, por tra pasur edhe dështime, edhe kemi vrarë, edhe na kanë vrarë.

Të tillë njerëz që i sajojnë këto gjëra jo vetëm falsifikojnë historinë, por e edukojnë keq brezin e ri, pse, dulce shkruar në këtë mënyrë, të rinjtë kujtojnë se lufta tra qenë shesh me lule, tra qenë një ndërmarrje e thjeshtë, me veprime që konceptoheshin dhe fitoheshin me një të hapur dhe të mbyllur të syve. Jo, lufta që bëri Partia dhe populli ishte shumë e vështirë. Askush të mos kujtojë se këto fitore u arritën me lehtësi. Përkundrazi, ato u arritën me vuajtje, me pjekuri, me sakrifica përpara plumbave, dredhive dhe politikës djallëzore të armikut.

Armiku okupator dhe tradhtarët nuk ishin aq frikacakë dhe aq budallenj, siç po i përshkruajnë disc, që mendojnë se kështu ngrenë zotësinë e trimërinë e Partisë dhe të tyre. Partia dhe populli ynë, natyrisht, ishin më të zotë dhe më trima se armiqtë, se lufta jonë ishte e drejtë, bëhej për një kauzë të madhe, kurse ajo e armiqtë jo, por nuk u duhet besuar disave që shkruajnë ose tregojnë se të gjithë ballistët ishin si lepuj. Jo! Realiteti nuk ishte kështu. Edhe ata ishin bij të kësaj toke, e pra, shumë prej tyre ishin trima. por ama ishin bij bastardë, të shitur, tradhtarë. Ata dhe sidomos krerët e tyre, luftonin që ç'ke me të, se në balancë ishte jeta ose vdekja e tyre. Ata do të thyheshin, siç u th'yen, pse ne ishim më të fortë, se politika jonë ishte e drejtë dhe populli ishte me ne, kurse ata ishin tradhtarë.

Dua të them, me këto radhë, se kurdoherë duhet shkruar realiteti, ndryshe brezat që vijnë pas nesh nuk mund të përcaktojnë mirë peshën e rëndë dhe sakrificat që bënë populli dhe Partia për të krijuar këtë realitet që ekziston sot, socializmin. Ky u arrit me luftëra, me gjak, me sakrificat dhe jo me dandanara. Socializmi duhet mbrojtur, por në rast se brezit që vjen pas nuk i tregohet e vërteta si u arritën këto ditë të lumtura, atëherë ai nuk do të dijë ta mbrojë atë mirë, pse kujton që armiku jo vetëm u thye me pak vështirësi, por aktualisht, kur kemi fituar kaq gjëra, mund të mendohet se armiku është i likuiduar përgjithmonë, prandaj... gjumë mbi dafina!

Gazetat tona ndonjëherë lejojnë që disa njerëz pa vlerë, që jo vetëm s'dinë të shkruajnë, por as nuk kanë pasur ndonjë aktivitet revolucionar, të botojnë disa shkrime krejt false dhe poshtë emrit të tyre vënë fjalën «veteran». Lexoja një ditë një shkrim të njërit nga këta pseudoveteranë për Ali Kelmendin. «Ta shkruaj, ka thënë ai me vete, se të paktë janë ata që e kanë njohur Aliun, të tregoj se e kam pjekur në Vjenë, kur punonte me Dimitrovin dhe vinte në kafe na edukonte», e të tjera përralla të tilla. Po trillami duket se, në mes të tjerash, ai thotë që «Aliu ishte një burrë i gjatë si malësorët, me shpatulla të gjera» etj. Krejt në të kundërtën e këtij përshkrimi ka qenë Aliu. Ai ishte një mesoburrë, abile, mund të them, ju i gjatë, me shpatulla aspak të gjera, përkundrazi, me një trup që po ia brente tuberkulozi. Nga trupi ishte njeri i zakonshëm, por ishte me shpirt të madh revolucionar.

Po pse i bëjnë të tillë njerëz këto gjëra? Kuptohet, për të ngritur veten, për të thënë: «Unë? Ohu, jam që në kohën e Ali Kelmendit!», kurse në realitet nuk ka qenë asgjëkundi, si para dhe pas Çlirimit, tundte derën dhe s'ia pa kurrë hairin Partia. Dhe tash rri e nxjerr simite, ia dërgon edhe gazetës, ecila ia boton si pa të keq, bile edhe me titullin e nderuar të veteranit.

Le të lexojnë me kujdes njerëzit dokumentet eshkrimet e Partisë dhe le të nxjerrin mësim sa me objektivitet trajtohen problemet, situatat, gjendja. Po, të mos bëhej një kritikë e rreptë për punën tonë në Konsultë dhe në mbledhjet e tjera të Partisë, nuk dihej fati i luftës, por pikërisht pse analizat u bënë drejt, edhe lufta shkoi drejt, prandaj u arrit fitorja.. Kjo rrugë e drejtë për asnjë moment nuk duhet braktisur, përkundrazi duhet të merret si shembull: i shkëlqyer dhe të thellohet, të pasurohet më tej nga. eksperiencia pozitive dhe negative.

Por le të kthehemi në temë, te mbledhja e Konsultës. Një pasdreke, në të ngrysur, shokët jashtë na laj mëruan se policia bastisi «Shtëpinë e bretkosave» (ishte një shtëpi në breg të Lanës, tek ura e vjetër me gurë, që të nxirrte te selia e Luogotenencës), dhe arresto shokun që banonte aty, i cili hynte e dilte te shtëpia e Bijes dhe e dinte që ajo ishte bazë ilegale. Po ashtu na lajmëruan se armiqtë ishin shumë të shqetësuar dhe të egërsuar nga dështimi i mitingut që hierarkët fashistë kishin organizuar në sheshin para Bashkisë për të festuar të ashtuquajturin «për vjetor i tretë i dorëzimit të kurorës së Skënderbeut mbretit të Italisë», dhe se rreth shtëpisë ku punonim ishin parë të lëviznin disa njerëz të dyshimtë. Duhej të shpërndahehim, prandaj pezulluam seancën. Të gjithë

shokët pjesëmarrës në Konsultë, që vinin nga xrethet apo që ndodheshin në ilegalitet, e kishin të caktuar bazën ku do të venin në rast alarmi ose rrethimi, i cili, po të ndodhte, do të çahet vetëm me luftë. Kur bënim mbledhje të tilla, ne merrnim masa të forta që më parë, jo vetëm masa sigurimi, por edhe për ushqime, që, në rast kontrolli, të mos diktohej asnjë gjurmë. Bukën që kishim, shokët e ndanë që ta merrnin nga një copë me vete kur të iknin, ç'kishte mbetur gjellë e hëngrëm në këmbë; u hoqën tavolinat e stolat, disa të improvizuara me dërrasa, u shpërndanë nëpër shtëpi, kurse ushqimet e chata u ruajtën, se mund të justifikoheshin si zahire. Pastaj shokët ngjeshën koburet dhe dolën njëri pas tjetrit.

Unë mbeta në fund, se prisja të errej edhe pak. Kishte mbetur edhe Nexhmija, e cila ishte përveshur e bashkë me Bijen, pastronin e rregullonin dhomën.

Nexhmija po lante me forcë dyshemenë që ishte bërë pis nga këpucët.

- Ditke të bësh dhe punë shtëpie, - i thashë,

- s'të paska përkëdhelur nëna.

- Jam dibrane, - m'u përgjigj pa ngritur kokën.

- E shoh, - i thashë, - por edhe ne gjirokastritët nuk mbetemi prapa për pastërti. Kur të vish ndonjëherë në shtëpinë time, - ia hodha me romuz, mund ta shohësh vetë.

Qeshi.

- Mirë, mirë, - tha, - po merre këtë qilim e shkunde pak në oborr, të shohim si i ndihmon gratë. Qilimin e shkunda. Dhoma e punës u shtrua me qilim e mindere, si një dhomë e zakonshme populli për pritje mysafirësh. Enët u lanë e u shpërndanë nëpër rafte e haure, që të mos binin në sy.

- Po tanfi, ku do të shkosh ti? - e pyeta Nexhmijen.

- Nuk e di, - më tha, - qëkur ika nga shtëpia, erdha drejt e këtu. Akoma nuk kam menduar për bazat se ku do të strehohem.

Nexhmija kishte rënë në sy në demonstratën e 7 prillit, kur, bashkë me një shoqe, i dolën përpara një milici shqiptar që kishte drejtuar pushkën kundër demonstruesve: «Bjer, i shitur, - i thanë ato, - kundër kujt shtie o tradhtar i mjerë, kundër vëllezërve e motrave të tua?». Milici ngriu me pushkën në dorë. Të nesërmen në shtëpi erdhën për ta arrestuar, por ajo shpëtoi, duke u larguar nëpërmjet oborreve të komshinjve.

- Mund të vete në bazën tonë, te Rruga e Shën gjergjit, te 66-a, - tha Nexhmija.

- Në asnjë mënyrë, - i thashë, - atje është larg, hajde me mua!

Nexhmija vuri koburen në çantë, unë timen në brez, dy bomba në xhepa dhe mora biçikletën time. Ishte një biçikletë «Bianchi», bojë bari, që e kisha qëkur isha legal. I thashë Nexhmijes:

- Hip përpara.

Ajo m'2 shikoi me habi dhe tha:

- Si do të më mbash mua, si mund të qëndroj, s'kam hipur ndonjëherë.

- Hip, - i thashë, - e mos bëj fjalë, se jem në vonë (po afrohej ndalim qarkullimi, Coprifuoco-ja). - Mbaje çantën gjysmë të hapur. Po na ndaluan patrullat qëllon, unë do të çaj përpara dhe do të hedh bombat.

- Dakord, - tha Nexhmija dhe rrëshqitëm sëra në bulevard, nga Rruga e Fortuzit, e pastaj poshtë Rrugës së Durrësit.

U futëm pa asnjë incident në bazë. Ishte një shtëpi e vogël përdhese, pranë ndërmarrjes «Bellotti», prapa Centralit Elektrik të Tiranës. Atë e kishte marra me q:ra një miku im i pakomprometuar në sy të armikut dhe una e kisha si bazë për situatën të vështirë. Kjo njëhej vetëm nga shoku Gogo dhe, tanfi që e solla këtu, edhe nga Nexhmija.

Aty banonin dy motra, njëra nga të cilat ishte e fejuara e mikut tim. Nexhmija u miqësua shpejt me to. Ato e bombarduan me lloj-lloj pyetje par luftën antifashiste e par rolin e gruas, pastaj biseda kaloi tek origjina e njeriut dhe e familjes. U çudita me njohuritë që kishte Nexhmija par veprën e Engelsit dhe par teorinë e Darvinit mbi speciet dhe luftën par ekzistencë. Më tha që këto vepra i kishin studiuar në rrethin edukativ të grupit komunist.

Të nesërmen në mëngjes u nisëm veç e veç për te shtëpia e Misto Mames, një dhomë përdhese tiranase që ishte në ekstremin tjetër të Tiranës, në një shesh, poshtë Rrugës Bardhyl, atje tek kalon sot unaza që të shpie në kompleksin e spitaleve. Porsa isha futur në shtëpinë e Mistos, erdhi një nga shokët që kishim vënë si rojë dhe na tha se hyrja e shokëve ka rënë në sy të fqinjve, që kishin filluar të tregonin shenja kurioziteti. Sigurisht, kishin të drejtë. Mistoja ishte punëtor dhe shtëpia e tij ishte e varfër, prandaj u binte në sy ç'donin gjithë ata njerëz, shumë nga të cilët nuk ishin veshur keq, dukeshin edhe si zotërinj, ca me borsalina, ca me gjyzlykë të zez, që i mbanin për t'i shpëtuar njohjes nga ana e spiunëve fashistë. Pale kur panë që aty hyri edhe një «zonjushë» me kapele e gjyzlykë të zeza!

Kështu shtëpia e Mistos u «dogj». Po ku të shkonim? Në prill të 1942-së nuk ishte akoma aq lehtë të kishim bazat tona që të ishin të sigurta dhe të mund të bënim mbledhje pak a shumë të gjera e kaq të rëndësishme. I them shokut të informohet se ç'u bë me të arrestuarin në «Shtëpinë e bretkosave» dhe a ka pasur lëvizje të dyshimta rreth shtëpisë së Bijes Vokshit. Atij i dhashë drejtimin se ku mund të më gjenin dhe u ndamë. Pas disa orësh më erdhi Mistoja e më tha se në «Shtëpinë e bretkosave» nuk ishte gjetur asgjë e dyshimtë. I arrestuari, pasi ishte pye tur, ishte lëshuar. As rreth shtëpisë së Bijes nuk ishte para ndonjë lëvizje e dyshimtë.

- Atëherë, - i thashë, - të rikthehemi te shtëpia e Bijes dhe të vazhdojmë mbledhjen.

E porosita të lajmëroheshin shokët me kujdes dhe, me nga një çerek ore interval, të futeshin nga të dyja hyrjet dhe të organizoheshin roja të forta gjatë bulevardit, sidomos në fund të tij dhe në rrugët e në rrugicat rreth e rrotull shtëpisë.

Dhe kështu u bë. Vazhdoi e mbaroi kështu mbi sukses e pa asnjë incident tjetër kjo mbledhje historike e Partisë, që shërbeu shumë për forcimin dhe për kalitjen e saj.

KONFERENCA E JASHTËZAKONSHME E PKSH (28-29 qershor 1942)

Konferenca e Jashtëzakonshme e Partisë mori në shqyrtim punën për asgjësimin e rrymës fraksioniste likuidatore dhe për vendosien e unitetit në Parti.

Periodha që ndan Konsultën e Parë të Aktivit të Partisë nga Konferenca e saj e Jashtëzakonshme është mbushur me ngjarje që janë ngulitur thellë në kujtesën time. Të gjithë ne, komunistët, ishim hedhurnë luftë për të vënë në jetë detyrat që na ngarkonte Partia dhe koha. Armiku po e ndiente nga dita në ditë forcën e Partisë së re, të porsaformuar, prandaj ishte, hedhur në një sulm të egër, për ta zhdukur dhe për ta mbytur. Për këtë qëllim ai po përdorte si dhunën fashiste, ashtu edhe agjentët e tij, që vërtiteshin rrugëve për të zbuluar bazat ilegale dhe komunistët.

Pikërisht në momentet kur ne qemë hedhur me të gjitha forcat në punë e në aksion për vënien në jetë të detyrave që na kishte ngarkuar Partia dhe Konsulta e Parë e Aktivit të saj u ndodhëm përballë një situatë shumë të rëndë: agjenti provokator Ludovik Nikaj, i cili kishte mundur të penetronte në radhët e Partisë, i kishte dhënë kuesturës fashiste informata të hollësishme e tepër të rëndësishme për disa nga bazat më kryesore të Partisë sonë në Tiranë. Këtë njeri të urryer as e kisha parë e as ia kisha dëgjuar kurrë emrin me parë; në strukturat organizative të Partisë ai nuk kishte asnjëfarë funksioni. Punën e tij armiqësore ai e bëri mbi baza njohjesh personale. Duke përfitur nga lidhjet familiare si dhe nga qëndrimet e pakujdesshme e toleranca e pafalshme e disa shokëve, kishte arritur të futej «si i shtëpisë» në disa nga bazat kryesore ku ndodhej teknika e Partisë, ku punonin ose strehoheshin shokë të Komitetit Qendror të Përkohshëm e të Qarkorit të Tiranës etj. Të gjitha informatat që mblodhi ai ia dha kuesturës dhe terrori e bastisjet shpërthyen si

kurrë ndonjëherë. Ndër të parët që u kap ishte Zef Ndoja. Ky, që me presionet e para të fashistëve, kapitulloi, dhe, ashtu si Zef Mala e Niko Xoxi më 1939, u kthye «né një thes me miell» që, sa herë i binin fashistët me shkop, diçka të re do të zbrazte. Për fat të keq dinte shumë dhe ia lëshoi të gjitha armikut.

Né bazë të të dhënave q-ë mori, vetëm pak ditë pas mbarimit të Konsultës së Parë të Aktivit të Partisë, armiku mundi të arrestonte në Tiranë e né rrethe të tjera një numër komunistësh, ndër të cilët edhe disa kuadro të qarkorëve. Bazat ku ruanim teknikën u bastisën dhe, fashistët arritën të shtinin né dorë përveç mjeteve tona të shtypit ilegal, edhe dokumente të një rëndësie të dorës së parë, ndër të cilat edhe procesverbalin e mbajtur gjatë ditëve dhe netëve historike të nëntorit. Kur u mblodhëm e themeluam Partinë.

Armiku kështu kishte né duar krejt listën e anëtarëve të Komitetit Qendror Provizor. Si dhe einRW e dhjetëra shokëve të tjerë që i gjeti né dokumentet që kapi. Të s'numëfishuara këto lista qarkullonin me shpejtësi né çdo kuesturë e postë karabinierie; ato i mbanin me vete spiunë e agjentë të tjerë të armikut. Urdhri që i prerë e urgjent: të arrestoheshin, kudo që të që e mundur, personat e shënuar né lista. Nëse kundërshtonin, të vriteshin né vend. Né qelitë e kuesturës e të burgjeve fashistët po përdornin torturat mesjetare për të thyer shokët e arrestuar që nuk jepeshin. Por edhe né qelitë e errëta shokët tanë po u tregonin armiqve se kush ishin komunistët, kush ishin ata që kishin marrë përsipër misionin e lartë të çlirimit të atdheut.

Né valën e këtij terrori të jashtëzakonshëm, fashistët vranë një nga bijtë më të mirë të popullit dhe një nga anëtarët më të devotshëm të Partisë, Qemal Stafën.

Pak para kësaj ngjarjeje, aty nga mesi i prillit 1942, armiqtë kishin mundur të arrestonin né Fier shokët tanë të paharruar, punëtorët komunistë, Hamdi Mëzezin, Ferid Xhajnun e Nikolla Tupen, kur po përcillnin né shok të Qarkorit të Vlorës, Rrumbullakun* *(pseudonimi i Sinan Gjonit), i cili. së bashku me shokun Hysni Kapo, kishte marrë pjesë né Konsultën e Parë të Aktivit të PKSH. Hysniu nuk u nis né të njëjtën kohë për në Vlorë sepse e mbajtëm në Tiranë pak ditë për punë. Rrumbullaku, pas arrestimit, u internua në Itali, kurse Hamdiu, Feridi e Nikolla u sollën në Tiranë dhe aty, pas tor turash çnjerëzore, u varën. Ndërkaq në Shkodër, në qershor, Perlat Rexhepi, Jordan Misja, Branko Kadiza e kthyen shtëpinë ku u rrethuan në një kala heronjsh legjendarë. Dhimbja jonë për shokët e rënë ishte e madhe, ashtu siç ishte e madhe edhe urrejtja për armikun dhe agjentët e tij.

Çastet qenë jashtëzakonisht kritike, çdo luhatje a shenjë paniku do të kishte pasoja katastrofike për të ardhmen. Duhej jo vetëm të përballohej menjëherë vala e terrorit dhe e arrestimeve, por edhe i duhej treguar armikut se ne qemë gjallë e të fortë, të organizuar e më të vendosur për ta çuar veprën e nisur gjer në fund. Kurrë' nuk do t'i harroj ato ditë e net të tensionuara, të mbushura plot punë, aksione e veprime të shpejta e decizive. Sapo morëm vesh se qemë tradhtuar, mblozha ata shokë të Komitetit Qendror të Përkohshëm e të Qarkorit të Partisë për Tiranën, që ndodheshin në qytet dhe, si masë të parë e urgjente, ndryshuam gjithë planin e bazave, të takimeve, të itinerareve që ndiqnim, të parullave që përdornim, të pseudonimeve etj. Sinjalizuam një nga një shokët që të ishin vigjilentë e tepër konspirativë, të ruheshin, por kurrësi të mos tërhiqeshin apo të largoheshin nga zjarri i luftës. Tërheqja do të ishte kapitullim.

Gjendja filloi të stabilizohej. Me përjashtim të atyre që kapi vala e parë e bastisjeve, shokët e tjerë vazhduan me devotshmëri luftën dhe punën. Armiqve u mbetën në duar vetëm listat me emrat tanë dhe urdhrat për arrestim ose vrasje në vend. Mirë, le t'i mbanin. Na kërkonin kudo e çdo cast, por më në fund, pas muajsh kërkimesh e përpjekjesh të dëshpëruara, u detyruan të na dënonin në mungesë. Shumicën prej resh e dënuan me vdekje ose me burgim të përjetshëm.

Por, kuptohet, ato qenë dënime që u realizuan vetëm në letër e u zverdhën dosjeve të arkivave. Rruga jonë ishte tjetër, vendimi ynë ishte tjetër: vdekje pushtuesve e tradhtarëve. Veç këtë vendim solemn ne s'e lamë në letër, por e realizuam në qytetet e në malet tona.

Qy sh në ditët e para të majit, kur armiku jetonte euforinë e «fitores» mbi komunistët, Partia i dha atij grushte trullësese. Me orientime të posaçme shokët tanë organizuan nëpër shkolla, qendra prodhimi e lagje popullore mitingje përkujtimore për Qemal Stafën e shokët e tjerë të rënë.

Bëheshin këto në mes të ditës, nën hundën e pushtuesve, me zë të lartë. Këngët aq të njohura për Qemal Stafën dhe për tre heronjtë e Shkodrës, zanafillën e kanë në ato ditë të paharruara.

Me trakte e me komunikata ne ngrinin lart veprën dhe shembullin heroik të shokëve të rënë, i bënim thirrje popullit ta mbante lart moralin e të intensifikonte luftën, u thoshim armiqve e tradhtarëve se për ta hakmarrja jonë s'do të njihete kufi.

Pikërisht në këtë periudhë, kur Partia ishte mobilizuar për vënien në jetë të programit të saj e për të përballuar gjendjen e rëndë të krijuar, e shtuan akoma më tepër veprimtarinë e tyre përçarëse e sabotuese edhe elementët armiq brenda Partisë, fraksionistët Anastas Lula e Sadik Premte. Këta vazhdonin të sabotonin me çdo mënyrë veprimtarinë e Komitetit Qendror, të komiteteve qarkore dhe të celulave.

Ndonëse i kishim kritikuar e i kishim demaskuar prej kohësh, duke fi'lluar që nga Mbledhja Themeluese, ata prapëseprapë vazhdonin të tyren. Jo vetëm e shprehnin hapur pakënaqësinë që s'kishin zënë vende «të merituar» në udhëheqje, por po shtonin përpjekjet për t'u organizuar si një grup më vete brenda Partisë. Përveç disa lidhjeve të vjetra që, në kundërshtim me vendimin e Mbledhjes Themeluese, nuk i kishin dorëzuar akoma në Parti, ata nisën të grumbullonin rreth vetes një numër elementësh të paformuar, me tendenca anarkiste e trockiste dhe i përpunonin e i yshtnin drejt një pune përçarëse. Duke përfutur nga vala e terrorit që shpërtheu armiku në fillim të majit, ata arritën gjer atje sa të akuzonin Partinë si përgjegjëse për gjendjen e krijuar dhe që këtej dilnin me idenë për një organizim të ri, i cili, natyrisht, në krye do të kishte ata, Xhepin e Qorrin. Gjithë fëlliqësitë e vjetra të kohës në grupe, si vjedhjet, imoralitetin, anarkizmin, konspiracionin e kalbur etj., ata përpiqeshin t'i injektonin e t'i zhvillonin edhe në trupin e shëndoshë të Partisë. Kundërshtonin direktivat dhe udhëzimet e udhëheqjes, bile arrinin të hidhnin edhe trakte të ulëta ku propagandonin vijën e vjetër të grupit.

Puna e tyre tradhtarë kishte arritur gjer në disa celula të veçanta partie, bile Xhepi e Qorri, kishin filluar të formonin edhe celula të tyre, me elementët e vet fraksionistë. Kësaj shtate i duhej dhënë një goditje e fortë dhe e menjëhershme, sepse, po të li hej të penetronte më tepër helmi, ai do të na shkatërronte krejt trupin e Partisë sonë të re. Kjo do të ishte tragjike për fatet e popullit tonë. Dobësimi e ca më tepër shkatërrimi i Partisë, do të çonte doemos në dobësimin e në shkatërrimin e luftës që udhëhiqte ajo kundër pushtuesve e tradhtarëve.

Këtë s'do ta lejonim kurrë. Partia jo-në Komuniste, megjithëse e re, po i analizonte ngjarjet dhe rrethanat me pjekuri, duke nxjerrë mësim dhe detyra për të ardhmen. Në luftën e tyre të ethshme për shkatërrimin e unitetit brenda Partisë, Anastas Lula e Sadik Premtja niseshin nga deviza se një parti pa unitet është e destinuar të asgjësohet. Por edhe ne e dinim këtë synim të tyre, prandaj nuk do të lejonim kurrë që qëllimi i tyre të arrihej.

Kishte ardhur koha që fraksionistëve dhe agjentëve të fashizmit që kishin mundur të depërtonin edhe brenda Partisë, t'u jepej dënimi i merituar. Isha i bindur se Anastas Lula dhe Sadik Premtja duhej të merrnin dënimin e merituar, por këtë dënim mund t'ua jepte vetëm Partia. Dhimbja e thellë për shokët e rënë më kthehej në urrejtje për këta të dy, por unë isha i detyruar të takohesha me Anastas Lulën dhe Sadik Premten.

Nuk do të zgjatëm shumë për Anastas Lulën dhe Sadik Premten, pse task njihen mirë nga Partia dhe nga populli. Ata ishin njerëz shumë të këqij, dinakë e armiq të rrezikshëm. Si Anastasi dhe Sadiku vazhdonin të ishin në Parti, por njëkohësisht bënin edhe punën e grupit, duke sabotuar konsolidimin e punës organizative të Partisë. Ata nuk kishin besim në luftën popullore çlirimtare, ata kundërshtonin dhe pengonin futjen e direktivave të Partisë në fshat. Ata hiqeshin si përfaqësues «të merituar» të proletarietit. Bile për t'u dukur sa më proletar, trockisti Anastas Lula, që ishte nga një fshat i Kolonjës dhe që, mbasi kishte zbritur në Korçë, ishte hedhur në Tiranë, mbante një kasketë të nxirë e të zhubrosur. Më kujtohet që një ditë, në një takim, një komunist, një punëtor i thjeshtë, më pyeti i habitur:

- Përse e mban atë kasketë të ndotur në kokë, ky Anastasi?

Unë vura buzën në gaz dhe i thashë me shaka:

- Që të duket sa më proletar.

Shoku nuk e kapi mirë shakanë time dhe më tha:

- Mund të mbash një kasketë edhe më të nxirë se kjo e Anastasit dhe të mos jesh proletar.

Vetëm kasketa nuk të bën dot proletar.

M'u bë qejfi nga pjekuria e shokut tira punëtor, prandaj i thashë po me tonin shakatar që kisha nisur bisedën:

- Anastasit, po t'i heqësh kasketën nga koka, nuk i mbetet asgjë prej proletari.

Edhe leitënanti i tij, Sadik Premtja në çdo gjë ishte njëlloj me Anastasin, ngjanin me njëri-tjetrin jo vetëm nga idetë trockiste, jo vetëm nga shpirti i lig e intrigant, por deri edhe nga shtati e fytyrat e tyre të thara e të nxira. Anastasi ishte një katran nga fytyra, me koqka të zeza, sikur lëkurën t'ia kishte përcëlluar baruti. Ai ishte miop e mbante syze, prandaj pseudonimin e kishte «Qorri». Por mbante një palë syze speciale, të vogla e të rrumbullakta, me një skelet të zi, që i jepnin fytyrës pamjen e një gjarpri, prandaj, pas formimit të Partisë, prej intrigave që nuk i la kurrë, ne i vumë edhe një nofkë tjetër më të përshtatshme, «gjarpri me syze». Anastas Lula gjarprit me syze nuk i ngjiste vetëm nga pamja e jashtme, por edhe nga sjelljet, edhe nga mënyra e fëlliqur e veprimtarisë së tij. Kisha lexuar diku, ndofta në ndonjë enciklopedi apo në ndonjë tekst biologjie, që gjarpri me syze bëhet aktiv, kur bie muzgu. Edhe Anastas Lula ishte njeri i natës, njeri i pabesive dhe i intrigave, njeri i trukeve, ashtu si i përdorin gjarpërinjtë me syze fakirët e Indisë. Gjarpërinjtë me syze janë shumë helmues, helmi i tyre vepron drejtpërdrejt në gjak. Edhe Anastas Lula donte të helmonte gjakun e pastër të Partisë, por kjo nuk kishte për të ndodhur kurrë. Sadik Premtja kishte pseudonimin «Xhepi». Pse ia kishin vënë Xhepi, nuk e di, por ndoshta i kishte mbetur qëkur ata organizonin «kusëritë», sepse të dy këta kaporionë udhëhiqeshin nga teoria, sipas të cilës «revolucionarëve u lejohet të grabitin dyqanet e pasuritë e borgjezëve». Çdo gjë e këtij lloji ishte e lejueshme për ta, bile këto quheshin «veprime të vërteta revolucionare», por, kur vinte puna të luftohej pushtuesi, sipas tyre, duhej pritur më parë të formohej proletariati (!), e të tjera teori trockiste.

Prandaj ata ishin kundër Partisë dhe bënë çmos të konsolidonin lidhjet me shokët e vjetër të grupit. «Shokët» e tyre të vjetër të Grupit të «Të Rinjve» filluan një e nga një t'u iknin nga dora dhe u lidhën ngushtë me Partinë. Këta vinin e na tregonin çdo gjë dhe çdo propozim që u bënin Qorri me Xhepin. Ne vazhdonim me durim t'i thërritnim që të dy dhe t'u flisnim të hiqnin dorë nga rruga që vazhdonin të ndiqnin. Ata ishin djaj të zgjuar, dredhonin, premtinin, por vazhdonin veprimtarinë e tyre. Anastasi me Sadikun vërtiteshin nëpër Tiranë legalë, si dy qen gjahu dhe ku nuk futeshin, kë nuk takonin e kë nuk ngatërronin. Më në fund e mbushën kupën. Kjo veprimtari e këtyre dy armiqve duhej luftuar dhe duhej të merrte fund.

Një ditë, pak kohë pas Konsultës së Parë të Aktivit të PKSH, kapa Anastasin në një rrugicë, ku e kisha lajmëruar të vinte, dhe i thashë:

- Sonte duhet të bisedojmë.

- Atë dua edhe unë, - u përgjigj ai. - Po ku të takohemi?

- Ku të duash ti, - i thashë, për të mos zbuluar bazat tona.

- Në Rrugën Bardhyl, - më propozoi ai, - kur del nga Rruga e Bamit dhe shkon drejt spitalit, nga ana e djathtë, filan shtëpi përdhese.

- Dakord, - iu përgjigja, dhe u ndamë.

Në orën 21 iu afrova shtëpisë. çdo gjë aty ishte e qetë dhe e errët. Hyra nga një derë e hapur në kopsht dhe i rashë tri herë derës së shtëpisë, ashtu si ishte parulla. Dera u hap dhe hyra brenda në errësirë. U ndez shkrepja dhe një qiri që mbante në dorë një mesogrua me rroba të zeza. E përshëndeta, i dhashë dorën, e pyeta si ishte dhe nëse kishte ardhur Qorri apo jo.

- Jo, akoma, - tha ajo, - po hyni në dhomë, se edhe ai nuk do të vonojë.

Dhoma ishte e errët. Atë e ndriçonte vetëm zjarri, që zonja e shtëpisë kishte ndezur në oxhak. Ndonëse ishim në të hyrë të pranverës, nuk kishte kaluar akoma të ftohtit e dimrit. Penxheret ishin me taraba dhe mbi to nga një copë perde e zezë. Shoqja e la qiriun buzë gjirmës dhe më tha:

- Këtu, në kamare, keni edhe një duzinë qirinj. Besoj se mjaft i keni.

- Vare,t nga Qorri, - i thashë dhe pastaj, duke bërë shaka, shtova: - Ju siguroj se nuk do t'i hamë.

Shoqja vuri buzën në gaz dhe doli jashtë të përgjonte ardhjen e Anastasit, i cili nuk mungoi të vinte. Qorri hodhi kasketën mbi krevat, më përshëndeti dhe, duke fërkuar duart, iu afrua zjarrit që të ngrohej.

- Të kanë hipur dridhmat nga Partia, - i thashë, - po nxehu, se edhe kasketa që hodhe me inat mbi krevat, sig thotë populli, tregon se do të kemi luftë conte.

- Si ju, intelektualët, - tha me ironi, - u besoni gjepurave të popullit?!

- Populli nuk flet kurrë gjepura, - iu përgjigja Qorrit, - por ti mos mendo se do ta kalosh provën me llafe proletare false.

- Jam gati të luftoj, - tha Qorri.

- Atëherë, - i thashë, - ia fillojmë.

Dhe fillova i pari, sepse isha u-në ai që e kisha kërkuar takimin. Kështu ia nisa akuzat si breshëri, por të gjitha të faktuara. Kur e akuzova se ai nuk pranonte dhe nuk zbatonte direktivat e Komitetit Qendror Provizor, Qorri u hodh përpjetë dhe tha:

- Nuk është e vërtetë, dua fakte.

- Rri i qetë, Qorr, - ia preva, - se do të të jap fakte boll. Tashti e di që kemi shkrirë grupet, që Partia është e organizuar në celula, ka komitete dhe kemi caktuar normat e punës e të lidhjeve, mirëpo ti dhe Xhepi të gjitha këto i shkelni, mbani lidhjet e vjetra dhe propagandoni teori fashiste reaksionare!

Për cilëndo nga këto akuza i jepja fakte: «Je pjekur me atë, je pjekur me këtë, ke biseduar për këtë çështje, ke biseduar për atë çështje, ke folur kundër hedhjes së trakteve, kundër aksioneve» etj, etj. Dy orë a më shumë i foli Qorrit. Ai herë protestonte me pak fjalë, duke shtuar «do të të përgjigjem edhe unë, herë mbante ndonjë shënim, herë ngrinte kokën dhe syzet i feksnin në dritën e zjarrit.

- Mbarove? - më tha.

- Ç'të mbaroj, - iu përgjigja unë, - punët tuaja armiqësore s'kanë fund, por besoj se mjaft i ke për sonte. Mund të më përgjigjesh.

Filloi Anastasi, sic e kishte zakon, herë ngrinte zërin, herë e ulte. Dy orë e gjysmë griu, u përpoq të pranonte disa gjëra të vogla, kurse në të tjerat të dredhonte. «Argumentet» e tij ishin të tilla: «Nuk është ashtu, po kështu; s'di unë c'bën Xhepi, i kam prerë lidhjet me të (dhe për këtë gënjenje); pse na ndalon Partia të piqemi me shokë të vjetër?». Kështu jepte e merrte Qorri gjatë gjithë bisedës, duke mbajtur një qëndrim të egër armiqësor dhe, si më hidhte vështrimin e syve të tij të ftohtë, vazhdonte:

- S'kam të drejtë unë të shfaq një mendim, mundet në kundërshtim edhe me tuajin?

- Ke, - i thashë unë, - por eja diskutoje në Parti, në celulë, me shokët që u zgjodhën nga Mbledhja Themeluese e Partisë dhe jo vesh më vesh me shokët e ish-grupit. Ne, komunistët, kemi marrë përsipër një barrë të rëndë, luftën për clirimin e atdheut dhe të popullit nga zgjedha e huaj. Dhe këtë luftë ne do ta përballojmë me unitetin tonë.

Herë pas here ngrinin zërin dhe harronim se mund të dëgjoheshim jashtë. Dy herë e zonja e shtëpisë, duke trokitur te dera, na tërhoqi vëmendjen:

- Flisni me zë të ulët. se do t'ju dëgjojnë në rrugë.

Si e pashë se Qorri nuk donte t'i pranonte gabimet dhe se kishte kaluar shumë nata, ia preva:

- Mjaft, s'të dëgjoj më, ti gënjen dhe s'ke ndër mend të njohësh asnjë gabim. Unë do të fle, se kam gjumë.

Dhe, ashtu i veshur sic isha, u tendosa në njërin nga krevatet, duke i kthyer krahët Anastasit.

- Si, mo, do të flesh? - bërtiti ai.

- E pse të mos fle. - i thashë, - akoma të rri e të dëgjoj përrallat e tua?!

- Çfarë përrallash, - ma ktheu ai, - po si do të të zërë gjumi?

- Pse të mos më zërë? - iu përgjigja. - Ndërgjegjen unë e kam të qetë, prandaj gjumi do të më zërë që c'ke me të!

- Po s'të lë unë të flesh, - bërtiti Qorri, m'i lëshove gurët dhe m'i le në kurriz.

- Rri rehat Qorr, - i thashë. - Ne të dy këtu s'kemi c'bisedojmë më. Me mua, të dërguarin e Komitetit Qendror, ti nuk u more vesh, atëherë unë do të propozoj të bëjmë një mbledhje më të gjerë, ku të vish edhe ti, të vijë edhe Xhepi dhe ta sqarojmë mirë e përfundimisht këtë punë.

- Jam dakord, - tha Anastasi, - po kur dhe ku?

- Ti përgatitu, çështjet une ti shtrova, këto do të bëjnë objektin e mbledhjes, pa se ku dhe kur, do të të lajmërojmë.

Kështu Anastasin s'e zuri gjumi fare atë natë. Ai rrinte kruspull afër gjirmës. Unë fjeta nja dy orë. Ku. u zgjuam, gruaja e shtëpisë na bëri nga një kafe. Prita sa u gdhi mirë. pastaj i dhashë dorën Qorrit dhe u largova.

-Né korridor e zonja e shtëpisë, që s'e mësova kurrë cila ishte, më shtrëngoi fort dorën. Ajo duhej t'i kishte dëgjuar zënkat tona. Ashtu si gjithë gratë e tjera, që i kishin kthyer ose do t'i kthenin shtëpitë e tyre në baza ilegale, edhe ajo ishte një grua e luftës, grua e thjeshtë e besnike. Akoma edhe sot e kësaj dite asnjë plakë nuk më ka ardhur të më thotë: «Shoku Enver, unë kam qenë grua e asaj shtëpie që ju pritë atë natë, kur u grindët me Anastas Lulën».

Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar nga reaksioni fashist dhe nga fraksionistët né Parti, ne, né Komitetin Qendror, vendosëm të thirrej Konferenca e Jashtëzakonshme e Partisë, ku do të shqyrtonim edhe veprimtarinë fraksioniste të Anastas Lulës, Sadik Premtes e të pasuesve të tyre, me qëllim që të forconim Partinë dhe unitetin e saj, që të mund të përballonim edhe luftën e madhe të çlirimit nga pushtuesit fashistë. Ibledhja u vendos të bëhej në shtëpinë e Adivije Agollit. Lajmëruam djalin e saj, shokun tonë, Zeqi Agollin, që të merrte masa për ushqime etj., vumë shokë të vëzhgonin rrugët gjatë javës, caktuam të tjerë që do të mbronin shtëpinë gjatë gjithë kohës së mbledhjes. të cilë t u vendosën né rrugë dhe brenda në obcrr. Nëpër errësirën e nates. që né mbrëmjen e 27 qershorit, filluan të vijnë të gjithë shokë` që do tz merrnin pjesë né Konferencë.

Né Konferencë, e cila zgjati dy c;itë. morën pjesë anëtarë të Komitetit Qendror Provizor të Partisë, anëtarë të Komitetit Qarkor të Tiranës. 2-3 shokë kryesorë nga Komiteti Qendror i Rinisë dhe disa konrunistë të vjetër.

Nat'yrisht né këtë Konferencë ndodheshin edhe Anastas Lula me Sadik Premten, por këtë herë jo për të derdhur helmin përçarës, por për të dhënë llogari për tërë veprimtarinë e tyre armiqësore. Kishim ftuar, gjithashtu, edhe Mustafa Gjinishin, sepse e dinim që ai merrej vesh me Qorrin, por për të nuk kishim zbuluar akoma fakte. Do të shihnim ç'do të na nxirrte mbledhja.

Të nesërmen ne mengjes, né fillim të punimeve të Konferencës përkujtuam me respekt të thellë shoket tanë të paharruar: Qemal Stafën, Perlat Rexhepin. Jordan Misjen, Branko Kadinë. Hamdi Mëzezin, Ferid Xhajnun. Nikolla Tupen e Sotir Nokën, rënë heroikisht nëfushën e luftes kundër pushtuesve fashistë; nderuam qëndrimin e papërkulur të shokëve dhe të miqve që dergjeshin nëpër burgjet e né fushat e përqendrimit te fashistëve, dhe dënuam pa mëshirë spiunët, tradhtaret dhe veglat e verbra, që ishin vënë né shërbim të pushtuesve.

Né mbledhje raportova gjerë e gjatë mbi masat që ishin marrë për forcimin e Partisë sipas rekomandimeve edhe të Konsultës së Parë të Aktivit të Partisë. që u mbledh në prill të atij viti. Raportova edhe për veprimtarinë fraksioniste të disa anëtarëve të ish-Grupit të «Të Rinjve», duke akzuar veçanërisht Qorrin dhe Xhepin; raportova edhe për takimin me Anastas Lulën e disa takime të tjera, si me Sadik Premten e ndonjë tjetër. Pas një pushimi dhe disa diskutimeve, filloi mbrojtjen i pari Anastasi dhe pas tij Xhepi. Ata e panë që atmosfera ishte elektrizuar dhe të gjithë ishin kundër tyre. Të dy filluan të mbroheshin me «qetësi relative» në fillim, pastaj të kundërakuzonin, të mohonin, të gënjenin. Dukej qartë që po bënin përpjekje të mëdha për të mbuluar luftën e tyre antiparti. Ata kërkonin edhe kokën ta shpëtonin, edhe tezat e tyre trockiste t'i mbronin, edhe organizimin dhe vijën e Partisë t'i atakonin. Pasi e nxorën vlerin dhe gasi i kishim dëgjuar me neveri, bëme një pushim të dytë.

Mbledhjen e rifilluam me një revoltë të natyrshme kundër këtyre dy armiqve të Partisë. Filluan si predha pyetjet e shokëve. Pyetjet sillnin përgjigjet plot dredhi të Qorrit dhe të Xhepit. Përgjigjet ngjallnin pyetje dhe akuza të reja të faktuara. I bëme të djersitnin, por edhe ne djersitnim, por, ndërsa ata po futeshin çdo minutë në batak, Partia fitonte.

Ishin orët e vona të natës, kur ne bëmë prapë pushim. Nervat i kishim të tendosur e çelik. Nuk e ndienim lodhjen. U ulëm pajdash përdhe e filluam të pinim cigare. Anastasi u ul afër meje.

- Më jep një cigare, Taras, - më tha.

Ia dhashë dhe ia ndeza.

- Shumë rëndë po më akuzoni, Taras, - më tha.

- Partia është zemërgjerë, - i thashë, - ajo të fal në rast se njeh fajet dhe nuk vepron më kundër saj.

Në atë moment erdhi Mustafa Gjinishi me fytyrë të skuqur. Kishte veshur kilota me xhepa përpara dhe duart i mbante brenda në ta. Ai qëndroi në këmbë në mes meje dhe Anastasit. Mustafai iu drejtua Anastasit, që rrinte me kokën ulur, duke thithur cigaren:

- Pse na lodh kot, o Anastas, trego të vërtetën, bëj autokritikë, ti kot e ke, të gjitha këto që t'u thanë i ke bërë.

Unë prisja reagimin e Qorrit. Ai u vrenjt edhe më tepër në fytyrë, ngriti kokën e shikoi Mustafanë nga këmbët te koka e, duke ngritur dorën, i ra vitheve të tij dhe i tha:

- Dëgjo, Mustafë, ti nuk ia hedh dot Anastasit. Lëri të tjerët të flasin se s'të bie ty as të më pyesësh, as të më këshillosh se si të flas. Ti fol për veten tënde, për të gjitha çka po bën pas shpinës së Partisë, trego lidhjet e fshehta që mban. More vesh?

Unë i hodha sytë Mustafait dhe prisja ç'do të përgjigjej. Personalisht dija mjaft gjëra për Mustafanë, por Qorri duhej të dinte më shumë.

- Unë jam i pastër në punë dhe me ndërgjegje prej komunisti, - u mjaftua të përgjigjej Tafari.

- Ua thuaj të tjerëve ato, - tha Anastasi, atyre që janë qorra të të besojnë. Mua Qorr më thërresin vërtet, por qorr nuk jam.

E pashë që dialogu po ndalej dhe, për ta nxitur, i thashë Anastasit:

- Pse, si e njeh ti Mustafanë?

- Le të të thotë vetë, - tha Qorri, - unë nuk di ku kam kokën time.

E mora vesh, «fajtori nuk donte ta dorëzonte fajtorin» dhe nuk e zgjati më tej. Mustafai u largua si pa të keq dhe u bashkua me grupe të tjera shokësh.

- Shkoi të shesë dokrra prej «komunisti të floringjtë», - murmuriti nëpër dhëmbë Anastasi. Se ç'donte të thoshte me këtë nuk e kuptova: ironizonte për Mustafanë që hiqej si «komunist i vyer», apo kishte dëgjuar edhe ai për ato sterlina që solli nga jashtë, gjoja për luftën. por që, pasi dha diçka sa për të thënë. shumicën e mbajti për vete, për punët e tij të mbrapshta. Por kjo është një histori tjetër. Konferenca rifilloi punimet ditën tjetër. Shokët, njëri pas tjetrit, flisnin me fakte dhe i dërrmuan armiqtë e Partisë. Diskutimet ishin të rrepta dhe të gjithë me radhë kërkuan përjashtimin nga Partia për Qorrin, për Xhepin dhe për një numër tjetër bashkëpunëtorësh të tyre.

Né fund bëra konkluzionet, duke i akuzuar të dy këta si antiparti, trockistë, armiq të betuar të Partisë, sabotatorë të vijës politike, ideologjike dhe organizative të saj. I akuzova si renegatë, si njerëz me dy faqe e hipokritë. Partia u doli borxhit. Konsulta e mëparshme ua kishte bërë të qarta pozitat marksiste-leniniste të Partisë e punën e tyre sabotuese dhe i kishte paralajmëruar të ndërronin rrugë, përndryshe do të merreshin masat më të rrepta kundër tyre. Thashë né Konferencë se këta elementë armiq né vend që të ndreqeshin, kishin shkuar më tej, as që e kishin përfillur Konsultën dhe mendimet e saj, ata u ishin përgjigjur né mënyrë antiparti edhe këshillave, edhe vërejtjeve që u kisha bërë unë dhe shokët e tjerë. Prandaj Anastas Lula, Sadik Premtja dhe disa shokë, të tjerë meritojnë dënimin më të rëndë, përjashtimin nga radhët e Partisë. ashtu sie e shprehën të gjithë shokët né këtë Konferencë.

Konferenca propozoi njëzëri përjashtimin e tyre nga Partia. U pyetën edhe një herë nëse kishin gjë për të thënë. Që të dy as që thanë një fjalë pendimi.

Atëherë e mora fjalën përsëri dhe porosita, siq kishim vendosur né Komitetin Qendror, né rast se Qorri e Xhepi nuk do të pranonin fajet brenda dy ditësh, të largoheshin nga Tirana, ku mund ta dëmtonin shumë punën ilegale të Partisë né kushtet e reaksionit fashist. I pari të shkonte né Skrapar dhe të ishte nën mbikëqyrjen e Ramiz Aranitasit, kurse Xhepi në Vlorë, nën mbikëqyrjen e shokut Hysni Kapo dhe të shokëve të tjerë të Partisë. U thashë atyre qt ky është urdhër, që nuk mund të

bëhet dy. Sa për propozimin e Konferencës, që ata të përjashtoheshin nga Partia, këtë do ta vendoste Komiteti Qendror në një mbledhje të veçantë të tij.

- E keni të qartë? - i drejtova atyre.

- Po, - thanë Qorri dhe Xhepi.

Kjo ishte një mundësi tjetër që u jepte atyre Partia për t'u korrigjuar, mirëpo më vonë, siq dihet. Xhepi organizoi fraksionin në Vlorë, i cili u shpartallua, kurse Anastas Lula u orvat të arratisesh nga Skrapari, të braktiste çetën, u ndoq nga partizanët dhe u vra si tradhtar.

Kështu mbaroi edhe kjo ndodhi me rëndësi partie, që u zhvillua në shtëpinë e Zeqi Agollit, e cita gjendej afër postës qendrore, afër banesave të personaliteteve fashiste kuislinge, por që forca konspirative, vendosmëria e Partisë dhe e njerëzve të popullit bënte që mbledhje të tilla të rëndësishme të zhvilloheshin edhe nën hundën dhe nën mjekrën e tyre.

Punimet e Konferencës së Jashtëzakonshme provuan se sa e kishin pjekur Partinë situatat, ngjarjet dhe vetë puna e lufta e saj. Kjo Konferencë provoi se Partia nuk do të toleronte dhe do të luftonte pa mëshirë çdo element e veprimtari likuidator fraksioniste në gjirin e saj, ashtu siç do të luftonte pa mëshirë armiqtë e popullit.

Pas diskutimeve të gjalla dhe të zjarra për punën armiqësore të fraksionistëve, për të cilët u bë fjalë më lart dhe pas përfundimit me sukses të Konferencës, në bazë të analizave e të konkluzioneve të saj, ne zhvilluam një mbledhje të veçantë të Komitetit Qendror të Partisë.

Kjo mbledhje u organizua në ditët e para të korrikut, në një shtëpi në fund të rrugës së sotme «Hoxha Tahsin». Në këtë mbledhje, përveç shokëve të zgjedhur në Komitetin Qendror të Partisë (natyrisht Gjin Marku vazhdonte të mungonte), merrnin pjesë edhe Ymer Dishnica e Nako Spiru. Siç dihet, të dy këta në Mbledhjen Themeluese të Partisë nuk ishin zgjedhur në përbërjen e Komitetit Qendror të Përkohshëm, por, pas vrasjes së Qemal Stafës dhe arrestimit të Koçi Xoxes në gjysmën e parë të vitit 1942, neve na u desh t'i aktivizonim Nakon e Ymerin me detyra të ndryshme të Komitetit Qendror. Natyrisht, zgjedhje ose kooptim zyrtar, ashtu si i kuptojmë sot këto veprime, ne për ta nuk bëmë, por fakt është se këta shokë mbaheshin afër, konsideroheshin si anëtarë të Komitetit Qendror të Përkohshëm dhe ngarkoheshin me detyra që u takonin anëtarëve të udhëheqjes së Partisë. Përveç këtyre në mbledhje e aktive të ndryshme, sipas rastit e problemit që analizohej, ne herë pas here ftonim ose ngarkonim me detyra të caktuara edhe shokë të tjerë. Ishte kjo një praktikë që ne kishim filluar ta përdornim në atë kohë e më pas dhe që, për ato kushte në të cilat na duhej të luftonim, i shërbente të mirës së punës. Kështu, për shembull, edhe në Konsultën e Parë të Aktivitetit të PKS-hë edhe në Konferencën e Jashtëzakonshme të Partisë morën pjesë si të ftuar një numër i kufizuar shokësh, të cilët, ndonëse nuk qenë të zgjedhur në organet drejtuese të Partisë në qendër e në qarqe, prapëseprapë ne i ftonim të merrnin pjesë me qëllim që edhe të diskutonin, por edhe të mësonin nga mënyra se si i shtronte e i analizonte problemet udhëheqja e Partisë. Këta, pra, këta të ftuar kishin të drejtë që të thoshin fjalën e tyre për problemet që shtroheshin, por s'kishin të drejtën të votonin apo të merrnin vendime. Përveç këtyre të ftuarve, në mbledhjet e ndryshme kishte raste kur na duhej të thërritnim edhe njërin apo tjetrin person, por këta të fundit nuk thirreshin për të dhënë mendime, por për të dhënë llogari për gabime e devijime që kishin kryer.

Mbledhja e Komitetit Qendror e fillimit të korrikut 1942 ishte e lidhur ngushtë me Konferencën e Jashtëzakonshme të Partisë, ishte, si të thuash, vazhdim i saj, por në një rreth më të kufizuar pjesëmarrësish, ishte njëkohësisht mbledhje ku u thelluan më tej analizat e Konferencës e u përcaktuan një sërë detyrash e vendimesh të rëndësishme për momentert që kalonim e për të ardhmen.

Dihej se Anastas Lula dhe Sadik Premtja nuk e kishin zhvilluar veprimtarinë e tyre armiqësore vetëm me njëri-tjetrin. Me njërin apo me tjetrën masë ata kishin bërë për vete edhe disa elementë të tjerë, pikëpamje e praktika të tyre kishin penetruar në një numër jo të vogël shokësh po të kemi parasysh kushtet e atëhershme. Komitetit Qendror të Partisë i duhej, pra, që, pas goditjes së krerëve fraksionistë, të shohiste mirë edhe influencën e tyre në bazë, nëpër celula apo elementë të veçantë. Partia duhej spastruar rrënjësisht e kudo nga elementë të tillë e nga çdo pikëpamje apo praktikë e huaj për jetën e saj. Pikërisht këtij problemi mbledhja e korrikut 1942 i kushtoi një vëmendje të

madhe dhe, pas diskutimeve që bëmë, vendosëm një sërë masash për spastrimin e Partisë e shëndoshjen e gjendjes. Përveç aprovimit unanim të masës së marrë në Konferencën e Jashtëzakonshme për përjashtimin e menjëhershëm të A. Lulës e S. Premtes nga Partia dhe për dërgimin e tyre në Skrapar e në Vlorë, mbledhja, gjithashtu, vendosi përjashtimin nga Partia për një kohë ;të pakufizuar të pesë vetave të tjerë që qenë lidhur më tepër me veprimtarinë e krerëve fraksionistë, kurse disa të tjerë elementë ;të gabuar e të gënjyer u vendos që të përjashtoheshin e të mbaheshin në provë për një periudhë prej tre muajsh.

Në këtë mbledhje të Komitetit Qendror u përgatit e u miratua edhe një qarkorel, e cila iu dërgua të gjitha organizatave-bazë të Partisë. Me anën e kësaj qarkoreje organizatat=bazë të Partisë viheshin në dijeni për dënimin e veprimtarisë armiqësore të Anastas Lu'ës e të Sadik Premtes dhe porositeshin që në fr'ymën e saj të analizonin krejt punën e jetën e tyre, të goditnin çdo rast e shenjë fraksionizmi në radhët e veta e të rritnin pandërprerë vigjilencën revolucionare.

Në këtë mbledhje të Komitetit Qendror ne morëm vendimin që të dënohej me vdekje tradhtari e agjenti provokator Ludovik Nikaj dhe vendimin e bëmë publik. Për të organizuar aksionin e gjetjes dhe të asgjësimit të agjentit kriminel, që i solli kaq dëme e gjak popullit e Partisë, ne ngarkuam shokun Vasil Shanto. Goditja e kriminelit u bë në Shkodër, mu në çerdhen e fshehtë ku e mbanin të mbyllur fashistët italianë, por për fat të keq, ai vetëm u plagos. Fashistët e tërhoqën menjëherë në Itali për shërbimet e posaçme që u kishte bërë. Por ne kishim marrë vendim që ai të asgjësohej patjetër dhe atë që s'mundëm ta bënim më 1942 e bëmë më pas, menjëherë pas Çlirimit. Ludovik Nikaj u gjet nga njerëzit tanë atje ku ishte fshehur, u soll në Shqipëri dhe organet tona të diktaturës së proletariatit ekzekutuan përfundimisht vendimin e Komitetit Qendror të Partisë të korrikut 1942. Po kështu u veprua edhe me tradhtarin e kapitullantin tjetër të Partisë, Zef Ndojën. Pasi u mor vesh mirë tradhtia e tij, një njësit i posaçëm partizan arriti ta arrestonte në Tiranë nga fundi i vitit 1943 dhe e solli në Labinot ku iu bë gjyqi partizan, i cili e dënoi me vdekje. E tillë ka qenë e mbetet Partia jonë - ajo i ka zbatuar kurdoherë vendimet e saj dhe s'ka lënë pa marrë hakun e shokëve të rënë a të tradhtuar.

Mbledhja e Komitetit Qendror të Partisë e korrikut 1942 mori edhe vendime të tjera shumë të rëndësishme. Aty ne diskutuam për problemet e këshillave nacionalçlirimtarë, shtruam domosdoshmërinë e zgjerimit e të forcimit të tyre dhe vendosëm që në një të ardhme të afërt të organizonim një konferencë nacionale, e cila do të përbënte një nga ngjarjet më të rëndësishme të atyre viteve. Kjo u realizua në Konferencën e Pezës, në shtator të 1942-së.

Ndonëse armiku e ndjeu shpejt se ne, edhe pas goditjes së tij, qemë në këmbë, të papërkulur e të organizuar, prapëseprapë në këtë mbledhje vendosëm që të jepnim një kundërgoditje të fuqishme e të organizuar që ta trondiste nga rrënjët regjimin e pushtimit. Vendosëm të organizonim aksionin e mirënjohur të 24 korrikut 1942. Atë natë prej njësiteve tona guerile do të priteshin telat dhe shtyllat e linjave telefonike në gjithë Shqipërinë, atë natë, regjimi i pushtimit do të paralizohej krejtësisht. Kështu vendosëm e kështu u bë. Partia jonë vërtet ishte e re, por ajo lindi në luftë dhe përmes luftës p' rritej e po forcohej nga dita në ditë, në luftë ajo kaliste radhët e saj, i shtonte me gjak të ri dhe i shtrinte anëmbanë vendit.

Për këtë rritje e fuqizim të saj patën vlerën e rëndësishme të tyre të madhe edhe analizat e masat që morëm në Konferencën e Jashtëzakonshme të Partisë e në mbledhjen e Komitetit Qendror të korrikut 1942.

**KONFERENCA E PARË E VENDIT E PARTISË
KOMUNISTE TË SHQIPËRISË
(17-22 mars 1943)**

Pas Mbledhjes historike të Themelimit të Partisë sonë, mbledhja më e rëndësishme që Konferenca e Parë e Vendit e PKSH, e cila luajti një rol shumë të madh për forcimin e unitetit e për të ardhmen e Partisë, për zhvillimin e mëtejshëm të Luftës Nacionalçlirimtare, për hedhjen e popullit në kryengritjen e përgjithshme të armatosur dhe për arritjen e fitores. Konferenca bëhej në momente shumë të vështira e të ndëtlukuara në të cilat kalonte vendi ynë i okupuar. Fashistët italianë dhe kuislingët e tradhtarët e vendit, të tërbuar nga disfatat e goditjet e njëpasnjëshme që po pësonin, ishin hedhur në raprezalje e terror të gjerë. Ata po bënin ç'ishte e mundur që të shuanin valët e Luftës Nacionalçlirimtare, të mbanin nën regjimin e shtypjes e të shfrytëzimit popullin shqiptar, e sidomos, të zhduknin Partinë Komuniste të Shqipërisë, e cila, efektivisht, ishte vënë në pararojë të popullit dhe po organizonte e udhëhiqte luftën hap pas hapi. D'y-tri kabinete kuislingësh, njëri më gjakatar se tjetri, u detyrua të ndërronte pushtuesi nga janari gjer në shkurt 1943; xhelatin Jakomon, po në këtë periudhë, Musolini e zëvendësoi me xhelatin tjetër, gjeneral Parianin, i njohur si «person që di të fjaloset me forcën e armëve»; fushata «spastrimi», sulme, internime, terror e arrestime nga më të ashprat ndërmori reaksioni kundër nesh; lodra e parulla demagogjike nga më të ndryshmet vuri në veprim, por të gjitha këto as e shuan e as e dobësuan luftën popullore që kishte shpërthyer. Përkundrazi, akoma më e furishme, më e organizuar dhe më rezultative po bëhej kundërgoditja jonë. Një rol veçanërisht të madh e të rëndësishëm për kthimin e luftës sonë të pandërprerë në kryengritjen e përgjithshme të armatosur do të luante, siç luajti, Konferenca e Parë e Vendit e PKSH.

Detyrën për organizimin e kësaj Konference në kohën e në momentet e përshtatshme ne e kishim shtruar që në Mbledhjen Themeluese të Partisë. Çështjen e kësaj Konference më pas ne e kishim hedhur për diskutim edhe në aktive të Partisë, në të cilat mblidhnim sekretarët e Partisë të qarqeve, sepse e ndienim të nevojshme. Për thirrjen e saj ne ishim të preokupuar, për arsye se kërkonim që Partia të mos shkonte atje me duar bosh dhe vetëm me fjalë, por të paraqitej me një veprimtari sa më të pasur organizative e luftarake.

Në prillin e vitit 1942, Konsulta e Aktivitetit të PKSH, dulce bërë analizën e pesë muajve të parë të jetës dhe të veprimtarisë së Partisë, midis të tjerash, arriti në përfundimin se kushtet për thirrjen e Konferencës po pëqeshin me shpejtësi. Partia tash ishte organizuar e rri tur, ajo po e afironte veten në luftën që po zgjerohej pandërprerë, prandaj në Konsultë vendosëm që në një të ardhme të afërt, pasi të laheshin njëherë e mirë hesapet me fraksionistët brenda radhëve të Partisë, të forcohej më tepër unite' i radhëve tona e të rritej më tej bilanci luftarak veprimtarisë së Partisë, të mblidheshim në Konferencë, e cila, kuptohet, për rolin dhe funksionet e saj do të kishte rëndësinë e një kongresi partie.

Në fund të vitit 1942 Komiteti Qendror i Përkohshëm i Partisë mendoi se qenë pjekur plotësisht kushtet për realizimin e kësaj ngjarjeje historike.

Vetë Partia tashmë ishte rritur dhe e kishte afirmuar e po e afirmonte veten si e vetmja forcë politike, e aftë dhe e vendosur për udhëheqjen e popullit drejt çlirimit të vendit dhe realizimit të të gjitha aspiratave të tij shekullore.

Një vit jete kishte në këtë periudhë Partia jonë, por ky kishte qenë një vit lufte e përpjekjesh të gjithanshme, vit kur Partia i kishte shtrirë rrënjët e saj në të gjithë vendin. Tani ne kishim celula anëmbanë Shqipërisë, qenë ngritur e organizuar komitetet qarkore, ishte bërë një punë e madhe dhe e suksesshme për forcimin e unitetit e të disiplinës së brendshme në Parti, për lartësimin politik e ideologjik të shokëve, në shtimin e pareshtur të radhëve, për lidhjet me masat e gjera të popullit etj. Shkurt, Partia jonë tashmë e kishte marrë fizionominë e saj; ajo punonte si një mekanizëm i organizuar e i ndërgjegjshëm që nga qendra e gjer në bazë. Kishte ardhur, pra, momenti që të bëhej bilanci i gjithë kësaj pune të kryer në këtë drejtim dhe të përcaktoheshin detyrat e reja për të

ardhmen. E këtë gjë mund ta bënte ashtu siç duhej vetëm një forum i tillë i lartë, siç ishte Konferenca e Partisë.

Nga ana tjetër, Partinë ne nuk e kishim krijuar dhe nuk po e forconim si qëllim në vetvete, e as si një sekt të mbyllur e të izoluar. Përkundrazi, Partia jonë lindi në zjarrin e luftës që të vihej e gjitha në shërbim të luftës, që të merrte përsipër udhëheqjen e popullit dhe me vijën e saj të drejtë ta çonte këtë, me trimëri e urtësi drejt fitores përfundimtare e të sigurt. Në vitin e parë të jetës së saj, Partia vërtetoi se edhe këtë detyrë primordiale po e kryente me sukses. Që nga Thirrja e Parë e PKSH e nëntorit 1941 e gjer në fundin e 1942-shit, flakët e luftës popullore qenë ndezur në qytete e në fshatra, e tash Shqipëria ndodhej në prag të shpërthimit të zjarrit të përgjithshëm. Demonstratat, përlëshjet, sabotimet, aksionet e pandërprera të njësiteve guerile, forma karakteristike të luftës në muajt e parë të jetës së Partisë, tashmë po pasoheshin nga veprime më të gjera, më të organizuara e të kombinuara të njësiteve, çetave e të reparteve partizane që qenë krijuar e po krijoheshin në çdo anë. Mbi 3000 luftëtarë numëroheshin tani në radhët e çetave partizane dhe rreth 8000-10000 luftëtarë të tjerë bënë pjesë në njësitet guerile dhe në çetat territoriale që vepronin anëmbanë vendit. Si rezultat i luftës heroike të këtyre forcave në periudhën kur do të mbahej Konferenca e Parë e Vendit, ishte rritur e po rritej pa ndërprerje numri i zonave të çliruara. Në Shqipërinë e Jugut, për shembull, armiku kishte nën kontroll vetëm qytetet e një numër fshatrash rreth qyteteve, kurse krejt zona tjetër ishte çliruar; në Shqipërinë e Mesme shumica e krahinave ishin çliruar ose ndodhesin nën kontroll të forcave tona etj.

Me punën e me luftën e sa, i të urrejtë e këmbëngulëse, me fjalën e ngrohtë e të sinqertë. Partia po e bënte popullin gjithnjë e më të ndërgjegjshëm, po e mobilizonte në luftën kundër pushtuesve e tradhtarëve vendës dhe, hap pas hapi, po forconte bashkimin e tij me anën e këshillave nacionalçlirimtarë, që themeluan e morën hov në vendin tonë pas Konferencës së Pezës.

Këto fitore neve na jepnin zemër e krahë, ato, gjithashtu, na vinin përpara detvra e kërkesa të reja, më të mëdha e më të vështira.

Ishte koha, pra, që Partia, duke analizuar gjithë rrugën e bërë për organizimin, mobilizimin dhe udhëheqjen e popullit në luftën kundër pushtuesit, të përcaktonte detyrat e reja në përshtatje me kërkesat e fazës së re, më të lartë në të cilën kishim arritur.

Pikërisht në këto momente një ngjarje tjetër i gëzoi zemrat tona e na dha forca e krahë për të ardhmen: Partia Komuniste e Shqipërisë u njoh nga Kominterni. Kjo njohje kishte rëndësi shumë të madhe, sepse me luftën tonë, me qëndrimet tona, me organizimin dhe me vijën e drejtë politike të Partisë sonë: ne vërtet de facto ishim në Komintern, por duhej të ishim edhe de jure anëtarë të tij.

Qysh në Konsultën e Parë të Aktivitetit të PKSH, ne menduam se kishte ardhur koha që të hynim në lidhje me Kominternin. T'i raportojmë atij për gjendjen në Shqipëri, për luftën që ishte bërë për formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, për qenien e kësaj Partie në krye të Luftës Nacionalçlirimtare dhe se kjo prante të gjitha kushtet e Kominternit dhe kërkonte të ishte pjesëtare e tij. Njohjen e PKSH nga Kominterni, Konsulta e shtroi si një ndër kushtet për thirrjen, në të ardhmen, të Konferencës së Parë të Vendit të Partisë.

Menjëherë pas Konsultës e biseduam këtë me Miladin Popoviçin dhe i thamë që, për lidhjen tonë me Kominternin, mundësisht të ndërmjetësonte Partia Komuniste e Jugosllavisë, e cila ishte vetë anëtare e Kominternit dhe, me sa dinim, vazhdonte të mbante lidhje me «Qendrën», pra me organet drejtuese të Internacionales.

Miladini e quajti me shumë vend kërkesën tonë dhe, gasi bëmë përgatitjet e duhura, në maj të vitit 1942, u nis për në Jugosllavi Dushan Mugosha që t'i çonte udhëheqjes së PK të Jugosllavisë kërkesën tonë drejtuar Kominternit.

Udhëtimi do të qe i gjatë, i vështirë, në kushtet e rënda të ilegalitetit e të terrorit që sundonte në të gjitha anët, prandaj ne caktuam shokun tonë të sprovuar Vasil Shanton, ta shoqëronte Mugoshën, gjersa ky të mbërrinte në duar të sigurta, pra gjersa të takohej me repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Vasil Shantoja, e më pas, bashkë me të edhe heroi i lavdishëm i Partisë e i popullit tonë, Vojo Kushi, e kryen me nder detyrën që u ngarkoi Partia.

Në shtator të vitit 1942 Kominterni e mori dhe e aprovoi kërkesën tonë. Aprovimin për këtë duhet ta ketë dhënë Dimitrovil, sepse në takimin e parë që pata me shokun Stalin në Moskë, pas luftës, kur i bëra një pasqyrë të përpjekjeve për themelimin e Partisë sonë, për luftën e saj dhe për gjendjen e vendit në ato momente, i zura në gojë, gjithashtu, edhe njohjen e Partisë sonë nga Kominterni. Ai më tha se vetë nuk ishte në dijeni sesi qe vepruar për këtë çështje, për arsye se kjo qe në kompetencat e Kominternit dhe «duhet të jebë shoku Dimitrov ai që e ka dhënë këtë aprovim». Sidoqoftë, këto janë hollësi. Puna është që njohja prej Kominternit, si dhe direktivat që na erdhën në të njëjtën kohë prej tij kishin një rëndësi shumë të madhe për Partinë tonë të re, për rritjen e autoritetit dhe për forcimin e saj, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të Luftës sonë Nacionalçlirimtare.

Njohjen dhe direktivat e Kominternit i solli në Shqipëri, në dhjetor të vitit 1942, Bllazho Jovanoviçi, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, një ndër drejtuesit kryesorë të Partisë dhe të Luftës Nacionalçlirimtare në Malin e Zi. Ne u lajmëruam që më parë dhe dërguam shokë për ta marrë atë në Bjeshkët e Veriut. Shokët tanë e morën Bllazho Jovanoviçin, e kaluan nëpër male dhe e sollën deri në Labinot të Elbasanit.

Takimin me delegacionin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë ne e pritëm me interes, sepse do të shkëmbenim eksperiencën e partive tona dhe të luftërave nacionalçlirimtare.

Fillimisht Bllazho Jovanoviçi na transmetoi lajmin e njohjes së Partisë sonë nga Kominterni dhe të direktivave, për të cilat na tha se vinin nga «Plaku» (e kishte fjalën për Stalinin), nga Moska. Pastaj bëmë edhe bisedime të tjera të gjata, të frytshme për të dy ja palët. Ne, nga ana jonë, i folëm Bllazho Jovanoviçit për situatën në vend, për gjendjen, shtrirjen dhe organizimin e Partisë sonë, për direktivat që e udhëhiqnin luftën tonë dhe për rezultatet që kishim arritur deri në atë kohë. Delegacioni jugosllav na bëri, gjithashtu, nga ana e vet, një ekspozitë të përgjithshme të partisë së tyre, të fraksioneve që kanë ekzistuar, të shumta bile në parti, fraksione këto të dënuara edhe nga Kominterni e, më vonë, nga udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ai na tregoi, gjithashtu, edhe për luftën që bënte populli jugosllav nën udhëheqjen e partisë.

Ky ishte një takim pune dhe njohjeje nga i cili krijova vetëm përshtypjet e para për Bllazho Jovanoviçin. Ai qe një burrë me shtat të gjatë, si janë malazeztë, dukej i thjeshtë, i matur në fjalë e në gjykime. Më pas ky takim i parë do të pasohej edhe nga takime të tjera, gjatë të cilave do ta njihnim më mirë njëri-tjetrin, sepse delegacioni i kryesuar nga Bllazho Jovanoviçi do të qëndronte edhe disa kohë, për të përshëndetur Konferencën tonë të Parë -të Vendit, si i deleguar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Në fund të dhjetorit 1942, në kasollen e Shmilit, u bë një mbledhje me një numër shokësh të Komitetit Qendror të Përkohshëm, ata që kishin mundësi të vinin, për të diskutuar e për të vendosur datën, vendin dhe rendin e ditës të Konferencës, formën e organizimit të zgjedhjeve të delegatëve dhe masat që do të merrnim për ardhjen e tyre në vendin e caktuar.

Në Shmil shkoja shpesh gjatë kohës që ndodheshim në zonën e Labinotit e të Çermenikës. E vërteta është se kudo në këto zona ne kishim bazat tona e populli fukara na priste me gjithë zemër, por në Shmil punonim më të sigurt e më të qetë për kryerjen e detyrave të mëdha e të vështira që u dëlnin Partisë dhe Luftës Nacionalçlirimtare. Që të mund të vinte armiku deri në Shmil, duhej të kapërcente postat tosa të partizanëve që nga Godoleshi, Labinoti, Fusha e Bizës, Librazhdi etj. Mbi fshat, në Qafë Shmil kishim një kasolle të vogël që me një shkallë të jashtme ngjiteshim në një dhomë të vetme e të varfër, kurse nën të kishte një bodrum që përdorej për bagëtinë, ku ne vendosëm më vonë teknikën, shtypshkronjën e Partisë, të cilën e kishin rrëmbyer njësitet guerile të Mihal Durit e të Misto Mames në Tiranë. Mbledhjen e Komitetit Qendror të Përkohshëm ne e bëmë pikërisht në këtë kasolle.

Në mbledhje përveç disa anëtarëve të Komitetit Qendror të Përkohshëm, si Tuk Jakovës, Ramadan Çitakut, Gjin Markut, nga Komiteti Qendror i Rinisë Komuniste mori pjesë shoqja Nexhmije Xhuglini (Nako Spiru ndodhej në burg), po ashtu edhe ndonjë shok tjetër. Me këtë rast kemi bërë edhe një fotografi, e cila është botuar e njihet, por në të kanë dalë edhe njere'z të tjerë, si Skënder Çaçi dhe një shok tjetër, që nuk kanë qenë pjesëtarë të mbledhjes. Ata kanë qenë quadro e

roja partizane, trima të dalluar që u ngarkuan me përgjegjësinë të dilnin përpara e të shoqëronin gjatë udhëtimit delegacionin e PK të Jugosllavisë.

Në këtë mbledhje, pra, u morën vendime e u dhanë udhëzime për përgatitjen e Konferencës së Parë të Vendit. Po në këtë mbledhje u vendos, që pas pakkohe të organizonim një mbledhje të rregullt të Komitetit Qendror të Partisë, ku do të njihnim shokët me direktivat e Kominternit, me përmbajtjen e tyre áhe detyrat që na dilnin për t'i vënë në jetë. Veç të tjerash, kjo do -të na jepte mundësinë që direktivat e Kominternit të pasqyroheshin sa më mirë në referatet që do të përgatitnim për të mbajtur në Konferencë. Gjithashtu u vendós t'i propozojë kësaj mbledhjeje që Konferenca t'i fillonte punimet më 17 mars të vitit 1943 në Labinot të Elbasanit. Në atë kohë Partia kishte afro 700 anëtarë dhe nga këta duhej të dërgoheshin në Konferencë 70 veta, delegatë e të ftuar. U përcaktua edhe rendi i ditës i Konferencës, i cili përfshinte

Referat për çështjet organizative, referat për çështjet politike, referat për Luftën Nacionalçlirimtare, referat për ushtrinë dhe një referat për bashkimin luftarak të punëtorëve me fshatarët. Kishte pastaj disa nënreferate: për gruan, për rininë, për çështjet e financës dhe, së fundi, do të procedohej në zgjedhjet.

Kështu, në fillim të muajit shkurt 1943, në Labinot të Elbasanit u organizua mbledhja që përmenda më lart ku morën pjesë anëtarët e Komitetit Qendror të Përkohshëm të Partisë (me përjashtim të Koçi Xoxes, i cili ndodhej i burgosur) e ndonjë tjetër. Në referatini që mbajta në këtë mbledhje u parashtrua shokëve në se konsistonin direktivat e Kominternit dhe i zhvillova gjerë këto, duke i lidhur me vijën që kishte ndjekur Partia jonë deri në atë kohë dhe me detyrat që duhej të zbatonim në të ardhmen.

Përmbajtja e këtij referati tash njihet, sepse është ruajtur dhe është botuar në dokumente të Partisë; prandaj, pa u zgjatur, dua vetëm të theksoj një moment

Për vetë dashurinë dhe respektin e thellë që ne ushqenim për Internacionalen Komuniste, direktivat e saj, ashtu si edhe vetë njohjen që i bëri Partisë sonë, i pritëm me gëzim të madh e me ndjenjën e thellë të përgjegjësisë komuniste. Por akoma më i madh ishte gëzimi ynë kur pamë se në përgjithësi vija që na udhëzonte të ndiqnim Internacionalja Komuniste, puqej me vijën që kishte ndjekur e po ndiqte Partia jonë Komuniste: Internacionalja Komuniste na porosiste të organizonim me të gjitha mjetet e forcat Luftën Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë; pikërisht këtë mision kishte përcaktuar si detyrë imediate Partia jonë dhe vetë situata në Shqipëri përmes dhjetëra e dhjetëra shembujve vërtetonte se Partia e populli ynë po e kryenin me nder, me gjak e sakrificë këtë mision të lartë; Internacionalja Komuniste na porosiste që të luftonim për bashkimin e popullit shqiptar në një front të fuqishëm antifashist dhe pikërisht këtë detyrë, Partia jonë që në Themelimin e saj e kishte vënë në rend të ditës, si një ndër hallkat më kryesore për vetë fatet e zhvillimit me sukses të luftës e të së ardhmes së popullit. Fronti Nacionalçlirimtar te ne qe formuar; ai në zjarrin e luftës po zgjerohej e po kalitej pandërprerë. Po kështu fliste realiteti ynë edhe për direktivën tjetër, rmbi pjesëmarrjen në luftë të sa më tepër patriotëve e nacionalistëve të ndershëm etj.

- Pikërisht se ne kemi përcaktuar e ndjekur një vijë të drejtë, - u thashë shokëve në mbledhje, - na njohu Kominterni. Me njohjen dhe me direktivat e saj Internacionalja Komuniste vulos punën tonë komuniste, na jep një të drejtë që e kemi merituar. Por prej kësaj të drejte rrjedhin edhe detyrime të mëdha, e më kryesorja midis tyre është që të forcojmë e të kalitim pareshtur Partinë tonë, të veprojmë kurdoherë në bazë të direktivave të Internacionales Komuniste, të mbajmë, pra, me nder titullin e lartë të Partisë, anëtare të Kominternit.

Qysh para kësaj mbledhjeje, por sidomos tanfi, pas orientimeve e detyrave që përcaktuam në Shmil e në Labinot, e intensifikuam punën për organizimin sa më mirë e në nivel sa më të lartë të Konferencës së Parë të Vendit të PKSH. Shokët u shpërndanë nëpër zona e qarqe, për t'i transmetuar gjithë Partisë lajmin e njohjes nga Kominterni e për të punuar në qarkoret e në celulat direktivat e Kominternit, për të ndihmuar për përgatitjen dhe për zhvillimin me sukses të konferencave të komiteteve qarkore, për zgjedhjen e delegatëve për në Konferencën e Vendit etj. E gjithë kjo punë duhej shoqëruar dhe u shoqërua me rritjen e aksioneve e të veprimeve luftarake në fshatra e në qytete, me shtimin e radhëve të reparteve e të njësiteve partizane, me forcimin e

mëtejshëm të këshillave nacionalçlirimtarë, me një punë më të madhe e më të dendur politike e ideologjike me masat e gjera të popullit etj.

Në dhjetor të vitit 1942, unë kisha kaluar në zonën e Elbasanit, por për vetë detyrat e mëdha që kishim përpara dhe për faktin që akoma vazhdoja të isha edhe sekretar politik i Qarkorit të Tiranës, ishte bëja herë pas bere rrugën nga Tirana në Elbasan e anasjelltas.

Këto udhëtime i kujtoj sot me nostalgji, siç i kujtoj gjithnjë ato ditë të rinisë e të luftës, por duhet thënë se për të gjithë ne rreziku ishte i madh, se armiku nuk flinte, kishte edhe ai vigjilencën e tij, siç kishim edhe ne tonën.

Ishin vitet e vështira të ilegalitetit, reaksioni që shumë i egër, emrat e fotografitë tona qarkullonin në çdo postë karabinerie, na kërkonin me ngulm kudo. Por punën tonë duhej ta bënim patjetër. Na është dashur të udhëtonim në këmbë, me udhë e pa udhë, ditën e natën, të maskuar herë si tregtarë e nëpunës, herë si punëtorë shëtitës e si fshatarë.

Por kishte raste që udhëtonim me makinë, duke shfrytëzuar lidhjet që kishte krijuar Partia nëpërmjet komunistëve e simpatizantëve të vet. Këto udhëtime kishin një risk më të madh, po shpesh ishin të domosdoshme për çështje urgjente që nuk prisnin.

Për një punë të tillë u nisëm një herë bashkë me Nexhmijen për në Elbasan me një veturë, një nga ato makinat e vogla që i quanin «topolino», të cilën, s'di se si, e kishin gjetur shokët e Tiranës. Unë isha veshur si tregtar, me borsalinë në kokë e një qostek që më ndriste i mbërthyer në jelek, dhe që e vija në dukje me qëllim, për të mos dyshuar, por edhe sepse kisha futur dorën në xhepin e pantallonave dhe shtrëngoja në dorë revolverin. Nexhmija ishte veshur si një zonjushë, me një kapele e me dy-tri revista mode në dorë. Udhëtonim me pasaporta false, si vël'la e motër. Unë quhesha...(?) ja që s'e mbaj mend si quhesha, kurse mbiemrin e kisha Hysi, kurse Nexhmija e kishte Vera Hysi. Asaj ia mbaj mend emrin se atë emër përdornim gjatë luftës në mes tonë dhe në rrethin tim familjar. Sot e kësaj dite njerëzit e mi e thërresin Vera. Lufta të kalit shumë nervat. Nuk e di se si ta shpjegoj, pse edhe në momentet më të vështira ndiheshim shumë të qetë. Bënim dhe shakara: «Ej, mik, - i thoshte Nexhmija shoferit, - si e quajnë këtë «zotrninë» që ke në makinë?». Pastaj kthehej nga unë: «More, si na e quajnë nënën? Po babanë?». Kështu i bënim provim vetes dhe qeshnim.

Aty ku fillon e përpjeta e Rrugës së Elbasanit; pak para se të arrinim te Pallati i Zogut, ose më mirë të themi i Jakomonit, mëkëmbësit të Viktor Emanuelit në Shqipëri (sot Pallati i Brigadave), ishte një postbllok, ku kontrolli ishte veçanërisht i rreptë. Sa u afruam, na doli një oficer i karabinierisë italiane dhe na bëri shenjë të ndalonim. Ne vërtet dokumentet i kishim në rregull, por çdo gjë mund të ndodhte. Natyrisht nëpër xhepa e poshtë sediljeve kishim revolverët e bombat; po të diktoheshim, ato do t'i vinim në veprim, por misioni ynë ishte që të mbërrinim në Elbasan e jo të bënim një ndeshje, sado heroike, me një postë karabinerie. Ndodheshim përballë saj. Shoferi u kthye nga ne e na mori pasaportat, pastaj doli e duke qeshur i thirri oficerit në emër. Unë nxora paketën e ndeza krejt «indiferent» një cigare, kurse «Vera shfletonte një revistë mode.

Sidoqoftë prapa kësaj «indiference» të shtirë të pamjes «sé qetë», përqendrohej gjithë vigjilenca e kujdesi ynë për të vepruar me shpejtësi e në çastin e duhur. Italiani mori pasaportat e u hodhi një sy, por ndërkaq shoferi ynë, duke qeshur, i zgjati një shishe raki e diçka nisi f'i thoshte. Ky e mori shishen, i shkeli syrin shoferit e bëri shenjë të kalonim.

Nuk i kujtoj dot emrat e të gjithë atyre shokëve shoferë që i shërbenin Partisë në këto misione, ku vinin, siç i thonë fjalës, me kokë në trastë, por e mbaj mend mirë trimërinë dhe zgjuarsinë e tyre, shkathtësinë dhe aftësinë për të dalë nga situatat. Ata ishin shumica djem të rinj, të zgjuar e të hedhur. Zinin «miqësi» me oficerë e milicë, që përgjonin nëpër postblloqe e nëpër rrugë, me një shishe raki, me një pako cigare, a me ndonjë porosi të vogël që u kryenin. Dhe kjo «miqësi» shpesh u hynte në punë.

Më ndryshe qëndronte puna kur lëviznim ose qëndronim në zonat e çliruara. Në këto zona ishim më të sigurt, por kjo siguri që relative. Rreziku ekzistonte edhe këtu, forcat ushtarake të pushtuesit, në bashkëpunim me tradhtarët, bënin herë pas here operacione ndëshkimore në fshatra për fu hakmarrë për humbjet e pësuarat në luftë me çetat partizane.

Me sa më kujtohet ka qenë dhjetori i 1942-shit kur ishim vendosur në Labinot bashkë me disa shokë, si Vasil Shanton, Ramadan Çitakun e të tjerë, kur u lajmëruam për afrimin e forcave të shumta të armikut. Menjëherë u bëmë gati, morëm materialet që na duheshin me vece, të tjerat i fshehëm në vend të sigurt dhe u tërhoqëm nga Labinoti në drejtim të pyjeve të Shmilit, ku qëndruam derisa shokët e Qarkorit të Elbasanit na lajmëruan se operacioni kishte marrë fund dhe armiku po tërhiqej.

U nisëm menjëherë për në Labinot në mes një shiu e një të ftohti që të hynin deri në palcë. Ishte edhe natë dhe kjo e bënte akoma më të vështirë udhëtimin. Ecëm nga 3-4 orë të mira dhe, kur arritëm në Labinotin-Mal, ishim të rraskapitur. Fjetëm atë natë si të vdekur në shtëpinë e vogël, poshtë, të Sami Bahollit.

Kështu një mëngjes, Vasili, që ngrihej shumë herët, hyri brenda me vrap e na zgjoi, duke thirrur:

- Çohuni, po vijnë ushtarë!

U ngritëm me nxitim dhe u bëmë gati t'i prisnim. Ndamë detyrat, shumë pozicion nëpër dritaret nga të gjitha anët e shtëpisë, që të mbroheshim nga çdo anë.

Vasili, gjakftohtë dhe i sigurt, zuri vend me automatikun e tij në korridorin e shtëpisë, në drejtim të derës së hyrjes.

- Po vijnë, - na tha me zë të ulët.

Ne po prisnim. Dëgjonim nga jashtë fjalë të shkëputura shqip e italisht. Vështroj me kujdes në dritare dhe shoh që shumë milicë po kalonin në një rrugë disa metra më poshtë nga shtëpia ku qemë ne dhe drejtoheshin në anën tjetër të fshatit. Një oficer italian, i pasuar nga 5-6 ushtarë, i hodhi një sy shtë

pisë, seç u foli të tijve, duke qeshur e duke treguar me dorë nga dritaret, një pjesë e të cilave qenë pa xhame. U larguan edhe këta dhe pas pak çastesh hyri Jashari, një fshatar vendës, që na shërbente e i vinte

doresh për shumë gjëra, dhe thirri shumë i gëzuar:

- Ikën. Më ngriu gjaku!

Lëvizëm nga vendet që kishim zënë. Vasili «urdhëroi»

- Jashar, gjej ku të gjes ca sheqer se do të bëjmë hallvë.

- Po, besa, - tha Jashari, - na duhet, që të mbledhim barkun.

Jasharit i duhej për të mbledhur barkun, ai bëhej merak për ne, megjithëse ndoshta nuk e përfytyronte dot se ç'do të bëhej po të ishin afruar ata ushtarë në drejtim të shtëpisë. Ne donim të festonim «shpëtimin» tonë nga vdekja që na kaloi aq pranë.

Kështu kaloi edhe ky rrezik, i cili, dihet, nuk ishte as i pari e as i fundit. Por ne i kishim marrë parasysh të gjitha, kryesorja ishte që punët të shkonin përpara.

Kujdes e vëmendje të posaçme u kushtuam në atë kohë përgatitjes në një nivel sa më të lartë referateve që do të mbanim në konferencë.

Referatin e parë, atë për çështjet organizative, do ta mbaja unë. Me shokët që do të mbanin referatet e tjera, m'u desh të punoja mjaft ditë. Diskutuam së bashku tezat kryesore, pastaj ata punuan dhe në fund referatet i shikuam edhe një herë. Kështu u bëmë gati për ditën e çeljes së Konferencës.

Konferenca i filloi punimet, ashtu siç kishim vendosur që më parë, më 17 mars 1943, në shtëpinë e madhe të Bahollëve, në Labinot. Salla e mbledhjes ishte përgatitur me kohë dhe ishte zbukuruar me flamuj të kuq, me parulla të mëdha e me portretet e klasikëve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit.

Pasi e deklarua Konferencën të hapur, gjithë delegatët mbajtën një minutë zi për militantët e shquar, si Ali Kelmendi me shokë, që kishin flijuar jetën për kauzën e madhe të komunizmit, dhe për shokët tanë të paharruar që kishin rënë heroikisht në ballë të iuftës e të aksioneve që nga 8 shtatori i vitit 1941. P as kësaj, fjaia m'u ciha rnuar për të mbajtur referatin për çështjet organizative.

Ky referat, që e kisha përgatitur në shtëpinë e vogël të Labinotit, ishte mjaft i gjatë, por, për fat të keq, na humbi, kështu që nuk ndodhet në Arvin Qendror të Partisë, bile, idetë e tij nuk janë të pasqyruara as në procesverbalin e Konferencës, i cili është ruajtur e ndodhet në Arkiv. Arsyeja se

pse ;është pasqyruar në procesverbal si referati im ashtu edhe disa referate të tjera, është po ajo që ndodh ngandonjëherë edhe sot në mbledhje të ndryshme: mbajtësi i procesverbalit pasqyron më tepër ato diskutime që bëhen me gojë apo me disa pika, kurse për referatet dhe diskutimet e shkruara, në procesverbal shënohet vetëm: «Është i shkruar». Tamam këto të fundit, ngandonjëherë prej pakujdesisë, harrohen të mblidhen dhe humbasin. Kështu kopjen e referatit që unë mbajta në Konferencë, pas mbarimit të punimeve, për të mos e mbajtur kurdoherë me vete, bashkë me disa dokumente të tjera, i futëm në një kuti teneqeje djathi, i mbështollëm brenda e jashtë me mushama, për të mos i dëmtuar lagështira, dhe i fshehëm nën baltën e dyshemesë në një kasolle të sigurt. Më pas, kur qe çliruar Shqipëria, e kërkuam, por pakon e dokumenteve nuk e gjetëm. Ato më tepër ka mundësi të jenë djegur, kur u dogj kasollja nga armiqtë, e jo të kenë rënë në dorën e armikut. Këtë e them se, kur kapëm mjaft dokumente që na i kishin marrë armiqtë, kur kishin sulmuar disa nga azat tona, kv referat nuk u gjet.

Por, për fat të mirë, një numër i mirë i dokumenteve të tjera të kësaj Konference. midis të cilave edhe procesverbal i mbajtur gjatë zhvillimit të punimeve, u gjetën pas Çlirimit. Këtë pjesë dokumentesh shokët tanë, si Sami Baholli e të tjerë, menjëherë pas Konferencës, i futën në një kusi, i izoluan mirë dhe i groposën nën një lis në pyllin e Shmilit. Pas Çlirimit ata shkuan në pyllin e Shmilit., gërmuan dhe i gjetën dokumentet në gjendje të mirë, e tanfi ato ruhen në Arkivin tonë të Partisë. Meqenëse referati që unë mbajta në Konferencë nuk ekziston, e quaj të nevojshme që me rastin e këtyre kujtimeve, të flas pak gjerë për përmbajtjen e tij e të shtjelloj problemet më kryesore që përfshinte. Dihet se Rezolucioni i Konferencës u hartua kryesisht mbi bazën e referatit organizativ, që ishte edhe më kryesori, prandaj paraqitjen e përmbajtjes së këtij referati po e bëj dulce u mbështetur si në kujtesën time, ashtu edhe te Rezolucioni.

Referati bënte një bilanc të lëvizjes komuniste shqiptare para dhe pas formimit të Partisë, deri në pragun e Konferencës. Pra, ky referat prekte veçanërisht gjendjen e brendshme shpirtërore dhe luftarake të popullit shqiptar, kurse për gjendjen ndërkombëtare aty flitej shkurtimisht, mbasi problemet e situatës së jashtme i trajtonte referati për çështjet politike.

Në referat vija në dukje politikën e imperializmit fashist italian ndaj Shqipërisë dhe qëndresën e popullit shqiptar, i cili, dhe këtë herë, si në gjithë historinë e tij, iu kundërvu me forcë strategjisë dhe taktikave të okupatorit. Qëndresa dhe lufta e popullit tonë morën përmasa të mëdha. sidomos kur u formua Partia Komuniste e Shqipërisë, por, theksoja në referat, edhe para formimit të saj, grupet komuniste, me gjithë pikëpamjet e tyre të gabuara, e urrenin fashizmin dhe, që në ditët e para të okupacionit, e luftuan atë me forma e me metoda të ndryshme. Për këto çështje nuk dua të zgjatem. sepse karr shkruar në kujtime të tjera, por doëshiroj të vë në dukje se situata dhe gjendja në përgjithësi e popullit tonë duheshin pasqyruar dhe u pasqyruan në referat.

Italia fashiste në përpjekjet e veta për të përjetësuar okupimin e Shqipërisë, pësoi disfata. Për të përballuar situatat e vështira që iu krijuan, ajo u det.; rua të ndërronte një sére «kryeministrash». Caktoi Shefqet Vërlacin dhe e shkarkoi pas ca kohe, e, në vend të tij, vuri Mustafa Krujën. Por edhe këtë shpejt e hoqi; vuri pastaj Eqrem Libohovën, që s'le la as dy muaj dhe caktoi në vend të tij Maliq Bushatin. Këto ndërime të lakenjve ishin pasoja të krizës ideologjike, politike e ushtarake të pushtesit e të klasave shfrytëzuese, të disfatave të tyre që ishin rezultat i udhëheqjes së drejtë të luftës e të rezistencës riga Partia Komuniste e Shqipërisë, të formave organizative që krijoi ajo, i bashkimit të masave të gjera të popullit dhe i mbështetjes në traditat luftarake. patriotike, liridashëse dhe përparimtare të popullit shqiptar.

Në referatin që mbajta në Konferencë, kalimthi vija në dukje se lëvizja përparimtare komuniste brenda vendit tonë kishte filuar që në vitin 1928. Jashtë shtetit komunist shqiptarë kishin krijuar edhe një fraksion komunist në Komitetin e Çlirimit Nacional*. *(Në mars të vitit 1925 demokratët revolucionarë shqiptarë, që u larguan nga atdheu pas shtypjes së Revolucionit të Qershorit, formuan në Vj.enë organizatën demokratike Komiteti Nacional Revolucionar (KONARE), i cili, që nga prilli i vitit 1927, u quajt Komiteti i Çlirimit Nacional.)

Më tej në këtë referat shtjelloja historikun e lëvizjes komuniste në Shqipëri para 8 Nëntorit 1941, e sidomos u ndala në analizën e luftës të paparim që kishin zhvilluar grupet e ndryshme komuniste në Shqipëri, e cila nuk u kishte shërbyer lëvizjes komuniste dhe krijimit të Partisë.

Theksoja se kjo luftë joparimore ishte nxitur, sidomos, nga krerët trockistë, kurse shumë militantë të vendosur të këtyre grupeve kërkonin të unifikohej veprimtaria dhe lufta e tyre kundër okupatorit fashist.

Duke analizuar veprimtarinë e grupeve të ndryshme që miltonin në vendin tonë para formimit të Partisë, fola për karakteristikat, për të mirat dhe për të këqijat e tyre, për tendencat që i udhëhiqnin dhe i ushqenin ato. Por rreth kësaj analize këtu nuk do të zgjatem, sepse kam shkruar veçanërisht në kujtimet për Themelimin e Partisë.

Analiza që nei bëjmë veprimtarisë së ish-grupeve komuniste në Shqipëri, theksohej në referat, ka një rëndësi shumë të madhe për të sotmen e për të ardhmen. Partia që ne kemi krijuar e po e foreojmë dita-ditës, vërtet trashëgoi e po pasuron pareshtur, në baza të shëndosha marksiste, gjithçka të mirë që kishte lëvizja komuniste në Shqipëri para nëntorit 1941, por, në të njëjtën kohë, Partia jo në hodhi poshtë, dënoi e luftoi pandërprerë kundër të gjitha të metave, dobësive e shtrembërimeve të ish-grupeve komuniste.

Frymën e sëmurë të ish-grupeve e të elementëve grupashë Partia jonë e kishte ndeshur shpesh në veprimtarinë e saj, prandaj në referat, në mënyrë të veçantë, i bëhej një analizë e drejtë dhe një demaskim i thellë, sidomos, veprimtarisë keqbërëse të ish-kryetarëve të Grupit të «Të Rinjve», Anastas Lulës dhe Sadik Premtes, të cilët, megjithëse kishin aderuar në Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe me fjalë kishin premtuar se do ta braktisnin rrugën që kishin filluar, aia, në bashkëpunim me elementë të Grupit të «Zjarrit», me Niko Xoxin, me Aristidh Qendron e të tjerë, e vazhduan punën minuese kundër Partisë.

Lufta kundër elementëve grupashë ishte një orientim me rëndësi që ne e kishim theksuar që në Themelimin e Partisë dhe më pas, në një sërë mbledhjesh e aktivitetesh të rëndësishme të Partisë, e kishim analizuar dhe kishim marrë masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes. Megjithatë, theksohej në referat, edhe sot e në të ardhmen në asnjë rast nuk duhet nënçmuar rreziku i elementëve antiparti, trockistë ose i elementëve të hedhur jashtë Partisë. Ata do të për

piqen prapë ta godasin Partinë dhe vijën e saj, prandaj të jemi kurdohere' syhapur ndaj tyre e të mos lejojmë që përpjekjet e tyre të dëmtojnë Partinë tonë të re. Për këtë në referat, veç të tjerash, shtjelloja me hollësi edhe metodat që kishin përdorur e përdornin elementët grupashë. Shpjegimi i metodave dhe i formave që përdornin këta elementë për të neutralizuar veprimtarinë e Partisë dhe për të shturur radhët e saj, kishte një rëndësi të madhe për komunistët, sepse kështu do të rritej vigjilenca e do të bëhej e mundur që asnjë komunist e asnjë celulë të mos ndodheshin përballë të papriturave e të mos binin në kurthet e intrigat që përpiqeshin të thurnin grupashët.

Në referat shtjelloja edhe luftën e ashpër të Komitetit Qendror kundër Grupit të «Zjarrit», të cilin Partia, me të drejtë, e kishte konsideruar si një grup të lidhur me armikun. Si rezultat i kësaj lufte, ky grup, në prag të Konferencës së Parë të Vendit, ishte shpartalluar jo vetëm ideologjikisht e politikisht, por edhe organizativisht dhe kjo shkaktoi që elementët e tij të shëndoshë, të cilët pranonin vijën e Partisë, të shkëputeshin nga ky organizëm i okupatorit dhe të organizoheshin nën drejtimin tonë. Tërhiqja vëmendjen që, sikurse ishte vendosur, me këta të krijoheshin celula të veçanta, ku të merrnin pjesë edhe dy-tre shokë të pjekur, dhe atje të punohej për edukimin e tyre komunist, për të spastruar mbeturinat e barërave të këqija që kishin rrënjësuar në pikëpamjet e tare arqiomarksistët shqiptarë.

Kuptohet, çështjet e forcimit organizativ të Partisë në referat zinin vendin kryesor. Siç e thashë edhe më parë, ne erdhëm në Konferencë me një Parti të organizuar, me një Parti që kishte hedhur bazat e saj, që kishte krijuar celulat, dhe kjo ishte një çështje e rëndësishme. Nga këto celula kishin dalë edhe forumet udhëheqëse, komitetet e Partisë të qarqeve apo qarkorët, siç u thoshim atëherë atyre. Duke i bërë një analizë të hollësishme krejt punës së kryer për organizimin e Partisë, në referat vihej në dukje se Komiteti Qendror i Përkohshëm kishte bërë një punë të kujdesshme për t'i formuar e për t'i forcuar këto organizata dhe këto komitete, për Vi hedhur në luftë dhe për t'i shmangur nga një punë amorfe, ose nga një punë e mbyllur e sektare. Por, pa u dehur nga sukseset e arritura, në referat shtrohej me forcë para të gjitha organizatave e para të gjithë anëtarëve të Partisë detyra që të bënin të gjitha përpjekjet për forcimin dhe për zgjerimin e mëtejshëm të organizatave.

Tash që jemi në valën e Luftës Nacionalçlirimtare, theksohej në referat, detyra për forcimin e pareshtur të të gjithë Partisë, të çdo celule e organi udhëheqës, duhet konsideruar si detyrë e dorës së parë. Si në terren, ashtu edhe në repartet e njësitet partizane celulatat duhet të jenë në ballë të punës, të rritin pareshur rolin e tyre udhëheqës, asgjë të mos u shpëtojë vëmendjes e përgjegjësisë së tyre, të bëhen shpirti mobilizues e frymëzues për të gjithë. Po ashtu referati kështillonte që puna e cilitdo komunist duhej të ishte një punë me horizont të gjerë, që çdo komunist të kishte rreth vetes grupe simpatizantësh, me të cilët të punonte vijën dhe direktivat e Partisë dhe t'i udhëhiqte ata, dulce qëndruar vetë në ballë të aksioneve, me veprime të centralizuara dhe të vendosura. Nga një punë e tillë, theksoja në referat, jo vetëm celulatat e komunistët do ta luajnë si duhet rolin e tyre të pararojës, por, nën shembullin e tyre, do të rritet pandërprerë numri i celulave të reja e i anëtarëve të rinj në ato ekzistuese. Në mënyrë të veçantë në referat shtrohej detyra për zhvillimin dhe forcimin e celulave në klasën punëtore e në fshat duke theksuar se vetëm kështu çështja e Partisë dhe e Luftës Nacionalçlirimtare do të kurorëzohej me sukses.

Celulatat e Partisë duhet të përfshijnë gradualisht gjithë vendin, theksohej në referat, e sidomos një punë më e madhe në këtë drejtim duhet bërë në krahinat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut ku jemi më mbrapa.

Në referat ngrihej si një çështje me shumë rëndësi edhe problemi i përgatitjes së kuadrove, sepse kishim parasysh që kuadrat e parë të Partisë nuk kishin një kulturë të gjerë revolucionare. Ata nuk kishin pasur mundësi të zhvillonin, si në vendet e tjera, një luftë sindikale kundër borgjezisë kapitaliste e industriale dhe as të lexonin gjerësisht libra teorikë marksistë-leninistë për arsye se mjaft prej tyre ishin me një arsim shumë të ulët, ose sepse mungonte literatura. Prandaj, dulce theksuar këtë mungesë, në referat rekomandonim që të forcohej puna për të propaganduar teorinë marksiste-leniniste dhe të organizohej puna për studimin e një sërë veprash nga më të rëndësishmet, siç qenë Historia e Partisë Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik dhe disa vepra, si «Imperializmi, faza më e lartë e kapitalizmit» e Leninit, Referati i Dimitrovit në Kongresin e 7-të të Internacionales Komuniste e të tjera, që në ato kohë i kishim të pakta.

Ky studim, u theksua, sipas mundësive, mund e duhet bërë edhe në grupe e kurse kolektive, por kryesorja është që për lartësimin e tyre politik e teorik, shokët duhet të mësohen të studiojnë individualisht. Në këtë drejtim në referat goditja fort konceptin e hVaj të shfaqur aty-këtu se «tanfi na duhet pushka e jo libri». Pushka dhe libri, theksoja në referat, kanë rëndësinë e tyre të veçantë; ato ndihmojnë e forcojnë njëra-tjetrën, prandaj ne as i ndajmë e as do t'i ndaj më kurrë nga njëra-tjetra, sepse neve na duhen luftëtarë trima e të mençur që të dinë mirë sesi, përse e kundër kujt të drejtojnë pushkën. Porositëm të shtypeshin sa të ishte e mundur materiale dhe këto të ishin të konirolluara, të përgatitura, nga shokët që kishin disa dijeni teorike më shumë, por dijeni të shëndosha, të drejta. Për këtë ndihej nevoja të sigurohej një teknikë më e gjerë, e cila duhej vendosur në ndonjë vend të sigurt.

Në referat, lidhur me këtë çështje, theksoja me të madhe edhe nevojën e përgatitjes së kuadrove të rinj, komunistë dhe të paorganizuar në Parti, sepse mbanim parasysh që nuk ishim në dasmë, por në luftë. Lidhur me këtë duhej që të goditeshin ashpër shfaqjet sektare ndaj kuadrit të ri, të mbaheshin afër e të përkraheshin gjithë ata që shquheshin për trimërinë, guximin dhe pjekurinë e tyre, t'u besoheshin detyra me përgjegjësi dhe, sipas aftësive e cilësive, të vendoseshin në vendet ku mund të jepnin më shumë.

Komunistët duhej të ishin dhe kurdoherë kanë qenë në vijën e parë të luftës. Duke qenë në kr'ye, aty ku rreziku ishte më i madh, shumë prej tyre do të binin dëshmorë, sikurse edhe kishin rënë deri në atë kohë, të tjerë do të kalonin në ilegalitet, prandaj duhej medoemos të përgatiteshin zëvendësit e tyre. Gjithashtu me krijimin e çetave partizane dhe vullnetare, duhej të përgatiteshin kuadro politikë dhe ideologjikë, por edhe me njohuri ushtarake. Këta do të ishin edhe anëtarë partie, por edhe elementë patriotë, sepse në Konferencën e Pezës u theksua si një domosdoshmëri krijimi i mundësisë për pjesëmarrjen e elementëve më të përparuar të masave të popullit edhe në udhëheqje të luftës. Kjo donte të thoshte se lufta nuk ishte monopol i Partisë, prandaj as drejtimi konkret, komandimi i reparteve, nuk duhej të ishte monopol i saj. Partia duhej e do të udhëhiqte krejt luftën,

sipas vijës së saj, sipas programit të saj, por, në udhëheqjen e punës konkrete për zbatimin e këtij programi, do të viheshin në detyra drejtuese edhe elementë patriotë që njiheshin si nacionalistë, por dhe që njiheshin për pikëpamjet e tyre përparimtare.

Përveç problemeve të forcimit e të zgjerimit organizativ të Partisë dhe atij të përgatitjes e të lartësimit të kuadrove, referati një vëmendje të posaçme i kushtonte problemit të forcimit të paseshtur të unitetit të Partisë, pra, forcimit të njësisë së Partisë, siç shpreheshim në atë kohë. Ky unitet, nënvizoja në referat, duhej të farkëtohej në luftë kundër okupatorit dhe në diskutime parimore e të shëndosha që bëheshin në celulat dhe në komitetet për problemet që shtroheshin. Këto probleme duhej të shikoheshin edhe nga ana politike, edhe nga ana e zbatimit. Në qoftë se do të kishte kundërshtime për çështje politike, atëherë këto duhej të sqaroheshin dhe në fund të debatit të vendosej sipas mendimit të shumicës. Vendimin në këtë rast ishte e domosdoshme ta zbatonte edhe pakica. Në Parti, theksonim që në atë kohë, është e domosdoshme të ketë unitet mendimi dhe veprimi revolucionar, se nuk mund të lejonim fraksione dhe mendime ose qëndrime në kundërshtim me vijën e Partisë. Partia jonë, theksoja, është kundër fraksioneve, dhe këtë ne e kemi vërtetuar në gjithë veprimtarinë tonë.

Kjo do të thoshte se çështjen e unitetit në Parti, e, lidhur me këtë, çështjen e centralizmit, Komiteti Qendror i Përkohshëm e kishte pasur kurdoherë parasysh. Ai ishte përpjekur për ta zbatuar drejt në gdo rast dhe kishte arritur sukses në këtë çështje, megjithatë, kishte pasur edhe gabime e të meta, kishte pasur gjithashtu edhe vështirësi, sepse elementët grupashë kërkonin ta dabësonin këtë centralizëm me metodat dhe me pikëpamjet e tyre centrifugale.

Në referat i bëja një tablo të hollësishme punës së Komitetit Qendror të Përkohshëm që kishte zgjedhur Mbledhja Themeluese, vija në dukje analizat që kishte zhvilluar Komiteti ynë Qendror, metodën e stilit e punës të shokëve të zgjedhur, sukseset e arritura si dhe gabimet e dobësitë e vërejtura në punën e njërit apo të tjetrit shok.

Komiteti Qendror, theksoja ndër të tjera në referat, ka luftuar ta kryejë me ndërgjegje detyrën e tij, i ka ndjekur, analizuar e përgjithësuar ngjarjet e situatat, ka nxjerrë detyra e ka luftuar për zbatimin e tyre nga e gjithë Partia. Por, nënvizoja, veg te tjerash, edhe gjendja e luftës dhe e kushteve të rënda të terrorit fashist nuk na ka lejuar që të mblidhej më shpesh dhe i gjithë Komiteti Qendror.

Për këtë, përveç direktivave e orientimeve të herëpashershme që i dërgonte bazës, Komiteti Qendror i Përkohshëm u kishte lënë kompetenca dhe iniciativë komiteteve të Partisë të qarqeve, të cilat duhej të kishin një kontroll të fortë e të shëndoshë marksist-leninist mbi celulat, por t'i lejonin që edhe ato vetë të vepronin me iniciativë, vegse gjithmonë në mënyrë të organizuar, në bazë të direktivave të dhëna, e jo në mënyrë të shthurur. Veprimet duhej të ndiqnin njëri-tjetrin, t'i shkaktonin armikut humbje të rënda, kurse Partisë dhe masave t'u jepnin mundësi që të dilnin nga lufta me humbje sa më të pakta.

Duke e trajtuar më tej këtë problem, në referat nënvizoja se njësia e Partisë nuk dëmtohet e nuk rrezikohet vetëm nga elementët grupashë, antiparti etj. Partia gjithnjë ka qenë e do të jetë vigjilente dhe e pamëshirshme kundër tyre, por duhet kuptuar nga cilido, se uniteti i Partisë mund të dëmtohet edhe nga shfaqje e fenomene të tjera të huaja që i mbart njëri ose tjetri shok. Këto shfaqje duhen dalluar e goditur shpejt e në themel, sepse, po u lanë të trashen, dëmet do të jenë të mëdha. Kështu, në referat theksohej se një ndër këto shfaqje të huaja që ekzistonte në Partinë tonë të re ishte sektarizmi, i cili vinte më shumë nga një kuptim jo i shëndoshë i teorisë marksiste-leniniste dhe nga megalomania ose nga mbeturinat e kësaj së keqeje nga grupet e mëparshme, nga mosbesimi në forcën e madhe të popullit dhe në krijimtarinë e tij, nga mosbesimi tek elementët e klasës punëtore, dhe sidomos të fshatarësisë. E njëjtë, sektare, ishte edhe mbyllja e komunistëve në vetvete. Sektarizmi, nënvizoja, duket si diçka që e mbron Partinë dhe pikërisht se shfaqet si i tillë ai, po s'u godit, ka rrezik të zhvillohet më shumë, të bëhet një e keqe serioze, e të cenojë unitetin e Partisë, forcën vepruese të saj.

Partia jonë, natyrisht, ishte e re dhe në analizën që i bëja në referat veprimtarisë së saj që nga koha e themelimit e deri në Konferencën e Parë të Vëndit, theksoja se ishte dukur edhe fryma e

lokalizmit dhe ky lokalizëm e kishte burimin pikërisht në ato pikëpamje të gabuara sektare që i ruanin akoma disa komunistë që nga koha e grupeve. Të tilla pikëpamje ishin, për shembull, mosbesimi i komunistëve të njërit grup te komunistët e grupit tjetër, mosbesimi i Bisave te masat e gjera të popullit.

Natyrisht këtu plekseshin edhe pikëpamje të tjera borgjeze, mikroborgjeze e fetare, të cilat, në një rën ose në tjetrën mënyrë, ushtronin presionin e ndikimin e tyre edhe në ndërgjegjen e komunistëve. Në Veri ishin më të theksuara ndjenja e bajraktarizmit dhe influenca e klerit katolik - me propagandën e tij, tek i cill fashizmi kishte një bazë të mirë, kurse në Jug të Shqipërisë, e sidomos në Korçë, ndihej më tepër influenca e borgjezisë, si të thuash, pak a shumë industriale-tregtare, e bejlerëve dhe e agallarëve.

Lidhur me këto probleme kritikoja edhe konspiracionin e sëmurë, i cili, gjithashtu, e kishte burimin te puna e grupeve. Por theksoja se konspiracioni i vërtetë duhej të ekzistonte patjetër në radhët e komunistëve, se ndryshe armiku mund të godiste rëndë Partinë. Ky konspiracion, vihej në dukje në referat, duhet të ketë karakterin e vërtetë komunist të një lufte ilegale që përmban besimin në vete dhe te shokët, që mban brenda tij një punë këmbëngulëse për sqarimin e pikëpamjeve të njerëzve dhe bindjen se këta njerëz do t'i spastrojnë në veten e tyre pikëpamjet e gabuara që kanë pasur ose vazhdojnë të kenë akoma.

Kështu me një punë të vazhdueshme e të kujdesshme jo vetëm shokët do të lartësohen hap pas hapi, por njëkohësisht ata do të lidhen më shumë me njëri-tjetrin, do të rritet më tej uniteti brenda celulave e i të gjitha celulave së bashku, pra, i krejt Partisë. Kjo është e do të jetë garancia jonë më e madhe për të përballuar me sukses çdo goditje të armiqve të Partisë dhe, për të mobdizuar e për të udhëhequr më mirë popullin drejt kurorëzimit me sukses të luftës sonë.

Për të kryer sa më mire' detyrat e saj, ishte e domosdoshme që Partia të mos mbyllej në guaskën e një puni të ngushtë dhe sektare. Ajo duhej të kuptonte mirë edhe situatat ndërkombëtare, edhe situatat e brendshme kombëtare, prandaj në këtë referat për çështjet organizative, lidhur me organizimin e punës së Partisë, një vëmendje të veçantë i kushtoja forcimit të mëtejshëm të punës së Partisë me masat. Në këtë drejtim vërtet ishin arritur mjaft suksese, por kishte pasur edhe shfaqje sektare, të gabuara, nga shokët tanë komunistë në vende të ndryshme të atdheut. Këta duhet të kuptonin mirë se lufta kundër pushtuesit nuk mund të bëhej vetëm nga anëtarët e Partisë dhe nga simpatizantët e saj, por nga të gjitha forcat dhe shtresat që u dhimbsej çështja e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut.

Duke folur për këto probleme, në mënyrë të veçantë në referat theksohej domosdoshmëria e forcimit të punës së Partisë me klasën punëtore, fshatarësinë, rininë e gruan. Puna e Partisë me këto klasa e shtresa në Konferencë do të shtjellohej më gjerësisht në referate e në nënreferate të veçanta, prandaj, në referatin organizativ, më tepër trajtoja vijën e përgjithshme politike të Partisë në këtë drejtim, evidentojta arritjet kryesore dhe kritikoja e goaitja një sërë pikëpamjesh e praktikash të gabuara që pengonin e frenonin punën e Partisë me masat.

Forcimi dhe zgjerimi i gjithanshëm i punës së Partisë me klasën punëtore në referat nënvizohet si një nga detyrat më themelore e jetike të Partisë. Gjatë viteve të para të jetës së saj, Partia jonë, siç kam shkruar edhe më lart, i kishte goditur e i kishte hedhur poshtë pikëpamjet e praktikat e huaja të ish-grupeve që e nënvleftësonin ose e injoronin klasën punëtore në Shqipëri dhe, si rezultat i kësaj, qenë arritur një sërë suksesesh në lidhjet e Partisë me klasën punëtore. Por dobësi e të meta vëreheshin akoma jo vetëm në zbatimin konkret të vijës së Partisë me klasën punëtore, por edhe në rishfaqjen e pikëpamjes së gabuar e të shtrembër të ish-grupeve mbi mungesën e proletariatit në Shqipëri.

Në referat pikëpamje e arsyetime të tilla hidheshin poshtë, duke zbuluar edhe rrënjët e tyre e duke vënë në dukje dëmin që sillnin.

Për secilin duhet të jetë e qartë, nënvizojta midis të tjerash, se pavarësisht nga numri i klasës punëtore në Shqipëri, Partia jonë Komuniste lindi e po rritet si pararoja e organizuar e klasës punëtore, se në veprimtarinë e saj Partia jonë udhëhiqet nga ideologjia proletare, dhe është bërë

kështu mbrojtësja dhe shprehësja më e zjarrtë e ideologjisë proletare, e interesave të proletariatit dhe e të gjithë të shtypurve.

Që këtej lind nevoja që ta intensifikojmë më tepër punën me klasën punëtore për të krijuar ato lidhje organike që ekzistojnë e duhet të ekzistojnë midis klasës punëtore e Partisë së saj pararojë, të lidhemi organizativisht me masat punëtore, të cilat janë masat më përparimtare të vendit, më të shtypurat e më të shfrytëzuarat, të bëjmë që punëtorët të zënë vendin e merituar në Parti, në këshillat nacionalçlirimtarë, në çetat, në njësitet dhe në repartet e tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare që po organizojmë etj.

Këto ishin në vija të përgjithshme çështjet që ngrita në referatin organizativ për punën me klasën punëtore, por, siç do të shkruaj më poshtë, gjatë punimeve të Konferencës, për këto e probleme të tjera u zhvilluan debate e diskutime të shumta, të cilat i pasuruan më tej idetë e referatit.

Një vend të rëndësishëm i kushtoja në referat, gjithashtu, punës së Partisë me fshatin. Në këtë front të rëndësishëm të punës sonë ne qemë ndeshur e vazhdonim të ndesheshim akoma jo vetëm me pikëpamjet disfatiste të kohës së grupeve, por edhe me pengesa të tjera të shkaktuara si nga vetë vështirësitë që paraqiste puna në fshat, ashtu edhe nga përpjekjet e propaganda e reaksionit të brendshëm për të mashtruar masat fshatare, sidomos në një sërë zonash në Veri.

Partia duhet absolutisht të futet në fshat, pse fshatarësia përbën shumicën dërrmuese të popullit tonë dhe pikërisht aty është e do të jetë burimi i fuqisë kryesore për luftën që kemi përpara. Komunistët duhet të shkojnë e të punojnë në fshatra dhe me urtësi e mençuri ta bëjnë fshatarin me vete, ta inkuadrojnë në Front, ta inkuadrojnë në getat partizane dhe vullnetare dhe elementët më të mirë e më të shëndoshë t'i inkuadrojnë në Parti.

Duke i shtjelluar më tej këto probleme, nënvizojta se me një punë të madhe e të vazhdueshme, me propagandë konkrete e bindëse, por sidomos në zjarrin e luftës duhet të krijojmë e të forcojmë paseshtur aleancën, ose njësinë luftarake, siç i thoshim atëherë, midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, aleancë të cilën Partia e konsideronte si armën më të sigurt në Luftën Nacionalçlirimtare.

Për sa i përket punës së Partisë për organizimin e udhëheqjen e rinisë, në referat kritikojta sidomos tendencat e paralelizmit që dukeshin aty-këtu në format e punës të Organizatës së Rinisë Komuniste me ato të Partisë. Organizata e Rinisë Komuniste, theksoja në referat, s'duhet të mbyllet në vetvete, por të mobilizojë e të afrojë masat më të gjera të rinisë, nën drejtimin e Partisë. Ajo po bëhet e duhet të bëhet akoma më mirë bërthama e fortë e asaj organizate të gjerë që të përfshijë të gjitha masat e gjera të rinisë sonë antifashiste, trime e patriote.

Pasi vija në dukje edhe punën e Partisë me gruan, nënvizojta se kryerja me sukses e detyrave në të gjithë këta sektorë të rëndësishëm do të thotë që Partia të realizojë ashtu siç duhet detyrën e saj primordiale për lidhjet me masat, pa të cilat asnjë fitore nuk mund të arrihet. Pikërisht për këtë ne komunistët, vihej në dukje në referat, e kemi për detyrë që të futemi sa më shumë në masat, t'i lartësojmë ato, t'i mobilizojmë në luftë e të forcojmë paseshtur unitetin e tyre në kuadrin e Frontit Nacionalçlirimtar që udhëheq Partia.

Në shtjellim të këtij problemi, theksoja se Partia jonë në luftën që po organizonte kishte strategjinë dhe taktikat e saj, siç kishte edhe okupatori strategjinë dhe taktikat e tij. Strategjia dhe taktikat e okupatorit po dështonin njëra pas tjetrës, kurse strategjia dhe taktikat e luftës së Partisë sonë e të popullit shqiptar, fitonin hap pas hapi, pse Lëvizja Nacionalçlirimtare merrte çdo ditë, çdo muaj e çdo vit një hov të madh, hov që ishte përforcuar në Konferencën e Pezës. Për këtë Konferencë në referatin organizativ unë folja jo vetëm thjesht se si u organizua ajo, por sidomos për vijën politike dhe organizative që u shtrua atje, për mobilizimin e popullit dhe për krijimin e Frontit Nacionalçlirimtar e të këshillave nacionalçlirimtarë, ku duhej të merrnin pjesë komunistë dhe patriotë të çdo ideje, të çdo besimi, por që kishin për qëllim luftën kundër okupatorit dhe çlirimin e Shqipërisë.

Për Konferencën e Pezës kam shkruar gjithashtu kujtimet e mia, prandaj nuk do të flas këtu, vetëm dua të theksoj se vendimet e kësaj Konference për krijimin dhe forcimin e Frontit Antifashist

Nacionalçlirimtar, ne i kishim pasur në qendër të vëmendjes dhe kishim bërë mjaft punë për realizimin e tyre. Por, kuptohet, domosdoshmëria e bashkimit të mëtejshëm luftarak të popullit në Front, mbetet një detyrë e përhershme, prandaj edhe në referatin që mbajta në Konferencë, këtij problemi i kushtoja vëmendjen e duhur.

Fronti Nacionalçlirimtar, theksoja, është një front i gjerë antifashist dhe detyra e tij është grumbullimi e mobilizimi i të gjitha forcave: punëtorë, fshatarë, të rinj, të reja, patriotë, nacionalistë, në luftën e madhe e vendimtare për shporrjen e pushtetit të huaj. Kjo është detyra themelore e etapës në të cilën kalojmë dhe gjithë puna e Partisë, vija dhe parullat e saj duhet t'i shërbejnë forcimit të këtij fronti të brendshëm antifashist e mobilizimit të tij në çështjen e madhe të luftës.

Në referat theksoja edhe format organizative të Frontit Nacionalçlirimtar dhe të këshillave nacionalçlirimtarë që duhej të krijoheshin edhe në qytete, edhe në zonat e çliruara, domethënë në fshatra, kompetencat e detyrat e tyre dhe veçanërisht përmendja se në të ardhmen ato do të ishin forma të pushtetit të ri të demokracisë popullore. Prandaj theksoja që kompetencave dhe detyrave të Frontit Nacionalçlirimtar dhe të këshillave nacionalçlirimtarë ne duhej t'u vinim një rëndësi të madhe në çdo moment dhe ato të zhvilloheshin në rrugë të drejtë.

Në mënyrë të veçantë në këtë pjesë të referatit vija në dukje jo vetëm politikën e matur që kishte ndjekur Partia për të bërë për vete masat, por njëkohësisht kritikojta ashpër disa shfaqje e tendenca sektarizmi ose oportunizmi që ishin vënë re në praktikë.

Kështu, për shembull, kishte raste kur në punën me masat, e veçanërisht me nacionalistët, disa shokë tregoheshin sektarë e të ngurtë, dilnin me parulla të avancuara e që nuk përshtateshin me karakterin e luftës sonë në atë periudhë, si Luftë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Po aq të gabuara e të palejueshme ishin edhe rastet kur, nën preokupimin për të bërë për vece elementë të ndryshëm nacionalistë, disa shokë binin nën presionin e tyre dhe, në njërin ose në tjetrën mënyrë, nënvleftësonin rolin udhëheqës të Partisë në Front, shfaqnin prirje që Partia të shkrihej në Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Të dyja këto shfaqje, qoftë ato sektare, qoftë ato oportuniste, theksoja në referat, janë të dëmshme, e të huaja për Partinë tonë dhe për vijën e saj, prandaj të jemi vigjilentë e të matur, t'i bëjmë masat për vete, të grumbullojmë në Front të gjitha forcat që janë për luftë gjer në fund e pa kompromis, por në të njëjtën kohë të ruajmë si sytë e ballit individualitetin e Partisë në Front dhe të luftojmë përshtur për forcimin e rolit të saj udhëheqës.

Këto fenomene në referat, e më pas edhe në diskutimet, i theksuam me forcë, sepse ishim të bindur që gabimet duhej t'i vinim në dukje, të mos i fshihnim se, me fshehjen e tyre, Partia nuk mund të shëndoshej. Veç kësaj, ne duhej të nxirrnim mësim nga gabimet, përndryshe do të përsëriteshin ato e do të bëheshin të tjera dhe, kështu, do të pësonim humbje e disfata përpara armiqve që ishin të egër, dinakë, të sprovuar në dredhira dhe të armatosur deri në dhëmbë.

Në referat një analizë të hollësishme i bëja edhe politikës së drejtë që kishte ndjekur e ndiqte Partia jonë ndaj organizatës së Ballit Kombëtar.

Balli Kombëtar (siç e kam përshkruar edhe në kujtime të tjera, lidhur me punën me nacionalistët dhe me takimet që kam bërë personalisht me ta) u organizua me nxitim pas Konferencës së Pezës, si një krijesë e feudo-borgjezisë reaksionare, me qëllim që të grumbullonte rreth vetes sa më shumë forca e t'i vinte si një kundërpeshë ndaj Frontit Nacionalçlirimtar e këshillave nacionalçlirimtarë. Si pjellë e borgjezisë dhe e reaksionit fashist, kjo organizatë do të bënte ç'ishte e mundur që të pengonte zgjerimin e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar e, më pas, do t'i kundërvihej hapur e me armë kësaj lufte.

Por në atë periudhë, kur Balli akoma nuk ishte diskredituar politikisht, Partia bënte përpjekje për ta tërhequr në luftë, duke synuar të bënte diferencimin mes pjesëmarrësve në këtë organizatë. Prandaj në referat theksoja se duhej të bënim të gjitha përpjekjet për ta bindur Ballin Kombëtar që të bashkohej me Frontin. Sigurisht, nënvizohej në referat, midis elementëve që e përbëjnë atë, ne do të gjejmë edhe pengesa. Në radhët e kësaj organizate ka demokratë, të cilët duan të bashkohen me ne, por nuk i shkëputen dot ndikimit të krerëve reaksionarë, ndikim që ka ekzistuar edhe përpara.

Atje ka edhe njerëz të lëkundshëm, që nuk dinë nga të venë, prandaj ne duhet të lidhim marrëdhënie me këta elementë dhe t'i sqarojmë që këta vetë, me punën dhe me qëndrimin e tyre, t'i izolojnë krerët, mundësisht t'i shtrëngojnë që të mos bëjnë kompromise me armikun, e, nëse kjo nuk arrihet, t'u kundërvihen atyre hapur. Ne duhet të punojmë në mënyrë që faji të mos i mbetet kurrë Partisë, të tregojmë se nuk është Partia ajo që i shtyn ata të flirtojnë me armikun, përkundrazi, vija e Partisë Komuniste është vetëm vijë e luftës pa kompromis me pushtuesin e tradhtarët. Ky qëndrim i drejtë, parimor i Partisë ndaj elementëve të lëkundur të Ballit Kombëtar mund të mbahet përderisa ata nuk bashkohen me armikun. Çështja e madhe e luftës e kërkon që ne të jemi të kujdesshëm me këta elementë, të përpiqemi t'i bëjmë për vete, por edhe të ruhem, sepse ekziston edhe mundësia që ata të bashkëpunojnë ngushtë me armikun dhe të na luftojnë ne. Qëllimi i krerëve të Ballit Kombëtar është që ta shuajnë Luftën Nacionalçlirimtare dhe, në kahën e duhur, ata vetë të jenë më të fortë dhe të marrin fuqinë në dorë me ndihmën e okupatorëve. Por krerët e Ballit duhet ta dinë se ne kurrë s'do të lejojmë që të realizohen ëndrrat e planet e tyre. Nëse ata do të bashkohen hapur me okupatorin e do të na luftojnë, atëherë edhe ne do t'i luftojmë njëllëj si okupatorët e huaj.

Në lidhje me forcat e armatosura, partizane dhe vullnetare, të cilat pas Konferencës do të organizoheshin në Ushtrinë Nacionalçlirimtare, sido që kishte një referat të veçantë, në referatin për çështjet organizative që mbajta përpara Konferencës, fola në vija të përgjithshme se cilat ishin strategjia dhe taktika e forcave tona luftarake, sesi duheshin organizuar çetat dhe batalionet partizane e vullnetare, si duhej përsosur armatimi i tyre, duke luftuar dhe duke ia rrëmbyer armikut etj. Konferenca do të merrte vendime të rëndësishme për organizimin, forcimin dhe kalitjen e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, prandaj detyra jonë ishte që sektorit të ushtrisë t'i kushtonim vëmendjen e kujdesin më të madh e të bënim që me një vijë politike sa më të drejtë të mobilizoheshin në radhët e kësaj ushtrie masat e gjera të popullit.

Duke theksuar faktin se ushtria që po organizohej nga Partia do të ishte kurdoherë nën udhëheqjen e saj, në të njëjtën kohë nënvizoja se çetat ose batalionet partizane (të cilat më vonë do të bëheshin brigada, divizione e korparmata) në ato kohë nuk round të quheshin forca të armatosura të Partisë», siç bëhej gabim nga disa që i quanin kështu. Këtë gabim e shfrytëzonte reaksioni dhe Balli Kombëtar për të gënjyer masat e popullit, për t'u thënë atyre që «këtu lufton vetëm Partia Komuniste», qëllimet e së cilës «nuk janë për të mirën e atdheut», sepse ajo «është në shërbim të të huajve», «në shërbim të sllavëve», e të tjera shpifje të kësaj natyre. Prandaj duhej të mbaheshin parasysh orientimet që kishte lëshuar Partia në Konferencën e Pezës.

Kryesorja është, theksoja në referat, që gjithë Partia, çdo komunist e luftëtar t'i kuptojë drejt detyrat e mëdha që shtrou faza e re e luftës, kalimi drejt kryengritjes së përgjithshme të armatosur të popullit shqiptar. Pa dyshim për këtë një rol të madh do të luajnë analizat dhe vendimet që do të përcaktojnë Konferenca e Parë e Vendit e PKSH. Çdo komunist duhet ta ketë të qartë se sektori kryesor i punës së Partisë tash e tutje është ushtria, organizimi dhe forcimi i pareshtur i saj përmes betejave e përpjekjeve të vazhdueshme.

Këto, sa më kujtohet mua, ishin shkurtimisht mendimet kryesore që u shtruan në referatin e parë për çështjet organizative.

Veç këtij, në Konferencë u mbajtën edhe referatet e nënreferatet e tjera që ishin në rendin e ditës.

Në referatin për çështjet e politikës së jashtme ndërkombëtare tregohej si ishte zhvilluar e po zhvillohej lufta kundër nazizmit gjerman e fashizmit italian edhe nga ana e Bashkimit Sovjetik, Anglisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jugosllavisë dhe vendeve të tjera; në referatin për Luftën Nacionalçlirimtare e në atë për Ushtrinë Nacionalçlirimtare, që u mbajtën njëri pas tjetrit, u fol më gjerësisht për rrugën e luftës sonë gjer në ato momente, për repartet e çetat partizane që qenë krijuar e vepronin në të gjitha anët e vendit, për sukseset e arritura e dobësitë e vërejtura si dhe për detyrat e mëdha e të vështira që shtronte faza e re e kalimit drejt kryengritjes së përgjithshme të armatosur të popullit shqiptar. Veçanërisht problemet që kishin të bënin me organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë etj., në këto referate zunë një vend të dukshëm. Pas këtyre u mbajtën edhe referati për bashkimin luftarak të klasës punëtore me

fshatarësinë si dhe nënreferatet për punën me rininë, gruan e ai për problemet e financës e të konspiracionit në Parti.

Analizat, mendimet dhe idetë e referateve e të nënreferateve u pasuruan më tej nga diskutimet e debatet, të cilat ishin në atë lartësi që kërkonte një mbledhje e tillë e madhe dhe historike siç ishte Konferenca e Parë e Vëndit. Shokë të ardhur nga të gjitha qarqet, nga komitetet e Partisë, nga drejtimi i luftës, sekretarë partie dhe anëtarë komitetesh, diskutuan me zjarr dhe ngritën probleme të rëndësishme që kishin të bënin me organizimin e gjeratëhershëm të punës dhe me detyrat për të ardhmen. Diskutimet në shumicën dërrmuese ishin të mira dhe tregonin se sa ishin rritur e pjekur kuadrot e Partisë gjatë pak më shumë se një vit lufte e përpjekjesh.

Në aiskutimin e vet Hysni Kapoja foli konkretisht për problemet që kishte Partia në qarkun e Vlorës, vuri në dukje vështirësitë, të metat, por edhe sukseset. Ai u tregoi shokëve delegatë për aksionet e kryera dhe theksoi se këto e kishin lidhur edhe më shumë popullin me Partinë.

Hysniu nënvizoi, veçanërisht, rrezikun që i sillte punës ekzistenca e frymës së grupeve

- Ne, - tha ai, - kemi luftuar kundër kësaj fryme, por mund dhe duhej të bënim më tepër që populli ta njohë më mirë vijën e Partisë dhe të zhdukë çfarëdo influence të elementëve grupashë, si Xhepi me shokë, që e dëmtojnë atë. Po kështu duhet punuar më mirë për të afruar elementët pozitivë që janë akoma nën influencën e Ballit.

Në vazhdim të diskutimit të tij Hysniu ngriti në Konferencë një sërë problemesh të rëndësishme që kishin të bënin me politikën e Partisë me masat, veçanërisht me fshatin, rininë e gratë, me organizimin e këshillave nacionalçlirimtarë, si themelet e pushtetit të ardhshëm; me nevojën e propagandimit e të popullarizimit të Partisë si forcë e vetme udhëheqëse e popullit shqiptar etj.

Edhe shoku Mehmet Shehu, që ishte në atë kohë sekretar organizativ i Qarkorit të Vlorës, ngriti në diskutimin e tij disa probleme kyçe që preokuponin Partinë në ato momente, siç ishin zhdukja e veprimtarisë fraksioniste, likuidatore, puna me elementët nacionalistë, forcimi i Partisë etj. Mehmeti i Soli Konferencës për veprimtarinë e dëmshme të Xhepit e të pasuesve të tij dhe tregoi për punën që bëhej në Vlorë për të çrrënjësuar influencën e këtyre dhe të elementëve të Ballit. Ai e siguroi Konferencën se influencia e Partisë në Vlorë është absolute.

Mendime të vlefshme shfaqti në Konferencë Mehmeti edhe për çështjet ushtarake.

- Çetat partizane duhet të jenë aktive, vepruese, - tha, në mes të tjerash, Mehmeti. - Ato janë krijuar për luftë dhe jo për të bredhur fshatrave, siç ka ndodhur në ndonjë rast. Ka rëndësi që njësitet tona të përvetësojnë taktikën partizane, të kenë shpejtësi e befasi në veprime, të kenë iniciativë e shpirt sulmues.

Në vazhdim të diskutimit të tij Mehmeti, që kishte marrë pjesë me armë në dorë në Luftën e Spanjës, solli në Konferencë një eksperiencë të vlefshme, sidomos lidhur me rrezikshmërinë e elementëve trookistë dhe për punën e Frontit Popullor atje.

- Edhe në luftën tonë, - tha Mehmeti, - Fronti Nacionalçlirimtar është forma kryesore e bashkimit të popullit për luftë kundër zaptuesve. Por në Front duhet ta ruajmë si sytë e ballit udhëheqjen e Partisë, ta popullarizojmë atë pareshtur.

Problemeve që kishin të bënin me punën e Partisë me masat dhe me rritjen e rolit të saj udhëheqës, Konferenca me të drejtë u kushtoi një vëmendje të madhe. Si në referatin që mbajta unë, ashtu edhe në diskutimet e shokëve të tjerë, u theksua me forcë se vërtet Partia duhej të futej në masat, vërtet duhej të zhvillonte një politikë të matur e të kujdesshme në Front, por kjo kursesi s'do të thoshte që të lejohej të humbiste individualiteti i Partisë, të cenohet roli dhe personaliteti i saj si forca e vetme udhëheqëse në vend.

E theksuam këtë jo thjesht për «teori», por për faktin se në atë periudhë, siç përmenda edhe më lart, disa elementë oportunistë e të lëkundshëm, në njërën ose në tjetrën mënyrë, përpiqeshin ta goditnin Partinë si «majtiste» e «sektare».

Një ndër këta elementë ishte edhe Koço Tashkoja. Ashtu si para themelimit të Partisë, edhe pas saj ai vazhdonte të na sillte shpesh pengesa e telashe. E manifestonte fare hapur pakënaqësinë

që Partia nuk e kishte zgjedhur në asnjë forum të saj në qendër e në bazë, e për këtë, bënte ç'ishte e mundur që të «na zinte në gabime» e të na «vinte para përgjegjësisë».

Njëherë, pak kohë pas Konferencës së Pezës, m'u afrua rëndë-rëndë e më tha:

- Vija që ndjek Partia me nacionalistët nuk është e drejtë, është shumë sektare.

- Ku e mbështet këtë që thua? - e pyeta.

- Po ja, - tha, - të gjithë e kanë marrë vesh se krejt punën në Front e në luftë e udhëheq Partia Komuniste, se ajo e organizoi Konferencën e Pezës, ajo po vihet në krye të luftës, ajo...

- Po ç'të keqe ka në këtë mes? - e pyeta. Kështu është e vërteta.

- Mirë, mirë, - vazhdoi Koçoja, - por duhet politikë elastike. Emri i Partisë Komuniste i trerëb nacionalistët, ata nuk e kuptojnë dot atë dhe prandaj nuk afrohen në Front patriotë të tillë, si Mehdi Fr tshëri, Muharrem Bajraktari, Shefqet Vërlaci, Kaloshët e të tjerë.

- Kurrë le të mos afrohen të tillët! - i thashë me zemërim. - Ne e kemi bërë dhe po e bëjmë punën tonë me nacionalistët e vërtetë, me ata që u dhimbset vërtet çështja e lirisë dhe e pavarësisë së Shqipërisë. Sa për ata që përmende ti, dije mire', jo që s'kanë për t'u afruar kurrë me ne, por janë haptazi kundër nesh, kundër popullit. Ata janë armiq.

- E ke ga~bim, - tha ai, - dhe unë s'mund të pajtohem me këtë mendim.

- Mirë, - i thashë, - ti je komunist, mua ma the, shtroje edhe në celulën tënde dhe dëgjo edhe mendimin e shokëve.

- Jo, - tha, - në celulë zor të më kuptojnë. Do t'i bëj një letër Kominternit. E kam menduar me kohë këtë se kam edhe probleme të tjera për t'i shtruar.

- Mirë, - i thashë, - shkruaji Kominternit e kujt të duash.

Pas disa ditësh ma dorëzoi vërtet letrën për Kominternin, duke më thënë:

- Duhet t'ia dërgosh patjetër Qendrës!

- Sapo të hyjmë në lidhje me të, do t'ia nis, e sigurova.

- Lexoje dhe vetë, - më tha. - Është çështje «pikëpamjesh», s'ka ndonjë gjë të keqe...

«Raporti» i Koços ishte pasqyrë e vërtetë e shpirtit të tij prej oportunisti dhe njeriu të lëkundshëm, Jo vetëm për qëndrimin ndaj nacionalistëve, por edhe për vetë karakterin e luftës sonë na akuzonte se ndiqnim një vijë «sektare», «majtiste».

Ishte po ai Koço që, në një rast tjetër, më pas (me sa mbaj mend në Konferencën Nacionalçlirimtare të Labinotit, në shtator 1943), besnik i vijës së tij për një «luftë të butë», shkaktoi ilaritet në sallë, kur u ngrit e lëshoi shprehjen: «Lufta të bëhet me sa më pak gjak, mundësisht pa gjak fare». Kështu e priste ai çlirimia atdheut: Ta «bombardonim» armikun me trakte e zne diskutime, në një kohë kur fjalën në qytetet e në malet e Shqipërisë e kishte marrë pushka e mitralozi! E pikërisht për këtë, ne qemë «majtistë» për Koço Tashkon!

Por, ndërsa ne prisnim që të na vinte njohja nga Kominterni, ngjarjet u rrokullisën me shpejtësi dhe «patriotët e nderuar» të Koço Tashkos po e tregonin hapur fytyrën e tyre të vërtetë prej armiqsh të betuar të Partisë, të popullit, të Frontit tonë Nacionalçlirimtar.

Më erdhi një ditë Koçoja, e, me një pamje të pencTuar, më tha:

- Mos e dërgo atë letrën. Isha i gabuar në pikëpamjet e mia, e tërheq.

Bisedova me të dhe m'u duk se vërtet e kishte ndier gabimin. Sido që ai ruante pakënaqësitë dhe takonet e vjetra, ne përpiqeshim ta ndihmonim, të pastrohej e të revolucionarizohej në luftë e sipër, të bëhel i vlefshëm për çështjen. Edhe në Konferencën e Parë të Vëndit ne e ftuam atë, bile i dhamë edhe fjalën. E nisi me «autokritikë» për pikëpamjet që kishte shfaqur në «letër» (natyrisht pa përmendur këtë fakt); por nuk kaloi gjatë e i dha shkak një debati që vazhdoi gjatë: nxori teorinë e «të vjetërve» e «të rinjve», duke teorizuar se «të vjetrit (ku kishte parasysh natyrisht veten) vërtet kanë ca kusure, por edhe të rinjtë kanë gabimet e veta», se «të rinjtë janë të prirë nga e majta», se «të vjetrit s'duhën lënë mënjane» etj.

U ngritën njëri pas tjetrit një numër shokësh e ia hodhën poshtë këtë «teori».

Midis tyre përshtypje të thellë më bëri diskutimi i pjekur, prej proletari të vërtetë e të ndershëm, i Vasil Shantos.

Pasi foli në frymë të thellë autokritike për gabimet e dikurshme të Grupit të Shkodrës dhe trajtoi një sërë problemesh të punës në periudhën pas Themelimit të Partisë, Vasil Shantoja theksoi:

- S'jam aspak dakord me ndarjen në «të vjetër» e në «të rinj», e as me mendimin se të vjetrit nuk përfillen, apo «janë lënë mënjanë». Këto janë teorizime boshe. Në Parti të gjithë jemi të rinj, - vazhdoi M dhe shtoi: - Shokët e rinj, të zgjedhur në udhëheqje kanë ditur ta drejtojnë mirë Partinë, i kanë dhënë gjak e ritëm të ri punës së saj.

Kishte momente gjatë seancave, ku shpërthenin debate të fuqishme, të cilat vërtet sikur «e prishnin» pakëz rregullin, por e eletrizonin atmosferën e shën. doshë të Konferencës.

Ishte duke diskutuar Gjin Marku. Pjesën më të madhe të diskutimit të tij e përqendroi në punën e në luftën e zhvilluar në malësitë e Skraparit e të Beratit, ku, siç dihet e siç kam shkruar edhe më lart, me të vërtetë lufta kishte marrë një zhvillim shumë të madh. Sa për punën e Partisë, në qytet e veçanërisht në Kuçovë, qendër e rëndësishme naftëtarësh, Gjini e kaloi fare rrëshqitazi, duke thënë se «tanfi po përpiqemi të hedhim edhe atje baza».

- Pse tani? - e ndërpreu që nga vendi ku ishte ulur «Isoja», shoku ynë i shtrenjtë Kozma Nushi dhe vazhdoi: - Të gjithë e dimë se në Kuçovë ne kemi pasur baza të mira që para Themelimit të Partisë, bile qysh para pushtimit fashist.

-Ne s'kemi gjetur një punë të organizuar atje, - u përgjigj Gjin Marku.

- Varet se kur dhe sa keni shkuar në Kuçovë! - ia ktheu Kozmai, dhe vazhdoi: - Po të rrish vetëm në malet e Skraparit, s'do mend, Kuçovën mund edhe «të mos e zbulosh» fare. Por jam i bindur se as realiteti në Kuçovë s'është ashtu si thotë shoku dhe as detyrën e Partisë në lidhje me naftëtarët ai s'e ka kryer. Naftëtarët, t'janë ndeshur me regjimin e Zogut e me koncesionare't italianë që më 1936, prandaj është detyra jonë t'i ngremë të gjithë ata menjëherë në ballin e luftës së madhe e të përgjithshme, duke filluar që nga sabotimet në nxjerrjen e naftës e gjer në pjesëmarrjen masive në repartet partizane. Kështu vîhet në vend direktiva e përhershme e Partisë që po e rrahim edhe këtu për një punë më të madhe në punëtorët.

Konferenca këtij problemi, me të drejtë, i kushtoi një vëmendje të posaçme dhe kjo kishte arsyet e veta për të cilat fola më lart, gjatë paraqitjes që i bëra referatit për problemet organizative. Edhe në Konferencë Ymer Dishnica, për shembull, me maninë që kishte «për të filozofuar» mbi gjërat, në një diskutim tha se në Shqipëri nuk ekziston një proletariati «në kuptimin marksist të fjalës»(!). Po ashtu Tuk Jakova, në referatin që mbajti «Mbi bashkimin luftarak të punëtorëve e të fshatarësisë», duke u nisur nga fakti që shumicën dërrmuese të popullsisë në Shqipëri e përbënte fshatarësia, e se klasa punëtore ishte e paktë në numër dhe «e pazhvilluar» tha se më tepër në Shqipëri ekziston «një gjysmëproletariat» dhe përsëriti teorizimin e Ymer Dishnicës mbi «mungesën e proletariatit».

Me ndërhyrjet e diskutimet e shumta, ashtu si unë edhe shumë shokë iu kundërvunë pikëpamjeve të gabuara që përmenda më lart dhe plotësuan më mirë idetë e referatit.

Kështu, pikëpamjen se në Shqipëri «nuk ekziston një proletariati në kuptimin marksist të fjalës», Konferenca e hodhi poshtë si një gabim që vinte nga mosnjohja e reatetit dhe nga tendenca për «filozofime» boshe.

Realiteti është se në vendin tonë vërtet nuk ka një proletariati industrial, theksuam midis të tjerash, por kjo s'do të thotë aspak se nuk ekziston klasa punëtore. Në Shqipëri ka një numër qendrash punëtore, si në Kuçovë, në Selenicë, në miniera të tjera, në sektorin e ndërtimeve, në një sërë punishtesh e fabrikash të vogla etj. Kështu, në vendin tonë ekziston proletariati që shtypet e shfrytëzohet nga borgjezia e mëparshme e nga borgjezia e re që po lind si dhe nga shoqëritë koncesionare italiane, të cilat, pas pushtimit fashist, janë bërë padrone jo vetëm të fushave të vajgurit, por të të gjithë Shqipërisë.

Duke sjellë këto argumente, u theksua se me formimin e Partisë, klasa punëtore e gjithë të shtypurit po fitonin ndërgjegjen si klasë, po përqafonin vijën e Partisë, e cila shprehte e mbronte interesat e tyre dhe po e forcanin pareshtur unitetin e tyre në kuadrin e Frontit Nacionalçlirimtar që udhëhiqte Partia.

Kështu, përmes debatesh të zjarrta, me pjekuri e me vigjilencë të lartë po i analizonte Konferenca problemet e mëdha që qëndronin në rend të ditës.

Si atmosfera brenda sallës në të cilën zhvilloheshin punimet e Konferencës, ashtu dhe ambienti dhe kushtet jashtë sallës, ishin normale dhe të sigurta. Shokët, e në veganti ata të Elbasanit, i kishin marrë të gjitha masat që asgjë të mos e kërcënonte sigurinë dhe qetësinë e Konferencës. Konspiracioni që i fortë, por edhe njësitet partizane qëndronin në gatishmëri e kishin zënë shtigjet nga mund të vinte armiku. Shokët e ngarkuar për përgatitjen e sallës së mbledhjes e për sistemimin e delegatëve, e në mënyrë të veçantë, i zoti i shtëpisë së Bahollëve ku bëme mbledhjen, shoku ynë Sami Baholli, si dhe banorët e fshatit na krijuan një atmosferë të ngrohtë e të përzemërt.

Në pushimet e seancave, në kohë të lirë, çlodheshim, rrinim e bisedonim. Nuk mungonin as këngët, as humori e shakarat. Më tepër se kushdo në qendër ishte Mustafa Kagaçi, të cilin kush e kush ta tërhiqte pranë, sepse të gjithë e donin për humorin e zgjuar që i bënte shoqëri trimërisë së tij.

- Vajtimin, vajtimin! - i luteshin Mustafait shokët në një pushim midis seancave të Konferencës.

- Çfarë vajtimi! - kundërshtonte Mustafai. Tash duhet të këndojmë!

- Vajtimin e Jakovit, - këmbëngulnin shokët.

Mustafai kishte marrë pjesë në Lëvizjen e Fierit të vitit 1935, por, siç dihet, ajo lëvizje dështoi para se të fillonte mirë dhe Mustafain e një numër pjesëmarrësish të tjerë Zogu i dënoi me vdekje. Patriotin Hekuran Maneku e varën, por, më pas, nën presionin e opinionit publik, Zogu u detyrua që të dënuarve të tjerë t'ua kthente dënimin me vdekje në burgim të përjetshëm.

Shokët kishin dëgjuar se edhe në momentet Erënda, kur prisnin ekzekutimin e dënimit me vdekje, Mustafai në qeli, ku rrinte me dy të dënuar të tjerë, njërin nga të cilët e quanin Jakov, gjente forca për të mbajtur lart moralin e shokëve, vazhdonte me shakara. Improvizonte skenën pas vdekjes së Jakovit.

«Shtrihu Jakov», - i thoshte.

«Mos, Mustafa», - i lutej ky.

«Hajt, hajt, - këmbëngulte Kaçaçi, - kollaj u ngrite kundër Zogut, ti! Shtrihu të të qajë nana!».

E shtrinin Jakovin dhe Mustafai i përkulej te koka e ia niste:

«Po qysh të vranë, o Jakov! Po ç'deshe ti more bir, të dilje kundër mbretit! Po pse me 4-5 veta. vriten mbretërit e mbretëritë more ditëzi?! Po nuk ua dëgjuam mirë as krismën pushkëve more Kovi O bir, o bir, nuk vritet kështu mbreti qafir...etj., etj.

Pikërisht për këtë skenë i luteshin delegatët Mustafait, e ky... ç'të bënte? Lidhte një shall në kokë dhe ia niste «vajtimin». Shokët bashkë me «të vdekurin» gajaseshin së qeshuri.

Edhe në Konferencë, kur u tha emri i Kaçagit për të diskutuar, nëpër sallë kaloi një e qeshur e lehtë. Mustafai shkoi te vendi ku mbaheshin diskutimet dhe në vend të letrës nxori... një paketë cigaresh «Diamant». Plasi e qeshura. Ai s'e prishi fare terezinë, po filloi diskutimin në bazë të pikave që kishte shkruar në anën e prapme të paketës. Dhe shokët e pritën mirë diskutimin e tij serioz, por që nuk i mungonin dhe batutat me një ironi therëse, kur foli se si e kuptonin komunizmin në të kaluarën ai vetë dhe disa të tjerë.

Mustafai «kishte gjetur» edhe mënyrën për ta bërë të padëmshëm Ballin! E shoh një ditë në mes një grupi shokësh që qeshnin me të madhe. U afrova dhe një nga shokët më tha:

- Shoku Taras, Kaçaçi e zgjidhi çështjen e Ballit.

- Po si? - e pyeta dhe pashë nga Mustafai.

- Më jepni nja dyzet dhen? - më tha.

- T'i japim, - iu përgjigja duke qeshur, - po ç'i do?

- Do t'i marrim me vete e do të nisemi. Sapo të shoh një grup ballistësh, frap do të lëshoj nja dy. Ata, merret vesh, do të sulen pas tyre. Do të shkojmë më tutje. Sa të shohim ballistë të tjerë, frap do të tjera. E kështu me dyzet kokë mund t'i shpar'tallojmë, sa herë na ndjekin.

I tillë qe Mustafai, heroi nga Kruja: i shkathët, ~gazmor, njeri i shakarave, por po aq trim, i sakrificës, i vetëmohimit, cilësi që i shfaqti me punën e me luftën e tij, derisa ra për atdheun dhe për idealet komuniste.

Kjo atmosferë e lirshme, shoqërore, e gëzueshme, me në pushimet midis seancave, na çlodhte e na përtërinte forcat për të vazhduar gjer në fund e për të kurorëzuar me sukses punimet e Konferencës. Hynim në sallë e nisnin përsëri analizat, debatet, diskutimet.

Një vend të veçantë i kushtoi Konferenca edhe 'punës së madhe që duhej të bënte Partia me gratë dhe me vajzat e popullit tonë. Kjo ishte një forcë Kolosale, që nuk duhej lënë në asnjë mënyrë jashtë luftës. Pikëpamja e drejtë e Partisë sonë për këtë problem duhej ngulitur mirë te të gjithë shokët, pse, edhe në Konferencë, u ngritën zëra, si i Naxhije Dumes, që tha se nuk duhej të dërgonim gra e vajza në çetat partizane, sepse mund të na ngjisnin skandale (!) e se për shoqet lufta do të ishte një barrë e rëndë (!) etj.

Natyrshisht, prapa «kujdesit» e «merakut» të kësaj shoqeje fshiheshin pikëpamjet e saj të gabuara, që më vonë i thelloi e i nxori sheshit. Në të vërtetë krejt ndryshe e shtronte Partia problemin për gratë e vajzat dhe realiteti i luftës po vërtetonte drejtësinë e vijës së Partisë. Partia rekomandonte që kudo gratë të zgjoheshin nga letargjia shekullore, dhe këto hap pas hapi po merrnin armët në dorë për lirinë e atdheut, po hapnin shtëpitë për partizanët dhe ilegalët, po mësonin e po edukoheshin në luftë e në aksione pse kështu do ta fitonin barazinë në një atdhe të lirë, të çliruar, me një Parti të klasës punëtore në krye.

Shumë nga shokët e shoqet që morën fjalën në Konferencë, krahas vlerësimit të vijës së Partisë për gratë e vajzat dhe evidentimit të punës së kryer, me argumente e me shembuj konkretë, e hodhën poshtë pikëpamjen e Naxhije Dumes.

Bile, Pilo Peristeri, të cilin në atë kohë e kishim dërguar në Mokër si komisar në çetën eatjeshme partizane, sapo Naxhija tha se «s'duhet t'i çojmë shoqet në çeta. ..», u ngrit e i deklaroi Konferencës:

- Nuk jam aspak dakord me pikëpamjen e shoqes. Morali i partizanëve tanë është shumë i lartë, prandaj në Mokër shoqet mund të vijnë menjëherë dhe do të priten me krahë hapur nga populli e nga partizanët.

Rreth këtij problemi diskutoi edhe Nexhmija.

- Të gjitha lëvizjet çlirimtare në Shqipëri, e në mënyrë të veçantë Lufta e sotme Nacionalçlirimtare, u detyrohen shumë edhe grave e vajzave shqiptare, - tha ndër të tjera Nexhmija, dhe solli një sërë shembujsh nga heroizmi i gruas shqiptare në shekuj. Por roli dhe vendi i gruas në luftë, - vazhdoi ajo, kurrë ndonjëherë s'është parë me kaq vëmendje e s'është vlerësuar kaq lart, siç po ndodh tani që ne kemi në krye Partinë tonë Komuniste. Të ndriçuar e të përkrahura nga Partia, gratë dhe vajzat po e rritin pandërprerë aktivitetin e tyre politik dhe unë nuk e teproj aspak kur them se shoqet përbëjnë një ndër shtyllat e fuqishme të Partisë e të Luftës Nacionalçlirimtare.

Duke i sjellë Konferencës eksperiencën e punës e të luftës së grave e të vajzave të Tiranës, Nexhmija theksoi se jo vetëm veprimtaria luftarake e shoqeve është vazhdimisht në rritje, por edhe sjelljet e tyre kanë qenë e janë shembullore.

- Në këtë drejtim, - nënvizoi ajo, - detyra jonë është që t'i aktivizojmë e t'i organizojmë sa më mirë e sa më shpejt shoqet, t'i ndihmojmë e t'i trajtojmë ato njëllor si edhe burrat. Është e vërtetë, vazhdoi më tej Nexhmija, - që vetë ne, gratë dhe vajzat, me luftën e me punën tonë do të afirmohemi më tepër si një forcë e madhe luftarake, por edhe shokët duhet të punojnë më tepër në këtë drejtim. Ka raste, - vuri në dukje ajo, - kur pupa me gratë ngandonjëherë quhet si «monopol» i vetë grave, ashtu siç ka edhe raste, kur gratë tënvleftësohen e puna ime to monopolizohet nga shokët.

Që të dyja këto praktika janë të gabuara. Në Oshtjet e Partisë e të luftës, të gjithë jemi të barabartë dhe detyrat duhet t'i kryejmë bashkërisht, si shokë -e shoqe të një ideali e të një qëllimi.

Edhe për rininë, sidomos për rininë shkollorë, u ndie ndonjë zë në Konferencë, si ai i Pandi Kristos (i cili më vonë tradhtoi e u shporr nga Partia), se ne nuk duhej ta nxitnirn rininë studenteske të dilte në zmal e në çeta partizane, pse këtë na dashkej edhe arniku, që të braktiseshin shkollat dhe t'i

mbyllte ato. (!) Ky ishte një kuptim i gabuar edhe krejt i cekët për sa i përket rolit të madh të rinisë dhe të luftës që duhej të bënte ajo, prandaj Konferenca me të drejtë i hodhi poshtë këto pikëpamje.

Shumë nga shokët, si Nako Spiru, Ramiz Aranita

si. Kahreman Ylli e të tjerë, u ngritën dhe e hodhën poshtë edhe këtë pikëpamje, duke theksuar se as luftës, as Partisë nuk kanë ç'u duhen diplomat e shkollave ku mësohet kultura e Xhiros dhe e hierarkëve të tjerë të fashizmit. Vetë rinia shkollore nuk i donte këto diploma. Diploma tani merrej në mal, në luftën për liri e pavarësi.

Në mënyrë të veçantë Nako Spiru, si në nënrefe ratin për punën me rininë, që mbajti në Konferencë, ashtu edhe me diskutimet e ndërhyrjet e tij gjatë zhvillimit të debateve, u bëri një trajtim të gjerë problemneve të punës së Partisë me rininë, të organizimit dhe të mobilizimit të saj në çështjen e madhe të luftës kundër pushtuesit fashist, të rolit udhëheqës të Partisë në organizatën e rinisë, të detyrave që shtronte Partia para rinisë etj.

- Dëshira dhe vullneti i mbarë rinisë shqiptare për të luftuar kundër pushtuesit fashist, - tha ndër të tjera Nako Spiru, - janë të papërkulur. Ata i ndien e i sheh kushdo. Rinia po mbush radhët e çetave partizane, ajo merr pjesë trimërisht në njësitet gueril_e nëpër qytete e fshatra, ajo po jep një kontribut të shquar me gjakun e saj, por edhe me punën e madhe që bën për të propaganduar vijën e Partisë në radhët e veta e në masat e gjera të qytetit e të fshatit.

Rinia i bën këto me ndërgjegje e devotshmëri, vazhdoi Nakoja, - sepse ajo e do atdheun, e do popullin e Partinë, e do komunizmin. Tjetër rrugë për realizimin e dëshirave e të aspiratave të rinisë, veç rrugës së Partisë nuk ka, prandaj rinia po mobilizohet e po shtrëngon radhët rreth Partisë.

Duke hedhur poshtë pikëpamjen që «rima shko= llore të mos marrë pjesë në çeta» Nako Spiru theksoi se me këtë pikëpamje as është pajtuar e as mund të pajtohet kurrsesi rinia shkollore. Përkundrazi, vuri në dukje ai, rinia përditë e më tepër po braktis shkollat e po mbush radhët e çetave e të reparteve partizane.

- Dëshira e rinisë shkollore, ashtu si e gjithë rinisë sonë, është lufta me armë për lirinë e përparimin e atdheut, - theksoi Nakoja, - ndaj ne duhet ta përkrahim e ta tërheqim rininë në këtë luftë finale, ku ajo po jep e do të japë akoma më shumë kontributin e saj edhe me forcën e trimërinë që e karakterizon, por edhe me ndërgjegjen e saj të pastër, me fjalën e zjarrtë, me aftësinë që ka për ta përvetësuar shpejt të renë e për t'ua transmetuar atë edhe të tjerëve.

Se sa të drejtë kishte Konferenca që mbrojti një vijë të tillë në lidhje me rininë shkollore dhe ç'vlera patën vendimet e rëndësishme që u morën atje, shumë shpejt do ta vërtetonte, midis shumë e shumë ngjarjesh, edhe aksioni i bujshëm i normalistëve të Elbasanit, për të dalë hapur e në mënyrë të organizuar në mal. Forca frymëzuese e vendimeve të Partisë, puna plot iniciativë, mençuri e këmbëngulje e shokëve të Qarkorit të Partisë dhe e shokëve të Qarkorit të Rinisë Komuniste të Elbasanit, me në krye të riun trim e të papërkulur Alqi Kondin, bëri që më 1 Maj 1943 rreth 100 nxënës të klasave të fundit të Normales së Elbasanit të braktisnin shkollën dhe, në mënyrë të organizuar, qysh atë ditë ata u hodhën në mal. Ky aksion, që ishte vazhde e veprimeve të tilla të mëparshme, u pasua menjëherë nga aksione të tilla edhe në Liceun e Korçës e në shkollat e tjera të vendit.

Jeta po konfirmonte, pra, se sa të drejta, sa frymëzuese e mobilizuese ishin vendimet e Konferencës. së Parë të Vendit, e cila, siç thashë, i zhvilloi punimet nga fillimi gjer në fund me një frymë të lartëpërgjegjësie, me shpirt të zjarrtë militant. Referatet dhe diskutimet e pjekura të shokëve e bënë Konferencën me të vërtetë një shkollë të madhe partie, ku u rrah vija e Partisë, dhe u përcaktuan detyrat që duhej të kryheshin më pas.

Në Konferencë iu dha fjala edhe Bllazho Jovanoviçit, të deleguarit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ai tha se sillte përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, të të gjithë popujve të Jugosllavisë, që luftonin kundër okupatorëve, sillte solidaritetin e tyre me Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe me luftën heroike të popullit tonë. Ai, gjithashtu, shprehu gëzimin për njohjen e Partisë sonë nga Kominterni.

Bllazho Jovanoviçi në fjalimin e tij përshëndeti luftën dhe sukseset e Partisë sonë. Ai çmoi luftën që kishte bërë Partia jonë kundër elementëve grupashë, i theksoi këta si të rrezikshëm për unitetin e Partisë dhe pastaj tregoi shkurtimisht eksperiencën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në zhvillimin e luftës dhe në organizimin e saj.

Në Konferencë e mori, gjithashtu, fjalën edhe shoku ynë i shtrenjtë, internacionalisti jugosllav, Miladin Popoviçi. Diskutimi që bëri në Konferencën e Parë të Vendit ishte i pjekur dhe mendimet e tij ishin të drejta. Me vlerësimin e lartë që i bëri në Konferencë punës së Partisë sonë, ashtu si edhe më parë e më pas, ai e tregoi veten se qe një komunist i vërtetë internacionalist, një mik i dashur e i sinqertë i Partisë e i popullit tonë.

Midis të tjerash, në mendje më ka mbetur edhe një moment tjetër gjatë Konferencës që tregon më së miri se kush qe Miladin Popoviçi. Në përshëndetjesn e tij Bllazho Jovanoviçi, pasi vlerësoi punën dhe veprimtarinë e Partisë sonë Komuniste, foli edhe për Miladinin e Dushan Mugoshën dhe në njëfarë mënyrë bëri aluzion se këta ishin «krijuesit» (!) e Partisë sonë. Miladini, si internacionalist, duke qenë kundër pikëpamjeve të olla, në ndërhyrjen e tij, theksoi:

- Askujt nuk duhet t'i shkojë ndër mend se Partinë Komuniste të Shqipërisë e kemi krijuar ne, dy të dërguar të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Jo, e vërteta është se Partinë Komuniste të Shqipërisë e krijuat vetë ju, komunistët shqiptarë dhe, nëse duhet folur për rolin tim, ose të çdokujt tjetër të jashtëm ky rol s'është gjë tjetër veçse ajo që në marrëdhëniet midis partive motra quhet ndihmë e përkrahje internacionaliste, vëllazërore. Partinë tuaj Komuniste ju do ta krijoni siç e krijuat, edhe sikur të mos vinim ne këtu 1.

I tillë qe Miladin Popoviçi prandaj ne e nderonim dhe e respektonim atë për cilësitë e tij të larta dhe për mirëkuptimin që arrinim, kur bisedonim për njërin apo për tjetrin problem. Siç thashë, «në ato vite, ne qemë njohur edhe me Dushan Mugoshën dhe në prag e gjatë punimeve të Konferencës, edhe me Bllazho Jovanoviçin. Dushani qëndroi në Shqipëri pothuaj deri në prag të Çlirimit, por nuk i afrohej Miladinit as nga kapaciteti, as nga kultura, as nga bonsensi e thellësia e mendimit dhe as nga karakteri. Miladini ishte i çiltër, i dashur me shokë, i rreptë me armiqtë, njeri me kulturë e me horizont të gjerë, komunist nga zemra e nga botëkuptimi, kurse Dushani, pa ia mohuar që ishte trim e ,punëtor, ishte i ngushtë, sektar, i përciptë, i nxituar dhe që me intrigat e tij, çorientoi e dëmtoi shumë organizata e kuadro. Por rrytën e tij të ndyrë prej shovinisti e titisti, të një agjenti të uijtë të Rankoviçit e armiku të ,betuar kundër shqiptarëve të Kosovës, ai e tregoi më mirë kur Partia Bolshevike e Stalini i madh dhe, pas saj, Partia jonë demaskuan klikën trockiste të Titos.

Gjatë ditëve që ishte në Shqipëri, siç thashë, ne njohëm edhe Bllazho Jovanoviçin.

Në një nga bisedat që patëm me të ky «shfaqë mendimin» se në ndonjë rast Partia jonë kishte rënë në «sektarizëm» (e kishte fjalën për konsiderimin e gabuar të ndonjë çete ,partizane si «çeta e partisë», gjë që ne vetë e kishim kritikuar qysh më parë dhe e kritikua edhe në Konferencë); gjithashtu, siç përmenda

më lart, në Konferencë, «lëshoi» për herë të parë aluzionin se Partinë tonë e kishin krijuar jugosllavët.

Ne ia kundërshtuam me forcë Bllazho Jovanoviçit thëniet e tij, argumentuam se si qëndronte e vërteta mbi të ashtuquajturat çeta të partisë dhe u duk se ky ra dakord me ne. Më pas, mbaj mend që as unë, as Miladini nuk patëm xne të ndonjë fërkim a mosmarrëveshje, ai qëndroi brenda funksioneve të tdj, bile megjithëse ishte anëtar i KQ të PK të Jugosllavisë, ai dëgjonte me vëmendje bisedat, argumentet, raportimet etj., të Miladinit se e shihte që ky e njihte mirë gjendjen e Partisë e të luftës në Shqipëri dhe, siç thashë, në përshëndetjen që i bëri Konferencës së Parë të Vendit, vlerësoi lart realizimet që ishin arritur nga Partia jonë e re, si në ngritjen e forcimin e saj, ashtu dhe ,në zhvillimin e luftës antifashiste të popullit shqiptar.

Është e çuditshme se si pak kohë pas Konferencës së Parë të .Vendit erdhi S. V. Tempoja, dhe, me një arrogancë e prepotencë të paparë, deshi të hidhte poshtë gjithë vijën e Partisë sonë. Si duket, udhëheqja e PKJ nuk ishte kënaqur ngaqë Bllazho Jovanoviçi

nuk mundi ta kryejë si deshën ata rolin që i kishin ngarkuar, prandaj dërguan Tempon me «vërejtje» e «kritikë», me plane për «Shtabin ballkanik», për të futur në një thes «federativ» Shqipërinë, Bullgarinë e Greqinë. Vërejtjet e propozimet e tij absurde e arrogante nuk mund t'i prananim dhe u grindëm e u ndamë keq me të si unë dhe Miladini. Që në këtë kohë ai përpunoi Koçi Xoxen dhe e nxiti për prapaska kundër udhëheqjes së shëndoshë të Partisë sonë, por Tempoja s'kishte kohë të ndalej shumë në Shqipëri, se kishte plane «të mëdha» dhe me komunistët grekë e bullgarë.

Pikërisht në këtë periudhë risi të shfaqej konflikti i ashpër midis nesh dhe udhëheqjes së PKJ e që më pas erdhi gjithnjë duke u acaruar. Ky konflikt në fillim dukej sikur shkaktohej nga personat e dërguar, siç qe rasti i Tempos në verën e 1943-së apo i Velimir Stojniçit e Nijaz Dizdareviçit në verën e vjeshtës e 1944-ës, por koha do të vërtetonte se rrënjët dhe synimet e konfliktit ishin shumë më të thella, të paramenduara prej kohësh e tepër armiqësore. Lufta jonë e vazhdueshme me elementët që përmenda më lart si dhe me pjesëtarët e tjerë të klanit të tyre, si Dushan Mugosha, Velimir Stojniçi, Nijaz Dizdareviçi, Josip Gjergjia, Boris Kidriçi, Savo Zllatiçi, Sergei Kraiger, gjenerali Kupreshanin, Serzhentiçi e të tjerë, të cilët gjatë viteve të luftës, por edhe pas Çlirimit erdhën në Shqipëri të dërguar nga KQ i PKJ, na bindi se konflikti që shpërtheu mes nesh nuk vinte nga «gabime» të njërës apo të tjetrit të dërguar, por e kishte burimin e vërtetë te vija dhe te synimet antimarksiste e antishqiptare të vetë udhëheqjes jugosllave me në krye Titon.

Në dokumente të shumta të Partisë sonë e në mjaft shkrime të miat janë pasqyruar gjerësisht qëndrimet e drejta dhe lufta jonë e ashpër dhe parimore me të dërguarit e Titos në Shqipëri (për të gjithë këta kam hedhur në letër, gjithashtu, një eikël kujtimesh), por këtu, meqë është rasti, dëshiroj të ritheksoj dy-tri momente:

Ashtu si Miladin Popoviçin edhe të dërguarit e tjerë të Jugosllavisë, që erdhën në Shqipëri në vitet e rënda të luftës (bile edhe në vitet e para pas luftës), ne i kemi pritur kurdoherë me zemër të hapur, pa prapamendime; i tremi pritur si komunistë, si vëllezër idealesh dhe nga ana jonë kemi bërë gjithçka që t'i respektonim si të tillë e të na respektonin si të tillë. Ardhjen e tyre në Shqipëri ne e çmonim si një ndihmë e përkrahje internacionaliste që na jepte një parti motër, anëtare e Kominternit, dhe jo si një ndihmë që na e jepte ky apo ai person i veçantë, qoftë ky edhe Titoja. Atëherë ne qemë të rinj, shumë gjëra edhe s'i dinim, por ama, si komunistë, ne e dinim mirë se çështjet më kardinale, më thelbësore të Shqipërisë na takonte t'i zgjidhnim e t'i vendosnim vetë ne e, me luftë e përpjekje, me mund e sakrifica, i zgjidhëm e i vendosëm vetë ne, komunistët shqiptarë. Por edhe eksperiencën e një panie motër qemë të gatshëm ta prananim me gjithë zemër.

Për problemet e ndryshme të punës e të ndërtimit të Partisë ne kishim një mendim tonin, kishim një përvojë të fituar nga studimi i literaturës marksiste, përvojën sado fillestare të kohës së grupeve etj. Por me vëmendje e respekt dëgjonim edhe fjalën e miqve, në rastin konkret të të dërguarve të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Kur ajo që na thoshin ata na dukej me vend, ne e aprovonim dhe për këtë s'kishte si të mos i falënderonim.

Kur jeta, praktika e justifikonte atë që na kishin sugjeruar ata, ne, si komunistë e si shqiptarë nuk e kursemim shprehjen e mirënjohjes më të thellë. Por kur jeta nuk e justifikonte atë që na thoshin, atëherë ne vetë vendosnim dhe gjenim një formë rapo një rrugë më të përshtatshme. Gjer këtu s'kishte asnjë të keqe. As ne s'kishte pse të zemëroheshim me miqtë, por as ata s'kishte pse të zemëroheshin me ne, meqë s'doli e tyrja. Në procesin e luftës e të punës të tilla fenomene s'ka si të mos ndodhin. Mjaft që gjithçka të jetë e sqartë dhe e ndershme, mjaft që gjithçka të jetë thënë apo sugjeruar me pastërti komuniste, me synimin për të mirën e çështjes. Kështu e shihnim ne, komunistët shqiptarë, eksperiencën që na jepnin të dërguarit e PKJ, dhe pikërisht se e shihnim kështu, prandaj dhe s'çmonim ata, i nderonim, e në shumë raste u jepnim më tepër, bile shumë më tepër se ç'u takonte. Si komunistë mendonim se dashuria, shpesh e tepruar, që u shfaqnim miqve, nuk sillte ndonjë të keqe midis komunistësh vëllezër; si shqiptarë kështu na thoshte të vepronim tradita e lashtë e nderimit të mikut që të tra ardhur në vatrë.

Por kur «miqtë» e viteve të para, apo «miqtë» e dekadave më vonë abuzuan me ne e synuan të bëhen «zotër» të shtëpisë, ne ditëm fi bindim se shtëpia jonë përveç vatrës së ngrohtë tra dhe një derë, bile dhe penxhere...

Por nuk i shihnin kështu, nuk niseshin nga këto pozita marksiste shumica, për të mos thënë të gjithë të dërguarit e Titos, me përjashtim të Miladin Popoviçit. Të rëndë e «seriozë të mëdhenj», kush me poza «strategu» e kush me fraza «mendimtari», me presione, intrdga e me hipokrizi, hap pas hapi ata filluan ta shfaqnin qartë thelbin e tyre. Akademi e kurse speciale partie ne s'kishim bërë, por që ata blafonin, që ata shpesh ngatërronin më tepër sesa ndihmonin, këtë nisëm ta vëmë re. Me këta të dërguar kemi pasur fërkime e kundërshtime për çështje parimore, për probleme vije: duhej të ndërtonim këshillat apo sovjetët; brigadat duhej t'i quanim «brigada sulmuese» apo «brigada profetare»; shqiptarët e Kosovës e të Maqedonisë duhej të luftonin sipas pikëpamjes sonë marksiste-leniniste, apo sipas pikëpamjes shoviniste të Vukmanoviç Tempos; duhej ta fshihnim Partinë nën maskën e Frontit dhe ta mbanim në gjendje pak a shumë ilegaliteti edhe pas Çlirimit, apo Partia të qëndronte në ballë, flamur, siç donim ne dhe jo siç pretendonte i dërguari i Titos, Velimir Stojniçi. Ky Stojniçi, me një pratendim të çmendur dhe kriminal, kërkonte të na impononte atë vijë likuidatore që Partia nuk e kishte pranuar as në kohën e luftës. Dhe kur e kërkonte këtë? Pikërisht kur Partia, vija e saj e drejtë, kishte fituar dhe kur duhej grumbulluar gjithë populli në luftën e ardhshme për rindërtimin dhe për zhvillimin socialist të vendit.

Mblidheshim tok me Miladinin dhe rrinim me net të tëra pa gjumë, duke diskutuar për t'u rezistuar në mënyrë luftarake këtyre elementëve, me të cilët, edhe pse i njihnim si shokë, nuk bashkoheshim në çështje vije. Ç'është e vërteta edhe Miladini, edhe unë, edhe shokët e tjerë, fillimisht, pa e njohur, kishim besim te Titoja. Kur bisedonim të dy, thoshim se nuk mund të mendojë Titoja kështu, por janë këta njerëz që gabojnë.

- Miladin, - i thosha unë, - ne nuk gabojmë. Situatën e vendit tonë, mentalitetin e popullit tonë i njohim ne dhe jo ata, prandaj nuk round të dalim kurrsesi me parulla të majta, duke u nisur nga fakti që në Jugosllavi u krijuan brigada proletare. Vija e PKSH nuk është oportuniste, siç pretendo; Tempoja kur u grindëm me të në Kucakë, dhe as sektare, siç pretendon Velimir Stojniçi.

- Jam dakord me t'y, Taras, - më thoshte Miladini, - ju keni të drejtë që nuk lëvizni nga mendimet tuaja. Ata le të mendojnë çfarë të duan.

- Fundi i fundit, - i thosha «Ahut» (këtë pseudonim i kishim vënë Miladinit), - ne, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë, jemi të vetmit përgjegjës përpara Partisë dhe përpara popullit tonë.

Këto kundërshtime parimore zhvilloheshin shumë më përpara se të demaskohej grupi i Titos si renegat e tradhtar i marksizëm-leninizmit dhe, siç thashë edhe më lart, Miladin Popoviçi jo vetëm s'kishte asnjë kundërshtim me vijën e ndjekur nga Komiteti Qendror i Partisë sonë, por edhe ndihmonte që kjo vijë të zbatohet e të mbrohet. Por ndihma dhe sinqeriteti i tij komunist binin në kundërshtim me planet djallëzore të Titos ndaj nesh, prandaj Miladini u thirr në mënyrë të hapur armiqësore nga Titoja, që të gjykohej për veprimtarinë e tij «armiqësore» dhe për t'i lënë dorë të lire' Velimir Stojniçit, i cili kishte ardhur ato kohë në Shqipëri, si përfaqësues dhe «instruktor» i PK të Jugosllavisë dhe i dërguar i Titos dhe që më 1944 organizoi prapaskenën e Beratit kundër Partisë sone ~heroike, kundër vijës së saj të drejtë dhe të pamposhtur marksiste-leniniste, kundër Partisë që i ngriti masat në këmbë dhe i organizoi e i çoi në fitore. Ai luftoi me porosi të Titos edhe kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Titoja synonte të dobesonte e më në fund te likuidonte Partinë tonë, të dobesonte vendin akoma më shumë ne prapun e fitores dhe, me anë të klikës së Koçi Xoxes, ta bashkonte Shqipërinë me Jugosllavinë.

Më kujtohet si sot që, në kohen kur Miladini u urdhërua të kthehej në Kosovë, para se të ndahej nga ne, duke shëtitur unë dhe ai u ngjitëm në kodrat e Odriçanit, e, duke biseduar, ai më tha:

- Taras, dëgjo! Këta, Stojniçi dhe Dizdareviçi, janë armiq. Vetëm në mos u pjeksha dot me Titon, se këta dhe të gjithë ata që i kemi luftuar së bashku, do t'i demaskoj.

Por shpejt ne do të bindeshim që vetë udhëheqja jugosllave, me Titon e Rankoviçin në krye, ishte dora që i kishte përgatitur e i kishte dërguar te ne, për veprimtari antiparti e antishqiptare, Mugoshët, Vukmanoviçët, Stojniçët e të tjerë. Dhe me pas, kur tradhtia e tyre doli sheshit, fabrikuan «libra të bardhë» e broshura, artikuj e «kujtime», një propagandë të terë false e të ndyrë

për të detyruar opinionin që të besojë se ata kanë krijuar këtë e atë, se ata e bënë këtë e atë, shkurt, ata na e paskan bërë diellin të dalë mëngjeseve në Shqipëri!

Këta flasin shumë për të dërguarit jugosllavë, të cilët erdhën për herë të parë nga Kosova në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1941, por nuk përmendin një fakt real: qysh në pranverën e 1939-s e më 1940, por sidomos pas prillit 1941, kur hynë italianët në Kosovë, nga Shqipëria u dërguan në Kosovë një numër komunistësh, me origjinë nga ato anë, por që prej kohësh ishin bërë këtu komunistë e vepronin këtu si komunistë. Ata dhane atje kontributin e tyre për organizimin e Partisë e të Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë e gjetkë, shumë prej tyre dhanë jetën në zjarrin e luftës.

Po kështu në vitin 1941, por edhe më pas, nga Shqipëria shkuan në Kosovë e në krahina të tjera me po-pullsi shqiptare në Jugosllavi, dhjetëra e dhjetëra mësues shqiptarë. Ne, komunistët e atëhershëm, duke shfrytëzuar këtë rast legal, u përpoqëm dhe mundem të futnim në përbërjen e atyre që u dërguan me punë në Kosovë elementë patriotë e revolucionarë, shumë nga shokët, miqtë e simpatizantët e grupeve tona komuniste, e më pas, të Partisti Komuniste që krijuam. Ata me porosinë tonë dhanë atje një kontribut të ndjeshëm, dulce përkrahur e duke u hedhur aktivisht në luftën antifashiste të popullit trim kosovar, vëllezërve tanë të një gjaku.

Dihet edhe kjo e vërtetë: njësi të tëra të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, me urdhër të Shtabit tonë të Përgjithshëm, që në ditët e para të tetorit 1944, kur akoma s'që çliruar plotësisht Shqipëria, vazhduan luftën heroikisht në Kosovë, kurse pas Çlirimit të vendit, brigada të tjera të ushtrisë sonë (dy divizione: V dhe VI), vazhduan luftën edhe në vисти të tjera të Jugosllavisë, krah për krah me njësitet e partizanëve kosovarë e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Disa qindra prej partizanëve tanë dhanë jetën në Kosovë, në Malin e Zi, në Sanxhak e në Bosnjë ku luftuan.

Pa qenë nevoja të rreshtojmë fakte të tjera, le të bëjmë pyetjen: Sikur të ndiqnim edhe ne logjikën e Tempove mbi rolin e «të dërguarve», atëherë në ç'konkluzione duhej të arrinim e ç'pretendime duhej të paraqitnim, të paktën për zonat ku shkuan e luftuan jo më 5 a 6 «të dërguar» me çanta në sup, por qindra e mijëra veta me armë në duar?!

Historia, koha e kanë thënë e do ta thonë fjalën e vet të padiskutueshme, kurse shpifjet e pafund të Tempove me kompani do të mbeten shpifje që s'qëndrojnë në këmbë. Por ata neve s'kanë ç'na bëjnë tjetër, le të vazhdojnë të fabrikojnë shpifje, aurora dafine» për «lavdinë» e tyre aspak të lavdishme.

Terrenin e falsifikimeve të ardhshme ata e përgatitën qysh më 1945. Jo shumë kohë pas çlirimit të Kosovës Miladin Popoviçin e vranë prapa krahëve njerëzit e UDB-së, sepse ishte shprehur për të drejtën e popullsisë shqiptare të Kosovës për vetëvendosje. Për këtë kemi bindje të plotë jo vetëm nga bisedat që bëmë me Miladinin, kur ishte në Shqipëri, por në Arkivin e Komitetit Qendror të Partisë sonë kemi dokumente që flasin qartë për këto pikëpamje të komunistit internacionalist, Miladin Popoviçit. Pas kësaj njerëzit e Titos trumbetuan se vrasjen gjoja e paskësh bërë... një shqiptar kosovar! Dhe ku? Mu në tavolinën e tij të punës, në shtëpinë që ruhej nga partizanë jugosllavë! E gjithë kjo farsë kriminale që organizuar, pra, me cinizmin më të madh nga Titoja me Rankoviçin e njerëzit e tyre, në mes të të cilëve edhe Dushan Mugosha, për të fshehur gjurmët e tradhtisë së tyre karshi nesh. Njeriut, që ata e urrenin dhe e vranë, sepse ai s'mund të pajtohej me veprën e tyre armiqësore ndaj komunizmit, i vunë dekoratën e heroit të popujve të Jugosllavisë. Ky veprim u shkon vetëm banditëve të tillë, për të cilët populli ynë thotë: «Të vrasin natën e të qajnë ditën».

Më kujtohet se, kur vajta për herë të parë në Jugosllavi, as Titoja dhe askush tjetër nuk më tha fjalën më të vogël për Miladin Popoviçin. Vetëm në një miting m'u afrua një plakë e thinjur, e cila, duke më puthur e përçafuar, më pëshpëriti: «Jam nëna e Miladinit dhe e Mihajllos, që luftuan tok me ty, djali im Enver Hoxha». E shtrëngova fort në kraharor, po m'u zu fjala në grykë dhe m'u mbushën sytë me lot për kujtimin e shokut tim të dashur, Miladin Popoviçit. Nuk mund të duroja të heshtja dhe në fjalën time atje fola për Miladinin fjalët më të mira e më të ngrohta ~që ai i meritonte.

Shpejt do të vinte dita t'i thoshim edhe për të tjerët ato që meritonin, do të vinte, pra, dita kur ne, hapur e botërisht, do të denonconim e do të demaskonim veprimtarinë antimarksiste e antishqiptare të udhëheqjes së PKJ me Titon në krye. Në këtë kuadër do të flisnim edhe për të vërtetën mbi veprimtarinë antishqiptare të të dërguarve jugosllavë në Shqipëri, veprimtari e cila filloi të shtohet e të egërsohet pas Konferencës së Parë të Vendit të PKSH.

Por, e thashë, kjo është tjetër histori, më gjerësisht me të do të merremi një herë tjetër, le të kthe hemi, pra, te Konferenca e Parë e Vendit, punimet e së cilës pas gjithë këtyre diskutimeve e debateve të zjarrta e të pjekura, po i afroreshin fundit.

Më 22 mars, pas mbylljes së diskutimeve, Konferenca e Parë zgjodhi Komitetin Qendror të Partisë të përbërë prej 15 anëtarësh dhe 5 kandidatësh, emrat e të cilëve gjenden në Arkivin e Komitetit Qendror të Partisë. Gjithashtu Konferenca zgjodhi Sekretarin dhe Byronë Politike dhe Sekretar të Përgjithshëm më zgjodhi mua. Kjo zgjedhje e Komitetit Qendror u prit me duartrokitje të nxehta, me aprovim unanim. Zgjedhja e Komitetit Qendror u bë në forma të përshtatshme të ilegalitetit. Qysh nga Themelimi i Partisë ne kishim ndjekur hap pas hapi punën e shokëve, njihnim cilësitë dhe aftësitë e tyre, i kishim provuar në luftë e në aksione dhe për ditë me radhë kishim diskutuar e kishim konkluduar për karakteristikat e kandidatëve të mundshëm, që do t'i propozoheshin Konferencës. Kandidatët që do të zgjidheshin nuk u paraqitën me emrat e tyre të vërtetë, por me numra konvencionalë, duke vënë përbri secilit numër karakteristikat kryesore nga biografia dhe nga veprimtaria e secilit, duke shënuar anash se sa vjet kishte qenë komunist, duke llogaritur edhe kohën kur kishte qenë anëtar i grupeve. Votimet ishin unanime.

Pas kësaj, në mes gëzimit dhe entuziazmit të të gjithë pjesëmarrësve, u ngrita për të mbajtur fjalën e mbylljes së Konferencës.

Në këtë fjalim të shkurtër vura në dukje se gjatë diskutimeve u vërejt uniteti i mendimit të Partisë sonë dhe se të gjithë shokët, në terren dhe në udhë heqje, i kishin vënë shpatullat Partisë. Theksova se kjo ishte një bazë e shëndoshë që akoma më shumë na siguronte se tani, pas zgjedhjes së Komitetit Qendror Definitiv, shokët do të shtrëngonin më shumë radhët për zbatimin me përpikëri e me heroizëm të detyrave që na ngarkoi Konferenca e Parë e Vendit. Me këtë rast i falënderova shokët për besimin e madh që na dhanë, dulce na zgjedhur në udhëheqjen e Partisë, dhe i sigurova se ne, anëtarët e Komitetit Qendror, do të bënim të gjitha përpjekjet për të qëndruar në lartësinë e misionit të ngarkuar. Nënvizova se tash e tutje duhej të përpiqeshim që të mbanim lldhje të ngushta midis bazës dhe Komitetit Qendror, shumë më të ngushta nga sa i kishim mbajtur deri në atë kohë, pavarësisht se ngjarjet e luftës, ndodhitë e përditshme krijonin vështirësi dhe na ndanin e nuk gjenim dot mundësi e lehtësi për t'u grumbulluar e për kontakte të drejtpërdrejta më të shpeshta.

Theksova gjithashtu se, duke zbatuar një vijë të drejtë, tash e mbrapa nuk duhet të ekzistojë më fryma liberale dhe butësia joparimore ndaj elementëve grupashë, që kanë për qëllim të minojnë unitetin dhe organizimin e Partisë, të shtrembërojnë vijën e saj të luftës dhe të aksionit, të shtrembërojnë ideologjinë që frymëzon Partinë tonë. Po ashtu, theksova, faza e re e luftës ku po hidhemi, akoma më imperative e bën qëndrimin e prerë e pa asnjë kompromis me tradhtarët e vendit e me gjithë ata elementë të Ballit Kombëtar që jo vetëm s'duan të luftojnë kundër pushtuesit, por janë lidhur e po lidhen me të për të sabotuar vijën e Partisë e Luftën Nacionalçlirimtare. Detyrat që na ngarkoi Konferenca, theksova, janë të mëdha e të vështira, ato përbëjnë një platformë të tërë pune e lufte për kurorëzimin me sukses të çështjes jetike të Partisë e të popullit tonë. Na bie neve barra e madhe që të luftojmë për vënien në jetë të këtyre detyrave dhe ne do ta kryejmë patjetër misionin tonë si forca udhëheqëse e popullit, si pararoja e luftës së madhe çlirimtare.

Ja kështu, pas gjashtë ditësh e netësh pune intensive, Konferenca e Parë e Vendit e PKSH, më 22 mars 1943, përfundoi me sukses të plotë. Ajo, siç thashë, e armatosi Partinë me vendime e direktiva të reja e shumë të rëndësishme, të cilat do të na shërbenin për betejat e mëdha që na prisnin. E tani mbetej për rpara kryesorja: Lufta për zbatimin e tyre.

SHPARTALLINII I FRAKSIONIT

(Maj 1943)

Partia ishte e angazhuar e gjitha me punën për të vënë në jetë detyrat e Konferencës së saj të Parë të Vendit, kur tradhtari Sadik Premte kurdisi në qarkun e Vlorës fraksionin e vet të rrezikshëm antiparti. Qëllimi i tij ishte i qartë: të shkatërronte me çdo mjet themelet e Partisë sonë të re. Këtë qëllim, që ai dhe Anastas Lula nuk e realizuan dot me dinakëritë e tyre në Mbledhjen Themeluese të Partisë, Sadiku u përpoq ta realizonte tani në qarkun e Vlorës, me anën e forcës, me luftë të hapur kundër Partisë.

Sadik Prerntja mbeti një armik konsekuent. Konsulta e Aktivit të Partisë e kishte demaskuar punën e tij me frymë grupazhi dhe Konferenca e Jashtëzakonshme e kishte përjashtuar nga radhët e Partisë, por këto masa nuk ishin punuar me të gjithë komunistët si vendime të rëndësishme e të domosdoshme për të ruajtur unitetin e radhëve të Partisë. Organizata e Partisë e qarkut të Vlorës nuk e kishte përqendruar mirë vëmendjen te ky element, që të mund të zbulonte çdo tentativë tjetër armiqësore të tij, ta demaskonte e ta shtypte pa mëshirë.

Duke përfituar nga këto të meta, në përgjithësi në punën politike e organizative të Partisë në qark, dhe veçanërisht nga mungesa e shokëve Hysni, Mehmet e disa të tjerëve, që kishin ardhur në Labinot për të marrë pjesë në Konferencën e Parë të Vendit, duke përfituar edhe nga familjariteti që ekzistonte në një sërë kuadrosh dhe nga niveli i ulët ideologjik i mjaft komunistëve, Sadik Premtja, si vendës që ishte, shfrytëzoi të gjitha lidhjet e vjetra e miqësitë e sëmura me njerëz që bënë pjesë në Parti si dhe me të tjerë që nuk bënë pjesë në të, por që ishin nacionalistë, elementë që e donin Luftën Nacionalçlirimtare, që simpatizonin Partinë dhe arriti të bindë një sërë prej t'yre për t'u ngritur kundër Komitetit Qarkor të Vlorës, për ta rrëzuar atë dhe për të marrë në dorë organizatën e Partisë të Vlorës. Organizata e Partisë e këtij qarku dhe udhëheqja e saj e diktuan, më në fund, qëllimin e kësaj pune armiqësore të Sadik Premtes dhe filluan të merrnin masa.

Nëpërmjet qarkoresh e udhëzimesh ne i kishim orientuar shpesh shokët e Vlorës për qëndrimin tepër vigjilent e të prerë që ata, duhej të mbanin ndaj Xhepit dhe bashkëpunëtorëve të tij, por, siç treguan ngjarjet, puna nuk ishte kryer ashtu siç duhej. Në ditët e para të majit, shoku Hysni Kapo më njoftoi se gjendja në Vlorë ishte shqetësuese dhe kërkonte një të deleguar. Rrebelimi i Sadik Premtes kishte shpërthyer me tërë egërsinë e vet. Ato ditë ndodhesha në Tiranë për të zbrëthyer direktivat e Konferencës së Parë të Vendit dhe për të ndihmuar shokët e Qarkorit të Tiranës në kryerjen e detyrave të rëndësishme që kishin përpara. E vlerësova gjendjen me tërë seriozitetin e duhur dhe qysh atë natë shkrova një letër, të cilën ua dërgova shokëve të Vlorës. Në këtë letër u bëja analizën shkaqeve që kishin çuar në atë situatë të rëndë dhe i porositja shokët e Vlorës që të vepronin menjëherë, të merrnin masa të pamëshirshme e radikale kundër elementëve antiparti, se vetëm kështu shëndoshej gjendja e krijuar. Partia, u thosha shokëve, duhet të jetë në lartësinë e duhur, me emrin dhe me konsekuencën e saj ajo duhet t'u futë tmerrin armiqve të jashtëm e të brendshëm, dhe kjo nuk arrihet ndryshe, veçse me luftë e me masa konkrete.

Masat që rekomandoja kishin për qëllim, dhe klow ishte e drejtë, ta bënë veprimtarinë e Sadik Premtës parrezikshme. Kjo do të realizohej duke e arrestuar atë, dulce e gjykuar edhe një herë tjetër përpara Partisë dhe dulce e dënuar menjëherë si tradhtar, fraksionist, armik të betuar të Partisë e të popullit. Po ashtu udhëzoja të arrestoheshin elementët më të afërt të Xhepit, të gjykoheshin, të nxirreshin jashtë Partisë e t'u thuhej prerë : çdo veprim pro Xhepit do të quhet tradhti e lartë. Njëkohësisht udhëzoja se duhen bindur shokët e tjerë të Partisë dhe gjithë ata elementë të popullit që ai i kishte implikuar në tradhtinë e tij, se rruga e këtij renegati ishte tradhti ndaj Partisë dhe luftës, prandaj ata duhej të shkëputeshin menjëherë prej tij, të ndreqeshin e të vinin në rrugën e drejtë të Partisë.

Ato ditë ishte kthyer në Tiranë Liri Gega, që ishte dërguar me punë në Vlorë. E thirra menjëherë, i tërhoqa vërejtjen që ishte larguar nga zona në situatën më të rëndë, i dhashë porosi të hollësishme dhe i thashë të nisej urgjent për atje. Mendova se letra udhëzuese dhe porositë që u dërgova me Liri Gegën ishin të mjaftueshme për t'i ndihmuar shokët e Vlorës, pa qenë e nevojshme të shkonte atje një i deleguar.

Komiteti Qarkor i Vlorës e mori letrën udhëzuese që i dërgova në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe nisi nga zbatimi i masave.

Nuk kaluan shumë ditë, kur shokët e Vlorës më lajmëruan përsëri se gjendja atje vazhdonte të ishte e rëndë. Arrestimi i Sadik Premtes nuk ishte organizuar aq mirë, kështu që ai kishte mundur të fshihej, të strehohej fillimisht te miqtë e tij fshatarë nacionalistë, e pastaj kishte gjetur mbështetje edhe tek elementë, si Hysni Lepenica e të tjerë. Tani që u zbulua komploti, më informonin ata, Sadik Premtja është hedhur hapur kundër Partisë e po vepron me ngut për të realizuar planin e tij. Xhepi, siç më njoftonin shokët, kishte thurur një mijë e një intriga për të ngatërruar popullin atje, që të gjente kështu një mbështetje për vete; veç kësaj, kishte armatosur edhe mjaft nga bashkëfshatarët e tij në Gjorm, me ariën e të cilëve kërcënonte shokët tanë. Natyrisht, për mua kjo nuk ishte një gjë e papritur, se e dija kush qenë Sadik Premtja dhe Anastas Lula. I papritur më erdhi lajmi se pikërisht mungesa e vigjilencës së shokëve të ngarkuar për arrestimin e Sadik Premtes bënë që ky t'i shpëtonte dënimit të Partisë e tash na qe vënë ballë për ballë. Një pjesë e elementëve, të gënjer e të mashtruar prej Sadikut, i kishin pranuar gabimet e tyre dhe i kishin ndarë hesapet me të, por shokët më sinjalizonin se kishte edhe disa nga ata që akoma nuk po bindeshin, prandaj, për të marrë një vendim përfundimtar, kërkonin të vinte një i deleguar nga Komiteti Qendror i Partisë.

Gjendja kështu ishte e ndërlikuar e serioze, prandaj, sa mora lajmin, vendosa përnjëherë që të nesërmen të shkoja vetë në Vlorë, të bisedoja me shokët e Qarkorit dhe, tok me ta, në emër të Komitetit Qendror, në emër të Partisë, të merrja kontakt me elementët ku mbështetej Sadik Premtja dhe sidomos me popullin e zonave ku Xhepi kishte krijuar një turbullirë, një situatë të koklavitur. Vajtja në Vlorë si i deleguar i Komitetit Qendror në këtë situatë do të ishte, gjithashtu, shprehje e hapur e përkrahjes dhe e mbështetjes së plotë që udhëheqja e Partisë dhe gjithë Partia u jepte Qarkorit të Vlorës e kuadrove të tij të shëndoshë dhe kështu, qoftë komunistët, qoftë populli, do të bindeshin përfundimisht se nuk qe Qarkori i Vlorës që «kishte tradhtuar», por ishin Sadik Premtja me shokë ata që i qenë kundërvënë Qarkorit dhe gjithë Partisë, nga pozita armiqësore e shkatërrimtare.

Të nesërmen në mëngjes u nisëm me automobil, me shokun që kishte ardhur të më lajmëronte. Ky ishte shoku Ymer Veshi, i cili bënte pjesë në organizatën e Vlorës. Për t'u maskuar, ai kishte marrë me vete nënën e tij, një grua trime dhe që u dallua si aktiviste e gjallë dhe e vendosur gjatë gjithë luftës dhe pas Çlirimit. Nga Tirana, më kujtohet, jemi nisur nga shtëpia e shokut Esat Dishnica, ku kisha nja dy-tri ditë që strehohesha dhe punoja me shokët ilegalë për punë të ndryshme propagandistike dhe për organizimin e aktiviteteve të tjera që bënim në këtë qytet. Ishte aty nga mesi i majit.

Unë kisha letërnjoftim fals, por këtyre letërnjoftimeve nuk u zihej shumë besë; besë u zinin më tepër në atë kohë naganteve dhe bombave që kishim me vete. Megjithatë, në postblloqet e ndryshme që ndodheshin gjatë rrugës Tiranë-Vlorë, kaluam pa incidente, bile, në shumë prej tyre, nuk na ndaluan fare. Për herë të parë na ndalën në postbllokun e Qafës së Koshovicës. Më kujtohet se xhandari që na kërkoi letërnjoftimet, ishte një burrë me mustaqe të mëdha. Ne ia dhamë por, ndërsa me një dorë i jepnim atij letërnjoftimet, me dorën tjetër mbanim koburet e fshehura në xhepa. Ai na i pa letërnjoftimet dhe na pyeti ku shkonim.

- Shkojmë në Vlorë, - i thamë.

- Mirë, - u përgjigj ai, na hapi postbllokun dhe kaluam.

Tek Ura e Mifolit, po ashtu, na ndaluan karabinierët, na pyetën edhe ata se ku po shkonim. U dhamë të njëjtën përgjigje: «Shkojmë në Vlorë» dhe na lanë të kalonim. Kështu e kaluam pa ndonjë vështirësi edhe këtë pengesë. Kur erdhëm te vendi ku do të ndaleshim, në kodrat me ullishte në të hyrë të Vlorës, zbritëm nga automobili dhe filluam të ngjitnim të përpjetën për të vajtur në

fshatin Hoshtimë, në shtëpinë e Mahmud Xhafës, te dajat e nënës së Ymerit. Aty, veç të zotëve të shtëpisë, gjetëm edhe babën e Ymerit, një burrë i mirë, i cili na priti ngrohtë dhe u gëzua që arritëm shëndoshë e mirë. Për mua i dhamë një emër, por plaku nuk u interesua, nëse ai që i dhamë ishte emri im i vërtetë ose jo. Pasi na pyeti si kaluam gjatë rrugës, u ngrit, shkoi nga dhoma matanë, që shërbente si kuzhinë, dhe u kthye me shishen e rakisë e ca meze. Sado që unë nuk pija, e ngrita gotën sa për t'u bërë qejfin, pastaj nisëm bisedën për luftën e për bujqësinë, megjithëse ai, në fakt, nuk ishte bujk, por rrobaqepës. Ndërkohë e zonja e shtëpisë dhe nëna e Ymerit, na përgatitën për të ngrënë dhe, si biseduam edhe pas darkës, u shtrimë për të marrë një sy gjumë.

Sa u thye mesnata, bashkë me Ymerin filluam përsëri udhëtimin drejt vendit të caktuar në zonën e lirë, ku do të takoheshim me shokun Hysni dhe me shokë të tjerë të Qarkorit, kështu që parashikohej të kalonim kodra, lugina e lumenj. Kishim rënë dakord zne Ymerin se, po të na pyesnin rrugës, unë do të paraqitesha si agronom, që kaloja këndeje për të parë pemëtoret e disa miqve të mi. Ne udhëtonim si legalë, por me pasaporta false, pa shoqërues partizanë, tjetër punë se ç'masa sigurimi kishte marrë Hysniu me ndonjë skuadër partizanësh. Megjithatë, kur të kapërcenim rrugën automobilistike, duhej të bënim kujdes të madh, po ashtu kujdes duhej të bënim edhe kur të kalonim lumin, se deri në Kropisht kishte forca italiane. Kurse gjatë gjithë pjesës tjetër të udhëtimit deri në Hysoverdh nuk kishte asnjë rrezik, për arsye se e gjithë zona ishte e çliruar.

Në Kërkovë, te shtëpia e Hajredin Kërkovës, nuk qëndruam shumë, se donim të fitonim kohë.

Prej aty u nisëm drejt Vaut të Shushicës, duke e zgjedhur rrugën me kujdes, që t'i shmangeshim ndonjë ndeshjeje me forcat e kavalerisë italiane.

Qëndruam pak edhe në Çeprat, te shtëpia ku banonte në atë kohë familja e shokut tonë Manush Myftiu. Ishte një shtëpi me dy dhoma prej guri e një prej qerpiçi. Ai nuk ishte aty, kishte dalë me kohë ilegal e merrej me organizatën e Partisë së Vlorës dhe me organizimin e çetave partizane. Gjithë familja ishte me luftën. Aty u takova me nënën e Manushit, një grua e urtë, e mençur dhe e mirë, me njërin nga vëllezërit e tifi, i vogli më duket, si dhe me njërin nga motrat, Lejlanë, partizane trime dhe shoqe e vendosur e aktive e Partisë. Pimë kafe e pas pak u ngritëm, se koha nuk priste.

Pasi kapërcyem Vaun e Shushicës. morëm rrugën në të djathtë dhe filluam t'u ngjiteshim kodrave midis Lubonjës e Peshkëpisë. Më kujtohet se, pasi kishim udhëtuar disa orë, qëndruam të çlodheshim në një breg. Sado që kishim me vete bukë, nuk kisnim futur asnjë kafshatë në gojë dhe na kishte marrë uria. Tek rrinim për t'u çlodhur në majë të bregores, vumë re se aty afër ishte një stan. Një nënë labe po rrinte afër zjarrit. Ajo, gasi na pa, na u afrua e na pyetd:

- Si jeni, more djema?
- Mirë, moj nënë, - iu përgjigjëm ne.
- Keni nevojë për gjëkafshë? - na pyeti prapë aj o.
- Jo, nuk kemi, - ia pritëm ne, - por, po té kesh, na jep një çikë djathë.
- U. të keqen nëna, - na tha ajo, - ju bëj unë një çikë djathë të tiganisur.

- O, sa mirë, - i thashë, - ma ke gjetur zemrën, moj nënë, djathin e tiganisur nuk ma ka munguar kurrë nëna ime, sido që me pakicë, por.. .

- Nashti, - tha ajo, - në luftë jemi, por ja, sa për ju kam djathë, të keqen nëna. - Ajo vuri tiganin në zjarr, hodhi një çikë gjalpë e na tiganisi nja 5 a 6 feta djathë. Për mua kjo ishte dasmë.

Pasi hëngrëm bukë dhe vrojtua vendin edhe një herë, zbritëm poshtë në drejtim të fushës së Peshkëpisë, e kaluam fushën dhe filluam të ngjitnim kodrat me ullishte -përballë Drashovicës, që të dilnim në Kropisht. Nga mafia e kodrës dukej mirë fusha e bukur e Drashovicës, ura dhe rruga Vlorë-Gjirokastër, nëpër të cilën lëviznin makina dhe ushtarë italianë. Aty qëndruam pak sa për t'u çlodhur, pastaj u vumë përsëri për udhë.

Në zonën e lirë u takuam me shokun Hysni, u për qafuam e u puthëm me të. Te shtëpia e shokut Kadri Hazbiu në Hysoverdh, ai kishte organizuar takimin që do të bënim me shokët e Qarkorit. U mblodhëm menjëherë dhe aty më informuan më me hollësi për situatën. Mehmeti, sekretar

organizativ i Qarkorit, nuk mori dot pjesë në këtë mbledhje, për arsye se kishte dalë në disa fshatra me një grup partizanësh, nuk e mbaj mend se për ç'punë.

Nga raporti që më dhanë, vura re se ata kishin reflektuar mirë në mjaft çështje sipas udhëzimeve që u kisha dërguar në emër të Komitetit Qendror për shkatërrimin e fraksionit*. *(Është fjala për udhëzimin e datës 3 maj 1943 dërguar Komitetit Qarkor të PKSHE të Vlorës mbi masat për likuidimin e fraksionit të Sadik Premtes.)

Shoku Hysni kishte një gjykim të mprehtë e të shëndoshë. E dëgjoja me vëmendje dhe akoma më tepër bindesha se me shokë të tillë asnjë e keqe e rrezik nuk do t'i ndodhte Partisë. Nga diskutimet e shokëve në këtë mbledhje dilte qartë se shokët Hysni Kapo e Mehmet Shehu, në mënyrë të veçantë, si dy udhëheqësit kryesorë të Qarkorit, të mbështetur nga shokët Manush Myftiu e të tjerë, kishin zhvilluar ato ditë një punë të madhe, të palodhur e të efektshme. Akuzat e poshtra, të thurura e të përhapura nga Xhepi e njerëzit e tij se gjoja «Qarkori i Vlorës ka tradhtuar», se «Hysni Kapoja është bashkuar me italianët» etj., ishin dërrmuar nga ndërhyrja e guximshme dhe e pjekur e shokëve tanë, të cilët kishin kaluar fshat më fshat për të sqaruar njerëzit dhe për t'i bindur se si qëndronte e vërteta. Me një rëndësi të veçantë për sqarimin e situatës kishte qenë vajtja e Hysniut në Tërbaç. Xhepi kishte nxitur Gjormin, fshatin e lindjes, që të ngrinte Tënbaçin kundër Hysniut, duke thënë se «ai e tradhtoi fshatin e tij» dhe kjo e kishte rënduar shumë Tërbaçin, i cili i kishte dhënë fjalën Hysniut se do të ishte me luftën. Tërbaçi nuk donte kurrsesi të besonte te fjalët që ishin hapur për birin e tij të dashur, megjithatë dyshimi ishte hedhur. Në atë situatë të nderë pati edhe njerëz që e besuan Xhepin, se gjarpri nuk i tregonte këmbët dhe u zemëruan keq me Hysniun, sa të afërmit e tij i dërguan fjalë të mos dukej në Tërbaç, derisa të qetësohej gjendja, se do ta vritnin. Por Hysni Kapoja, si një shok i vendosur e luftëtar trim që ishte, shkoi në fshatin e tij pikërisht në këtë situatë. Atje ai bisedoi për tërë natën me një përkrahës me influencë të Xhepit dhe, më në fund, e bindi që ta braktisë Xhepin dhe rrugën e tradhtisë ku po i fuste. Në mëngjes dolën të dy para popullit, i cili ishte mbledhur dhe priste. Ai shoku kishte folur si burrat para popullit, kishte pranuar fajet e veta, kishte demaskuar me fakte veprimet armiqësore të Xhepit dhe kishte premtuar se do të luftonte tërë jetën në anën e popullit. Këtë premtim që bëri në ato çaste kritike, ai e ka realizuar me nder. Kur kishte folur Hysni, populli i Tërbaçit s'mbahej nga gëzimi që biri i tyre ishte po ai Besniku që njihnin e donin ata. Aty ishin edhe disa fshatarë nga Tragjasi e nga fshatra të tjera të afërta dhe këta e përhapën shpejt lajmin për atë që ndodhi në Tërbaç. Pas kësaj pune, Hysni vazhdoi të shkonte në të gjithë zonën e Mesaplikut dhe në fshatra të tjera të Vlorës, të demaskonte veprimtarinë armiqësore të Sadik Premtes e të pasuesve të tij dhe të sqaronte ata që ishin gënjer e lëkundur.

Kështu, pra, me përpjekje të guximshme po qartësohej në populi pozita e shëndoshë e Qarkorit të Partisë dhe pozita armiqësore e Xhepit. Në këtë situatë Sadik Premtja, i egërsuar dhe i trembur që u zbulua komploti, ato ditë i kishte shpejtuar shumë përpjekjet për të realizuar me çdo kusht fraksionin. Ai kalonte si një hije e zezë sa te njëri te tjetri prej njerëzve të tij dhe kërkonte t'i ngrinte në veprimtari të hapur kundër Partisë. U kishte dhënë urdhër bashkëpunëtorëve në fraksion të punonin me celulatat, të kërkonin një konferencë që të rrëzonin Qarkorin e Partisë dhe në vend të tij të zgjidhnin një tjetër me Xhepin në krye, e me njerëzit e tij, pra ta merrnin vetë në dorë drejtimin e tërë punës së organizatës së Vlorës dhe të realizonin kështu synimet e tyre armiqësore.

Në këto përpjekje të shpejta e të rrezikshme Sadik Premtja kishte mbështetjen e grupeve nacionaliste e balliste, që vepronin në ato krahina dhe që kishin në krye elementë si Hysni Lepenica e të tjerë. Ai shkonte me mendimin se do të kishte edhe mbështetjen e Cetës Plakë, e cila, sipas planeve që kishte bërë, duhej të ngrihej me armë kundër Qarkorit. Popullit ia kishte frikën, megjithatë shpresonte ta fitonte përkrahjen e tij, prandaj kishte hapur një fushatë të madhe shpifjesh kundër Qarkorit, të cilin e quante «klikë tradhtarësh». Ato ditë në zonën e Mallakastrës ishin vrarë aksidentalisht dy veta dhe ishte plagosur një tjetër, të tre të Cetës Plakë të Vlorës. Njëri nga të vrarët dhe i plagosuri ishin të arrestuar prej Qarkorit si fraksionistë dhe mbaheshin të izoluar, derisa t'u bëhej gjyqi. Sadik Premtja e kishte shfrytëzuar këtë rast, i kishte fryrë zjarrin të hakmarrjes, duke përhapur fjalë se i vrau Çeta e Mallakastrës. Me këtë synonte ta lëkundte

;besimin e popullit tek udhëheqësit e tij dhe të ngrinte krahinat e Vlorës e të Mallakastrës me armë kundër njëra-tjetrës.

Situata nuk priste. Duhej sqaruar mirë populli për tradhtinë e poshtër të Sadik Premtes që të rifitohej plotësisht besimi i tronditur i popullit; duhej izoluar Xhepi

nga populli e nga njerëzit e gënjyer që kishte përreth dhe ky tradhtar, ashtu sig kisha porositur që në fillim

të majit, duhej kapur, gjykuar e pushkatuar si armik i betuar i Partisë e i popullit; duhej forcuar me qdo kusht Partia. Prandaj vendosëm që të gjithë të ndaheshim e të shkonim në ato krahina ku Xhepi kishte lëshuar helmin e tij, të mblidhnim popullin e të sqaronim mirë çdo gjë.

Unë me Hysniun do të shkonim në Tragjas. Atë ditë që do të niseshim për atje, u ngritëm me natë. Rrugën Vlorë-Gjirokastrë dhe lumin e Shushicës duhej t'i kalonim pa aguar. Ky ishte vendi më i rrezikshëm, se në Kotë ndodhej një garnizon italian, prandaj vendësit kishin zgjedhur për ne shtigjet rrëzë Qafës së Dushkut. Ecëm nëpër errësirë kodrave, brigjeve e gërxheve. Kur zbardhi drita, ne ishim në të hyrë të fshatit Mazhar. Rrezikun se mos diktoheshim nga italianët e kaluam, por shokët prapë bënë kujdes, se Xhepi mund t'i nxirrte njerëzit e tij në pritë në çdo shteg të kësaj zone. Hysni i bëri shenjë njerit prej shokëve që na shoqëronte dhe ai mori një rrugë të ngushtë në drejtim të disa shtëpive në luginë, aty ku fillonte të lartësohej mali. Pas pak ai u kthye e na gjeti tek ishim ulur për t'u çlodhur dhe vari midis nesh disa copa bukë e djathë. Filluam të hanim dhe ndienim si na ngrohte zemxën dashuria e këtij populli të varfër, por zemërbardhë e patriot.

Plot forca nga kjo dashuri e nga misioni i lartë me të cilin na kishte ngarkuar Partia, bashkë me Hysniun iu qepëm malit. Shoku Hysni ecte si sorkadhe. Hapat i kishim të lehtë e të shpejtë, por mali ishte i lartë dhe na u desh mjaft kohë që të arrinim në Qafë të Mazharit. Pasi kapërcyem majën, dolëm në pllajat që dominojnë Tragjasin. Këtu qëndruam, se do të takonim me Pali Terovën dhe Qazim Qakërrin, dy ndër bashkë-punëtorët kryesorë të Xhepit, por ata nuk kishin ardhur. Dërguam një korrier në Tragjas që t'i gjente ku ishin dhe t'u thoshte se i prisnim në takim këtu në qafë të malit, ashtu siç ishin njoftuar. Kaluan disa orë dhe korrieri u kthye vetëm. Ata nuk kishin pranuar të vinin. «Të deleguarin e presim këtu», - i kishin thënë.

Ne pikërisht në Tragjas do të shkonim, atje kishim organizuar edhe mbledhjen e popullit të Tragjasit dhe të fshatrave të tjera rreth e rrotull, por shokët e kishin parë të arsyeshme që bisedën me fraksionistët ta zhvillonim para se të hynim në fshat.

Në mes të shpatit të malit, kur po zbritnim, u ndalëm në një shpellë. Atje jetonte verës një çoban që këtë shpellë e kishte si shtëpinë e tij, ndërsa dhentë kullotnin sipër, në pllaja. Ai na priti dhe u gëzua shumë kur Hysni i tha se të gjithë ishim të njohur të tij, se ishim miq të familjes së tij e shokë të luftës. Çobani na gostiti me dhallë. Si u freskuam dhe u çlodhëm, zbritëm shpatin e malit dhe mbërritëm në Tragjas.

Neshkuam drejt te shtëpia e Islam Gjonit. Ky ishte babai i Rrumbullakut, i cili ishte arrestuar nga italianët dhe e kishin internuar në Itali. Islam Gjoni, i cili, në qoftë se nuk gabohem, kishte qenë mësues në Tërbaç, që një burrë i moshuar me gjyzykë dhe, siç më kishte thënë Hysni, që një njeri i mirë, gjë që dukej edhe nga biseda që bëmë me të.

Aty thirrëm Pali Terovën, Qazim Çakërrin si dhe nja 2-3 të tjerë, që kishin rënë në ujërat e Xhepit. Njëri nga ata më të vendosurit* *(është fiala për Neki Ymer Hoxhën (Vangjon).) në rrugën e Xhepit mungonte, sepse shokët me Mehmetin e kishin çuar në Mallakastër, e kishin mbyllur me rojë në një shtëpi dhe, kur të kthehesha më vonë andej, do të bisedoja me të.

Këta që thirrëm, u përpoqa t'i bindja me argumente për tradhtinë e Xhepit, për metodat nga më të poshtrat e më dinaket që kishte përdorur për t'i bërë pas vetes dhe për t'i pasur si mashë në zbatimin e planit të tij për të goditur Partinë, për të sabotuar Luftën Nacionalçlirimtare. Orët e natës kalonin dhe biseda vazhdonte gjithnjë e ndezur. Fraksionistët e kishin të vështirë të shkëputeshin nga ajo rrugë ku ishin futur.

Pasi kishte kaluar mjaft kohë që po bisedonim, theksova:

- Partia ju bën thirrje edhe një herë t'i analizoni veprimet tuaja, të shihni me mendje të kthjellët se ku ju çon kjo rrugë dhe të hidheni pa rezerva në anën tonë, se kjo është në të mire'n e Luftës

Nacionalçlirimtare dhe në të mirën tuaj. Interesi i përgjithshëm e kërkon të jemi tok, prandaj ngulim këmbë që ju t'i njihni gabimet e t'i hidhni tej, por edhe në mos pranofshi kursesi të bëni kthesë, Partia do të fitojë edhe pa ju, sepse ajo ka popullin me vete, i cili e ka zgjedhur rrugën e tij, ka zgjedhur rrugën e luftës me armë në dorë kundër okupatorëve e tradhtarëve të vendit. Kjo është rruga e drejtë për çdo shqiptar të ndershëm. Çështja shtrohet thjesht dhe prerë: ose me Partinë e Luftën Nacionalçlirimtare, ose kundër këtyre dhe, pra, po të qëndroni në këtë të dytën, s'jeni gjë tjetër vece tradhtarë jo vetëm të Partisë, por edhe të popullit që lufton nën udhëheqjen e saj.

Më në fund arriti një moment që u duk ha-ptas e çara midis tyre. Pali dhe Difi* *(Pseudonimi i Qazim Çakërrit.) m'bajtën qëndrim antiparti. Kuptohet, këta ishin armiq konsekuentë dhe si zor të bënin kthesë. Ndërsa të tjerët, që ishin të gënjer e që po luftonin me veten në ato momente kritike të jetës së tyre, filluan t'i njihnin gabimet e të bënin auto kritikë, se duhej t'i kishin dëgjuar më mirë direktivat e Partisë. Ata e dënuan Xhepin dhe shtuan se ishin gati të pranonin dënimin që do t'u jepte Partia. Kjo shkaktoi një tronditje te Pali e te Difi, por tani diferencimi u bë.

K'y ishte një sukses që arritëm ne me këtë takim.

Suksesin më të madh e arritëm të nesërmen, në mbledhjen që bëmë me popullin. Sheshi jo shumë larg. Izvorit ishte mbushur plot me njerëz. Në fjalën që mbajta aty, përshëndeta të gjithë të pranishmit, përshëndeta luftën heroike të popullit të Vlorës, fola për traditat e vjetra patriotike të të gjithë këtij qarku, për ngritjen e Flamurit, për Shpalljen e Pavarësisë etj. Në mënyrë të veçantë fola për Luftën heroike Nacionalçlirimtare kundër okupatorëve, të cilën populli i krahinës së Vlorës po e zhvillonte me sukses nën drejtimin e Partisë.

- Vlora, - theksova para tyre, - për gjithë Shqipërinë dhe për Partinë tonë Komuniste është simboli i shkëlqyer i lirisë, i luftës burrërore dhe fitimtare kundër pushtuesit italian. Në historinë e luftërave të popullit tonë, ajo ka qenë një nga çerdhet më të zjarra të patriotizmit; nga gjiri i saj doli Ismail Qemali, që ngriti Flamurin dhe Shpalli Pavarësinë; këtu luftuan Selam Musa Salaria, Zigur Leloja, Sali Murati e shumë murin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, po e ngrënë peshë popullin e Vlorës në luftën më të madhe që ka parë vendi ynë, në Luftën Nacionalçlirimtare.

Dikush duartrokiti dhe në çast brohoritën të gjithë.

- Me t'u formuar Partia, - thashë, - sytë e saj u drejtuan edhe në Vlorë. Vlora e heronjve, Vlora e Pavarësisë duhej të ishte medoemos Vlora e luftës së re të çlirimit. Ajo, si luftëtare që ishte, do të ndiqte traditën dhe këtë herë Flamurin tradicional të luftës patriotike e ngriti lart Partia, për të mos u ulur më kurrë, prandaj kishim bindjen se Vlora do të ishte me Partinë. Parulla e heronjve të Luftës së 1920-s «Italianët në det» është përsëri në rendin e ditës dhe kësaj i është shtuar parulla historike e Partisë : «Vdekje fashizmit - Liri popullit!».

- Vdekje fashizmit vëllezër! - thirri dikush nga turma, me një zë të fortë.

- Liri popullit! - u përgjigjën të gjithë si oshëtimë.

- Po, - vazhdova plot emocione, - lirinë do ta fitojmë, për këtë jemi ngritur të gjithë në këmbë. Dy breza, babë e bir, nënë e bijë, gjenden përsëri në të njëjtat llogore, kundër të njëjtit armik. Po atë armik që dje prindërit tanë e hodhën në det, këtë herë ne do ta shfarosim në tokën tonë dhe kockat e tyre do të ngelen në fushat, në përrenjtë e në malet tona.

- Por, - vazhdova, - Luftën Nacionalçlirimtare, këtë luftë që do t'u sjellë lirinë atdheut dhe popullit, armiqtë po mundohen ta sabotojnë. Sadik Premtja as këtu nuk e pushoi veprimtarinë e tij prej tradhtari. Partisë i është dashur të merret për një kohë të gjatë me këtë tradhtar, ajo është treguar e duruar, e pjekur dhe e gjerë me të, ia ka bërë të qartë në çdo kohë se ku do ta çonte rruga që kishte nisur ai me tradhtarin tjetër Anastas Lulën, e ka këshilluar, i ka tërhequr vërejtje, por Sadik Premtja nuk ka përfillur asnjë këshillë e ndihmë të Partisë, mbeti armik konsekuent, sa, më në fund, Partia u detyrua ta përjashtonte nga radhët e saj. Partia, pali e dënoi, e solli në Vlorë që të ishte nën mbikëqyrjen e Qarkorit të këtushëm dhe i theksoi se i jepte mundësinë edhe një herë të korrigohej. Mirëpo Sadik Premtja hyri më thellë në rrugën e tradhtisë. Atij vazhdonte t'i punonte mendja te plani i vjetër, i cili ishte: të shkatërronte Partinë tonë, të kishte një parti që nga lufta të mos përcëllohej, ta kishte mirë me të gjithë, me okupatorë e me tradhtarë.

Këtu u shpjegova direktivat e Partisë për luftën dhe për organizimin e saj; u thashë se Sadik Premtja me disa shokë të tij nuk kishin vepruar drejt, por në kundërshtim me vijën e Partisë, me dëshirat dhe me aspiratat e popullit, se ata qenë përpjekur të rrezonin Qarkorin e Vlorës, i cili ndjek rrugën e Partisë, ua bëra të qartë edhe se si dështuan në këtë përpjekje. U shpjegova pastaj pak a shumë me hollësi cilat ishin pikëpamjet e Sadik Premtes dhe të Anastas Lulës. Pastaj vazhdova:

- Ju, vëllezër, e dini më mirë se kushdo tjetër se ç'dëm të madh i ka sjellë Xhepi organizimit të luftës kundër okupatorit në qarkun e Vlorës. Ai ka nuhatur dobësitë e disa shokëve që ishin në vende me rëndësi në Qarkor e në komandën e çetës, ka nxitur tek ata ambicien e karrierizmin, i ka komprometuar dhe i ka bërë bashkëpunëtorë të tij, i ka ngarkuar me detyrë që të sabotonin kudo, me çdo kusht. Sadik Premtja vetë, dhe me anën e këtyre njerëzve, - u thashë, - është përpjekur të futë në zemrat tuaja mosbesimin ndaj Partisë e ndaj forumeve udhëheqëse të saj, ka dashur t'ju shkëputë ju, popullin trim e patriot, nga bijtë tuaj më të zgjedhur e më të dashur, që i keni në krye të Partisë e të luftës këtu në qarkun e Vlorës. Ai me bashkëpunëtorët e tij kanë bërë akuza të ulëta për shokët tanë dhe bijtë tuaj që i kanë dalë zot kësaj lufte e që kanë llogaritur të japin edhe jetën për lirinë e popullit e të atdheut, kanë nxitur njerëzit kundër vendimeve e direktivave të Partisë, kundër aksioneve e kundër organizimit të Luftës Nacionalçlirimtare. Sadik Premtja kërkonte që ta shkëpuste organizatën e Partisë të Vlorës nga Partia Komuniste e Shqipërisë dhe ta largonte popullin e këtij qarku nga lufta kundër okupatorit, në një kohë që ky okupator po na e zhurit jetën me zjarr e me hekur. Të kërkosh këtë, është krimi më i madh, është tradhtia më e lartë.

E si mund t'i zihet besë më këtij tradhtari? Jo, vëllezër! Tash me Sadik Premten na ndan vetëm gryka e pushkës! Partinë e kemi në këmbë, vigjilente, trime. Rreth organizatës së Partisë këtu në Vlorë, rreth Komitetit Qarkor janë grumbulluar burra të moshuar, por sidomos të rinj e të reja, nga qyteti e nga fshatrat dhe po luftojnë me besnikëri e meguxim. Fitorja është jona, vëllezër! Të jemi vigjilentë, t'i zhdukim mbeturinat e fraksionit, të mos lejojmë të shfaqet më fryma e grupazhit në radhët tona.

Këto ishin, në përgjithësi, çështjet kryesore që ngrita atë ditë në mes të popullit, ku folam ndonjë orë a një orë e gjysmë dhe çdo gjë, me këtë rast, përfundoi me sukses.

Herë pas here populli brohoriste: «Rroftë Partia!», «Rroftë bashkimi i popullit në luftë», «Poshtë tradhtari Sadik Premtja!» etj. Këto thirrje i kujtoj me emocion, me dashuri e me nderim të thellë për njerëzit e thjeshtë që ishin mbledhur aty, në sheshin e Tragjasit, ku gjendjen shumë të rëndë e të rrezikshme për Partinë e kthym në një situatë të tillë luftarake, sa populli i krahinës brohoriste njëzëri: «Partia mbi të gjitha!». Ky qëndrim donte të thoshte se Sadik Premtja nuk kishte mundur t'i shtrinte rrënjët deri në popull. Zemrën e këtij populli trim e patriot e kishte fituar Partia Komuniste e Shqipërisë. Isha i bindur se, po të shfaqej pas kësaj mbledhjeje Sadik Premtja midis tyre, këta vetë do ta gjykonin sipas ligjeve të luftës dhe do ta varnin te dega e rrapit, buzë Izvorit, aty ku grumbulloheshin më shumë njerëz, që ta shihnin të gjithë e të kujtonin përherë sesi paguhet tradhtia. Por dhelpra dinake u fsheh si lepur, ferrave, se iu tremb gjykimit të popullit.

Në Tragjas mbaruam punë dhe morëm rrugën e kthimit andej nga erdhëm një ditë më parë. Ngjitja nga ana e Tragjasit është shumë më e lodhshme, se mali është thikë. Deri te shpella nuk e ndiem rrugën, mbasi ajo kalonte në një terren jo shumë të thyer, por, kur arritëm te zona e shkëmbinjve, aty ku mali lartësohej thikë mbi kokat tona, sikur e ngadalësuam pak hapin. Kishte filluar freskia, megjithatë na dukej si pika e vapës. Gurët e hirtë na lëshonin në fytyrë nxehtësinë që kishin thithur gjatë ditës, kurse në kurriz na binte dielli i pasdrekes. Burimin e kishim larg, përtej pllajës kur të dilnim në qafë. Por ne ishim të rinj e të fuqi shëm. Lufta na kishte kalitur. Sa rrugë kishim bërë duke kaluar shteg më shteg e brinjë më brinjë.

Nata na zuri në një shtëpi të Mazharit, te një mik i Hysni Kapos, i Partisë dhe i luftës, te xha Sherif Hasani, i cili na priti shumë mirë. Të lodhur nga gjithë ajo rrugë, bëmë një gjumë të këndshëm në dyshekët e shtruar me çarçafë të bardhë e me batanije të pastra përsipër.

Të nesërmen arritëm në Hysoverdh dhe u ndalëm përsëri te shtëpia e shokut Kadri Hazbiu. Atje na mbërriti doktor Ibrahim Dervishi, i cili kërkoi të bisedonte me mua. U tërhoqëm në një dhomë me disa shokë, ku erdhi edhe Ibrahim që filloi të më tregonte «tragedinë» e tij. Zemërimi i

Ibrahim Dervishit ishte shkaktuar, sepse shokët nuk e kishin lajmëruar me kohë, né qoftë se nuk gabohem, se Xhepi kishte tradhtuar, se i bëme goditjen e fundit dhe se po ndiqej nga komunistët, kështu që Braçja, siç e kemi quajtur, për një ditë a dy qëndroi, pa ditur gjë, në anën e grupit të Xhepit. Kur e mori vesh, ai e braktisi Xhepin menjëherë, por edhe me shokët u inatos shumë, se ishte doktor Ibrahim ai që i kishte thënë shokut Hysni se diçka po kurdiste Xhepi, prandaj nuk e priste që shokët të mos e informonin për çfarë ndodhi me Xhepin. Ai ngulte këmbë me kokëfortësi duke thënë se Qarkori e konsideronte doktorin si partizan të Xhepit, prandaj nuk i kishin besim dhe nuk e kishin vënë né dijeni. Hajde ta bindje doktor Ibrahimin! Dhamë e morëm të gjithë shokët, po pse, bindej doktori? Natyrisht, si i zemëruar që ishte, ai nuk i kontrollonte dot fjalët. Edhe shokët u nxehtën dhe grindja arriti deri aty sa Braçja u ngrit duke u bërtitur atyre: «Ju më tradhtuat mua dhe jo unë», «unë s'e dua më veten».

- Më lini vetëm me doktorin, - u thashë shokëve, - se e gjejmë ne fjalën me njëri-tjetrin.

Dy orë ndenja me të, e qetësova, u shpjeguam, i thashë se sa e donin shokët dhe sa besim kishte Partia tek ai etj. Kështu ai e mblodhi veten, dolëm në oborr dhe thirra shokët. Ky i përqafoi njërin pas tjetrit dhe u tha: «Unë tash jam i qetë, se më sqaroi Tarasi. Derisa të vdes do t'i qëndroj besnik Partisë. Tani po shkoj 'ku jam caktuar». Dhe u nis. «Dale doktor, - i thashë, se do të vij të eci ca me ty rrugës teposhtë». Dhe e shoqërova një gjysmë orë rrugë nëpër pyllin me dushk të Hysoverdhit. Rrugës i fola përsëri butë për ta qetësuar akoma më fort, për ta siguruar që doktor Ibrahim të mos mbetej i pizmosur, por, bashkë me Partinë, të hidhej me të gjitha forcat në luftën kundër fashistëve italianë. Doktorin u largua plotësisht i qartë, i gëzuar dhe me forca të reja. Ai luftoi dhe qëndroi vazhdimisht mirë me ne.

Doktor Ibrahim ishte nga doktorët e paktë që morën pjesë me armë në dorë në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Pas Çlirimit ai qëndroi në ushtri dhe arriti deri në gradën gjeneral. Më vonë e morëm si doktor pranë shokëve të udhëheqjes. Punonte me pasion, më donte shumë dhe u lodh që të më bindte të lija duhanin, por në lçetë :gjë nuk pati sukses. Ai u bë edhe ministër i Shëndetësisë dhe punonte mirë, po nga nervozizmi nuk u shërua krejt. Tash është në pension, komunist i mirë dhe i devotshëm për Partinë.

Në Hysoverdh, te shtëpia e shokut Kadri, qëndrova disa ditë, se përgatiteshim për analizën. Bëja edhe ndo një lëvizje nëpër disa fshatra, si, për shembull, në Mavrovë, në Shkozë e në Dushkarak, por bazën e kisha në Hysoverdh, kështu që m'u dha rasti të njihesha më mirë me familjen e shokut Kadri. Sa herë kthehesha në Hysoverdh, nënë Xhevoja më priste me plot kujdes e dashuri. Ajo ishte një grua e zgjuar, me tipare burrërore dhe me humor të hollë. Aty kam takuar edhe shokun Kadri dhe vëllanë e tij të madh. U ngjanin prindërve, djem të zgjuar e trima. Kadriu në atë kohë kishte dalë partizan. Ai u bë shpejt një luftëtar syptatrembur dhe pas Çlirimit një nga udhëheqësit më të shquar, kurdoherë besnik i Partisë dhe luftëtar i palodhur për çështjen e popullit e të socializmit.

Gjatë atyre ditëve takoja shokë të Qarkorit dhe shokë të tjerë që vepronin në këto zona, që merreshin me punën e Partisë në terren ose me drejtimin e njërive partizane dhe me organizimin e aksioneve.

Një mëngjes, kur isha në Dushkarak, më thanë se kishte ardhur shoku Manush Myftiu. Hysniu më kishte folur mirë për të si Shok i vendosur i Qarkorit dhe që luftohej nga xhepistët. I kisha thënë se doja ta takoja e të njihesha me të. Kur dola jashtë, Manushi m'u prezantua me pseudonimin e tij «Heqimi» (që i kishte mbetur se ndiqte studimet për mjekësi). U ulëm te shkallët. E pyeta ç'mendonte e si shkonin punët. Më foli për gjendjen e rëndë të krijuar nga Xhepi e pasuesit e tij, por u shpreh optimist për forcat që kishte organizata e Partisë dhe mbështetjen e kësaj nga populli shumë patriot e nga rinia revolucionare e Vlorës. Pastaj vazhduam bisedën, dulce shëtitur krah për krah nga shtëpia e deri te Kodra e Xhelile e... paf-puf, dulce pirë cigare papushuar. Manushi e pinte më keq se unë.

Ndër ato ditë që isha kthyer nga Tragjasi né Hysoverdh, para se të bënim mbledhjen e Qarkorit për analizën mbi punën armiçësore fraksioniste të Xhepit, u hodha përtej Vjosës, né zonën e Mallakastrës dhe shkova né e-orrush, te shtëpia e shokut Mehmet Shehu. ku do të rrija disa ditë.

Atje do të vazhdoja punën për t'u përgatitur për mbledhjen dhe ndërkohë, bashkë me Mehmetin do të shkonim për të takuar Vangjon. Mehmetin nuk e gjeta në shtëpi. Ai akoma nuk kishte ardhur, se ndodhej në pjesën e poshtme të Mallakastrës, ku pritej operacioni i afërt italian, por më pritën i ati, sheh Ismaili dhe nëna e tij, Sulltana. U përqaftuam me të dy dhe ata më futën brenda, në të hyrë të portës së madhe nga e majta, ku ndodhej një teqe. Por çfarë teqeje ishte ajo! Aty filluam bisedën me shehun. Ai më pyeti për luftën, ndërsa unë e p'yeta si shkonin punët në Mallakastër.

- Ja, mor djalë, - më tha ai, - edhe këtu, në Mallakastër po luftohet, por prapë kemi armiq.

- Kemi, - iu përgjigja unë, - se po të mos kishim, nuk do të qe nevoja të luftonim, por se kemi armiq, prandaj duhet të bashkohemi dhe t'i godasim.

- Ashtu është, - tha shehu, - nuk duhet të tremi mëshirë për këta qafirë.

Shehu ishte një burrë jo dhe shumë i gjatë, por imponant, me mjekër dhe me xhybe të zezë. Në kokë mbante një qylaf bojëhiri, rreth e rrotull me një buhasi të zezë, si i thoshim ne në Gjirokastër. Ai nuk ishte dervish bektashi, por sheh i sektit halveti. Megjithatë, për sa i përket fesë, m'u duk se as që e çante kokën fare për të.

- Po këtu keni njerëz të ligi? - e p'veta unë.

- Kemi sa të duash, - tha, - tremi si Bektash Cakranin e Rrapo Lelon.

Pastaj pyeti: - Po ju andej nga Gjirokastra treni nga këta biçimë?

- Kudo tra të tillë, o sheh, - i thashë unë, edhe ne në Gjirokastër kemi. Bejlerët në Gjirokastër

tremi qëruar me kohë, por agallarë, fajdexhinj e të tjerë si këta, kemi akoma.

Ai më përmendi emrin e një fajdexhiu nga Gj:rokastra.

- A e njeh? - më pyeti.

- Si s'e njoh, - i thashë, - po zotrote ku e njeh

- E njoh mirë unë atë fajdexhi, - m'u përgjigj, - se ai i tra shtrirë thonjtë deri në këto anët tona. Ai dhe disa të tjerë na kanë rrjepur lëkurën me fajde.

Meqë muhabeti doli te fajdexhinjtë e Gjirokastrës, nisa t'i tregoja shehut historinë e njërës prej tyre:

- E di ti, o sheh, një histori që e tregojmë ne në Gjirokastër për «filanti .fajdexhi? - e pyeta.

- Ta dëgjoj një here', - tha, - mbase nuk e di, por ma trego.

- Ky fajdexhiu, - fillova t'i them, - mbante mustaqe të mëdha. Një ditë një gjirokastrit, të cilit i kishte ardhur inati në majë të hundës nga ai, e shau atë mu në mes të pazarit, me nder teje i tha: «Të dhjefsha mustaqet, o kusar i madh». Mirëpo fajdexhiu do të mbronte «nderin» dhe e hodhi në gjyq. Ky që e shau, ishte i varfër i ziu dhe nuk ia dflte dot me gjyq, por s'kishte ç'të bënte, u detyrua të paraqitej. Gjykatësi donte ta shpëtonte, se e dinte që ishte i këputur.

- Ore, - i tha atij që kishte sharë fajdexhiun, - e tre sharë këtë ti?

- E kam sharë, - iu përgjigj ai.

- Jo more, nuk besoj ta kesh sharë, - ia priti gjykatësi, që donte ta mbronte.

- More po, e kam sharë, si nuk e kam sharë?! ngulte këmbë ai.

- Po çfarë i ke thënë? -e pyeti atëherë gjykatësi.

- Po ja, i k-am thënë kusar, - shpjegoi ai.

- Si ore, i ke thënë kusar? Pa mendohu njëherë! - i tha prapë për ta mbrojtur gjykatësi.

- More i kam thënë kusar që ç'ke me të, ngulte këmbë prapë ai.

- Po do të dënohesh, në rast se ia ke thënë, - i tha gjykatësi.

- Pse do të dënohem?! - pyeti ai.

- Se i ke thënë kusar, domethënë e ke sharë e për këtë dënohe, - i tha prapë gjykatësi.

I varfri u mendua pak, kruajti kokën dhe pastaj u ngrit e tha:

- Më pyesni pse e kam sharë? Si të mos e shaj? Pa shikojeni njëherë atë syfet në fytyrë!

- Ç't'i shikojmë?

- Po ja, shikojeni, ai ka rrëmbyer qime nga mjekra dhe ia ka futur mustaqes. Për këtë gjë unë i thashë kusar, se ka vjedhur mjekrën dhe ia ka dhënë mustaqes. Kjo është një kusëri, - sqaroi më në

fund ai. Të gjithë sa ishin në gjyq qeshën me të madhe dhe kështu ai e fitoi gjyqin dhe fajdexhiu nuk u ndie më, që të mos bëhej gazi i botës.

Qeshi edhe shehu bashkë me mua, sepse i pëlqeu zgjuarsia e gjirokastrit të varfër dhe tha: - Atë fajdexhiun gjirokastrit mustaqemadh e njoh se i pata marrë njëzet napolona borxh dhe më hëngri shpirtin gjersa ia lava, me gjithë fajde dyzet napolona.

- Por tani, - thashë, - po ikën koha kur fukaranë e hidhte në gjyq beu e agai. Do të vijë dita që populli do të ketë pushtetin e tij dhe ligjet e veta. E di ç'të bëjmë, o sheh, - vazhdova unë bisedën, - edhe Bektash Cakranin e Tefik Cfirin, edhe Ali Këlcyrat e fajdexhinjtë e Gjirokastrës, të gjithë ç'janë armiq, t'i futim në një thes, t'u lidhim një gur të madh dhe t'i hedhim në Vjosë.

- More këta qena janë për t'u hedhur dhe për t'u pushkatuar, - tha shehu. - Ah, kur s'ua shuajti racën Haxhi Qamili.

- Pse e njihje Haxhi Qamilin? Mos ke qenë gjë me të? - e pyeta.

- Me të kam qenë, - tha me krenari shehu, se ai ishte kundër bejlerëve dhe unë ata as nuk i shihja, e as nuk i shoh dot me sy.

- Mos ishe bashkuar me Haxhi Qamilin për punë të fesë? - e ngacmova unë, - se thoshin që ai ishte fetar.

- Çfarë fetari ishte Haxhi Qamili! Ai u ngrit se ishte kundër bejlerëve dhe pashallarëve. Jo or jo, nuk u ngrit për çështje feje ai, llafe ishin ato që thoshin atëherë për të.

Kështu ndenjëm atje për një kohë, dulce biseduar me shehun. Në mbrëmje dolëm te porta e shtëpisë, se edhe koha ishte e bukur e nuk bënte ftohtë. Në një sofat u ula unë, e në sofatin tjetër u ul shehu. Shikonim kodrën që kishim përballë dhe shkëmbenim ndonjë fjalë. Kur rrinim ulur te sofatet e shtëpisë, erdhi dhe një plak tjetër, një kushëri i Mehmetit.

- Hajde rri, - i tha shehu, - se kemi një shokun e Mehmetit. Do të rrish edhe ti për darkë, o Hysen, meqë ka ardhur dhe ky miku, - e ftoi ai xha Hysenin.

- Ju falemnderit, por unë nuk mund të rri, se kam punë. Qejfi ma kishte, po më vjen keq se nuk rri dot, - tha xha Hyseni dhe pas pak u largua.

Pasi bëmë edhe ca muhabet aty përjashta, shehu më ftoi të hynim në shtëpi.

- Hyjmë brenda, - tha, - se gratë do të na e kenë përgatitur darkën.

- Shkojmë, - iu përgjigja, - ndoshta tashti mund të vijë edhe Mehmeti.

- Kur nuk erdhi deri tashti, si zor të vijë sonte, - tha ai.

- Mirë, o sheh, por unë do të fle këtu.

- Flemë bashkë, - tha ai, - ja, teqenë përse e kemi?

- Pse, teqe është kjo? - e pyeta unë.

- Po, teqe i themi ne, - m'u përgjigj shehu, por çfarë teqeje është kjo, teqe zeza, ka vetëm atë tyrben ku është varrosur një nga pleqtë e mi.

Nën të ashtuquajturën teqe ishte konaku i familjes së shehut, por atje unë nuk hyra. Kur u futëm brenda, erdhi dhe hyri në bisedë me mua edhe nënë Sulltana, e cila më pyeti për nënën time, për familjen, më pyeti ç'njerëz kisha, nëse kisha vëllezër, motra e të tjerë. Iu përgjigja me kënaqësi nënë Sulltanës për të gjitha ato që më pyeti. Ajo ishte një grua shumë e dashur dhe që atëherë unë lidha miqësi të ngushtë me të shtrenjtën nënën e Mehmetit, të cilën e doja shumë, se ishte plakë shumë e mirë, por ama edhe ajo më donte shumë. Kur vdiq, mua më erdhi shumë keq dhe kam qarë për të.

Atë natë nënë Sulltana na kishte bërë një darkë të mirë. Pasi hëngrëm, shehu më tha:

- Nuk kalohet nata, o djalë, di të hedhësh zare ti?

- Zare? Nuk di zare unë, - iu përgjigja.

- Hajde o, se t'i mësoj unë, - më tha ai, - se mos është ndonjë punë e madhe.

- Në të vërtetë, - i thashë, - unë diçka di nga loja me zare, se kam parë kur luante plaku im tavlë.

- Jo mor jo me tavlë, se s'kam tavlë këtu unë, - tha shehu, por kam një kartë dhe atje do t'i hedhim zaret.

- Hajde, - i thashë unë, - i hedhim, pa punë e madhe.

- Të hedh unë i pari, - tha ai, - dhe filloi.

Hidh ai e hidh unë, hidh ai e hidh unë, e u bënë kështu nja 20 herë që i kishim hedhur. Në këtë kohë shehu më tha:

- Fitove ti, fitove, se ti je më i ri nga unë.

Pasi lamë lojën me zare, nisëm përsëri një bisedë dhe pas ca, erdhi nënë Sulltana e na shtroi për të fjetur aty për ahe. Ramë të flinim.

- Si fle ti, - më p'yeti shehu, - me kandil apo pa kandil?

- Si të duash zotrote, sheh, - i thashë unë, bëj si do vetë, unë jam nga ata që s'bëj naze, as në të ngrënë, as në të fjetur.

Pas kësaj bisede, shehu shuajti kandilin, u shtri dhe, menjëherë, e zuri gjumi. Filloi të gërhinte e ç'të gërhitur! Si plaku im, aeroplan fare. Por pas pak nuk e ndjeva më. Isha i lodhur dhe më zuri gjumi shpejt. Në mëngjes u ngritëm, dolëm jashtë dhe u lamë, i shtiva unë i pari ujë shehut e pastaj më shtiu edhe ai mua.

Sapo kishim ngrënë mëngjesin, kur erdhi Mehmeti. U përqaftuam.

- E, o sheh, - iu drejtua ai të jatit, - si shkuat?

- Mirë, - iu përgjigj shehu, - e paske të mirë këtë shokun.

- E shikon këtë shehun ti, - m'u drejtua mua Mehmeti, - është një i sertë ky që s'ke ide, po ama, - shtoi duke qeshur, - mua ma ka frikën.

- Unë ta kam frikën ty? - tha shehu. - Bah, po unë s'e kam njohur kurrë frikën! Jam sheh me kobure, unë! - shtoi pastaj me shaka. Të gjithë ne qeshëm me këtë thënie të shehut.

Me Mehmetin biseduam gjerë e gjatë për çështjen e luftës dhe për gjendjen në Mallakastër. Ai më tregoi se situata në atë zonë ishte shumë e mirë. Në masat popullore mbizotëronte një patriotizëm i madh.

- Ndonëse veprojnë edhe ata të Bektash Cakranit, të Tefik Cfirit e të tjerë, ne e kemi situatën në dorë, - tha Mehmeti.

Për sa i përket anës ekonomike, natyrisht, fshatrat e Mallakastrës kishin vështirësi të mëdha. Në ato kohë, fshatarët venin deri larg në Fier e në Vlorë me shpresë se mos gjenin ndonjë punë sa për të siguruar bukën, por kudo i priste vetëm mundimi e rraskapitja.

Nga dreka erdhi edhe Hysniu dhe bashkë me Mehmetin shkuam e takuam Vangjon atje ku mbahej i izoluar në një shtëpi. I folëm për takimin që kishim pasur me popullin në Tragjas dhe me fraksionistët e tjerë, i treguam për ata që njohën gabimet e tyre dhe se ia arritëm që disa prej tyre t'i bindnim që të dilnin përpara popullit, të bënin autokritikë e të premtonin se do ta braktisnin Xhepin dhe rrugën e tij, sepse ishte rruga e tradhtisë, kundër Luftës Nacionalçlirimtare dhe si e tillë ndihmonte okupatorin fashist.

- Ti, - i thamë, - i interesoje shumë Xhepi, se ishte komandant çete dhe ai synonte të hidhte çetën në dorë. Xhepi, i cili është i njohur për metodat dinake që përdor për të komprometuar njerëzit, e shfrytëzoi mirë ambicien dhe karrierizmin tënd, shfrytëzoi edhe krushqinë që ka me ty dhe të futi aq thellë në rrugën e tij, sa ti deshe ta përdorje çetën për t'iu imponuar me forcë Qarkorit të Partisë. Në vend që të punoje për të forcuar radhët tona, për të shtuar çetat, se populli i qarkut tuaj ka marrë armët e po lufton me trimëri kundër pushtuesve, ti re nën influencën e një elementi të pabesë e armik i tërbuar siç është Xhepi dhe po bënit planet për të arrestuar shokët e Qarkorit. Ne e dimë se ke filluar të kuptosh deri diku intrigat e planet antiparti të Xhepit por, me aq sa e njohim gjendjen këtu dhe veprimtarinë tënde, kjo ftohtësia jote ndaj Xhepit mos ka ardhur nga shkaqe personale? Partia kërkon që ti të ndahesh përfundimisht prej fraksionistëve, të tregon rrugën e vërtetë në të cilën duhet të ecësh, të jep të gjithë ndihmën që ta bësh këtë kthesë.

Folëm gjatë me të dhe në fund i theksuam se ai do të mund të shkëputej nga Xhepi vetëm në qoftë se do të arrinte ta dënonte atë si armik e si tradhtar dhe në qoftë se do të ishte i vendosur për Luftën Nacionalçlirimtare. Vangjoja, disa ditë më parë, u kishte dërguar shokëve të Qarkorit një autokritikë me shkrim, po sa do t'i besonim asaj autokritike të çalë, që të ngjante sikur ishte bërë më shumë për t'u justifikuar, duke ua hedhur fajin shokëve që nuk e paskeshin ndihmuar ta njihte mirë

Xhepin? A ishte i ndërgjegjshëm edhe për aq sa pranonte nga gabimet e tij, apo ishte më tepër i trem bur ?

Megjithatë, në takimin që bëmë, Vangjoja na premtoi se do të shkonte në çetë dhe do të luftonte si partizan i thjeshtë. Me kaq u ndamë. Por te ne mbeti një hije dyshimi: a ishte Neki Ymeri nga ata burra që Idshin kurajën të njihnin fajet dhe të këputnin lidhjet me Xhepin, lidhjet shoqërore, organizative e ideologjike?* *(Pas takimit me shokun Enver Hoxha dhe pas «autokritikës» që kishte bërë, Vangjoja u dërgua në çetë si partizan i thjeshtë. Por premtimet e tij kishin qenë false. Ai dezertoi përsëri dhe u ribashkua me Sadik Premten. Në gusht 1943 u vra si tradhtar nga një njësit partizan.)

Nga Çorrushit pastaj shkuam në Kutë e vazhduam rrugën për në Klos, te shtëpia e shokut tonë komunist e luftëtar, Bilbil Klosi. Kjo ishte një familje patriote. Fshatarëve u tërhoqi vëmendjen ardhja jonë dhe, ashtu siç ktheheshin nga puna, filluan të mbliáheshin në sheshin e fshatit. Shkuam edhe ne midis tyre dhe folëm për fraksionin e Sadik Premtes e ,për fundin e tij, për këshillat nacionalçlirimtarë që ishin ngritur në zonën e lirë të Mallakastrës, për çetat partizane që po shtoheshin gjithandej dhe për luftën që po zgjerohej në mbarë vendin.

Fshatarët e varfër mallakastriotë, shumë të interesuar se ç'mendonte Partia për gjendjen në atë zonë dhe për luftën në përgjithësi, dëgjonin me vëmendje dhe shprehnin besimin se këtë luftë do ta fitonte Partia me popullin. Ata e dinin se kjo fitore do të vinte me gjak e me sakrifica, por nuk flisnin për rrezikun, se ishin trima, të ndërgjegjshëm për sakrificën që do të bënin. K'y është populli.

Pasdarke te shtëpia e Bilbilit erdhën miq e shokë të familjes së tij, siç vinin gjithnjë në fshat për të nderuar mikun. Vazhdoi po ajo bisedë e ngrohtë e plot zjarr që kishim nisur te sheshi.

Gjatë atyre ditëve që qëndrova në Çorrush, në Kutë e në Klos u njoha për herë të parë nga afër me Mallakastrën.

U ktheva përsëri në Hysoverdh, ku do të bënim analizën e punës për shpartallimin e fraksionit. Në ditën e caktuar u mbledhëm dhe filluam diskutimet për probleme organizative, politike dhe ideologjike. Aty shpjegova arsyet që bënë të mundshme veprimet antiparti të Sadik Premtes. Theksova se Xhepi e kishte treguar kurdoherë veten si element armik i pakorrigjueshëm, i pabesë e intrigant në kulm, mirëpo anëtarëve të Partisë dhe simpatizantëve të saj në qarkun e Vlore's u ishte folur pak për shkaqet pse u dënua nga Partia dhe për dëmet e mëdha që i ka sjellë punës së saj. Komiteti Qendror e njihte mirë Sadik Premten, prandaj kishte porositur t'u bëhej e qartë njerëzve rrezikshmëria që paraqiste, të demaskohej veprimtaria e tij dhe të mbahej nën kontroll të vazhdueshëm. Kjo, porosi, vura në dukje, nuk është zbatuar me tërë seriozitetin që kërkohej, prandaj pati mungesë vigjilence në ndjekjen hap pas hapi të veprimtarisë së këtushme të Xhepit.

Ai përfitoi edhe nga niveli i ulët i disa komunistëve dhe filloi të përpunonte njere'zit. Xhepi i kishte studiuar elementët ku mendonte të mbështetej. Te disa drejtues ai kishte vënë re shenja ambicioze e karrierizmi dhe pikërisht këto dobësi të tyre shfrytëzoi. Po të kërkohej më shumë llogari nga shokët e Qarkorit dhe po të kontrollohej me rigorozitet në rrugë partie veprimtaria e elementëve të sëmurë, atëherë këta elementë të dyshimtë, ambiciozë e karrieristë, që u bënë bashkëpunëtorë të Xhepit, do të frenoheshin në kohë dhe, ose do të ndreqeshin, ose do të hidheshin jashtë Partisë pa arritur ta dëmtonin atë.

Pasi diskutuam për shkaqet pse mundi të organizohej fraksioni, ne u ndalëm gjerë te detyrat që na dilnin. Fraksioni u likuidua, por pasojat e tij akoma jo. Duke folur për këtë çështje, porosita shokët që të merrnin masa të menjëhershme e radikale, të ishin të pamëshirshëm me këta armiq.

- Jemi në luftë, - u thashë, - e lufta nuk pret. Ajo kërkon ta shëndoshim medoemos e menjëherë gjendjen. Elementët e dyshimtë e të lëkundshëm që kanë vende drejtuese kudo qoftë të zëvendësohen me të tjerë. Në gjirin e Partisë e të popullit ka plot bij besnikë, trima dhe të zgjuar, të aftë për ta drejtuar luftën. Të dyshimtët e të lëkundshmit nuk mund të jenë në pararojë. Kjo që ndodhi është një mësim për të gjithë ne.

Lufta për t'u prerë krahët e për t'i izoluar grupashët kërkon forcimin e radhëve tona, ngritjen ideologjike të shokëve, zbatimin me besnikëri të direktivave të Komitetit Qendror. Këtë e kemi vetë në dorë ta realizojmë. Likuidimi i fraksionit antiparti do ta forcojë organizatën e Partisë të Vlorës dhe gjithë Partinë.

Pasi diskutuam gjerësisht, tok me shokët e Vlorës, vendosëm për disa masa që ishin të domosdoshme të merreshin, si për organizimin më të fortë të Partisë, për një punë politike më të thellë dhe për një agjitacion e propagandë më të madhe, më të gjerë si në Parti edhe në popull, sepse duhej bërë e qartë puna armiqësore e Sadik Premtes dhe duhej rritur besimi në Luftën Nacionalçlirimtare. Këto masa synonin fuqizimin e unitetit të popullit rreth Partisë dhe hedhjen e tij në luftë të pandërprerë e të guximshme kundër okupatorëve dhe kundër të gjithë atyre elementëve që do të përpiqeshin ta pengonin këtë luftë.

Para se të mbyllej mbledhja, u ngrit Hysniu. Sekretari politik i Qarkorit shprehu bindjen se do t'i kryenin me besnikëri të gjitha detyrat që caktoi kjo mbledhje, si dhe çdo detyrë që do t'u ngarkonte Komiteti Qendror i Partisë. «Ju premtojmë, shoku Taras, - tha ai, - se Vlora do të jetë gjithnjë me Partinë. Këtë theksuan të gjithë shokët kur diskutuan, kjo është edhe bindja ime». Hysniu foli i qetë, serioz dhe i vendosur.

Ajo ishte një analizë e thellë që na shërbeu të gjithëve. Isha i bindur se komunistët e Vlorës do të vepronin menjëherë dhe do të zbatonin urdhrat e Komitetit Qendror. Nuk mund të ndodhte ndryshe në një vend si Vlora, e njohur në luftërat kundër pushtuesve dhe e futur nën ndikimin e ideve komuniste që në kchën e grupeve. Këto ide ishin përhapur që atëherë në radhët e studentëve, në shtresat e varfra të qytetit e të fshatit. Në Vlorë, qysh me Themelimin e Partisë, u hrijua menjëherë organizata e Partisë.

Në Vlorë Partia kishte Hysni Kapon, udhëheqësin e Qarkorit, njërin nga shokët tanë më të çeliktë, komunistin besnik dhe syshqiponjë. Ai mori pikërisht pseudonimin aq kuptimplotë «Besniku», besnik i Partisë dhe i popullit deri në vdekje e.

Shokëve të Vlorës Partia u kishte dërguar një shok tjetër komunist. heroik e besnik për tërë jetën ndaj Partisë dhe idealeve të saj, partizanin e vjetër, luftëtarin e Spanjës Republikane dhe anëtarin e Brigadës Internacionaliste «Garibaldi», Mehmet Shehun, që mori pseudonimin «Vjosa». Komiteti Qarkor i Partisë i Vlorës e kishte zgjedhur sekretar organizativ të tij.

Organizata e Partisë në Vlorë patjetër do të shëndoshej, do të forcohej. Garanci për këtë ishin udhëheqësit e sprovuar të saj, si Hysni Kapo e Mehmet Shehu, ishin të gjithë shokët e Qarkorit, që shprehnin vendosmëri, vullnet e besim, ishin komunistët e thjeshtë që prinin në pararojë e binin në fushën e nderit, duke u bërë frymëzim për të gjithë luftëtarët e lirisë, ishte populli patriot i këtyre krahinave, ishte rinia e zjarrtë e Vlorës.

Para se të largohesha nga zona e Vlorës, kisha edhe një punë për të kryer. Komiteti Qendror i Partisë sonë përpiqej që, si kudo, edhe këtu të merrte kontakt me nacionalistët, të shpjegonte luftën, qëllimet e saj dhe të bashkonte forcat e popullit në luftë kundër pushtuesve. Për këtë qëllim Qarkori i Vlorës, dhe personalisht shoku Hysni Kapo, më kishte organizuar takimin me Tahir Hoxhën dhe me Xysni Lepenicën.

Hysni Lepenica, i cili e kishte mbështetur fraksionin e Sadik Premtes me të gjitha mundësitë, shumë më i ri se Tahir Hoxha, hiqej si komunist, sepse kishte qenë anëtar i Grupit të «Zjarrit». Dihet që ky grup nuk desh të bashkohej me Partinë dhe krerët e tij ishin agjentë të Mustafa Krujës e bashkëpunonin me të. Në atë kohë ne e kishim demaskuar përfundimisht «Zjarrin» dhe anëtarët e mirë të këtij grupi, të mashtruar prej trockistit Andrea Zisi e të tjerë, po i afronim e po i pranonim në radhët tona duke u kujdesur vazhdimisht për edukimin e tyre me pikëpamjet ideologjike, politike e organizative të Partisë sonë. Hysni Lepenica ishte oficer, njeri i gjallë, trupgjatë, shkonte pas avazit: «Armikun mos e duaj, por pjesën ia ruaj»; ishte ballist trim. Ne donim dhe luftonim që ai të mos mbetej me Ballin, por parimet nuk mund t'i shkelnim. Hysni Lepenica rrinte gjoja në ilegalitet, ose më mirë në gjysmlegalitet. Kur dilte nëpër fshatra, si në Gjorm, Dukat etj., për të bërë propagandë për personin e tij ndër agallarë e në familjet që ishin fis e gjini me intelektualë të qytetit, si mësues ose avokatë, ai mbante me vete disa fshatarë të armatosur. Me këtë donte të tregonte se ishte në «luftë» me italianët, por, me gjithë trimërinë e tij, nuk e shkrepri kurrë, veçse, më vonë, kundër forcave tona.

Takimi me Hysni Lepenicën dhe me Tahir Hoxhën u bë në shtëpinë e dajës së shokut Mehmet Shehu, +.,e Gani Aliko, në fshatin Shkozë. Nga ana jonë ishim unë dhe Hysni Kapoja.

Biseda vazhdoi gjatë. Patëm debate e shkëmbyem mendime secili prej nesh, për luftën, për organizimin e saj etj.

Fjalët e këtyre të ashtuquajtur nacionalistë s'ishin veçse demagogji.

- Ne jemi dakord që të luftojmë, por jo kështu, siç bëni ju, - tha Tahiri. - Ju ngrini çunakët që s'dëgjojnë as nënë, as baba (e hidhte fjalën për fëmijët e tij që kishin rrëmbyer pushkën bashkë me ne dhe ishin në kundërshtim të hapur me të) dhe venë gjoja të luftojnë. Po në fakt ata s'dinë të luftojnë.

- Pse, nuk e quan luftë zotrote të sulmsh depot, t'i djegësh, të vritesh me italianët dhe të armatosësh veten dhe popullin? - i thashë Tahir Hoxhës.

- Jo, - tha Tahiri, - unë nuk e quaj luftë atë që të vrasësh spiunë. Luftë quaj unë atë të Selam Musait, me llogore.

- Po atë luftë po bëjmë, - i tha shoku Hysni. Ne dimë ta bëjmë edhe atë luftë. Hajde të luftojmë së toku.

- Jo, - tha Tahiri, - duhet ta përgatitim, duhet të kemi edhe ne topa e mitraloza.

- Po Selami, - i thashë unë, - ku i gjeti topat, apo ia fabrikoi uzina e armëve e Salarisë? E harrove historinë, zoti Tahir, kujtohu si thotë populli: «E zure topin nga gryka, Selam Musai o lule».

- Nuk janë pjekur situatat për luftë, - nguli këmbë në të tijën Tahir Hoxha.

- Ç'situata prisni ju, zoti Tahir, - e pyeta, vendi është i okupuar, populli e urren fashizmin dhe faktikisht është ngritur i gjithi në këmbë, po lufton me trimëri, po derdh gjak.

- Të organizohemi njëherë, se lufta nuk bëhet me nga një të shkrehur, çak këtu e bamb atje, - u mundua Tahiri t'i hidhte ujë zjarrit.

- Lufta po gjëmon, Tahir Hoxha! Ju këtë e dini fort mirë, - i thashë, - por nuk doni ta pranoni. Kjo luftë është e organizuar dhe e drejtuar nga Partia Komuniste e Shqipërisë, nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, i cili përfaqëson popullin dhe pikërisht kjo është arsyeja që okupatorëve italianë po u vjen fundi. Edhe këtë e dini, tjetër gjë se nuk doni ta pranoni. Sa për «çunakët që venë gjoja të luftojnë», është e tepërt t'ju themi se ata po tregojnë një pjekuri dhe trimëri të rrallë. Heroizmin legjendar të partizanëve tashmë e njohim të gjithë. Ne ju bëjmë thirrje të hidheni pa rezerva, sa nuk është vonë, kundër okupatorëve e tradhtarëve, se interesi i Luftës Nacionalçlirimtare e kërkon të jemi të bashkuar. Ju jeni të lirë të zgjidhni rrugën tuaj, ne e kemi për detyrë t'ju themi se, po ecët kundër interesave të popullit, jeni të humbur.

Hysni Lepenica, megjithëse, në fakt, ishte kundër nesh, bënte gjoja sikur lëkundej. Duke parë se nuk u morëm vesh, e lamë që me ta të bisedonin prapë shokët e Vlorës, të cilët bënë çmos, por nuk u arrit asgjë.

Kur bisedës i kishim dhënë fund e po përgatiteshim për të shkuar, Hysni Lepenica na tha: «Dua të kem një bisedë të veçantë me ju». Dhe ne pranuan. ù ndamë me Tahir Hoxhën dhe që të tre, unë, shoku Hysni Kapo e Hysni Lepenica u nisëm për në Dushkarak. Shkuam te xha Murati. Ai ishte një plak shumë i mirë, i dashur, trim, besnik i Partisë. Farefisi i tij, i madh e i vogël, ishin partizanë.

Pak para se të fillonte takimi, që do të bëja me Hysni Lepenicën, erdhi shoku Rrapo Dervishi, që ishte përgjegjës i Partisë për krahinën e Kudhësit. Biseduam fare pak se nuk kisha kohë. Ai, duke ikur, më tha se xha Murati ishte në merak dhe e kishte pyetur Rrapon nëse duhej ta therte një berr. «Më kanë ardhur miq këta goxha burra, kishte thënë, - po kujt t'ia ndreq e kujt t'ia prish, se ju partizanët s'i keni qejf këto harxhe e gostira. . .». Qeshëm e pastaj, si me shaka, i thashë xha Muratit: «Ja, ne komunistët e partizanët luftojmë jo vetëm për lirinë e madhe, çlirimin e atdheut dhe të popullit, por edhe për çlirimin e njerëzve nga lloj-lloj zakonesh e telashesh që u rënden, si në ekonominë e tyre ashtu edhe në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, në famiije e në shoqëri».

Filluam bisedën me Hysni Lepenicën. Ai na shtroi dy gjëra: e para, çështjen e Grupit të «Zjarrit», «pjesëtar i të cilit tram qenë dhe unë me Fetah Butkën e të tjerë», - siç tha, dhe, e dyta, çështjen e Sadik Premtes.

Dukej qartë se Hysni Lepenica ishte kundër trajtimit dhe luftës që i kishte bërë Partia jonë këtij grupi arqiomarksist. Kjo, siç u shpreh ai, ishte «një padrejtësi që i qe bërë partisë së tij», sepse, siç pretendente ai, «Zjarri» na paskej qenë një «parti e vërtetë komuniste», se vetëm kjo kishte qenë e lidhur me Kominternin, paskej pasur edhe «vulën» e tij etj. Nuk jam dakord, shtoi Hysni Lepenica, as me trajtimin që i bëtë ju dhe Qarkori i Vlorës çështjes së Sadik Premtes. Ai është komunist i kulluar, është miku im i ngushtë dhe unë dëshiroj t'i ndaloni ndjekjet kundër tij. Duhet të dini se ai është nën mbrojtjen time dhe, po goditët Sadik Premten, më treni goditur edhe mua.

Këto tha Hysni Lepenica. Pasi mbaroi ai, e mora fjalën unë:

- Problemi i Grupit të «Zjarrit» qëndron kështu: Me Fetah Butkën e Anastas Plasarin, që kanë qenë ndër krerët e këtij grupi, tram marrë kontakt vetë, tram biseduar gjatë me ta, jam përpjekur t'u shpjegoj politikën e Grupit të Korçës dhe të Partisë që themeluam. Me Andrea Zisin me kohë kanë marrë kontakt shokë të tjerë në Korçë. Ai është një provokator, trockist, agjent i anglezëve, i grekëve dhe tash i Musfafa Krujës. Puna e «vulës» dhe e «lidhjeve me Kominternin» është një gënjeshtër e madhe, por besoj se ju, - i thashë Lepenicës, - nuk jeni aq naiv sa ta hani këtë. Të gjitha këto ua tram shpjeguar edhe Fetahut, edhe Plasarit, por ata nuk deshën të bindeshin. Megjithatë ne ju bëmë ftesë si Grup i «Zjarrit» që të merrnit pjesë në bisedimet për formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, me kusht që të demaskonit tradhtarin dhe agjentin Andrea Zisi e disa të tjerë, të pranoni, në qoftë se ishit komunistë, vendimet që do të merrte shumica dhe t'u bindeshit këtyre vendimeve. Grupi i «Zjarrit», domethënë ju me shokë, nuk pranuat të vinit në Mbledhjen e grupeve. Kjo tregonte për Partinë tonë se krerët e Grupit të «Zjarrit» mund të ishin çdo gjë, por komunistë nuk ishin. Ata ishin ose trockistë, ose nacionalistë antikomunistë. Është e qartë se Fetahu u bashkua me Safetin dhe ju, Hysni Lepenica, mbrëmë u treguat shumë i afruar me Tahir Hoxhën, e aspak me ne.

Për Partinë Komuniste të Shqipërisë Grupi i «Zjarrit» si grup tra mbaruar. Në një artikull që tram botuar pak kohë më parë, të cilin besoj se e tre lexuar, ne demaskonim synimet trockiste, likuidatore e oportuniste të këtij grupi dhe fytyrën e vërtetë të krerëve të tij si shërbëtorë të fashizmit e të Mustafa Krujës, të cilët përpiqeshin të sabotonin luftën tonë dhe unitetin e popullit në Frontin Nacionalçlirimtar. Pas këtij demaskimi publik Grupi i «Zjarrit» humbi pa nam e pa nishan. Komunistët e gabuar e të gënjyer nga krerët po bashkohen me Partinë. Prandaj nga të gjitha ato çka thatë ju, zoti Lepenica, asnjë nuk pranojmë, pikëpamje të tilla i hedhim poshtë e do t'i luftojmë.

- E treni gabim, - m'u përgjigj Hysni Lepenica. - Ju do të humbitni e do të jeni shkaktarë të gjakderdhjes.

- S'gabohemi ne, por ju, - i thashë. - Vëllavrasjen po e filloni ju dhe jo ne. Ne kemi filluar e do të vazhdojmë deri në fund luftën kundër pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ne dëshirojmë shumë dhe ju bëjmë thirrje, zoti Lepenica, që të bashkoheni pa hezitim me ne në Luftën Nacionalçlirimtare. Për sa i përket Sadik Premtes, që ju e merrni nën mbrojtje deri në atë shkallë sa të ria kërcënoni, po ju themi haptas se nuk ria frikësoni dot. Mundet që as ju nuk frikësoheni riga ne, por çështjen e shtruat gabim dhe ju themi se duhet të tërhiqeni riga ky gabim. Çështja e Sadik Premtes është çështje e brendshme e Partisë sonë. Ai ishte anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë, «pranoi» direktivat dhe vendimet e saj, por si tradhtar, si renegat, si trockist që ishte, u hodh kundër Partisë, organizoi edhe puçin kundër Qarkorit. Ai u dënua me vdekje riga Partia Komuniste e Shqipërisë si agjent i të huajve, si armik i Partisë, i popullit dhe i Luftës Nacionalçlirimtare, prandaj Sadik Premten nuk e falim dhe nuk mund ta shpëtojnë dot as ju, as karabinieria e italianëve, as milicët e Halil Alisë dhe të Qazim Koculit. Po ta gjejmë Xhepin, po të themi hapur, do ta pushkatojmë.

- Atëherë, - tha Lepenica, - e mbaruam bisedën. Me ju nuk u morëm vesh në asnjë çështje. Ju më vutë pushkën.

- Nuk është e vërtetë, - i thashë, - varet riga ju në rast se do të shkëmbejmë pushkë, por rrugën tonë ne nuk e ndërrojmë. S'ka forcë që të ria lëkundë riga parimet dhe riga qëllimet e shenjta që i ka caktuar vetes Partia.

- As ne, - tha Lepenica, - nuk e ndërrojmë rrugën tonë.

I dhamë dorën njëri-tjetrit, e përcollëm deri te dera dhe u ndamë me të. Nuk ia pashë më sytë këtij ballisti arrogant, pseudonacionalist dhe bashkëpunëtor i italianëve, si një riga krerët e Ballit Kombëtar.

Ai u vra në Grëhot të Gjirokastrës, ku italianët kishin kazermat e tyre dhe ishin grumbulluar atje, të rrethuar m2 topa, mortaja dhe mitraloza, si breshka brenda në guaskën e vet. Kjo ndodhi në kohën kur kapitulloi Italia. Fronti Nacionalçlirimtar kishte lëshuar atëherë komunikatën, me anën e së cilës i bëhej thirrje ushtrisë italiane që të mos dorëzohej te gjermanët, sepse këta do t'i grinin, por të dilnin në mal dhe ata, që do të dëshironin të luftonin tok me ne, do t'i pranonim. Thirrja jonë u dëgjua riga shumë reparte italiane, me ushtarët e të cilave ne formuam batalionin

•«Antonio Gramshi». Balli Kombëtar tashmë ishte ndeshur me forcat tona. Kishte kohë që qe nënshkruar protokollin Dalmaco-Këlcyra për të ria sulmuar së toku, italianë e ballistë, batalionet dhe brigadat tona partizane. Pra kjo marrëveshje midis tyre po zbatohet. Hysni Lepenica në këtë kohë ishte bërë një eksponent i Ballit dhe çeta e tij ishte nën drejtimin e Ali bej Këlcyrës.

U dhamë urdhër forcave partizane të sulmonin Gjirokastrën, të spastronin qytetin, të vendosnin pushtetin e këshillave nacionalçlirimtarë dhe të mos lejonin në asnjë mënyrë futjen e ballistëve. Mirëpo Bedri Spahiu hyri në bisedime me ballistët dhe, sido që forcat tona e kishin në dorë situatën në Gjirokastrë, i lejoi të hynin. Në këtë qytet ndodhej në atë kohë edhe Hysni Lepenica me çetën e tij dhe ky, i fortë riga «miqësia me Dalmacot», u nis me shpejtësi të shkonte të merrte në dorëzim kazermat italiane. Tanëve ne u kishim dhënë urdhër si të vepronin: me kujdes të rrethonin nga larg kazermat, t'u prisnin italianëve rrugët e ndihmat, t'u hidhnin komunikatën e thirrjes etj. Dhe kështu vepruan.

Kurse Hysni Lepenica me çetën e tij u nis me «hap», me pushkët poshtë, si te «miqtë». (!) Mirëpo miqtë nuk e kishin ftuar dhe i grinë të gjithë me mitraloza. S'mbeti asnjë në këmbë i gjallë. Hysni Lepenica, ky zjarrist, mik i Xhepit e ballist, u vra si qeni në vreshtë.

Të nesërmen u ktheva në Shkozë, te Gani Alikoja, ku më priste Mehmeti. Kisha mbaruar punë në kU~të anë të Vjosës. Bashkë me Mehmetin u hodhëm përsëri në Mallakastër dhe morëm rrugën për në Çorrush, te shtëpia e tij.

- Mirë që më erdhe edhe njëherë në shtëpi, më tha shehu, sa më pa, dhe më përqafoi, - se do të më kishe lënë me një merak të madh.

- Nuk largohesha që këtej pa të takuar edhe njëherë, - iu përgjigja, - u bëmë miq, më hyre në zemër. Po si është puna, sheh? - i thashë.

- Uluni njëherë, se jeni lodhur, po kemi kohë të bisedojmë.

Mehmeti më shkeli syrin. Ia kishin treguar historinë e pelës, por u bë i paditur para shehut. Mezi mbanim të qeshurën, kurse ai priste çastin e përshtatshëm që të na shpjegonte si ndodhi. Puna ishte se, kur u largova herën e parë nga Çorrush për në Hysoverdh, kërkova një kafshë, por shehu s'e kishte aty pelën. Sa u nisa unë në këmbë, e shoqja i kishte thënë: - Si, o burrë, e le goxha shok të niset në këmbë? Ta gjeje, ku ta gjeje një kafshë.

Ndërsa unë po udhëtoja, afër Kalivaçit më arriti në rrugë xha Hyseni, kushëriri i Mehmetit, hipur mbi një kalë, gjithë djersë nga të rendurit me vrap.

- Më dërgoi sheh Ismaili, - më tha, - na, hip këtu.

- Pse u mundove, - i thashë, - s'ishte nevoja, unë jam mësuar të eci në këmbë.

- Merre, - më tha, - se, po e mori vesh Mehmeti, që nuk të siguroam një kalë, na vrau.

Qeshëm të dy. Kjo ishte historia për pelën, që i kishte mbetur peng sheh Ismailit.

- More, pa na thoni, - hapi muhabetin shehu, - ç'gatuat andej nga Vlora?

- Në Vlorë e në gjithë Shqipërinë po «gatuhet». revolucionin, - i thashë. - Fraksioni i Sadik Premtes mori fund.

Biseda jonë u përqendrua te ngjarjet e mëdha të kohës.

Të nesërmen në mëngjes u largova nga Çorrush. Më përcollën Mehmeti, shehu e nënë Sulltana, u puthëm e u përqafoam me ta. Më shoqëronin një udhërrëfyes dhe 3-4 partizanë që kishte zgjedhur Mehmeti.

Edhe sot i kam të gjalla përshtypjet nga ky udhëtim, nëpër gjithë këto vende nga kalova, ku populli ishte i lidhur me Luftën Nacionalçlirimtare; të paharruara kanë mbetur në mendjen e në zemrën time kujtimet, sidomos për njerëzit që na kanë pritur me aq ngratësi e dashuri.

Do të kaloja nëpër Skrapar dhe prej andej do të shkoja në Korçë. Bëmë shumë rrugë. Kur arritëm te një teqe, qëndruam aty për të kaluar natën. Të nesërmen dolëm në xhade mbi Paraspuar, zbritëm poshtë dhe ndoqëm rrugën derisa arritëm në fshatin Vërzhezhë, te Pasho Hysi. Ky ishte një patriot i dëgjuar e i nderuar, i cili e kishte nisur që në moshë të re rrugën e luftës për liri e pavarësi. Pikërisht se ishte afirmuar si i tillë dhe se mori pjesë me të gjitha forcat në Luftën Nacionalçlirimtare, Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare që u bë në Labinot e zgjodhi atë anëtar të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Nacionalçlirimtar. Shtëpia e Pasho Hysit u bë një nga bazat më të rëndësishme të Partisë në atë krahinë. Djemtë e nipërit e tij, Neshati dhe të tjerët, ishin dalluar si luftëtarë të vendosur e trima.

Sa mbërritëm në Vërzhezhë, ata dolën e më pritën. E dinin që do të veja, se i kishin lajmëruar. Tok me ta ishin edhe disa shokë të tjerë, me të cilët do të bëja një mbledhje. Shkuam në dhomën sipër, ku na shtruan për të ngrënë dhe filloi biseda aty ku na dhimbte dhëmbi, për luftën e popullit kundër pushtuesve e tradhtarëve. Atje ai na foli për situatën në Skrapar, për urrejtjen ndaj pushtuesit që kishte populli, i cili ishte kurdoherë i gatshëm për të luftuar. Pashoja na tregoi se pushkë e municione kishin, por jo të mjaftueshme, megjithatë, çetat e Skraparit ishin ndeshur me italianët, kishin çliruar edhe Çorovodën, kurse Vërzhezhja e të gjitha fshatrat e tjera ishin krejt të çliruara.

Atë natë fjetëm në Vërzhezhë dhe në mëngjes dolëm përpara shtëpisë së Pashos, ku pritëm sa erdhi një korrier tjetër, që do të më përcillte deri në Zalosh një, se korrieri që më kishte sjellë nga Mallakastra u kthye në Corrush. Ngado që të ktheje sytë, shihje vetëm male. Përballë nesh ishte Veleshnja, vendlindja e Zylyftar Veleshnjës, e njërit prej partizanëve të parë, bir i shquar i popullit të Skraparit. Ai kishte marrë pjesë në shumë luftime të ashpra, ishte plagosur rëndë në përpjekje me armiqte dhe kurdoherë dallohej si luftëtar trim.

Sa erdhi korrieri u ndamë me Pashon dhe me familjen e Hysajve dhe morëm udhën përmes luginave të thella e shpateve të maleve, drejt Zaloshnjës. Atje qëndruam te shtëpia e xha Hysenit.

Hysen Zaloshnja ishte një burrë i mirë dhe shakaxhi. Me të unë isha njohur edhe më parë nëpërmjet një mikut tim. E dija se rridhte nga një familje me tradita patriotike.

Kur vajta unë, ai nuk ndodhej në shtëpi, megjithatë më pritën të tjerë, burrat e gratë e shtëpisë, të cilët më ftuan të hyja brenda dhe më çuan në dhomën e madhe. Në krye të kësaj dhome, në minder, mbi një shilte, ishte ulur e rrinte plaku i shtëpisë, babai i Hysenit, Mahmud Zaloshnja. Unë i dhashë dorën, e përshëndeta dhe ai më përqafoi. Pasi u ula, ai filloi bisedën.

- Nga të kemi ty, mor djalë? - m'u drejtua.

- Jam nga Gjirokastra, - iu përgjigja.

- Po si ta thonë emrin? - më pyeti.

Pasi i tregova si më quanin, ai vazhdoi të më pyeste përsëri.

- More, - më tha, - në kohën e Ismail Qerralit, kur ngritëm Flamurin në Vlorë, se isha edhe unë atje, ishte edhe një Hysen efendi Hoxha nga Gjirokastra, ç'e ke ti atë?

- E kam xhaxha, - i thashë unë.

- O, po kemi qenë miq me Hysen Efendinë, tha e, pasi më përqafoi, shtoi: - Kanë qenë kohë të vështira ato, mor djalë.

- Ashtu kanë qenë, - i thashë unë, - të vështira, por populli i ka kaluar vështirësitë, sado të mëdha që kanë qenë, sepse ka pasur një shpirt luftarak, përparimtar dhe e donte lirinë. Ja, shikoje, edhe tashti vendi është i okupuar, por populli nuk e ka përkulur kurrizin përpara armiqve. Kemi organizuar luftën dhe po i godasim fashistët italianë dhe gjithë tradhtarët.

- E, - tha plaku, - duhet t'u biem këtyre tradhtarëve, se këta na kanë prishur punë kurdoherë. Unë jam plak, por megjithatë e di që të tillë Shqipëria ka pasur dhe kam luftuar me pushkë kundër tyre.

- Ka pasur, xha Mahmud, - i thashë unë, dhe ka akoma, ka mjaft nga ata që bëjnë lojën e okupatorit italian. Po, sidoqoftë, ne përpiqemi t'u bëjmë thirrje atyre, që u ka mbetur pak ndershmëri që të bashkohen me ne dhe të japin prova se e duan popullin duke luftuar kundër okupatorëve. Në qoftë se ata gjakosen me okupatorët krah për krah me ne, atëherë kemi bindjen se ata do të ndreqen, por në rast se nuk futen në luftë, me siguri, xha Mahmud, do të venë me italianët.

- Ashtu është, mor djalë, - më tha, dhe vazhduam kështu bisedën.

Xha Mahmudi më tha se gjendja në Skrapar ishte e mirë, «ishte top», siç e quajti ai.

Atë natë, aty këmbëkryq, me xha Mahmudin e me disa fshatarë të tjerë që u mblodhën biseduam gjatë për Luftën Nacionalçlirimtare që po merrte përpjesëtime të mëdha anembanë vendit, për mobilizimin e popullit në këtë luftë. Në mënyrë të veçantë plakut i bënë përshtypje të thellë ato që i tregova për Myslim Pezën e luftëtarët e tij, për Baba Faja Martaneshin e të tjerë.

- Më rrofshi, - thoshte xha Mahmudi e merrte gotën e rakisë. - Hajde, të paçim!

- Të rroni ju, të rrojë populli! - i thosha dhe e trokitja gotën me të.

- Armë të pathyera! - përshëndeste plaku dhe gjallërohej i tëri. Kjo qe bërë një shprehje e dashur në përshëndetjen e luftëtarëve të lirisë.

Gjatë bisedës u interesova për organizimin e këshillave nacionalçlirimtarë të fshatrave të Skraparit dhe u fola për detyrat e mëdha të këtyre këshillave si gjatë luftës ashtu dhe për të ardhmen. Biseduam për organizimin e gruas dhe të rinisë në fshatra dhe u gëzova kur dëgjova se sa mirë po zgjidheshin këto probleme në ato anë.

Plaku që ishte shumë kureshtar, gëzohej nga fjalët, e mia dhe herë pas bere më përqafoje nga kënaqësia, më jepte uratë dhe më uronte «për gojën e mirë», siç shprehej ai, sidomos kur shpjegova se qysh do të ishte Shqipëria kur të shporrej armiku.

Kështu kaloi pjesa më e madhe e asaj nate dhe. të nesërmen, pasi kisha marrë një sy gjumë, dola nëpër fshat. Nuk kishte gëzim më të madh për mua kur atje erdhën e m'u hodhën në qafë dy shokë të rinj, të dy partizanë. I njoha menjëherë, i kisha pasur nxënës në Liceun e Korçës. Njëri nga ata më duket ishte nipi i xha Mahmudit, tjetri nuk ishte skraparlli. Kishin ardhur në Zalosnjë me mision që të përgatitnin dhomën e bazat e tjera të nevojshme për zhvillimin e një mbledhjeje të rëndësishme, të Konferencës së Parë të Vendit me Aktivin e Rinisë Komuniste të Shqipërisë.* *(Kjo Konferencë i zhvilloi punimet në Zalosnjë të Skraparit më 9-13 qershor 1943.) Atje do të vinin edhe Nakoja me Nexhmijen e shokë të tjerë të Komitetit Qendror të Rinisë, po këta unë nuk i takova dot, se nuk kishin arritur akoma. Lashë për Nakon përshëndetjen që kisha përgatitur për Konferencën e Rinisë2 * *(Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, f. 304.) dhe një letër për Nexhmijen.

Erdhi edhe momenti që të ndahesha nga njerëzit trima, bujarë e punëtorë të Skraparit.

I shoqëruar nga disa partizanë e bashkë me karrrierin, morëm rrugën për në Korçë. Udhëtuam në kodra e male derisa arritëm në Mazrekë. Atje kishin dalë shokët e Korçës të më prisnin: komandant Teki Kolaneci, Zalo Zvarishti, Agush Gjergjevic, Hasan Moglica, Asllan Gura edhe shokë të tjerë. Pasi u përqafova e u përshëndetëm, morëm rrugën drejt për në Lavdar, sepse kisha lajmëruar që atje të mblidheshin shokët e Qarkorit dhe komandantë të çetave, pasi do t'u flisja për situatën politike, për gjendjen e ushtrisë sonë, për luftën dhe veçanërisht për fraksionin e Sadik Premtes e masat që mori Partia për shkatërrimin e tij. Në Lavdar arritëm në mbrëmje. Ai ishte akoma i padjegur në ato kohë dhe kishte shtëpi të mira. Ky fshat ishte qendra e partizanëve. Matanë Lavdarit ishte Punëmira, ku ne kishim edhe depo me ushqime e me veshmbathje, që i mblidhnim në popull ose ua kishim rrëmbyer armiqve dhe i depozitonim atje për t'ua shpërndarë çetave e reparteve partizane që kishin nevojë. Atë natë fjetën në Lavdar. Në mëngjes filluam mbledhjen, në të cilën, në qoftë se nuk gabohem, ishin nja 25-30 shokë. Në këtë mbledhje unë u fola shokëve për ato gështje që përmenda më lart dhe ata më njohën me situatën në qarkun e Korçës. Pastaj, i shoqëruar nga Tekiu dhe nga Asllani, kaluam edhe nëpër fshatra të tjera dhe arritëm në Gurë, ku hëngrëm drekën në një shtëpi që ishte e lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Prej aty kaluam në zona të tjera të Korçës e, pasi u ndava me Tekiun e me Asllanin, u hodha në Kucakë, ku qëndrova disa ditë. Më vonë kalova nëpër Mokër dhe aty nga fundi i qershorit 1943, mbërrita në Labinot të Elbasanit.

Nga i gjithë ky udhëtim, nga takimet me shokët drejtues të Partisë, me komunistë, me çeta partizane të zonave nga kalova, krijova bindjen se Partia jonë ishte forcuar, se ajo ishte zhvilluar dhe ishte përhapur në të gjitha zonat ku kalova. Nga takimet e bisedat dhe nga raportimet e shokëve, konstatova se rrënjët e Partisë ishin të shëndosha, se elementët komunistë që ishin pranuar në Parti ishin të vendosur. Pavarësisht se ngritja ideologjike e një pjese të madhe të komunistëve të rinj linte shumë për të dëshiruar, ata i karakterizonte vendosmëria, shpirti luftarak, dëshira për të mësuar e devotshmëria për ta çuar çështjen gjer në fund. Kjo ishte një garanci e madhe për të ardhmen dhe isha i bindur se me një punë më të dendur e më të kujdesshme nga ana jonë, në luftë e sipër komunistët do të përgatiteshin më mirë edhe ideologjikisht, do të përvetësonin ideologjinë marksiste-leniniste të Partisë. Shokë punëtorë, fshatarë të varfër ose intelektualë patriotë me tradita patriotike në familje, ishin bërë anëtarë partie dhe ishin inkuadruar në çeta e në reparte partizane, pra, Partia kishte elementë të vendosur për luftë.

Në takimet e bisedat që pata me fshatarët, pashë se këta ishin entuziastë dhe me besim të patundur në fitore. Ata me thirrjen e Partisë ishin ngritur dhe, në çdo aksion që organizonte çeta ose Qarkori i Partisë, i përgjigjeshin thirrjes, rroknin armët dhe të inkuadruar zinin pozicionet për të sulmuar kolonat e armikut, qofshin këto kolona transporti, ose kolona trupash. E tillë ishte situata në Vlorë, në Mallakastër, në Skrapar, në Korçë e në Mokër. Kjo ishte shumë optimiste dhe shpresëdhënëse, sepse lufta kundër pushtuesit do të rezultonte me sukses të madh, me çlirimin e Shqipërisë, me çlirimin e dyfishtë si nga pushtuesi i huaj edhe nga bejlerët e agallarët, të cilët kishin filluar të lidheshin hapur me pushtuesin drejtpërdrejt ose nëpërmjet Ballit Kombëtar.

Tash që edhe lufta për shpartallimin e fraksionit të Sadik Premtes përfundoi me sukses, gjithë Partisë dhe udhëheqjes së saj u duhej që me forca të shumëfishuara të mobilizoheshin për zbatimin e plotë e në stil të gjerë të vendimeve të rëndësishme të Konferencës së Parë të Vendit. Sigurisht, puna për këtë kishte filluar menjëherë pas Konferencës, por tash shtrohej detyra që të fitonim edhe atë kohë që na u desh të harxhonim për të larë hesapet me fraksionistët.

Përpara kishim detyra shumë të mëdha. Lufta Nacionalçlirimtare sa vinte po bëhej më masive, më e ashpër, më e përgjakshme. Populli i ngritur në këmbë po mobilizohej gjithnjë e më tepër dhe këto masa njerëzish patriotë kishin nevojë për një udhëheqje të vendosur e të drejtë si dhe për një organizim që t'u përgjigjej sa më mirë entuziazmit e shpirtit të tyre të sakrificës.

Për të realizuar këto, duhej forcuar, në radhë të parë, Partia ideologjikisht, politikisht dhe organizativisht, të forcohej e të kalitej uniteti në udhëheqjen e në krejt bazën e saj. Kryerjes së kësaj detyre primordiale i vumë rëndësi të veçantë, duke bërë të gjitha përpjekjet për shtrirjen e Partisë në masat, në radhë të parë në klasën punëtore e në fshatarësi, për futjen e Partisë në ato zona ku influenca dhe puna e saj ishin më të dobëta; për lartësimin e vazhdueshëm të shokëve, përmes aksioneve si edhe formave e rrugëve të tjera të mundshme të edukimit etj. Gjithë synimi ishte që Partia jonë të ngrihej në lartësinë e vendimeve që përcaktoi Konferenca dhe e detyrave të mëdha që shtronin zhvillimi i situatave në përgjithësi dhe zhvillimi i vetë luftës së Partisë e të popullit tonë.

Udhëheqja e Partisë e kishte të qartë rrugën nga do të ecte Lufta Nacionalçlirimtare, si do të kalohej nga çetat e njësitë në batalione e brigada, në divizione e korparmata, që do të kishin në krye një shtab drejtues operativ, siç u bë Shtabi i Përgjithshëm që u krijua më 10 korrik 1943. Kështu, me maturi e me konsekuencë ne i organizuam luftëtarët e lirisë në një ushtri të rregullt, radhët e së cilës rriteshin pa ndërprerje, në ushtrinë e popullit kryengritës. Me këtë ushtri dhe bashkë me popullin, të organizuar në Frontin Nacionalçlirimtar, ne do t'i jepnim armikut goditje pas goditjesh, të paprera, pa kompromise, derisa ta çlironim vendin nga pushtuesit e tradhtarët. Në luftë e sipër kishte lindur pushteti i ri popullor, i cili do të forcohej vazhdimisht derisa të vendosnim një rend shoqëror demokratik e popullor.

Këto ishin punë të mëdha që Partia jonë do t'i kryente me nder e pa lëkundje, sepse ia ndriçonte rrugën ideologjia e saj. Por sa probleme të ndërlikuara do të dilnin, sa pengesa e vështirësi, të parashikuara e të paparashikuara, të mëdha e të vogla, sa armiq do të na dilnin veç atyre që i kishim përballë grykës së pushkës, ç'punë e madhe edukuese e organizuese kërkohej nga Partia, nga komunistët që të arriheshin të gjitha këto !

Teksti i Historisë së PPSH, dokumentet e botuara e të pabotuara, i pasqyrojnë saktë këto. Edhe unë kam kujtimet e mia të shumta e të pashlyeshme nga lufta dhe nga puna e Partisë, për organizimin e Frontit Nacionalçlirimtar, të Luftës Nacionalçlirimtare dhe për vendosjen e pushtetit popullor; i kam hedhur e po i hedh këto në letër, duke u mbështetur në kujtesën time, në shënimet që kam mbajtur, si dhe në dokumentet e asaj periudhe.

Pikërisht në këtë periudhë, sa më shumë që i afrohem fitores, aq më i egër bëhej terrori, aq më shumë tërbohej reaksioni për ta mbytur në gjak luftën e popullit shqiptar që udhëhiqte Partia. Këto ne do t'i kapërcenim siç i kapërcyem, me luftë e me sakrificë. Por nuk qenë vetëm nazifashistët e tradhtarët e Ballit e të Legalitetit që luftonin kundër nesh. Çdo ditë e më tepër e ndienim ne edhe pabesinë e «aleatëve» anglo-amerikanë, të cilët nëpërmjet misionëve të tyre, me metodat e veta shekullore, kurdisnin plane e intriga, flirtonin me krerët tradhtarë «nacionalistë» e bashkëpunuan hapur me ta, deri edhe me nazistët, mjaft që Shqipëria «të mos u dilte nga dora». Por Shqipëria u iku nga dora. Si? Ç'rrugë ndoqi, ç'qën drime mbajti, si luftoi e manovro!, pra, Partia jonë me këta «aleatë» gjatë luftës e në vitet e para të pasçlirimt, gjë që bëri të mundur që Shqipëria të mos kthehej në një Greqi të dytë?! Edhe kjo është një histori më vete, por këtu s'është as vendi, as rasti të flasim hollësisht për të. Le ta lëmë për një herë tjetër.

Paralelisht me ndërhyrjet e komplotet e «aleatëve» e, shpesh në akord me ta, veganërisht pas Konferencës së Parë të Vendit të PKSH, nisën të shfaqeshin më hapur edhe qëndrimet e veprimet e shtrembra e armiqësore të «të dërguarve» të Titos. Sa më tepër i afrohem ditës së fitores, aq më shumë të «miqtë» ne po dallonim antimarksistët e antishqiptarët. Deba tet dhe grindjet tona në Labinot, Kucakë, Helmës, Odriçan me Tempon, Stojniçin, Dizdareviçin e të tjerë, në nëntorin e vitit 1944 në Berat do të merrnin formën e një lufte të ashpër, të rëndë e me pasoja të mëdha për të ardhmen. Njerëzit e Titos atje do të organizonin prapaskenën e tyre të ndyrë e të poshtër në përpjekjet e ethshme për realizimin e planeve të tyre të errëta. Ata, me agjentët e tyre Koçi Xoxe me shokë, deshën që në Berat ta goditnin Partinë tonë në zemër, por zemra e Partisë Komuniste të Shqipërisë ishte prej çeliku dhe nuk u tund as atje e as nga sulmet e tjera të ethshme që titistët vazhduan pa ndërprerje. Më 1948 ne premë çdo marrëdhënie me ta, duke i demaskuar e dulce i denoncuar hapur e publikisht.

Por këto janë vetëm konturet e një historie të gjatë, plot ngjarje të ashpra e dramatike, plot përpjekje e ndeshje të pandërprera.

Për to ka shkruar gjerësisht historia jonë, për to edhe unë kam folur e kam shkruar shumë herë. E megjithatë akoma kanë mbetur shumë për të thënë e për të treguar edhe për titistët, për marrëdhëniet dhe për luftën tonë konsekuente kundër tyre.

I përmenda këtu të gjitha këto vetëm për të treguar se ç'luftë të vështirë, të madhe e të gjithanshme. me armiq të egër e të të gjitha llojeve iu desh të bënte Partisë Komuniste të Shqipërisë që në vitet e para të jetës së saj. Por kjo luftë vetëm e forcoi dhe e kaliti më tej Partinë tonë të shtrenjtë. Nga këto beteja ajo dilte gjithnjë fitimtare dhe më e vendosur për ta çuar çështjen e madhe të lirisë e të së ardhmes së atdheut gjer në fund. Dhe kështu ndodhi vërtet. Ne bijtë dhe ushtarët e saj i dhamë Partisë, që në ditën e krijimit të saj, gjithçka: gjakun tonë, mendjet e zemrat tona, tërë forcat dhe energjitë, tërë ëndrrat e dëshirat revolucionare. Dhe Partia, nga ana e sai, na dha neve gjithçka: ajo na rriti e na edukoi, ajo na hodhi nga beteja në betejë, ajo na çoi në fitoren më të madhe të historisë shumëshekullore të popullit tonë - në çlirimin përfundimtar të Shqipërisë, në vendosjen e pushtetit popullor, në socializmin që gëzojmë, zhvilloimë dhe e mbrojmë si sytë e ballit.